KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES

REVISTA USHTARAKE

Organ teoriko-shkencor
i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes

Nr. 3/2013

Tiranë, shtator 2013

Këshilli Botues i Revistës Ushtarake
Miratuar me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes Nr. 1721, datë 10.10.2012

Kryetar
Gjeneral Brigade Bardhyl Hoxha, Komandant i KDS

Anëtarë
Kolonel Ahmet Leka
Kolonel Dr. Agim Q Sula
Gjeneralmajor (R) Prof. Dr. Ruzhdi Gjatoja
Gjeneralmajor (R) Prof. Dr. Kostaq Karoli
Kolonel (R) Prof. Dr. Pëllumb Danaj
Kolonel (R) Thimi Hudhra

Kryeredaktor
Ajet Nuellari

Redaktore
Silvana Markgjonaj

Art design
Teuta Mullisi

ISSN 2227-8133 (Print), ISSN 2227-8141 (Online)

Copyright © 2012 nga Qendra e Doktrinës (QD) të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes).

Copyright © 2012 by the Center for Doctrine (CD) of the Albanian Training and Doctrine Command.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në Revistën Ushtarake janë tërësisht të autorit/autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë politikat apo pozicionet zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm dhe Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

Autori/Autorët e shkrimeve të Revistës Ushtarake nuk do të jenë subjekt i ndëshkimit për shprehjen e lirë të qëndrimeve e pozicioneve të tyre individuale edhe sikur përmbajtja e tyre të mos jetë në përputhje me qëndrimet zyrtare të institucionit të mbrojtjes.

Njëkohësisht, autori/autorët mbajnë përgjegjësi për shtrembërimet e fakteve si dhe kopjimet e pareferuara të krijimeve dhe mendimeve të autorëve të tjerë.

Ky botim i Revistës Ushtarake gjendet në website http://www.tradoc.mil.al/

Në rast se nuk mund të merrni informacionin që kërkoni në internet lutemi të kërkoni një kopje të tij në adresën: e-mail: *revistaushtarake@aaf.mil.al* ose *qd@aaf.mil.al*

Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes

Qendra e Doktrinës

Dega e Botimeve
Shtypur: shtator 2013

PËRMBAJTJA

Siguria kombëtare dhe kontributi në sigurinë globale 7
(Pjesë nga programi i qeverisë për mbrojtjen, 2013-2017, "Aleanca për Shqipërinë Evropiane", Tiranë 2013)

RUBRIKA E PARË: Analiza, sinteza dhe vlerësime të sigurisë

Roli i "Soft Security" në kuadër të sigurisë tradicionale 11
Gj. B. Bardhyl Hoxha
Komandant i KDS

Modeli i lidershipit ushtarak dhe shekulli i 21-të 20
Kol. Dr. Idriz Haxhiaj
Shef i Qendrës së Simulimeve, KDS

Përcaktimi dhe zhvillimi i konceptit të sigurisë 29
Bedri Bytyçi
Student në Programin MSc. "Siguria Kombëtare", AFA

Zgjerimi i NATO-s me anëtarë të rinj 41
Kolonel (R) Kristaq Birbo
Drejtor Ekzekutiv i Këshillit të Atlantikut të Veriut

Kultura për sigurinë rrit vetëdijen në zbatimin e detyrave 48
N/kol. (R) Dr. Ulsi Meta

Diplomacia Publike dhe Komunikimi 56
Bonin Toptani
Student në Programin MSc. "Siguria Kombëtare", AFA

Inteligjenca-element i rëndësishëm i vendimmarrjes politike 66
Ismail Skënderaj
Student në Programin MSc. "Siguria Kombëtare", AFA

Gjuha, faktor jetësor i gjeopolitikës kombëtare 75
MSc. Granit Zela
Programi i Doktoraturës, 2011-2014, AFA
Silvana Markgjonaj
Studente në Programin MSc. “Siguria Kombëtare”, AFA

Roli i lidershipit në kuptimin e zbatimin e procesit gjinor në FA 90
Kolonele (R) MSc. Suzana Jahollari
Pedagoge në AFA
MSc. Mentor Isufaj
Programi i Doktoraturës, 2011-2014, AFA

Koncepti i përdorimit të FA të RSH në operacione kombëtare dhe ndërkombëtare 100
Kolonel David Rroku
Shef i Departamentit të Operacioneve, AFA
Nënkolonel Beqir Tafili
Kursi i Lartë i Oficerit

RUBRIKA E DYTË: Punime nga AFA

Ushtaraku, një profesion bashkëkohor me standarde dhe kërkesa të larta 114
Kol. Prof. As. Dr. Kristaq Xharo
Shef i Departamentit të Lidershipit, AFA

Metodologjia e Kërkimit Shkencor, jo vetëm modul i një programi mësimor 120
Dr. Simon Gega
Pedagog në AFA

Rreziku në luftë sipas Klauzeviçit dhe reflektimi në Doktrinën Ushtarake 127
Prof. Dr. Pajtim Ribaj
Pedagog në AFA
N/kolonel Armir Çani
Kursant KLO

Nocioni i pikës kulmore në mbrojtje dhe mësymje 133
Prof. Dr. Kostaq Karoli
Pedagog i Departamentit të Operacioneve, AFA
N/kolonel Edmond Sardi
Kursant i KLO

Fuqia luftarake kërkon aftësi drejtimi dhe përgatitje të lartë ushtarake 144
MSc. Luftim Dema
Shefi i Sektorit të Taktikës, AFA
MSc. Agim Gjini
Specialist në QD, KDS
Nënkolonel Ali Mali
Kursant KLO

Informacioni dhe zbulimi, faktor i rëndësishëm në vendimmarrje 158
MSc. Vladimir Imeraj
Pedagog i DO
Nënkolonel Besnik Cukali
Kursant KLO

Refleksione të veprës së Sun Tzu në Artin Ushtarak të FA 168
Nënkolonel Arjan Rroshi
Pedagog në AFA

Drejt harmonisë apo përplasjes së qytetërimeve? Huntingtoni i gabuar? 175
MSc. Lindita Mukaj
Programi i Doktoraturës 2010-2013
Akademia e Forcave të Armatosura

Siguria mjedisore në dokumentet strategjike të Shqipërisë 182
MSc. Enkeleida Sallaku

RUBRIKA E TRETË: Studime historike

Strategjia dhe Mendimi Ushtarak Shqiptar në periudhën e Luftës së Ftohtë 192
Kolonel Ahmet Leka
Shef i Qendrës së Doktrinës, KDS
MSc. Evis Sadikaj

Reformimi i Ushtrisë Shqiptare deri në anëtarësimin e saj në NATO 207
Nënkolonel Leonard Çoku
Shef i Degës së Personelit në KDS

Operacioni Gjerman i Dimrit në Luginën e Shushicës (dhjetor 1943-shkurt 1944) 220
Kolonel (R) Mikado Shakohoxha

Roli i Kinës dhe Iranit në zhvillimin e Afganistanit 225
Kol. Dritan Demiraj
Komandant i Batalionit të FS

Përmbledhja në anglisht 235

Kujtesë për bashkëpunëtorët 249

Siguria kombëtare dhe kontributi në sigurinë globale

(Pjesë nga programi i qeverisë për mbrojtjen, 2013-2017, "Aleanca për Shqipërinë Evropiane", Tiranë 2013)

Programi për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare do të vazhdojë të mishërojë standardet dhe parimet e Aleancës së Atlantikut të Veriut. Ndër parimet bazë të saj, siguria kombëtare përbën themelin për një zhvillim demokratik dhe rritje të qenësishme ekonomike të vendit.

Reformimi i Forcave të Armatosura, në përputhje me standardet e NATO-s, do të synojë rritjen e shkallës së profesionalizmit, depolitizim, dinjitet dhe integritet, duke e kthyer atë në një forcë aktive, në shërbim të vendit dhe të denjë për standardet e vendeve anëtare të Aleancës.

Hapat kryesorë për arritjen e këtyre objektivave do të fillojnë nga angazhimi institucional për përgatitjen e Dokumentit të Strategjisë Kombëtare.

Ky dokument i rëndësishëm do të hartohet në përputhje me kushtet e reja të mjedisit të sigurisë si dhe bazuar në "Konceptin e ri Strategjik" të Aleancës, të vitit 2010. Pas miratimit në Kuvendin e Shqipërisë, qeveria do të përgatitë Dokumentin e ri të Strategjisë Ushtarake, për të realizuar përputhjen e nivelit të ambicieve kombëtare me burimet financiare në fushën e mbrojtjes, të parashikuara këto në Dokumentin e Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes.

Qeveria do të mundësojë kryerjen e një reforme të thellë në Forcat e Armatosura, në pikëpamje doktrinare, konceptuale dhe strukturore, me qëllim që të rrisë profesionalizmin, të sigurojë depolitizimin e strukturave dhe të forcojë luftën kundër korrupsionit.

Një platformë e fuqishme do të hartohet për rritjen e bashkëpunimit me NATO-n, me vendet anëtare dhe ato partnere, për një mbështetje më të madhe të tyre në arritjen e standardeve të kërkuara dhe realizimin e kontributit tonë në misionet e mbrojtjes kolektive dhe ato paqeruajtëse, të drejtuara nga Aleanca.

Qeveria do të hartojë një plan afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të FARSH për periudhën 2013-2020. Synimi i hartimit e zbatimit të planit afatgjatë të zhvillimit do të jetë:

- Krijimi i një strukture të re organizative të FA, duke ulur në mënyrë të përshkallëzuar numrin aktual të personelit.

- Rishikimi në tërësi i sistemit të edukimit, arsimimit dhe trajnimit të Forcave të Armatosura, me qëllim përgatitjen e ushtarit profesionist, nënoficerit, oficerit të trupës dhe oficerit të shtabit të Forcave të Armatosura, në përputhje me nevojat e strukturës së re të kësaj force.

Përparësi do të marrë realizimi i gatishmërisë operacionale të Grup Batalionit të Këmbësorisë së Mekanizuar si dhe Grupit të Forcave Tokësore për Operacionet Speciale, duke përmbushur në këtë mënyrë, detyrimet ndaj NATO-s në kapacitetet ushtarake, të kërkuara për mbrojtjen kolektive dhe operacionet e ruajtjes së paqes.

Ne do të ripunojmë kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e Forcave të Armatosura. Në thelb të kësaj pune do të jetë përmirësimi i Statusit të Ushtarakut, me synim rikthimin e dinjitetit të nëpërkëmbur dhe rritjen e besimit të tyre tek shteti.

Rishikimi i kuadrit ligjor për përmirësimin e trajtimit financiar të ushtarakëve aktivë është një domosdoshmëri për mbajtjen dhe tërheqjen e burimeve njerëzore cilësore në Forcat e Armatosura për të ardhmen, por edhe për trajtimin dinjitoz të ushtarakëve në rezervë dhe lirim.

RUBRIKA E PARË

Analiza, Sinteza dhe Vlerësime për Sigurinë

Në këtë rubrikë autorët sjellin mendime dhe vlerësime për sigurinë në vend e rajon, duke shprehur pikëpamjet dhe konsideratat e tyre, në mënyrë analitike apo duke bërë sintezë dhe cilësime ndaj gjendjes dhe rrugëzgjidhjeve për kohën dhe hapësirën që na rrethon.

Rubrikës i paraprin një pjesë nga programi i Qeverisë Shqiptare për "Sigurinë kombëtare dhe kontributin në sigurinë globale" për vitet 2013-2017. Reformimi i Forcave të Armatosura, në përputhje me standardet e NATO-s, do të synojë rritjen e shkallës së profesionalizmit, depolitizim, dinjitet dhe integritet, duke e kthyer atë në një forcë aktive në shërbim të vendit dhe të denjë për standardet e vendeve anëtare të Aleancës. Hapat kryesorë për arritjen e këtyre objektivave do të fillojnë nga angazhimi institucional për përgatitjen e *Dokumentit të Strategjisë Kombëtare*.

Në trajtesat e tjera analizohen problemet e sigurisë dhe mbrojtjes. Gjeneral Brigade Bardhyl Hoxha, në shkrimin e tij, analizon problemet e sigurisë në mjedisin e sotëm, një çështje kjo shumëdimensionale. Në thelb, autori thotë se siguria merret me parandalimin ose frenimin e kërcënimeve. Autori thekson se instrumentet ndërkombëtare dhe ato kombëtare të të gjitha shteteve demokratike, çdo ditë e më tepër, prodhojnë më shumë siguri e besim për një botë më të mirë.

Kolonel (R) Kristaq Birbo bën një pasqyrë mbi debatin për fytyrën e ardhshme të NATO-s dhe shikon të ardhmen e saj me aleatë të rinj nga Ballkani Perëndimor si: Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, Bosnje Hercegovina, Kosova. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e stabilitetit afatgjatë në Ballkanin Perëndimor, kjo shihet si një progres i bërë deri tani nga ana e Bosnjës, Malit të Zi dhe Serbisë. Këto vende pritet të marrin ftesën e anëtarësimit në NATO.

Në artikullin "Kultura për sigurinë rrit vetëdijen ndaj detyrave", Dr. Ulsi Meta analizon përgjegjësinë që ka çdo nëpunës i administratës shtetërore për të marrë përsipër më shumë ndaj vetes, për të rritur sigurinë ndaj detyrës dhe vendit të tij.

Edhe në shkrimet e tjera nënvizohet dhe vihen në dukje puna dhe përpjekjet institucionale të strukturave të mbrojtjes për rritjen e sigurisë në fushën e lidershipit, komunikimit, zbulimit, në fushën operacionale, në gjeopolitikë, etj.

Si përfundim, mund të themi se jetojmë në këtë botë me të mirat e të këqijat e saj. Është në nderin e çdo qytetari, që për ditë të pyesë veten: Ç'bëra unë sot për sigurinë kombëtare, për sigurinë time, për sigurinë e njerëzimit?

Roli i "Soft Security" në kuadër të sigurisë tradicionale

Gjeneral Brigade Bardhyl Hoxha,
Komandant i KDS

Trajtesë e shkurtuar. *Mjedisi ndërkombëtar i fillim shekullit XXI është karakterizuar nga pasiguria, paqëndrueshmëria, ndryshimet e shpejta të situatave, nga zbehja e rregullave të vjetra dhe zëvendësimi i tyre me rregulla të reja, të cilat kërkojnë rritjen e aftësive vlerësuese të vendimmarrësve për të reaguar me efektivitet dhe në kohën e duhur. Sipas disa analistëve, bota e sotme është më kaotike dhe zhvillimet e ardhshme janë më të paparashikueshme se në çdo periudhë tjetër në histori.*

Sigurinë mund ta përcaktojmë në terma të përgjithshëm si siguri ose liri nga frika dhe rreziku. Në mënyrë tradicionale, studimet e sigurisë janë fokusuar kryesisht në kërcënimin, përdorimin dhe kontrollin e forcave ushtarake. Megjithatë që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë, koncepti i sigurisë është zgjeruar, duke përfshirë sigurinë shtetërore, shoqërore, si dhe sigurinë njerëzore[1]

Përzierja dhe metoda në lidhje me mënyrën se si politikat e sigurisë "hard dhe soft" zbatohen në kohë paqe, krize dhe konflikti, janë ende çështje në diskutim. Ekziston një diskutim i madh thelbësor mes studiuesve dhe ekspertëve në atë se si të bëhet përdorimi më i mirë të këtyre politikave. Emëruesi i përbashkët në diskutime të tilla duket të jetë se elementët e sigurisë së butë janë të një natyre mjaft parandaluese dhe të përdorura më mirë ndikojnë për të rikrijuar stabilitetin dhe për të përhapur normalitetin në zonat e nxehta.

Sot argumentohet se nëpërmjet thellimit të bashkëpunimit dhe dialogut si dhe shtimit të ndihmave financiare dhe programeve të zhvillimit, qëllimi i tanishëm është për të

[1] ***Siguria Shtetërore*** lidhet më shumë me masat për sigurinë dhe mbrojtjen tradicionale të vendit dhe ka të bëjë kryesisht me ruajtjen e sovranitetit, mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të pavarësisë.
Siguria Shoqërore lidhet me sigurinë dhe mbrojtjen e popullsisë civile dhe të grupeve shoqërore nga emergjencat e shkaktuara nga natyra, incidentet industriale ose gabimet njerëzore, si dhe nga terrorizmi etj.
Siguria Njerëzore synon mbrojtjen e te drejtave të njeriut sipas Rezolutës 1674 të OKB në kuadrin e "*përgjegjësisë për të mbrojtur*" popullsitë nga gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, spastrimet etnike, krimet e luftës etj.

neutralizuar natyrën e dhunshme potenciale të kërcënimeve "soft" dhe për t'i parandaluar ato të kthehen në kërcënime "hard" në një periudhë afatgjatë.

Diskutimi sot rreth kësaj fushe, ka si qëllim të artikulojë politikën e përgjithshme dhe "negociatat" e planifikimit si dhe sugjeron strategjitë e mundshme të rregullimit dhe zbutjes. Qëllimi përfundimtar është për të krijuar një sistem të qëndrueshëm në rajon/shtetin në objektiv, aq sa ndihma nga jashtë nuk është më e nevojshme dhe të gjitha format e kërcënimeve "soft" dhe "hard" bëhen të parëndësishme.

Koncepti dhe përqasja ndaj *"Soft Security"*

Kuptimi i *"Soft Security"* dhe *"Hard Security"*

Siguria është përcaktuar në aspektin e perceptuar të kërcënimeve dhe rreziqeve. Veçanërisht në mjedisin e sotëm kompleks, kjo është një çështje shumëdimensionale dhe evazive.

Në thelb, siguria merret me parandalimin ose frenimin e kërcënimeve. Ka dy kategori që mund të përdoren për të përcaktuar kërcënimet: (a) kërcënimet *hard* dhe (b) kërcënimet *soft.* Terrorizmi dhe armët e shkatërrimit në masë janë pranuar përgjithësisht si kërcënime *hard*, kurse varfëria e skajshme, diferenca midis dhe brenda shoqërive dhe përhapja e sëmundjeve ngjitëse apo ndryshimit të klimës dhe degradimi mjedisor, bien nën kategorinë e kërcënimeve të buta.[2] Kjo listë nuk është, në asnjë mënyrë, shteruese. Dikush mund të shtojë në listën e kërcënimeve të buta konfliktet ndëretnike, emigrimin e paligjshëm dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Kërcënimet kibernetike të cilat mund të shkaktojnë dëme të mëdha në infrastrukturën ekonomike dhe sociale të vendeve, janë konsideruar gjithashtu si kërcënime të buta.

Në realitet, nuk ka linja ndarëse të prera qartë mes kërcënimeve *hard* dhe *soft*. Ato janë të ndërlidhura dhe kërkojnë një qasje gjithëpërfshirëse dhe ndërdisiplinore.[3] Në fakt, një kërcënim *soft* lehtësisht mund të kthehet në një kërcënim *hard.* Realizimi i përfitimeve nga migrimi ilegal, me qëllim financimin e aktiviteteve të tyre të paligjshme, është një shembull i mirë se si organizatat terroriste transformojnë një kërcënim *soft* në një kërcënim *hard*.

Roli i *"Soft Security"* në kuadër të sigurisë tradicionale

Një dallim thelbësor në mes të politikave të sigurisë *hard* dhe *soft* është se shtetet, në mënyrë tradicionale, iu drejtohen metodave konvencionale të tilla si pozicionimi i forcave ushtarake për të siguruar sigurinë *hard*. Megjithatë, në politikat e sigurisë *soft*, përdorimi i forcës konvencionale ushtarake nuk është as i pranueshëm në mënyrë automatike dhe as i preferueshëm. Sidoqoftë, disponueshmëria dhe përdorimi i opsioneve të politikave të sigurisë soft është në funksion të situatës. Për shembull, në qoftë se ka vend për të bashkëvepruar me autoritetet lokale/qendrore, mjetet jo

[2] Kofi Annan, "Secretary General's address to the UN General Assembly," 23 September 2003, New York. http://www.un.org

[3] Kofi Annan, "AIDS is the real weapon of mass destruction" Africa Recovery, United Nations News Releases, December 2003, http://www.un.org

ushtarake, duke përfshirë ndihmën financiare dhe sociale mund të shfrytëzohen me qëllim për të parandaluar një spirale të paqëndrueshmërisë. Këto metoda ndryshojnë në varësi të strukturës politike dhe sociale të rajonit/shtetit, si dhe nivelit të saj të zhvillimit ekonomik dhe financiar.

Në çështjet e sigurisë *hard*, edhe pse civilët kanë një rol më të madh,[4] ata kryesisht janë plotësues, ndërsa në misionet e sigurisë *soft*, civilët udhëheqin përpjekjet. Pjesëmarrja e sektorit civil dhe bashkëpunimi efektiv midis ndëragjencive janë të domosdoshme në zbatimin e politikave të sigurisë *soft*. Vlera e ekspertizës civile, veçanërisht në fushat e informimit publik dhe të aktiviteteve të tjera jo ushtarake është e domosdoshme. Janë civilët që mbajnë kontakte të përditshme me banorët vendas dhe luajnë një rol kryesor në zbatimin e politikave të sigurisë *soft*. Po aq sa bashkëpunimi ndërinstitucional, komponentët civilë të politikave të sigurisë janë të zhvilluar dhe të implementuar në ekspertizën e institucioneve qeveritare të lidhura dhe agjencitë. Prandaj, pavarësisht nga nevoja për personel të mirëtrajnuar dhe infrastrukturë, duhet një mekanizëm konsultimi konstant dhe efektiv.

Synimi përfundimtar është të krijohet një sistem i qëndrueshëm në rajonin/shtetin në objektiv, me qëllim që ndihma nga jashtë të mos jetë më e nevojshme dhe të gjitha format e kërcënimeve *soft* dhe *hard* të bëhen të parëndësishme. Disa shembuj konkretë të misioneve të sigurisë *soft* janë operacioni i NATO-s në Afganistan dhe operacionet policore të BE-së në Bosnjë-Hercegovinë dhe Maqedoni. KFOR *(Kosovo Force)* dhe operacionet SFOR-it (Forca e Stabilizimit në Bosnjë-Hercegovinë) si dhe operacioni i udhëhequr nga SHBA, "Liria e Qëndrueshme në Afganistan" janë misione të sigurisë *hard* të natyrës ushtarake.

Brenda këtij kuadri, organizatat ndërkombëtare kanë shqyrtuar strukturat dhe procedurat e tyre përballë konflikteve. Kombet e Bashkuara që kanë përgjegjësinë kryesore për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, sanksionuar në Kartën e saj, kanë filluar të përqendrohen kryesisht në strategjitë e parandalimit të konfliktit. Si elementë të politikave të sigurisë *soft*, ndërtimi i kapaciteteve kombëtare dhe mbështetja e rolit të shoqërisë civile, me ndihmën e agjencive të specializuara të OKB-së, kanë qenë fushat prioritare të veprimit për OKB-në. Parimi udhëheqës aty ka qenë angazhimi i saj për parimet e pavarësisë politike, barazisë sovrane dhe integritetit territorial të të gjitha shteteve.[5]

OKB-ja ka qenë gjithashtu aktive në operacionet paqeruajtëse shumëdimensionale, në të cilat përgjegjësitë e civilëve janë rritur ndjeshëm. Mes këtyre përgjegjësive mund të jenë:

- Mundësimi i ish kundërshtarëve për të zbatuar marrëveshjet komplekse të paqes, duke u lidhur me një varg aktorësh politikë dhe civilë.
- Koordinimi shpërndarjes së ndihmës humanitare.
- Asistimi në çarmatimin, çmobilizimin dhe riintegrimin e ish luftëtarëve.
- Mbikëqyrja dhe kryerja e zgjedhjeve elektorale.

[4] "Statement by the President of the Security Council," S/PRST/1999/34, 30 November 1999.
[5] UN Security Council Resolution No. 1366 (2001).

- Forcimi i sundimit të ligjit, përfshirë edhe ndihmën me reformën gjyqësore dhe trajnimin e policisë civile.
- Promovimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe hetimi i shkeljeve të pretenduara.
- Asistimi me rimëkëmbjen dhe rehabilitimin pas konfliktit.

Këto detyra shërbejnë gjithashtu si parime udhëzuese për organizatat e tjera ndërkombëtare që kryejnë misione të sigurisë *soft* po aq mirë sa dhe komponentët e tyre civilë.

NATO, nga ana tjetër, e cila karakterizohet në mënyrë konvencionale si një siguri statike *hard*, ka ndërmarrë një axhendë ambicioze të transformimit. Ajo ka përfshirë edhe politikat e sigurisë *soft* në portofolin e saj. Roli i NATO-s në Afganistan është një rast në këtë pikë. Aleanca mori përsipër Forcën Ndërkombëtare të Sigurisë së Ndihmës (ISAF), më 11 gusht, 2003. Ky është misioni i parë i NATO-s përtej zonës euroatlantike. Me miratimin e *Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1510*, mandati i ISAF-it u zgjerua përtej Kabulit. NATO është në Afganistan për të ndihmuar paqen dhe stabilitetin në të gjithë vendin. Për këtë qëllim, NATO ka zhvilluar konceptin e *"Ekipeve Lokale të Rindërtimit" (PRT)*, një mjet praktik i ndërveprimit midis vendeve aleate dhe popullit afgan në teatër.

Bashkimi Europian, nga ana e tij, ka gjithashtu një politikë të plotë dhe gjithëpërfshirëse të sigurisë *soft*, bazuar në të kuptuarit se asnjë rajon nuk është imun ndaj efekteve të konflikteve.[6] *Dokumenti Strategjisë së Sigurisë* të BE-së është sqarues në këtë drejtim. Politikat e sigurisë *soft* të BE-së janë bazuar në supozimin se "konfliktet shkatërrojnë infrastrukturën normale dhe sociale; inkurajojnë kriminalitetin; pengojnë investimet dhe e bëjnë jetën normale ekonomike të pamundur." BE-ja konstaton gjithashtu se kërcënimet kyç në natyrë janë *hard* dhe *soft*: terrorizmi, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë, konfliktet rajonale, shtetet e dështuara dhe krimi i organizuar.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) është organizata më e madhe rajonale e sigurisë në hapësirën euroaziatike dhe euroatlantike, me 55 shtetet pjesëmarrëse, duke mbuluar një sipërfaqe nga *Vankuver*-i në *Vladivostok*. Koncepti i "sigurisë bashkëpunuese", bazuar në të kuptuarit se siguria e zakonshme, në kontekstin e globalizimit, mund të arrihet vetëm nëpërmjet bashkëpunimit në rritje midis shteteve pjesëmarrëse, është ende një nocion i zhvilluar brenda strukturës së OSBE-së.

Kultura si komponent i *"Soft Security"*

Thuhet, midis të tjerash, se kultura lidhet me "mënyrat me të cilat qeniet njerëzore kapërcejnë barbarizmin e tyre origjinal… për t'u bërë plotësisht humanë."[7] Përfytyroni se çfarë ndodhi në Luftën e Ftohtë. Secili bllok ushtarak, pikërisht për shkak të një mbetjeje të barbarizmit në shekullin e 20-të, harxhonte qindra miliardë dollarë për të qenë gati për të shuar njeri-tjetrin. Ky ishte perceptimi i rrezikut dhe kërcënimit.

[6] Uğur Ziyal, *Re-conceptualization of soft security and turkey's civilian contributions to international security.*www.turkishpolicy.comimagesstories2004-02-globalsecurity TPQ2004-2-ziyal.pdfQ2004-2-ziyal.pdf, 09.06.2013

Por, çuditërisht, në vitin 1990, Lufta e Ftohtë mori fund pa zhvilluar asnjë betejë ushtarake. Në fakt, betejë u zhvillua, por ajo nuk u zhvillua në rajone mbrojtjeje, mësymjeje apo desantimi. Ajo u zhvillua në një terren tjetër: në atë të garës ekonomike, garës së zhvillimit, garës së perceptimeve të kundërta. Kuptimi i kësaj rruge të dytë është konkurrenca e mendjes përballë konkurrencës së armëve, konkurrenca e kulturës për të shikuar përpara, përballë kulturës për të mbetur prapa në mentalitetet e barbarisë.

E gjithë kjo fitore, fitorja më e madhe në historinë botërore ishte e tillë jo vetëm pse çtensionoi mijëra mbushje bërthamore, por se çtensionoi, në radhë të parë, mendjet e militarizuara që mbajtën në ankth njerëzimin për gati pesë dhjetëvjeçarë.

Njëzetvjetëshi pas përfundimit të Luftës së Ftohtë na flet akoma më shumë për këtë kapërcim ylberi midis luftës për të shkatërruar çdo kulturë dhe kulturës për të shmangur çdo luftë. Përfytyroni Ballkanin, kultura e të cilit ka qenë historikisht vetëm grindja, vetëm konflikti. Ballkani, sot pas njëzetë vjetësh, është diametralisht një Ballkan tjetër. Popujt e tij janë gjithashtu tjetër. "Të ngulur prej shekujsh në këtë rajon të Evropës, ekzistenca e asnjërit prej tyre nuk mund të kushtëzohet prej tjetrit. Në rast ndërlikimesh, me hir apo me pahir, jemi të detyruar të merremi vesh. Ju duket një vizion i zymtë? Mendoj se ajo që kemi përjetuar para ca vitesh nuk ka qenë më pak e frikshme. Që t'i kthehemi një vizioni më shpresëdhënës, duhet thënë se një drejtpeshim ka qenë vendosur megjithatë historikisht në Ballkan. Sot, në kushtet e Bashkimit Evropian-tutor i pranuar prej të gjithëve, ky drejtpeshim është shumëfish i siguruar."[8]

Në marrëdhëniet ndërkombëtare, kultura ka një vizion tjetër, vizion i cili ia kalon përparësinë bashkëpunimit dhe kanaleve të komunikimit dhe jo perdeve të hekurta që kishin zënë vend midis popujve dhe njerëzve. Në çështje të tilla, të quajtura delikate, siç janë mbrojtja dhe siguria, në vend të kulturës së mbajtjes nën shënjestër të kundërshtarit, u krijua kultura e takimeve miqësore, konsultimeve të përbashkëta, e gjetjes së rrugëve për të kapërcyer së bashku sfidat e sigurisë. Në këtë kuptim, kultura shndërrohet në fuqi, duke përfaqësuar një dimension nevralgjik të fuqisë që i jep formë konceptit të përparësisë së asaj çfarë kuptohet me konceptin "siguri".

Kultura është një mënyrë tjetër e sheshimit të diferencave. Diferencat janë gjithnjë të natyrshme, jo vetëm midis njerëzve, por më shumë midis shteteve e sidomos në një rajon si Ballkani, ku diferencat kanë qenë aq të thella, sa shpesh europianët kanë humbur edhe durimin, e pse jo, edhe besimin ndaj ballkanasve. Ka një arsye objektive pse janë këto diferenca: Ballkani ka qenë dhe, madje, vijon të jetë pika më e madhe e përplasjes midis qytetërimeve, besimeve fetare, kulturave dhe civilizimeve, ndër më të fuqishmet e njerëzimit. Për shkak të këtyre kulturave, çështjet ballkanike të Pasluftës së Ftohtë filluan të zgjidhen me metodat e gati një shekulli më parë, me ato të luftërave ballkanike. Por, më në fund, kultura e qytetërimit dhe e vlerave moderne të zbutjes së diferencave fitoi mbi kulturën e ashpërsimit të mëtejshëm të diferencave të përdorura me petkun nacionalist.

[7] Velkley, Richard (2002). "The Tension in the Beautiful: On Culture and Civilization in Rousseau and German Philosophy". *Being after Rousseau: Philosophy and Culture in Question*. The University of Chicago Press. pp. 11–30.

[8] Kadare, Ismail, Intervistë: "U projektua dëbimi i një populli, serbët nuk e dënuan. Turp!" www.balkanweb.com/ 2012-05-25

Arsimimi si komponent i *"Soft Security"*

Të lidhësh termin "arsimim" me termin "siguri" duket paksa e çuditshme, e pavend e pa lidhje. Por të mos harrojmë se koncepti "arsimim" nuk ka të bëjë thjeshtë me ciklin formal të përfundimit të një shkolle a kursi, as me certifikimin e studentit me një diplomë apo certifikatë, as me marrjen e disa njohurive e shprehive teknike për të ushtruar një profesion. Arsimimi është një edukim i tërë, një formim i tërë, një kultivim i tërë. Arsimimi, apo *"education"* siç përdoret në gjuhë të tjera, kultivon më shumë aftësi e shprehi teknike, ai ndriçon mendjen, hap horizonte mendimi e gjykimi, kultivon logjikën e arsyen, kultivon vlera personaliteti, dashurie e miqësie, kultivon njohjen e popujve, kulturave, gjuhëve dhe qytetërimeve të tyre. Kështu i arsimuari shkëputet nga rrethi vicioz klasik i urrejtjes, sipas të cilit: *"unë nuk ju dua, sepse nuk ju njoh dhe, duke mos ju njohur, nuk do t'ju dua"* për ta zëvendësuar me vizionin modern të miqësimit sipas të cilit: *"unë po ju njoh dhe prandaj ju dua, duke ju dashur, do t'ju njoh më mirë e më shumë."*

Vetë arsimi në vetvete, në qëllimet që ka, është një investim në siguri në kuptimin që përgatit njerëz me hapësira të gjera mendimi, me alternativa të shumta zgjidhjesh, me pasuri të madhe ndjenjash. Janë pikërisht këto vlera, të cilat nuk nxisin përballje, por paqe e liri. Nga ana tjetër, këto vlera janë një instrument i gatshëm në mendjen dhe psikikën e njerëzve të kultivuar që, në rast rreziku, të peshojnë alternativat dhe jo të bien pré e instrumenteve të forcës, miopisë dhe zgjidhjeve fataliste. Nuk është e rastit që nismat më të fuqishme ndërkombëtare për paqen përkrahen, në radhë të parë, nga popuj që kanë nivele dhe tregues më të lartë arsimimi.

Bota moderne, veçanërisht pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, ka krijuar mundësi të gjera dhe ka zbatuar praktika të shkëmbimit të dendur të arsimimit të të rinjve e të të rejave në vende të ndryshme. Një realitet i tillë është mbase unik për të rinjtë e të rejat shqiptare, një përqindje e madhe e të cilëve, jo vetëm ata emigrantë, po shkollohen në Europë e deri në SHBA. Ky është një revolucion i tërë, sepse krijon rryma të fuqishme shkëmbimesh, njohjesh, miqësimesh të cilat janë në bazë të sigurisë së çdo vendi. Të gjithë këta të rinj e të reja janë ambasadorët më të mirë, ushtarët më të mirë për të përcjellë sigurinë, pikërisht përmes fuqisë së butë të arsimimit.

Transformimi i kulturës dhe arsimit - investimi më i rëndësishëm në *"Soft Security"*

Përpara viteve '90, Shqipëria edhe pse harxhonte dhjetë herë më shumë burime financiare nga sot, edhe pse kishte më shumë ushtarë e armatime, përsëri ishte në gjendje lufte në rajon dhe ne shqiptarët jetonim më keq e mendonim vetëm për një zgjidhje: për luftën.

Shqipëria tanimë është anëtare e NATO-s. Jo vetëm Shqipërisë, por çdo vendi të sapopranuar, i është dashur normalisht rreth një dhjetëvjeçar për t'u integruar plotësisht. Përse? Pikërisht sepse akti zyrtar i pranimit nuk është njëherësh edhe akti që tregon se sa i integruar është një vend në pikëpamje të standardeve dhe sidomos të kulturës së të bashkëpunuarit në planifikim dhe në operacione.

Që nga muaji shtator i vitit 1996 deri në muajin shkurt 2013, Shqipëria ka angazhuar rreth 6000 ushtarakë në operacione ushtarake të drejtuara nga NATO, BE dhe OKB.

Shqipëria është përfshirë gjithashtu dhe, madje, ka një aktivitet të gjerë në nismat rajonale të sigurisë, sikurse janë *"Adriatik 3"*, që sot është shndërruar në *"Adriatik 5"*. Në kuadër të kësaj nisme, nga pala shqiptare ka filluar *Kursi i Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes* në Tiranë, për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet vendeve të rajonit, përmes arsimimit dhe kualifikimit të përbashkët të personelit të lartë civil e ushtarak nga vendet e rajonit, për çështje të sigurisë dhe politikave të mbrojtjes. Kursi iu siguron pjesëmarrësve mundësinë e promovimit në vendet e tyre të punës. Në këtë kurs shërbejnë si kurrikula referuese materiale të *Qendrës Europiane të Studimeve të Sigurisë "George C. Marshall"*, *Kolegjit të NATO*-s në Romë, *Kolegjit Baltik të Mbrojtjes*, *Kolegjit të Luftës së SHBA-ve*, etj., pra, një kulturë elitare kualifikimi.

Po kështu, në kuadër të nismës *Southeastern European Defense Ministerial* (SEDM) i cili është themeluar përsëri në Tiranë, që prej vitit 1996, shprehen realisht prirjet për kulturë bashkëpunimi dhe integrim rajonal, ku përfshihet nisma e *Multinational Peace Force of South Eastern Europe* (MPFSEE) ose Brigada e Europës Juglindore (SEEBRIG) dhe një numër projektesh të tjera. SEDM bashkon vendet e rajonit në një sërë aktivitetesh, të materializuara në projekte të përbashkëta dhe angazhime në fushën e armëkontrollit, sigurisë së kufijve, luftës kundër terrorizmit, demilitarizimit, shkëmbimit të teknologjisë ushtarake, stërvitjeve të përbashkëta, operacioneve për parandalimin e fatkeqësive natyrore, e deri në ndërmarrjen e misioneve paqeruajtëse jashtë rajonit, duke sjellë një frymë mirëbesimi dhe respekti reciprok. Vendet anëtare e shohin njëri-tjetrin në dritën e miqësisë dhe partneritetit, larg mosbesimit dhe frymës kundërshtuese. Nga ana tjetër, përveç qëllimit të forcimit të lidhjeve të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit ndërmjet vendeve të SEDM, ky proces ka luajtur edhe një rol të madh në afrimin e vendeve jo anëtare të strukturave euroatlantike tek këto struktura, duke e bërë kështu kulturën e bashkëpunimit një kulturë rajonale.

Shqipëria ka bashkëpunim dypalësh në fushën e mbrojtjes dhe atë ushtarake me të gjitha vendet anëtare dhe ato partnere të NATO-s. Bashkëpunimi konsiston në fushat e arsimit, trajnimit dhe kualifikimeve ushtarake. Shqipëria, prej afro 20 vjetësh, ka dërguar në këto vende një numër relativisht të madh ushtarakësh për arsimim e kualifikime. Bashkëpunim i suksesshëm është zhvilluar përmes stërvitjeve të përbashkëta, angazhimeve të përbashkëta në operacione në kuadër të NATO-s, shkëmbim përvojash dhe ekspertizash për fusha të ndryshme, vizita njohëse, etj.

Të gjitha këto zhvillime kanë patur një rezultante domethënëse: Shqipëria ka zhvilluar tanimë një kulturë tjetër nga ajo çka trashëguam nga e kaluara: kulturën e nismës dhe të përgjegjësisë për bashkëpunim, kulturën e të punuarit sipas standardeve të NATO-s si dhe edukimin e arsimimin sipas këtyre standardeve.

Natyrisht, sikurse e thamë më lart, ne ende nuk mund të vetëvlerësohemi se jemi plotësisht të integruar. Por të mos harrojmë se integrimi është një proces dhe jo një datë. Këtij procesi i janë nënshtruar të gjithë pjesëtarët e Aleancës, me kohëzgjatje të ndryshme. E rëndësishme është që edhe për këtë të kemi një kulturë: kulturën që asnjëherë proceset nuk janë të përfunduara. Edhe nga anëtarët e vjetër të NATO-s sot kërkohen konceptime të reja sikurse është ai i *Smart Defense*. Prandaj ne kemi ende shumë për të bërë që të zhvillojmë akoma më tej këtë kulturë.

Kultura dhe arsimi hyjnë në atë pjesë të arsenalit të sigurisë së një vendi që garantojnë

jo thjesht sigurinë, por filozofinë e sigurisë. Kalimi në etapa të ndryshme historike të zhvillimit të njerëzimit si dhe në etapa të ndryshme të ndryshimit të marrëdhënieve ndërkombëtare, duke filluar që nga L.II.B, Lufta e Ftohtë dhe së fundmi Gjenerata e Katërt e Luftës, kanë nxjerrë në pah dhe ndryshime të perceptimit të kërcënimeve dhe rreziqeve si dhe të elementëve pjesëmarrës që ndikojnë në këtë proces.

Ndryshimet kulturore, ashtu siç dhe e përmendëm më sipër, pasqyrojnë në mënyrë të prekshme deviacionin nga një mënyrë reflektimi në një tjetër. E kaluara e deritanishme e zgjidhjes së konflikteve apo e ndërtimit të marrëdhënieve dypalëshe (deri në përfundim të Luftës së Ftohtë) është zëvendësuar me multilateralizëm rajonal dhe global. Ajo ka mbetur thjesht në analet e studimit të historisë. Kultura e tanishme nuk pasqyron pikëndarjet por pikëtakimet në drejtim të përforcimit dhe të rritjes në një shkallë më të lartë të sigurisë. Pra në thelb, kemi ndryshim në mënyrën e të menduarit dhe të vepruarit, ose një kulturë ndryshe komunikimi dhe koherence në bashkëpunim.

Pikënisja e parë për të pasqyruar një kulturë ndryshe në qasjen ndaj sigurisë është, pa dyshim, arsimimi. Ai bën të mundur formësimin e shikimit të zgjidhjes së divergjencave, jo në mënyrën tradicionale por në atë të pranimit ndryshe të shfaqjes së mënyrës së sjelljes dhe të gjykimit, duke zëvendësuar konfliktin me mënyrën e të menduarit ndryshe, karakteristikë e nivelit të lartë të arsimimit.

Shqipëria dhe Forcat e Armatosura po ndjekin plotësimin në vazhdimësi të kritereve drejt integrimit të plotë në NATO, po mbështesin me forca në operacionet ushtarake në kuadrin e OKB, NATO-s, BE si dhe të nismave rajonale si *Adriatik 5*. Krahas këtyre fushave të bashkëpunimit, Forcat tona të Armatosura janë të përfshira në programe të ndryshme trajnimi, arsimimi dhe kualifikimi, si me vendet anëtare të këtyre organizatave ashtu dhe të atyre kandidate.

Në këtë mënyrë, bëhet i mundur ndërveprimi i kulturave dhe arsimimit, duke i shndërruar ato nga individuale në partnere, nga rajonale në globale. Plotësimi i nismave të organizatave ku vendi ynë bën pjesë, siç është *"Smart Defence"*, kërkojnë, nga vendet pjesëmarrëse, "heqjen dorë" nga një pjesë e sovranitetit individual dhe kjo do të thotë që kultura e deritanishme e bashkëpunimit ka ndryshuar në përmbajtje dhe në koncept si pasojë e rritjes, në një shkallë më të lartë, të kulturës si dhe të arsimimit duke bashkëpunuar.

Bashkëpunimi në kuadrin *"Smart Defence"*

Në terma të përgjithshme, sigurinë mund ta përcaktojmë si siguri ose liri nga frika dhe rreziku. Në mënyrë tradicionale, studimet e sigurisë janë fokusuar kryesisht në kërcënimin, përdorimin dhe kontrollin e forcave ushtarake. Megjithatë, që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë, koncepti i sigurisë është zgjeruar duke përfshirë disa nga sfidat e reja të sovranitetit të shteteve dhe integritetit të shoqërive. Kërcënimet e sotme të sigurisë përfshijnë krimin e organizuar, konfliktet etnike dhe ideologjike, korrupsionin, pasigurinë e kufijve, imigracionin ilegal, ndryshimet klimaterike, sulmet kibernetike, përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë dhe natyrisht dhe terrorizmin. Një karakteristikë e dhjetëvjeçarëve të ardhshëm do të jetë rritja e fuqisë së aktorëve jo shtetërorë si rezultat i globalizmit, gjë që mund të fuqizojë individë fanatikë, duke

iu dhënë akses në mjete tepër shkatërruese siç treguan dhe ngjarjet e 11 shtatorit 2001.

Ndryshimet klimaterike do të shoqërohen me një varg të gjerë zhvillimesh të papëlqyeshme të cilat asnjë shtet-komb nuk ka fuqinë t'i frenojë i vetëm. Janë këto kërcënime që do të formojnë mjedisin e ardhshëm të sigurisë të dhjetëvjeçarëve të ardhshëm. Por mjedisi i ardhshëm i sigurisë do të përballet natyrisht dhe me krizën ekonomike-financiare, si rezultat i së cilës të gjitha vendet e aleancës do të përballen me kufizime buxhetore që nuk mund të kuptohen pa kufizime financiare dhe në buxhetet e mbrojtjes. Natyrshëm lind pyetja se si duhet të zhvillohet aleanca me qëllim që t'i afrojë anëtarëve të saj një maksimum sigurie dhe një maksimum ndikimi mbi formësimin e këtij mjedisi të ri? Kjo kërkon zgjidhje të reja, për të siguruar më shumë kapacitete me më pak shpenzime. Është kjo arsyeja që lindi dhe konceptin *"Smart Defence"* që e ka dhe origjinën e shpalosjes së tij në *Qendrën e Politikave Europiane*, në Bruksel, më 30 shtator 2011.

Për këtë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, kur shpjegon konceptin *"Smart Defence"*, nënvizon: "Unë e di që në periudhën e shtrëngesave financiare nuk mund të shpenzojmë më shumë, por nuk mund të shpenzojmë as më pak. Përgjigjja është të shpenzojmë më mirë dhe me paratë që shpenzojmë të arrijmë më të mirën. Të ndihmojmë vendet të ruajnë kapacitetet e tyre, si dhe të sigurojnë kapacitete të reja. Kjo do të thotë që ne duhet të përcaktojmë më mirë përparësitë, të specializohemi për kapacitete të caktuara si dhe të kërkojmë zgjidhje shumëkombëshe. Këto, së bashku, unë i quaj *"mbrojtje e mençur."*[9]

Bibliografia:

- Kofi Annan, "Secretary General's address to the UN General Assembly," 23 September 2003, New York. http://www. un.org
- Kofi Annan, "AIDS is the real weapon of mass destruction" Africa Recovery, United Nations News Releases, December 2003, http://www.un.org
- "Statement by the President of the Security Council," S/PRST/1999/34, 30 November 1999.
- UN Security Council Resolution No. 1366 (2001).
- Ugur Ziyal, *Re-conceptualization of soft security and turkey's civilian contributions to international security.*www.turkishpolicy.comimagesstories2004-02-globalsecurityTPQ2004-2-ziyal.pdfQ2004-2-ziyal.pdf , 09.06.2013.
- Velkley, Richard (2002). "The Tension in the Beautiful: On Culture and Civilization in Rousseau and German Philosophy". *Being after Rousseau: Philosophy and Culture in Question*. The University of Chicago Press.
- Kadare, Ismail, Intervistë: "U projektua dëbimi i një populli, serbët nuk e dënuan. Turp!" www.balkanweb.com/ 2012-05-25
- Fjala e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Rasmussen në Qendrën e Politikave Europiane në Bruksel, më 30 shtator 2011, Revista Ushtarake, Dhjetor 2011.

[9] Fjala e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Rasmussen në *Qendrën e Politikave Europiane* në Bruksel, më 30 shtator 2011, Revista Ushtarake, Dhjetor 2011, faqe 10.

Modeli i lidershipit ushtarak dhe shekulli i 21-të

Kolonel Dr. Idriz Haxhiaj,
Shef i Qendrës së Simulimeve, KDS

Trajtesë e shkurtër. *Po të studiohet spektri i gjerë i drejtimeve kryesore të aktivitetit të FA-së në 20 vitet e fundit dhe intensiteti i kësaj veprimtarie, atëherë do të kuptonim më mirë vitalitetin e tyre, sakrificën dhe energjitë e shpenzuara por edhe gatishmërinë për t'u transformuar, pavarësisht dhimbjeve që kanë shkaktuar reformat e thella. Në të gjithë këtë histori, FA janë rritur dhe përshtatur në mënyrën më shembullore dhe janë të gatshme për të marrë përsipër përgjegjësi të reja. Në këtë kuadër, nevoja për personel të kualifikuar, për lidership vizionar me kurajë e integritet profesional, ashtu si në të gjitha vendet, paraqet një ndër sfidat kryesore të zhvillimit të tyre.*

Epërsia e vlerave dhe e traditave në FA, krijimi i një klime pozitive organizacionale, hartimi dhe miratimi i politikave mbështetëse për personelin ushtar, oficer dhe nënoficer dhe për familjet e tyre, do të bënte të mundur rekrutimin e të rinjve qytetarë të aftë e të ndershëm. Kyçi i suksesit në këtë drejtim është roli i lidershipit politik e ushtarak për t'i krijuar kushte zhvillimi FA-ve, për të ndryshuar kulturën dhe për të përmirësuar strukturën e personelit ushtarak. Për këtë, nevojitet përshtatja e shumë proceseve dhe sistemeve, punë e palodhur dhe krijuese dhe zgjuarsi në adoptimin e formave e metodave efektive dhe të suksesshme. Individë dhe grupe cilësore ekzistojnë me shumicë në të gjitha nivelet dhe fushat e organizimit në FA, por nevojitet sinergjia e tyre për një qëllim të përbashkët, realizimin e misionit ndaj atdheut dhe aleatëve tanë.

FA me performancë në rritje

Të ndodhura në krah të ushtrive aleate e partnere në luftime direkte me talebanët e grupe të tjera terroriste, duke trajnuar ushtrinë afgane në tokat e largëta shkretinore të Afganistanit si në Herat, Kabul, Mazar-e-Sharif; të vlerësuara maksimalisht për aftësitë e ekspertizën e tyre në zbulimin dhe çaktivizimin e minave dhe predhave të mbetura nga koha e konfliktit të përgjakshëm mes serbëve e boshnjakëve në Bosnje e Hercegovinë; në luftë me flakët e zjarreve për të shpëtuar

pasurinë kombëtare në pyjet e Lurës, Dajtit e Llogarasë, pavarësisht se nuk zotërojnë mjetet e pajisjet e duhura; të mobilizuara për të shpëtuar jetën e popullsisë civile dhe pasurinë e saj në zonat e përmbytura në Shkodër e Lezhë; të gatshme për të ndërhyrë në çdo moment që dikush jep sinjalin SOS mes dallgëve të frikshme të detit apo për të fluturuar në çdo moment të kohës e motit për të shpëtuar jetë njerëzish në çdo cep të territorit të vendit, efektivat e FA-ve konfirmojnë se vlera e guximit, moralit dhe profesionalizimit mbeten të pazëvendësueshme në radhët e tyre dhe përbëjnë themelin e suksesit në misione.

Angazhimet e mësipërme janë përballuar, pavarësisht reduktimit në numër që FA kanë pësuar në vite, në kuadër të reformave dhe të dinamikës së ngjeshur të tyre, duke riorganizuar, dislokuar e ridislokuar repartet nga një vend në tjetrin, ndonjëherë edhe në mënyrë të përsëritur e kaotike. Komandat dhe njësitë ushtarake kanë ruajtur operacionalitetin e tyre paralelisht me kryerjen e një procesi transformimi të thellë strukturor e konceptual, në kuadër të anëtarësimit në NATO e kërkesave të këtij procesi. Numri mesatar i ushtarakëve të dislokuar në misione ndërkombëtare, vitet e fundit, ka arritur në mbi 400 vetë. Ata kanë vepruar në kushtet e vazhdueshme të një buxheti jo të mjaftueshëm, si rezultat i tranzicionit që kaloi vendi, efekteve të krizës globale financiare e të gjendjes ekonomike në vend. Njësitë e repartet e FA-ve kanë shfaqur e përsosur vazhdimisht profesionalizimin, pavarësisht largimeve të shumta nga radhët e tyre të personelit oficer profesionist e specialistëve të mirëfilltë, si rezultat i kërkesave të ligjit për gradat e karrierën në FA, i cili me kërkesat që ka, mund të konsiderohet i kaluar, që e ka realizuar misionin e tij e është në nevojë të ngutshme për t'u rishikuar.

Përballë një dinamike të tillë ristrukturimi dhe organizative, ngarkese operacionale dhe aspekteve e ndikimeve të tjera sociale, edhe kompanitë e organizatat më të fuqishme nuk do të rezistonin ndoshta në një mënyrë kaq shembullore sa Forcat tona të Armatosura. Niveli i lartë i angazhimit, sukseset e vlerësimet e arritura në misione ndërkombëtare, detyrat e ngarkuara brenda vendit, dëshira dhe gatishmëria për t'u reformuar dhe përqafimi i të rejave, përfaqëson jo vetëm një qëndrueshmëri institucionale të FA-ve dhe zhvillim strukturor, por edhe një shembull pozitiv shoqëror dhe një periudhë të rëndësishme në të gjithë historinë e tyre.

Në kuadër të transformimit, proceset më të shumta kanë zënë vend për të identifikuar ndryshimet që duhet të ndodhin në strukturën organizative të FA-ve, përmirësimet e teknologjisë, zhvillimet në fushën e komunikimit, përsosjen e proceseve të automatizimit, etj. Por, duhet të pranojmë se ushtria jonë, me karakteristikat dhe madhësinë e saj, buxhetin dhe burimet e tjera në dispozicion, bazohet, në radhë të parë e mbi të gjitha, tek personeli i saj e cilësia e tij. Një pohim i tillë është i vlefshëm edhe për ushtri më të mëdha e më të zhvilluara teknologjikisht. Po të pranojmë këtë, atëherë duhet të shqetësohemi seriozisht rreth aftësisë dhe perspektivës së FA-ve për të zhvilluar kapacitetet e kërkuara intelektuale e njerëzore në dhjetëvjeçarët e ardhshëm ose, e thënë më drejtë, për të ruajtur kapacitetet e tyre operacionale.

Organizatat dhe kompanitë e mëdha e komplekse, pavarësisht fushës dhe veprimtarisë ku ato veprojnë, kanë më shumë ngjashmëri sesa dallime, në lidhje me sfidat me të cilat ato përballen në procesin e thithjes, zhvillimit/kualifikimit dhe mbajtjes në punë

të punonjësve të talentuar e të aftë. Ngjashmëritë më të mëdha në kërkesat dhe cilësitë që duhet të ketë personeli i tyre, janë në nivelet strategjike, pra në nivelin e lidershipit strategjik.

Padyshim që në sektorin ushtarak ka edhe dallime thelbësore në krahasim me sektorët civilë, çka ndikon drejtpërdrejtë në politikat e zhvillimit të personelit. *Së pari*, në çdo shtet ka vetëm një forcë të armatosur dhe një ushtarak nuk mund të transferohet në të njëjtin nivel në një kompani tjetër, ashtu siç mund të ndodhë me një inxhinier mekanik apo menaxher të një niveli të caktuar, i cili lëviz nga një kompani në tjetrën, duke ruajtur profesionin dhe nivelin përkatës. E njëjta logjikë funksionon edhe për fenomenin e anasjelltë. Asnjë punonjës i kompanive të ndryshme nuk mund të transferohet në radhët e FA-ve e të sistemohet në nivele të larta të saj, pasi karriera në FA bëhet vetëm brenda saj. Ky aspekt ka të bëjë me veçantinë e profesionit të ushtarakut, por edhe me rëndësinë e jetëgjatësisë e të vazhdimësisë së tij, çka lidhet drejtpërdrejt me interesat jetike të personelit ushtarak dhe atraktivitetin që paraqesin FA. Dihet se aspektet themelore të një kompanie (por edhe të FA-ve) për të tërhequr, motivuar dhe zhvilluar personel cilësor janë ato të mbështesin dhe të garantojnë sigurinë e personelit. *Së dyti*, kur flasim për veçoritë në sektorin ushtarak, duhet të kemi parasysh gjithashtu që marrëdhëniet epror-vartës janë të mbështetura jo vetëm në ligj por edhe në një traditë e kulturë të veçantë ushtarake. Dhe *së fundi*, duhet të jemi të vetëdijshëm që personeli i lartë drejtues i FA do të promovohet dhe do të dalë nga kontingjentet e brendshme dhe nivelet më të ulëta të FA-ve dhe asnjëherë nuk mund të sigurohet nga jashtë. Ky aspekt ka të bëjë me nevojën për politika afatgjatë dhe largpamëse në fushën e burimeve njerëzore.

Procesi i reduktimit masiv të numrit të personelit dhe njësive ushtarake duket se ka mbaruar dhe është e nevojshme të zëvendësohet me konsolidimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, duke përfshirë rekrutimin cilësor, plane rigoroze edukimi e kualifikimi si dhe programe tërheqëse të mbështetjes së personelit. Largimet e shumta të personelit, bazuar këto jo në dobinë e individëve për FA-të, por në kritere teknike strikte të qëndrimit në gradë e në shërbim, kanë varfëruar ndjeshëm fusha të caktuara, specialitete e sektorë të ndryshëm, megjithëse për efektet negative të tyre nuk janë bërë studime e analiza me objekt të veçantë dhe as ekzistojnë statistika të plota e qarta. Kompanitë private apo edhe institucione të tjera publike do të tregoheshin më fleksibël dhe më të zellshme për të gjetur zgjidhjet e duhura ligjore e procedurale dhe do të bënin të mundur mbajtjen e kontingjenteve njerëzore të dobishme për nevojat e interesat e tyre. Asnjë shkencë apo praktikë e menaxhimit efektiv nuk do ta lejonte që burime akoma me vlerë për organizatën, të nxirreshin jashtë përdorimit apo jashtë inventarit të saj. Nga ana tjetër, individët e aftë dhe të talentuar në FA, në rastin më të mirë, janë angazhuar në aktivitete të dyta private, ndoshta duke siguruar të ardhura më të mira sesa në FA ose po largohen përfundimisht nga FA. Në rastin e parë ata do t'i shërbejnë më mirë atij punëdhënësi që i paguan më shumë, duke i bërë të neglizhojnë dhe të largojnë interesin e tyre përditë e më shumë nga FA.

Situata dhe dinamika në fushën e burimeve njerëzore është komplekse dhe përshkohet nga ndikime e fenomene të ndryshme pse jo edhe kontradiktore. Përpjekjet dhe rezistenca e personelit ushtarak apo civil për të qëndruar në radhët e FA, kur për arsye ligjore i kërkohet largimi, janë të mëdha dhe bëhen në forma nga më të

ndryshmet. Kërkesat për rekrutime të reja, në çdo kategori të personelit ushtarak e civil, janë të shumta në numër. Aspektet e mësipërme duken si avantazhe për FA-të, duke i dhënë atyre mundësi përzgjedhjeje në fushën e personelit. Kjo është e vërtetë nëse nuk do të diskutonim cilësinë e këtyre kontingjenteve, rezistencë për t'u larguar apo pretenduese për t'u rekrutuar. Faktori cilësi ia vlen të vendoset në qendër të debatit, kur analizojmë rëndësinë e burimeve njerëzore dhe rolin e tyre në përmbushjen e misionit të FA-ve dhe në përcaktimin e të ardhmes së tyre.

Konvergimi i një klime të tillë të brendshme me ndikimin e faktorëve të jashtëm dhe aftësia për t'iu përgjigjur këtij momenti, përbën edhe sfidën kryesore institucionale për MM, SHPFA dhe komandat e çdo niveli, në kuadër të veprimtarisë së tyre drejtuese. Pavarësisht pretendimeve dhe perceptimeve të oficerëve të rinj për një jetë më të mirë familjare, pavarësisht tolerancës së ulët që ata kanë ndaj klimës së lidershipit, reagimi i tyre është i kufizuar dhe zgjidhja mbetet brenda FA-ve. Edhe tendenca për në sektorë civilë ku të rinjtë e sotëm po ndryshojnë gjithnjë e më shpesh vendin e punës, ku pranojnë mobilitet të lartë në punësimin e tyre apo nuk dëshirojnë të nënshkruajnë kontrata me detyrime afatgjata me kompani të caktuara, nuk është se ka ndikuar shumë në qëndrimin e korpusit të oficerëve në marrëdhënie me FA. Tregu i punës në vend është i kufizuar dhe aftësitë e tyre duket se nuk premtojnë punësim të shpejtë e të sigurtë në këtë treg apo edhe më gjerë.

Një përzierje e tillë e sjelljeve dhe situatave specifike duket sikur nuk të jep një pamje të plotë për tendencat e ardhshme në burimet njerëzore dhe për zhvillimin e lidershipit ushtarak por në fakt, thelbi i saj është shumë i qartë. Forcat e Armatosura vazhdojnë të kryejnë detyrat dhe misionet koherente, pa marrë parasysh pasojat afatgjata që mund të përballemi në fushën e personelit në një të ardhme të shpejtë. Struktura dhe cilësia e personelit të FA-ve nuk po ndryshon ose ndryshimi ndodh shumë ngadalë, duke rrezikuar kështu të ardhmen e tyre. Balancimi i kërkesave për t'iu përgjigjur nevojave dhe misioneve aktuale me nevojën për të planifikuar dhe zhvilluar me vizion të qartë sistemin institucional në këtë fushë, përbën një nga sfidat kryesore të lidershipit për sot, por edhe për të ardhmen.

FA në përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e nivelit të lidershipit

Përzgjedhja dhe zhvillimi i lidershipit gjithmonë ka qenë dhe mbetet objekt studimi dhe përparësi i çdo strukture. Në këtë drejtim, kompani të ndryshme normojnë dhe sanksionojnë praktikat më pozitive, duke i kthyer ato në rregulla e norma për të gjithë personelin dhe për proceset e ardhshme. Në kompanitë me profil teknik, një gjë e tillë është e lehtë. Pavarësisht së ekzistojnë modele e praktika tashmë të pranuara gjerësisht, çështja bëhet me komplekse kur shtrohet pyetja se çfarë kuptojmë me "praktikë pozitive" në sjelljet apo qëndrimet njerëzore. Një kompleksitet i tillë përfshin edhe FA në procesin e përzgjedhjes së drejtuesve dhe menaxhimin e karrierës së personelit ushtarak.

Bota e biznesit privat por edhe e atij publik, në vendet perëndimore, përdor forma të ndryshme për të matur efektivitetin dhe efiçencën e veprimtarisë e të lidershipit që drejton. Organizatat e mëdha civile praktikojnë tërheqjen e vlerësimeve dhe të *feedback*-ut për drejtuesit e niveleve të larta nga vartësit, kolegët, por edhe nga vëzhgues profesionistë dhe qendra të kualifikuara në fushën e lidershipit. Praktika të

tilla janë shumë më të përhapura dhe të pranueshme në organizata e kompani me objekt fitimprurës. Niveli i dështimeve të drejtuesve gjatë këtij procesi vlerësimi e monitorimi nuk është i qartë por, gjatë 10 viteve të fundit, llogaritet diku në nivelin 30-60% të numrit të përgjithshëm të tyre. Forma të tilla zbatohen në një masë të mirë dhe po përhapen edhe në kompanitë private në vendin tonë. Mjafton të kryesh një shërbim në sportelet e kompanive të telefonisë celulare, të bankave apo në kompani të shërbimeve të tjera dhe menjëherë pas shërbimit do të marrësh një telefonatë, e.mail apo formularë për të shprehur përshtypjet tuaja rreth cilësisë së shërbimit që u krye ndaj jush. Komandat e të gjitha niveleve, struktura të veçanta apo procese standarde në ushtrinë amerikane organizojnë vëzhgime dhe pyetësorë periodikë me efektivat e tyre për të matur e vlerësuar nivelin e besimit tek lidershipi ushtarak, klimën e komandimit, klimën e etikës, shkallën e profesionalizmit të drejtuesve apo efiçencën e tyre. Rezultatet dhe raportet e dala prej tyre konsiderohen si një nga mënyrat më konkrete për të komentuar dhe vlerësuar anët e forta dhe të dobëta të ushtrisë e të lidershipit të saj dhe për të kontribuuar në vendimet e emërimeve e gradimeve të radhës.

Në kushtet tona, megjithëse fenomene të tilla nuk analizohen në mënyrë formale, nuk bëhen objekt konkret diskutimi në simpoziume e konferenca shkencore apo të trajtohen gjerësisht në organet e shtypit ushtarak. Në biseda të përditshme apo nga analistë të jashtëm që ndjekin zhvillimet në fushën ushtarake komentohet qëndrimi i heshtur apo "kokulur" veçanërisht i drejtuesve të lartë e me grada madhore për probleme serioze që shqetësojnë FA-të, qëndrim që ka të bëjë drejtpërdrejt me kurajën personale dhe integritetin moral e profesional. Në sallat dhe auditoriumet e institucioneve arsimore, kursantët dhe studentët duken më "të gatshëm" për të shprehur skepticizmin për emërimet apo gradimet e radhës, për gjetjet "e goditura" në pozicione drejtuese të niveleve të ndryshme, etj[1]. Numri i madh i anekdodave dhe historive të treguara për drejtues të caktuar është i konsiderueshëm dhe vështirë për t'u neglizhuar apo për t'u injoruar nga kushdo që tenton ta bëjë një gjë të tillë. Edhe përshkrimi më optimist i situatës aktuale në FA do të identifikonte probleme e çështje serioze në këtë fushë. Niveli i besimit, cilësia e profesionalizmi si dhe morali në drejtues të ndryshëm kanë shfaqur probleme të dukshme.[2]

Vlen të përmendet fakti se deri në kohët e fundit dhe akoma në përdorim është sistemi, i tejkaluar tashmë në shumë vende aleate, i RGJOF-së[3] (më i përhapur është vlerësimi i Tempit Operacional të Njësive), ku njësitë e repartet në mënyrë të rëndomtë mbledhin të dhëna rreth nivelit të gatishmërisë së pajimeve të tyre, shkallës së kompletimit apo nivelit të furnizimit. Mungesa e një sistemi raportimi apo monitorimi të gjendjes së komponentit njerëzor me të gjitha aspektet përbërëse të tij: moral, besim, profesionalizëm, lidership, etj., neglizhon këtë komponent të rëndësishëm të gatishmërisë dhe fuqisë luftarake, duke e kaluar atë në plan dytësor.

[1] Diskutime personale të autorit.

[2] Ambasadori i SHBA-ve, i caktuar në Republikën e Shqipërisë, Sh.T. Zoti Donald Lu, në seancën dëgjimore para Kongresit Amerikan, trajtoi çështjen e luftës kundër korrupsionit në FARSH, si një nga përparësitë e punës së diplomacisë amerikane në Shqipëri gjatë mandatit të tij, "Zëri i Amerikës", datë 27 Shtator 2013.

[3] RGJOF-Regjimi i Gjendjes Operacionale të Forcave.

Sigurisht që klima është e ndryshme nga një repart në tjetrin dhe në nivele të ndryshme. Diku ka më shumë punë e ngarkesë, diku më shumë stres e lodhje por në shumicën e strukturave ka entuziazëm, besim dhe idealizëm në radhët ë efektivave dhe veçanërisht te brezi i ri. Diferenca të tilla në klimën ekzistuese tregon për rëndësinë që merr roli i lidershipit dhe i drejtuesve ushtarakë në çdo nivel dhe në çdo kohë për ta ndikuar atë në drejtimin e duhur. Në këtë drejtim, krahas personalitetit, faktorë të tjerë sistematikë që kanë të bëjnë me karrierën e secilit, edukimin dhe formimin e përgjithshëm, përcaktojnë nivelin e profesionalizimit dhe rolin e çdonjërit në korpusin e oficerëve dhe në radhët e lidershipit.

Lidershipi ushtarak, në përmbushje të kërkesave të shekullit të 21-të

Në çdo ushtri të botës dhe në çdo periudhë të historisë, detyra kryesore e lidershipit është që, në fund të fundit, të realizohet misioni që iu ngarkohet FA-ve. Drejtuesit e aftë ushtarakë, për ta bërë të mundur një gjë të tillë, fokusohen në përqendrimin e përpjekjeve të efektivit në vendin e duhur; qartësimin e objektivave; forcimin e besimit dhe marrëdhënieve reciproke; organizimin e efektivit dhe ndërtimin e punës në grup; udhëheqjen me shembullin personal; frymëzimin e vartësve dhe racionalizimin e sakrificave të tyre. Pavarësisht ekzistencës së studimeve të shumta në fushën e menaxhimit e të lidershipit ushtarak, akoma ekzistojnë pikëpyetje, debate e dilema rreth sjelljeve e aftësive që duhet të ketë një lider. Cilësitë dhe aftësitë e kërkuara të liderit mund të ndryshojnë nga një shkollë në një tjetër, por formulat bazë për të qenë i suksesshëm nuk kanë ndryshuar shumë në historinë gati 2000-vjeçare të njerëzimit. Nga ana tjetër, metodat dhe stili për të garantuar një sjellje të përshtatshme të drejtuesit që të mbështesë, t'i mbijetojë kohës dhe të udhëheqë veprimtarinë e përditshme, akoma nuk janë të qarta. Studimet në këtë fushë tregojnë se në 20-30 vitet e fundit ka patur një pritshmëri më të lartë e cila ka evoluuar në të gjithë sektorët e shoqërisë rreth asaj se çfarë përbën sjellje të suksesshme të liderit. Ato kanë radhitur disa nga kompetencat dhe cilësitë kryesore që një lider i shekullit të 21-të duhet të ketë në sektorë të ndryshëm të shoqërisë[4]. Këto përfshijnë aftësitë për të vepruar me kompleksitetin e të panjohurave: tolerancë në situata të turbullta; zhdërvjelltësi intelektuale; nivel i mirë i vetëdijes si dhe kuptim i plotë i marrëdhënieve mes nënsistemeve dhe përbërësve të organizatës që, në mënyrë kolektive, ndërtojnë një klimë të përbashkët suksesi. Në fushën ushtarake, këtyre do t'iu shtonim edhe disa cilësi të tjera që nuk maten në njësinë e kohës siç janë: integriteti, guximi dhe përgjegjshmëria ndaj vlerave institucionale.

Në periudhën e sotme kur luftërat dhe konfliktet janë me intensitet të lartë, teknologjikisht komplekse dhe me dimensione kohore e hapësinore të paparashikueshme, kërkohet që drejtuesit të zotërojnë aftësi të mira njohëse dhe intelektuale. Një gjë e tillë është e domosdoshme që ata jo vetëm të jenë të aftë apo të rrisin në maksimum shanset e realizimit me sukses të misionit të marrë, por të sigurojnë burimet (kryesisht ato njerëzore) edhe për misionin e radhës. Misionet e dhjetëvjeçarëve të fundit në Irak dhe Afganistan vërtetuan se kërkesat për lidershipin dhe drejtuesit, në të ardhmen, do të përshkohen nga "stresi i lartë", "luftime në zona

[4] "Leadership challenges of the 21st Century Army Symposium", temë e paraqitur nga *Instituti per Menaxhim dhe Kërkime në fushën e Lidershipit* të *Universitetit Teknik*, Texas,2006.

të izoluara dhe të largëta" dhe "përhapje të madhe të forcave" në fushën e luftës. Në këto rrethana, ndaj drejtuesve shtrohen kërkesa për kualifikim të vazhdueshëm dhe për ndryshim të thellë konceptual në lidhje me formimin e aftësimin e tyre. Dallimi midis nevojës që drejtuesi të drejtojë dhe të arrijë objektivat e tij afatshkurtra dhe nevojës që ai të përmirësojë vazhdimisht funksionimin e sistemit e të procedurave dhe, në këtë mënyrë, të sigurojë suksesin e vazhdueshëm në planin afatgjatë, përbën thelbin e çështjes së drejtimit.

Kërkesa dhe cilësi të tilla për lidershipin dhe drejtuesit e FA-ve identifikohen shpeshherë në rrugë akademike edhe në institucionet tona arsimore ushtarake. Por, mund të thuhet se deri tani nuk ka patur përfundime apo kërkesa të qarta që të iniciohen apo të hartohen politika apo platforma të plota e integrale të cilat do të udhëhiqnin dhe mbështesnin zhvillimin e këtyre cilësive të identifikuara si domosdoshmëri për korpusin e oficerëve dhe të drejtuesve të ardhshëm. Po kështu, nuk ka studime të mjaftueshme ku të analizohen e përgjithësohen raste e periudha të ndryshme të drejtimit në radhët e FA-ve me sukseset apo dështimet e tyre, në interes të nxjerrjes së mësimeve. Hartimi i një doktrine bashkëkohore për lidershipin dhe respektimi i kërkesave të saj, çka do të ndikonte në mënyrë të konsiderueshme në praktikat e deritanishme, duket se do të marrë më tepër kohë. Kjo vërteton faktin se FA dhe lidershipi i tyre janë më të gatshëm të veprojnë e të përshtaten me ndryshime të shpeshta e të vazhdueshme strukturore e operacionale të FA-ve dhe jo aq të gatshëm për modifikimin dhe ndryshimin e praktikave e politikave të drejtimit. Ndryshimet në FA nuk mund dhe nuk duhet të kufizohen vetëm në struktura apo në teknologji, me gjithë rëndësinë e madhe që kanë ato. Ato kanë të bëjnë me ndryshimin e vetë FA-ve dhe të kulturës së tyre. Siç pranohet gjerësisht, ndryshimi i kulturës në çdo organizatë është detyrë dhe meritë e lidershipit të saj dhe në këtë drejtim kërkohet projekt i mirëfilltë strategjik për ndryshimin e kulturës në FA. Periudha në të cilën jetojmë është e ndryshme dhe kërkohet që të adoptohemi e të rritemi me këto ndryshime. Një rritje e tillë natyrisht që do të kërkojë perspektiva të reja zhvillimi, mësime të reja por edhe praktika, sjellje e qëndrime të reja të lidershipit ushtarak.

Ndërkohë që iniciohen ndryshime të njëpasnjëshme organizative e strukturore, njohuritë e performanca e drejtuesve, si pjesë e këtyre ndryshimeve, është me rëndësi thelbësore. Disa vite më parë, në një raport studimor në ushtrinë amerikane shkruhej që: "Diskutimet në kuadër të Revolucionit në Çështjet Ushtarake, në të shumtën e rasteve, bëhen në këndvështrimin e zhvillimeve teknologjike. Por, harrohet se natyra e luftës është një ndërveprim kompleks i objektivave politike, emocioneve njerëzore, faktorëve etnikë e kulturorë dhe aftësive ushtarake"[5]. Edhe në rastin tonë vihet re se në projektet për zhvillime e përmirësime teknologjike, për përgatitjen e doktrinave e manualeve apo për konsolidimin e procedurave operacionale, shpenzohen shumë energji megjithëse. Nga ana tjetër, pranojmë se ushtari në fushën e luftës dhe faktori njeri do të përcaktojnë rezultatet e betejës.

Nevoja për përshtatje sistematike në zhvillimin e lidershipit ushtarak

- *Ndryshimet më të mëdha, në procesin e edukimit e të përgatitjes së oficerëve të ardhshëm.*

[5] Earl H. Tilford, Jr., The Revolution in Military Affairs: Prospects and Cautions.

Po të kemi parasysh dallimet themelore në këtë fushë, ajo që nevojitet është kalimi nga nevoja se "*çfarë të mësohet*" në atë se "*si të mësohet*" në auditorët akademikë. Institucionet arsimore në vendet aleate kanë ndërmarrë nisma për ndryshimin dhe përmirësimin e kurrikulave me fokus të veçantë në *nevojën dhe në aftësitë për të menduar.* Ky fokus duhet të përshkojë të gjithë sistemin e edukimit profesional ushtarak krahas dhënies së njohurive teknike, duke nxitur kryesisht punën kërkimore e shkencore, analiza, zhvillimin e diskutimeve e debateve konstruktive. Këtyre metodave u duhet shtuar edhe puna e individualizuar me studentë/kursantë, duke u bazuar në aftësitë dhe prirjet e çdonjërit. Në këtë mënyrë, jo vetëm që do të merreshin rezultate më të mira, por do të kontribuohej në identifikimin dhe përzgjedhjen e drejtuesve të ardhshëm.

- *Nevojë për lider reformatorë e transformues në FA, krahasuar me drejtues të stilit menaxherial apo letraxhinj.*

Megjithëse drejtuesit reformatorë, në shumë raste, nuk shfaqen qartë tek eprori, ata evidentohen nga vartësit e tyre, identifikohen mes kolegëve dhe i shërbejnë, në mënyrën më të mirë të mundshme, FA-ve. Shpeshherë, drejtuesit tanë përdorin si standarde kryesore në vlerësimin e vartësve, kryerjen në kohë të detyrave, besnikërinë ndaj ideve të tyre, marrjen apo zbatimin e vendimeve konformiste e të strukturuara më parë. Nga ana tjetër, nuk iu kushtohet vëmendja e duhur sjelljeve e ideve transformuese, shpalosjes vizionare dhe motivuese, ndërmarrjes së sfidave intelektuale, inspirimit të punës në grup, trajtimit dhe përfshirjes së plotë të vartësve, të qënurit të hapur ndaj ideve dhe mendimeve të të tjerëve, demonstrimit të kurajës morale, dhënies së shembullit personal, ndërvarësisë e respektit të plotë ndaj misionit të njësisë.

- *Nevoja për të rishikuar dhe përshtatur sistemin e raportimit, RGJOF, me qëllim përfshirjen në të edhe të elementeve si kohezioni i njësisë, morali dhe disiplina, krahas raporteve tradicionale të kompletimit të njësive me pajisje e personel.*

Përfshirja e këtyre elementeve do të fuqizojë komandat përkatëse në vlerësimin e njësisë së tyre, por, mbi të gjitha, është një hap i madh në drejtim të ndryshimit të kulturës në FA, duke nxitur besimin reciprok mes niveleve të komandimit. Po kështu, mund të praktikohej edhe zhvillimi periodik i vlerësimit për klimën e komandimit dhe të etikës në njësi e reparte. Për çështjen e dytë, vendet perëndimore kanë përvojë të pasur, por në rastin tonë këto aspekte duhen përfshirë fillimisht në sistemin e edukimit profesional ushtarak. Mënyra më e mirë, në këtë drejtim, është që vlerësimet dhe vëzhgimet në fushën e komandimit e të etikës të paraqiten fillimisht tek komandanti i njësisë i cili do t'i shfrytëzonte rezultatet në ndërtimin e punës së tij në të ardhmen, por një raport përmbledhës mund të dërgohej edhe në komandën më të lartë.

- *Përmirësimet në sistemin e vlerësimit të personelit dhe në procesin e gradimeve.*

Procesi i vlerësimit të personelit, me gjithë përmirësimet dhe vëmendjen e kushtuar kohët e fundit, vazhdon të jetë empirik dhe fiktiv, ndërsa procesi i gradimeve ka

shfaqur tendenca devijuese si një proces i veçantë dhe pak i lidhur me perspektivën e emërimeve të ardhshme të të promovuarve. Në këtë drejtim, kërkohet vlerësim më i qartë e më i thelluar i performancës dhe personalitetit të oficerëve, duke përfshirë moralin e tyre, fokusimin në misionin e ngarkuar, aftësinë për të përzgjedhur përparësitë e duhura, efektivitetin në komunikim, besimin e tyre në lidership, aftësinë për të përmbushur detyrat kryesore, paraqitjen dhe nivelin e lartë të disiplinës, ndjenjën e nismës si dhe trajtimin e drejtë e të barabartë të vartësve. Në vlerësimin e këtyre aspekteve, veçanërisht të personalitetit dhe aftësive drejtuese, mund të përdorej edhe vlerësimi i kolegëve dhe vartësve[6].

Në ditët e sotme, detyra kryesore rezulton të jetë jo dhe aq përcaktimi i kërkesave që duhen për lidershipin e ardhshëm, por si ta zhvillojmë e ta kultivojmë vazhdimisht atë. Më e rëndësishme sot është të ecim e të bazohemi në historitë e mëparshme të suksesit e në përvojat pozitive sesa në platforma të thata teorike. Përvoja e krijuar në këto vite transformimi, integrimi por edhe në operacionet e NATO-s, është pjesë e performancës kolektive të FA-ve dhe e sakrificave të lidershipit të saj ndër vite.

Bibliografia:

- Fjala e Ambasadorit të SHBA-ve, i caktuar në Republikën e Shqipërisë, Sh.T. Zoti Donald Lu, në seancën dëgjimore para Kongresit Amerikan, "Zëri i Amerikës", datë 27 Shtator 2013.
- "Leadership challenges of the 21st Century Army Symposium", temë e paraqitur nga *Instituti për Menaxhim dhe Kërkime në Fushën e Lidershipit* të *Universitetit Teknik*, Texas, 2006.
- Earl H. Tilford, Jr., The Revolution in Military Affairs: Prospects and Cautions.
- Manuali "Military Lidership" i Ushtrisë Amerikane.
- Diskutime të punimeve në Konferencën Vjetore të Shoqatës së Ushtrisë Amerikane, tetor 2012.

[6] Ushtria amerikane ka vite që praktikon vlerësimin 360 gradë, ku përveç vlerësimit të eprorit merret në konsideratë edhe vlerësimi i vartësve dhe kolegëve/bashkëpunëtorëve.

Përcaktimi dhe zhvillimi i konceptit të sigurisë

Bedri Bytyçi
Student në Programin MSc. "Siguria Kombëtare",
Akademia e Forcave të Armatosura

Trajtesë e shkurtuar. *Siguria në marrëdhëniet ndërkombëtare shihet nga rryma të ndryshme në mënyra të ndryshme. Mënyra se si këto rryma e shohin botën në termat e sigurisë, krijon tek individi një përshtypje të caktuar për mjedisin e sigurisë i cili e rrethon. Në bazë të këtij perceptimi krijohen më pas politika dhe strategji të caktuara sigurie.*

Artikulli, pasi veçon kompleksitetin e sigurisë, fokusohet në këndvështrimin historik për zhvillimin, format dhe hapësirat e ndryshme që përfshin koncepti i sigurisë. Në këtë punim trajtohen periudha, të cilat kanë formësuar në mënyra të ndryshme perceptimet dhe dimensionet e sigurisë siç janë për shembull periudha e Paraluftës së Ftohtë, periudha gjatë Luftës së Ftohtë si edhe periudha e Pasluftës së Ftohtë.

Në këtë sferë të trajtimit të rolit dhe vendit që zë siguria dhe përpjekjet për ta perceptuar dhe përkufizuar atë, është shumë e nevojshme të studiojmë paralelisht rëndësinë që zë një aktor si edhe impaktin që ka ai në rrjedhën e pafundme të ndryshimit dhe ndryshimit.

Si përfundim, në këtë artikull i jepet rëndësi e veçantë trajtesës së procesit të globalizimit dhe sigurisë si dhe një prej çështjeve më të debatuara sidomos në kohët e fundit dhe veçanërisht pas ngjarjeve të 11 shtatorit në SHBA. Kjo çështje ka pasur ndikim të thellë në ndryshimin dhe përcaktimin e dimensioneve të reja për konceptin e sigurisë duke i dhënë një hov të ri debatit të kësaj çështjeje. Ajo zë vend qendror në fushën e studimeve të sigurisë dhe përbën një ndër kërcënimet më serioze për të.

Hyrje

Siguria kombëtare është garancia për integritetin kombëtar, ekzistencën e kombit dhe shtetit që realizohet nëpërmjet përdorimit të elementeve të fuqisë kombëtare si: politika, diplomacia, informacioni, ekonomia dhe fuqia ushtarake. Si koncept, siguria ka të bëjë me garancinë që jepet në një sistem demokratik me nivelin në rritje të "paqes sociale" të shoqërisë në tërësi. Siguria në vetvete është pjesë e hierarkisë

së nevojave[1] jetike për çdo qenie shoqërore, nga ku është përcaktuar natyra njerëzore, shoqërore dhe mbijetesa e tyre. Ajo ka një domethënie universale dhe është komplekse e dinamike në veçantinë e saj. Për rëndësinë që paraqet, ajo trajtohet gjerësisht nga teoritë e marrëdhënieve ndërkombëtare[2]. Siguria kombëtare në një vend demokratik është efektive kur funksionojnë në harmoni elementët e mësipërm të fuqisë kombëtare.

Siguria kombëtare është gjithëpërfshirëse, me një spektër të gjerë veprimi, duke filluar me integritetin territorial, stabilitetin politik, me mënyrat demokratike të ndërtimit të jetës së institucioneve, me mirëqeverisjen dhe transparencën e qeverisjes. Ajo ka të bëjë me kohezionin socio-kulturor, konsensusin shpirtëror dhe moral, garancinë për paqe sociale pa kërcënime të brendshme nga situata të paqëndrueshme. Ka të bëjë gjithashtu me përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, mirëqenien dhe shëndetin e tyre në mënyrë të vazhdueshme, me sistemin e edukimit të qytetarëve, me sistemin e komunikimit midis njerëzve, me ndërtimin me kujdes të një legjislacioni cilësor dhe me përzgjedhjen të lidershipit efektiv, efiçent dhe cilësor për hierarkinë e shtetit, me jetë të pastër publike e private, që e duan dhe punojnë për vendin e tyre. Sfidat ndaj sigurisë detyrojnë politikëbërësit që të adresojnë ndjeshmërinë e njerëzve, votëbesimin ndaj institucioneve shtetërore, si dhe për përgjegjësinë që ata duhet të kenë në çdo nivel vendimmarrës.[3] Siguria kombëtare[4] lidhet me mbrojtjen e interesave kombëtare dhe të shtetasve të vet. Ajo ka të bëjë me dimensionin e jashtëm dhe të brendshëm njëkohësisht.

Gjithsesi, ndryshimi i mjedisit strategjik, sulmet terroriste në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara na japin arsye të forta për të bërë përpjekje që të rishikojmë e të ripërcaktojmë kuptimin e konceptit të sigurisë. Për një kohë të gjatë siguria është konceptuar në përgjithësi si një çështje që i takon shtetit dhe që reflektohet dhe gjen zbatim me anë të formulimit dhe përcaktimit të politikës së jashtme e të brendshme të këtij shteti. Por që prej përfundimit të Luftës së Ftohtë shumë çështje që lidhen me sigurinë i kanë kapërcyer kufijtë kombëtare të shtrirjes së tyre duke u bërë kështu gjithnjë e më ndërkombëtare. Kështu, çështja e terrorizmit ndërkombëtar që perceptohet si një sfidë e kohës, si një kërcënim real për sigurinë nuk mund të gjejë zgjidhje në nivelin e shtetit komb, brenda kufijve të tij, për arsye se rrënjët e tij, shkaqet dhe efektet kanë shtrirje ndërkombëtare duke kapërcyer çdo kufi.

Për të përcaktuar konceptin e sigurisë nuk ka asnjë mendim që të jetë i pranuar nga të gjithë. Edhe nëse marrim parasysh numrin e madh të shkrimeve që janë botuar për çështjen e sigurisë këto shtatëdhjetë vitet e fundit, ende nuk është pranuar si i mirëqenë një përkufizim i përgjithshëm për sigurinë. Koncepti i sigurisë mbetet si një nga konceptet më të diskutuara. Siguria ka shumë kuptime disa prej të cilave nuk lidhen domosdoshmërisht me kuptimet tradicionale që mund të na vijnë ndërmend[5]. Termi siguri shfaqet me disa kuptime si në përmbajtjen ashtu edhe në format e saj dhe i

[1] Maslow, A.H. (1943). "A Theory of Human Motivation," *Psychological Review* 50 (4): 370-96.
[2] Allan Collins, Studime bashkëkohore të sigurisë, Tiranë, 2009, f.481
[3] Allan Collins, Studime bashkëkohore të sigurisë, Tiranë 2009, f. 484
[4] Defining national security: the nonmilitary aspects. New Project on America's Task in a Changed World. Council on Foreign Relations. Romm, Joseph J (1993); pp. 122.
[5] Dalby;1997,6

referohet një sërë vlerave dhe çështjeve të ndryshme. *Wolfers*[6] e ka karakterizuar sigurinë kombëtare si një *'simbol dykuptimësie'*, i cili i përdorur pa u specifikuar, *"lë hapësira për më tepër konfuzion nga sa mund ta përballojë çdo shpjegim politik apo studimor"*. Pavarësisht nga përpjekjet e shumta që kanë bërë studiues të fushës së sigurisë për të dhënë një koncept koherent dhe sistematik të saj, duhet të themi se siguria mbetet një koncept që gjeneron debat gjë që nuk na lejon të arrijmë në një përcaktim që do të pëlqehet dhe do të pranohet nga të gjithë.[7]

Ky artikull do të analizojë mënyrat se si është konceptuar siguria në literaturën akademike dhe se si ka zhvilluar debati akademik në lidhje me këtë çështje gjatë periudhave të ndryshme kohore. Qëllimi i këtij artikulli është që të jepet një historik bashkëkohor i zhvillimit të konceptit të sigurisë. Zhvillimi i konceptit të sigurisë si edhe ndryshimet në këtë konceptim, të bazuara në hamendësime të ndryshme politike dhe teorike, kanë lidhje të ngushtë me zhvillimin historik të sistemit ndërkombëtar si edhe me progresin intelektual në përpjekje për të interpretuar konceptin e sigurisë. Çdo konceptim i sigurisë i korrespondon vlerave të veçanta, kërcënimeve dhe aftësive për të përmbushur sfidat që perceptojmë.[8]

Zhvillimi historik i konceptit të sigurisë

Lufta dhe paqja, kërcënimet dhe strategjia, mirëqenia dhe epidemitë, çështje si këto kanë bërë pjesë në shekuj me radhë në axhendën e mendimtarëve dhe studiuesve. Siç thekson dhe *A. Collins*[9] asgjë nuk i ngjante studimeve të sigurisë, siç e njohin studiuesit, në një fushë të veçantë studimi deri rreth fundit të Luftës së Dytë Botërore. Si gjithmonë kur themelohet një fushë, është e lehtë të shohim pararendësit dhe punën përgatitore gjatë etapave të mëparshme. Përcaktimi tradicional i sigurisë lidhej ngushtë me konceptin e shtetit-komb, e parë pothuajse gjithnjë në prizmin ushtarak. Në mënyrë të veçantë ky fokus që lidhej me kërcënime të brendshme ushtarake për sigurinë kombëtare ka dominuar gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë. E megjithatë do të ishte gabim që fillesat dhe përpjekjet për studimet mbi sigurinë t'i lidhim me periudhën e Luftës së Ftohtë dhe me kërcënimin që vinte nga prodhimi i armëve bërthamore. Prandaj për të kuptuar më së miri ndikimin e Luftës së Ftohtë në konceptimet dhe studimet për sigurinë së pari duhet të analizojmë përpjekjet studimore të periudhës së para Luftës së Ftohtë në lidhje me këtë temë. Në ndryshim nga periudha para Luftës së Ftohtë, fokusi i studimeve për sigurinë gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë ka ardhur gjithnjë duke u ngushtuar dhe duke u kanalizuar drejt koncepteve të reja.[10]

Përcaktimi i sigurisë para Luftës së Ftohtë

Periudha midis Luftës së Parë Botërore dhe Luftës së Dytë Botërore ka qenë shumë domethënëse për zhvillimin e studimeve për sigurinë.[11] Gjatë kësaj periudhe studiuesit

[6] 1952;483

[7] Buzan,1991; 15-16.

[8] Haftendorn, 1991;5

[9] Allan Collins, Studimet bashkëkohore të sigurisë, UET/Press, Tiranë, f.478-9

[10] Baldwin;1995, 119

[11] Studimet e sigurisë mund të thuhet se nisin të shfaqen në periudhën midis dy luftërave botërore duke iu referuar punës së kryer mbi studimin e shkaqeve dhe parandalimit të luftërave, Shih dhe Allan Collins, Studimet bashkëkohore të sigurisë, UET/Press, Tiranë,f. 481

gjithmonë kanë theksuar faktin se demokracia, mirëkuptimi dhe marrëveshjet ndërkombëtare ishin mënyrat kryesore për të arritur paqen dhe sigurinë[12]. Këta studiues kanë theksuar më së shumti rëndësinë dhe rolin e pazëvendësueshëm të institucioneve dhe të së drejtës ndërkombëtare më tepër se sa të forcës ushtarake.[13] Sistemi i ri ndërkombëtar konceptohej si '*bashkësi që bënte fuqinë'* në të cilën të gjitha shtetet do të bashkëpunonin për kauzën e përbashkët të garantimit të sigurisë dhe të drejtësisë për të gjithë aktorët dhe do të hiqnin dorë nga konkurrenca dhe nga mjetet shtrënguese.[14]

Gjatë dekadës së parë të Pasluftës së Ftohtë u rrit ndjeshëm interesi akademik për të studiuar çështje të sigurisë. Megjithëse çështjet e sigurisë kombëtare shpeshherë trajtoheshin brenda kuadrit të fushës së marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të politikës së jashtme, kjo periudhë është përshkruar si periudha më "krijuese dhe ngazëlluese në të gjithë historinë e studimeve rreth sigurisë".[15]

Gjatë kësaj periudhe janë themeluar (kryesisht në SHBA) institucione shumë të rëndësishme studimore për çështje ndërkombëtare. Gjithashtu janë ngritur edhe qendra të rëndësishme kërkimore për çështje të sigurisë kombëtare. Po ashtu gjatë kësaj periudhe janë themeluar dy revista të përjavshme me një rëndësi madhore për studimet akademike që janë *International Organization* (1947) dhe *World Politics* (1948), të cilat shërbejnë si platformë bazë për debatet mbi çështjet e sigurisë kombëtare.[16]

Megjithëse studiuesit dhe akademikët e njihnin shumë mirë rëndësinë e instrumenteve ushtarake në duart e shtetit kur flitej për çështje të sigurisë, ende në këtë kohë fusha e studimeve rreth sigurisë nuk do të shqetësohej për armët bërthamore dhe për parandalimin e tyre sikundër do të bënte gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë. Studiuesi i mirënjohur *Baldwin*[17] identifikon katër rryma konceptimi të sigurisë gjatë periudhës midis 1945-1955. *Së pari*, siguria konceptohej jo si qëllimi primar i të gjithë shteteve në të gjitha kohërat, por më tepër si vetëm njëra mes një mori vlerash, rëndësia relative e së cilës ndryshonte në varësi të kohës dhe të hapësirës. *Së dyti*, siguria kombëtare shihej si një qëllim në vetvete, i cili duhej të përmbushej duke përdorur si teknika dhe mjete ushtarake ashtu edhe ato jo ushtarake nga ana e shtetit. *Së treti*, në lidhje me aspektin ushtarak, ishte më se normale që t'i kushtohej rëndësi e veçantë politikave për përkujdesje dhe parandalim. *Së katërti*, vëmendja më e madhe e studiuesve ishte përqendruar te marrëdhënia midis sigurisë kombëtare dhe punëve të brendshme të shtetit të tilla si: ekonomia, çështje të së drejtës dhe lirive si edhe proceseve politike demokratike. Ky përcaktim relativisht i gjerë i sigurisë në një farë mënyre pasqyron debatin bashkëkohor në fushën e studimeve për sigurinë në lidhje me idenë e "zgjerimit" dhe "thellimit" të konceptit të sigurisë. Duke marrë në konsideratë këto dyzime që karakterizojnë konceptin e sigurisë, atëherë krejt natyrshëm lind pyetja se përse është lënë pothuaj tërësisht pas dore puna e studiuesve

[12] Fox;1949, 69
[13] Baldwin;1995, 119
[14] Haftendorn;1991, 7
[15] Baldwin;1995,121
[16] Për më gjerë shih Allan Collins, Studimet bashkëkohore të sigurisë, UET/Press, Tiranë, f.487-489
[17] Baldwin;1995, 122

të kohës përpara vitit 1955, përse është anashkaluar duke mos u marrë parasysh si shumë e rëndësishme në këtë proces të zhvillimit të konceptit të sigurisë? Ashtu siç argumenton edhe vetë *Baldwin*[18] "*Duket sikur kjo fushë studimi ka fituar përkufizime kaq strikte gjatë këtyre viteve të fundit, saqë pyetjet dhe çështjet e ngritura gjatë viteve të mëparshme duken sikur nuk i përkasin më fushës së studimeve për sigurinë*".

Konceptime të sigurisë gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë

Gjatë gjithë periudhës së Luftës së Ftohtë kanë ekzistuar një sërë mendimesh e konceptimesh për çështjen e sigurisë në lidhje me konfliktin midis Lindjes dhe Perëndimit.[19] Forca shtytëse e këtij debati lidhej me praninë e armëve bërthamore, fenomen i cili përmbante një forcë të madhe shkatërruese në vetvete dhe si i tillë ndryshoi ndjeshëm konceptin për marrëdhëniet ndërkombëtare në përgjithësi si edhe atë të sigurisë në veçanti. Për herë të parë në historinë e njerëzimit po prodhoheshin armë kaq të fuqishme, sa që mund të shkatërronin gjithë botën. Ky regres historik që lidhej me këtë rrjedhë të prodhimit të armëve ndikoi ndjeshëm në debatin akademik dhe atë politik. Për shembull, *Sigal*[20] ka theksuar se: "*thjesht forca shkatërruese e luftës bërthamore ka bërë të pavlerë çdo përpjekje për të dalluar fitoren nga humbja. Prandaj vetë ideja e strategjisë ushtarake si mjeti më efikas i forcës për të përmbushur objektivat e një shteti e ka humbur kuptimin e saj.*" Duke marrë shtysë nga ky argumentim, disa strategë kanë pretenduar se përdorimi i armëve bërthamore në konflikte të vogla do të ishte i pamundur, pasi efektet e tmerrshme të këtyre armëve i tejkalonin objektivat që do të donte të përmbushte një shtet me një veprim të tillë.

Gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë mund të identifikohen katër rryma mbizotëruese për sigurinë: ekuilibri i forcës, bota bipolare, politika frenuese, politika e frikësimit apo parandaluese.

Ekuilibri i forcës.[21] Koncepti i "ekuilibrit të forcës" është tërësisht kompleks dhe studiues të ndryshëm japin mendime dhe përcaktime të ndryshme për këtë koncept. Janë të shumtë akademikët dhe studiuesit që e kanë trajtuar në punimet e tyre këtë koncept.[22] Kështu në përpjekje për të dhënë konceptime të reja në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, *Waltz* ka theksuar se: "*në qoftë se ka në të vërtetë ndonjë teori politike krejtësisht të dallueshme nga të gjitha teoritë e tjera të politikës ndërkombëtare, kjo teori është padyshim ajo e ekuilibrit të forcës. Megjithatë ende nuk mund të pranohet një përfundim i vetëm ose një përcaktim i përbashkët edhe për këtë teori.*"[23] Pavarësisht nga moria e debateve që lidhen me përpjekjet për të dhënë

[18] Baldwin;1995, 122

[19] Risia e viteve '40-shek. XX, ishte lindja e një kategorie në gërshetimin e studimeve bazuar në gërshetimin e ekspertizës ushtarake dhe shkencave sociale me bazë universitare…. Studimet e sigurisë të lindura në SHBA, në vitet '50-60 njohën "epokën e artë". Puna mbi teorinë e lojës dhe teorinë e përmbajtjes ishin një shembull i rrallë i një zhvillimi intelektual, që arriti të kapte majat e krijimtarisë dhe sofistikimit teorik me dobishmëri paralele në politikëbërje. Kujtojmë se në vitet 50 u shpik dilema e sigurisë… Shih" Allan Collins, Studimet bashkëkohore të sigurisë, UET/Press, Tiranë,f.481-5

[20] Sigal;1979

[21] Për më gjerë shih dhe Allan Collins, Studimet bashkëkohore të sigurisë, UET/Press, Tiranë, f.35-38

[22] Deutsch and Singer;1964/Rosecrance;1966/Chatterje;1972/Healy and Stein;1973/Wagner;1986

[23] Waltz;1979, p.117

përcaktimet e duhura për këtë çështje sidomos në lidhje me vlerën dhe rolin që ka, nocioni bazë i konceptit të ekuilibrit të forcës është "*marrëdhënia midis numrit të aktorëve dhe stabilitetit të këtij sistemi.*"[24] *Haas*[25] thekson gjithashtu se koncepti i ekuilibrit të forcës ka kuptime të ndryshme, "*një prej kuptimeve më të rëndomta është një përshkrim i thjeshtë e sipërfaqësor i shpërndarjes së forcës politike në arenën ndërkombëtare në çfarëdo kohe*". Gjithsesi duhet të pranojmë që brenda këtij koncepti përfshihet edhe një komponent teorik që shërben si pikë orientimi për politologët me qëllimin që të shmangë dominimin e vetëm njërit shtet në këtë sistem. Një sistem i tillë mund të marrë forma nga më të ndryshmet me dy ose më shumë lojtarë dominues, të shoqëruar ndoshta me një balancues, që do të ishte një shtet që do të mund të ruante ekuilibrin e duhur.

Këto mendime dhe përcaktime kanë qenë pa diskutim thelbi i debatit akademik në lidhje me çështjen e ekuilibrit të forcës. Në një pjesë të këtyre diskutimeve janë përfshirë edhe elementë të fushave të ndryshme të marrëdhënieve ndërkombëtare duke e perceptuar çështjen nga këndvështrimi i teorisë së lojës, por edhe nga këndvështrimi i neorealizmit. Vetë neorealisti *Kenneth Waltz* ka formuluar një teori të ekuilibrit të forcës, e cila shpjegon se si shtetet ndërveprojnë me njëri-tjetrin duke u nisur nga supozimi që sistemi ndërkombëtar është anarkik dhe se shtetet janë "si njësi". *Waltz* del në konkluzionin se ekuilibri i forcës në periudha të ndryshme do të marrë trajta dhe formësime të ndryshme. Debati rreth çështjes së ekuilibrit të forcës ka zhvilluar me kalimin e kohës dhe është transformuar në një debat të ri, i cili ka pasur në qendër aktorët mbizotërues në sistemin ndërkombëtar. Sipas *Sullivan* debatet për ekuilibrin e forcës të viteve 1950 dhe të fillimit të viteve 1960 u zbehën fare nga fundi i viteve 1960 teksa bota dypolëshe u shndërrua gradualisht në botën shumëpolëshe në periudhën komplekse që sollën vitet 1960. Dalja në skenë e fuqive të reja në sistemin ndërkombëtar bëri që studiuesit dhe komentatorët e politikës ndërkombëtare të mendonin që dominimi i dy superfuqive SHBA-BS do të kishte marrë fund e megjithatë mbeti e pandryshuar ndarja që solli Lufta e Ftohtë në politikën ndërkombëtare.

Politika e frenimit. Nocioni i politikës së frenimit ose të përmbajtjes[26] është trajtuar ndoshta për herë të parë dhe me qëllimin për të kuptuar sa më mirë thelbin e saj nga diplomati i shquar amerikan *George Kennan*. I ngarkuar me detyrë në ambasadën e Moskës, *Kennan* nuk binte dakord me politikën amerikane me pretendimin se kjo politikë nuk merrte në shqyrtim vetë natyrën e "Rusisë". Në atë që njihet më së miri si 'Artikulli X' *Kennan* vë në dukje shkatërrimin total të kapitalizmit si edhe të çfarëdo lloj forme opozitare të organizuar e zyrtare brenda vendit duke u dhënë liri të plotë veprimi udhëheqësve sovjetikë për të pasur kontroll absolut të çdo aspekti të jetës Sovjetike. Më tej *Kennan* thekson se këta dy faktorë nuk do mund të kuptohen nëse nuk shqyrtohet edhe një faktor i tretë që është monopoli i lidershipit sovjetik për të përcaktuar të vërtetat. Kjo do të thotë që e vërteta nuk është konstante, por që në fakt krijohet për përfitimet dhe qëllimet nga vetë udhëheqësit sovjetikë.[27] *Kennan* e sheh me pesimizëm një marrëdhënie paqësore me Moskën për shkak të ndryshimeve

[24] Deutsch and Singer;1964, p.390
[25] Haas;1953, p.446
[26] Shih dhe Charl Kegley, Politikat Botërore,
[27] Kennan;1947, p.573

thelbësore midis kapitalizmit dhe socializmit. Ai është i mendimet se regjimi sovjetik është shumë më i dobët sesa bota perëndimore.

Në disa pjesë të tjera në vazhdim të artikullit të tij *Kennan* shpreh natyrën dhe mënyrën sesi e mendon ai këtë lloj politike. Karakteristika kryesore e politikës së SHBA në përgjithësi kundrejt BS do të ishte politika afatgjatë dhe e qëndrueshme e forcës së frenimit të tendencave ekspansioniste të BS. Në këtë mënyrë presioni i BS ndaj institucioneve të lira të botës perëndimore është një qëndrim që mund të frenohet duke iu përgjigjur me një politikë kundërshtuese dhe vigjilente duke u zhvendosur nga një fokus politik e gjeografik në një tjetër në paralelizëm të plotë me manovrat e lëvizjet e politikës së BS.[28]

Ndonëse është një qëndrim që është kundërshtuar shpesh herë nga strategji të tjera, politika e frenimit do të mbetej pjesë e politikës së jashtme të SHBA për një kohë të gjatë. Ky qëndrim u bë madje strategjia e preferuar e SHBA që nga vitet 1950 e në vazhdim, gjatë Luftës së Vietnamit si edhe gjatë Luftës së Ftohtë.[29]

Politika e frikësimit. Koncepti kryesor i hasur gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë ka të bëjë me atë që mund të quhet politika e frikësimit ose e parandalimit. Ky koncept ka të bëjë me faktin që palët e përfshira në një situatë konfliktuale nuk kanë guxim të sulmojnë nga frika e një kundërsulmi nga pala tjetër. Në rastin e SHBA dhe BS të dyja palët frikësonin njëra-tjetrën që të parandalonin ndonjë sulm të mundshëm. Për këtë çështje shumë kritike janë të mendimit se ky qëndrim krijoi një situatë të nderë e të tensionuar midis superfuqive dhe shkaktoi një luftë të paprecedent armatimesh në gjithë historinë e njerëzimit. Mund të dallohen disa lloje të ndryshme të një politike frikësimi si për shembull ajo që njihet si Frikësim i Kufizuar, Shkatërrim i Sigurt i Përbashkët (*Mutual Assured Destruction*) ose MAD si edhe politika për parandalimin e luftës. Frikësimi i Kufizuar bazohej në premisën që udhëheqësit e të dy palëve i frikësoheshin kaq shumë idesë së luftës bërthamore, saqë vetëm një sasi e kufizuar armësh bërthamore do të ishte e mjaftueshme për të ndaluar kundërshtarin. MAD u përfshi në doktrinën strategjike të SHBA në vitet ’60. Në thelbin e kësaj doktrine qëndronte ideja se SHBA duhet të bënin reprezalje dhe të shkatërronin të paktën 50 për qind të popullsisë dhe të industrisë sovjetike në rastin e një sulmi të mundshëm nga ana e sovjetikëve.[30]

Politika e parandalimit të luftës ishte forma më agresive e të gjitha llojeve të tjera të kësaj politike. Ajo bazohej në idenë se SHBA duhet të ishin në gjendje të dilnin fituese në çdo konfrontim, gjë që kërkonte një arsenal shumë herë më të madh si edhe raketa me saktësi të lartë goditje.[31] Gjatë periudhës së administratës *Reagan* ka sunduar më së shumti kjo doktrinë zyrtare dhe si rezultat i kësaj doktrine buxheti i mbrojtjes amerikane arriti nivele marramendëse. Ky fakt i bëri studiuesit të dalin në përfundimin se kjo doktrinë kontribuoi në një përfundim më të shpejtë të Luftës së Ftohtë pasi Bashkimi Sovjetik nuk mund ta ndiqte më ritmin e garës së armatimeve.

Për teorinë e politikës së frikësimit dhe në lidhje me studimet rreth konceptit të sigurisë kritika ka dalë në shumë konkluzione. Fakti që ajo u zhvillua si pasojë e çështjeve që

[28] Ibid; p.576
[29] Cumings;1995, p.363
[30] Lebow and Stein;1995, p.159
[31] Lebow and Stein;1995, p.160

shtriheshin nga Lindja në Perëndim bëri që disa studiues të theksojnë se teoria e politikës së frikësimit dhe teoria e lojës përbën një kuadër të fuqishëm që i bashkoi këto çështje thelbësore, por shpesh me çmimin që nuk u mor parasysh konteksti politik dhe ai historik.[32] *Jervis*[33] doli me përcaktimin se koncepti i frikësimit ishte "*kaq i errët saqë krijonte hapësira për çdo lloj sjelljeje"* dhe se ky koncept *"thjesht përmbante atë që burrat e shtetit madje edhe vëzhguesit amatorë e njihnin që më parë*."

Bota bipolare. Gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara kanë dominuar në arenën ndërkombëtare të politikës si dy superfuqi kundërshtare. Ndikimi i tyre u përhap pothuajse në çdo aspekt të klimës ndërkombëtare dhe shumë shtete që kishin domethënie dhe vlera strategjike u prekën nga kjo ndarje gjë që rezultoi në "*polarizimin e parë të vërtetë të fuqisë në historinë bashkëkohore'*[34] Gjithsesi, dallohen një sërë nocionesh për bipolaritetin. Një përpjekje e hershme për të kuptuar strukturën bipolare ishte se SHBA dhe BS ishin zhytur në një betejë për të dominuar botën, ose të paktën në një 'përleshje' për të përcaktuar pozicionet e tyre brenda sistemit botëror. Një përpjekje tjetër për të kuptuar bipolaritetin thekson se "*Ndryshimet territoriale dhe/ose politike mund të ndodhin në marrëdhëniet ndërkombëtare pa cenuar stabilitetin gjithëpërfshirës."*[35]

Diskutimi për bipolaritetin lidhet në mënyrë të paevitueshme edhe me alternativat e tjera që rrjedhin prej këtij koncepti që janë multipolariteti dhe unipolariteti. Pyetja kryesore që ngrihet për përgjigje është se cili prej këtyre sistemeve krijon mjedisin më të qëndrueshëm në sistemin ndërkombëtar.[36] Ky diskutim është dominuar nga realistët, të cilët e përcaktonin si më të favorshmen nga të gjitha format e tjera ndarjen që rrodhi prej Luftës së Ftohtë midis dy superfuqive.

Përkrahësit e idesë së bipolaritetit theksojnë se një ndarje e sundimit të botës midis dy palëve është ndarja më favorizuese për sigurinë ndërkombëtare. Rosecrance[37] paraqet katër arsye se përse bipolariteti do ta zvogëlonte konfliktin dhe dhunën ndërkombëtare[38]. Së pari, bipolariteti e ndan botën në mënyrë të barabartë gjë që i

[32] Nye and Lynn Jones;1988. p.6
[33] 1979; p.289-290
[34] Gaddis;1987, p.221 dhe gjithashtu Kissinger;1994, p.22
[35] Rosecrance;1966, p.316
[36] Wohlforth, 1999; Mearsheimer, 1990; Mastanduno, 1997
[37] 1966
[38] Së pari, bipolariteti e ndan botën në mënyrë të barabartë gjë që i detyron superfuqitë të shprehin interes për çdo pjesë të politikës botërore *'përkushtimi për kahe të kundërta ka sjellë ekuilibër solid dhe vendimtar'* pasi *'aplikohet gjithmonë'*. Së dyti, konkurrenca i shtyn pjesëmarrësit të përpiqen në maksimum. Intensiteti i kësaj konkurrence është rritur ndjeshëm. Rosecrance përmend hapësirat, rritjen ekonomike, përgatitjen ushtarake, si edhe çështje të brendshme të të gjitha llojeve që kanë marrë rëndësi në marrëdhëniet ndërkombëtare. Se treti, ripërsëritja e krizave, (duke pasur parasysh që konflikti është fakt i ditur dhe krejt i natyrshëm, dhe prandaj mund të ndodhë në çdo kohë,) mund të menaxhohet më mirë brenda sistemit ndërkombëtar kur në të ka vetëm dy lojtarë kryesorë. Bipolariteti i detyron të dy lojtarët të tregohen të kujdesshëm dhe të matur kundrejt njëri-tjetrit. Njëri prej aktorëve mund të arrijë kufirin, por jo ta kapërcejë atë. Dhe së fundmi, ndryshimet e vogla në ekuilibrin e forcës nuk ndikojnë ndjeshëm te palët e përfshira. Ky nuk është sistem pa mangësi, por këto mangësi mund të tolerohen e të pranohen si të tilla.

detyron superfuqitë të shprehin interes për çdo pjesë të politikës botërore *'përkushtimi për kahe të kundërta ka sjellë ekuilibër solid dhe vendimtar'* pasi *'aplikohet gjithmonë'*. Së dyti, konkurrenca i shtyn pjesëmarrësit të përpiqen në maksimum. Intensiteti i kësaj konkurrence është rritur ndjeshëm. Rosecrance përmend hapësirat, rritjen ekonomike, përgatitjen ushtarake, si edhe çështje të brendshme të të gjitha llojeve që kanë marrë rëndësi në marrëdhëniet ndërkombëtare. Së treti, ripërsëritja e krizave, (duke pasur parasysh që konflikti është fakt i ditur dhe krejt i natyrshëm, dhe prandaj mund të ndodhë në çdo kohë,) mund të menaxhohet më mirë brenda sistemit ndërkombëtar kur në të ka vetëm dy lojtarë kryesorë. Bipolariteti i detyron të dy lojtarët të tregohen të kujdesshëm dhe të matur kundrejt njëri-tjetrit. Njëri prej aktorëve mund të arrijë kufirin, por jo ta kapërcejë atë. Dhe së fundmi, ndryshimet e vogla në ekuilibrin e forcës nuk ndikojnë ndjeshëm tek palët e përfshira. Ky nuk është sistem pa mangësi, por këto mangësi mund të tolerohen e të pranohen si të tilla.[39]

Kritikët e bipolaritetit ngrenë një sërë çështjesh për diskutim. *Morgenthau*[40] ka theksuar se: 'në *një botë bipolare fitorja për njërën palë është humbje për palën tjetër dhe prandaj e vetmja zgjidhje e mundshme për të dyja palët mbetet që të rrisin fuqinë e tyre në çdo kohë'*. Në bipolaritet nuk ka vend për burra shteti inteligjentë. Ashtu siç shton edhe *Rosecrance*[41] struktura bipolare krijon një "proces zvetënues': *'njëra palë mund të mendojë jo vetëm për rreziqet që mund t'i kanosen si pasojë e sulmit ndaj kundërshtarit, por edhe për rreziqet që mund të rrjedhin nëse vendos të mos sulmojë'*. Lufta parandaluese mund të shihet kështu si më e preferuar sesa lufta e iniciuar nga kundërshtari.

Çështje të sigurisë në periudhën e Pasluftës së Ftohtë

Fundi i Luftës së Ftohtë duket se i ka shtangur si akademikët ashtu edhe studiuesit e fushës së marrëdhënieve ndërkombëtare. Asnjëra prej teorive ekzistuese të kësaj fushe nuk e kishte parashikuar fundin e një epoke që e kishte mbajtur peng mbarë botën. Duket sikur në këtë periudhë diskutimet dhe trajtesat në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare morën një rrjedhë krejt të re pasi teoritë ekzistuese e kishin humbur vlerën dhe besimin e tyre. Prej fillimit të viteve '90 e në vazhdim një sërë debatesh akademike kanë riformuluar trajtesat dhe mendimet mbi sigurinë. Fundi i Luftës së Ftohtë iu ofroi studiuesve të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të studimeve rreth sigurisë të fokusoheshin në tema që ndryshonin nga ato të teorisë së parandalimit dhe të ekuilibrit të forcës. Vëmendje të veçantë fituan çështje të tjera ku një nga më të rëndësishmet lidhet me konceptin dhe përcaktimet e globalizimit. Debati në lidhje me globalizimin brenda fushës së marrëdhënieve ndërkombëtare kishte të bënte me çështje të tilla si pyetja se nëse ky koncept ishte një vazhdimësi e një procesi të vjetër në kohë dhe në hapësirë, apo një fenomen i ri i nxitur nga zhvillimi i teknologjisë së transportit dhe të komunikimit. Ky debat u përqendrua gjithashtu në pasojat e tregjeve në rritje dhe skemave të prodhimit, të cilat shkaktonin ose pabarazi në rritje,

[39] Për më gjerë shih dhe në: Rosecrance, 1966: 314-315

[40] Morgenthau, 1948,shih dhe Hans J. Morgethau, Politika ndërmjet kombeve, Instituti i Studimeve ndërkombëtare, Tiranë, 2008, f.127,185-200

[41] 1966;316

ose mundësi për të gjithë.[42] Një tjetër çështje me peshë në këtë diskutim ishte ndikimi i vazhdueshëm i organizatave joqeveritare (OJQ) si edhe i organizatave ndërqeveritare në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. *Keck* and *Sikkink* iu referohen këtyre aktorëve "të rinj" në sistemin ndërkombëtar si "rrjete ndërkombëtare avokatie":

Politika botërore në fillim të shek. XXI përfshin shtete që po formësohen si të tillë, shumë aktorë jo shtetërorë që bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, shtete si edhe organizata ndërkombëtare. Këto procese bashkëvepruese janë strukturuar në formën e rrjeteve dhe këto rrjete të ndërkombëtarizuara po bëhen gjithnjë e më të dukshme në arenën e politikës ndërkombëtare. [43]

Kaldor[44] ka shtuar se lufta, një çështje e lidhur ngushtë me marrëdhëniet ndërkombëtare, ka ndryshuar rrënjësisht dhe se *"luftërat e reja duhet të kuptohen brenda kontekstit të procesit të njohur si globalizimi"*. Këto luftëra të reja ndryshojnë nga ato të mëparshmet në tre mënyra thelbësore duke pasur parasysh qëllimet, financat dhe metodat e të bërit të "luftës". Këto forma të reja krijohen duke ndryshuar marrëdhëniet shoqërore në mënyrën e të zhvilluarit të 'luftës' si produkt i globalizimit dhe për shkak të teknologjive të reja. Ndikimi që këto "luftëra të reja" kanë në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në studimet rreth sigurisë është shumë i madh. *"Në ambientin e sotëm ndërkombëtar, siguria nuk mund të kuptohet siç duhet pa marrë parasysh procesin e globalizimit."*[45]

Një koncept i lidhur ngushtë me debatin rreth globalizimit është koncepti i kriminalitetit global. *Makkai* [46] ka theksuar se: *"Globalizimi i ekonomisë botërore ka pasur shumë efekte pozitive te shtetet-kombe, por është gjithashtu e qartë se globalizimi, ndoshta në mënyrë të paqëllimshme ka rritur kapacitetin e individëve për t'u organizuar në vepra kriminale që i kapërcejnë kufijtë (të njohura si krimi ndërkombëtar) në përmasa të panjohura më parë."*

Kriminaliteti global mbulon shumë fusha ndër të cilat trafikimi i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore, pastrimi i parave si edhe krime me bazë internetin janë ndër më të njohurit. Pastrimi i parave dhe veçanërisht lidhja e tij me terrorizmin ndërkombëtar ka tërhequr vëmendjen dhe interesin e akademikëve dhe politologëve këto vitet e fundit. Mendohet se ngjarjet e 11 shtatorit 2001 *"kanë ndryshuar perceptimet për pastrimin e parave sepse diskutimet publike tashmë kanë të bëjnë me mënyrat e përdorura nga terroristët për të siguruar financime për aktet e tyre të kobshme."*"[47] Lidhja midis terrorizmit dhe krimit global reflekton debatin gjithnjë e më të zgjeruar të shtetit komb kundrejt aktorëve jo shtetërorë në sistemin ndërkombëtar. Ajo që është tepër komplekse për këto rrjete kriminale ka të bëjë me faktin se ato janë tmerrësisht fleksibël dhe operojnë në nivel global gjë që i bën shumë të vështira për t'u kontrolluar nga një shtet i vetëm. Sulmet e fundit terroriste në nivel ndërkombëtar,

[42] Wade, 2003; Castells,1997
[43] 1998;1
[44] 1999;3
[45] Vennesson;2006,126
[46] Makkai;2006,199
[47]Serio,2004; 435-436; Ehrenfeld,2003

si për shembull ai i 11 shtatorit, kanë treguar se terroristët mund ta përdorin globalizimin si një mjet në duart e tyre për të goditur fuqishëm.[48] Zhvillimi i fushatave të ndryshme kundër grupeve terroriste si edhe terrorizmit në përgjithësi mund të përcaktohet si lufta e parë e globalizimit.[49]

Përfundim

Siguria mbetet një ndër konceptet më të debatuara të kohës në kërkim të një përcaktimi që mund të jetë i pranueshëm nga të gjithë. Ky koncept i referohet disa çështjeve, qëllimeve dhe vlerave të ndryshme të cilat shpeshherë reflektojnë kontradiktat që rrjedhin nga teori të ndryshme të fushës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Debati që mbetet i hapur mes akademikëve lidhet me konceptimet e sigurisë dhe më së tepërmi me nivelet e ndryshme të analizës, me qëllimin dhe me studimin e saj.

Fokusi dhe qëllimi i studimeve të sigurisë është zhvilluar ndjeshëm me kalimin e viteve. Gjatë periudhës së Paraluftës së Ftohtë një sërë studiuesish kanë formuluar një perceptim të gjerë për sigurinë. Por ata ende nuk kishin në fokusin e tyre çështjen shqetësuese që lidhej me politikën e frikësimit dhe me armët bërthamore, të cilat do të shndërroheshin në fokusin e studimeve të sigurisë gjatë Luftës së Ftohtë. Në këtë periudhë koncepti i sigurisë mori kuptime më të ngushta duke u përcaktuar kryesisht si në lidhje me nivelin e shtetit-komb dhe në mënyrë më specifike me prizmin ushtarak. Konceptet e propozuara gjatë viteve të Paraluftës së Ftohtë janë neglizhuar nga pjesa më e madhe e studiuesve pavarësisht nga vazhdimësia historike e përpjekjeve akademike për të zgjeruar hapësirat e studimeve të sigurisë.

Koncepti kryesor i sigurisë gjatë Luftës së Ftohtë lidhej ngushtë me teorinë realiste, e cila fokusohet te qëndrimi që mbajnë shtetet për të garantuar sigurinë me anë të mjeteve ushtarake. Sipas këtij koncepti siguria barazohej me çështjet ushtarake dhe me përdorimin e forcës nga ana e shtetit.

Fundi i Luftës së Ftohtë shkaktoi një debat të madh mes akademikëve në lidhje me të ardhmen e sigurisë kombëtare dhe asaj ndërkombëtare. Disa studentë përqendroheshin në çështje që nuk lidheshin me politikën e frikësimit dhe të forcës ushtarake, duke i hapur rrugë zgjerimit gjithëpërfshirës të konceptit të sigurisë. Një nga çështjet më dominante të këtij debati kanë qenë pasojat e procesit të globalizimit, sidomos marrëdhëniet midis aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë në sistemin ndërkombëtar si edhe rritja e rrjeteve ndërkombëtare kriminale. Globalizimi duket se ka ndryshuar rrënjësisht si kërcënimet ndaj sigurisë, ashtu edhe mjetet me të cilat arrihet ajo. Disa studiues kanë hedhur mendimin për 'zgjerimin' dhe 'thellimin' e konceptit të sigurisë. Debati akademik për 'zgjerimin' dhe 'thellimin' e konceptit të sigurisë dëshmon natyrën kontestuese të sigurisë.

Përparime të shpejta në informacion do të krijojnë dobësi të reja bio-teknologjike për sigurinë.

Teknologjitë e reja do të rrisin produktivitetin por dhe do krijojnë ndarje në botë. Siguria kombëtare e të gjitha shteteve të përparuara do të preket gjithnjë e më shumë

[48] Vennesso; 2006, 125

[49] Campbell;2002

nga dobësitë e infrastrukturës ekonomike globale. E ardhmja ekonomike do të jetë e vështirë të parashikohet dhe të menaxhohet.

Në këtë kah meritojnë vlerësime puna që po bëhen në AFA dhe në institucione të tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, etj. Kjo rritje joshëse mbështet "në rëndësinë e "sigurisë" në epokën e "luftës globale kundër terrorit dhe në ekzistencën tashmë të një sërë teorish, që lindën gjatë viteve '90-të."[50]

Bibliografia:

- Allan Collins, Studimet bashkëkohore të sigurisë, UET/Press, Tiranë.
- Hans J. Morgethau, Politika ndërmjet kombeve, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë, 2008.
- Maslow, A.H. (1943). "A Theory of Human Motivation," *Psychological Review* 50(4).
- Baldwin, D.A. (1995) Security Studies and the End of the Cold War.
- Baldwin, D.A. (1997) The Concept of Security, Review of International Studies .
- Buzan, B. (1991) People, States and Fear. An agenda for International Security .
- Haftendorn, H. (1991) The Security Puzzle: Theory-Building and Discipline-Building in International Security', International Studies Quarterly, vol. 35.
- Dalby, S. (1997) Contesting an Essential Concept.
- Dalby, S. (2002) Environmental Security, Minneapolis.
- D. Singer (1964) "Multipolar Power Systems and International Stability" .
- Fox, W.T.R. (1949) 'Interwar International Relations Research.
- Gaddis, J.L. (1999) Toward the Post-Cold War World', Foreign Affairs.
- Haas, E. B., (1953) The Balance of Power.
- Kennan, G., (1947) "The Sources of Soviet Conduct".
- Buzan, Barry dhe Lene Hansen. *The Evolution of International Security Studies* (Cambridge: Cambridge University Press, 2009).
- Lebow, R. N., J. G. Stein (1995) "Deterrence and the Cold War" Political Science.
- Makkai, T., (2006) "Researching Transnational Crime: The Australian Institute of Criminology".
- Nye, Jr., J.S., and S.M. Lynn-Jones (1988) International Security Studies.
- Rosecrance, R. N., (1966) "Bipolarity, multipolarity, and the future," .
- Sigal, L., V., (1979) "Rethinking the Unthinkable," Foreign Policy, no. 34.
- Vennesson, P. (2006) 'Globalization and Military Power: The Politics of Military.
- Serio, J. D., (2004) "Fueling Global Crime: The Mechanics of Money Laundering.
- P. Ribaj, Siguria bashkëpunuese model i sigurisë bashkëkohore, UFO, 2009.

[50] Allan Collins, Studimet bashkohore të sigurisë, UET/Press, Tiranë,, f. 479

Zgjerimi i NATO-s me anëtarë të rinj

Kolonel (R) Kristaq Birbo,
Drejtor Ekzekutiv i Këshillit të Atlantikut të Veriut

Trajtesë e shkurtuar. *Në këtë shkrim trajtohet në mënyrë të përmbledhur çështja e zgjerimit të Aleancës Atlantike që nga krijimi i saj e deri në ditët e sotme. Nisur nga fakti që në Samitin e ardhshëm të NATO-s, i cili, me shumë gjasa, do të mbahet në vitin 2014, pritet të merret vendim për anëtarësime të reja. Autori bën një analizë të saktë dhe të faktuar se kush mund të jenë anëtarët e rinj që do të marrin ftesën për anëtarësim.*

Në shkrim autori është mjaftuar të analizojë vetëm vendet e Ballkanit Perëndimor, si: Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia, Serbia, Kosova, si dhe dy shtetet e ish-Bashkimit Sovjetik, Ukraina dhe Gjeorgjia, vende këto që kanë dialog të intensifikuar me NATO-n. Aty trajtohet rruga e ndjekur nga këto vende drejt anëtarësimit, arritjet, mosarritjet në këtë proces, si dhe mundësitë që këto vende kanë për të marrë ftesën në samitin e ardhshëm.

Ka edhe vende të tjera, anëtare të Partneritetit për Paqe, por që aktualisht nuk kanë kaluar mbi këtë shkallë procesi anëtarësimi.

Në fund, nisur edhe nga zhvillimet aktuale, si dhe nga vetë tradita e NATO-s në fushën e zgjerimit, arrihet në përfundimin (këto janë vetëm mendimet e autorit), që dy vendet fqinje të Shqipërisë, Maqedonia dhe Mali i Zi, janë vendet e vetme që plotësojnë kushtet për t'u bërë anëtare të NATO-s.

Gjatë këtyre viteve, debatet në NATO janë dominuar kryesisht nga çështjet e Afganistanit, evoluimit të Aleancës në përputhje me kushtet e reja gjeopolitike në botë dhe së fundmi, debatet janë përqendruar mbi ngjarjet në Siri. Aktualisht po del në dritë përsëri procesi i zgjerimit të Aleancës me anëtarë të rinj. Pyetja që shtrohet është se kur do të bëhet zgjerimi i radhës dhe cilët do të jenë shtetet që do të marrin ftesën për anëtarësim?

Neni 10 i Traktatit të Uashingtonit parashikon se Palët, në marrëveshje të plotë, mund të ftojnë për të aderuar në këtë Traktat, çdo shtet tjetër evropian që është i aftë të çojë më tej parimet e këtij Traktati dhe të kontribuojë në sigurinë e zonës së

Atlantikut të Veriut. Tre vjet pas krijimit të NATO-s, në vitin 1952, NATO-s iu bashkuan vendet ballkanike, Greqia dhe Turqia, në vitin 1955 u anëtarësua Gjermania Federale, ndërsa Spanja u pranua më 30 maj 1982.

Në fillim të viteve '90, NATO kishte mundur me sukses të kthente Evropën nga një vendburim konfliktesh në një rajon të stabilizuar dhe të integruar, në paqe, siguri e përparim. Traktati i Varshavës ishte shpërbërë dhe Bashkimi Sovjetik, bashkë me kërcënimin që ai përfaqësonte, nuk ekzistonte më. Megjithatë, shpejt u konstatua se stabiliteti dhe paqja nuk kishin ardhur me përfundimin e Luftës së Ftohtë dhe se kërcënime të reja dhe të rrezikshme u bënë konkrete për sigurinë e shteteve anëtare, përfshi këtu konflikte rajonale apo tensione e konflikte etnike, që rrezikonin të përhapeshin.

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë pati një diskutim jo të lehtë në lidhje me zgjerimin e NATO-s me vende ish-komuniste. Kishte nga ata që e konsideronin këtë si një përfitim për NATO-n, ndërsa të tjerë mendonin se zgjerimi i NATO-s do të shtonte akoma më tej vështirësitë për konsensus, si dhe do të përkeqësonte marrëdhëniet me Rusinë. Të tjerë ishin për pranimin e një numri të kufizuar vendesh, si: Hungaria, Çekia dhe Polonia, ndërsa vendet e tjera ish-komuniste, sidomos vendet baltike, të mbaheshin larg NATO-s. Por në mënyrë të befasishme dhe të habitshme, një numër i madh shtetesh ish-komuniste aplikuan për anëtarësim në NATO. Kjo lindi nevojën e hartimit të kritereve mbi bazën e të cilave do të bëhej edhe pranimi.

Gjatë Samitit të Brukselit të janarit 1994, Aleatët riafirmuan që Aleanca është e hapur për anëtarësimin e vendeve të tjera evropiane, të cilat janë në gjendje të promovojnë parimet e Traktatit të Uashingtonit dhe të kontribuojnë në sigurinë e zonës së Atlantikut të Veriut. Bazuar në vendimin e marrë në Takimin e Ministrave të Punëve të Jashtme të Aleancës, në dhjetor 2004, pyetjet se "përse dhe si do të kryhet zgjerimi" u përcaktuan në Studimin për Zgjerimin e NATO-s, i cili u bë publik në shtator 1995.

Në lidhje me *përse*-në e zgjerimit, studimi doli në konkluzionin se, me përfundimin e Luftës së Ftohtë dhe shpërbërjen e Organizatës së Traktatit të Varshavës ka një nevojë dhe mundësi unike për të përmirësuar sigurinë në të gjithë zonën euroatlantike, pa rikrijuar linja ndarëse. Zgjerimi i NATO-s, i cili nuk kërcënon asnjë shtet tjetër, është një hap i mëtejshëm drejt objektivit kryesor të Aleancës për zgjerimin e sigurisë dhe stabilitetit në të gjithë zonën euroatlantike, duke plotësuar aspiratat më të gjera drejt integrimit në Bashkimin Evropian dhe forcimin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

Studimi gjithashtu konkludoi se zgjerimi i Aleancës do të kontribuojë në zgjerimin e stabilitetit dhe sigurisë për të gjitha shtetet në zonën euroatlantike, në disa mënyra. Do të inkurajojë dhe mbështesë reformat demokratike, përfshi edhe vendosjen e kontrollit civil dhe demokratik mbi Forcat e Armatosura. Zgjerimi do të ushqejë bashkëpunimin, konsultimet dhe ndërtimin e konsensusit, që karakterizojnë marrëdhëniet ndërmjet Aleatëve aktualë dhe do të promovojë marrëdhënie fqinjësore të mira në të gjithë zonën euroatlantike. Do të rritë transparencën në planifikimin e mbrojtjes dhe buxhetet ushtarake, duke forcuar në këtë mënyrë besimin ndërmjet shteteve dhe tendencën për integrim dhe bashkëpunim në Evropë. Për më tepër,

zgjerimi do të forcojë aftësinë e Aleancës për të kontribuar në sigurinë ndërkombëtare dhe mbështetjen e paqeruajtjes drejtuar nga OKB dhe OSBE, si dhe do të forcojë dhe zgjerojë partneritetin transatlantik.

Në lidhje me mënyrën e zgjerimit, studimi konfirmoi se ashtu si në të kaluarën çdo zgjerim i ardhshëm do të kryhet nëpërmjet aderimit të shteteve të reja në Traktatin e Atlantikut të Veriut, në përputhje me nenin 10 të Traktatit të Uashingtonit. Anëtarët e rinj do të gëzojnë të drejtat dhe do të kenë të njëjtat detyrime të anëtarësimit sipas Traktatit, duke pranuar edhe parimet, politikat dhe procedurat e miratuara nga të gjithë anëtarët në kohën e anëtarësimit. Studimi e bëri të qartë se vullneti dhe aftësia për t'i plotësuar këto angazhime jo vetëm në letër, por edhe në praktikë, do të jetë një faktor kritik në çdo vendim që Aleanca mund të marrë në të ardhmen, për të ftuar një shtet për t'iu bashkuar Aleancës. Shtetet që janë përfshirë në mosmarrëveshje etnike, mosmarrëveshje territoriale me fqinjët, përfshi këtu edhe pretendime irredentiste, ose mosmarrëveshje juridike të brendshme duhet t'i zgjidhin këto marrëveshje me mjete paqësore, në përputhje me parimet e OSBE-së, përpara anëtarësimit.

Studimi gjithashtu konfirmoi se aftësia e vendeve aspirante për të kontribuar ushtarakisht për mbrojtjen kolektive, paqeruajtjen dhe misionet e tjera të Aleancës do të përbëjë një faktor në marrjen e vendimit për dhënien e ftesës. Studimi, si përfundim, konkludoi se Aleatët do të vendosin me konsensus nëse do të ftojnë një shtet për t'iu bashkuar Aleancës.

Në Samitin e Uashingtonit 1999 u dizajnua edhe një program i ri për asistimin e vendeve aspirantë për përgatitjen për anëtarësim, Plani i Veprimit për Anëtarësim. Ky plan u ofron vendeve aspiruese këshillim praktik dhe asistencë me objektiv të përcaktuar. Nga ana e tyre, vendet aspiruese presupozohet të plotësojnë disa objektiva politike, përfshi zgjidhjet paqësore të konflikteve territoriale, respekt për procedurat demokratike dhe sundimin e ligjit dhe kontrollin demokratik të forcave të armatosura. Pjesëmarrja në këtë plan nuk ofron ndonjë garanci për anëtarësimin e ardhshëm, por i ndihmon këto vende të përshtatin forcat e tyre të armatosura që të përgatiten për detyrimet dhe përgjegjësitë që do të sjellë anëtarësia në Aleancë.

Zgjerimi i Aleancës nuk është një qëllim në vetvete, por një mjet për të zgjeruar më tej sigurinë e NATO-s dhe ta bëjë të gjithë Evropën më të qëndrueshme, në liri dhe paqe. Procesi i zgjerimit ndihmon t'u paraprijë konflikteve në kohë, sepse perspektiva e anëtarësimit shërben si një nxitës për vendet aspiruese që të zgjidhin konfliktet me vendet fqinje dhe të përparojnë me reformat e procesin e demokratizimit. Për më tepër, anëtarët e rinj jo vetëm do të përfitojnë nga avantazhet e anëtarësimit, ata duhet të jenë në gjendje të japin kontributin e tyre për sigurinë e përgjithshme për të gjitha vendet anëtare, pra ata duhet të jenë edhe kontribues, jo vetëm përfitues e konsumues të sigurisë.

Në përputhje me politikën e dyerve të hapura të Aleancës, tre ish-vende partnere të NATO-s: Republika Çeke, Hungaria dhe Polonia u bënë anëtare në mars 1999, duke e çuar numrin e përgjithshëm të anëtarëve në 19. Në Samitin e Pragës, në nëntor 2002, Aleanca ftoi edhe shtatë vende të tjera: Bullgarinë, Estoninë, Letoninë, Lituaninë, Rumaninë, Sllovakinë dhe Sllovenínë, që të fillonin bisedimet për anëtarësim. Këto vende u bënë zyrtarisht anëtare të Aleancës në fund të marsit 2004.



Më datë 1 prill 2009, Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut iu bashkuan dy vende të reja, Shqipëria dhe Kroacia, duke e çuar numrin aktual të vendeve anëtare në 28.

Udhëheqësit e vendeve anëtare të NATO-s, në Samitin e Çikagos në maj 2012 nuk morën ndonjë vendim në lidhje me anëtarësimet e reja në Aleancë, ndryshe nga çfarë ka ndodhur në samitet e mëparshme. Zgjerimi i NATO-s nuk ishte në prioritetet e administratës së Presidentit Amerikan Barack Obama, e cila më shumë është fokusuar drejt përfundimit të luftës në Afganistan dhe krizës së borxheve që po mbretëron në Evropë. Por gjatë punimeve të Samitit të Çikagos, Sekretarja Amerikane e shtetit, Hilari Klinton deklaroi, se: SHBA-të mbeten të përkushtuara në politikën e dyerve të hapura për anëtarësinë në NATO dhe theksoi se ky do të jetë Samiti i fundit që do të kalojë pa ftesë për anëtarësime të reja në Aleancë.

Pra logjikisht në Samitin e ardhshëm të Aleancës është e sigurtë që NATO do të diskutojë dhe do të marrë vendim për pranime të reja.

Por cilat janë vendet që mund të marrin ftesën për anëtarësim? Le t'i marrim me radhë duke filluar nga Ballkani Perëndimor, pra Maqedonia, Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovina, Serbia, Kosova dhe në fund Gjeorgjia e Ukraina.

Maqedonia iu bashkua Partneritetit për Paqe në vitin 1995 dhe filloi zbatimin e MAP-it në vitin 1999, në të njëjtën kohë me Shqipërinë. Përparimet e saj kanë qenë të dukshme, i kishte plotësuar të gjitha kushtet dhe ishte gati që, në Samitin e Bukureshtit të merrte ftesën për anëtarësim së bashku me Kroacinë dhe Shqipërinë. Por një mosmarrëveshje me Greqinë mbi punën e emrit të Maqedonisë, bëri që anëtarësimi të shtyhej dhe, akoma edhe sot ka mbetur pezull. Greqia nuk është dakord që Maqedonia të pranohet me emrin e sanksionuar në Kushtetutë, "Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë", që sipas saj cenon integritetin territorial të Greqisë. Në momentin që Greqia do të heqë bllokimin e saj për emrin, Maqedonia automatikisht merr ftesën për anëtarësim.

Në Samitin e Çikagos, duke folur me lëvdata për pjesëmarrjen e rëndësishme të ushtarëve të Maqedonisë në misionin në Afganistan, Sekretarja Amerikane e Shtetit Znj. Klinton, u bëri thirrje Shkupit dhe Athinës që ta zgjidhin çështjen e emrit, në mënyrë që Maqedonia sa më shpejt të bëhet anëtare e NATO-s.

Maqedonia e hodhi Greqinë në Gjykatën Ndërkombëtare, në lidhje me çështjen e bllokimit të anëtarësimit të saj në NATO. Në 11 dhjetor 2011, kjo gjykatë, me 15 vota pro dhe një kundër (kundër ishte vetëm gjyqtari grek), vendosi se Greqia nuk kishte të drejtë të pengonte Maqedoninë të merrte ftesën për anëtarësim në Samitin e Bukureshtit në vitin 2008.

Megjithëse rreth 82% e popullsisë maqedonase nuk është dakord për ndërrimin e emrit, kohët e fundit vihen re lëvizje intensive nga politikanët e të dy vendeve për të

gjetur një zgjidhje të pranueshme nga të dy palët, me synimin që në Samitin e ardhshëm të NATO-s, kjo mosmarrëveshje, të jetë sheshuar.

Bazuar në vendimet e marra në Samitin e Bukureshtit, anëtarësimi i ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë në Aleancë do të kryhet sapo të zgjidhet mosmarrëveshja e emrit me Greqinë

Mali i Zi po punon fort për t'u anëtarësuar në NATO. Në Samitin e Rigës, në 3 qershor 2006, Mali i Zi pranohet në procesin e Partneritetit për Paqe dhe që atëherë, përparimet e tij drejt anëtarësimit kanë ardhur në rritje. Në nëntor të viti 2007 nënshkruan Marrëveshjen me NATO-n, me anë të së cilës lejoheshin trupat e NATO-s të kalonin në territorin e saj. Në nëntor të vitit 2008 aplikoi për MAP, kërkesë që u pranua në dhjetor të vitit 2009.

Mali i Zi mbështetet fuqishëm nga vendet anëtare të NATO-s për të plotësuar të gjitha kushtet për anëtarësim. Ai merr pjesë vazhdimisht në operacionet e NATO-s si në Afganistan dhe në operacione të tjera paqeruajtëse, në Liberi e në Somali.

Problem mbetet mbështetja e opinionit publik. Në një aktivitet të organizuar nga Këshilli Atlantik në Malin e Zi, vitin që kaloi u paraqit sondazhi sipas së cilit vetëm 35% e opinionit publik mbështet anëtarësimin në NATO, 40% janë kundër dhe 25% janë të pavendosur. Ka një farë rritje nga sondazhet e mëparshme (në vitin 2009 ishte 31%), por gjithsesi mbështetja e opinionit publik mbetët e ulët. Ka edhe parti politike parlamentare që i kundërvihen këtij procesi.

Megjithatë, duke parë përparimet dhe reformat e kryera në kuadër të rrugës drejt anëtarësimit, ka shumë mundësi që në Samitin e ardhshëm të NATO-s, i cili pritet të mbahet në vitin 2014, Mali i Zi të marrë ftesën për anëtarësim, gjithnjë në qoftë se do të arrihet konsensusi i 28 vendeve anëtare.

Bosnjë-Hercegovina iu bashkua procesit të Partneritetit për Paqe në vitin 2006 dhe nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit në fushën e Sigurisë në vitin 2007. Në shtator të vitit 2008 u ftua të bëhet anëtare e Kartës se Adriatikut. Në shkurt 2009, Ministri i Mbrojtjes i Bosnjë-Hercegovinës, Selmo Cikotic, deklaroi se 70% e vendit mbështet anëtarësimin në NATO. Me mbështetjen e fortë të Turqisë, vendi u ftua në Planin e Veprimit për Anëtarësim, në dhjetor të vitit 2010, por me disa kushte : U autorizua Këshilli i Atlantikut të Veriut të pranonte Programin Kombëtar Vjetor në kuadrin e MAP-it, vetëm atëherë kur pronat e patundshme të mbrojtjes, të identifikuara si të domosdoshme në fushën e mbrojtjes për të ardhmen, të ishin zyrtarisht të regjistruara si pronë e shtetit të Bosnjë-Hercegovinës, në përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes. Ky kusht deri tani, pra pas 3 vjetësh nga pranimi në MAP, nuk është plotësuar. Është për të ardhur keq që Bosnja humbi kaq kohë për t'iu bashkuar NATO-s, por nga ana tjetër, vendi favorizohet nga fakti se zgjerimi në Ballkanin Perëndimor është një prej objektivave kryesorë të Aleancës. Gjithsesi, nisur nga fakti që ende Bosnjë-Hercegovina nuk kanë përmbushur kushtin e mësipërm dhe nuk ka filluar zbatimin e MAP-it, e bën pothuaj të pamundur që ky, vend në Samitin e ardhshëm të Aleancës, të marrë ftesën për anëtarësim.

Serbia u bë pjesë e Programit të Partneritetit për Paqe në Samitin e Rigës, në vitin 2006. Ky Program është hapi i parë për një shtet drejt anëtarësimit në NATO, por

mbetet e paqartë nëse Serbia dëshiron vërtet për t'u anëtarësuar në Aleancë. NATO ka luftuar serbët e Bosnjës gjatë luftës në Bosnjë, si dhe ka bombarduar Serbinë gjatë konfliktit me Kosovën në vitin 1999, për pasojë, mbështetja e opinionit publik në Serbi për anëtarësim në NATO është shumë e ulët, rreth 28%. Vetëm disa parti të vogla politike janë për anëtarësim në NATO, ndërsa të tjerat jo. Veç kësaj, anëtarësimi në NATO nuk figuron si prioritet në programet e partive në pushtet. Pra qeveria e Beogradit nuk ka shprehur ndonjëherë dëshirën për t'u bërë pjesë e Aleancës, duke u shprehur se Partneriteti për Paqe, tani për tani, mjafton.

Kosova Për kontributin unik që NATO ka dhënë në pavarësinë e Kosovës dhe për ndihmesën e madhe ndër vite për sigurinë dhe ndërtimin e institucioneve demokratike, besoj se nuk ka vend tjetër të dëshirojë kaq shumë të bëhet anëtare e NATO-s se sa Kosova.

Përparimet e mëdha që Kosova ka bërë si në aspektin politik, ashtu edhe në atë ushtarak janë vlerësuar lart nga autoritetet më të larta të NATO-s. Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK) kanë një numër personeli afërsisht prej 2200 vetë. Në qershor të këtij viti, FSK janë konsideruar nga Këshilli i Atlantikut të Veriut si forca me kapacitete të plota, të përgatitura plotësisht sipas standardeve të NATO-s për operacione humanitare, kërkim-shpëtim, përballimi i emergjencave civile etj. Në vazhdën e këtij vlerësimi, NATO do të vazhdojë të ndihmojë perfeksionimin e mëtejshëm të kësaj force, nëpërmjet Ekipit të Ndërlidhjes dhe Këshillimit të NATO-s i cili përbëhet nga një personel miks prej 30 vetësh, ushtarakë dhe civilë.

Faktikisht, Kosova nuk ka nisur procedurat për anëtarësim në NATO. Kjo edhe për faktin se vende anëtare të Aleancës, si: Greqi, Spanjë, Rumani apo Portugalia nuk e kanë njohur ende pavarësinë e saj.

Gjeorgjia është vendi ndoshta më i komplikuar për sa i përket anëtarësimit në NATO, vend i cili u përfshi në konflikt të armatosur me Rusinë dhe forcat ushtarake ruse janë akoma të dislokuara në rajonin e Abkazisë dhe Osetisë Jugore.

Gjeorgjia ka qenë ndër vendet e para që ka nënshkruar me NATO-n programin e Partneritetit për Paqe në vitin 1994 dhe gjithnjë e ka justifikuar këtë me dëshirën e fortë për anëtarësim, si kundërvënie ndaj kërcënimeve që mund të vinin nga Rusia. Ajo ka punuar fort për të përmbushur detyrimet për anëtarësim dhe në bazë të numrit të popullsisë, ka dhënë një kontribut të çmuar në operacionet e NATO-s në Afganistan, me një numër ushtarësh shpesh më të shumtë se edhe disa vende anëtare të NATO-s, bile ka patur edhe viktima; 77% e popullsisë mbështesin anëtarësimin në NATO dhe objektivi më i afërt ka qenë pranimi në MAP gjatë Samitit të Bukureshtit në vitin 2008. Në këtë Samit, administrata e Presidentit Amerikan Bush po punonte shumë në mënyrë që Gjeorgjia dhe Ukraina të pranoheshin në MAP dhe të përshpejtohej procesi për anëtarësimin e tyre në NATO, por vende të tilla si, Franca, Gjermania etj ishin kundër këtij pranimi. Një konflikti i mundshëm midis Rusisë dhe Gjeorgjisë, në bazë të nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit, do të angazhonte NATO-n në një konflikt me Rusinë. Me konsensus u vendos që Ukraina dhe Gjeorgjia të mos pranoheshin në MAP, por rruga e anëtarësimit të tyre në NATO të lihej e hapur. Në Deklaratën pas Samitit të Bukureshtit u vendos që:" Ne sot ramë dakord që këto vende të bëhen në të ardhmen anëtare të NATO-s", por pa dhënë një datë konkrete pranimi.

Hap tjetër ishte edhe krijimi i një Komisioni të veçantë NATO – Gjeorgji, në mënyrë që të vihej në dukje statusi i veçantë që ka Gjeorgjia, në krahasim me vendet e tjera aplikante. Disa muaj me vonë, në gusht 2008, filloi lufta Rusi - Gjeorgji, e cila u shndërrua në faktorin kryesor për pro ose kundër pranimit të Gjeorgjisë në NATO.

Pas Samitit të Bukureshtit, kërkesa e Ukrainës për anëtarësim në NATO mori një rrjedhë tjetër. Udhëheqës të lartë të vendit filluan të deklarojnë se vendi nuk ishte më i interesuar për një anëtarësim të shpejtë në NATO, ndërsa në qershor 2010, Parlamenti i Ukrainës miratoi ligjin sipas të cilit Ukraina nuk do të marrë pjesë në aleanca politiko-ushtarake, por do të vazhdojë partneritetin me NATO-n, si vend i paangazhuar.

Kështu, nga vendet që aspirojnë për anëtarësim mbetet vetëm Gjeorgjia si mollë sherri dhe që ka realisht vështirësi për arritjen e konsensusit për zgjerimin e radhës. Pavarësisht krizës financiare dhe shkurtimeve të buxhetit të mbrojtjes në pothuaj të gjitha vendet anëtare, Gjeorgjia ka pasur një zhvillim konstant ekonomik. Në maj 2013, Kryeministri i Gjeorgjisë, Bidzida Ivanishvili, deklaroi se qëllimi i qeverisë së tij është pranimi në MAP nga NATO brenda vitit 2014.

Megjithatë konflikti territorial midis Rusisë dhe Gjeorgjisë, prania e trupave ushtarake ruse atje, e vështirëson shume pranimin e Gjeorgjisë në NATO. Në nenin 6 të Studimit mbi Zgjerimin, për të cilin folëm më lart, thuhet se: vendet aplikante me probleme territoriale apo me lëvizje irredentiste duhet t'i zgjidhin ato, para se të pranohen në NATO. Disa analistë, mbështetës të pranimit të Gjeorgjisë në NATO, bëjnë analogji me pranimin e Gjermanisë në 1955 në NATO. Në atë kohë, një e treta e Gjermanisë ishte e pushtuar nga trupat e Bashkimit Sovjetik dhe megjithatë, vendi u pranua në NATO. Pavarësisht kësaj, është vështirë që situata e asaj periudhe që i përket fillimit të Luftës së Ftohtë, të krahasohet me konfliktin e sotëm Rusi–Gjeorgji, për Abkhazinë dhe Asetinë Jugore.

Si përfundim, nisur edhe nga tradita e pranimeve të reja që Aleanca ka bërë pas Luftës së Ftohtë, me shumë gjasa, vendet që do të marrin ftesën për anëtarësim në NATO do të jenë fqinjët tanë, Maqedonia dhe Mali i Zi

Bibliografi:

- Traktati i Atlantikut të Veriut.
- Aksioni i Veprimit për Anëtarësim (MAP), NATO.
- Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, 5 dhjetor 2011.
- BBC News, 3 qershor 2010 " Parlamenti i Ukrainës braktis ambicien për në NATO".
- Koncepti i Ri Strategjik i NATO-s, Lisbonë, nëntor 2010.

Kultura për sigurinë rrit vetëdijen në zbatimin e detyrave

Dr. Ulsi Meta,

Trajtesë e shkurtuar. *Kultura e sigurisë është një fushë relativisht e re e sigurisë së informacionit. Vitet e fundit, studiues dhe hulumtues të sigurisë filluan të njohin dhe të pranojnë se kultura e sigurisë e një organizate, strukture shtetërore apo private është një faktor i rëndësishëm në arritjen e një niveli të përshtatshëm të sigurisë së informacionit dhe të sistemeve të komunikimit dhe informacionit ku përpunohet, ruhet dhe transmetohet informacioni i një strukture.*

Zbatimi i teknologjive të sigurisë së informacionit nuk mund të rezultojë gjithmonë në përmirësimin e sigurisë. Faktorët njerëzorë luajnë një rol të rëndësishëm në sigurinë e informacionit. Janë njerëzit ata që përgatisin informacionin, që e përpunojnë, e ruajnë, e transmetojnë dhe zbatojnë kërkesat procedurale dhe teknike të mbrojtjes së informacionit. Njerëzit karakterizohen nga diferencat në kulturë, qëndrimet dhe sjelljet individuale, aftësitë njohëse, tiparet e personalitetit, perceptimi individual i rrezikut etj. Gjithashtu, të gjitha këto elemente janë të ndikuara nga kultura e strukturës dhe mjedisi i sigurisë në të cilin ato ndodhin. Këta faktorë ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe mund të rezultojnë në veprime dhe qëndrime që shpesh janë të dëmshme për sigurinë e informacionit.

Kuptimi i kulturës së sigurisë

Në mjaft raste, kur diskutohet për kulturën e sigurisë, vërehet se ka një trajtim të kufizuar, duke u fokusuar vetëm në veprimet dhe sjelljet e përdoruesve fundorë dhe në mënyrën se si mund të ndikohet në menaxhimin e aspekteve të kulturës të sigurisë për të zhvilluar dhe përshtatur përdoruesit fundorë me politikat e sigurisë. Por, ndikimi i kulturës së sigurisë në një strukturë civile apo ushtarake shkon përtej përcaktimeve të politikës konkrete të sigurisë. Fakti që shumë incidente të sigurisë, të përjetuara nga një strukturë, shkaktohen nga personeli i tyre, është një argument bindës për strukturën që të jetë e shqetësuar për kulturën e sigurisë. Krijimi i një kulture sigurie të mirë është faktor i rëndësishëm në edukimin dhe veprimin praktik të personelit në përputhje me kërkesat e sigurisë së informacionit.

Për kulturën e sigurisë ka shumë përkufizime, por në thelb ajo është një tërësi e besueshmërisë, sjelljeve, veprimeve, praktikave dhe pranueshmërisë që mbështesin sigurinë e informacionit. Zhvillimi i një kulture të sigurisë brenda një strukture është i lidhur me nxitjen e personelit për të njohur, respektuar dhe zbatuar kërkesat ligjore, politikat, procedurat dhe standardet e sigurisë brenda dhe jashtë vendit të punës. Kultura e sigurisë është më shumë se sa pajisjet dhe procedurat. Ajo ka të bëjë me krijimin e një mjedisi të hapur dhe të besueshëm, të fokusuar në veprime aktive për të pakësuar rrezikun që mund t'i kanoset një strukture të caktuar.

Paralajmërimi i personelit për sigurinë, vetëdija e tyre gjatë zbatimit të detyrave funksionale, trajnimi, udhëzimet dhe komunikimet e vijueshme me personelin luajnë një rol të rëndësishëm. Këto masa kanë një rëndësi të madhe nëse shoqërohen me veprime konkrete. Personelit mund t'i kërkohet të ruajë dokumentet në mënyrë të sigurtë, fizikisht ose elektronikisht, por më parë duhet t'i garantohet mjetet e nevojshme.

Një mjedis pune, natyrisht që ka një kulturë të brendshme që ndikon mbi personelin për të bashkëvepruar dhe për sjelljen ndërmjet tyre. Por, kultura ekzistuese mund të mos mbështesë plotësisht sjelljet dhe veprimet e përshtatshme për sigurinë. Prandaj, struktura duhet të zhvillojë një kulturë ku veprimet e përditshme dhe qëndrimet e stafit të kontribuojnë vijimësisht për një mjedis pune sa më të sigurt.

Një strukturë mund të ketë të qartë idenë e kulturës së sigurisë që ajo kërkon. Mbi këtë bazë struktura e përpunon dhe ndryshon vijimësisht atë, duke marrë në konsideratë natyrën e detyrës që ka, mjedisin ku vepron dhe vendin që zë brenda një strukture tjetër. Në këtë kontekst, termi "kulturë" i referohet vendimmarrjes, metodës, synimeve dhe vlerave që struktura synon të arrijë për sigurinë. Nga kjo lind e nevojshme të qartësohet se cili është niveli që pritet të marrë vendime për praktikat e sigurisë, si do të ofrojë struktura udhëzime të sakta për sigurinë personelit, çfarë nivel rreziku konsiderohet i pranueshëm dhe pa pasoja në punën e përditshme, në çfarë shkalle duhet të jetë detyrimi për zbatimin e masave të sigurisë, etj. Bazuar në këto, struktura analizon përmasat e hendekut ndërmjet kulturës aktuale dhe asaj të dëshiruar dhe përcakton çfarë duhet të bëjë për të arritur sjelljen dhe përfundimin e kërkuar.

Strukturat duhet të përcaktojnë mekanizmat e duhura që lidhen me futjen e kulturës së duhur në mendimin dhe qëndrimin e personelit. Kështu mund të përqendrohemi në menaxhimin e sigurisë për përshtatjen e sjelljeve dhe veprimeve të dëshiruara të personelit, aftësimin e tij, trysninë dhe masat detyruese etj. Sidoqoftë, duhet marrë në konsideratë se një mekanizëm që funksionon mirë në një strukturë nuk është e mundur të jetë i përshtatshëm për një tjetër, për shkak të kulturës ekzistuese të sigurisë, objektivave, rregullit, metodës së punës dhe mënyrës së menaxhimit të sigurisë.

Masat për edukimin me kulturën e sigurisë

Çdo strukturë përcakton masat e nevojshme të sigurisë mbi bazën e politikës së saj të sigurisë. Suksesi i masave dhe procedurave të sigurisë së strukturës varet se sa efektivisht ato janë transmetuar te personeli. Individët do të përfshihen më shumë, nëse ata qartësohen përse janë vendosur masat e sigurisë dhe çfarë përgjegjësish

kanë ata në lidhje me sigurinë. Në këtë mënyrë, çdo individ mund të japë një kontribut pozitiv për kulturën e sigurisë dhe ka mundësi të zbulojë dhe parandalojë një akt dëmtues të brendshëm.

Rritja e shkallës së opinionit të personelit rreth standardeve të sigurisë brenda një strukture është një metodë e dobishme për të përcaktuar qëndrimin aktual dhe për të monitoruar në kohë çdo prirje. Informimi i personelit për përvojën pozitive dhe negative që ekziston brenda strukturës dhe zgjidhjet për probleme të ndryshme janë mjaft efektive në arritjen e kulturës së sigurisë.

Veprimi i drejtuesve kryesorë (vendimmarrësve) ka një rol parësor në rritjen e kulturës së sigurisë. Angazhimi dhe veprimi i drejtuesve është i rëndësishëm për të demonstruar te personeli që masat e sigurisë janë të nevojshme, të vlefshme, të zbatueshme për të gjithë dhe që do të monitorohen të gjithë. Mbështetja e tyre është garanci për sigurimin e burimeve të nevojshme financiare dhe materiale për të përmirësuar ose ruajtur sigurinë brenda strukturës. Drejtuesit, si përgjegjësit direkt për vartësit e tyre, janë pika ku mund të reflektohen sjelljet korrekte ose të gabuara të individëve. Mungesa e angazhimit të tyre do të dëmtojë procesin e ngritjes së një kulture të nevojshme të sigurisë.

Përcaktimi i buxhetit për sigurinë është i domosdoshëm për të garantuar mjetet e nevojshme që zbatohen për sigurinë. Nëse nuk investohet, nuk do të arrihen masa efektive për sigurinë e informacionit. Praktika tregon se, kur kjo nuk kuptohet nga drejtuesit, shpesh personeli përgjegjës për sigurinë vihet në vështirësi për sigurimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të sigurisë. Zbatimi i masave të sigurisë të një strukture është i lidhur ngushtë me ekzistencën e politikës dhe procedurave të sigurisë dhe me njohjen e tyre nga personeli. Këto nuk duhet të mbeten qëllim më vete thjesht për të thënë që janë hartuar. Personelit i duhet krijuar mundësia e hyrjes në këto dokumente si dhe duhet testuar për njohjen e tyre. Praktika tregon se shpesh personeli nuk ka dijeni për procedurat e sigurisë ose e di që ekzistojnë por nuk i njeh ato në detaje. Për këtë arsye, këto dokumente duhen çuar te personeli në formë të shkruar ose elektronike.

Politika dhe procedurat e sigurisë duhet të jenë të qarta. Ato duhet të përfshijnë nënvizimin e objektivave, synimeve, përgjegjësive dhe veprimeve që duhen ndjekur për të mos thyer masat e sigurisë, por nga ana tjetër edhe dënimet konkrete. Procedurat e qarta e mundësojnë strukturën të trajtojë thyerjet, të evidentojë thyerësit e rregullave dhe të kërkojë që individët të ndëshkohen për shkeljet. Për t'iu përgjigjur masave dhe zhvillimeve të sigurisë së informacionit, politika dhe procedurat e sigurisë duhen përditësuar. Një dokument i hartuar qoftë edhe para një viti mund të mos jetë i kohës dhe i vlefshëm për kohën aktuale.

Që politika dhe procedurat të jenë efiçente dhe të mos mbeten thjesht dokumente pa vlerë, nevojitet që të ushtrohet kontroll i hapur dhe i vijueshëm për zbatimin e tyre. Nëse personeli e di që në realitet nuk do të kontrollohet, për shembull, për futjen e pajisjeve elektronike të paautorizuara në zyrë ose që nuk do të ndëshkohet për këtë shkelje, kjo është një nxitje për të mos e besuar këtë politikë apo procedurë. Përveç kësaj, kur zbatimi i procedurave nuk ndiqet vijimësisht, personeli mund të mendojë që ata nuk kontrollohen. Për të transmetuar mesazhet kryesore të sigurisë te personeli, duhen përdorur vazhdimisht paralajmërimet dhe mënyra të tjera për t'i rikujtuar për masat e sigurisë.

Një kulturë sigurie efektive kërkon përgjegjësi individuale dhe angazhim të çdo pjesëtari të personelit, pavarësisht se ata janë të përhershëm, të përkohshëm ose kontratorë. Kjo është e rëndësishme pasi çdo i punësuar mund të keqkuptojë ose të mos marrë parasysh masat e sigurisë, duke krijuar një pikë të dobët në kulturën e sigurisë. Është e rëndësishme që zyrat dhe personeli përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të masave të sigurisë të strukturës, të mbështetet kur ai përballet ose raporton ata të cilët shkelin rregullat dhe procedurat e sigurisë. Po kështu, në organikat e strukturave duhet të gjejnë vend më mirë funksione të mirëfillta dhe të specializuara që të përgjigjen për masat e ndryshme të sigurisë. Për të evidentuar dhe qartësuar përgjegjësitë individuale të personelit për mbrojtjen e informacionit, është e domosdoshme që individëve t'u kërkohet të nënshkruajnë një deklarim për zbatimin e detyrimeve dhe përgjegjësive personale për politikën dhe procedurat e sigurisë dhe kërkesat konkrete që ka struktura që në fillim të punësimit. Kjo duhet të mbështetet me udhëzime të vijueshme dhe informacion të përditësuar.

Siguria e mjedisit të punës është pjesë e kulturës së sigurisë. Në pamje të parë duket sikur kjo është një kërkesë jo shumë e pranueshme. Por, është e domosdoshme që mjedisi i punës të modelohet për të mos krijuar asnjë shkak për cenimin e sigurisë së informacionit. Të gjitha aspektet e mjedisit të zyrës duhen marrë në konsideratë për të garantuar që nuk ka ndonjë dobësi të sigurisë. Ka mjaft shembujt që duhen patur në vëmendje si: mos lejimi i personave të paautorizuar që të njihen me dokumente të cilat nuk u adresohen ose u përkasin atyre; kontrolli i printerëve që të mos kenë punë të ruajtur në memorie; mos lënia e dokumenteve jashtë kasafortës ose sirtarëve të pakyçur; lënia e fjalëkalimeve të tjerëve; asgjësimi i të gjitha mbeturinave dhe letrave; komunikimi me persona jashtë zyrës, etj.

Dokumentet që përpunohen në një strukturë janë zyrtare dhe pronë e tyre. Personeli nuk ka asnjë të drejtë, pavarësisht shkallës së besueshmërisë që i është dhënë, që këto dokumente t'i nxjerrë jashtë zyrës. Shpesh këtu abuzohet me termin e të qenit të dokumentit i klasifikuar ose jo. Pavarësisht nivelit të klasifikimit, dokumentet e një strukture janë zyrtare dhe nevojitet autorizim i titullarëve që ato të jenë ose jo publike.

Kontrolli i vijueshëm mbi marrjen dhe dorëzimin e dokumenteve si dhe mënyrën e ruajtjes së tyre në zyra është një mjet që do të ndikonte shumë në sigurinë e informacionit. Kur jemi të shqetësuar për humbjen ose lëvizjen e dokumenteve, është e nevojshme që të vihen rregulla dhe të kontrollohet administrimi dhe shumëfishimi i tyre duke kufizuar vendin dhe mundësinë e hyrjes në mjetet e fotokopjimit. Gjithashtu, evidentimi i personave me një numër personal identifikimi, bën të mundur të kontrollohet se kush dhe sa ka printuar apo fotokopjuar. Pajisja e personelit me aftësitë e duhura ka rëndësi në garantimin e zbatimit të përgjegjësive brenda konceptit të sigurisë të strukturës. Për këtë nevojitet trajnimi dhe informimi i vijueshëm, që mund të arrihen nëpërmjet mbledhjeve të punës, zbatimit të skenarëve të veprimit sipas roleve që kanë në sistem, udhëzimeve, demonstrimeve të mënyrave të veprimit, artikujve, forumeve, posterave, paralajmërimeve, kontrolleve të shkurtra etj.

Siguria e personelit mbetet një nga drejtimet më të rëndësishme në sigurinë e informacionit. Procedurat e sigurisë së personelit synojnë të menaxhojnë rrezikun e njerëzve që përdorin ose kanë si qëllim të përdorin hyrjen ligjore të tyre tek asetet e strukturës për qëllime të paautorizuara.

Vlerësimi i rrezikut të sigurisë së personelit përqendrohet në aftësitë e tyre, rolin e funksionit të tyre kur kanë të drejtë hyrje në asetet e strukturës, rrezikun që mund të shfaqin, përshtatshmërinë me masat mbrojtëse etj. Në vlerësimi i rrezikut është vendimtar ndihma që japin menaxherët e sigurisë, të burimeve njerëzore dhe persona të tjerë të përfshirë në vendimet për vlerësimin e rrezikut të personelit.

Me marrjen e personelit në punë është mjaft e domosdoshme që të organizohen programet fillestare me udhëzime konkrete për të theksuar rëndësinë e sigurisë dhe paraqitur drejtimet bazë që duhet të ketë në konsideratë çdo pjesëtar i një strukture. Personat përgjegjës për organizimin dhe zbatimin e sigurisë duhet të kapërcejnë disbalancën që krijohet nga shpjegimi i procedurave që duhen ndjekur, nxitja e stafit për të pranuar përgjegjësitë personale për sigurinë dhe kërkesat e nevojshme por të paparashikuara në procedura.

Për të arritur një trajnim të mirë të personelit me kulturën e sigurisë duhet të përqendrohemi në: nxitjen e personelit për t'i vlerësuar kërkesat e sigurisë si të domosdoshme dhe të arritshme; raportimin e menjëhershëm të problemeve të sigurisë (nëpërmjet rrugëve të përcaktuara qartë); demonstrimin e mbështetjes pa kushte të zbatimit të politikën e sigurisë (veçanërisht nga ana e drejtuesve); sqarimin e politikave të sigurisë në mënyrë të hapur (p.sh.; deklarimi i qartë i problemeve, zonave, materialeve sensitive); dhënien e një pamje reale të kërcënimeve dhe rreziqeve për strukturën; nxitjen e kulturës që zgjidh dhe rregullon problemet se sa fokusimin në fajësimin dhe dënimin e personelit; vlerësimin e zbatimit të masave dhe standardeve të sigurisë, etj.

Gjatë trajnimit të personelit duhen shmangur disa praktika të cilat kanë efekt negativ si: analizimi i veprimeve ose sjelljeve të cilat nuk janë thelbësore; zmadhimi i rreziqeve dhe kërcënimeve që mund të përballet struktura për të siguruar më shumë besueshmëri; dhënia e pohimeve të pa vërteta rreth sigurisë, duke u përpjekur të frikësohet personeli për të qenë në pajtim me rregullat, etj.

Kultura e sigurisë dhe faktorët njerëzorë

Epoka e informacionit ka bërë që të jemi shumë të varur nga sistemet komplekse të informacionit. Nga ana tjetër, jemi të fokusuar në dobësitë e këtyre sistemeve ndaj sulmeve të sigurisë dhe krimeve kompjuterike. Për shkak të teknologjisë së lartë të këtyre sistemeve dhe të ekspertizës teknike të kërkuar për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e tyre, nuk është e papritur që vëmendja kryesore e specialistëve ka qenë dhe mbetet e përqendruar në dobësitë teknologjike dhe zgjidhjen e tyre. Por, nga ana tjetër, nuk duhen harruar njerëzit, të cilët projektojnë sistemet, i shfrytëzojnë apo i sulmojnë ato dhe kuptojnë psikologjinë dhe veprimet e sulmuesve të sistemeve të informacionit.

Në faktorët njerëzorë, një vëmendje e veçantë i kushtohet personelit që është në organikë të strukturës, që zakonisht i quajmë "të brendshëm". Nëse do t'i gruponim të brendshmit, këtu mund të futen: personeli përdorues, specialistët e teknologjisë së informacionit, kontraktorët dhe ish-punonjësit. Konteksti i personelit është kritik për të kuptuar marrëdhënien ndërmjet njerëzve që kanë lidhje me informacionin dhe teknologjinë e informacionit dhe strukturës ku bëjnë pjesë.

Personeli përdorues paraqet mbase rrezikun më të madh në kuptimin e të drejtës së

hyrjes dhe dëmtimit të mundshëm në sistemet e informacionit, pasi është i madh në numër. Pas shqyrtimit të pastërtisë, personeli është në pozicionin e besueshmërisë dhe supozohet të ketë një ndikim të madh në funksionimin e sistemeve. Të konsideruar "pjesëtarë të strukturës", ata shpesh janë tej dyshimit ose të fundit që merren në konsideratë kur një sistem funksionon keq apo dështon.

Specialistët e teknologjisë së informacionit kanë të drejta hyrje në projektimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve. Personeli i kësaj kategorie janë një problem i veçantë pasi ata zotërojnë aftësi të nevojshme dhe hyrje për t'u përfshirë në shpërdorim ose dëmtim. Detyrat më tipike janë: administratorët e sistemit, programuesit, inxhinierët e rrjetit etj.

Studime të ndryshme kanë përcaktuar se specialistët e teknologjisë së informacionit kanë tendencën të jenë të rezervuar dhe më pak të hapur në grup. Ata janë të orientuar drejt botës së brendshme të koncepteve dhe ideve se sa te bota e jashtme e njerëzve. Ata pëlqejnë të jenë vetëm, preferojnë mendimet e tyre në bashkëbisedimet me të tjerët dhe nga ana sociale mund të jenë jo të shoqërueshëm dhe të hapur. Gjithashtu, ata tentojnë të jenë përtej të ndërgjegjshmit, të fshehtë, pesimistë dhe kritikë.

Për sa më sipër, është e nevojshme që këto karakteristika të njihen nga drejtuesit e specialistëve të teknologjisë së informacionit, por kurrsesi nuk mund të përgjithësohen dhe përdoren për paragjykimin e këtyre individëve në veprimet e tyre. Nuk duhet harruar se këta njerëz kanë edhe disa veçori të personalitetit të tyre me shumë vlerë si: të kujdesshëm për veten, të menduar, pëlqejnë të kuptojnë detajet, të interesuar në vetënjohje dhe vetëkuptim, i mbajnë emocionet për vete, të qetë dhe të rezervuar në grupe të mëdha dhe me njerëz të panjohur, më të afruar dhe të shoqërueshëm me njerëzit që i njohin mirë, mësojnë mirë nëpërmjet vëzhgimit etj.

Për ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve, shpesh strukturat futen në marrëdhënie me kontraktorë të ndryshëm. Kontraktorët edhe konsultuesit punojnë si të përkohshëm me strukturën, por në këtë moment ata duhet të konsiderohen si të brendshëm. Për këtë arsye, ndaj tyre nevojitet të zbatohen pa asnjë lëshim të gjitha kërkesat e ligjore dhe procedurat e sigurisë që ka struktura. Sigurimi dhe kontrolli i të dhënave për besueshmërinë e kontraktorëve dhe punonjësve të tyre është i domosdoshëm që në fazën e parë të fillimit të punës me to. Kjo është e rëndësishme sepse kontraktorët shpesh kanë privilegje të larta hyrje në asetet e informacionit të strukturave për shkak të ekzistencës së mundësive të jashtme të programimit dhe të funksioneve të tjera të teknologjisë së informacionit në distancë.

Ish-personeli përfshin individë të cilët kanë punuar për një kohë në një strukturë, por që mund të mbajnë akses te sistemet dhe burimet e informacionit për shkak të neglizhencës në heqjen e të drejtave të hyrjes, formave të fshehjes ose indirekt nëpërmjet ish-shoqërisë që ruajnë me personelin që punon. Konflikti i mundshëm me një person ose synimi për një veprim të qëllimshëm, mund të përgatisin shkakun për hyrjen e fshehtë në sistemet kompjuterike, fjalëkalimet e ndryshme ose thjesht rezervimin e të dhënave për një përdorim të mëvonshëm. Kjo dikton nevojën për të përmirësuar menaxhimin e procesit të kontrollit dhe shkëputjes së të drejtave për të hyrë në sisteme menjëherë sapo një person ndërpret marrëdhëniet e punës apo shkon në një detyrë tjetër.

Një shqetësim i madh në kuadër të sigurisë së informacionit është kërcënimi i sulmeve të "inxhinierisë sociale". Sulmet e "inxhinierisë sociale" kryhen në përpjekje për të marrë informacion të ndjeshëm (sensitiv) dhe ky informacion shpesh përdoret me keqdashje në dëm të individëve dhe strukturave. "Inxhinieria sociale" përbën një kërcënim real për të gjitha strukturat dhe për të pakësuar këtë kërcënim, individët duhet jo vetëm të jenë të vetëdijshëm për sulmet e mundshme, por gjithashtu të njohin dhe zbatojnë mjetet e përshtatshme për të zvogëluar shanset e tyre për t'u bërë një objektiv dhe një viktimë. Shpesh, nën petkun e ndihmës ndaj kolegëve të përfshirë në "inxhinierinë sociale", të brendshmit me ose pa dashje bëhen bashkëpunëtorë me persona të jashtëm, gjë që mund të shfrytëzohet prej tyre për të cënuar sigurinë e sistemeve.

Dëmtimet madhore të sistemeve të informacionit mund të rriten edhe për shkak të tendencës së konsolidimit dhe përqendrimit të sistemeve, mënjanimit dhe shkeljes së parimit "nevoja për njohje". Këto mundësi, të projektuara për të përmirësuar ndarjen e informacionit dhe rritur funksionalitetin, bëjnë të mundur që kundërshtari të gjejë hapësira për të hyrë dhe dëmtuar sistemet e informacionit.

Rastet dhe shembujt e rrezikimit të sistemeve të informacionit nga të brendshmit janë të shumta dhe përfshijnë veprime të ndryshme si: marrja e të dhënave të strukturës dhe dhënia e tyre të tjerëve; veprimi si sulmues i brendshëm; modifikimet dhe ndryshimet në konfigurime; sulmet nga jashtë; moskryerja në kohë e procedurave të përditësimit ose instalimit të plotë të një programi; veprimet e panevojshme dhe të parregullta gjatë rregullimit ose fshirjes etj.

Rastet e thyerjes së sigurisë tregojnë që rritja e besueshmërisë ndaj teknologjisë së informacionit është e lidhur ngushtë me dobësitë që krijohen nga personeli që i projekton, mirëmban dhe shfrytëzon sistemet. Specialistët e teknologjisë së informacionit, operatorët, programuesit, inxhinierët e rrjetit dhe administratorët e sistemit mbajnë pozicione të rëndësishme dhe shumë të besueshme. Veprimet keqdashëse të tyre si të brendshëm mund të kenë pasoja të rënda dhe serioze. Kjo është veçanërisht e vërtetë për sisteme që janë kritike për një strukturë.

Thyerjet e sigurisë së sistemeve të informacionit tregojnë edhe disa probleme të tjera. *Së pari*, është e qartë që problemet e brendshme në shkallë të ndryshme ekzistojnë. *Së dyti*, gjatë funksionimit të sistemeve, ka një tendencë të përdoruesve dhe administratorëve për t'i zgjidhur problemet shpejt dhe pa zhurmë, duke mënjanuar ndikimet e rrezikshme organizative e personale dhe publicitetin. Kjo bën që realisht të mos njihet sa është shtrirja dhe gjerësia e problemit. Shpesh ka një optimizëm dhe familjaritet dhe deklarohet vetëm ajo që mund të mos jetë kryesore në shkeljet e sigurisë në sisteme. Kështu, mund të jemi të rrezikuar nga shkelësit përsëritës që fshehin gabimet, pasi autorët e thyerjeve kalojnë nga një pozicion pune në një tjetër, të mbrojtur nga mungesa e evidentimit të shkeljeve, mos kontrolli i referencave personale dhe mos dënimi i shkeljeve.

Shkeljet dhe thyerjet e sigurisë në sistemet kompjuterike nevojitet të evidentohen saktësisht, për të nxjerrë shkaqet e shkeljeve. Një analizë e plotë do të përcaktonte përse ndodhin shkeljet, nga paaftësia profesionale apo motive të tjera, nëse janë të qëllimshme apo jo. Si rrjedhim mund të dalin mjaft probleme si: lakmia, egoja për

t'u dukur, zgjidhja e çështjeve personale ose profesionale, mbrojtja ose përparimi në karrierë, sfida e aftësive, mëritë ndaj të tjerëve, frika ndaj ndëshkimit, konsideratat e të tjerëve, etj.

Kufiri i autorëve të shkeljeve të rrezikshme dhe i motivimit të tyre është i gjerë. Në shumë raste veprimet e keqpërdorimit të kompjuterit dhe të marrjes së të dhënave kryhen nga personeli i pakënaqur, të cilët janë të mërzitur, pezullohen, transferohen etj. Raste të tjera përfshijnë personelin, i cili për shkak të pozicionit të tij përfshihet në zbulimin dhe hyrjen e paautorizuar në pjesë të ndryshme të një sistemi të caktuar, duke u shfaqur si shumë të motivuar dhe pretenduar se po bëjnë më të mirën për mbrojtjen e sistemit. Për më tepër, mundet që shkelës të tjerë, të përfshijnë individë që futen në punë në një strukturë me qëllimin e caktuar për të kryer spiunazh, mashtrime ose përvetësime.

Një fenomen që vihet në sigurinë e sistemeve është fakti se, pavarësisht përhapjes së problemit të të brendshmëve dhe të dobësive të veçanta të infrastrukturës publike dhe private, më shumë trajtohen dhe marren masa për investime dhe kontrolle të ndërhyrjeve të jashtme se sa ato të brendshme. Mbrojtja teknologjike nga kërcënimet e jashtme është vërtet e rëndësishme, por problemet njerëzore nuk mund të zgjidhen me masa teknike. Pa një vëzhgim të detajuar të problemit të brendshëm dhe të zhvillimin e metodave të reja të menaxhimit të rrezikut të brendshëm, sistemet e informacionit do të jenë të dobëta ndaj personave të brendshëm që i njohin dhe administrojnë këto sisteme.

Përfundim

Drejtuesit e strukturave duhet të vlerësojnë kulturën e sigurisë si një element të rëndësishëm në rritjen e sigurisë. Në këtë kuadër, është e nevojshme që të planëzohen dhe zbatohen të gjitha masat e duhura për krijimin e një kulture sigurie të përshtatshme dhe të qëndrueshme. Këto masa duhet të përfshijnë politikat dhe procedurat e konkrete, arsimimin dhe trajnimin e vijueshëm të personelit, motivimin dhe njohjen e psikologjisë së personelit, mbështetjen me burimet e nevojshme materiale dhe financiare të sigurisë etj.

Bibliografia:

- Ligji Nr.8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror"", i ndryshuar.
- VKM Nr.122, datë 15.03.2001 "Për shqyrtimin e pastërtisë dhe për dhënien e "certifikatës së sigurisë" personave që do të njihen me informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror"", i ndryshuar.
- VKM Nr.922, datë 19.12.2007 "Për sigurimin e informacionit të klasifikuar "Sekret Shtetëror", që prodhohet, ruhet, përpunohet apo transmetohet në sistemet e komunikimit (INFOSEC)", indryshuar.
- Adams, A. & Sasse, M.A. (1999). Users are not the enemy. Communications of the ACM, 42(12), 41-46.
- Aiello, M. (2008). Social engineering. In L.J. Janczewski & A.M. Colarik (Eds.), Cyber Warfare and Cyber Terrorism (pp. 191-198). Hersey, PA: IGI Global.
- Knapp KJ, Marshall TE, Rainer RK, Ford FN. Information security: management's effect on culture and policy. Information Management & Computer Security 2006; 14(1):24–36.

Diplomacia Publike dhe Komunikimi

Rast studimor: "Instituti i Kulturës Italiane"

Bonin Toptani,
Student në Programin MSc. "Siguria Kombëtare",
Akademia e Forcave të Armatosura

Trajtesë e shkurtuar. *Në kohën e sotme komunikimi me hapësirën publike ka shumë rëndësi. Shtetet ose aktorët ndërkombëtarë po tentojnë t'i drejtohen sa më tepër masës së gjerë të publikut, jo vetëm për të siguruar mbështetjen e opinionit publik, por edhe për të sqaruar në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha problematikat e nevojshme që duhen kuptuar saktë nga njerëzit por edhe nga bashkësitë e tjera politike, shtetet, organizatat etj.*

Në komunikimin publik, me të tjerët, veçanërisht me opinionin publik ndërkombëtar, kanë rëndësi edhe format e organizuara me të cilat një shtet i drejtohet një tjetri. Kur një diplomaci zyrtare i drejtohet një populli tjetër tregon mbi të gjitha vlerat e veta më të larta e të mirënjohura. Në këtë kuadër është shumë interesante të vërehet se si vende të mëdha e të mesme, të afta të organizojnë e drejtojnë politika të fuqishme drejt të tjerëve, paraqiten në publik.

Hyrje

Diplomacia publike[1] (DP) si terminologji është relativisht e re. Ajo ka hyrë në përdorimin zyrtar e publik vetëm në gjysmën e dytë të shekullit të shekullit të 20, e pikërisht në vitet 60, kur u përdor nga diplomati amerikan Edmund Gullion në SHBA, i cili e përcaktonte si "ndikim mbi qëndrimin e publikut mbi formimin dhe zbatimin e politikave të jashtme...". DP parimisht zhvillohet midis organizmave zyrtarë të një shteti drejt një a më shumë organizmash zyrtare dhe një publiku të jashtëm, pra të një vendi tjetër.

Diplomacia publike ka filluar të marrë rëndësi gjithnjë në rritja veçanërisht pas sulmeve terroriste të vitit 2011 mbi Kullat Binjake në Nju Jork, ku u vërtetua se edhe

[1] Edmund Gullion, 1965, në "Edward Murrow" Center.

fuqia me madhe e botës, fuqia fituese Luftës së Ftohtë, mund të jetë e cenueshme. Madje ajo u demonstrua e cenueshme nga aktorë të papërfillshëm në krahasim me të, siç mund të jenë organizatat terroriste apo shtete si Afganistani e Iraku, apo edhe të tjerë të përkufizuar në kohën vet nga Presidenti i SHBA G. Bush si "boshti i së keqes".

Politologu amerikan *Nye*[2] e quajti se në Luftën e Ftohtë "fuqia e butë ishte në fund arma fituese". Në këtë kuadër, pjesë e fuqisë së butë që një shtet përdor në marrëdhëniet e tij më të tjerët është edhe "arma" e diplomacisë, ku pjesë e posaçme e saj është edhe ajo publike.

Në thelb të diplomacisë publike është fuqia e komunikimit, përdorimi i komunikimit në të gjithë hapësirën e tij si mjet për të demonstruar argumentet e një shteti, mundësitë e tij, format e tij të bashkëpunimit, vlerat e tij të vetvetes e ato që një popull e shtet transmetojnë tek të tjerët. Në këtë kuptim, në diplomaci e, sigurisht në atë publike, komunikimi ndërkombëtar ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe, sepse kjo është mënyra e sotme, por që gjithsesi që ka qenë gjithnjë çelësi për çdo lloj realizimi të suksesshëm për aktorët ndërkombëtarë.

Në kohën e sotme ka shumë rëndësi edhe komunikimi me hapësirën publike. Pra në këtë kuptim, shtetet ose aktorët ndërkombëtarë tentojnë t'i drejtohen sa më tepër drejtpërdrejtë masës së gjerë të publikut, jo vetëm për të siguruar mbështetjen e opinionit publik, por edhe për të sqaruar sa më qartë të gjitha problematikat e nevojshme që duhen kuptuar drejt e saktë nga njerëzit, por edhe nga bashkësitë e tjera politike, shtetet, organizatat etj. Kështu, një organizëm ndërkombëtar si BE, mbishtetëror, e ka domosdoshmëri t'u drejtohet të gjithëve sa më drejt e shpejt për të sqaruar problematikat dhe për t'u kuptuar në veprimet e veta, për të mirën e shteteve që përfaqëson por edhe për vetë publikun e saj.

Në komunikimin publik me të tjerët, veçanërisht me opinionin publik ndërkombëtar, kanë rëndësi edhe format e organizuara me të cilat një shtet i drejtohet një tjetri. Kur një diplomaci zyrtare i drejtohet një populli tjetër tregon mbi të gjitha vlerat e veta më të larta e të mirënjohura. Në këtë kuadër është shumë interesant të vërehet si se vende të mëdha e të mesme, të afta të organizojnë e drejtojnë politika e të fuqishme drejt të tjerëve, paraqiten në publik. Një shembull i tillë studimor janë edhe Institutet Italiane të Kulturës (IIK), që Italia i ka prezantuar në një seri të madhe vendesh në botë, në Europë e jashtë saj, si pararendëse të diplomacisë italiane, si përfaqësuese të denjë të politikave paqësore italiane, me në qendër zhvillimet kulturore, kombëtare e ndërkombëtare.

Këto institute të kulturës italiane punojnë për përhapjen ë kulturës italiane në botë, të gjuhës, ofrojnë informacion e dokumentacion mbi jetën e zhvillimet reale e kulturore italiane, mbi institucionet demokratike e shoqërore të Italisë, promovojnë manifestime sociale e kulturore të përbashkëta, shkollimin, raporte kulturore bilaterale ndërshtetërore, gjithnjë të finalizuar drejt një rritje të bashkëpunimit e simpatisë së institucioneve e njerëzve, të besimit reciprok.

[2] Joseph S. Nye, Il paradosso del potere Americano.

Diplomacia Publike

a) Rëndësia e Diplomacisë Publike

Në vija të përgjithshme, të gjitha shtetet, por edhe organizatat e mëdha kombëtare e ndërkombëtare, punojnë shumë në drejtim të diplomacisë së tyre publike, por natyrisht jo të gjithë kanë mjetet, përvojën dhe mundësitë, për të realizuar në të vërtetë këtë diplomaci. Kjo varet nga shumë faktorë, ku ndër më të rëndësishmit mund të përmendim: *fuqinë rrezatuese*, pra të ideve që një entitet transmeton (shembull i mirë është fuqia e ideve dhe përvojës së demokracisë amerikane), *fuqia ekonomiko-financiare*, *kulturore*, *ideologjike*, ajo *ushtarake e teknologjike*, etj. Mbase edhe entitete të tjerë, aktorë të vegjël, do të donin të përpiqeshin të jenë të mirëpranuar e të njohur nga publiku i gjerë, por në të vërtetë, pa i zotëruar të gjithë mjetet e mësipërme, apo një pjesë të tyre, do të ishte tepër e vështirë të arrihej në ndonjë sukses të rëndësishëm në diplomacinë publike.

Në çdo kohë kanë ekzistuar shumë elementë të diplomacisë publike, ndonëse mund të ishin nën terminologji të ndryshme. Tek grekët e lashtë thuhej: "Të ishe njeri politik, pra të jetoje në 'polis', kishte kuptim se çdo gjë vendosej përmes fjalës dhe bindjes e jo me anën e forcës apo dhunës"[3]. Ndërsa në Francën e Rishëljësë, në "regjimin e vjetër, francezët shkuan edhe më larg se vendet e tjera europiane në riformimin e imazhit të tyre jashtë. Ata shpenzuan shumë energji e forca për menaxhimin e reputacionit të vendit, duke e konsideruar atë si një nga burimet kryesore për fuqinë e vendit"[4].

Shtetet e mëdha si SHBA, apo shtetet kryesorë te BE-së, qoftë edhe vetë BE deri diku, kanë mundësi reale të ushtrojnë këtë lloj diplomacie, pasi ato kanë se çfarë të demonstrojnë si tek publiku i tyre, ashtu edhe tek ai i jashtëm. Ato duhet të tregojnë shumë e hapur mbi aktivitetet e tyre, për të qenë sa më transparentë ndaj vetes e të tjerëve, për të ngjallur e forcuar besimin e të tjerëve ndaj tyre dhe ndaj rolit të tyre si lider në botën e sotme.

Në kohën e sotme, pra në kohën e teknologjive "*high-tech*", komunikimi me publikun e gjerë, kombëtar e ndërkombëtar, është i një rëndësie vendimtare për të "mëdhenjtë" e botës. Le të marrim për shembull rastin e luftës në Irak apo Afganistan: sa e sa përpjekje iu deshën SHBA-ve dhe miqve e aleatëve të vet, të demonstronin përpara të gjithë njerëzve arsyet e këtyre fushatave ushtarake, pse duheshin organizuar, si dhe rreziqet e mundshme. Mbase jo gjithnjë këto përpjekje patën suksesin e pritur, por gjithsesi, nuk u kursyen asnjëherë përpjekjet maksimale në këtë drejtim.

Në kohën tonë, kur ne flasim për fenomene botërore si globalizmi, kur vlerat dhe idetë mbajnë peshën kryesore në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe kur njerëzit kanë mundësi informimi të gjithanshëm, diplomacia publike ka qenë e detyruar të përshtatet me nevojat e kohës, duke shtuar cilësinë e sasinë e komunikimit të saj me publikun e gjerë, vendas e ndërkombëtar. Shpesh, roli i mediave, sot më vendimtar se kurrë më parë, u ka dhënë mundësi të gjithëve që me shpejtësi marramendëse të mësojnë ngjarjet në kohë reale, madje ende pa u dhënë mundësinë aktorëve kryesore zyrtarë për

[3] Jaup Zenuni, Komunikimi Ndërkombëtar, f. 230.
[4] Po aty.

ndërhyrje sqaruese e prezantuese për fenomenet e ndodhura. Kështu, për qeveritë e entitetet e tjera, për ruajtjen dhe fuqizimin e imazhit të tyre kombëtar e ndërkombëtar, kjo lloj diplomacie, ajo publike, po merr gjithnjë e më tepër rol të rëndësishëm.

b) Zhvillimi i Diplomacisë Publike

Diplomacia publike, degë e veçantë e diplomacisë tradicionale, përfshin dimensionet e marrëdhënieve ndërkombëtare përtej diplomacisë tradicionale; kultivimin e opinionit publik në vende të tjera nga ana e qeverive; ndërveprimin midis grupeve dhe interesave private në një shtet të caktuar me ato të një shteti tjetër; me raportimin për çështjet e huaja dhe impaktin e tij mbi politikën; komunikimin midis atyre që merren me komunikimin, si ai midis diplomatëve dhe korrespondentëve të huaj; proceset e komunikimit ndërkulturor.

Nëse do të duam të përcaktojmë disa drejtime kryesore të interesave të një diplomacie publike, do të përfshinim këto boshte, ndër më themeloret:

- Qeveri-publik i huaj (elitë kundër masë).
- Ekspertë të medias profesioniste.
- Publicitet, sepse flitet për përgjegjësi demokratike;
- Qeveri të hapur: e hapur ndaj filtrit të publikut, prandaj e detyruar të thotë të vërtetën.
- DP shpie në paqe dhe mirëkuptim më të madh.

Ndërsa diplomacia tradicionale ndiqet ne kanale zyrtare, pak a shume të hapura, e shpesh të fshehta, ajo publike bëhet gjithnjë e hapur, na favor të publikut. "Ata që merren me DP përdorin mjete në përpjekjet e tyre për qëllim qartësimin e politikave të qeverisë e për të shmangur keqkuptimet e bazuara tek propaganda apo mungesa e informacionit, me shpresën se në fund do të fitojnë zemrat dhe mendjet e publikut të huaj"[5].

DP mbështetet në një seri me parime, të qarta, për të si disiplinë e po ashtu edhe për të tjerët[6]:

- Dialogu merr fuqi të plotë, duke shmangur monologun, që sjell mirëkuptim e dëshirë për bashkëpunim,
- Bashkëpunim me partnerë jo zyrtarë,
- Zhvillim i punës në rrjete, reduktim i punës hierarkike,
- Zgjidhje të përshtatura me detyrat,
- Informacion i ndershëm e i besueshëm,
- Integrim me diplomacinë tjetër, në të mirë të publikut.

Ndër objektivat më kryesore të DP mund të përmenden:

- Afrimi i njerëzve me shtetin, që i shtyn ata të mendojnë për të, duke e përmirësuar imazhin e tyre për shtetin e duke lënë mënjanë opinione negative,
- Shtim i vlerësimit të njerëzve për shtetin,
- Angazhim të njerëzve në shtet e me shtetin, nga reformat e deri në bashkëpunimet shkencore,

[5] Public diplomacy comes of age, C. Ross, f. 75.
[6] Komunikimi Ndërkombëtar, Jaup Zenuni, f. 238

- Ndikim pozitiv mbi njerëzit, që shton investimet private, që shtyn publikun të mbështesë qëndrimet e politikës, etj.

Në këtë të kuptim, objektivat e DP prekin një fushë punë shumë të gjerë. Qëllimet e saj janë zakonisht të qarta e të hapura për të gjithë, në mënyrë që të arrihet edhe konsensusi maksimal.

DP përdoret si mjet efektiv për të fituar 'mendjet dhe zemrat'.

Komunikimi

Komunikimi publik është një formë komunikimi që niset nga administrata publike/ private duke iu drejtuar sektorëve të gjerë të publikut të jashtëm, ku është çështje më vete përcaktimi i saktë i 'kufijve' të sektorit publik, pra të kujt e merr më pas komunikimin. Por në fushën tonë, interes ka tema mbi komunikim ndërkombëtar.

Në lidhje me përkufizimin e komunikimit ndërkombëtar vërehen qasje të ndryshme, që lidhen edhe me etapat historike dhe fushat e veprimtarisë njerëzore.

Komunikimi ndërkombëtar, është komunikimi shumëplanësh midis dy apo më shumë vendesh, që realizohet me anën e mjeteve të masmedias[7], pra ai lloj komunikimi që realizohet me aktorë jashtë kufijve gjeografik të një shteti. Ai kryhet në nivel shoqërie dhe ndryshon nga komunikimi ndërpersonal. Por ka edhe studiues që venë shenjën e barazimit midis 'komunikimit ndërkombëtar' dhe 'komunikimit global'.

Komunikimit është proces në hapësirë dhe kohë i aktorëve globalë dhe rajonalë, nëpërmjet kanaleve, strategjive, taktikave dhe mjeteve të ndryshme, për t'u përballur me rreziqe e sfida të përbashkëta në një shoqëri e rend botëror ku globalizmi është prirje e pashmangshme kohës së sotme dhe mjet i domosdoshëm i suksesit për institucionin që pretendon sukses.

Në një sistem të artikuluar mirë, komunikimi publik është edhe një shënjestër që u drejtohet disa kategorive si:

- Qytetarëve (*punëtorë, konsumatorë, zgjedhës, nëpunës e sipërmarrës*),
- Opinionit publik e qytetar civil;
- Shoqatave (*shoqata të ndryshme të të gjitha kategorive, shoqërizimeve sektoriale).*

Në bazë të kësaj shumice kategorish publike, komunikimi publik vepron në disa sfera influence kryesore, si:

- Sociale, që përfshin të gjithë ato subjekte në gjendje të përfaqësojnë vlera e të drejta;
- Politike, që përfshin të gjithë ato subjekte të përcaktuar në kushtetutë;
- Institucionale, që tregon përgjegjësinë e për garantimin e marrëdhënies së rregullt qytetar-klient[8].

Sistemi i komunikimit publik, kohët e fundit ka pësuar edhe transformime lidhur me metodologjitë e aplikimit, të ardhura si nevojë për karakteristikat e sotme të 'publikut

[7] William B. Gudykunst & Bella Mody, internet

[8] Manuale di Comunicazione pubblica, strategie e Cfr. Istituto Nazionale per la Comunicazione.

qytetar', që vërehen në shoqëritë tona në transformim. Shoqëria ka hyrë në një fazë të re: dallga e globalizmit ka krijuar brenda saj mungesa ekuilibrash që kanë goditur e ateruar vlerat etike, sociale, kulturore e politike të saj, duke provuar edhe humbje e shumë pikave të referimit, të domosdoshme për ekuilibrat e kohës. Shoqëritë e mijëvjeçarit të ri, gjithnjë e më komplekse, bëhen më të specializuara e kompetitive. Në këtë kohë të re, shteti duhet të jetë koordinatori dhe pika e referimit kryesore për publikun, për sa është pikërisht ky të cilit i drejtohen për përmirësimin e sigurisë sociale e të cilësisë së jetës.

Në këtë kontekst, komunikimi publik është mjeti më efikas në duart e shtetit/institucionit, që të mirëmbahen e respektohen marrëdhëniet e mira drejt 'publikut qytetar'. Me transformimet shoqërore dhe sipas pozicioneve të reja që po mbajnë tashmë shtetet, edhe komunikimi pëson transformimin e vet të finalizuar për arritjen e rezultateve efikase përballë publikut, drejt të cilit i duhet të veprojë. Komunikimi po bëhet kështu instrumenti themelor e strategjik në raportet shoqërore ndërmjet personave, së pari, por edhe ndërmjet shtetit e qytetarit pastaj, me instrumentet e tyre më kryesore janë mjetet e informimit masiv publik.

Rast Studimor - Instituti Italian i Kulturës

a) Vlera e Institutit Italian të Kulturës

Institutet Italiane të Kulturës (IIK) janë organizma zyrtarë që veprojnë jashtë Italisë e për llogari të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Objektivi kryesor i tyre i punës është përhapja e zhvillimi i kulturës italiane në të gjitha format e saj të mundshme, duke u shndërruar në pikë referimi për kryerjen e politikave të jashtme të shtetit, jashtë tij. Ato janë një vend takimi e dialogu intelektualësh e artistësh, por edhe për të gjithë operatorët e tjerë kulturorë, qytetarët italianë e të huaj, që duan të mbajnë e shtrëngojnë raporte profesionale e intelektuale më Italinë.

Në mbështetje të ambasadave e konsullatave italiane, IIC është edhe instrument i përhapjes së imazhit të Italisë si qendër prodhimi, konservimi e zhvillimi kulturor, të cilat funksionojnë mbi bazën e një ligji të parlamentit italian (Nr. 401, 22 dhjetor 1990).

IIC është një instrument mbështetës në marrëdhëniet publike të qeverisë, me funksione në sferën publike. Me kalimin e viteve, përgjegjësitë e qeverive kundrejt qytetarëve kanë pësuar një rritje të madhe. Tashmë raporti i institucioneve me njerëzit nuk mund të bëjë pa aspektin themelor të komunikimit publik, që është kthyer në instrument kryesor për përhapjen e informacionit e në mirëkuptimin e nevojave të qytetarit. Shoqëritë moderne nuk arsyetojnë më vetëm brenda kufijve të tyre territoriale, por mbajnë parasysh edhe aspektet e globalizmit e te zhvillimeve botërore.

Politika kulturore, ose edhe siç mund të quhet ndryshe edhe "diplomacia kulturore", konsiderohet si një nga instrumentet më efikase për zhvillimin e implementimin e planeve politike në vende të ndryshme. Promovimi kulturor luan një rol efektiv në brendësi të raporteve bilaterale të Italisë me vendet e tjera, duke qenë edhe koherente me politikën zyrtare të shtetit, pra në një farë mënyre një diplomaci kulturore e mirëfilltë. E përcaktuar si ndër instrumentet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, ajo funksionon për përhapjen sa më të gjerë të gjuhës italiane.

Zhan Monet, njëri nga "baballarët themelues" të bashkimit të ardhshëm të Europës dhe mbështetës i "Planit Shuman", në vitet 60 tha që nëse do të ishte e mundur të rifillohej procesi i integrimit evropian, do të kish preferuar të fillohej nga kultura, më tepër se sa nga çeliku e qymyri. Monet e kuptoi se kultura mund të ishte elementi "ngjitës" i parë e më i rëndësishëm për të favorizuar integrimet kontinentale të popujve. Dhe në Itali, dimensioni kulturor është njëri nga elementët thelbësor të politikës së jashtme shtetërore, por edhe e vetë qytetarëve italianë.

Përdorimi i saj është një investim i vërtetë e madhor i shtetit, që mund të japë rezultate edhe më të rëndësishme se sa investimet e format të tjera, jo vetëm në terma të imazhit, por edhe interesave më konkretë. Promovimi kulturor luan një rol të përcaktues në kontekstin e gjerë të marrëdhënieve dypalëshe të Italisë me të tjerët, duke u kthyer diplomacinë kulturore në pjesë të pandashme të politikës së jashtme. Deputeti italian Salvatore Cilento është shprehur: "...Duke i mëshuar pasurisë së pakrahasueshme të vendit tonë, ajo, diplomacia kulturore, kontribuon në forcimin e imazhit të Italisë në botë, duke, duke shoqëruar kështu edhe projektimin e saj politik në skenarët ndërkombëtarë..."[9].

b) Organizimi dhe detyrat e Institutit Italian të Kulturës

Sociologu italian Francesco Alberoni, në një takim të korrikut 1999 në Ministrinë e Punëve të Jashtme u shpreh: "IIK janë një përvojë që duhet të rritet: ato duhet të jenë pika e rakordimit midis politikës italiane dhe vendeve të huaja, në të cilat kërkohet që ajo të shkojë. Nga IIK duhet të rrezatohet i gjithë aktiviteti ynë promocional me jashtë, aty duhet të jetë pika jonë e referimit, "shtëpia" e gjithkujt kërkon të eksportojë kulturën italiane"[10].

IIK janë organizma që veprojnë pranë e, bashkëpunojnë, me ambasadat italiane jashtë shtetit, rreth bursave të studimit që miratohen e ofrohen nga Qeveria italiane për studentët e huaj. Ato ofrojnë një seri më madhe shërbimesh e informacionesh, organizojnë kurse gjuhe, manifestime të ndryshme kulturore e shkencore. Ato janë edhe një pikë referimi e politikës së jashtme italiane në botë, një vend ideal takimi për intelektualë, artistë, madje edhe për qytetarë të thjeshtë, italianë e jo, që duan raporte me Italinë.

Institutet italiane të kulturës datojnë që nga 1926, kohë e Mbretërisë së Italisë, periudhë e karakterizuar nga ndryshime të vrullshme të kulturës e politikës vendore, ndonëse edhe e si nevojë për përhapjen e italianizmit, ato janë edhe më të hershme, pra që nga koha e shtetit liberal. Në thelb, ato nuk u krijuar për përhapjen e gjuhës italiane, por edhe me qëllime më të thella kulturore, politike, institucionale, ekonomike e sociale. Rëndësi jo të vogël pati periudha e fashizmit, kur edhe përhapja e kulturës dhe ndikimi i saj publik, u pa si mjet i rëndësishëm në politikën e brendshme e të jashtme të shtetit, pra nga koha e ideologut të madh *Giovani Gentile*[11] e duke vijuar me të gjithë të tjerët, pas tij.

[9] Gli Istituti italiani di cultura all'estero, Micaela Martina, f. 48

[10] Gli Istituti italiani di cultura all'estero, Micaela Martina, f. 72

[11] Giovanni gentile, 1875 – 1944, filozof, ndër ideologhët kryesore të lëvizjes fashiste në itali.

Pas Luftës II Botërore, rëndësia e IIK erdhi duke u rritur, pasi Italia e re e demokratike i drejtoi politikat e saja të reja në drejtim të bashkëpunimit ndërkombëtar e lidhjes së urave të mirëkuptimit me gjithë shtete e tjera. Në këtë kuadër, IIK kanë luajtur gjithnjë një rol të dorës së parë në forcimin e mirëkuptimit reciprok më shtetet e popujt e tjerë.

Shpërndarja e IIK[12]

Përgjithësisht IIK gjenden në të gjitha shtetet më të cilat Italia ka raporte normale diplomatike. Ato janë pjesë e buxhetit të MPJ e zakonisht vendosen në kryeqytete, veç Polonisë që ka edhe në Krakov. Nëse duam të shohim një ndarje sipas shteteve, vërehet se: 55 Institute Italiane të Kulturës, ndahen në 35 në Europën perëndimore, 10 në atë lindore, 12 në Afrikën e Veriut, 4 në Afrikën nën Sahariane, 8 në Amerikën e Veriut dhe 8 në Oqeani. Vendi ku ka më tepër IIK është Gjermania, me 8, e ndjekur nga Franca me 6, SHBA me 5, Spanja e Kanadaja me 3, Mbretëria e Bashkuar, Austria, Zvicra, Polonia e Greqia, me 2. Në vendet e tjera ka vetëm 1 IIK.

Ndërsa jashtë Europës ka nga 2 IIK në Argjentinë, Brazil, Australi e Japoni. Ndërsa në disa shtetet ka mbi 1 IIK, në rreth 140 shtetet të tjera mungon fare, vende në të cilat kultura italiane përfaqësohet edhe nga Atashetë apo struktura të tjera.

MPJ përgjithësisht drejton aktivitetin e IIK dhe jep drejtimet kryesore të punës së tyre dhe të personelit të tyre. Ajo koordinon pjesëmarrjen në konferenca e aktivitete. Rol të rëndësishëm luan edhe Komisioni Kombëtar për promovimin e kulturës italiane jashtë vendit, pranë MPJ-së. Ai formulon iniciativat e sektorëve specifikë, duke iu referuar zonave gjeografike të interesit dhe prezencës së vetë qytetarëve italianë në botë. Por gjithsesi, IIK kanë edhe një autonomi operative e financiare, por gjithnjë në kuadrin e drejtimeve kryesore të miratuara.

Rol të rëndësishëm kanë drejtorët e IIK, që emërohen nga Ministri i Punëve të Jashtme, të cilët kryejnë disa nga funksionet më delikate të këtij sektori publik. Ato merrem me koordinimin e gjithë aktivitetit të IIK, çështjet financiare, burokratike, përgjegjësitë.

Funksionet kryesore të IIK rrjedhin në mbështetje të ligjit italian nr. 401, 22.12.1990 dhe klasifikojnë këto detyra themelore:

- ofrojnë mundësi për mësim e zhvillim të gjuhë, me materiale didaktike, biblioteka, kurse, etj., në bashkëpunim edhe me universitetet italiane kombëtare;
- u hapin rrugë operatorëve italianë të kulturës në proceset e shkëmbimeve e takimeve intelektuale, shkrimtarëve e prodhimeve kulturore ndërkombëtare;
- japin mbështetje logjistike operatorëve kulturorë italiane e jo;
- mbështesin iniciativat në drejtim të dialogut ndërkulturor, mbështetur gjithnjë në parimet e demokracisë e solidaritetit ndërkombëtar.

IIK, në sintoni me rekomandimet e Komisionit Kombëtar për promovimin e kulturës italiane jashtë, punojnë për:

[12] Ministero Affari Esteri Italiano

- Integrimet e aktiviteteve kulturore në dialogët politike, në ato zona ku këto favorizojnë bashkëpunimet ndërkulturore, proceset politike të shtensionimit e paqësimit;
- Promovim të kulturës, lidhur me promovimet bashkëkohore në Itali në sektorë si teatrot, artet vizive, kërcimet, letërsia, kinematë, artizanatet, etj.;
- Mbështetje në zona ku ka prezencë të fortë numerike komunitetesh italiane;
- Zhvillime të kulturës teknologjike e shkencore, të shkencave shoqërore e juridike, përmes mbështetjeve sipas marrëveshjeve me projekte me institucione të tjera italiane, kërkues, konferenca, etj.;
- Shkëmbime materialesh e përvojash në sektorë të pasurisë kulturore kombëtare, bibliotekave, muzeve, restaurimeve, bashkëpunime televizive, sportive e shumë forma të tjera.

Një formë tjetër e re dhe interesante e bashkëpunimeve të IIK është ai ekonomik. Kjo lidhet më njohjen e të tjerëve me përvojën italiane, *Italian Syle* dhe metodat e tyre në realizimin e biznesit, apo drejtimin e ndërmarrjeve, kryesisht të atyre ndërmarrjeve të mirënjohura e të suksesshme në tregun e sotëm global, në lidhje me proceset e tyre të inovacionit të pandërprerë.

Fundi shekullit XX e gjeti botën pjesë të një zhvillimi të ri, nën shenjën e fragmentarizmit dhe të bindjes në detyrimin për ruajtjen dhe fuqizimin e të drejtave të njeriut, në krahasim me ato të përkatësisë së grupit/shoqërisë. Prandaj bota e sotme është gjithnjë e më tepër komplekse, duke u dhënë mundësi edhe "grupeve" të vogla edhe numerikisht të mund të thonë fjalën e tyre publike. Sot, po dominon kudo termi i ri i globalizimit, ose siç mund edhe të thuhet "botërizimi", apo edhe "fshati global", pra integrimi ekonomiko-shoqëror i gjithanshëm i njerëzve. Pra në këtë kuadër, po përparon pa u ndalur edhe një lloj globalizimi kulturor.

Këtij termi mund t'i japësh edhe një vlerësim si humbje e rëndësisë së shtetit-komb, të mekanizmave të integrimeve shoqërore e shtetërore; në fakt shumë individë, pavarësisht nga kombësia e tyre, gjithnjë e më tepër i referohen disa modeleve kulturore homogjene, të njëjtë, duke çuar në humbje të elementëve të origjinës dhe duke sjellë një uniformitet të pamohueshëm. Po çfarë roli luajnë në këto zhvillime Institutet e Kulturës?

IIK ka një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e zhvillimin e kulturës e të gjuhës italiane, jashtë Italisë dhe në promovimin e tyre. Në të vërtetë, nisur edhe nga filozofia e tyre, IIK janë në gjendje të zhvillojnë strategji e trajektore të punës e kulturës të afta të ndërtojnë një imazh të ri konvergjues kolektiv, por që edhe të garantojnë në realizimet e veta, diferencat, të ndërtojnë një imazh të ri konvergjues kolektiv. Ato përforcojnë instrumentet në dispozicion të qeverisë duke përballuar me sukses edhe konkurrencën e fortë "kundërshtare" të organizatave të tjera. IIK duke krijuar rrënjë të forta e të thella në realitetet ku punojnë, bëhen gjithnjë e më tepër armë të rëndësishme të politikës së jashtme italiane.

Përfundime

Në shtetet e së kaluarës, në kuptimin e atyre shteteve e shoqërive të kohëve më të

vjetra, grupet drejtuese të shtetit që bënin dhe drejtonin diplomacinë e vendit të tyre, nuk ndjenin asnjë nevojë a detyrim të sqaronin popujt e tyre, të cilët gjithashtu nuk kishin lidhje me konceptet e kombit e shtetit, se sa me vetë monarkun. Mbretërit e shtetarët e tjerë të lartë, përgjithësisht nuk kishin domosdoshmëri të sqaronin opinionin e tyre publik mbi veprimet e rëndësishme të politikës së tyre të jashtme, pasi veprimet kryheshin në emër të "njëshit", perëndisë apo të interesave të një grupi të vogël njerëzit, aristokracisë vendase.

Pas zhvillimeve të vrullshme të shekullit XX, luftërave të mëdha, që përfundimisht u fituan nga ato vende që vepruan e u zhvilluan nën konceptet e demokracisë së tipit perëndimor, të ekonomisë së tregut, ku pesha e opinionit publik ka peshë specifike të madhe në vendimmarrjet e rëndësishme, ndodhën edhe ndryshimet e mëdha, pra zhvillimi i diplomacisë publike, në kuptimin tonë të sotëm, kur gjerat i shpjegohen popullit, njerëzve, brenda e jashtë shteteve. Pa një mbështetje të vërtetë të tyre, asnjë qeveri e kohëve moderne nuk do të mund të qëndronte në pushtet, pa u kuptuar e miratuar publikisht, shtetarët nuk do të kishin asnjë konsensus e mbështetje reale. Asnjë organizatë private a publike, që kërkon mirëpranimin e opinionit, nuk do të mund të prosperonte pa një komunikim të drejtpërdrejtë me njerëzit.

Në këtë mënyrë, organizma si Instituti Italian i Kulturës janë shprehjet të zhvillimeve të botës së sotme, sepse ato bëjnë lidhjen më të mirë e të shpejtë ndërmjet politikës së një shteti, e në rastin tonë të Italisë, me gjithë të tjerët, drejt të cilëve Italia ka nevojë të drejtohet, të kuptohet e aprovohet në veprimet e veta afatgjata. Zhvillimi i gjuhës italiane jashtë Italisë, i kulturës së saj, përhapja e nocioneve të jetës e përvojës italiane, shihet gjithnjë si hap i parë drejt kuptimit e mirëkuptimit të gjithçkaje italiane në botë, në thelb e përhapjes së influencës së Italisë si shoqëri e model ndjekjeje. Roli shoqëror i IIK në procesin e botës globale, ka kuptim e efikasitet, nëse gjen protagonistë e bashkëbisedues që të diskutojë, nëse ka qartësi e forcë në njohjen e dhënien e njohurive.

IIK mund të shihet edhe si një shembull i mirë e i nevojshëm edhe për Shqipërinë, prej së cilës së paku mbi 1 milion njerëz kanë emigruar jashtë vendit. Do të ishte e domosdoshme për vendin tonë që të bëhej, e mundura dhe e pamundura, që jo vetëm të mbështeteshin këta njerëz jashtë Shqipërisë, të cilët kanë lënë familjet e tyre pas shpatullave për të kërkuar diçka më të mirë, por edhe që popullsitë e vendeve ku ata kanë shkuar të jetojnë e punojnë, të mund të njohin më tepër gjithçka është shqiptare, të dinë e munden të kuptojnë vlerat e vërteta e të moçme të popullit tonë.

Biobliografia:

- Edmund Gullion, 1965, në "Edward Murrow" Center .
- Joseph S. Nye, Il paradosso del potere Americano.
- C. Ross, Public diplomacy comes of age
- Micaela Martina, Gli Istituti italiani di cultura all'estero.
- Jaup Zenuni, Komunikimi ndërkombëtar.
- Manuale di comunicazione pubblica, strategie e Cfr. - Istituto nazionale per la comunicazione
- Ministero Affari Esteri Italiano - *Site zyrtar.*
- William B. Gudykunst & Bella Mody, *internet.*

Inteligjenca-element i rëndësishëm i vendimmarrjes politike

Ismail Skënderaj,
Student në Programin MSc. "Siguria Kombëtare",
Akademia e Forcave të Armatosura

Trajtesë e shkurtuar. *Kërcënimet e sotme, pavarësisht se ku shfaqen, kanë impakt të drejtpërdrejtë në sigurinë kombëtare, gjë që ka çuar në një rikonceptim të shërbimeve sekrete, rolit, misionit dhe kompetencave të tyre si dhe të nevojës për një reagim mjaft më të shpejtë ndaj shfaqjes së këtyre kërcënimeve. Intensiteti, shumëllojshmëria, befasia e kërcënimeve aktuale të sigurisë dhe përmasat e dëmeve prej tyre janë shtuar dhe, për rrjedhojë, etapat kohore të procesit të vendimbërjes politike janë zvogëluar mjaft.*

Në këtë realitet, tipari themelor i rëndësisë së shërbimeve inteligjente është ndihma e tyre e drejtpërdrejtë në vendimmarrjen politike, nëpërmjet vlerësimeve, rekomandimeve, këshillimeve dhe dhënies së opsioneve më të mira për vendimmarrjen politike në adresimin e suksesshëm të kërcënimeve të sotme.

Sfidat e shërbimeve inteligjente në shërbim të vendimmarrësve politikë lidhen me një pozicionim të ri të këtyre marrëdhënieve, nga statike në dinamike. Rëndësia e tyre nuk varet më thjesht nga statusi ligjor si institucione shtetërore inteligjence, por nga aftësia e tyre për të përmbushur me sukses misionin në përballjen informative të kërcënimeve të sigurisë dhe për të ndihmuar vendimmarrjen politike të ketë gjithë informacionin e nevojshëm për një vendimmarrje të suksesshme në adresimin e çështjeve të sigurisë kombëtare dhe interesave të vendit.

Hyrje

Misioni dhe detyrat e shërbimeve sekrete në funksion të vendimmarrjes

Misioni i shërbimeve inteligjente është të informojnë vendimmarrjen politike dhe shtetërore mbi kërcënimet e brendshme dhe të jashtme që i kanosen sigurisë kombëtare dhe interesave të vendit.

"Ne punojmë prapa skene për të informuar dhe lehtësuar veprimet e diplomacisë, mbrojtjes, institucioneve të zbatimit të ligjit dhe "klientëve të tjerë"… Në të njëjtën

kohë, inteligjenca ndihmon për të dobësuar besueshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin e vendimbërjes së kundërshtarit."[1]

Në varësi të legjislacionit që kanë ndërtuar vende të ndryshme, ky informim bëhet i centralizuar përmes një strukture që koordinon gjithë veprimtarinë e shërbimeve inteligjente e të sigurisë së vendit, si në SHBA dhe i decentralizuar nga çdo shërbim inteligjent në nivel kombëtar, rasti i vendit tonë.

Produkti inteligjent duhet të përmbajë informacion objektiv, të kuptueshëm qartë, paraprijës, gjithëpërfshirës, konciz dhe të japë rekomandime për vendimmarrësit me vlerësimin e opsioneve më të mira të marrjes së vendimeve për shmangien/bërjen të paefektshme të rreziqeve konkrete që kanosin sigurinë kombëtare dhe interesat e vendit.

Reduktimi i kohës së procesit për vendimbërjen politike

Implikimet globale të sigurisë, natyra asimetrike e kërcënimeve të sotme, impakti mjaft i madh i efekteve të globalizmit, lëvizja e lirë e njerëzve dhe tregu global ekonomik, zhvillimi galopant i teknologjisë së komunikimit dhe i mjeteve të transportit kanë rritur pasigurinë, kanë krijuar gjendje kërcënimi të vazhdueshëm me një mundësi gjithnjë e më të vogël të parashikimit të shfaqjes së tyre. Këto ndryshime kanë çuar në reduktim të kohës së paralajmërimit dhe, rrjedhimisht, në një ngjeshje të etapave kohore të procesit të vendimmarrjes. Në këto rrethana, shërbimet inteligjente duhet të sigurojnë që vendimmarrësit të jenë sa më shumë të informuar për këto lloj situatash, në mënyrë që vendimet dhe nismat e tyre të kenë shansin më të mirë për arritjen e suksesit.

Nevojat e vendimmarrjes për inteligjencë

Vendimmarrja politike, në aktualitetin e sotëm, kërkon informacion më shumë se kurrë ndonjëherë, por komuniteti i inteligjencës jo vetëm që nuk përbën më furnizuesin e vetëm, por nuk është as edhe më i privilegjuari i politikëbërësve për informacion.

Faktorët e dobësimit të rolit të komunitetit të inteligjencës për informimin e vendimmarrësve

Shtimi me ritme galopante i burimeve të informacionit ka krijuar një "bollëk" të pamatë në tryezën e punës së çdo individi në përgjithësi. Ky fenomen ka ndryshuar perceptimin për rolin e misionin e shërbimeve sekrete si furnizuesit kryesorë të politikëbërjes me informacion. Mjaft prej politikanëve e marrin informacionin së pari nga televizioni e më tej me rradhë nga gazetat, nga miq dhe lidhje të tyre të besuara, nga interneti, si përmes kërkimit personal ashtu edhe nga ana e stafit të tyre dhe së fundi shfrytëzojnë informacionet e ardhura nga shërbimet inteligjente. Sipas vëzhgimeve të ndryshme, rezulton se informacioni që ata shfrytëzojnë në procesin e vendimmarrjes politike, përmban vetëm një të pestën e produkteve të inteligjencës.

Pol Miller i karakterizon mjaft prej produkteve të komunitetit të inteligjencës si " jorelevante dhe të pavlera" sepse megjithëse janë "mjaft të rafinuara" ato shpesh

[1] "A globally networked and integrated intelligence enterprise- Vision 2015" faqe 8. Botim i Zyrës së Drejtorit të Inteligjencës Kombëtare të SHBA.

konkurrojnë dobët me burimet e tjera të informacionit, mbi të cilat vendimmarrësit politikë bazohen, burime tek të cilat përfshihen duke filluar që nga " një profesor i laureuar në shkenca politike, përvojat personale dhe deri tek titujt e "*New York Times*"[2]

Raporti produkt inteligjent-informacion i burimeve të hapura në vendimmarrjen politike

Informacioni që qarkullon rëndom sot ka këto dobësi për t'u përdorur:

Së pari, është i hapur që do të thotë se "kundërshtari" hedh në tregun mediatik informacion sipas interesit të tij. Nëse mediat do të mund të zbulojnë informacione të klasifikuara të "kundërshtarit" sigurisht ndodh që ato t'i publikojnë. Kjo gjë i jep mundësi kundërshtarit të ndryshojë menjëherë taktikë;

Së dyti, nuk sigurohet vijueshmëria e informacionit, ato vijnë sipas rastit dhe jo sipas nevojës për informacion që kanë vendimmarrësit;

Së treti, nuk ka kontroll mbi mediat nga vendimmarrja politike, gjë që nuk jep besueshmëri në vlerën, vërtetësinë dhe përdorimin e tij. Mediat janë të pavarura dhe shpesh në shërbim të pronarëve të tyre.

Së katërti, informacioni që qarkullon nga këto burime është anarkik, i palidhur. Secili e përdor për interesat e veta dhe nuk analizohet në këndvështrimin e pasojave që sjellin ngjarjet që përcjellin, në parashikimin e ecurisë së kërcënimeve të sigurisë kombëtare dhe nuk janë objektivisht rekomanduese.

Vetëm shërbimet inteligjente mund të shmangin këto vulnerabilitete të cilat, për rolin dhe veprimtarinë që kryejnë në funksion të vendimmarrjes, duhet të funksionojnë si institucione të shteteve demokratike, me të gjitha standartet që kërkohen.

Nevojat aktuale të vendimmarrjes për informacion

Nga njëra anë, politikanët e kanë të lehtë marrjen e informacionit që iu intereson, nga ana tjetër, përgjegjësia e vendimmarrjes bazuar tek ky informacion rritet, pasi tek ta lindin natyrshëm disa pikëpyetje dhe hezitime: "…Disa vendime janë të thjeshta, sapo merren harrohen; disa të tjera duhet të rishikohen vazhdimisht dhe janë të varura nga kundërpërgjigja e kundërshtarit dhe disa të tjera janë të vogla, por pjesë e një serie të gjatë vendimesh të lidhura me njëra tjetrën…"[3]

Rrjedhimisht, ajo që në fakt duan politikanët nga komuniteti i inteligjencës është aftësia e tyre për vërtetimin e fakteve bazë të informacionit që marrin, analiza të shpejta të situatave dhe paraqitje të "linjave të rekomandimit të politikave apo zgjidhjeve" të vendimmarrjes së tyre. Vendimmarrësit e stafet e tyre nuk ankohen ndonjëherë nëse shërbimet inteligjente i kalojnë "caqet". Interesi i tyre është të marrin sa më shumë produkte inteligjente të përfunduara si analiza fenomenesh, dukurish,

[2] Paul D. Miller, "Lessons for Intelligence Support to Policymaking During Crises," Studies in Intelligence 54, no. 2, cited from https://www.cia.gov/ library/center-for-the-study-of-intelligence/csi-publications/csi-studies/studies/ vol.-54-no.-2/lessons-for-intelligence-support-to-policymaking.html, accessed 11 July 2010.

[3] Alex Mintz dhe Karl deRouen"Understanding foreign policy decision making" faqe 15 ISBN-13: 978-0521876452. Dalë në qarkullim për herë të parë më 22 Shkurt 2010, në gjuhën angleze.

tablo informative dhe vlerësime strategjike që japin rekomandime për veprimet e ardhshme të tyre.

Ish zëvendësdrejtori i Komitetit të Sigurisë Kombëtare të SHBA-së për Analizën, *Thomas Fingar*, gjatë një fjalimi të mbajtur me rastin e largimit, tregon se: "Sekretarja *Allbright*, pas raportimit që i bëra për një informacion të marrë mbi një vend të Lindjes së Mesme, më pyeti: E ç'duhet të bëj unë me këtë sipas jush?"- "Unë jam analist, iu përgjigja, nuk bëj politikë."…dhe përgjigja e saj ishte: "Tom, unë ju kërkoj opinion sepse e respektoj gjykimin tuaj. Kjo nuk do të thotë se unë do të bëj atë që do të më sugjeroni, por unë dua të di se ç'mendoni ju." Zoti *Fingar* në përfundim thotë se duhet zhvilluar një procedurë veprimi nga ana jonë për t'u marrë edhe me këtë çështje"[4]

Pra vendimmarrësit nuk duan vetëm t'iu ofrosh thjesht informacion, por edhe gjykimin e tyre se ç'kuptohet me "informacionet e reja" që marrin si dhe efektet e mundshme të këtij informacioni ndaj një politike të caktuar.

Lidhja e procesit të politikëbërjes me komunitetin e inteligjencës

Pikat e dobëta të marrëdhënies midis politikanëve me shërbimet inteligjente

Klientët[5] e produktit të inteligjencës në sferën e politikëbërjes nuk i kuptojnë misionin, vlerat dhe standartet e saj. Ata priren drejt skepticizmit ndaj inteligjencës, veçanërisht kur janë të rinj në politikë. Këta politikanë, në shumë raste, e krijojnë përshtypjen për shërbimet inteligjente nëpërmjet të njëjtave mjete që e krijon edhe publiku-nga media, shtypi dhe raportet parlamentare. Të pakta janë rastet kur kjo përshtypje krijohet nga burime serioze të fshehta, të sakta dhe aq më pak nga burime që pasqyrojnë realisht punën voluminoze dhe mjeshtëritë që përdorin shërbimet inteligjente për të arritur tek informacioni që iu përcjellin. Politikanët kanë këndvështrimin e tyre të të njohurit të botës dhe axhenda politike mjaft të qarta. Për këtë arsye, në mjaft raste, mendojnë se shërbimet sekrete kanë një axhendë politike si dhe vetë ata.

Nuk është për t'u çuditur që politikanët, jo gjithnjë e kuptojnë se si mund të ndihmohen prej komunitetit të inteligjencës. Në fund të fundit, mund të mendojë një politikëbërës, unë jam vendimmarrësi, më është besuar posti nga zgjedhësit dhe mbaj përgjegjësinë e vendimmarrjes. Kam burime të shkëlqyera informacioni dhe jam shumë i zënë, kështu që pse duhet të harxhoj kohë me shërbimet sekrete?

Sfidat e inteligjencës për një raport të efektshëm me vendimmarrësit politikë

Raportet me vendimmarrësit janë mjaft të rëndësishme për shërbimet inteligjente. Ata janë punëdhënësit e tyre. Prej këtij raporti varet gjithë veprimtaria e shërbimit, ecuria, zhvillimi, suksesi, dështimet dhe mbështetja politike dhe financiare. Dy janë momentet më të rëndësishme me ndikim kryesor në marrëdhëniet me ta:

[4] Thomas Fingar, Payne Distinguished Lecture Series 2009, "Reducing Uncertainty: Intelligence and National Security," Lecture 2: "Spies Collect Data, Analysts Provide Insight," Stanford University, 19 May 2009.

[5] Klient është personi i cili porosit produktin inteligjent dhe si rrjedhim i interesuari kryesor për këtë product, ndryshe nga konsumatori, i cili lexon produktin inteligjent por mund të mos jetë i insteresuari kryesor për këtë produkt.

Dobishmëria. Komuniteti i Inteligjencës jo vetëm duhet të ketë diçka për t'iu thënë vendimmarrësve, por ajo duhet të jetë e tillë që ata të mos kenë mundësi ta arrijnë me burime të tjera. Produkti i inteligjencës duhet të përmbajë më shumë se sa sekrete;

Komunikimi, mënyra se si përcillet produkti inteligjent. "Çdo produkt inteligjent duhet të bazohet në mirëkuptimin më të lartë të audiencës për të cilën është përpiluar"[6] Kjo nuk ka të bëjë me objektivitetin e brendisë së informacionit, por me disa rregulla formulimi, etike dhe sjelljeje profesionale që duhen patur parasysh kur shkruhen produktet informative për nivele të ndryshme të vendimmarrjes. Kjo kërkesë ka të bëjë me kohën në dispozicion të vendimmarrësit dhe nevojës që ka për specifikat e ndryshme të produktit inteligjent në një vendimmarrje konkrete.

Komuniteti i inteligjencës nuk është thjesht një mjet fakultativ për vendimbërësit, por nevojitet të jetë i ftuari i tyre në procesin e vendimmarrjes. Por, kur je i ftuar në një darkë, nëse spërkat të tjerët me verë, sigurisht mikpritësi ofendohet. Si rrjedhim, nuk ka gjasa të ftohesh sërish prej tij.

Komuniteti i inteligjencës përballet me këto probleme kryesore që dobësojnë rolin e tij në mbështetje të vendimmarrjes politike:

Së pari, reformimi/përshtatja me ndryshimet. Ndryshimet në konceptet e objektit, misionit, fushave dhe shtrirjes së veprimtarisë së shërbimeve sekrete, të cilat si rrjedhojë e zhvillimit global të botës së sotme, kanë qenë të domosdoshme për përballjen e kërcënimeve të reja të sigurisë, kanë zgjatur procesin e reformimit dhe përshtatjes në ambientin e ri të sigurisë. P.sh. nëse tradicionalisht shërbimet sekrete kanë qenë kryesisht të orientuara për të marrë të dhënat sekrete të mbrojtura nga kundërshtari, apo për të mbrojtur të dhënat e klasifikuara të vendit të tyre, sot ato duhet të orientohen kryesisht drejt informacionit që publikohet nga një mori e panumërt burimesh të hapura, të pikasë, përzgjedhë dhe vërtetojë atë pjesë që lidhet me sigurinë kombëtare dhe të mbështesë vendimmarrjen me rekomandime për të shmangur apo pakësuar efektin e tyre.

Kjo kërkon rikonceptim të strukturave, ku përparësi marrin strukturat analitike, ekspertët, shfrytëzimi i teknologjisë si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Kërkuesit, apo mbledhësit e informacioneve kërkohet vazhdimisht të jenë të orientuar nga strukturat analitike dhe specifikisht të orientuar për vërtetimin e të dhënave që siguron analiza. Ky reformim i zgjatur, i shoqëruar me kufizimet financiare ul performancën dhe si rrjedhim zvogëlon dhe dobëson cilësinë e mbështetjes së vendimmarrjes politike.

Së dyti, konkurrimi aktual i dobët i produktit të shërbimeve inteligjente në tregun e bollshëm të informacionit ka të bëjë edhe me natyrën e produktit të tyre, inteligjencës, si një element thelbësor i mallit publik të quajtur "siguri kombëtare". Vështirësia qëndron tek matja e vlerës reale të inteligjencës, si përbërës mjaft i rëndësishëm i mallit "siguri kombëtare". Duke patur një natyrë abstrakte dhe për rrjedhojë vlera abstrakte matjeje, financimi i shërbimeve sekrete shpesh vihet në plan dytësor përballë financimit të projekteve që realizojnë produkte të matshme dhe me efekt të drejtpërdrejtë tek publiku,

[6] Martin Petersen "What I Learned in 40 Years of Doing Intelligence Analysis for US Foreign Policymakers", faqe 1.

aq të dëshirueshme për vendimmarrësit në realizimin e objektivave të tyre elektorale, siç janë projekte të infrastrukturës, energjisë, etj. Në kushtet e një krize aktuale financiare, ky problem vështirësohet, por me një menaxhim të zgjuar, koncepti "Smart Intelligence" dhe me një konceptim të qëndrueshëm nga vendimmarrësit dhe hartuesit e buxhetit të mallit "siguri" si një e mirë superiore publike, mund të përballohet.

Së treti, marrëdhënia e komunitetit të inteligjencës me vendimmarrësit politikë nuk është më statike. Shërbimet inteligjente nuk duhet të konsiderojnë më që vendimmarrësit politikë t'iu drejtohen atyre së pari për çdo vendimmarrje politike. Ata janë në pozicionin që janë sepse janë realisht të matshëm në vlerën e kontributin e tyre për vendimmarrjen politike. Kjo kërkon nismë dhe rol aktiv të shërbimeve inteligjente në marrëdhëniet me vendimmarrësit. Ndryshimet në konceptimin e fushës së veprimit të shërbimeve inteligjente po sjellin një konkurrencë të produktit inteligjent që sigurohet nga shërbime të ndryshme inteligjente që janë në skenë. P.sh. vlerësimet për kërcënimet e sigurisë së rajonit që tradicionalisht kanë qenë domen i shërbimit inteligjent të jashtëm, mund të jepen edhe nga shërbimi informativ ushtarak me një ekspertizë gjithnjë e në rritje, si rezultat i ridimensionimit të tij si anëtar i inteligjencës ushtarake të NATO-s, si dhe nga shërbimi i sigurisë së brendshme, nëse kemi parasysh "ndërkombëtarizimin' e krimit të organizuar, terrorizmit, trafiqeve, etj, të cilat janë objekt kryesisht i tyre.

Së katërti, ndërtimi i mekanizmave të bashkëpunimit me stafet e vendimmarrësve politikë. Të parët që marrin dhe vlerësojnë produktin e shërbimeve inteligjente janë këshilltarët, konsulentët e vendimmarrësve. Duke rënë vazhdimisht në kontakt me produktet e shërbimeve inteligjente, ata jo vetëm ndikojnë për përdorimin e këtij produkti në vendimmarrje, por edhe krijojnë vlerësimin e zotësisë së komunitetit të inteligjencës për përmbushjen me sukses të misionit. *Feedback*-u i tyre është i rëndësishëm, jo vetëm për orientimin e punës së mëtejshme të këtij komuniteti por edhe për të kuptuar nevojat e vendimmarrësve për informacion. Prandaj edhe vendosja e mekanizmave të bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me ta është një domosdoshmëri e një komunikimi të efektshëm shërbime inteligjente-vendimmarrje politike, për të rritur vlerën e produktit dhe të vetë komunitetit të inteligjencës në vendimmarrjen politike.

Pikat e forta të shërbimeve inteligjente

Politikëbërësit mund të përdorin gjithë komunitetin e Inteligjencës si një "bazë të shëndoshë" për politikat që ata synojnë të zhvillojnë. Në këtë ambient, ata mund të eksplorojnë ide politike që ndihmohen nga përvoja e inteligjencës mbi rrjedhojat e mundshme të një politike, anët e mundshme negative dhe përftimet e paparashikuara të saj.

Të ndodhura në vijën e parë të kërcënimeve të sotme të sigurisë, shërbimet inteligjente janë të parat që kuptojnë dhe vlerësojnë natyrën e tyre, rreziqet që sjellin dhe mësohen të parashikojnë jo vetëm ecurinë por edhe masat e duhura për përballjen e suksesshme të tyre nga institucionet politike dhe shtetërore të vendit. Si rrjedhojë, komuniteti i inteligjencës përfton dhe ka një ekspertizë gjithnjë e në rritje dhe mjaft unike e të domosdoshme për sigurinë kombëtare dhe mbrojtjen e interesave të vendit.

" Me erozionin e konceptit të kufijve kombëtarë, shtetet kanë ndërmarrë masa më

aktive për të mbrojtur popullsinë e tyre dhe këto përpjekje janë gjithnjë e më tepër të startuara nga inteligjenca"[7]

Kjo përvojë në zhvillim i ka dhënë inteligjencës aftësinë të kuptojë dhe shquajë qartë dallimin midis problemeve me informacionin, të cilat kërkojnë më shumë të dhëna dhe akses tek kundërshtari që kontrollon informacionin e kërkuar, me të kuptuarin e problemeve që do të thotë se kur problemi i informacionit është zgjidhur, puna e komunitetit të inteligjencës nuk mbaron, por kërkohet perceptim, imagjinatë, apo njohuri të shumta për kuptimin e informacionit të përftuar.

Për inteligjencën, në raport me vendimmarrësit, çështja nuk është thjesht nëse informacioni i përftuar është "objektivisht i vërtetë", por nëse mënyra e përdorimit të këtij informacioni sjell krijim vlerash. Në këtë mënyrë, barra intelektuale e komunitetit inteligjent kalon nga "të dhëna të besueshme" në "shërbim inteligjent të besueshëm".

Me fjalë të tjera, shërbimi ndaj vendimmarrësve politikë varet tek krijimi dhe mbajtja e besimit, më tepër sesa vlerat e brendshme të ndonjë pjese të veçantë informacioni, platforme specifike apo rrjeti agjenturor cilësor që arrin të ndërtojë.

Në këtë mënyrë, vendimmarrësi krijon besim jo tek produkti analitik, por tek aftësia e shërbimit sekret për t'i vendosur të dhënat në kontekst, aftësia për të kuptuar se si veprimet, ngjarjet dhe aktorët mund të ndërveprojnë për të ndikuar tek rezultatet. Më shumë rëndësi do të kishte jo vetëm parashikimi i efekteve që mund të sjellë një fatkeqësi natyrore, por përshtatja e shërbimeve sekrete me kushtet e reja që krijohen, për të arritur të ndihmojë maksimalisht vendimmarrjen në realizimin e objektivave dhe synimeve të veta për shmangien e shkaqeve e pasojave.

Analiza e shërbimeve inteligjente përmban dhe duhet të përmbajë elemente që të mund të kombinohen në mënyrë imagjinare për të krijuar diçka të re, pra një proces që grekët e lashtë e kanë parë si antitezë të analizës-sintezë.

Roli i lidershipit për "Influencimin" e vendimmarrjes politike

Punonjësit e shërbimeve inteligjente e dinë mirë se sa shumë punë, kohë dhe mjete duhen për të arritur tek produkti i gatshëm për vendimmarrësit politikë, që shpesh paraqitet në thjesht tri katër paragrafë, apo maksimumi dy faqe informacion të shkruar. Është një punë voluminoze, shpesh me orare pune të zgjatura, kërkim informacioni në ambiente të rrezikshme dhe të vështira për të depërtuar, angazhim ekspertësh, strukturash dhe mjetesh të shumta për vërtetim informacioni. Dhe në përfundim, mund të ndodhë që ky produkt të mos përdoret fare nga vendimmarrësi.

Në artikullin " Sintezë për klientët, jo analizë për blerësit" analistët e inteligjencës amerikane *Josh Kerbel* dhe *Anthony Olcott* ngrenë për diskutim çështjen: " *Çfarë mund të ndodhë nëse komunitetit të inteligjencës i duhet të pranojë ... se politikëbërësit vazhdojnë të bëjnë politikë edhe nëse marrin parasysh ose jo "produktet e përfunduara" të këtij komuniteti ?"*[8] Sigurisht asgjë, por do të ishte një zhgënjim i madh për të gjithë ata që mundësuan, përmes një pune teje të lodhshme, këtë produkt.

[7] Richard J.Aldrich. Transatlantic intelligence and security cooperation. page 24.

[8] Josh Kerbel and Anthony Olcott "Synthesizing with Clients, Not Analyzing forCustomers" faqe 17 Studies in Intelligence Vol. 54, No. 4 (Extracts, December 2010).

Për të shmangur këto "dështime", lidershipit të komunitetit të inteligjencës i duhet të ndërtojë një strategji të efektshme të "influencimit" të vendimmarrjes politike përmes një lidhjeje të sinqertë dhe mirëkuptimi me ta.

Vendimmarrësi politik ka dy mënyra për të "fituar" nga produkti inteligjent: profesionalisht dhe personalisht. Dëgjimi i tij, në të dyja rastet, krijon mundësi për t'i shërbyer në mënyrë të efektshme.

Si drejtues, një pjesë e përgjegjësisë së liderit është që të sigurohet se organizata e tij i jep përparësi mënyrës dhe kohës së angazhimit në marrëdhënien me vendimmarrësin politik.

Një pjesë e rëndësishme e procesit të menaxhimit të marrëdhënieve me vendimmarrjen politike është të identifikohen njerëzit brenda stafit të politikëbërësit që influencojnë në produktet apo shërbimet e organizatës.

Duke analizuar më në detaje këtë element të rëndësishëm, këta influencues mund të jenë:

Influencues përdorimi. Në stafet e titullarëve të institucioneve të larta vendimmarrëse gjenden këshilltarë të specifikuar për çështjet që lidhen me produktin apo shërbimin e organizatës. Ata janë personat që influencojnë mjaft vendimmarrjen e liderit të tyre dhe kanë ekspertizën më të mirë mbi çështjet që mbulon organizata. Perceptimi tek vendimmarrësi për organizatën varet në disa raste tërësisht nga këta persona.

Influencues ekonomikë. Organizata nuk mund të zhvillojë plotësisht aftësitë dhe kapacitetet e veta nëse ka mungesë fondesh. Dihet se marrësit e vendimit për akordimin e buxhetit janë kryeministri, ministri i financave, parlamenti, etj, por ndodh që mund të jetë edhe ndonjë individ më pak i pritshëm, një këshilltar ekonomik, anëtar komisioni parlamentar, etj.

Influencues teknikë. Në stafet e "klientit" gjenden këshilltarë apo specialistë që kanë ekspertizën, jo vetëm të argumentimit të rëndësisë së përdorimit të mjeteve teknologjike, komunikimit, transportit, pajisjeve speciale, etj. që kanë rol thelbësor në performancën dhe realizimin e produktit të dëshiruar të organizatës, por edhe të mënyrës së sigurimit të tyre në kohë, me cilësi dhe kosto më të ulët. Këta sigurisht nuk janë vendimmarrësit e fundit, por luajnë një rol mjaft të rëndësishëm influencimi në vendimmarrjen e "klientit".

Konsulentë. Janë persona në stafin e "klientit" por që në mënyrë të vazhdueshme pëlqejnë kontributin dhe produktin e organizatës dhe e përdorin në procesin e vendimbërjes politike. Nëse lideri i organizatës i kushton vëmendje kultivimit të një marrëdhënieje të sinqertë me ta, që produkti i tyre të ketë sukses tek "klienti", këta konsulentë mund të jenë shumë të rëndësishëm për të ndihmuar organizatën.

Në marrëdhëniet me vendimmarrësin, një drejtues i shërbimeve inteligjente duhet të kuptojë se edhe ata si çdokush tjetër duan të jenë të vlerësuar. Vendosja e një lidhjeje personale e liderit me "klientin" është vendimtare për të kuptuar nevojat e tyre.

Realizimi i kësaj marrëdhënieje është kritike. Një lider i mirë pranon faktin se ka më shumë energji dhe entuziazëm për të reklamuar suksesshëm produktin dhe shërbimet e organizatës tek vendimmarrësi se sa për finalizimin e detajeve të një urdhri,

marrëveshjeje apo për mbikqyrjen e realizimit të operacioneve të ndërmarra nga organizata.

Përfundime

Roli i shërbimeve inteligjente në vendimmarrjen politike është rritur mjaft si rrjedhojë e ndryshimeve të shumta në mjedisin e sigurisë së sotme kombëtare dhe ndërkombëtare. Adresimi i kërcënimeve të sotme nis dhe udhëhiqet nga produkti inteligjent i shërbimeve sekrete.

Efektet e globalizmit, zhvillimi mjaft i madh i teknologjisë, mjeteve të komunikimit, transportit, informacionit, etj, kanë sjellë ndryshime në konceptimin e mjedisit të sigurisë ndërkombëtare. Kërcënimet e sotme, pavarësisht se ku shfaqen, kanë impakt të drejtpërdrejtë në sigurinë kombëtare, gjë që ka çuar në një rikonceptim të shërbimeve sekrete, rolit, misionit dhe kompetencave të tyre si dhe të nevojës për një reagim mjaft më të shpejtë ndaj shfaqjes së këtyre kërcënimeve. Intensiteti, shumëllojshmëria, befasia e kërcënimeve aktuale të sigurisë dhe përmasat e dëmeve prej tyre janë shtuar dhe, për rrjedhojë, etapat kohore të procesit të vendimbërjes politike janë zvogëluar mjaft. Në këtë realitet, tipari themelor i rëndësisë së shërbimeve inteligjente është ndihma e tyre e drejtpërdrejtë në vendimmarrjen politike, nëpërmjet vlerësimeve, rekomandimeve, këshillimeve dhe dhënies së opsioneve më të mira për vendimmarrjen politike në adresimin e suksesshëm të kërcënimeve të sotme.

Sfidat e shërbimeve inteligjente në shërbim të vendimmarrësve politikë lidhen me një pozicionim të ri të këtyre marrëdhënieve, nga statike në dinamike. Rëndësia e tyre nuk varet më thjesht nga statusi ligjor si institucione shtetërore inteligjence, por nga aftësia e tyre për të përmbushur me sukses misionin në përballjen informative të kërcënimeve të sigurisë dhe për të ndihmuar vendimmarrjen politike të ketë gjithë informacionin e nevojshëm për një vendimmarrje të suksesshme në adresimin e çështjeve të sigurisë kombëtare dhe interesave të vendit.

Bibliografia:

- "A globally networked and integrated intelligence enterprise- Vision 2015" faqe 8. Botim Zyrës së Drejtorit të Inteligjencës Kombëtare të SHBA.
- Paul D. Miller, "Lessons for Intelligence Support to Policymaking During Crises," Studies in Intelligence 54, no. 2, cited from https://www.cia.gov/ library/center-for-the-study-of-intelligence/csi-publications/csi-studies/studies/ vol.-54-no.-2/lessons-for-intelligence-support-to-policymaking.html, accessed 11 July 2010.
- Thomas Fingar, Payne Distinguished Lecture Series 2009, "Reducing Uncertainty: Intelligence and National Security," Lecture 2: "Spies Collect Data, Analysts Provide Insight," Stanford University, 19 May 2009.
- Martin Petersen "What I Learned in 40 Years of Doing Intelligence Analysis for US Foreign Policymakers".
- Josh Kerbel and Anthony Olcott ,"Synthesizing with Clients, Not Analyzing forCustomers" Studies in Intelligence Vol. 54, No. 4 (Extracts, December 2010).
- Richard J.Aldrich, Transatlantic intelligence and security cooperation.

Gjuha, faktor jetësor i gjeopolitikës kombëtare

Granit Zela,
Programi i Doktoraturës, 2011-2014

Silvana Markgjonaj,
Studente në Programin MSc. "Siguria Kombëtare",
Akademia e Forcave të Armatosura

Trajtesë e shkurtuar. *Gjuha është një nga përbërësit themelorë të identitetit të popujve dhe të etnive. Ajo është një nga karakteret e tyre dallues dhe për këtë mund të jetë karakteri i tyre kryesor i përcaktimit të identitetit. Kur flitet për gjuhën, bëhet fjalë për një dimension të gjeopolitikës së brendshme të shteteve. Gjuha mund të jetë gjithashtu një dimension i gjeopolitikës së jashtme, duke qenë faktor i fuqisë dhe ndikimit për popujt, duke u shndërruar edhe në faktor hegjemonie.*

Një popull që humb gjuhën e tij, humb jo vetëm shpirtin por edhe dallimin e tij si popull. Por si paraqitet rruga nga etnia në popull dhe nga shteti në komb? Është rrugë e gjatë që e kalon nga një gjuhë e përbashkët për popullsinë që jeton brenda kufijve shtetit. Kësisoj, gjuha është gjithashtu një mjet i ndërtimit të projekteve kombëtare.

Gjuha si pushtet dhe instrument i fuqisë kombëtare

Kur e pyetën kancelarin Oto fon Bismark (Otto von Bismarck) se cila ishte ngjarja më domethënëse e historisë, ai u përgjigj në mënyrë enigmatike: "Amerika e Veriut flet anglisht". Mesazhi nga mendja më fine e diplomacisë europiane ishte i qartë: gjuha është pushtet. Gjykimi i Bismarkut-i cili i përket vitit 1898- e zbuloi saktësinë e tij vetëm pak vite më vonë, me hyrjen e Shteteve të Bashkuara në Luftën e Parë Botërore përkrah Britanisë së Madhe dhe kundër Gjermanisë e Austro-Hungarisë, perandori të bashkuara nga gjuha e përbashkët gjermane

Pushteti i gjuhës shpjegohet qysh në mitin e "Kullës së Babelit" prej së cilës kuptohet se të pasurit e një gjuhe të vetme nënkupton fuqi dhe përbën pushtet të jashtëzakonshëm. Sipas mitit, kishin kaluar 5 breza nga përmbytja e madhe, kur ata thanë: "*Le të ngrejmë një kullë, maja e së cilës të prekë qiellin dhe me këtë të bëhemi të famshëm, para se të vdesim*". Zoti që vëzhgonte kryelartësinë e njerëzimit, vendosi

që të pështjellonte gjuhën e njëjtë të mëparshme dhe t'i linte njerëzit në një kaos komunikimi.

Historia e qytetërimeve është gjithashtu historia e gjuhëve që pasojnë njëra tjetrën në rolin e tyre hegjemon. Greqishtja dhe latinishtja janë, falë Greqisë dhe Romës, gjuhët e mëdha botërore të qenies antike. Në shekullin VII, arabët kërkuan të imponojnë me fenë dhe gjuhën e tyre hegjemoninë mbi botën. Ata arritën ta bëjnë këtë në gjithë Lindjen e Mesme, në Afrikën e Veriut dhe në jugun e gadishullit europian. Në shekullin XVI, kohën e zbulimeve të mëdha ekstra europiane, hegjemonia duket se ndahet mes portugezçes dhe spanjishtes. Shekulli XVII është shekulli i rusishtes dhe frëngjishtes.[1] Anglishtja fillon ngjitjen e saj duke filluar nga shekulli XVIII. Ajo është e folura hegjemone e shekullit XX.[2]

Gjeopolitikani gjerman Karl Haushofer e lidhi domenin gjerman me fushën e shtrirjes së gjuhës gjermane. Kur kanë ndodhur ndryshime të mëdha në hartën e shteteve, shumë shpesh privilegjohen koherencat gjuhësore, në dëm të çdo kriteri tjetër. Tipik është p.sh. shembulli magjar, baza e nacionalizmit hungarez. Pas Traktatit të Trianonit të 1918, shtetit magjar iu hoqën të gjitha provincat ku gjuha e shumicës nuk ishte gjuha magjare.[3] Disa shtete shumë etnike janë përballur me problemin e shpërndarjes gjuhësore. Ky është p.sh rasti i Papuazisë-Guineja e re, e ndarë midis botës melaneziane dhe botës papu dhe që numëron në pjesën orientale të ishullit më shumë se 400 të folura të dallueshme.[4]

Gjuha është një faktor identitar i brendshëm dhe një mjet i fuqisë së jashtme. Uniteti gjuhësor është shpesh i nevojshëm për një shtet për të vendosur stabilitetin dhe për të shkëlqyer në botë. Por megjithë rëndësinë e saj, gjuha nuk është faktori i vetëm gjeopolitik. Në ish Jugosllavi, gjuha serbo-kroatisht, para viteve 90, dukej sikur i jepte unitetin Shtetit Federal. Ky unitet s'ishte veçse fasadë; tensione identiteti të thella të lidhura me dallimet etnike dhe fetare e trazuan vendin dhe provokuan shpërthimin e tij. Gjeopolitika, një shkencë ndërdisiplinore duhet të refuzojë monizmin: refleksionet e saj duhet të përmbledhin tërësinë e të dhënave dhe të faktorëve përcaktues. Mbledhja e faktorëve nuk mjafton; duhet gjithashtu të dish t'i vendosësh ato sipas origjinalitetit, të lidhura me çdo situatë të studiuar.

"Gjeopolitika e gjuhëve" në skenën ndërkombëtare

Ka shumë mënyra se si mund të studiohet çështja e marrëdhënies së ndërvarur mes gjuhëve dhe politikave. Gjeopolitika është vetëm njëra prej tyre. Nëse gjeopolitika merret me studimin e proceseve politike në një kontekst hapësinor, roli politik i gjuhës përbën një element të rëndësishëm të gjeopolitikës, ndërsa vetë gjeopolitika

[1] C. Hagege, Le français et les siècles, Paris, Odile Jacob, 1987; J. L. Trister, Histoire de la langue française, Paris, Ellipses, 1999.

[2] A. Chauprade, L'espace économique francophone, Paris, Ellipses, 1996; D. Noguez, La colonialisation douce…, Paris , ed. du Rocher, 1991.

[3] A. Chauprade, F. Thual, Dictionnaire de géopolitique, 2e ed., Ellipses, 1999, articles «Italie» , «Hongrie». P. Renouvin, Histoire des relations internationales, Paris, Hachette, 1957, t. VII, Les crises du XXe siècle, I, De 1914 a 1929. «Le règlement de la paix», pp. 154-191.

[4] Y. Lacoste, Dictionnaire de géopolitique, Paris, Flammarion, 1993, articles Papouasie-Nouvelle Guinée, p. 1197-1199 et papous (peuples et langues), p. 1199.

përbën një instrument me anë të të cilit mund të studiohet çështja e marrëdhënies së ndërvarur mes gjuhëve dhe politikave, jo vetëm në institucionet politike, por edhe në sjelljen politike mes shteteve dhe brenda shtetit. Çështja e gjuhës ose politikës së nxënies së gjuhës ka një ndikim shumë të rëndësishëm në proceset e formimit të strukturave gjeopolitike të shtetit, por gjithashtu edhe në krijimin e bazave themelore për marrëdhëniet ndërkombëtare të një shteti.

Gjuha nuk është vetëm një karakteristikë madhore përkufizuese e identitetit politik të individëve, e grupit ose shtetit, por edhe elementi më i natyrshëm i sjelljes politike. Zgjedhja e një gjuhe për përdorim në një komunikim më të gjerë, zgjedhja e gjuhës e cila studiohet, bilingualizmi ose vendimi për të mos mësuar gjuhë të tjera përbëjnë shembujt më të mirë të sjelljes tonë politike. Studimi i këtyre aspekteve mund të na tregojë shumë për politikat tona të brendshme dhe ndërkombëtare po aq sa shërben si tregues në analizën e institucioneve politike.

Përhapja e gjuhëve nuk mbështetet vetëm në numrin e folësve të saj, por gjithashtu në fuqinë ekonomike, teknologjike dhe politike e cila qëndron pas vendimit për të përdorur një gjuhë. Prandaj dhe zgjerimi i territorit ku flitet një gjuhë, rënia ose rivaliteti mes gjuhëve është, më së shumti, produkt i proceseve dhe ndryshimeve gjeopolitike. Studimi i marrëdhënies së ndërsjelltë mes gjuhëve, politikave dhe territorit na ndihmon në të kuptuarit e zhvillimeve globale, rajonale dhe lokale.

Gjeopolitika e gjuhëve në nivel global: anglishtja dhe frëngjishtja

Gjuhët mbikombëtare janë gjuhë që nuk janë të lidhura me një komb politik. Gjuhë të tilla fliten në më shumë se në një komb politik. Folësit e këtyre gjuhëve mund të ndahen më tej në tre grupe: folësit e gjuhës si gjuhë amtare, folësit e gjuhës si gjuhë e dytë dhe folësit e gjuhës si gjuhë e huaj. Kjo tipologji përdoret gjerësisht prej sociolinguistëve, por kjo ndarje është e mundur të përdoret gjithashtu edhe në kategoritë gjeopolitike.[5]

Në kategorinë e parë është e mundur të përfshihen shtetet në të cilat shumica flet gjuhën mbikombëtare, ose atë e flet si gjuhë amtare një pjesë thelbësore e qytetarëve të shtetit. Kategoria e dytë janë vendet ku gjuha mbikombëtare nuk flitet gjerësisht prej qytetarëve si gjuhë amtare, por përdoret si *lingua franca* dhe ka status zyrtar në këto vende. Ka vende në të cilat gjuha mbikombëtare përbën një gjuhë të dytë. Kategoria e tretë janë shtetet ku gjuha mbikombëtare nuk ka status zyrtar, por politika arsimore e shtetit e nxit përphapjen e kësaj gjuhe si gjuhë të komunikimit të gjerë, sidomos në nivel ndërkombëtar. Në këtë kategori është e mundur të përfshihen vendet ku nuk ka një politikë arsimore për të nxitur përhapjen e një gjuhe konkrete mbikombëtare si gjuhë të një komunikimi më të gjerë ndërkombëtar, por shumica e popullsisë së një vendi përdor gjuhën mbikombëtare si gjuhë të huaj dhe, shumë shpesh, si gjuhë të parë të huaj.

Në kategorinë e gjuhëve globale mbikombëtare mund të përfshijmë një gjuhë e cila flitet gjerësisht jo vetëm si gjuhë amtare, por flitet gjithashtu gjerësisht sidomos si një gjuhë e dytë dhe si gjuhë e huaj në makrorajone të ndryshme të botës. Vetëm dy gjuhë mund të përfshihen në këtë kategori, Anglishtja dhe Frëngjishtja.

[5]Kachru, B. (1986): The Alchemy of English. Oxford: Pergamon.

Statusi ndërkombëtar i gjuhës në aspektin gjeopolitik

Arsyet pse një gjuhë merr statusin e gjuhës ndërkombëtare nuk kanë të bëjnë vetëm me numrin e njerëzve që e flasin atë, por shumë më tepër ka të bëjë me faktin se cilët janë "folësit e saj". Gjuha latine u bë një gjuhë ndërkombëtare nëpërmjet Perandorisë Romake dhe kjo nuk erdhi për shkak se romakët ishin më të shumtë në numër se popujt që ata pushtuan. Ata ishin thjesht më të fuqishëm. Më vonë, kur fuqia ushtarake romake ra, latinishtja mbeti për një mijëvjeçar si gjuha ndërkombëtare e arsimit, në sajë të një lloji tjetër fuqie, asaj të katolicizmit romak.

Megjithatë, një gjuhë nuk bëhet ndërkombëtare për shkak të cilësive të saj strukturore, apo për shkak të madhësisë së fjalorit të saj, apo sepse ajo ka qenë mjet i prodhimit të një literature të madhe në të kaluarën, e lidhur me një kulture apo besim të madh. Natyrisht, faktorë të tillë mund të motivojnë dikë për të mësuar një gjuhë, por që kurrsesi nuk mund të sigurojë përhapjen globale të një gjuhe. Në të vërtetë, faktorë të tillë nuk mund të garantojnë as mbijetesën e një gjuhe si të gjallë dhe në përdorim-këtu mund të përmendim gjuhën latine e cila sot studiohet thjesht si një gjuhë klasike vetëm nga një numër i vogël studiuesish.[6]

Ka një lidhje tepër të ngushtë midis dominimit të një gjuhe dhe pushtetit ekonomik, teknologjik dhe kulturor dhe kjo marrëdhënie bëhet gjithnjë e më qartë me historinë e gjuhës angleze. Pa një bazë të fortë pushteti dhe një force të çfarëdo lloj natyre, asnjë gjuhë nuk mund të bëjë përparim si një mjet i komunikimit ndërkombëtar. Gjuha nuk ekziston në një lloj hapësire mistike, e ndarë dhe e pavarur nga njerëzit që e flasin atë. Gjuha ekziston vetëm në trurin, gojët, veshët, duart dhe sytë e përdoruesve të saj. Kur ata janë të suksesshëm në arenën ndërkombëtare, gjuha e tyre korr sukses gjithashtu, kur ata dështojnë, gjuha e tyre gjithashtu dështon.

Anglishtja si gjuhë e parë globale

Anglishtja është padyshim në kategorinë e gjuhëve mbikombëtare globale. Statusi aktual që gjuha angleze gëzon sot në botë është rezultat i kryesisht i dy faktorëve: zgjerimi i pushtetit kolonial britanik, i cili kulmoi drejt fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe shfaqjes së Shteteve të Bashkuara si fuqi kryesore ekonomike e shekullit të njëzetë. Është pikërisht faktori i fundit i cili vazhdon të shpjegojë pozitën botërore të gjuhës angleze sot.

Sipas një qasjeje tjetër, statusi i anglishtjes si gjuhë globale shpjegohet në dy aspekte: atë gjeografiko-historik, por edhe atë socio-kulturor. *Aspekti* gjeo-historik tregon se si anglishtja arriti një pozicion parësor në botë, ndërsa ai socio-kulturor shpjegon pse vazhdon të mbetet e tillë. Kjo ishte një përhapje e cila u pasua nga zgjerimet koloniale të shekullit të nëntëmbëdhjetë në Afrikë dhe në Paqësorin e Jugut dhe mori një ngritje të rëndësishme kur kjo gjuhë u miratua si gjuhë zyrtare apo gjysmë-zyrtare në mesin e shekullit XX, nga shumë vende te reja të saposhpallura shtete të pavarura. Anglishtja tashmë përfaqësohet në çdo kontinent, si edhe në ishuj në tre oqeanet kryesore.

Nga vitet 1960, epërsia e kësaj gjuhe mori udhë, por që në atë kohë nuk mund të përshkruhej si një gjuhë e vërtetë ndërkombëtare. Që atëherë, dy ngjarje kanë siguruar,

[6] Bailey, Richard W. 1991. Images of English: a cultural history of the language. Cambridge: Cambridge University Press.

së bashku, statusin e saj ndërkombëtar. E para ishte lëvizja drejt pavarësisë politike e disa vendeve, nga e cila anglishtja doli si një gjuhë me status të veçantë në shumë vende të reja. Në shumicën e këtyre, roli i anglishtes ishte kaq i madh saqë asnjë gjuhë tjetër nuk mund ta konkurronte atë. E dyta ishte revolucioni elektronik , ku edhe në këtë rast, anglishtja ishte në vendin e duhur (SHBA) në kohën e duhur (vitet 70-të të shekullit të kaluar).

Aspekti socio-kulturor sqaron se si njerëzit nëpër të gjithë botën, në shumë sfera të jetës, janë të varur nga anglishtja për mirëqenien e tyre ekonomike dhe sociale. Zhvillimi i kompjuterëve, në shekullin XX, ka qenë pothuajse krejtësisht një biznes amerikan. Sistemet e para operative kompjuterike ishin në anglisht, sikurse mund ta shohim dhe tek udhëzimet në sistemet e MS.DOS-it, por edhe tek sistemet operative të mëvonshme të cilët zëvendësuan DOS-in, të cilat ndikohen nga influenca e anglishtes, edhe pse ka alternativa edhe në disa gjuhë të tjera. Është pikërisht kjo hegjemoni dhe përhapje që e bën gjuhën angleze të etiketohet si "gjuhë mbarë-botërore"në realitet. Dihet gjithashtu që anglishtja ka një pozitë dominuese edhe në internet, rreth 80 përqind e informacionit të ruajtur aty në mënyrë elektronike është në anglisht, duke bërë kështu që anglishtja të jetë e para *"Lingua franca"* e internetit. Kjo gjuhë ka depërtuar thellë në fushat ndërkombëtare të jetës politike, biznesit, sigurisë, komunikimit, argëtimit, medias dhe arsimit. Lehtësia e të pasurit një *lingua franca* në dispozicion të marrëdhënieve dhe nevojave globale njerëzore po vlerësohet nga miliona njerëz.

Skenarë gjeopolitikë të gjuhës angleze

Skenari "Anglishtja mbizotëron"

"Anglishtja mbizotëron" është një term që e prezanton botën me një skenar të thjeshtë i cili sugjeron përhapjen e kësaj gjuhe në mbarë botën si dhe gjasat për vazhdimësinë e kësaj përhapjeje apo mbizotërimi dhe në të ardhmen.

Një gjuhë arrin një status të vërtetë botëror, kur ajo luan një rol të veçantë i cili i njihet në çdo vend. Një rol i tillë është më i dukshëm në vende ku një numër i madh i njerëzve e flasin gjuhën si gjuhë amtare-në rastin e gjuhës angleze, si në SHBA, Kanada, Britani, Irlandë, Australi, Zelandë e Re, Afrikë e Jugut, disa vende në Karaibe dhe në disa territore të tjera në botë. Asnjë gjuhë tjetër nuk është folur "si gjuhë amtare" nga një numër kaq i madh njerëzish të shpërndarë në kaq shumë territore/ vende të globit (spanjishtja kryeson vetëm në këtë aspekt si gjuhë e folur në rreth 20 vende kryesisht të Amerikës Latine). Përdorimi si gjuhë amtare vetëm në një vend, sado i madh qoftë ai në numër popullsie, nuk arrin dot t'i japë një gjuhe statusin e gjuhës mbarëbotërore. Për të arritur një status të tillë, një gjuhë duhet të përdoret nga vende të tjera rreth botës të cilët vendosin t'i japin asaj një vend dhe rol të veçantë brenda komuniteteve të tyre, edhe pse për nga numri ata mund të kenë, mund të mos kenë, apo të kenë fare pak folës të kësaj gjuhe si gjuhë të tyre amtare.

Anglishtja e arriti këtë status nëpërmjet dy mënyrave kryesore: së pari, ajo arriti të bëhej gjuha zyrtare e disa vendeve, duke u përdorur si mjet komunikimi në institucione të tilla si: qeveri, gjykatë, media dhe sistem arsimor. Për të hyrë në të tilla brazda ishte dhe është tepër e rëndësishme që gjuha të zotërohet sa më herët të jetë e mundur

në jetën e individit. Një gjuhë e tillë është përshkruar shpesh si 'gjuhë e dytë', pasi shihet si plotësuese e gjuhës amtare ose e 'gjuhës së parë' të individit. Anglishtja sot gëzon një status të veçantë në mbi shtatëdhjetë vende, të tilla si Gana, Nigeria, India, Singapori, etj. Së dyti, një gjuhë mund të bëhet prioritet si pjesë e programit arsimor në mësimin e gjuhës së huaj në një vend, edhe pse kjo gjuhë nuk ka asnjë status zyrtar në vendin respektiv, duke u bërë kështu gjuha të cilën fëmijët kanë më shumë gjasa ta mësojnë kur ata futen në shkollë. Anglishtja është gjuha që tani mësohet më gjerësisht si gjuhë e huaj-në mbi 100 vende, të tilla si Kina, Rusia, Gjermania, Spanja, Egjipti dhe Brazili-dhe në shumicën e këtyre vendeve del si gjuha kryesore e huaj e hasur në shkolla, duke zhvendosur kështu një gjuhë tjetër. Në vitin 1996, për shembull, anglishtja zhvendosi apo zëvendësoi frëngjishten si gjuha primare e huaj në shkollat në Algjeri (një ish-koloni franceze). Këtu mund të përmendim dhe rastin e Shqipërisë, ku shumë shpejt anglishtja arriti të zhvendosë rusishten por edhe frëngjishten si gjuhë e huaj e mësuar në shkollat shtetërore, për të vazhduar dhe më tej me vendimin qeveritar sipas të cilit anglishtja futet si pjesë e provimeve të maturës shtetërore.

Pra për shkak të zhvillimit të trefishtë të kësaj gjuhe, si 'e parë', 'e dytë' dhe 'e huaj', kjo gjuhë sot po përdoret nga një numër shumë më i madh njerëzish nëpër botë, nga ç'është përdorur ndonjë gjuhë tjetër më parë. Tashmë anglishtja ka arritur fazën e një gjuhe mbarëbotërore. Rreth një katërta e popullsisë botërore janë folës të rrjedhshëm apo kompetent të anglishtes dhe kjo shifër në fillim të mijëvjeçarit të ri ishte në rritje të vazhdueshme-që do të thotë rreth 1.5 miliardë e popullsisë botërore.

Skenari i rënies si gjuhë globale

Historia e gjuhëve të përdorura si *"lingua franca"* na ka treguar në mënyrë të përsëritur se duhet të jemi të kujdesshëm kur bëjmë parashikime për të ardhmen e një gjuhe. Nëse, në mesjetë, dikush do guxonte të parashikonte rënien e gjuhës latine si gjuhë e arsimit, njerëzit nuk do e merrnin seriozisht. Po kështu, në shekullin e tetëmbëdhjetë, nëse dikush sugjeronte se një gjuhë tjetër dhe jo frëngjishtja, do të përdorej në të ardhmen si gjuha e politikës dhe shoqërisë së lartë, askush nuk do ta besonte.

Faktori "kohë" konceptohet ndryshe në politikë dhe ndryshe në gjuhësi. Për politikën një javë mund të jetë dhe një periudhë mjaft e gjatë, ndërsa në gjuhësi edhe një shekull merret si periudhë e shkurtër. Sidoqoftë, ekzistojnë edhe skenarë për rënien e një gjuhe nga statusi i gjuhës globale. Në parashtrimin dhe analizën e skenarëve që mund të ndikojnë në rënien e anglishtes si *"lingua franca"* mund të parashtrohen disa mundësi. Një ndryshim në ekuilibrin e forcës, qoftë asaj politike, ekonomike, teknologjike apo kulturore, mund të ndikojë në ngritjen e gjuhëve të tjera në statusin që ka anglishtja sot.

Nëse dominimi i një gjuhe është vetëm çështje e ndikimit politik dhe veçanërisht atij ekonomik, atëherë mjafton një revolucion në ekuilibrin e forcës në glob, i cili mund të sjellë pasoja dhe për zgjedhjen e gjuhës globale.

Pavarësisht rritjes së spikatur në numrin e përdoruesve të gjuhës angleze, të paktën dy të tretat e popullsisë së botës ende nuk e përdorin atë. Në disa pjesë të botës (në shumicën e shteteve të ish-Bashkimit Sovjetik, për shembull), anglishtja ka ende një prani shumë të kufizuar. Në disa vende të tjera po rriten burimet financiare në mbrojtje të rolit të gjuhëve të tjera (të tilla si frëngjishtja, në disa vende të Afrikës).

Skenari i zëvendësimit me "makinën përkthyese" si metodë globale komunikimi

Një skenar tjetër shumë më i besueshëm është dalja e një metode tjetër alternative të komunikimit e cila mund të eleminonte nevojën për gjuhë globale. Këtu mund të përmendim përkthimin automatik: "makinën përkthyese". Nëse progresi në këtë fushë vazhdon të jetë aq i shpejtë sa në dhjetëvjeçarin e fundit, ka një mundësi që, brenda një brezi ose dy, kjo do të jetë rutinë për njerëzit që të komunikojnë me njëri tjetrin direkt, duke përdorur gjuhët e tyre të para.

Por, gjithsesi, duke marrë parasysh shpejtësinë me të cilën është zhvilluar skenari i shfaqjes së gjuhës angleze, është e pamundur të bëhen parashikime në lidhje me shfaqjen e një gjuhe tjetër kaq gjithpërfshirëse në mbarë botën. Brenda pak më shumë se një brezi, ne kemi lëvizur nga një situatë ku ekzistenca e një gjuhe botërore shfaqej si një mundësi teorike, në situatën ku ajo është një realitet i dukshëm.

Duke qenë se SHBA është bërë elementi më dominant në thuajse të gjitha fushat e veprimtarisë, e ardhmja e gjuhës angleze varet deri diku nga e ardhmja e këtij vendi. Fuqia më e madhe që ka ushqyer rritjen dhe forcimin e kësaj gjuhe gjatë shekullit të njëzetë ka ardhur nga Amerika.

Frëngjishtja si gjuhë globale mbikombëtare: Frankofonia

Frëngjishtja ka gjithashtu ambicien gjeopolitike të jetë një gjuhë globale mbikombëtare. Si gjuhë amtare, flitet gjerësisht sigurisht në Francë, si gjuhë minoriteti flitet në Kanada, Belgjikë dhe Zvicër. Frëngjishtja është gjuhë zyrtare në Luksemburg, në shumë vende afrikane, nga të cilat numri më i madh i folësve të frëngjishtes si gjuhë e dytë është në Bregun e Fildishtë, Republikën Demokratike të Kongos, Kamerun, Senegal dhe Kongo (Brazzaville). Në grupin e vendeve që e pranojnë frëngjishten si gjuhë të komunikimit ndërkombëtar, numri më i madh i folësve të frëngjishtes janë në Algjeri, Marok, Tunizi dhe Liban. Frankofonia është një hapësirë kulturore, politike dhe ekonomike me peshë që shtrihet në pesë kontinente, përmbledh 53 shtete dhe qeveri anëtare si dhe 10 vëzhguese[7], që paraqet më shumë se 10% të popullsisë botërore- më pak se 1% e popullsisë së botës është franceze. Vendet anëtare iu takojnë të pesë kontinenteve dhe mblidhen çdo dy vjet në samitin e Frankofonisë.

Hapësira frankofone që shtrihet në pesë kontinente për më tepër është një hapësirë në zgjerim të vazhdueshëm. Dhe kjo hapësirë është gjithashtu një realitet makro-ekonomik me peshë. Pasuria ekonomike e kësaj hapësire sigurisht është e përqendruar, në 90%, në 4 vende-Franca, Kanadaja, Zvicra dhe Belgjika- por dimensioni makro-ekonomik i Frankofonisë është tashmë një realitet: 10% e popullsisë botërore; 12 % e prodhimit botëror dhe 17% e shkëmbimeve tregëtare ndërkombëtare.

Projekti frankofon, meqë është i shtrirë në pesë kontinentet, ndonjëherë shkon ndesh me dinamikat e regjionalizimit dhe formimit të blloqeve kontinentale të integruara. Nga pikëpamja gjeografike, konstatohet që shumë vende në Europën qendrore, lindore dhe në Azi aspirojnë të integrohen në frankofoni. Në Francë projekti i frankofonisë mbrohet nga partizanët e një France fuqi botërore dhe ekuilibri. "Kjo Frankofoni

[7]Më 2006, sipas sitit zyrtar të OIF (Organisation Internationale de la Francophonie).

është një nga shtyllat e kësaj France botërore. Frankofonia ofron një potencial gjeopolitik, ekonomik dhe kulturor të begatë".[8] Dhe kur Franca dyshon për veten, kur ndërtimi europian po kalon një krizë të thellë identiteti, kur shumë pyesin mbi kuptimin e mondializimit, është koha që elitat franceze të mos buzëqeshin më kur flitet për Frankofoninë.[9] Disa shtete njohin kufij të brendshëm gjuhësorë. Është rasti i shteteve anëtare të Komonuelthit ose të Frankofonisë në kontinentin afrikan (Kameruni dhe Maurice), Analiza gjeopolitke e brendshme e shteteve lidhet me faktin e vënies në dukje të vijave të ndarjes identitare dhe në përcaktimin e kufijve gjuhësorë të brendshëm.

Gjeopolitika e gjuhëve në nivel rajonal dhe nënrajonal: Rasti i Bashkimit Europian

Problemi i komplikuar i roleve të gjuhëve europiane kombëtare brenda BE-së është ndoshta pengesa më e madhe për integrimin e mëtejshëm ekonomik dhe politik Para së gjithash, është e nevojshme të mbahet në mendje pozicioni i veçantë i gjuhëve kombëtare në kulturat politike të europianëve. Historianët po mendojnë për shekullin e XIX si epokë e nacionalizmit, por është e vërtetë që shumica e shteteve-kombe europiane janë një produkt i shekullit XX dhe ky proces ndoshta nuk ka mbaruar akoma ndërsa sugjerohet prej disa lëvizjeve kombëtare në pjesë të caktuara të Europës.

Pavarësisht rrethanave, pozicioni i gjuhëve mbikombëtare në procesin e integrimit europian është edhe më i ndërlikuar për shkak të rezultateve të dobëta të politikave gjuhësore në BE. Rezultatet ndryshojnë shumë në vende të ndryshme dhe janë shumë më të mira në vende me gjuhë "të vogla" kombëtare, por statistikat tregojnë që vetëm gjysma e popullsisë së BE-së është në gjendje të komunikojë në një gjuhë të ndryshme nga gjuha amë. Pozicionin më të mirë e ka anglishtja, me 40% të folësve jo vendas në BE, e ndjekur nga frëngjishtja me 20%, gjermanishtja me 10% dhe spanjishtja me 6%.

Për të kuptuar pozitën e anglishtes në BE, është e nevojshme të theksohet se kjo është një gjuhë e cila filloi të mbizotëronte në administratën e BE-së, vetëm pas zgjerimit në vitin 1995.[10] Faktori i dytë kufizues i pozitës së anglishtes është roli "i veçantë" i frëngjishtes, nga fillimi i procesit të integrimit deri të paktën në vitin 1995,si gjuha e parë e BE-së dhe ruajtja e pozitës së veçantë kryesisht për shkak të "kryeqyteteve" të BE-së, (Brukseli, Strasburgu, Luksemburgu) janë në një zonë frankofone. Një zgjerim lindor mund të përmirësojë pozitën e anglishtes, por do të forcojë gjithashtu pozitën e gjermanishtes, tashmë gjuhë që flitet më gjerësisht si gjuhë amtare pas bashkimit të Gjermanisë dhe hyrjes së Austrisë në BE.

Diversiteti gjuhësor është një element i rëndësishëm i pasurisë së kulturës europiane, por në pikëpamjen gjeopolitike është një nga faktorët më të rëndësishëm kundrejt krijimit të një tregu të vetëm ekonomik, me një forcë pune përtejkufitare dhe kundrejt krijimit të një identiteti politik europian. Në krahasim me grupimet e tjera makrorajonale, mund të themi që BE, pa pranimin e "një politike gjuhësore të një

[8]Michel Gouillou, Francophonie puissance, coll. «Références géopolitique»Ellipses, 2005.
[9] Po aty
[10]Time International. June 24, 2002, p.47.

gjuhe të vetme zyrtare", është duke patur një shans më të vogël për krijimin e një njësie të bashkuar gjeopolitike, një shans më të vogël se, le të themi Liga Arabe.

Procesi i integrimit nënrajonal është i dukshëm mes vendeve me gjuhë të ndryshme zyrtare, veçanërisht në Europë, ku një traditë e bashkëpunimit nënrajonal është më e vjetër se procesi i integrimit europian. Rezultatet e sotme të një zhvillimi të gjatë historik janë organizata të tilla si Beneluksi, Këshilli Nordik ose Grupi i Vishegradit. Beneluksi është, në shumë aspekte, një shembull model i integrimit europian, jo vetëm në termat ekonomikë por edhe gjeopolitikë. Fundi i kontrollit të kufijve të përbashkët u realizua në 1949, shumë më shpejt se krijimi i sistemit të zonës *Shengen* brenda BE-së. Edhe tani, arsyeja kryesore gjeopolitike për ekzistencën e mëtejshme të Beneluksit është pozita e saj si *"heartland"* i BE-së. Por zonat gjuhësore brenda Beneluksit janë duke theksuar elementë të ndryshëm të një orientimi më të gjerë gjeopolitik. Për Luksemburgun dhe rajonin gjermanishtfolës të Belgjikës, objektivi kryesor gjeopolitik është të jetë një "urë" mes Francës dhe Gjermanisë. Por për Hollandën dhe Beneluksin e Flanders-it është jo vetëm një institucion që bashkon zonat hollandishtfolëse tek Vendet e Ulëta, por gjithashtu një institucion i balancimit të "trekëndëshit të fuqisë" të tre shteteve perëndimore europiane (Francë, Gjermani dhe Britani).

Europa Qendrore është ndoshta një nënrajon tradicionalisht më shumë i diskutuari në perspektivën gjeopolitike. Në një ligjërim gjeopolitik mbi këtë rajon ka teori të ndryshme Një teori është ajo sipas së cilës Europa Qendrore shërben si një "urë" mes Europës Qendore dhe Lindore, një koncept i *"Mitteleuropa"*, ose një tjetër ide se Europa Qendrore është si një "periferi" e Perëndimit.[11] Por të gjitha këto koncepte funksionojnë me rolin e rëndësishëm të një *lingua franca* e cila ndihmon në komunikimin mes popujve të nënrajonit. Gjermania është vendi që ka luajtur tradicionalisht këtë rol. Kjo nuk ka ndryshuar as me rënien e Austro-Hungarisë dhe as me ngritjen e "Perdes së hekurt". Franca nuk ishte suksesshme në përpjekjen e saj për të zëvendësuar Gjermaninë në vitet 1920-të dhe 1930-të; e njëjta gjë ndodhi edhe me rusishten gjatë epokës së Luftës së Ftohtë. Vetëm rënia e komunizmit në këtë nënrajon hapi dyert e përdorimit masiv të anglishtes. Është tepër herët që të parashikojmë që anglishtja do të zëvendësojë plotësisht rolin tradicional të gjermanishtes. Për momentin duket që kjo ka gjasa të ndodhë më shumë në disa vende të kësaj zone si Sllovenia, Republika Çeke, Polonia se në vende të tilla si Hungaria dhe Sllovakia. Edhe me këtë skenar, është e mundshme të pritet që Gjermania të qëndrojë në një pozitë të fortë në të gjitha këto vende, sidomos në zonat kufitare me Gjermaninë dhe Austrinë.

Në përgjithësi është e mundshme të themi që në një nivel nënrajonal ka shumë më shumë organizata ndërkombëtare monolinguistike ose organizata të tilla me një gjuhë kryesore të një komunikimi të ndërsjelltë se sa ka në një nivel makrorajonal. Në këndvështrimin gjeopolitik, do të thotë që në politikat globale, një bashkëpunim ndërkombëtar nënrajonal mund të jetë më i shpeshtë, më konkret dhe më i efektshëm se në nivel makrorajonal. Europa përbën një shembull të mirë në këtë rast.

[11]Hnízdo, B. (2002): Støední Evropa v geopolitických promìnách kontinentu (Central Europe in geopolitical changes of the Continent). In: Kabele, j., Mlèoch, l., Pscheidt, S. (ed.). Konsolidace vládnutí a podnikání v Èeské republice a v Evropské unii. Praha: Matfyzpress.

Është e vështirë të parashikohet që anglishtja do të pranohet plotësisht në të gjitha zonat e BE-së si gjuha kryesore e vetme e komunikimit. Kjo do të ketë si problem kryesor për BE-në, pamundësinë për të funksionuar plotësisht si një njësi plotësisht e integruar gjeopolitike në termat ekonomikë, kulturorë dhe politikë. Por disa vende të BE-së janë duke pranuar tashmë këtë rol të anglishtes, sidomos në shtetet me gjuhë "më të vogla" kombëtare. Si rezultat i qasjeve të ndryshme të rolit të anglishtes, mund të krijohet një lloj hendeku mes këtyre vendeve dhe vendeve të tjera, sidomos atyre me ambicie për gjuhët e tyre kombëtare që ato të luajnë një rol gjuhësor në një komunikim më të gjerë me BE-në.

Kemi një gjendje shumë të ndryshme nëse Europa shihet prej një perspektive nënrajonale. Në këtë nivel, ka nënrajone që janë qartësisht të dukshme të unifikuara prej një gjuhe. Nuk janë vetëm Ishujt britanikë, një Europë frankofone dhe vendesh gjermanishtfolëse, por në kategorinë e rajoneve të tilla është e mundur të përfshijmë gjithashtu Spanjën si një shtet rajonal (me Portugalinë, ku njerëzit nuk kanë vështirësi në të kuptuarit e spanjishtes), Italia, një shembull tjetër i një shteti rajonal dhe zonat hollandishtfolëse të Beneluksit. Në pjesë të tjera të Europës (Vendet Nordike, Europa Qendrore, Ballkani) një bashkëpunim nënrajonal mund të shndërrohet në krijimin e një integrimi të unifikuar gjeopolitikisht vetëm bashkë me pranimin e një lingua franca të përbashkët.

Integrimi shumë i afërt ekonomik, kulturor dhe politik nënrajonal është i mundur mes vendeve që kuptojnë në mënyrë të ndërsjellë gjuhët e njëri tjetrit. Kjo ndodh në rastin e tre vendeve skandinave, Finlandës dhe Estonisë, Republikës Çeke dhe Sllovakisë, Rumanisë dhe Moldavisë, Bullgarisë dhe Maqedonisë, por gjithashtu, ndoshta në bashkëpunimin mes vendeve të ish Jugosllavisë (Serbi, Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovinë dhe Kroaci). Rrjedhimisht, mund të parashikohet që BE, në termat gjeopolitikë, ka gjasa të jetë një kompleksitet bashkëpunimi të ndërsjellë (por gjithashtu konkurrues) të nënrajoneve brenda BE-së, më shumë se një lojtar i unifikuar në skenën globale.

Nëse në nivelin nënrajonal të politikave ndërkombëtare, gjuhët mbikombëtare luajnë një rol të kufizuar vetëm në raste të veçanta të grupimeve multilinguistike, në nivelin e shtetit-komb roli i gjuhëve mbikombëtare tradicionalisht ka qenë gjithmonë i rëndësishëm dhe vazhdon të jetë i tillë.

Gjuhët në nivel kombëtar: shqipja

Shtrirja gjeografike e shqipes

Gjuha shqipe flitet prej më shumë se gjashtë milionë njerëzish në jugperëndim të Gadishullit Ballkanik, kryesisht në Republikën e Shqipërisë dhe në vendet fqinje të cilët ishin pjesë të ish-federatës jugosllave (Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi dhe Serbi). Në Shqipëri, gjuha shqipe përdoret nga tërë popullata prej 3.087.159 banorëve (regjistrimi i prillit 2001), duke përfshirë edhe disa pakica etnike dygjuhësore (grekë, romë, sllavë).

Në Kosovë, ku ende nuk ka statistika të sigurta, gjuha shqipe flitet nga pothuajse tërë popullata prej rreth dy milionë banorëve, duke përfshirë disa pakica dygjuhësore: boshnjakë, goranë, turq, kroatë, romë dhe ashkali. Në kohën e Jugosllavisë, serbët etnikë të Kosovës (tani rreth pesë përqind e popullsisë), në një masë të madhe, nuk

mësonin ose flisnin shqip, por qëndrimi i tyre mund të ndryshohet me zbutjen e emocioneve dhe problemeve etnike.

Llogaritet se në Republikën e Maqedonisë ka rreth një gjysmë milion shqiptarë, d.m.th. rreth njëzetepesë përqind e popullsisë së përgjithshme, megjithëse nuk ka statistika të sigurta. Popullsia shqiptare gjendet në Shkup dhe rreth tij ku është pakicë, në Kumanovë dhe, në veçanti, në Maqedoninë perëndimore nga Tetova, Gostivari dhe Dibra deri në Strugë, ku është shumicë.

Në Malin e Zi gjendet një pakicë shqiptare prej rreth 50.000 personash, kryesisht afër kufirit shqiptar (Ulqin, Tuz, Guci). Ka gjithashtu të paktën 70.000 deri 100.000 shqiptarë në jug të Serbisë, kryesisht në Luginën e Preshevës, afër kufijve të Maqedonisë dhe të Kosovës.

Në Greqi, ka ngulime të vjetra të dialektit çam në Epir (Pargë dhe Gumenicë). Me gjithë luhatjet e kufirit dhe shpërnguljet për në Shqipëri, mund të ketë ende deri 100.000 shqiptarë në këtë rajon, megjithëse janë të greqizuar në masë të madhe. Në Greqinë qendrore, gjuha shqipe, e njohur këtu si arbërisht dhe në greqisht si arvanitiká, mbijeton në rreth 320 fshatra, kryesisht në Viotía (Boiotía), veçanërisht rreth Levadhiasë, në jug të ishullit Évia (Euboia), Atikë, Korinth, dhe në veri të ishullit Andros. Këtu jetojnë pasardhësit e migrantëve shqiptarë të cilët erdhën në Greqi në Mesjetën e vonshme. Nuk ka statistika të sigurta për ata. Shqipja që flitet këtu është mjaft konservatore si dialekt.

Në jug të Italisë ka një pakicë të vogël por të qëndrueshme shqipfolëse që quhet arbëreshët. Ata janë pasardhësit e refugjatëve të cilët ikën nga Shqipëria pas vdekjes së Skënderbeut, në vitin 1468. Janë rreth 90,000 persona dhe jetojnë kryesisht në fshatrat malore të Kosenzës në Kalabri dhe rreth Palermos në Siçili. Arbëreshët flasin një variant mjaft arkaik të shqipes, i cili ndryshon dukshëm nga shqipja që flitet në Ballkan, kështu që komunikimi me ata bëhet i vështirë nëse arbëreshët nuk dinë gjuhën standarde.

Ngulime të vjetra shqiptarësh gjenden edhe në vendet e tjera të Ballkanit: në fshatin Arbanasi në jug të Zarës në bregdetin kroat, në disa fshatra të Sanxhakut dhe në krahinën kufitare mes Bullgarisë, Greqisë dhe Turqisë, në mënyrë të veçantë në fshatin bullgar Mandrica. Ka edhe disa fshatra shqiptare, kryesisht të asimiluara, në Ukrainë, në krahinat e Metropolit dhe të Odesës. Nga kolonitë e dikurshme të shqiptarëve në Perandorinë Osmane ka mbetur pak. Pakica shqiptare në Egjipt u shpërbë, por ka ende bashkësi të dukshme shqiptarësh në Turqi (Stamboll, Bursa dhe gjetiu) dhe në Siri, kryesisht Damask. Që prej fundit të viteve 1980 në Kosovë dhe që prej hapjes së Shqipërisë në vitet 1990-1991, shumë shqiptarë kanë emigruar në vende të tjera, kryesisht në Greqi dhe në Itali. Sot ka shumë shqipfolës në Europën perëndimore, veçanërisht në Gjermani, Zvicër, Skandinavi dhe Londër, si dhe në Amerikën e Veriut (Nju Jork, Boston, Detroit, Toronto).

Ndalimi i shkrimit të gjuhës shqipe si instrument i shpërbërjes së identitetit "shqiptar"

Gjeopolitikani francez Zhak Ansel (Jacques Ancel) vëren që në Europën e shekullit XIX-, gjuha luajti një rol përcaktues në ndërtimin e kombeve të reja. Ky ishte edhe

rasti i Shqipërisë, së vendosur në ndikimin e përbashkët të zonave latine, greke dhe turke dhe që e bazoi veçantizmin e saj kombëtar në një gjuhë shqiptare origjinale.[12]

"Një popull jeton tek gjuha e vet" thotë një proverb hungarez. Nga gjithë gjuhët e Gadishullit të madh Ballkanik, gjuha shqipe, është e vetmja, shkrimi i së cilës u ndalua për pesëqind vjet. *Unë nuk di ndonjë vend tjetër në kontinentin europian,- thotë* Ismail Kadare[13] *gjuha e të cilit të ketë pësuar një tmerr të tillë. Përse? Si u gjykua më pas, përse nuk ndryshoi me kalimin e shekujve, si vazhdoi gjer në fund, në çastet kur perandoria plakë po jepte shpirt?* Shqiptarëve u lejoheshin shumë gjëra: u lejoheshin kishat, pronat, gradat e larta në ushtri e në administratë, madje posti i kryeministrit perandorak, që ata e patën disa herë, por nuk iu lejua kurrë një gjë: shkrimi i gjuhës shqipe. Ky ishte një ndalim i vërtetë, dramatik e pa kthim. Në kronikën botërore të arsimimit, nuk besoj se gjenden raste kur mësues e vocërrakë, të kapur tek mësonin në fshehtësi shkrimin e gjuhës, masakroheshin aty për aty pa mëshirë dhe pa pendim.

Por, pikërisht në atë kohë, shtysa e vetëruajtjes rivuri në veprim një mekanizëm të vjetër: letërsinë gojore. Lart në male, atje ku kishte mbetur ende një mugullimë drite, makina e lashtë u trand përsëri. Kishte qenë përherë aty, por disi jashtë vëmendjes, sidomos qysh nga koha që shqiptarët kishin mësuar të shkruanin, madje të botonin edhe libra në gjuhën latine, si gjithë europianët e ditur. (Njëri prej tyre, prifti shkodran, Marin Barleti, qe përkthyer ndërkaq në krejt gjuhët e Europës). Pra, makina kishte qenë aty, veç tani, në ditët e apokalipsit, u duk se sa shumë i duhej këtij vendi.[14] Dhe Kadare i kthehet përsëri këtij veprimi unik në Perandorinë Otomane: ndalimi i shkrimit të gjuhës shqipe, duke kujtuar simbolikën e shpëtimit që gjuha e popullit shqiptar që vërtet nuk ishte më e gjallë, por pa të cilën nuk mund të përfytyrohet qytetërimi europian.[15]

Gjeopolitika e "hierarkisë gjuhësore" përballë shqipes sot

Zotërimi i një gjuhe të huaj në të gjitha kohërat ka qenë një përparësi për individët dhe nga kjo nuk bën përjashtim as shoqëria shqiptare. Kontaktet me pushtuesit, shërbimi ushtarak, punësimi sezonal në vendet fqinje dhe emigrimet kanë qenë disa nga faktorët përgjegjës për dygjuhësinë shqip-gjuhë e huaj. Kurse njëgjuhësia ka qenë kurdoherë një përjashtim dhe karakteristikë e shoqërive të mbyllura. Kur flitet për dygjuhësinë, duhet bërë dallimi midis dygjuhësisë individuale (të kultivuar) dhe dygjuhësisë kolektive. Ndërsa dygjuhësia kolektive është karakteristike për pakicat etnike-gjuhësore apo për zonat kufitare, dygjuhësia individuale varet kryesisht nga politikat gjuhësore të shtetit. Edhe tek ne dygjuhësia individuale ka qenë nxitur nga shteti, duke futur në shkollë mësimin e detyruar të gjuhëve të huaja. Sigurisht, lloji i gjuhës së huaj në këtë dygjuhësi individuale ka ndryshuar shumë. Në gjysmën e parë të shekullit të kaluar, në vend të parë qe italishtja; në gjysmën e dytë të tij deri aty

[12]Aymeric Chauprade, Géopolitique, Constantes et changements dans l'histoire, Ellipses, p. 276.

[13] Ismail Kadare *"Letërsia e gjuhës së ndaluar", lexuar në Universitetin e Palermos, me rastin e dhënies së titullit Doctor Honoris Causa.* Ismail Kadare, ibid. Hylli i Dritës", gusht 2009

[14] Ismail Kadare, ibid. Hylli i Dritës", gusht 2009.

[15]Ismail Kadare, ibid.

nga fillimi i viteve ‘70 vendi i parë i takoi rusishtes, që pastaj filloi të mënjanohej nga anglishtja e frëngjishtja. Pas 1990-ës, kjo paradigmë ka ndryshuar dukshëm.

Siç del nga anketimi i të rinjve, disa gjuhë kanë humbur dukshëm, si rusishtja e frëngjishtja, kurse disa të tjera si anglishtja, italishtja e greqishtja janë bërë të pëlqyera. Kështu, sipas të dhënave të Eurobarometrit (1995), në 1000 të rinj të anketuar, 29% flitnin italisht, 22% anglisht, 7% frëngjisht dhe 6% greqisht. Në studimin “Rinia postkomuniste shqiptare”, të kryer nga Qendra Sociologjike EUREKA, nga 2600 të rinj të pyetur, 47% preferonin anglishten, 34,6% italishten, 10,3% gjermanishten, 5,3% frëngjishten dhe 1,5% greqishten. Të dhëna pak më të ndryshme kanë dalë nga një anketim tjetër, i kryer në po ato vite, i 697 të rinjve lidhur me gjuhët e huaja që kuptonin dhe flitnin, sipas të cilit vendin e parë e zinte italishtja me 40,3%, pastaj anglishtja me 38,5%, frëngjishtja me 10%, greqishtja 3,6% dhe gjermanishtja 1%.

Në kushtet e integrimit mbareuropian, mësimi i gjuhës së huaj po fiton një përmasë të re. Kjo është arsyeja pse trajtimi i këtij problemi zë një vend të rëndësishëm në shumë konventa e dokumente të BE-së, të KE-së, të OSBE-së dhe të shumë organizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kështu, “Letra e Bardhë mbi Arsimin dhe Edukimin” (1995) e Bashkimit Europian, në kreun IV të saj “Zotërimi i tri gjuhëve të huaja” thotë: “Zotërimi i disa gjuhëve të Bashkimit Europian është bërë një kusht paraprak që qytetarët e BE-së të përfitojnë nga mundësitë vetjake dhe të punësimit që iu janë hapur në tregun unik dhe pa kufij. Ky zotërim i gjuhës duhet të rezultojë në aftësinë për t’iu përshtatur kushteve të punës dhe të jetesës në kultura të ndryshme. Gjuhët janë gjithashtu çelësi për t’u njohur me të tjerët. Zotërimi i gjuhëve ndihmon për formimin e ndjenjës së të qenit europian, me gjithë diversitetin dhe pasurinë e saj kulturore dhe të kuptimit midis qytetarëve të Europës…

Në përputhje me rezolutën e datës 31.3.1995 të Këshillit të Ministrave të Arsimit të BE-së, për këdo po bëhet e domosdoshme, pavarësisht nga rrugët e zgjedhura për arsimin dhe edukimin, të fitojë dhe të ruajë aftësinë për të komunikuar të paktën në dy gjuhë të BE-së, veç gjuhës së tyre amtare… Me qëllim që të arrihet zotërimi i tri gjuhëve të BE-së, është e dëshirueshme që mësimi i gjuhës së huaj të nisë që në arsimin parashkollor. Por një mësim i tillë është e domosdoshme që të bëhet në baza sistematike në arsimin fillor, me nxënien e një gjuhe të dytë të huaj të BE-së në shkollë të mesme. Mund të mos duket e pamundur që nxënësit e shkollës së mesme të studiojnë disa lëndë në gjuhën e parë të huaj. Me mbarimin e shkollës së mesme kushdo duhet të zotërojë rrjedhshëm dy gjuhë të huaja të BE-së.”

Ky dokument, të cilit duhet t’i përmbahet edhe Shqipëria si vend kandidat për t’u anëtarësuar në Bashkimin Europian, e bën më se të qartë se ç’gjuhë të huaja duhen mësuar dhe ç’politika duhen ndjekur për nxënien e tyre gjatë viteve të arsimit parauniversitar. Ai nuk lë vend për improvizime apo parapëlqime individësh. Mbi bazën e këtij dokumenti duhen ndërtuar edhe politikat gjuhësore të shtetit tonë lidhur me gjuhët e huaja që duhen mësuar në shkollë dhe numrin e këtyre gjuhëve.

Ndër gjuhët ndërkombëtare, pa dyshim që përparësi duhet të ketë anglishtja, që duhet të jetë gjuhë e parë e huaj (L1), mësimi i së cilës duhet filluar që në arsimin parashkollor. Gjuhët e tjera ndërkombëtare duhet të jenë gjuhë të dyta (L2), kurse gjuhët e fqinjëve, si italishtja, greqishtja apo edhe gjermanishtja duhet të jenë gjuhë

L3, të cilat në zonat kufitare me këto vende mund të jenë L2, d.m.th. të ndërrojnë vend me gjuhët ndërkombëtare L2, po në asnjë rast nuk mund të jenë L1. Ky pozicionim do t'iu priste rrugën edhe mëtimeve të ndonjë vendi për një status më të lartë të gjuhës së tij, qoftë edhe në zona të veçanta. Politika të tilla afatgjata, të ndërtuara mbi bazën e legjislacionit të BE-së dhe në konsultim me specialistët e fushës, duhen ndërtuar edhe për arsimin universitar dhe atë pasuniversitar. Ato do t'i jepnin edhe Ministrisë sonë të Arsimit mbështetjen ligjore në zbatimin e tyre në praktikë.[16]

Përfundime

Në përfundim mund të theksojmë që përdorimi dhe përhapja e gjuhëve përbën një tregues të besueshëm të proceseve gjeopolitike. Ky përdorim mund të hulumtohet në lloje të ndryshme gjuhësh, në një perspektivë gjeopolitike të gjuhëve. Gjuhët e shpërndara, gjuhët rajonale, gjuhët kombëtare ose gjuhëve mbikombëtare, secila prej tyre tregojnë dhe reflektojnë dinamizmin gjeopolitik të politikave globale. Por roli më i dukshëm është luajtur nga gjuhët mbikombëtare, sidomos në proceset e integrimit politik në nivel nënrajonal, makrorajonal ose politikat ndërkombëtare.

Një rol unik luhet nga gjuhët globale, anglishtja dhe, në një masë më të vogël, frëngjishtja. Këto gjuhë, ashtu si gjuhë të tjera mbikombëtare, po ndihmojnë në thellimin e integrimit kulturor, ekonomik dhe politik mes shteteve të populluara prej folësish së të njëjtës gjuhë, por mund të funksionojë gjithashtu si një faktor "çimentimi" për proceset integruese në rajone, ku këto gjuhë nuk fliten gjerësisht si gjuhë amtare. Anglishtja po luan këtë rol në nivel makrorajonal, p.sh.në nënkontinentin Indian ose në Azinë Juglindore ashtu sikurse në një nivel nënrajonal në Afrikën Jugore apo në vendet nordike. Frëngjishtja luan një rol të ngjashëm, p.sh. në Afrikën perëndimore ose Ekuatoriale. Të dyja gjuhët mund të jenë madje një komponent i identitetit nënrajonal të disa grupimeve më të mëdha monolinguale, pasi është i dukshëm roli i anglishtes në shtetet e Gjirit ose në rastin e frëngjishtes në Magreb.

Globalizimi në termat ekonomikë, kulturorë dhe politikë nuk do të thotë një thellim i prirjes drejt uniformitetit gjuhësor. Për shkak të prirjeve demografike dhe për shkak të proceseve të rajonalizmit në politikat globale, roli gjeopolitik i gjuhëve të tjera jo globale mbikombëtare është vetëm në rritje. Kjo është e vërtetë sidomos për rolin e gjuhëve të tilla si gjuha mandarin, indiane, spanjishte ose arabishte.Globalizimi është gjithashtu i lidhur më shumë me bilingualizmin sesa me monolingualizmin, i cili ishte, në perspektivën gjeopolitike, një produkt i krijimit të sistemit të shtetit-komb dhe produkt i nacionalizmit dhe imperializmit. Decentralizimi i fuqisë politike brenda një shteti-komb, si bashkëprodukt i procesit të integrimit mbikombëtar të politikave globale, nxitja e bilingualizmit rajonal, për shkak të përdorimit dhe njohjes së një gjuhe lokale si dhe një gjuhe mbikombëtare është në shumë rajone të botës e rëndësishme për identitetin politik të qytetarëve po aq sa përdorimi dhe njohja e gjuhës "kombëtare" në vetvete.

Qeveritë që dëshirojnë të luajnë pjesën e tyre në ndikimin e të ardhmes gjuhësore të botës duhet t'i peshojnë vendimet politike dhe shpërndarjen e burimeve për

[16] *Prof.* Dr. *Rami Memushaj*, *Politikat gjuhësore në epokën e globalizimit*, Gazeta Shqip, 2012-02-19.

planifikimin gjuhësor. Tani, më shumë se kurrë, në historinë gjuhësore, ata duhet të miratojnë platforma afatgjata dhe të planifikojnë paraprakisht nëse interesat e tyre janë për promovimin e gjuhëve apo për zhvillimin e përdorimit të gjuhëve të tjera në komunitetin e tyre. Nëse ky shans gjuhësor nuk shfrytëzohet siç duhet, mund të mos ofrohet më asnjë tjetër.

Gjuha, duke qenë mjeti themelor për shprehjen e kulturës, përbën edhe një nga përmasat themelore të saj. Roli i gjuhës rritet edhe më shumë në kuadrin e integrimit europian. Por, në kushtet e një shoqërie të hapur, gjuha ndodhet para të njëjtave rreziqe dhe probleme si edhe kultura që ajo bart. se hallkat shtetërore përgjegjëse ende nuk janë ndërgjegjësuar për domosdonë urdhëruese të hartimit të politikave të tilla dhe të legjislacionit përkatës që do ta mbronin gjuhën shqipe nga trysnia e gjuhëve të huaja brenda kufijve politikë si dhe jashtë tyre, në trojet etnike e në diasporë, ku shqipja ndodhet në kontakt me gjuhë të ndryshme, që do t'i siguronin asaj të paprekur statusin e gjuhës së parë brenda kufijve shtetërorë dhe që do të ndihmonin shtetin shqiptar për t'u përpjekur për t'i siguruar shqipes një status të pranueshëm atje ku ajo është gjuhë në kontakt. Dhe jo vetëm që nuk po punohet për hartimin e politikave gjuhësore adekuate për një shoqëri të hapur, por nuk njihet as legjislacioni europian e ndërkombëtar për problemet e gjuhës amtare e të pakicave, ndonëse është përkthyer pothuajse i tëri dhe është botuar nga Këshilli i Europës.

Bibliografia:

- Chauprade, F. Thual, Dictionnaire de géopolitique, 2e ed., Ellipses, 1999.
- P. Renouvin, Histoire des relations internationales, Paris, Hachette, 1957, t. VII, Les crises du XXe siècle, I, De 1914 a 1929. « Le règlement de la paix ».
- Y. Lacoste, Dictionnaire de géopolitique, Paris, Flammarion, 1993, articles Papouasie-Nouvelle Guinée, et papous (peuples et langues).
- Bailey, Richard W. 1991. Images of English: a cultural history of the language. Cambridge: Cambridge University Press.
- Kachru, Braj. 1988. The sacred cows of English. *English Today* 16, 3-8.
- Chauprade, L'espace économique francophone, Paris, Ellipses, 1996.
- Michel Gouillou, Francophonie puissance, coll. « Références géopolitique ». Ellipses, 2005.
- Hnízdo, B. (2002): Støední Evropa v geopolitických promìnách kontinentu (Central Europe in geopolitical changes of the Continent). In: Kabele, j., Mlèoch, l., Pscheidt, S. (ed.). Konsolidace vládnutí a podnikání v Èeské republice a v Evropské unii. Praha: Matfyzpress .
- Aymeric Chauprade, Géopolitique, Constantes et changements dans l'histoire, Ellipses.
- Ismail Kadare *"Letërsia e gjuhës së ndaluar"*, Hylli i Dritës", gusht 2009.
- *Prof.* Dr. *Rami Memushaj* **,** *Politikat gjuhësore në epokën e globalizimit.* Gazeta Shqip, 2012-02-19.

Roli i lidershipit në kuptimin e zbatimin e procesit gjinor në Forcat e Armatosura

Kolonele (R) MSc Suzana Jahollari,
Pedagoge në Departamentin e Lidershipit
dhe Shkencave Shoqërore, AFA

MSc. Mentor Isufaj,
Programi i Doktoraturës, 2011-2014, AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Nisur nga opinioni i shprehur nga Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Admiral Giampaolo di Paola, që procesi gjinor është një aset për të përmirësuar efektivitetin operacional dhe që është një forcë e shumëfishtë që ndihmon të fitojnë zemrat e mendjet, lind natyrshëm detyrimi i të kuptuarit më drejt të këtij procesi. Ai shton që "Gjinia është një koncept i zgjeruar i cili ndihmon të kuptojnë strukturat lokale ku forcat e NATO-s operojnë. Në një kontekst të tillë, perspektiva gjinore duhet të arrihet si një komponent kyç i Konceptit Strategjik të NATO-s"* [1]

Së bashku, këto qëndrime theksojnë rëndësinë e njohjes së perspektivës gjinore, sidomos 10 vjet pas adaptimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së "Për Gratë, Paqen e Sigurinë".

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Grave, Mars 2013, Përfaqësuesja Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm, për Gratë, Paqen e Sigurinë, Mari Skaare, iu përgjigj pyetjeve për implementimin e UNSCR 1325 në Aleancë dhe në misionet e saj, specifikisht në Afganistan. Mari Skaare flet për rolin e femrave ushtarake, praninë e femrave në vendimmarrje dhe angazhimin afatgjatë të NATO-s për çështjet gjinore në Afganistan. Asaj iu bënë tridhjetë pyetje nga përfaqësues të dhjetë vendeve të ndryshme të botës. Përfaqësuesja Speciale Skaare zgjodhi pesë pyetje që trajtonin më gjerësisht çështjen dhe paraqiti përgjigjet e saj në Ditën Ndërkombëtare të Grave. Paraqiti gjithashtu një video për çdo pyetje përgjigje; Është interesante të njihet pikëpamja e saj për pyetjen e bërë nga unë, në emër të FA të RSH për rolin e ndryshimit të mentalitetit të meshkujve por edhe të femrave, sidomos nëpërmjet rolit të lidershipit në këtë proces.

[1] NATO, *The NCGP Conference*, May 2010.

Sfidat e sigurisë sot kërkojnë jo vetëm përgjigje ushtarake

Në 27 janar 2010, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, *Anders Fogh Rasmussen*, deklaroi: "Ne duhet, jo vetëm të integrojmë çështjet gjinore në planëzimin e operacioneve tona, por edhe të punojmë aktivisht të zhvillojmë mundësitë tona në këtë fushë. Fuqizimi i mëtejshëm dhe mbrojtja më efektive e grave ndaj rreziqeve specifike me të cilat ato përballen në konfliktet e armatosura, është në përfitim jo vetëm të femrave, por të të gjithëve ne. Është një komponent i rëndësishëm për të siguruar përballjen me sfidat e shekullit të 21-të".[2]

Sfidat e sigurisë sot kërkojnë jo vetëm përgjigje ushtarake. Në situatën globale e komplekse të sigurisë, suksesi i operacioneve ushtarake për të menaxhuar situatat e krizave dhe pas krizave, kërkon aftësi të shumta, të ndryshme dhe përvoja. Femrat duhen konsideruar si pjesëmarrëse aktive të FA dhe në situatat konfliktuale e të krizave. Theksimi në mendje se në operacionet në mbështetje të paqes dhe në të gjitha stadet, përcaktimi i detyrave, planëzimi, implementimi, monitorimi dhe vlerësimi i politikave dhe programeve, nuk duhet të lërë jashtë pesëdhjetë përqind të popullsisë, vë detyrimisht theksin te roli i të kuptuarit të këtij procesi të rëndësishëm, sidomos nga drejtuesit. Në të gjithë aktorët e vendimmarrjes, femrat duhet të llogariten për të dhënë kontributin e tyre në procesin e ndërtimit, stabilizimit dhe në sigurinë e ambientit.

Pikëpamja e dhënë në Shtabin e NATO-s në Bruksel, nga Përfaqësuesja Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm, për Gratë, Paqen e Sigurinë, *Mari Skaare*, për pyetjen e bërë nga ana ime, në emër të FA të RSH, për rolin e ndryshimit të mentalitetit të meshkujve por edhe të vetë femrave në procesin e perspektivës gjinore në FA, është e rëndësishme të kuptohet e të zbatohet në praktikë.

Pyetja ishte: "Rëndësia e rritjes së numrit të femrave në FA është njëra anë e diskutimit për çështjen gjinore në ushtri. Por një aspekt shumë i rëndësishëm është ndryshimi i mentalitetit tek personeli ushtarak, së bashku femra e meshkuj, nëpërmjet rolit të lidershipit dhe të vendimmarrësit. Si mund të arrihet kjo?"[3]

Përgjigja e saj ishte se "Bota ushtarake, tradicionalisht, ka qenë e dominuar nga meshkujt, megjithëse hendeku gjinor duket se po ngushtohet ngadalë. Ne duhet të përmirësojmë sistemin tonë të raportimit brenda NATO-s, por shifrat tregojnë se në disa ushtri të vendeve të NATO-s përqindja e femrave është njëzetë përqind, ndërsa në disa të tjera është në përqindje të ulët. Megjithatë nuk është çështje thjesht shifrash. Mentaliteti i njerëzve është themelor për të integruar me sukses një perspektivë gjinore në veprimtarinë e përditshme, në strukturat ushtarake dhe në strukturat civile. Rritja e ndërgjegjes është sfidë, por dhe hap themelor për të arritur rezultate. Dhe që të arrihet kjo është i rëndësishëm trajnimi e arsimimi i lidershipit politik. Dhe NATO po tregon lidership politik. Në Samitin e Çikago-s dhe në Lisbonë, kryetarët e shteteve dhe qeverive bënë një deklaratë të fortë politike dhe angazhim në kontributin e NATO-s për gratë, paqen e sigurinë dhe axhendën e sigurisë. Angazhimi i Sekretarit të Përgjithshëm është i madh dhe kjo është e rëndësishme."[4]

[2] NATO, *Incorporating a gender perspective in to the NATO crisis response and operations planning processes*, 2012.

[3] S. Jahollari, FARSH 8.03.2013 Atlantic-Comunnity.org, NATO Mari Skaare

[4] 2013 Atlantic-Comunnity.org, NATO Mari Skaare

Aleanca nuk ka drejtpërdrejt autoritet për masat trajnuese dhe zhvillimet në nivel kombëtar, por kërkon që personeli që shkon në mision dhe në operacione të NATO-s, të jetë i trajnuar, arsimuar dhe me edukimin me sjellje sipas standarteve për çështjet e gjinisë, perspektivës gjinore në FA dhe rolit që ato luajnë në operacionet e NATO-s Ndryshimi i mentaliteteve është një proces i gjatë, por sinjale pozitive duken që të ketë optimizëm në këtë drejtim, veçanërisht për të ardhmen. Sot ka modele të rolit të meshkujve dhe avokatë të të drejtave të barabarta dhe mundësive për femrat e meshkujt edhe në sektorin e sigurisë. Femrat dhe meshkujt janë aleatë në këtë betejë.

Gjinia i referohet ndryshimeve shoqërore ndërmjet burrave e grave. "Gjinia, e shoqëruar me problemet etnike, moshën, klasën shoqërore, fenë dhe faktorë të tjerë shoqërorë, përcakton rolet dhe fuqinë për femrat e meshkujt në çdo kulturë dhe lidhjet midis femrave e meshkujve."[5]

Rolet gjinore janë trajtuar shpesh më shumë si të përcaktuara biologjikisht, por gjithsesi rolet gjinore kanë thellë rrënjët në kulturën e një vendi, ato gjithashtu ndryshojnë në kohë dhe kanë një variacion të gjerë brenda dhe midis kulturave. Historikisht, vëmendja për lidhjet gjinore është drejtuar nga nevoja për të plotësuar nevojat e veçanta dhe mundësitë për femrat, krahasuar me meshkujt. Megjithatë në rritje ka qenë edhe konsiderata se është e rëndësishme dhe njohja e nevojave dhe roleve të meshkujve në çdo kulturë apo organizim. Nëpërmjet vetëvlerësimit gjinor, bëhet analiza e problemeve gjinore. Kjo do të thotë të mbledhësh dhe të analizosh informacionin për femrat dhe meshkujt, duke përfshirë rolet e tyre shoqërore dhe aksesin e tyre në kontrollin e burimeve. Për sektorin e sigurisë, një analizë gjinore është një proces i mbledhjes së informacionit për tipe të ndryshme të pasigurisë që kërcënojnë gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë dhe se si secili nga këto grupe ndërvepron me institucionin. Analiza gjinore është e domosdoshme për procesin gjinor.

Procesi gjinor, thjesht kupton vlerësimin e implikimeve për femrat dhe meshkujt në një plan veprimi, konsideron një fushatë të re rekrutimi, një ndryshim në politikat e burimeve njerëzore dhe në direktivat operacionale. "Procesi gjinor është një strategji për t'i bërë shqetësimet e përvojat e femrave aq sa edhe të meshkujve, një dimension përbërës për çdo veprim, zbatim, monitorim dhe vlerësim të çdo nisme. Kështu meshkujt dhe femrat përfitojnë njëlloj dhe pabarazia nuk lejohet. Objektivi përfundimtar është të arrihet barazia gjinore."[6]

Përcaktimi se një përgjigje gjinore e institucioneve të sigurisë si një nga arritjet për nevojat e ndryshme të sigurisë për burrat, djemtë, gratë e vajzat dhe promovim të plotë dhe pjesëmarrje të barabartë për femrat e meshkujt vlen të konsiderohet. Përcaktimi për një përgjigje gjinore të institucioneve të sigurisë si një nga arritjet për nevojat e ndryshme të sigurisë për burrat, djemtë, gratë e vajzat dhe promovim të plotë dhe pjesëmarrje të barabartë për femrat e meshkujt, vlen të konsiderohet. Ajo ka proceset e identifikimit të nevojave të veçanta të grupeve të ndryshme, femra e meshkuj brenda komunitetit. Kërkon ndërmarrjen e hapave për të arritur këto nevoja,

[5] Valasek, K., *Securing Equality, Engendering Peace: Policy and Planning on Women, Peace and Security, Santo Domingo*: UN-INSTRAW, 2006.

[6] *Report from the UN Economic and Social Council for 1997*. A/52/3, 18 September 1997.

monitorim dhe vlerësim të impaktit. Të kuptuarit se bashkë, personeli femra e meshkuj, janë vlerësuar, promovuar dhe mbështetur në balancimin e përgjegjësive profesionale e familjare është domethënës. Për ta bërë sa më produktive përgjigjen institucionale gjinore duhen ndërmarrë hapa për politika gjinore, rishikimin e praktikave të rekrutimit dhe të përshkrimit të detyrës, trajnim për çështjet gjinore dhe hartimin e një plani veprimi gjinor.

Objektiva të thjeshta për vetëvlerësimin gjinor në FA janë: identifikimi i barrierave që pengojnë pjesëmarrjen e femrave në misione paqeruajtëse dhe strategjitë për t'i kapërcyer ato.

"Ne duhet të hartojmë sot Planin e Veprimit për UNSCR 1325 për menaxhimin e krizave të tanishme dhe të ardhme, në planëzimin operacional, në doktrinën e trajnimit të Aleancës dhe në të gjitha aspektet e detyrave të saj. Ne jemi të angazhuar për implementimin e kësaj Politike dhe Plani Veprimi si një pjesë përbërëse e punës, për të përmirësuar efektivitetin e Aleancës."[7]

Në FA të RSh është miratuar Urdhëri i MM Nr. 405, datë 04.03.2013 "Për ngritjen e Grupit të Punës për Implementimin e Projektit Studimor: Guidë vetëvlerësimi për barazinë gjinore në FA. Është organizuar puna me tre faza. Në fazën e parë: veprimi në terren për grumbullimin e informacionit, sipas programit të miratuar për projektin e Vetëvlerësimit Gjinor në FA. Faza e dytë është përpunimi dhe analiza e informacionit. Faza e tretë është draftimi i raportit përfundimtar. Në Fazën e I u realizua procesi i shqyrtimit të dokumenteve: ligjet, politikat, planifikimi; trajnimi, kurset, kualifikimet; personeli, karriera; marrëdhëniet me komunitetin. Në pjesën *intervista* u konsideruan: efektiviteti i performancës, llogaridhënia dhe mbikëqyrja, kultura institucionale, platforma për përfaqësimin e femrave në FA. Në pjesën *fokus grupet* u shqyrtuan: efektiviteti i performancës, marrëdhëniet në komunitet, kultura institucionale, anketimi.

Trajnimi për çështjet gjinore për trupat para se të shkojnë në misione duhet të përmbajë: përkufizimin e konceptit proces gjinor; të kuptuarin e konceptit proces gjinor; të kuptuarin e diversitetit, mundësive të barabarta, ndryshimeve gjinore, roleve gjinore, barazisë gjinore, perspektivës gjinore.

Një shembull se si analizohet, në funksionet ushtarake, problemi gjinor:
*J1*i përgjigjet çështjeve të tilla si: A ka trajnim të personelit që shkon në mision për problemet gjinore, para nisjes dhe a ka staf gjinor të trajnuar? A ka femra mjaftueshëm në shërbim në FA, të trajnuara, të cilat mund të përzgjidhen për të vajtur në mision, në specialitete si përkthyese, mjekësi, punë kërkimore në fushën gjinore, psikologe, femra civile e ushtarake të angazhuara drejtpërdrejt në njësitë bazë në terren? A ka trajnim të ushtarëve, nëse kanë marrë njohuri e trajnim për problemet gjinore dhe për standartet e sjelljes në zonë?

J2 i përgjigjet pyetjeve për të patur femra të shërbimit të tyre të trajnuara, sa femra ka si përkthyese, për rëndësinë e të kuptuarit të angazhimit e kontaktimit me femrat e zonës, për qëllime të marrjes së informacionit.

[7] NATO, *The NCGP Conference How can gender make the difference to security in the operations-indicators,* 2011.

J3 i përgjigjet pyetjeve të tilla për të kuptuarit e rolit të femrës në shoqëri, të kuptuarit e rolit të kulturës e të fesë në shoqëri në lidhje me femrat, a ka parashikim të veprimeve operacionale, duke pasur si objekt femrat. Detyra në patrullim për përfshirjen e femrave në skuadrat e patrullimit, a ka të tilla, me qëllim kërkimi, për të moderuar sjelljen e trupave, për angazhimin e komunikimin me femrat e zonës. Në rolin e policisë ushtarake, të kërkojë kuptimin e procedurave të raportimit për femrat lokale të abuzuara, për të kuptuarit e rolit që kanë për bashkëpunimin e mbështetjen me Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve, rëndësinë e detyrës që kanë për të zbuluar rastet e abuzimit ndaj femrave lokale. Përsa i përket kontraktimit, duhet të konsiderohen si kontraktues femrat lokale për aktivitete tregtare.

J4 të sigurojë se femrat e shërbimit të mjekësisë janë pjesë e forcës dhe t'i përdorojë/vërë në shërbim ato në aktivitetin mbështetës.

J5, për çarmatimin dhe riintegrimin, të sigurohet që femrat të jenë pjesë e programeve mbështetëse si dhe meshkujt për shtëpi, arsimim, trajnim; të sigurohet a ka femra përkthyese dhe femra që kanë shërbyer më parë në njësi luftimi. Të dijë të marrë masa për trajnimin e femrave lokale për ushtare e police, për akomodimin e tyre. Për negociatat pas konfliktit, duhet të angazhohen femra në to. Për personat e shpërngulur dhe refugjatët, a janë kampet të sigurtë për femrat, a janë kampet të mbrojtur, a kanë ujë, ushqim, etj.

J7 i përgjigjet pyetjeve të tilla që në raportimet të përfshihen dhe raportime për të drejtat e njeriut, për trajtimin e femrave, zbatimin e ligjeve për femrat dhe meshkujt, a është bërë trajnim para shkuarjes në mision të trupave dhe, nëse është e nevojshme, trajnim dhe gjatë shkuarjes së trupave në mision e operacion.

J8: A janë parashikuar në buxhet fonde për mbrojtjen e femrave lokale të angazhuara?

J9: Për bashkëpunimin civilo-ushtarak, të sigurohen që organizatat e shoqërisë civile përfaqësojnë interesat e femrave dhe që janë të përfshira në bashkëpunimin civilo-ushtarak, nismat e femrave të jenë njëlloj të konsiderueshme si dhe nismat tradicionale.

Analiza e bërë në planëzimin e Forcës së Bashkuar, paraqet katër faza:

Faza e parë paraqet gjendjen dhe situatën.

Faza e dytë bën vlerësimin e situatës; krahas gjithë këshillimeve, çfarë këshillimi duhet bërë për problemet gjinore, çfarë rekomandimi duhet të jepet?

Në Fazën e tretë, bazuar në përshkrimin e situatës, jepen opsionet e përgjigjeve për situatën, duke parashikuar dhe informacionin për problemet gjinore: si janë të përfshira, çfarë mekanizmash mund të përdoren, çfarë koordinimi kërkohet?

Në Fazën e katërt, bëhet planëzimi mbi bazën e dokumenteve kryesore, përgatiten të dhënat që duhet t'iu jepen komandantëve në shkallë taktike dhe përgjigjet pyetjeve se çfarë lloj informimi do t'iu jepen komandantëve në shkallën taktike.

Vlerësimi gjinor është hapi i parë në transformimin e institucioneve

"Përgatitja e një vlerësimi gjinor është hapi i parë në transformimin e institucioneve të sektorit të sigurisë, për të promovuar të drejtat e barabarta midis burrave e grave

dhe pjesëmarrjen e tyre."[8]

Shembulli i *Rregullores së Vetëvlerësimit për Policinë, FA dhe Sektorin e Drejtësisë*, përgatitur nga DCAF, (*Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik në FA*), nëpërmjet *Qendrës për Sigurinë, Zhvillimin dhe Zbatimin e Ligjit*, jep modelin, është një mjet për vlerësimin e përgjigjeve gjinore në institutet e sektorit të sigurisë. Kjo rregullore, nëpërmjet tetë shkallëve të procedurave, ndihmon e bën vetëvlerësim për zbatimin e problemeve gjinore:

- Marrja në konsideratë e përfitimeve dhe rreziqeve.
- Sigurimi i autorizimit për veprim.
- Organizimi i punës.
- Organizimi i procesit të vetëvlerësimit.
- Mbledhja e informacionit dhe e të dhënave.
- Analiza dhe raportimi i të dhënave.
- Hartimi i një plani veprimi gjinor.
- Monitorimi, vlerësimi dhe përshtatja**.**

Janë 16 dimensione të përgjigjes gjinore për vetëvlerësim:

A: Performanca dhe efektiviteti: Kapacitetet dhe trajnimi; Aksesi në shërbim; Të dhëna lidhur me krimet bazuar në gjini.

B: Ligjet, Politika dhe Planëzimi: Ligjet dhe standarte kombëtare e ndërkombëtare; Politikat institucionale, procedurat dhe bashkëpunimi.

C: Lidhjet me komunitetin: Perceptimi i publikut; Bashkëpunimi dhe konsultimi me publikun.

D: Qëndrimi: Ankimimet ndaj personelit të sektorit të sigurisë; Qëndrimi i brendshëm dhe i jashtëm.

E: Personeli: Rekrutimi dhe Përzgjedhja; Mbajtja e personelit; Emërimi në detyrë, vajtja në misione, gradimi; Trajtimi dhe mbështetja; Infrastruktura dhe pajisja.

F: Kultura institucionale: Të kuptuarit e çështjeve gjinore dhe marrëdhëniet midis personelit femra dhe meshkuj; Roli i lidershipit dhe prezantimi publik.

Për të bërë vlerësimin ngrihet grupi i punës, i drejtuar nga MM dhe pikat e kontaktit në njësi e reparte. Grupet e punës përdorin intervistat, pyetësorët, fokusimin në grupe interesi, për të mbledhur informacion. Analizimi bëhet nëpërmjet 16 dimensioneve të mësipërme të grupuara në 6 fusha:

A: Performanca dhe efektiviteti; B: Ligjet, Politika dhe Planëzimi;

C: Lidhjet me komunitetin; D: Qëndrimi; E: Personeli; F: Kultura institucionale.

Kryerja e vetëvlerësimit dhe puna për hartimin e planit të veprimit kërkon një kohë minimale, 4-6 muaj. Pas këtij procesi, përgatitet një raport vlerësimi që jep një vështrim të procesit gjinor të FA, duke përfshirë pikat kyçe dhe sfidat që duhen diskutuar dhe planëzuar. Plani i Veprimit gjinor përfshin monitorimin dhe mekanizmat e vlerësimit.

[8] DCAF, *Gender Self-Assessment Guide for the Police, Armed Forces and Justice Sector*, ISBN: 978-92-9222-169-0; 2011.

Një vlerësim gjinor ndihmon:

- Identifikimin e burimeve institucionale për çështjet gjinore në termat e aftësive, njohurive, politikave e procedurave.
- Identifikimin se çfarë nuk shkon mirë në trajtimin gjinor midis burrave e grave në FA.
- Identifikimin e nevojave për trajnim e pajisje.
- Nxjerrjen e të dhënave për evoluim e progres.
- Demonstrimin e angazhimit për mundësi e oportunitete të njëjta.
- Të kuptuarit pse personeli femër e meshkuj ikin.
- Identifikimin e praktikave të mira të rekrutimit të barabartë, ruajtjes së personelit dhe përparimit si të meshkujve edhe të femrave.
- Demonstrimin te vendimmarrësi të angazhimit në të drejtat e njeriut dhe të barazisë gjinore.
- Forcimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile.
- Zhvillimin e objektivave realë dhe praktikave e strategjive për një përgjigje gjinore.

Nëpërmjet një rregulloreje të tillë, kuptohet koncepti i problemeve gjinore dhe diskriminimit seksual.

Plani gjinor i veprimit

Plani gjinor i veprimit trajton sfidat e institucionit, në lidhje me problemet gjinore. Duhet të ndërtojë kornizat e politikave gjinore të institucionit. Kjo realizohet nëpërmjet identifikimit të ligjeve, politikave, planëzimit. Plani gjinor i veprimit trajton 6 fushat e ekzaminuara në procesin e vetëvlerësimit:

A: Performanca dhe efektiviteti-p.sh., përmirësimin e trajnimit për çështjet gjinore për kategori të caktuara të personelit.

B: Ligjet, Politika dhe Planëzimi-p.sh, ngritja e bashkëpunimit të brendshëm dhe strukturave për të zhvilluar përgjigjen institucionale gjinore.

C: Lidhjet me komunitetin-p.sh, zhvillimi i bashkëpunimit me organizatat jo qeveritare që mbështesin aktivitetet e mbrojtjes së viktimave.

D: Qëndrimi- p.sh, zhvillimi i protokollit për raportimin e abuzimeve e ngacmimeve seksuale.

E: Personeli-p.sh, hapat për të promovuar rekrutimin e femrave, ruajtjen e tyre dhe avancimin në karrierë.

F: Kultura institucionale-p.sh, nismat për të trajtuar mbrojtjen ndaj ngacmimeve seksuale në punë.

Plani gjinor i veprimit duhet të specifikojë:

- Objektiva realë të matshëm dhe të arritshëm.

- Aktivitete që duhen kryer për të arritur objektivat.
- Kohën për arritjen e objektivave.
- Përgjegjësi të përcaktuara.
- Burime njerëzore, financiare dhe nevoja të tjera që duhen.
- Formatin e monitorimit, vlerësimit dhe raportimit.

Ky plan duhet të trajtojë rrënjët e problemit, më tepër sesa rrjedhojat. P.sh nëse problemi është numri i pakët i personelit femër dhe numri i pakët në rekrutim, plani duhet të përcaktojë arsyen pse femrat largohen.

Krijimi i sistemit për monitorimin dhe raportimin e arritjes së objektivave në plan, është themelor. Ky monitorim mund të jetë i integruar në sistemin ekzistues të menaxhimit të performancës, p.sh përmbajtja individuale e performancës të përmbajë kritere që lidhen me problemet gjinore. Të gjenden rrugë në të cilat, në mënyrë institucionale, të raportohet për çështjet gjinore. Detyrimi i raportimit të jetë i qartë në plan se kush është përgjegjës për raportim, te kush dhe për çfarë. Sa shpesh dhe në çfarë forme.

Një shembull për të mbledhur informacion se si është gjendja e trajnimit për çështjet gjinore:

A: Çfarë masash janë marrë për të familjarizuar personelin me: Të drejtat e njeriut përfshirë të drejtat e femrave; Analizën e çështjeve gjinore dhe e procesit gjinor; Ligjin kombëtar për barazinë gjinore dhe politikat për problemet gjinore; Politikat institucionale gjinore; Mundësitë e barabarta; Ngacmimet seksuale dhe diskriminimin; Parandalimin dhe përgjigjen për abuzimet seksuale.

B: Në cilat mënyra integrohen të drejtat e femrave me çështjet gjinore në trajnim. Në çfarë misionesh është trajnuar personeli për çështjet gjinore.

A ka këshillues gjinorë, me përshkrim detyre, për të mbështetur analizën gjinore dhe për t'u përgjigjur në operacione.

C: Gjatë operacioneve, si personeli femër dhe meshkuj janë të angazhuar në operacione zbulimi e mbledhje informacioni. A ka mjaftueshëm personel femra që e bëjnë me efektivitet detyrën.

D: Si është trajnuar personeli që është në mision paqeruajtës dhe në operacione të tjera për kodin e sjelljes, për ngacmimet seksuale dhe abuzimet, parandalimin e dhunës seksuale kundër grave e vajzave, mbrojtjen e të drejtave dhe nevojave të femrave, Rezolutës 1325 dhe 1820, rëndësinë e përfshirjes së femrave në operacione paqeruajtëse, HIV/AIDS. "Dhuna mbi bazën gjinore, do të thotë çdo veprim i dëmshëm që kryhet kundër vullnetit të një personi dhe që është bazuar në diferencimin gjinor midis femrave e meshkujve"[9]

E rëndësishme është politika e rekrutimit dhe e përzgjedhjes. Femrat janë të pak përfaqësuara në sektorin e sigurisë. Pjesëmarrja e plotë dhe e barabartë e femrave dhe e meshkujve në këtë sektor është një objektiv për këto institucione. Praktikat

[9] IASC, *Gender Handbook for Humanitarian Action, Women, Girls, Boys&Men-Different Needs, Equal Opportunities*, 2006, p.12.

tradicionale të rekrutimit, shpesh, dështojnë për të tërhequr femrat, ose me qëllim a pa qëllim, ato janë të përjashtuara. Kësaj i përgjigjet sasia numerike në përqindje dhe në shifra, sa korrespondon në fakt gjendja e femrave p.sh. në FA, duke parë edhe shpërndarjen sipas forcave, specialiteteve, në çdo nivel të njësive e reparteve dhe sipas gradave. Ka limite të përqindjes së lejueshme të femrave të rekrutuara, por si justifikohen ato? Ka diferenca në kriteret e rekrutimit në testimin fizik për meshkuj e femra. Nëse femrat janë më pak të rekrutuara, çfarë pengon? A bëjnë femrat kandidate përgatitje të veçantë për të arritur kërkesat që duhen? E domosdoshme është që të rishikohen procedurat e rekrutimit, të shqyrtohen raportet e materialet e rekrutimit, të intervistohen rekrutët e rinj.

Në politikat e ruajtjes së personelit, gjatë karrierës në FA, femrat janë ato që e lënë më shumë karrierën. Pse? A ka politika që e mbështesin atë gjatë shtatzënisë e rritjes së fëmijëve për të ndjekur karrierën ashtu si edhe meshkujt? A ka politika favorizuese ose masa pozitive për t'iu dhënë të drejtën e arsimimit e trajnimit si edhe meshkujve që ato të jenë në gjendje të promovohen në grada e karrierë. Çfarë mbështetje praktike e psikologjike iu jepet familjeve të personelit kur një anëtar i familjes është në mision? Çfarë mekanizmash ndihmojnë personelin aktiv që është në mision të mbajë kontakt me familjen, etj.? A është investimi në infrastrukturë dhe në pajisje për femrat njëlloj si për meshkujt? A duhet ndryshe? A ndjehen të izoluara, kur janë të pakta në numër, femrat në njësitë e repartet?

Përfundime

Lidershipi luan rol themelor në formimin e kulturës institucionale, në të dy aspektet: çfarë thonë liderët dhe çfarë bëjnë konkretisht për çështjet gjinore si dhe kur femrat dhe meshkujt janë liderë të barabartë. Gjithashtu i rëndësishëm është fakti se si institucioni prezantohet në publik, si pasqyron kulturën institucionale.

Në fazën e planëzimit të operacionit në mision bëhet analiza gjinore: lidhjet me çështjet e kulturës që krijojnë impakt në efektivitetin e operacionit, bashkëpunimi civil ushtarak, vlerësimi për mbrojtjen e civilëve, përfshirja e raportimit dhe analizës gjinore në raportimin e përgjithshëm, normat e standartet e sjelljes kombëtare, rajonale ndërkombëtare, parandalimin e dhunës seksuale, bashkëpunimin me femrat lokale, me organizatat jo qeveritare e të tjera që merren me mbrojtjen e viktimave, e të abuzuarve, përgjigja ndaj dhunës seksuale e abuzimit në komunitet, etj.

Në kulturën institucionale është e rëndësishme të kuptuarit e çështjeve gjinore dhe të marrëdhënieve midis femrave e meshkujve. Por çdo të thotë kjo? "Kulturë institucionale do të thotë tërësia e vlerave, e historisë dhe mënyrat e bërjes së gjërave që formojnë e krijojnë rregullat e lojës në institucion."[10]

Kultura institucionale mund të jetë një aleat i fuqishëm në bërjen e problemeve gjinore, një pjesë të vlefshme të punës së institucionit ose, në të kundërt, mund të bllokojë progresin në çështjet gjinore, duke e bërë të vështirë për femrat që të punojnë ose të kenë akses në të. Në problemet gjinore, kultura institucionale përfshin norma dhe parime të sjelljes që një organizatë i pranon ose i lejon për femrat dhe meshkujt. Një

[10] DCAF, *Police self-assessment of recruitment and retention of women', in Gender and Security Sector Reform*, Geneva, DCAF, 2011, p.36.

shembull i kulturës institucionale mund të jetë diskriminimi, si p.sh. limitimi i pozicionimit të tyre në pozicione mbështetëse, thirrja e meshkujve në fillim në mbledhje, në trajnim, etj. Një aspekt ngushtësisht i lidhur me kulturën institucionale është dhe cilësia e marrëdhënieve midis personelit femra e meshkuj.

Në Samitin e Çikago-s në Maj 2012 u theksua: "Ne i qëndrojmë angazhimit për implementimin e plotë të Rezolutës 1325 dhe Rezolutave në lidhje me të, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të femrave, rolin dhe pjesëmarrjen e tyre në parandalimin e konflikteve".[11]

Bibliografia:

- Poter, Antonia., *We the women: Why conflict-mediation is not just a job for men*, Centre for Humanitarian Dialogue, October 2005.
- Valosek, Kristin., *Securing Equality, Engendering Peace: A Guide to Policy and Planning on Women Peace and Security* (UNSCR1325). UN-INSTRAW. 2006.
- OSCE, *The Secretary General's Annual Evaluation Report on the Implementation of the 2004 OSCE Action Plan for the Promotion of Gender Equality*. September 2009.
- Koppell, Carla., *Supporting women in Negotiations: A model for Elevating their Voices and Reflecting their Agency in Peace Deals*, The Institute for Inclusive Security, October 2009.
- Goetz, Anne Marie., *Women's Participation in Peace Negotiations: Connections between Presence and Influence.* UNIFEM, April 2009.
- Rudolph Giuliani,"Udhëheqja", SHB "Dudaj", Tiranë 2006.
- Deril Henderson, "Kohezioni (elementi njeri në luftim)", SHBU, Tiranë 1995.
- Samuel P. Hunitgton, "Ushtaraku dhe shteti", SHBU, Tiranë 1995.
- Incorporating a gender perspective in to the NATO crisis response and operations planning processes, 2012.
- How can Gender make a difference to Security in Operations- Indicators, 2011.
- IASC, *Gender Handbook for Humanitarian Action, Women, Girls, Boys&Men-Different Needs, Equal Opportunities*, 2006.
- wwwAtlantic-community.org

[11] NATO, Incorporating a gender perspective into the NATO crisis response and operations planning processes, 2012.

Koncepti i përdorimit të FA të RSH në operacione kombëtare dhe ndërkombëtare

Kolonel David Rroku,
Shef i Departamentit të Operacioneve, AFA

Nënkolonel Beqir Tafili,
Kursi i Lartë i Oficerit

Trajtesë e shkurtuar. *Zhvillimet gjeopolitike, anëtarësimi i Shqipërisë në NATO, shumëllojshmëria e operacioneve ushtarake, prania e faktorit civil, zhvillimet e shpejta të teknologjisë dhe informacionit si dhe faktorë të tjerë kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në rikonceptimin e përdorimit të strukturave të Forcave të Armatosura (FA) në mjedise të ndryshme operacionale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (RSH).*

Bazuar në zhvillimet e viteve të fundit, veçanërisht anëtarësimit të RSH në NATO, ndryshimeve dinamike të mjedisit të sigurisë, me qëllim harmonizimin e shpenzimeve të mbrojtjes në krijimin e kapaciteteve operacionale për kryerjen e spektrit të plotë të operacioneve, RSH kreu Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes (RSM), i cili u bazua në Kushtetutën e RSH, Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, Strategjinë Ushtarake të RSH, si dhe në Rishikimin Strategjik të Aleancës 2010. Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes parashikon krijimin e kapaciteteve operacionale të dedikuara për kryerjen e disa roleve, duke përdorur konceptin e një seti të vetëm forcash për shumë qëllime si dhe identifikimin dhe zhvillimin e atyre kapaciteteve operacionale, të cilat mund të plotësojnë edhe detyrimet kombëtare dhe ato në kuadër të NATO-s.

Rikonceptimi i përdorimit të Forcave të Armatosura në operacione

Shqipëria, që nga viti 2009, është pjesë përbërëse e sistemit të sigurisë dhe të mbrojtjes së NATO-s duke ndarë përfitimet dhe detyrimet. Forcat tona të Armatosura, si anëtare të NATO-s, konceptohen dhe do të përdoren si forcë e aleancës në operacione të nenit 5-s, Traktati i Uashingtonit[1] ose operacione ndërkombëtare në përgjigje të krizave jashtë nenit 5, kurse për operacionet brenda

[1] Neni 5 i Traktatit të Uashingtonit, Washington D. C., SHBA, 4 prill 1949.

territorit të RSH, përdorimi operacional i FA bazohet në bashkimin e kapaciteteve sipas konceptit "*task force*". Për angazhimin e kapaciteteve operacionale ushtarake, në të gjithë spektrin e operacioneve brenda dhe jashtë vendit, autoritetet drejtuese të FA, bazuar në legjislacion dhe në procedurat standarde, krijojnë e përgatisin strukturat përkatëse *task force* duke transferuar edhe një pjesë të autoritetit të komandim-kontrollit, ose organizmave ndërkombëtare që mund të drejtojnë operacionin ushtarak, ose autoriteteve kombëtare që mund të drejtojnë operacionin brenda territorit të RSH.

Sipas misionit kushtetues, rolit, detyrave dhe kontributit, FA, si gjenerues kapacitetesh operacionale, përdoren për të garantuar sovranitetin dhe tërësinë territoriale të RSH, për të kryer operacione në mbështetje të autoriteteve civile kombëtare në ruajtjen e rendit kushtetues, në menaxhimin e Emergjencave Civile ose si kontribuuese në operacione ndërkombëtare, në përgjigje të krizave, të drejtuar nga NATO, OKB, BE ose koalicion shtetesh. Raportet e gjeneruesve të kapaciteteve operacionale me përdoruesit e këtyre kapaciteteve, si në rrafshin kombëtar, ashtu edhe në rrafshin ndërkombëtar, përcaktohen dhe zhvillohen sipas konceptit "*Gjenerues Force/Force Provider*" dhe "*Përdorues Force/Force User*[2]". Kapacitetet e nevojshme operacionale të gjeneruara nga FA, vihen nën vartësi operacionale të përdoruesve potencialë duke zbatuar konceptet dhe parimet e *Transferimit të Autoritetit (TA)*, nga autoritet gjenerues i forcave, tek autoritetet drejtuese të operacionit, të cilat do t'i përdorin këto kapacitete. Sa më sipër, në planifikimin dhe përgatitjen e operacioneve, në zhvendosjet strategjike ose lëvizjet taktike, gjatë përdorimit të forcës në operacion si dhe gjatë rizhvendosjes, duhet të udhëhiqemi nga koncepti i përdorimit modular në struktura të tipit "*task force*" të të gjithë kapaciteteve të FA, të cilat do të gjenerohen bazuar në konceptet "*Force-user-Force provider*". Sipas këtij koncepti, nuk është më e nevojshme që Forcat Tokësore, Ajrore e Detare të sigurojnë të gjitha kapacitetet që u duhen për të plotësuar spektrin e plotë të operacioneve, përkundrazi ato duhet të zhvillohen si një e tërë duke integruar kapacitetet e forcave të ndryshme në një strukturë të vetme kompakte të integruar sipas misionit dhe detyrave konkrete.

Roli i Forcave të Armatosura për mbrojtjen dhe sigurinë

Në Kushtetutën e RSH përcaktohet se... "*Forcat e Armatosura sigurojnë pavarësinë e vendit, si dhe mbrojnë tërësinë territoriale dhe rendin e tij kushtetues*[3]", ndërsa në Strategjinë Ushtarake[4] citohet se "*...misioni i Forcave të Armatosura është: ruajtja e pavarësisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale të vendit, mbrojtja dhe mbështetja e popullit në kohë paqeje, krize e lufte, si dhe dhënia e kontributit për paqen dhe sigurinë në rajon e më gjerë*[5]". Forcat e Armatosura të RSH përgatiten për t'u angazhuar në të gjithë skenarët strategjikë të sigurisë duke luajtur *rol kryesor* në operacione për mbrojtjen e vendit, *rol mbështetës* në operacione të Emergjencave Civile ose mbështetje të rendit kushtetues dhe rol *kontribuues* në operacione ndërkombëtare. Përdorimi i kapaciteteve ushtarake do të bëhet sipas një *zinxhir të qartë komandimi*, misionit, në kohë paqe, krize dhe lufte bazuar në legjislacionin

[2] NATO/MCC-133-3 Aneksi C.
[3] Kushtetuta e RSH, Neni 12, Pika 2.
[4] Strategjia Ushtarake e Forcave të Armatosura të RSH, 2007.
[5] Strategjia Ushtarake 2007, kapitulli 4, pika 4.1.

kombëtar, ndërkombëtar, konventa dhe marrëveshjet e mirëkuptimit. Në këtë kontekst, FA përgatiten për realizimin e tre objektivave kryesore operacionale**:**[6]

a) Objektivi operacional 1, synon garantimin e sovranitetit, pavarësisë dhe mbrojtjes së territorit të vendit nga një agresion i mundshëm nga jashtë. Ky është objektivi ushtarak themelor ku Forcat e Armatosura të RSH luajnë *rol kryesor*. Për përmbushjen e këtij roli, FA koordinojnë e përshtatin planet kombëtare për situata të veçanta (CONPLAN) me ato të Aleancës.

b) Objektivi Ushtarak 2, ka të bëjë me angazhimin e FA brenda territorit të RSH për mbrojtjen dhe mbështetjen e autoriteteve civile e të popullit shqiptar në emergjenca civile ose kur cenohet rendi kushtetues. Në këtë skenar Forcat e Armatosura luajnë ***rol mbështetës.*** Për përmbushjen e këtij objektivi, FA mbështetin institucionet e tjera të shtetit në kohë paqe, krize dhe lufte, sipas autoritetit që u jep ligji, duke vënë në dispozicion kapacitetet e tyre në përputhje me planet e situatave të veçanta, për operacione brenda vendit.

c) ***Objektivi Ushtarak 3,*** lidhet me angazhimin e FASH për mbështetjen e paqes dhe të sigurisë globale. Ky është një objektiv tjetër i rëndësishëm, ku FA luajnë ***rol kontribuues***. Për përmbushjen e objektivit të mësipërm, ato përgatiten për të kontribuuar me kapacitetet përkatëse në misionet për menaxhimin e krizave dhe operacione në mbështetje të paqes. Përveç sa më sipër, FA mund të angazhohen edhe në veprimtari të tjera jo luftarake, si ato të asistencës trajnuese dhe këshilluese, ndërtimin e kapaciteteve në fushën e mbrojtjes, si dhe programet e bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm.

Nivelet dhe llojet e Komandim-Kontrollit

Komandimi i forcave ushtarake ekziston në të tre nivelet: *nivelin strategjik*, *nivelin operacional* dhe *nivelin taktik*[7]. Sipas doktrinës së NATO-s ekzistojnë tre modele komandimi: modeli i komandimit ***plotësisht i integruar/fully integrated***; modeli v***endi drejtues/Lead Nation*** dhe modeli ***vendi kuadër/Framework Nation.*** Pavarësisht modelit të drejtimit të operacionit, komandimi dhe kontrolli i forcave mund të jetë komandim-kontroll i plotë (FULLCOM); komandim-kontroll operacional (OPCOM/OPCON)[8] dhe komandim-kontroll taktik (TACOM/TACON)[9].

Komandimi i plotë është autoriteti dhe përgjegjësia ushtarake e një komandanti epror për t'u dhënë urdhra e detyra vartësve[10]. Ai përfshin të gjitha aspektet e operacioneve ushtarake e të administrimit dhe ekziston vetëm brenda Forcave të Armatosura Kombëtare (në një kontekst shumëkombësh, termi *komandim* përmban shkallë më të ulët autoriteti e përgjegjësie). Asnjë komandant i NATO-s ose i ndonjë koalicioni tjetër shumëkombësh nuk ka gjasën e komandimit të plotë mbi njësitë a repartet që i jepen nga vende të tjera, pasi gjatë caktimit të njësive a reparteve për NATO-n, vendet delegojnë vetëm kontrollin operacional. C2 i plotë (FULLCOM)

[6] Rishikimi strategjik i mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, shkurt 2013.
[7] Doktrina e Përbashkët e Aleancës për kryerjen e Operacioneve AJP-3 (B).
[8] STANAG APP-6 NATO Terms and Definitions.
[9] Publikimi i NATO-s APP-6.
[10] Allied Tactial Publication (ATP)-3.2.2&Publikimi i NATO-s AAP-6.

ushtrohet vetëm në operacione kombëtare dhe kur forcat që kryejnë operacionin i përkasin strukturës organizative të komandës që drejton operacionin.

Komandimi Operacional (OPCOM[11]) është autoriteti që i jepet një komandanti për t'u dhënë detyra e misione komandantëve vartës, për të përhapur njësitë a repartet, për të bërë ndarjen e forcave dhe për të mbajtur e deleguar kontrollin operativ ose taktik, kur komandanti e gjykon të nevojshme. Ky lloj komandimi nuk përfshin përgjegjësinë për administrimin. OPCOM ushtrohet nga një Komandë Operacionale në nivel Force të Armatosur ose Kombëtar. Ky C2 do të jetë kryesisht gjatë operacioneve kombëtare të njësive të FASH kur forca që kryen operacionin është pjese e strukturës se përhershme të komandës që drejton operacionin.

Kontrolli Operacional (OPCON[12]) është autoriteti që i delegohet një komandanti për të drejtuar forca të caktuara që të përmbushë misione a detyra të veçanta, të cilat zakonisht kufizohen nga funksioni, koha ose vendndodhja; për të përhapur njësitë a repartet në fjalë dhe për të mbajtur a deleguar kontrollin taktik të atyre njësive a reparteve. Ai nuk përfshin autoritetin për përdorim të veçantë të komponentëve të njësive a reparteve në fjalë. Në vetvete, nuk përfshin as kontrollin administrativ ose logjistik. Komandantit, të cilit i është deleguar ***kontrolli operacional*** i një njësie a reparti nga një autoritet tjetër, nuk e ka autoritetin për ta përdorur atë njësi ose ndonjë pjesë të saj për detyra të tjera përveç detyrës së ngarkuar, ose për të ndryshuar organizimin bazë të saj aq sa ajo të mos jetë në gjendje të marrë një detyrë të re. Komandanti i cili ushtron kontroll operacional ndaj një force, mund të *delegojë një pjesë të autoritetit (TACOM ose TACON)* në nivelet komanduese më poshtë.

Komandimi taktik (TACOM[13]) është autoriteti që i delegohet një komandanti për t'u caktuar detyra forcave nën komandën e tij në të mirë të përmbushjes së misionit të dhënë nga komandanti epror.

Kontrolli taktik (TACON[14]) është drejtimi dhe kontrolli i lokalizuar i lëvizjeve dhe manovrave të nevojshme për të përmbushur misionet ose detyrat e ngarkuara. Duhet të mbajmë parasysh që me Transferimin e Autoritetit (TA) të një njësie të vartësisë direkt, ruhen marrëdhënie të caktuara të komandim-kontrollit midis të gjitha komandave që kanë lidhje me njësinë në fjalë.

Kontrolli administrativ[15] është drejtimi ose ushtrimi i autoritetit mbi njësitë vartëse ose organizmat në funksion të çështjeve administrative siç është menaxhimi i personelit, shërbimet si dhe çështje të tjera të papërfshira në misionin e njësive vartëse. Kjo zakonisht mbetet përgjegjësi kombëtare, nëse nuk i është deleguar komandantit të NATO-s, por edhe nëse i delegohet komandantit të forcës, koha dhe qëllimi do të jenë të kufizuara.

Autoriteti koordinues[16] është autoriteti i dhënë i një komandanti ose përgjegjësi personale e dhënë për koordinimin e funksioneve specifike ose aktiviteteve ku

[11] Allied Tactial Publication (ATP)-3.2.2&Publikimi i NATO-s AAP-6.
[12] Allied Tactial Publication (ATP)-3.2.2&Publikimi i NATO-s AAP-6.
[13] STANAG 2199- Command and Control of Allied Land Forces.
[14] AAP-15 NATO Glossary of Abbreviations.
[15] Allied Tactical Publication (ATP) -3.2.2
[16] Allied Tactical Publication (ATP) -3.2.2

përfshihen forcat e dy apo më shumë vendeve ose komandave, dy apo më shumë shërbime ose dy apo më shumë forca brenda një shërbimi. Ai ka autoritetin të kërkojë konsulencë nga përfaqësuesit e forcave të angazhuara por nuk ka autoritet për të diktuar marrëveshjet. Në rastet e mosmarrëveshjeve midis forcave të angazhuara, ai duhet të përpiqet të gjejë një pikë takimi në marrëveshje nëpërmjet diskutimeve. Në rastet kur dështohet në gjetjen e një marrëveshjeje, atëherë komandanti e adreson çështjen tek autoritetet më të larta përkatëse.

Forcat e dislokuara në terren, të cilat janë në Kontrollin Operacional të Komandantit të Operacionit, për operacione specifike, mund të riorganizohen dhe kryejnë detyra të tjera sipas organizimit për detyrë "task force", duke zbatuar konceptet e "caktimit"/ *assign* ose "përforcimit"/*attach*.

Caktimi (Assign): Vendosja e njësive dhe e personelit nën një formacion/njësi/agjenci të caktuar me një kohëzgjatje relativisht të përhershme, edhe kur formacione/njësi/ agjenci të tilla kontrollojnë dhe administrojnë njësitë dhe personelin për funksionet primare ose pjesën më të madhe të funksioneve të njësisë ose personelit.

Përforcim (attach): Vendosja e njësive dhe e personelit nën një formacion/njësi/ agjenci të caktuar me një kohëzgjatje relativisht të përkohshme. Duke qenë subjekt i kufizimeve të deklaruara në urdhrin për përforcim, komandanti i formacionit ose njësisë që përforcohet do të ushtrojë të njëjtën shkallë C2 siç e ushtron në njësinë dhe me personelin nën komandën e tij. Gjithsesi, formacioni ose njësia "mëmë" ushtron autoritetin dhe ka përgjegjësinë për transferimin dhe promovimin e personelit të dhënë në përforcim.

Koncepti i përdorimit të FA në operacione

Forcat e Armatosura të RSH përdoren në operacione brenda vendit dhe jashtë tij, në përputhje me interesat, vlerat dhe imazhin e vendit tonë, duke mbështetur vlerësimet e udhëheqjes politike për kërcënimet dhe arkitekturën e sigurisë ndërkombëtare. FA marrin pjesë në operacione ndërkombëtare duke u bazuar në kornizën aktuale ligjore të RSH[17] dhe me shqyrtim rast pas rasti për pjesëmarrjen dhe specifikën e çdo operacioni.

Operacione Ndërkombëtare

Forca e ardhshme operacionale (sipas procedurave të NATO-s), bazuar në llojin e operacionit, fillimisht krijon komandën dhe shtabin e operacionit me personel kryesor nga komponenti tokësor i Komandës së Forcës së Bashkuar për operacione tokësore, nga komponenti ajror për operacione me bazë ajrin dhe nga komponenti detar për operacione detare me bazë në det. Aktualisht, strukturat operacionale (CJSOR) të komandës Strategjike dhe Komandave të Forcës së Bashkuara të NATO-s janë të dizenjuara për funksionimin e strukturës aktuale operacionale *(me indeksin Peace Establishment- PE)*, por me fillimin e një krize, elementët kryesorë (rreth 62% e personelit kryesor) të shtabit të forcës së ardhshme, me anë të një urdhri aktivizimi kalojnë në strukturën tjetër *(me indeksin Crisis Establishment-CE*) operacionale për

[17] Kushtetuta e RSH, Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia Ushtarake, Koncepti Strategjik i Mbrojtjes.

planëzimin, përgatitjen, organizimin dhe komandim-kontrollin e operacionit të ardhshëm.

Koncepte të delegimit dhe transferimit të autoritetit. Ashtu siç është përmendur edhe më lart, në raport me përfituesit e kapaciteteve operacionale si në planin kombëtar, ashtu dhe në atë ndërkombëtar, FA luajnë rolin e gjeneruesit të forcës/ *force provider*[18]. Në një operacion kombëtar ose ndërkombëtar, FA të cilat konsiderohen "*force provider*", me formacionet dhe njësitë e caktuara për kryerjen e operacionit, kalojnë nën komandim-kontrollin e drejtuesit/komandantit të operacionit për operacione kombëtare dhe komandantit multinacional në operacione ndërkombëtare. Ky proces i njohur si procesi i "Transferimit të Autoritetit", nuk është shumë i saktësuar dhe qartësuar në FA e pikërisht për këtë, koha e transferimit të autoritetit, kryesisht për operacione ndërkombëtare duhet të jetë pjesë e axhendave të hershme koordinuese të niveleve të ndryshme politiko-ushtarake të vendeve kontribuuese dhe autoriteteve të NATO-s, e cila drejton formimin e forcës në terren etj. Gjatë planëzimit duhet të përcaktojnë ***kur*** dhe ***ku*** do të kryhet integrimi i forcave, shtabeve respektive si dhe kohën dhe vendin e delegimit të autoritetit nga autoritetet e vendeve kontribuuese me trupa te komanda strategjike e NATO-s e së fundmi te komandanti i operacionit. Në procedurat standarde të NATO-s, delegimi i autoritetit mund të realizohet sipas njërit nga opsionet e mëposhtme ose si kombinim i tyre:

- Organizimi sa më herët i Transferimit të Autoritetit, pasi në këtë mënyrë i jepet mundësia komandantit të operacionit për të planëzuar dhe për të kryer integrim sa më efektiv të forcave në operacion. Në fazën e krijimit të strukturës së forcës, gjatë dislokimit ose ridislokimit, komandantët e operacionit kanë përgjegjësinë dhe duhet pikë së pari të koordinojnë, drejtojnë dhe kontrollojnë zhvendosjet strategjike dhe ato taktike të forcave dhe mjeteve të vëna në dispozicion nga vendet kontribuuese. Disa nga detyrat kryesore të komandantëve operacionalë janë siguria, organizimi, kontrolli, koordinimi i dislokimit të forcave, integrimi si dhe trajtimi i mëtejshëm i forcave nëpërmjet procesit të Pritjes-Qëndrimit-Lëvizjes/Integrimit/*Reception Staging and On-ward Movement/Integration* (RSOM/I)[19]. Kjo përgjegjësi e komandantit të operacionit duhet të shoqërohet me një konsensus të qartë politik të vendeve kontribuuese për operacionet ndërkombëtare, vendime në kohë, veçanërisht një saktësim të kohës për planëzim, për formimin e shtabeve të forcës, për zhvendosjet strategjike dhe lëvizjet brenda zonës së operacionit deri në destinacionin final.

- Vendet kontribuuese me trupa mund ta delegojnë autoritetin, pasi përfundojnë masat parapërgatitore në një zonë të sigurt/vendpërqendrimi të përcaktuar, arrijnë kapacitete të plota operacionale duke raportuar gatishmërinë për fillimin e detyrave në zbatim të misionit. Ky vendpërqendrim, bazuar në situatën operacionale, mund të jetë edhe jashtë Zonës së Operacionit (si shembull mund të përmendim operacionin KFOR ku NATO ka funksionale një qendër RSOM[20] në Selanik, Greqi).

[18] DP-01-paragrafi 4.5-Rolet e reja të FA, fq.55
[19] Reception Standing and On-ward Movement (only for KFOR).
[20] Reception Standing and On-ward Movement (only for KFOR).

Mbas arritjes së aftësisë së plot operacionale e deklarimit të komandantit të kontingjentit "Gati për Mision", në këtë moment komandanti i operacionit, fillon të marrë autoritetin e deleguar nga autoritetet e vendeve kontribuuese me trupa (zakonisht OPCON[21]) e të ushtrojë autoritetin e tij komandues mbi këto forca, pavarësisht nëse kontingjenti gjendet brenda zonës së përgjegjësisë ose jashtë saj.

- Transferimi i autoritetit ndodh kur forcat e vendeve kontribuuese me trupa arrijnë në zonën e operacionit, pa pasur më parë një plan të integruar me autoritetet drejtuese të operacionit. Ky opsion u lejon vendeve kontribuuese mundësinë e dislokimit të kontingjenteve të tyre si dhe përgatitjen e tyre për fillimin e operacionit. Kjo formë e zhvendosjeve strategjike, e lëvizjeve taktike por edhe procesi i Transferimit të Autoritetit nuk e mundëson komandantin e forcave operacionale të koordinojë dhe të kontrollojë dislokimin e forcave e si pasojë ky opsion është më pak i përdorshmi përveç në raste të veçanta.

Transferimi i Autoritetit në Operacione Ndërkombëtare. Asnjë nga organizatat e sigurisë përfshirë edhe NATO-n, nuk kanë forca nën komandimin e plotë, por forcat e gatshme, forcat rezervë ose forcat për përdorim operacional sigurohen nga kapacitetet operacionale të vendeve anëtare ose vendet kontribuuese me trupa. Në kontekstin e pjesëmarrjes së kapaciteteve operacionale të FA në operacione ndërkombëtare, neni 5 ose jashtë këtij neni, të udhëhequr nga OKB, BE ose NATO, Shtabi i Përgjithshëm i FA (Shefi i Shtabit të Përgjithshëm), konsiderohet "***Gjenerues Force"/Force provider,*** ndërsa organizata që drejton operacionin, NATO, OKB, BE ose koalicion "*ad hoc*", konsiderohet ***"Përdorues Force"/Force User***. Në kontekstin e brendshëm, pra në zinxhirin e komandimit të Forcave tona të Armatosura, strukturat që gjenerojnë kapacitetet ushtarake, Forca Tokësore, Forca Detare, Forca Ajrore dhe Komandat Mbështetëse konsiderohen "***Gjenerues Force***", ndërsa Shtabi i Përgjithshëm i FA (Shefi i Shtabit të Përgjithshëm) konsiderohet ***"Përdorues Force".***

Delegimi i Autoritetit te përdoruesi i Forcës. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA delegon autoritetin për përdorimin e kapaciteteve të FA të vëna në dispozicion të komandave respektive të NATO-s, BE, OKB. Së pari, kontingjentet që zhvendosen në distanca të largëta strategjike, në operacione ushtarake jashtë kufijve të RSH, ***dislokimin*** e kryejnë në *dy nënfaza*. ***Nënfaza e parë,*** përfshin zhvendosjen strategjike[22], e cila nënkupton lëvizjen strategjike nga vendi i origjinës (aeroporti-hyrës/porti/kufiri), deri tek aeroporti/porti/kufiri i vendit, ku do të kryhet operacioni dhe që konsiderohet si zona e operacionit; ***nënfaza e dytë*** përfshin lëvizjen nga aeroporti/porti/kufiri në të cilin forcat arrijnë pasdislokimit strategjik, deri në destinacionin final[23], vendgrumbullimi (vendi i akomodimit) brenda zonës së përgjegjësisë, zonë në të cilën kontingjenti do të kryejë detyrat e ardhshme operacionale. Komandimi i plotë i këtij/këtyre kontingjenteve është përgjegjësi kombëtare, ndërsa Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA delegon vetëm Kontrollin Operacional (OPCON) te Komanda Strategjike e NATO-s për operacione të drejtuara nga NATO.

[21] Doktrina e Përbashkët e NATO-s.

[22] Allied Joint Doctrine for the Deployment of Forces AJP-3.13.

[23] Allied Joint Movement and Transportation Doctrine AJP-4.4; Edition B, version 1-May 2013.

Ky autoritet i delegohet komandës strategjike të NATO-s që në momentin e zhvendosjes strategjike të forcave tona nga aeroporti, porti ose pika kufitare shtetërore deri në aeroportin (hyrës), portin ose kufirin e vendit ku do të zhvillohet operacioni ose mund t'i delegohet kur kontingjenti arrin në aeroportin/portin ose kufirin e vendit ku do të zhvillohet operacioni. Me mbërritjen e forcave tona në aeroportin/portin, kufirin shtetëror ose kufirin administrativ të vendit ku kryhet operacioni, Komanda Strategjike e NATO-s i delegon kontrollin taktik (TACON) komandantit të operacionit (komandanti i forcës) vetëm për sigurinë e kontingjentit (*Force Protection*) dhe për koordinimin e lëvizjes nga aeroporti/porti/kufiri shtetëror/kufiri administrativ deri në destinacionin final, vendgrumbullimi/vendin e akomodimit në zonën e përgjegjësisë së kontingjentit respektiv. Në këtë moment, bazuar në procedurat standarde të NATO-s, forcat e dislokuara përveç trajnimit që kanë kryer në fazën përgatitore në vendin e tyre, bazuar në një program stërvitor 5-10 ditor (varet nga madhësia e kontingjentit), fillojnë përgatitjet dhe trajnimet për familjarizimin me zonën e përgjegjësisë/operacionit, specifikat, njohjen e Zonës së përgjegjësisë, ndërveprueshmërinë, integrimin e komandim-kontrollit etj.

Në përfundim të stërvitjes familjarizuese, kontingjentet respektive, pasi kanë arritur kapacitetet e plota operacionale (FOC) dhe janë gati për të filluar kryerjen e detyrave sipas detyrave kryesore të misionit, raportojnë me shkrim gatishmërinë te komandanti i operacionit/forcës nëpërmjet një formati standard. Në këto kushte, komandanti i operacionit/forcës, i cili ka në dorë edhe formatin e Transferimit të Autoritetit dërguar nga SHSHPFA, i raporton Komandës Strategjike të NATO-s, në rastin konkret SACEUR, marrjen e kontrollit operacional (OPCON) të forcave respektive duke integruar në matricën e kufizimeve edhe ato të kontingjentit të radhës, nëse ka. Që nga ky moment, kontingjentet e vendeve kontribuuese me trupa kalojnë nën kontrollin operacional të komandantit të operacionit dhe përdorimi i tyre bëhet bazuar në Planin Operacional, urdhrin operacional dhe, për operacione specifike, përdorimi i forcave do të bëhet në bazë të konceptit të operacionit sipas një urdhri të pjesshëm (FRAGO).



Delegim i Kontrollit Operacional (OPCON)

Komandantëve të forcës në operacione ndërkombëtare duhet t'i delegohet vetëm Kontrolli Operacional (OPCON) nga autoritetet e nivelit Strategjik të FA sipas fazave dhe zinxhirit të transferimit dhe delegimit të autoritetit. Pse duhet të delegohet vetën Kontrolli Operacional dhe jo Komandimi Operacional? Autoriteti i dhënë për përdorimin e forcës në nivelin "Kontroll Operacional" e kufizon Komandantin e operacionit për **dhënien e një tjetër misioni** ose **ndarje** të kontingjentit për kryerje detyrash të ndryshme. Në praktikën për Transferimin e Autoritetit "*Transfer of Authority*"- (TOA) nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-s[24], te komandanti i Operacionit, kufizimet (*Caveats)* duhet të jenë të mirë analizuara duke pasur parasysh specifikën e veçantë, misionin dhe detyrat themelore që ka çdo kontingjent që mund të dislokohet në zonën e operacionit.

Po ashtu në vëmendje duhet të kihet edhe paketa e rregullave të miratuara të Angazhimit që ka në dispozicion vetë komandanti i Operacionit, Konventat Ndërkombëtare, ligjet kombëtare të vendeve ku zhvillohet operacioni, ligjin e konfliktit të armatosur e një sërë marrëveshjesh e dokumentesh të tjera ligjore. Mënyra e Transferimit të Autoritetit nga vendet kontribuuese me Trupa për tek autoritetet që do të drejtojnë operacionin, do të jetë e njëjtë si për operacione nën artikullin V "Mbrojtja Kolektive", ashtu edhe për operacione jashtë këtij artikulli në operacione në përgjigje të krizave. Për transferimin e autoritetit të kontingjentit që përfundon detyrën në zonën e operacionit, nga ana e Komandantit të Operacionit te Komandanti Strategjik i NATO-s (SACEUR) e së fundmi tek autoritetet përkatëse të vendit kontribuuese me trupa, ndiqet e njëjta praktikë në të kundërt të asaj që u përdor kur kontingjenti u dislokua në zonën e operacionit. I vetmi ndryshim qëndron në faktin që komandanti i operacionit në këtë rast ruan Kontrollin Operacional deri sa kontingjenti del nga kufiri/porti/aeroporti i vendit ku kryhet operacioni. Vendet kontribuuese me trupa në operacione ndërkombëtare, për lëvizjet transite, qoftë kur dislokohen, qoftë edhe kur rizhvendosen, shfrytëzojnë marrëveshjet që mund të ketë NATO/BE/OK me shtetet ku kontingjenti do të kalojë transit ose në mungesë të marrëveshjeve të tilla, mund të bëhen marrëveshje mirëkuptimi vetëm për kalime transite të forcave dhe mjeteve ushtarake me qëllim lehtësimin e kalimit.

Delegimi i Komandim-Kontrollit Taktik (TACOM/TACON). Bazuar në procedurat e NATO-s vetëm për qëllime operacionale, komandanti i operacionit ka të drejtën që Duhet nënvizuar se Qendra e Bashkuar Operacionale, për shkak të rolit që luan, nuk duhet të jetë pjesë e zinxhirit të komandim-kontrollit të strukturave të Forcave të Armatosura, të cilat kryejnë operacionin. Funksioni dhe detyrat kryesore të Qendrës Operacionale janë: monitorim, koordinim, menaxhim informacioni, përditësim i aktivitetit operacional, ndjekja e ritmit të operacionit etj. Për të shmangur konfuzionin dhe për të pasur procedura të qarta të krijimit, organizimit dhe të funksionimi të një "*task force*" në operacione të ndryshme kombëtare, duhet që të konceptohet sa më herët, duke përgatitur procedura standarde veprimi, duke orientuar trajnimet, stërvitje kompaktësuese dhe integruese të kapaciteteve të ndryshme të FA të parashikuara për t'u përdorur në operacione të ndryshme brenda vendit. Për formimin e shtabit drejtues të një "*Task Force*", gjeneruar nga FA, mund të ndiqet e njëjta procedurë me NATO-n,

[24] Formati i Transferimit të Autoritetit

[25] DP-01, paragrafi 4.3.2 Angazhimi i FA në operacione-faqe 52.

duke pasur parasysh kontekstin aktual të forcave tona por ndoshta duke përgatitur më parë edhe bazën ligjore dhe procedurat standarde të veprimit ***për gjenerim force dhe transferim autoriteti.*** Gjenerimi i forcave operacionale për krijimin e një "*task force*" padyshim do të kërkohet nga ato struktura që garantojnë kryerjen në mënyrë sa më profesionale të detyrave për misionin konkret, me qëllim arritjen e objektivave ushtarake dhe fundin e dëshiruar të përcaktuar nga niveli strategjik i drejtimit të Forcave të Armatosura.

Konceptimi i "Task Forcës" në operacione të EC. Përballimi i emergjencave civile përbën një ndër detyrat themelore mbështetëse të FA, të cilat përfaqësojnë një nga strukturat më të organizuara, më të stërvitura, më të pajisura dhe më të gatshme në nivel kombëtar[26]. Angazhimi i tyre në përballimin e emergjencave civile bëhet në kuadër të përpjekjeve kombëtare dhe në mbështetje e përforcim të autoriteteve përgjegjëse civile, të parashikuara me ligj. Angazhimi i FA në emergjenca civile bëhet me kërkesë të autoriteteve përgjegjëse, në rastet kur përdorimi i aseteve të tjera civile rezulton i pamjaftueshëm ose i paefektshëm. Koncepti i përdorimit operacional të FA në emergjenca civile parakupton që strukturat e FA, si rregull, hyjnë në operacion të EC për të mbështetur strukturat e angazhuar e jo si strukturë reaguese primare, por kur ndërhyjnë, ato shpalosin një kapacitet të lartë si në forca, ashtu dhe në mjete. Struktura kryesore e FA, që kontribuon në përmbushjen e misionit të FA për përballimin e emergjencave civile, është Brigada e Mbështetjes Rajonale, por në misionin e FA për mbështetjen e Emergjencave Civile përfshihen edhe strukturat e tjera të FA të cilat stërviten dhe mbajnë në gatishmëri forca e mjete për të kontribuuar në përballimin e një fatkeqësie natyrore ose emergjence civile të pritshme. Ashtu siç është përmendur më lart, Forcat e Armatosura aktivizohen në këto operacione si një bashkim kapacitetesh nga struktura të ndryshme të FA në përputhje me natyrën dhe llojin e misionit që duhet kryer duke krijuar një forcë sipas organizimit për detyrë "*Task Force*".

Transferimi i autoritetit në operacione të EC. Sipas Doktrinës së Përbashkët të FA, operacionet e FA në menaxhimin e Emergjencave Civile kryhet në mbështetje të autoriteteve civile kombëtare qendrore dhe vendore, në kuadër të planit kombëtar të përballimit të fatkeqësive natyrore ose emergjencave civile[27]. Në këtë kontekst Forcat e Armatosura konsiderohen *"force provider"* dhe autoritetet civile që drejtojnë operacionin konsiderohen *"Force User"*. Por duke u nisur nga fakti që vetë Forcat e Armatosura në operacionet e Emergjencave Civile caktojnë një komandant operacioni, atëherë strukturat e FA, komandat e forcave (Forcat Tokësore, Forcat Ajrore dhe Forcat Detare) konsiderohen "*Force Provider*", ndërsa Shtabi i Përgjithshëm i FA/SHSHP të FA konsiderohet si "*Force User*", i cili për komandim-kontrollin në terren të operacionit delegon ***kontrollin operacional*** te komandanti i Task Forcës/*Joint Task Force*.

Ky lloj zinxhiri komandimi aktualizohet pasi në strukturën tonë ***mungon një komandë operacionale,*** e cila do të luante rolin e "*force user*" në të gjitha fazat e operacionit. Pavarësisht se në DP-01[28] Qendra Operacione e SHP shikohet si element komandues ose kontrollues, ajo nuk mund ta luajë as rolin komandues, as rolin kontrollues, por

[26] DP-01, Paragrafi 4.6-Koncepti i përdorimit të FA në Emergjenca Civile.
[27] Plani Kombëtar i Emergjencave Civile i RSH.
[28] Faqja 52, paragrafi 4.3.2- Angazhimi i në operacione.



vetëm rol koordinues/monitorues etj. Si mund të aplikohet koncepti "*force user*"-"*force provider*" në operacione të Emergjencave Civile? Duke mos u ndalur në trajtimin e fazave të menaxhimit të emergjencave civile[29] por vetëm në mënyrën e angazhimit të FA në operacione të mbështetjes së EC, më poshtë trajtohen fazat e kryerjes së operacionit nga forcat ushtarake dhe delegimi i autoritetit. FA mund ta konceptojë operacionin në mbështetje të EC në 4 faza:

Faza e parë (Përgatitore): Kjo fazë mund të ketë dy nënfaza. Në ***nënfazën e parë,*** forcat e Armatosura përgatiten duke përdorur skenarë dhe variante të ndryshëm për përballimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore: zjarre, përmbytje, rrëshqitje dheu, bllokim rrugësh nga dëbora, ndërtim kampingjesh, tërmetet etj., bazuar në planin kombëtar të Emergjencave Civile. Kjo nënfazë përfundon pas shpalljes ose jo të Emergjencës Civile, marrjes së kërkesës dërguar nga autoritetet civile për mbështetje si dhe marrjes së vendimit nga niveli strategjik i FA për mbështetje të operacionit të EC. ***Nënfaza e dytë*** fillon pikërisht me marrjen e kërkesës për mbështetje, vendimin nga autoritetet strategjike për marrje pjesë në operacion, dërgimin e urdhrit të aktivizimit te komponentët respektivë dhe përfundon me organizimin e "*task forcës*", përfundimin e planëzimin, përgatitjet reale për marrjen e detyrës specifike sipas misionit për mbështetje të operacionit të EC dhe bërjen gati për t'u zhvendosur në zonën e operacionit (më shumë detaje do të gjenden në Procedurën Standarde të Veprimit që është në proces përgatitjeje). *Bërthama e shtabit të task forcës* gjenerohet nga komponenti kryesor i operacionit. Forcat e Armatosura kanë kohën e nevojshme në dispozicion për të marrë masa parapërgatitore dhe koordinuese pasi ato nuk janë kapacitetet e para që do të aktivizohen për menaxhimin e emergjencës ose fatkeqësisë, si e tillë përgatitja duhet të fillojë sipas programeve dhe planeve "kontigjenci" (CONPLAN) të përgatitura në kohë normale.

***Faza e dytë (Lëvizja[30])*:** Në këtë fazë, forcat ushtarake organizojnë zhvendosjen për në zonën e operacionit ose të emergjencës civile. Kjo fazë përfshin lëvizjen e kapaciteteve ushtarake deri te destinacioni final, akomodimin në zonën e operacionit, orientimin me zonën e operacionit, detyrat që do të kryejnë, fillimin e përgatitjeve për të arritur kapacitetet e plota operacionale e për të filluar kryerjen në mënyrë profesionale të detyrave për realizimin e misionit. Faza përfundon kur forcat ushtarake arrijnë kapacitetet operacionale të plota (FOC), në zonën e emergjencës (ose në një vend grumbullimi të caktuar nga komandanti i Task Forcës) dhe kur komandantët e kontingjenteve (komandantët e caktuar nga FT, FD e FAj) raportojnë te komandanti i 'task forcës", kontingjenti "Gati për Mision". Mbas deklarimit nga ana e

[29] Plani kombëtar i Emergjencave Civile.

[30] Doktrina e përbashkët AJP 4.4-Allied Joint Doctrine for movement and Transportation.

komandantëve respektivë të kontingjenteve, forca "Gati për Mision", komandanti i "Task Forcës" i adresohet SHSHP të FA dhe kështu fillon edhe transferimi i autoritetit (TOA) nga SHSHP të FA (ose gjeneruesi i forcës, FT, FAj, FD, nëse synohet kështu nga SHSHP të FA), te komandanti i operacionit ose komandanti i Task Forcës. Komandantit të "Task Forcës" i delegohet nga SHSHP të FA, ***kontrollit operacional*** për forcat operacionale të organizuara si "Task Force" e tashmë ai do të jetë përdoruesi i forcave dhe mjeteve në dispozicion. Gjeneruesit e forcave vazhdojnë të mbajnë komandimin e plotë të kapaciteteve të vëna në dispozicion por tashmë vetëm për qëllime administrative dhe logjistike. Nga ana tjetër, komandanti i operacionit/Task Forcës raporton gatishmërinë e forcës ushtarake tek autoritetet civile të drejtimit të operacionit (drejtuesi i operacionit) me qëllim fillimin e detyrave operacionale në terren. Tashmë FA, në raport me autoritetet civile që drejtojnë operacionin, konsiderohen "gjenerues force" ndërsa autoritetet lokale ose qendrore të drejtimit të operacionit konsiderohen "përdorues force". Komandantit ushtarak të operacionit, në të gjitha rastet kur ka Emergjencë të shpallur Civile, i delegohet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA autoriteti për komandim-kontrollin e forcave ushtarake të konceptuara si "Task Force".

Faza e tretë (Zhvillimi i operacionit*)**: Kjo fazë fillon mbas kalimit të forcave ushtarake të gjeneruara nga komponentët tokësorë, detarë ose ajrorë, nën ***kontrollin operacional të komandantit të "Task Forcës". Edhe në këtë fazë, komandantët e komponentëve tokësorë, ajrorë dhe detarë ushtrojnë komandim-kontrollin e plotë vetëm për çështje administrative dhe logjistike, kurse komandanti i "Task Forcës" ushtron kontrollin operacional (OPCON[31]) duke marrë detyra nga drejtuesi i operacionit dhe duke koordinuar me aktorët e tjerë të angazhuar në operacion. Ky autoritet duhet t'i bëhet prezent drejtuesit të operacionit/autoriteteve lokale ose qendrore duke i relatuar me shkrim ato që bëjnë dhe nuk mund të bëjnë forcat ushtarake në këtë operacion. Ky relatim i aftësive operacionale të FA në operacione të mbështetje së EC, mund të bëhet nga dy drejtime, nga Komandanti i Task Forcës dhe nga ana e Shtabit të Përgjithshëm të FA. Faza përfundon kur autoritetet civile drejtuese të operacionit deklarojnë: "Misioni u realizua". Në këtë moment, forcat ushtarake të angazhuara në operacion fillojnë përgatitjet për të dorëzuar ambientet dhe rikonfiguruar terrenin e përdorur duke tentuar që gjithçka të lihet në atë gjendje që ishte kur u dislokuan forcat ushtarake. Pas këtyre aktiviteteve dorëzuese "*out processing*[32]" forcat përgatiten për t'u rizhvendosur në venddislokimin e përhershëm të tyre. Në përfundim të kësaj faze, komandanti i "Task Forcës" raporton realizimin e misionit te SHSHP i FA dhe përgatitet për të ritransferuar autoritetin te komandantët e komponentëve pjesëmarrës në operacion nëpërmjet Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA ose drejtpërdrejt te komandantët e komponentëve, nëse autorizohet nga SHSHP i FA.

Faza e katërt (Përfundimi-kthimi): Kjo fazë fillon kur forcat ushtarake kanë përfunduar detyrat e dhëna që nga momenti i deklarimit të drejtuesit të operacionit/ komandanti i Task Forcës: "Misioni u realizua", pra janë bërë dorëzimet dhe rregullimet përkatëse të infrastrukturës së përdorur. Pas përfundimit të detyrave të

[31] AAP-15 NATO Glossary of Abbreviations.

[32] Procedurat Standarde e Veprimit për dorëzimin e detyrës.

mësipërme, kur forcat bëhen gati për lëvizje në drejtim të venddislokimeve të tyre të përhershme, para fillimit të lëvizjes, komandanti i "Task Forcës", transferon autoritetin e kontrollit operacional (OPCON) te SHSHP të FA, i cili ua transmeton komandantëve respektivë të forcave, ose komandanti i "Task Forcës" e transferon drejtpërdrejt te komandantët e komponentëve kur autorizohet nga SHSHP të FA. Faza e katërt, rizhvendosja, përfundon kur forcat pjesëmarrëse në operacion arrijnë në venddislokimin e tyre të përhershëm dhe fillojnë detyrat e tyre rutinë.

Bibliografia:

- Neni 5 i Traktatit të Uashingtonit, Washington D. C., SHBA, 4 prill 1949. NATO/MCC-133-3 Aneksi C.
- Kushtetuta e RSH, Neni 12, Pika 2.
- Strategjia Ushtarake e Forcave të Armatosura të RSH, 2007.
- Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, shkurt 2013.
- Doktrina e Përbashkët e Aleancës për kryerjen e Operacioneve AJP-3 (B).
- STANAG APP-6 NATO Terms and Definitions.
- Publikimi i NATO-s APP-6.
- Allied Tactial Publication (ATP)-3.2.2&Publikimi i NATO-s AAP-6.
- STANAG 2199- Command and Control of Allied Land Forces.
- AAP-15 NATO Glossary of Abbreviations.
- Allied Tactical Publication (ATP) -3.2.2
- DP-01-paragrafi 4.5-Rolet e reja të FA.
- Reception Standing and On-ward Movement (only for KFOR).
- Doktrina e Përbashkët e NATO-s.
- Allied Joint Doctrine for the Deployment of Forces AJP-3.13.
- Allied Joint Movement and Transportation Doctrine AJP-4.4; Edition B, version 1-may 2013.
- Formati i Transferimit të Autoritetit.
- DP-01, paragrafi 4.3.2; Angazhimi i FA në operacione.
- DP-01, Paragrafi 4.6; Koncepti i përdorimit të FA në Emergjenca Civile.
- Plani Kombëtar i Emergjencave Civile i RSH.
- ·Doktrina e Përbashkët AJP 4.4-Allied Joint Doctrine for movement and Transportation.
- Procedurat Standarde e Veprimit për dorëzimin e detyrës.

RUBRIKA E DYTË

Punime nga Akademia e Forcave të Armatosura

Akademia e Forcave të Armatosura është, tashmë, prej kohësh e pranishme në faqet e Revistës Ushtarake, me shkrimet e sjella nga personeli i saj akademik e kryesisht, nga studentët e kursantët.

Profesioni i ushtarakut si një profesion bashkëkohor me standarde dhe kërkesa të larta është sjellë në revistë, i trajtuar nga Kolonel Prof. Dr. Kristaq Xharo. Autori e trajton problemin nën këndvështrimin e vëmendjes që duhet t'i kushtohet profesionit të ushtarakut, si rezultat i rritjes së vëmendjes së përhershme ndaj çështjeve të sigurisë dhe mbrojtjes në psikologjinë kombëtare. Sipas autorit, besimi dhe prestigji i profesionit të ushtarakut ndikohet fuqimisht nga sjellja e përgjithshme e publikut kundrejt Forcave të Armatosura.

Në shkrimin "Metodologjia e Kërkimit Shkencor, jo vetëm modul i një programi mësimor", sjellë në RU nga Dr. Simon Gega, Pedagog në AFA, theksohet se metodologjia e kërkimit shkencor nuk mund të shihet thjesht si një modul i një lende, por pjesë e rëndësishme e çdo moduli dhe veprimtarisë së përditshme. Metodologjia e kërkimit shkencor që tashmë është modul i veçantë në programet e institucioneve të arsimit të lartë, i jep kuptim përmbajtjes së veprimtarisë mësimore, kërkimore e shkencore të vetë institucionit.

Në këtë rubrikë, një vend të rëndësishëm zënë edhe punimet e KLO, Kursit të Lartë të Oficerit. Kursantët që vijnë në këto shkrime së bashku me pedagogët e tyre drejtues, janë fokusuar në trajtimin e problematikave të Forcave të Armatosura, parë në kuadrin e diskutimit shkencor të zhvilluar prej tyre mbi refleksionet e strategëve të mëdhenj ushtarakë si Klauzeviç apo Sun Xu.

Ushtaraku, një profesion bashkëkohor me standarde dhe kërkesa të larta

Kol. Prof. As. Dr. Kristaq Xharo
Shef i Departamentit të Lidershipit dhe Shkencave Shoqërore, AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Nuk është e habitshme që, trendi i profesionalizmit ushtarak ka qenë në rritje dhe me një ritëm të qëndrueshëm që prej Luftës së Dytë Botërore. Kërcënimet e vazhdueshme nga Lufta e Ftohtë, përfshirë edhe luftërat në Kore, Vietnam, e deri në Irak e Afganistan, por dhe rritja e mëvonshme e krizave rajonale dhe të terrorizmit global, kanë shtruar rrugën për një vëmendje të përhershme të çështjeve të sigurisë dhe të mbrojtjes në psikologjinë kombëtare.*

Në këtë vështrim po tentojmë ta shohim edhe profesionin e ushtarakut. Dhe dihet që besimi dhe prestigji i profesionit të ushtarakut influencohet fuqimisht nga sjellja e përgjithshme e publikut kundrejt Forcave të Armatosura. Kjo lidhet me perceptimin e kërcënimit nga ana e këtij publiku dhe në këtë rast edhe prestigji në të cilin çdo ushtri ka në shtetin e vet. Kështu, le ta shohim si një mundësi për ta trajtuar këtë përvojë mbi bazën e disa elementeve të njohurive mbi këto aspekte të një interesi më të përgjithshëm, përpara se të kalojmë tek një survejim më i përqendruar për profesionin e ushtarakut në një kuptim më specifik.

Hyrje

Transformimet e thella gjeopolitike, të cilat filluan më 1989 çuan në uljen e perceptimit të kërcënimit nga perëndimi për disa vjet (si dhe të tjerët gjithashtu) dhe që menjëherë u ndoqën nga një ulje në numër të FA dhe buxheteve ushtarake. Por, iluzioni i "fundit të historisë" dhe asaj të "dominimit të paqes" shpejt i la vendin një realiteti ndërkombëtar më shumë të paqartë, se sa në të kaluarën, por, e cili deri në ngjarjet e shtatorit të 2001 nuk tërhiqte vëmendje nga opinioni publik[1].

Perceptimi i kërcënimit ishte një e dhënë e një interesi shumë të vogël pas 1989 një çështje, aq sa në survejimet e Eurobarometrit në vitet 1990 deri në 2002 nuk e përfshiheshin as si çështje në pyetësorët e tyre. Sulmet e shtatorit të 2001 shënuan pikë kthese në rritje, përsa i përket shqetësimeve të regjistruara nga survejimet në opinion,

[1] Eurobarometër 2008, f. 8.

të cilat njëkohësisht zbuluan një ndjeshmëri përsa i përket kërcënimeve. Pas 2001, qytetarët e vendeve perëndimore provuan se tashmë, duken të shqetësuar nga ajo të cilën e etiketojnë me termin "kërcënimet e reja për sigurinë". Ato duket se shtrihen që nga terrorizmi ndërkombëtar, përhapja e ADM, krimi i organizuar, aksidente në centralet bërthamore, e deri në konfliktet etnike dhe lufta botërore. Natyra e këtyre të gjitha llojeve të kërcënimeve të përmendura më lart, përveç njërës "krimit të organizuar dhe aksidenteve nukleare-vlerësohen se janë çështje të cilat shtrihen në kompetencat e FA, të paktën edhe në analizën më afatshkurtër duket se janë objekt në rritje.

Profesioni ushtarak dhe opinioni publik. Siç përmendëm më sipër, sjelljet kundrejt profesionit ushtarak janë ndjekur nga të njëjta trende pozitive dhe janë treguar përmes rritjes së besimit së opinionit publik. Fytyra në ndryshim e profesionit të ushtarakut në 1990 duket se ishte e përcaktuar nga tre shkaqe. *E para,* në praktikën e sotme oficeri po thirret në më të shumtën e rasteve në misione të operacioneve ushtarake, mjaft të ndryshme nga konfliktet klasike dhe mes tyre ka një rritje të operacioneve në mbështetje të paqes. *E dyta,* kontingjentet e vendosura në këto tipe misionesh po bëhen gjithmonë e më shpesh ndërkombëtare në karakter. Kjo do të kërkojë që oficerët do të duhet të përshtaten me probleme të komplekse të ndërveprueshmërisë me njësitë e vendeve të tjera, pra ato multinacionale. *E treta,* në kohën e sotme ushtarakër kanë marrë role të një natyre publike e diplomatike në rritje, për të cilën ata më parë nuk kanë qenë objekt e subjekt. Këtu përfshihet edhe ruajtja e marrëdhënieve me komunitetet lokale, me komunitetet fetare, me trupat ndërkombëtare dhe me organizatat joqeveritare.

Për të përgatitur profesionistët e rinj ushtarakë, për këto aspekte të reja të profesionit të tyre, janë në dinamikë ndryshime substanciale, si në programe dhe në theksin e proceseve kualifikuese në akademitë ushtarake[2] e kolegjet e mbrojtjes[3] në të shumtën e vendeve evropiane, gjë e cila ka çuar në disa momente të rëndësishme. Së pari, përafrimi i programeve të akademive ushtarake, ku shembull i veçantë është programi "Military Erasmuss" apo kolegjet e NATO-s dhe së dyti, përpilimin e programeve në të njëjtat standarde me universitetet civile (veçanërisht të fakulteteve të shkencave politike). Ky zhvillim arriti në një stad të ri pas lëshimit nga Konsortiumi i akademive dhe kolegjeve të NATO-s dhe PfP të kurrikulës së përgatitjes së ushtarakut. Është një projekt që dominoi diskutimin intelektual në qarqet akademike pas vitit 2011. Këto zhvillime kanë çuar në fenomenin e konvergjencës se institucionit të FA me shoqërinë civile, një konvergjencë e cila më shumë se kudo në Evropë e ka bërë profesionin e ushtarakut më të kuptueshëm (më mirë të çmuar) se sa në periudhën e Luftës së Ftohtë, ku funksioni kryesor i FA ishte ai i parandalimit apo bërjes së Luftës. Nuk shtrohet ende dilema që ushtaraku është "punë apo profesion."

Refleksione në shkrimin "Arti dhe shkenca ushtarake një disiplinë akademike"[4]

Pothuajse tre dekada më parë profesor *Samuel Huntington* publikoi traktatin e tij

[2] Akademitë ushtarake njihen institucione të cilat titullojnë oficerët (shënimi i autorit)

[3] Kolegjet e mbrojtjes emërtohen institucione të cilët kualifikojnë ushtarakët deri në nivelet më të larta ushtarake dhe politike (shënimi i autorit)

[4] Gjenmaj Eduard ATKESON, Ph.D. http://findarticles.com/p/articles/mi_qa3723/is_200505/ai_n13636344/

historik "Ushtaraku dhe Shteti", ku në mënyrë të veçantë argumentoi teorinë dhe politikën e marrëdhënieve civilo-ushtarake". Në më shumë se pesëqind faqe (534), ky gjigand i mendimit politik, për fat të mirë edhe ushtarak, argumentoi dhe loboi fuqishëm për njohjen e karrierës ushtarake si një profesion. Duke u mbështetur kryesisht mbi themeluesin e shkencës ushtarake *Karl Von Clauseviç*, *Huntigton* nënvizoi se : *"Fakti se lufta ka gramatikën e vetë kërkon që ushtarakët si profesionistë të lejohen të zhvillojnë artin dhe shkencën e vetë me sa më pak ndërhyrje... Virtuti profesional i ushtarakut" (term i Clausevic) gjendet në natyrën e fushës ku ai vepron po aq sa dhe çdo profesion tjetër ..."*[5].

Huntington e bazon argumentin e vetë në shembuj dhe përvoja të shumta, që sjell nga pothuaj të gjitha llojet e armëve: tokësore, ajrore dhe detare. Më tej, nëpërmjet një aparati të mahnitshëm konceptual, Huntigton vazhdon ta bazojë argumentin e tij të "rëndë" në veçori dhe ngjashmëri të përbashkëta me gjithë profesionet e tjera. Ai jo vetëm, që beson, por edhe na sjell në përfundimin, që profesioni i oficerit tejkalon të gjitha karakteristikat dhe elementet që referohen edhe aktivitetet e tjera për t'u quajtur profesion. Është mahnitëse thjeshtësia se si Huntigtoni i jep argument "dilemës së kohës" së shkuar. Ai nga larmia kap thelbin, nga e përgjithshmja shkon te konkretja dhe nga fakti kalon tek domosdoshmëria. Ndërsa pranon se *"kapiteni i një anije, komandant i një njësie këmbësorie, apo drejtuesi i një formacioni ajror duhet të jenë ballazi me shumë probleme që kërkojnë aftësi shumë të ndryshme*", ai vazhdon të vinte në dukje se pavarësisht prej tyre ka edhe një të përbashkët dhe ajo gjendet në "sferën e kompetencave profesionale ushtarake."[6] Kjo disiplinë e përbashkët përfshin organizimin, pajisjen dhe trajnimin e forcave, planifikimin e operacioneve, dhe drejtimin e menaxhimin e tyre para-gjatë-pas, brenda dhe jashtë konfliktit. Aftësitë me të cilat përballet ushtaraku bindin se përbëjnë thelbin e profesionalizmit ushtarak, pavarësisht nga shërbimi apo specialiteti me të cilën ata identifikohen.

Duke cituar fraza të paharrueshme të *Harold Lassuell*, *Huntington* kurorëzon çështjen e tij me pohimin se profesioni ushtarak është unik dhe vlera intelektuale buron nga fokusi i tij mbi "artin dhe shkencën ushtarake"[7]. Pra, ashtu si shumë vëzhgues të tjerë, ne mund të gjejmë tek argumenti i *Huntingtonit*, faktin e identifikimit të këtij profesioni si një disiplinë akademike duke i dhënë fund debatit për njohje të këtij profesioni, jo më pak se gjithë profesionet e tjera. Kur ai me bindje dhe argumente e konsideron ushtarakun si një nga profesionet më të fuqishme, i cili ka ecur nëpër një proces specifik, por edhe me ambicien për të fituar njohje të plotë. Debatet për ta anashkaluar apo për ta çuar këtë përfundim në periferi, duket se jo vetëm që nuk janë miqësore, por as objektive e përkundrazi rikthejnë diskutimin në nivelin empirik e pse jo me dashje edhe nihilist..

Në këtë vlerësim, disa opinionistë e kanë nënvlerësuar këtë arritje dhe preferojnë ta shohin aktivitetin e ushtarakut si një shërbim/biznes, gati në nivelin aplikativ e empirik, sesa në të njëjtin nivel krahasimi me fushat më të spikatura të dijes: të ligjit, të

[5] Klausevitz "Lufta dhe politika", f. 345.
[6] Huntigton "Soldier and State", f. 276.
[7] Huntigton "Soldier and State", f. 276.

filozofisë, të mjekësisë apo të financës etj. Dhe për fat të keq, pikëpamjet e tilla nuk kanë qenë të kufizuara, dhe jo rrallë përfaqësues të këtij mendimi janë gjendur edhe në fusha zyrtare apo akademike. Për çudi, dhe ndoshta në mënyrë ironike, jo pak, edhe figura të "vet-shquara" në uniformë, herë pas here nuk kanë qenë shumë optimist dhe nuk kanë arritur të kundërshtojnë një përcaktim të tillë të profesionit të ushtarakut, për të mos përmendur faktin që jo rrallë edhe kanë rënë në batakun e vet gjykimit. Ndoshta, kanë shprehur edhe pasiguri, se një njohje e tillë do të dobësonte konceptin "tradicional-praktik". Ky grup, i "trembur" se përcaktime jashtë këtij formati, pra që kërkesat intelektuale për studim dhe shkrim nuk shkonin në vijën e mëparshme, tradicionale të oficerit, janë bashkuar në kauzën për ta quajtur aktivitetin e ushtarakut një punë e jo një profesion. Në këtë kontekst, mund të shpjegohet edhe tollovitja në programet akademike e profesionale të ushtarakëve.

Përballë kësaj rryme, shkolla/revolucioni në ratifikimin e ushtarakut me profesionin, do të duhet të referohemi nga filozofi dhe mendimtari më i madh i këtij shekulli Samuel Huntington. Dhe jo vetëm për kauzën që frymëzon, por edhe për emrin që ka, ai ndihmon për një orientim të drejtë. Nuk mundej që kjo lëvizje të mos vishej me mbështetje edhe nga figurat të tjera të fuqishme intelektuale, akademike dhe politiko-ushtarake. I shquar midis këtyre ithtarëve mbetet gjenerallejtënant *Deitt C. Smith*, ish- komandant i Kolegjit amerikan të Luftës, i cili pati meritën, se demonstroi një argumentim të fuqishëm për bazat ku mbështetet arti dhe shkenca ushtarake. Ai shprehet se "Kolegjet ushtarake janë të dedikuara për arsimin më të lartë profesional ushtarak. Disiplina akademike që është në themel të programeve buron nga qëllimi dhe misioni ynë. Ajo përfshin studime në ato fusha të kërkimeve akademike të cilat përbëjnë profesionin ushtarak dhe që nuk janë më pak se fushat e tjera profesionale, kërkimore e shkencore. Ky formacion i dijes, një nga më të gjerët, mund të quhet me plotë gojën "arti dhe shkenca ushtarake".[8]

Një tjetër zë i fuqishëm, në favor të njohjes më të gjerë të nocionit ushtarak si një disiplinë profesionale vjen nga Kolonel *Lloyd J. Mattheus* më vonë "doktor" në Universitetin Visconsin. *Mattheus* arriti të jepte një detajim të shkëlqyer të kësaj çështje në forumet dhe debatet intelektuale. Ai e balancoi veprën e tij me një përmbledhje të argumenteve ndaj kritikave të kundërshtarëve, por edhe në mënyrë mjaft bindëse e çoi opinionin publik, përmes debateve, në përfundime dërrmuese logjike. Në një prej këtyre debateve të fuqishme, *Mattheus*, pasi mbështet *Huntigton*, në kriteret themelore të ligjshmërisë së një profesioni, i drejtohet profesor *Allan R. Millett* me afrimin në një konceptimin logjik të gjashtë kritereve të tjera themelore, që një aktivitet të konsiderohet profesion i ligjshëm. Këto kritere ishin: 1) punë e qëndrueshme, e përhershme, me kohë të plotë; 2) përgjigje ndaj nevojave të vazhdueshme të shoqërisë; 3) një pamje e përhershme e të angazhuarve, të cilët identifikojnë personalisht veten me profesionin e tyre të punës; 4) një organizatë që për kontrollin e standardeve të performancës dhe të kandidimit mbështetet në një arsimim të plotë formal teorik; 5) një orientim të shërbimit dhe të besnikërisë ndaj kërkesave të klientëve duke afruar standarde, dhe kompetenca; 6) një autonomi kolektive e dhënë nga ana e shoqërisë, që i shërben, sepse ushtruesit kanë provuar

[8] Gjenerallejtënant Deuitt C. Smith, "Military profesionalist".

etikë dhe besueshmëri në standardet më të lartë të tyre dhe që nuk mund t'i delegohet dikujt tjetër.

Kongresi i SHBA nuk kishte asnjë vështirësi në njohjen e vlefshmërisë së argumentit kur, në vitin 1963, ai autorizoi Kolegjin e Komandave dhe Shtabit për të kërkuar akreditim nga Agjencia e Kolegjeve dhe universiteteve të Amerikës Qendrore dhe Veriore në nivelin Master. Pika e rëndësishme këtu nuk ishte vetëm njohja e standardit dhe ekuivalentit për anëtarësim e bashkëpunim me institucionet homologe universitare në zhvillimin e programeve të bashkëpunimit. Pika më e rëndësishme ishte se vet institucioni u njoh për vlerën e kurrikulës dhe programit, e cila meritonte të shihej e të reflektonte në mesin e atyre standardeve që Agjencia e Lartë e Akreditimit përfaqësonte. Në thelb, arti dhe shkenca ushtarak kishin gjetur pozicionin e tyre.

Por, modeli ishte ende i pa kompletuar. Kjo shkundi më pas akademitë ushtarake në nivel "Bachelor" (West Point etj.,) ishin ende larg një përqasje të tillë. Ato e kishin mjaft të vështirë për një lidhje të drejtpërdrejtë midis programeve që ato afronin me atë çka ofrohej në Fort Leavenworth apo edhe në nivel më të lartë në Kolegjin e Luftës apo Universitetin e Mbrojtjes. Në këto kushte u desh gati një revolucion për kalimin e studimeve në nivelin e doktoraturës. Për më shumë se një dekadë, West Point ka ofruar disa kurse në "artin ushtarak dhe shkencës", duke formuar një lidhje të përafërt në mes të programeve të rregullta akademike dhe ushtarake

Aktualisht fotoja e arsimit ushtarak ka ndryshuar në të gjithë kolegjet perëndimore. Sot në të gjithë institucionet e arsimimit ushtarak në perëndim, kandidatët mund të zgjedhin edhe në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes të marrin diplomat e tyre në nivel Master e Doktoraturë me studime të mirëfillta shkencore[9].

Kjo po provon faktin që ushtarakët mund të gjejnë dhe të luajnë në të gjithë spektrin e kualifikimit akademik me të njëjtat mundësi si dhe të gjitha fushat e tjera të dijes. Forcat e Armatosura mund të përfitojnë nga inkurajimi i oficerëve në veçanti i më të spikaturve për të ushtruar aftësitë e tyre në zhvillimin e studimeve të fokusuar në tema të mirëfillta të sigurisë dhe të mbrojtjes. Pra, topi është hedhur në oborrin e atyre që janë përgjegjës për zhvillimin e mendimtarëve në FA ,që janë përgjegjës për identifikimin e fushave të mëdha, në të cilat gjatë ushtrimit të aftësive ushtarake-intelektuale mund të prodhojë dobi më të mëdha.

Paralele në arsimimin ushtarak të vendit tonë. Vitet e fundit mund të konsiderohen me të vërtetë si nga më të rëndësishmit për arsimimin tonë ushtarak. Dhe duke parë lidhjen e tij me vet profesionin e oficerit, rëndësia zmadhohet edhe më tepër dhe, ushtarakët duket se përfundojnë dilemën e tyre për t'u ndjerë po aq krenar sa gjithë profesionet e tjera. Çfarë ndodhi në këto vite? Në mënyrë retroperspektive kurorëzuan punën disa vjeçare të stafeve akademike dhe të autoriteteve më të larta të FA.

Komisioni Parlamentar i Arsimit dhe Shkencës në mënyrë unanime përfshiu Arsimin profesional Ushtarak në Ligjin e Arsimit të Lartë. Në 22 korrik 2010, Parlamenti Shqiptar miratoi Ligjin e Arsimit të Lartë, ku arsimi ushtarak me ligj, njihet, pranohet dhe vendoset në të gjithë hapësirën e Arsimimit të lartë në RSH. Agjencia e Akreditimit

[9] Shih Atkinson 2011.

të Arsimit të Lartë shpalli përfundimin e procesit të Plotë të Akreditimit, ku Akademia e Forcave te Armatosura "njihet zyrtarisht si institucion i Arsimit të Lartë për lëvrimin e programeve të ciklit të dytë e të tretë (i pari institucion publik i arsimit të lartë në vendin tonë.)[10]

Aktualisht vijmë në përfundimin se: formalisht, praktikisht dhe juridikisht, profesioni i ushtarakut në vendin tonë ka përmbyllur me sukses procesin e vlerësimit, pranimit dhe njohjes së tij, si krahas profesioneve më të spikatura në vendin tonë. Ndoshta edhe formalisht mbërritëm aty ku Agjencia Ndërkombëtare e Akreditimit të Profesioneve në Gjenevë e kishte vendosur profesionin e ushtarakut pra në nivelin 1-4[11]. Niveli "1" nënkuptonte që oficeri vendosej në të njëjtën kolonë me ligjvënësit, me mjekësinë dhe jurisprudencën. Ndërsa niveli "4" përcaktonte që arsimimi i Lartë (universitar dhe pas-universitar" për këtë profesion kërkonte kohën më të gjatë (4-6 vjet).[12] Është stadi më i lartë që kërkohet me një profesion dhe i merituari për profesionin e ushtarakut. Është detyra jonë që ta mbajmë me respekt e krenari këtë pozicion. Dilema nuk duhet të vazhdojë.

Bibliografia:

- Eurobarometër 2008.
- http://findarticles.com/p/articles/mi_qa3723/is_200505/ai_n13636344/
- Klausevitz "Lufta dhe politika".
- Huntigton "Soldier and State".
- Gjenerallejtënant Deuitt C. Smith, "Military profesionalist".
- Faqja zyrtare e MASH.
- Organizata ndërkombëtare e profesioneve ILO Gjenevë 08.
- Agjencia Kombëtare e Profesioneve, broshurë nr. 4, 2009.

[10] Shih faqen zyrtare të MASH.

[11] Organizata ndërkombëtare e profesioneve ILO Gjenevë 08.

[12] Agjencia Kombëtare e profesioneve broshurë nr. 4, 2009.

Metodologjia e Kërkimit Shkencor, jo vetëm modul i një programi mësimor

Dr. Simon Gega
Pedagog në AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Metodologjia e kërkimit shkencor, si modul i veçantë në programet e institucioneve të arsimit të lartë i jep kuptim përmbajtjes së veprimtarisë mësimore, kërkimore e shkencore të vetë institucionit. Fatmirësisht, në kuadrin e ristrukturimit të të gjithë sistemit të arsimimit në RSH, kërkimi shkencor ka marrë një dimension shumë të prekshëm e të perceptueshëm, duke i vënë institucionet në rolin që u takon në këtë fushë. Në këtë kuadër, lidhja e procesit të arsimimit me praktikën e veprimtarisë shoqërore e shtetërore, veçanërisht për ciklin e dytë e të tretë të studimeve, ka vlera të pazëvendësueshme për shmangien e proceseve rutinë dhe që përsërisin vetveten.*

Institucionet e arsimimit me stafet akademike të tyre, kanë të gjithë hapësirën e nevojshme për përfshirjen e të gjithë proceseve të zhvillimeve të gjithë fushave të jetës në objekte, hulumtimi, diskutimi, analizë e kërkimi shkencor, duke krijuar teori e praktika të reja e bashkëkohore drejtimi e zhvillimi. Këtij qëllimi i shërbejnë jo vetëm punimet e diplomave dhe disertacioneve por edhe vetë procesi i arsimimit Është veçanërisht e rëndësishme të kuptohet se: "Është jashtëzakonisht e shëmtuar të flasësh si në libra dhe programe, por është po aq e shëmtuar nëse njeriu nuk diskuton e drejton siç e ka mësuar në libra."[1]

Për fushën e sigurisë e të mbrojtjes, kjo, është më se e domosdoshme. Praktikat e drejtimit, duke filluar që nga planifikimi, programimi, buxhetimi ,ekzekutimi, për të vazhduar me aspektet e tjera që lidhen me rolin e personalitetit e të autoritetit të lidershipit, janë lehtësisht të perceptueshme si pjesë e një procesi unik, në të cilin si praktika dhe arsimimi nuk mund të veçohen. Prandaj metodologjia e kërkimit shkencor nuk mund të shihet thjesht si një modul i një lende, por pjesë e rëndësishme e çdo moduli dhe veprimtarisë së përditshme.

[1] Oskar Blumenthal Wisenschaftlich schreiben leicht gemacht 4..Auflage. fq.5.

Një vështrim i përgjithshëm

Kanti ka theksuar: "*intuita e mendjes sonë është gjithnjë pasive, ajo bëhet aktive vetëm atëherë kur diçka na godet shqisat tona.*"[2] Ky është një përcaktim me vlerë, në kuadrin e vlerësimit të kapacitetit intelektual të vetvetes apo institucionit. Në këtë kuptim, nëse shihen sot veprimtari të individëve apo institucioneve që nuk e kapërcejnë kuadrin e rutinës, ose e kundërta, i japin impuls zhvillimit dhe janë koherent me kërkesat dhe nevojat konkrete, nuk është vështirë të përcaktohet "investimi dhe objekti i tij" për të aktivizuar ose mbështetur intelektualizmin.

Në procesin e arsimimit ka shumë rëndësi "didaktika" që aplikohet për të nxitur aktivizimin e aftësive të lindura të individëve, për të qenë gjithnjë aktiv në krijimin e kombinacioneve të materializuara në dije konkrete rreth objektit dhe qëllimit që ka procesi i arsimimit. Për këtë arsye, aplikimi i metodave "figurative", lehtësisht të perceptueshme, lënia e lirë e nxënësve parashkollorë apo ato të arsimimit bazë në përdorimin e mjeteve, të ashtuquajtura "lodra mësimore" apo aplikimi i metodave të ndryshme në mësim, u shërben edukatorëve mësueseve, pedagogëve e trajnuesve jo vetëm për të konkretizuar orën mësimore dhe realizimin e qëllimit të mësimit, por kryesisht, ajo ka vlerë për përjetimin e kombinacioneve si produkt i vetëdijes dhe intelektit, i cili përbën thelbin dhe nivelin e realizimit të qëllimit të procesit. Kjo do të thotë se procesi i arsimimit duhet të aktivizojë mendjen pasive, të disiplinojë formën e të menduarit dhe logjikën e lidhjes së teknikave, për konkretizimin e mendimit me anë të shqisave.

Në një farë mënyre, duke u mbështetur te kantizmi, të gjithë njerëzit normal i kanë potencialet dhe kapacitetet e të menduarit, "gjendjen materiale mendore", treguesit bazë jetësorë, pothuajse të njëjtë, por për nga mënyra se si janë përshtatur, orientuar dhe aktivizuar në jetë, shpalosin diferenca në tipare thelbësore, duke krijuar një realitet në të cilin shumë pak gjasa ka të gjesh dy njerëz të njëjtë.

Të gjitha këto nuk janë gjë tjetër, veçse një normalitet, pa të cilin vetë jeta nuk ka kuptim. Nisur nga kjo pikëpamje, mjedisi në të cilin ndeshen për herë të parë shqisat e brezit të ri është kontribut i disa breznive, duke u shfaqur në këtë mënyrë si skenë në të cilën të rinjtë rendin për të gjetur rolin më të përshtatshëm. Pikërisht, "regjisori" është ai që i vendos kapacitetet e tyre në rolin që duhet, duke përputhur prirjet individuale me nevojën e shfaqjes në skenë. Ky është në të njëjtën kohë thelbi i tërë metodologjisë së ndërtimit të të gjithë procesit të arsimimit dhe baza në të cilën duhet të mbështeten programet që përputhin rolin me qëllimin final të shfaqjes si nevojë për të gjithë.

Siç edhe praktika e jetës ka provuar, nevojat janë shumë dimensionale në jetë. Padukshmëria e mendimit edhe për shumë kohë do të jetë jashtë nivelit të njohjes. Për këtë arsye, procesi do të jetë gjithmonë i ndërtuar mbi hipotezat e një realiteti të ardhshëm. Ky realitetet, ndërsa është hipotezë për t'u administruar si nevojë, ai nuk mund të jetë i tillë në procesin e arsimimit. Prandaj, thelbi i metodologjisë së kërkimit shkencor qëndron në përputhjen e një realitetit të hipotezuar me një realitet të shfaqur si mundësi, për të motivuar njerëzit për veprimtari konkrete, por të sigurt në rezultat.

[2] I. Kanti "Format dhe Parimet" fq.85.

Koncepti mbi metodën e kërkimit si objekt arsimimi

Kërkimi shkencor nuk është atribut vetëm i atyre që janë të prirur për të realizuar projekte të mëdha ose me "emër të madh". Kërkim shkencor do të thotë të sigurosh të gjitha të dhënat që mundësojnë realizimin e një produkti intelektual apo material, në mënyre të tillë që, fuqia bindëse, të sigurojë dominimin e kulturës së njohjes së realitetit në të cilin ky produkt është shfaqur si nevojë, duke u shndërruar në projekt konkret dhe krejt të veçantë në llojin e tij. Me fjalë të tjera, projekti, i cili materializon kombinacionin e burimeve të disponueshme në një produkt origjinal në formë dhe përmbajtje, pavarësisht se ai mund të mos jetë i përkryer, nuk është gjë tjetër, veçse një veprimtari e bazuar në argumente teorike e praktike, e cila siguron zgjidhjen optimale me koston më të mirë të mundshme dhe, e gjithë procedura që siguron këto burime në njësinë e kohës konsiderohet metodologji e kërkimit shkencor. Kjo do të thotë që kërkimi shkencor siguron të dhënat më të reja, por jo përfundimtare për mënyrën e realizimit të kombinacioneve të mundshme teorike e praktike, duke i hapur rrugë kompletimit të tij hap pas hapi, pa ndryshuar boshtin qendror që e lidh emrin e produktit me kërkuesin.

Duke perifrazuar Karl Popperin, procesi i arsimimit duhet ta shndërrojë metodologjinë e kërkimit shkencor në një instrument me anën e të cilit vendoset përballë "optimizmi i teorisë së njohjes" me "pesimizmin e teorisë së njohjes"[3]. Në këtë kuadër, nëpërmjet debatit akademik, mund të arrihet natyrshëm në argumente pro dhe kundër, duke pasuruar dijen dhe duke zhvilluar kapacitete intelektuale mbi njohjen e të gjithë mjedisit dhe burimeve që na rrethojnë. I vetmi institucion, i cili mund të kontribuojë direkt në këtë drejtim, është institucioni i arsimimit të lartë.

Prandaj në programet mësimore, kryesisht akademike, përfshirja e një moduli mbi metodologjinë e kërkimit shkencor duhet të zërë një vend të rëndësishëm jo vetëm si koncept i rëndomtë, "shkrim akademik", por si një modul që jep të gjithë aparatin e nevojshëm për të mundësuar zgjerimin e njohurive dhe fitimin e praktikave të domosdoshme, kreative për veprim. Vetëm institucioni i arsimimit ka atributet e nxitjes, orientimit e materializimit të punës kërkimore shkencore.

Përfshirja e studentëve në kërkimin në terren dhe përjetimi i rezultatit

Kërkimi shkencor konsiderohet një nga kërkesat themelore të ligjit të arsimit të lartë dhe kjo jo vetëm në vendin tonë[4]. Në këtë kuptim, kërkimi shkencor nuk mund të jetë një aspekt fakultativ ose i lidhur vetëm me orën mësimore apo me mbrojtjet e diplomave dhe disertacioneve. Ai duhet të jetë shumë konkret, shumë dinamik dhe tepër frymëzues në të gjithë jetën dhe aktivitetin e shoqërisë sonë. Për këtë do të mjaftonte që stafet akademike, në veçanti pedagogët që drejtojnë modulet kryesore të programeve mësimore, duhet të shohin shumë më larg se përmbajtja e orës mësimore. Ata kanë përgjegjësinë dhe autoritetin që brenda kuadrit të programit mësimor, t'i japin kuptim të gjithë procesit të arsimimit në shkollat e larta, duke e orientuar atë sa më afër jetës dhe kohezionit të zhvillimit shoqëror.

---

[3] K. Popper. Për filozofinë e shkencën fq17.

[4] Ligji Nr.9741 date 21.05.2007 I ndryshuar me ligjin 10307 dt 22.7.2010, neni 2/a. dhe kreu III.

Nuk ka temë dhe modul që të mos jetë i lidhur me këtë kohezion, por në fakt, shoqëria e ndjen shumë pak rolin e stafeve akademike dhe aq më pak e ndjen këtë legjislativi dhe ekzekutivi i shtetit Shqiptar, të cilët për hir të së vërtetës, rolin e stafeve akademike e kanë ndjerë më shumë në pozicionin e kritikuesit e analizuesit, sesa në rolin kryesor të tyre, të kontribuuesit të procesit të vendimmarrjes. Dikush mund të theksojë se, kjo është më shumë teori dhe propagandë se sa realitet. Në fakt nuk është ashtu. Le të marrim një shembull. Hartimi i ligjit kundër duhanit dhe alkoolit. Për këtë nuk është e vështirë që institucionet e arsimit të lartë të vihen në dijeni për axhendën e i hartimit të bazës legjislative. Për këtë ligj, kontributin kryesor mund ta japin stafet akademike të Fakultetit të Mjekësisë, të Infermierisë, të Farmacisë, të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, ato Sociale etj. Në kuadrin e moduleve sipas programeve të tyre mësimore mund të ngrenë grupe kërkimi në terren me studentët, duke përfshirë të gjithë gamën e problemeve që lidhen me objektin e lidhur. Studentët sipas drejtimeve të ndryshme sjellin në auditorë, në formën e tyre më të mirë dhe më të plotë, opinionin bruto nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Ky opinion i nënshtrohet diskutimit dhe debatit në auditor, në të cilin mund të marrin dhe duhet të marrin pjesë edhe ligjvënësit, ekspertet e fushave të ndryshme, duke ndihmuar në këtë drejtim drejtpërsëdrejti në përmbajtjen e ligjit. Në dukje tingëllon si një proces i vështirë, por në fakt, nga praktika personale si pedagog e drejtues i modulit të kërkimit shkencor, më rezulton se një praktikë e tillë është shumë efektive qoftë edhe për konkretizimin dhe argumentimin e një mendimi shumë të debatueshëm.

Procesi i arsimimit është një nga mënyrat më efikase për të realizuar jo vetëm objektin për të cilin zhvillohet, por edhe mundësinë më origjinale të shndërrimit të idesë në realitet. Shembuj të kësaj natyre mund të gjenden kudo nëpër praktikat e universiteteve botërore, për të cilin mjafton të sjellim në vëmendje angazhimin e studentëve të Universitetit të Münchenit e Düsseldorfit për zbulimin e mbartësit të bakterit E. Coli. Ata përcaktuan se shkaqet ishin nga më të ndryshmet dhe pavarësisht nga devijimet e ndryshme, konkluzionet e tyre ishin me bazë shkencore.

Natyrisht, pedagogu është ai që thith informacionin, e përpunon dhe nxjerr konkluzionet mbi bazën e rezultatit të studentëve dhe për rastet kur fushat janë të ndryshme, ka një kooperim ndërmjet pedagogeve të fushave apo institucioneve, për të arritur në një përfundim më konkret i cili shërben dhe paraqitet si zgjidhje komplekse dhe vendimtare. Ky është edhe objekti i konferencave shkencore dhe i debateve akademike dhe jo thjesht se dikush do të mbajë një ligjëratë për shkak të një promovimi, punimi apo titulli. Mbi këtë bazë arrihet në përfundime dhe rekomandime konkrete, të cilat i bëhen prezent, sipas rastit, shoqërisë, opinionit apo institucionit, për reflektim në veprimtarinë e tyre në të ardhmen.

Në këtë mënyrë, studentët e ndjejnë vetveten në rrugën e dijes së konkretizuar dhe të materializuar, i japin forcë arsyes dhe gjykimit, duke krijuar sigurinë e nevojshme në aftësitë që zhvillojnë në procesin e arsimimit. Laboratori më i mirë i kërkimit është jeta dhe kjo është tashmë një aksiomë, e cila ekziston me të gjithë kapacitetin dhe pajisjet moderne të kohës, por duhet të vendoset me efikasitet si objekt arsimimi, duke angazhuar vetë studentët me aftësitë dhe kapacitetet e tyre që të veprojnë për atë që mundin dhe dinë të bëjnë. Në të njëjtën kohë, studenti jo vetëm shpalos aftësitë, por edhe vlerësohet për kompetencat që zotëron në bazë të aftësive dhe njohurive që ka marrë.

Studentët janë shumë efektiv dhe shumë këmbëngulës, bile më këmbëngulës sesa ata që e bëjnë këtë punë, pasi psikologjikisht janë përpara një presioni për të identifikuar vetveten, por edhe për të marrë një vlerësim sa më të lartë në fushën që angazhohen. Në këtë mënyrë mundet që konkluzionet që ata nxjerrin mbi fenomenet e takuara në terren nuk janë shumë të favorshme dhe shumë të goditura, si fjala vjen, përqasjet në lidhje me mbartësin e bakterit E. Coli te perimet, por pas një selektimi efikas nga një konferencë shkencore e studiuar mirë, mund të arrihen konkluzione më të koncentruara dhe më të plota, të cilat përbëjnë bazën e rekomandimit për implementim.

Ky do të ishte konceptimi i shpejtë në lidhje me aplikimin e metodologjisë së kërkimit shkencor në të gjitha fushat e studimit dhe të kërkimit, duke i bërë studentët pjesë aktive të procesit. Aq më tepër në institucionet e sigurisë, siç janë FA, rekomandimet dhe konkluzionet janë shumë të prekshme. Në këtë kontekst, është tërësisht e papranueshme që pas zhvillimit të konferencave e simpoziumeve shkencore mbi fenomenet e ndryshme që ndeshen në veprimtarinë drejtuese, të ndeshemi me të njëjtat fenomene.

Përfshirja e studentëve në procesin e arsimimit duhet të jetë thellësisht e lidhur me programin dhe kapacitetin e tyre. Diskutimet dhe vërejtjet e studentëve për programet janë, as më pak e as më shumë, metoda "populiste", pasi ata nuk e dinë dhe nuk e perceptojnë dot as qëllimin, as përmbajtjen. Ne i pyesim ata vetëm për të qenë brenda kornizave burokratike dhe për të luajtur me fjalën demokraci. Në fakt, ne nuk bëjmë gjë tjetër, veçse i vendosim nën një presion psikologjik që në momentin e parë për programin, duke harruar se deri në këtë moment ata kanë vetëm dijet minimale për atë fushë që do nisin rrugën e studimit të tyre, dhe këtë ne e dimë. Edhe nëse ne i pyesim ata në fund të ciklit, përsëri, i njëjti fenomen do të ndodhë nëse nuk e kanë përjetuar realisht efektin e vërtetësisë së shkencës. Nëse vazhdojmë me konceptin "mësimi dhe shkenca në shkollë është tjetër gjë në krahasim me shkencën e jetës dhe veprimtarinë drejtuese", në vend që të bëjmë mirë, krijojmë precedencë të rrezikshmërisë së "teorisë për teori, që s'ka lidhje me praktikën".

Me këtë nuk dua të fyej kapacitetin e studentëve, por drejtuesit e modulit e dinë shumë mirë se cilët janë aspektet e veçanta të përfundimit që duhet të nxirret në fund të modulit, pasi e ka të gjithë kapacitetin për këtë. Parimet didaktike e metodike për rritjen e efikasitetit të mësimdhënies diktojnë zhvillimin e formave të cilat kanë jo vetëm rendiment, por edhe sjellin kënaqësi te studentët. Në këtë kontekst, nëse duam të dimë se cila do të ishte figura e një personaliteti politik e publik, si do të donim të ishte një drejtues shteti që të kishte përmasat e një institucioni sigurie apo si do të duhej të ishte etika e komunikimit politik e publik e tjerë, do të thotë se ne shtrojmë një problem që kërkon zgjidhje. Kjo do të thotë se ne pedagogët, drejtuesit kërkimor shkencor e dimë formatin e një drejtuesi, dimë të gjithë elementet që e formatojnë një drejtues ideal në sytë e opinionit publik, por realiteti është krejt ndryshe. Për ne ka rëndësi jo realiteti, por aftësitë që kanë studentët për të krijuar "një figurë hyjnore", me anën e së cilës ata mund e duhet ta krahasojnë vetveten për të qenë drejtues të suksesshëm dhe të respektuar. Ky është thelbi i çështjes fjala vjen për modulin e lidershipit dhe për këtë, drejtuesi i modulit ndërton problemin, duke u kërkuar angazhim direkt studentëve për zgjidhje.

".. duhet kuptuar se pikënisja e çdo zhvillimi shkencor është një problem apo një situatë problemore, d.m.th shfaqja e një problemi në një situatë të caktuar të dijes sonë të përgjithshme...."[5] .

Në këtë drejtim, rol parësor ka drejtuesi i mësimit, zotërimi i procesit dhe i objektit të lëndës, modulit. Prandaj, braktisja e disa metodave klasike të mësimdhënies është më se e domosdoshme për të rritur shkallën e angazhimit dhe kërkimit shkencor te studentët. Praktika e pashmangshme deri tani leksion/seminar, bashkëbisedim apo punë individuale po e rëndon shumë procesin e cilësisë së kërkimit, duke e shndërruar kërkimin shkencor thjesht në zhvillimin me sukses të orës së mësimit. Le të perifrazojmë edhe një herë Popperin, sipas të cilit nëse studentëve u kërkon vetëm të dëgjojnë, por nuk u thua se çfarë do nga ata që të bëjnë, procesi mbyllet vetëm në kuadrin mësues-nxënës, apo pedagog-student, ku secili lihet në rolin e tij. Por ky nuk është kërkim shkencor dhe as përmbushje e detyrimit që ke si drejtues i procesit të konsolidimit të dijes dhe jo thjesht i të nxënit.

"Dija nuk është rezultat i shkollimit, por produkt i përpjekjeve për të përjetuar atë në jetë"[6] Prandaj, ndërtimi i një metode efikase, që nxit studentin në një angazhim konkret në përputhje me objektin e mësimit, duke e shndërruar atë jo thjesht në një dëgjues aktiv, por edhe në një kontribuues real për të gjetur zgjidhje, është thelbi i misionit të institucionit të arsimimit.

Procesi i arsimimit është një proces zhvillimi i personalitetit të individit. Kjo do të thotë se "zbulimi" dhe "trokitja" në elementet themelore të personalitetit të studentit, përbën një hap të sigurt në ndërtimin e problemit si bazë orientuese e besueshme për të arritur atë që do. Kjo përbën thelbin e çështjes, bazën e zgjidhjes dhe sigurinë e përfundimit. Besimi, -thekson Kanti, -çlodhet mbi nevojën e përdorimit për një qëllim praktik[7]. Në këtë kuptim, procesi i arsimimit zgjon arsyen te studenti, të cilën pedagogu e shndërron në nivel dijeje, duke i dhënë kuptim nevojës së materializuar në një produkt tashmë të formësuar si personalitet dhe zotërues të vetvetes. Por kjo realizohet vetëm në procesin e të zbatuarit dhe të përjetimit të rolit të dijes në praktikë. "Çlodhja" e Kantit ka efektin e vet vetëm atëherë, kur produkti përjetohet duke sjellë kënaqësinë e zgjidhjes.

Në vend të një përfundimi

Vlera e kësaj lende, rritet veçanërisht në kushtet e dimensionit që merr cikli i dytë e i tretë i studimeve universitare. Aparati i logjikës shkencore që ofron metodologjia e kërkimit shkencor del jashtë kontekstit të përmbajtjes së thjeshtë të një lende mësimore. Ajo mund të konsiderohet një shkencë gjithëpërfshirëse, në të njëjtin standard e nivel si etika, të cilat së bashku, nuk mund të jenë të shkëputura nga praktika e përditshme. Kështu, "*Metodë e kërkimit shkencor konsiderohet ajo praktikë e cila mundëson bashkimin e të dhënave duke formuar një koncept intelektiv mbi një objekt konkret"*[8].

[5] Karl Popper "Për filozofinë e shkencën"fq 94.
[6] A. Einstein. http://www.einsteinjahr.de/page_2874.htm.
[7] I. Kanti Filozofia kritike fq 137.
[8] Kanti. Parimet dhe format fq.14

Në fund të fundit, objekti i arsimimit, duke marrë për bazë eksperiencën e paraardhëseve dhe me një situatë burimesh të gatshme, d.m.th, një objekt konkret, zhvillon e përpunon teori e praktika të ndryshme, duke synuar zhvillimin e fantazisë së brezave të rinj për të luajtur me intelektin e tyre në një produkt e fushë konkrete studimi. Këtë e mundëson, pikërisht, metoda e kërkimit shkencor, e cila krijon atë hapësirë akademike që i nevojitet studiuesit të ardhshëm. Prandaj, vlera e institucionit të arsimimit shihet gjithnjë në unitet me kërkimin shkencor.

Parë në këtë këndvështrim, janë të gjitha mundësitë që çdo lëndë të zhvillohet në bazë të parimeve të metodologjisë së kërkimit shkencor për të gjitha çështjet që shqetësojnë sot zhvillimin ekonomiko-shoqëror të vendit, ashtu sikundër institucioni i arsimimit i ka të materializuar në programet e studimit të tij. Në fushën e sigurisë e të mbrojtjes, materializimi i këtij koncepti është jetësor për vendin e sigurinë kombëtare. Veprimtaria drejtuese dhe operacionale janë laboratorët e të gjithë procesit të arsimimit, ndërsa vetë procesi i arsimimit është logjika dhe truri i tyre.

Bibliografia:

- Imanuel Kanti. Parimet dhe format. Bot. Shqip.
- Imanuel Kanti. Filozofia kritike. Bot. Shqip.
- Karl Poper. Për Filozofinë dhe Shkencën. Bot Shqip.
- Martin Kormmeier. Wissenschaftlich schreiben leicht gemacht. 4.Auflage.
- Lek Sokoli. Metodat e kërkimit. Tekst mësimor Univ. Aleksandër Moisiu.
- Oliver Dengg. Wissenschatliches Arbeiten.

.

Rreziku në luftë sipas Klauzeviçit dhe reflektimi në Doktrinën Ushtarake

Prof. Dr. Pajtim Ribaj
Pedagog në AFA

Nënkolonel Armir Çani
Kursant KLO

Trajtesë e shkurtuar. *"Lufta lëviz në një atmosferë të përbërë nga rreziku, tendosja fizike, pasiguria dhe rasti. Çdo gjë në luftë është e thjeshtë, por edhe gjëja më e thjeshtë është e vështirë, dhe këto vështirësi, në pjesën më të madhe të papritura e të paparashikuara, grumbullohen e prodhojnë fërkim, një frenë ngadalësuese mbi shtrirjen dhe shkarkimin e plotë të dhunës. Këto vështirësi përbëhen nga "rreziku", 'tendosja trupore', 'informacioni' ose mungesa e tij dhe rrethana e pasiguri të tjera të panumërta të vogla e të pallogaritshme, që burojnë nga rasti. Këto janë disa nga gjërat e pashmangshme që e pengojnë gjithmonë luftën në realitet qoftë edhe t'i përafrohet luftës në letër e në plane."*[1]

Kur luftojnë, forcat tokësore krijojnë një mjedis unik, i cili është tejet kompleks, dinamik dhe armiqësor. Veprimi luftarak ndodh ndërmjet organizmave njerëzorë kompleks dhe është e vështirë që rezultati i tij të parashikohet me siguri. Në thelb, ai është i paparashikueshëm.[2] *Luftimi tokësor është krejtësisht njerëzor, -sjellja njerëzore shpjegon natyrën e luftimit më mirë se numrat dhe ndërveprimi i teknologjisë, megjithëse të dyja mund të jenë kritike. Përveç kësaj, lufta priret të jetë evolucionare,- forcat e armatosura mësojnë nga përvoja e mëparshme dhe humbësi priret të mësojë më shumë.*

Zbulimi mund ta pakësojë pasigurinë dhe operacionet mund të planifikohen për ta mënjanuar këtë pasiguri. Sidoqoftë, pavarësisht se sa shumë përpjekje bëhen për zbulimin, përsëri komandantëve do t'u duhet të marrin vendime duke u bazuar në informacion të paplotë, të pasaktë ose kontradiktor.[3] *Kjo është e ashtuquajtura 'mjegull e luftës'. Rreziku pakësohet me shtimin e informacionit për armikun, por rëndohet nga efektet e kundërta të rastit. Mundësi krijohen nga efektet e dobishme*

[1] Karl Fon Klauzeviç, "Mbi luftën", SHBU, Tiranë, Vëllimi I, faqe 53 dhe 77.
[2] AJP-3.2(kreu1) 1-5.
[3] Ibid.

të rastit. Këto mundësi duhet të shfrytëzohen me këmbëngulje për përmbushjen e misionit. Vendimmarrja e efektshme dhe në kohë, nisma dhe liria e veprimit janë çelësat për të shfrytëzuar pasigurinë, që është veçanërisht tipike për mjedisin tokësor.

Kërcënimi për përdorim ose përdorimi i dhunës është mjeti nëpërmjet të cilit një armik detyrohet t'i bindet vullnetit të forcave kundërshtare. Dhuna çon në gjakderdhje, shkatërrim dhe vuajtje njerëzore. Ajo sjell tronditje, befasi, rrezik e frikë.[4] Të gjithë burrat e gratë ndiejnë frikë në një farë shkalle; guximi është forca për ta mposhtur atë. Disa gjejnë guxim përbrenda, ndonëse shumica kanë nevojë për ndihmë nga burime të jashtme. Këto burime përfshijnë besimin e përbashkët në një kauzë, kohezionin moral të grupit dhe udhëheqjen e fortë.

Përkimi[5] pengon çdo veprim, ai mund ta bëjë të thjeshtën të vështirë dhe të vështirën pothuajse të pamundur. Përkimi mund të jetë mendor si, për shembull, pavendosmëria se çfarë duhet bërë më tej. Po ashtu, mund të jetë fizik si, për shembull, efektet e zjarrit të dendur të armikut, terreni i vështirë ose moti i keq. Ai mund të shkaktohet nga një plan i keq, nga keqkuptimi ndërmjet aleatëve ose nga një përplasje e karaktereve. Vendosmëria është mjet kryesor për të kapërcyer përkimin; përvoja është një tjetër. Morali i lartë, organizimi i mirë, sistemi i efektshëm i komandimit dhe stërvitjet intensive, të gjitha e ndihmojnë një forcë për të kapërcyer përkimin.

Megjithëse teknologjia e ka transformuar luftimin, prania e dhunës dhe efektet e saj mbi njeriun nuk kanë ndryshuar. Luftimi nganjëherë është i tmerrshëm dhe efektet e rrezikut, të frikës, të rraskapitjes, të vetmisë dhe të privimin prekin forcën e vullnetit të të gjithë ndërluftuesve. Prandaj, vendosmëria e komandantëve dhe e ushtarëve për të përmbushur misionin e tyre, pavarësisht nga rrethanat, është themeli i efektshmërisë luftarake të një ushtrie. Shpesh zanafilla e shpartallimit të një armiku është gërryerja e vullnetit të ushtarëve a komandantëve të tij. Suksesi në fushëbetejë shpesh varet nga vendosmëria relative e forcave kundërshtare, individualisht dhe kolektivisht.

Rreziku si koncept

Forcat e armatosura veprojnë që të jenë të suksesshme në arritjen e objektivave të caktuar: prandaj suksesi duhet të jetë i përcaktueshëm dhe duhet të jetë i matshëm brenda objektivave. Kjo arrihet nëpërmjet identifikimit të gjendjes përfundimtare të dëshiruar, e cila përkufizohet si "gjendja politike dhe/ose ushtarake që duhet të arrihet në përfundim të një operacioni, që tregon se objektivi është realizuar".[6]

Forcat e armatosura në fushën e betejës janë të ekspozuara ndaj një rreziku kompleks i cili mund të klasifikohet si përmbledhje e komponentëve të rrezikut taktik dhe rrezikut aksidental. Në rrezikun taktik mund të rreshtohen: incidentet, provokacionet dhe terrorizmi në zonën e operacionit; goditja me aviacion, lëndët helmuese luftarake të karakterit të përkohshëm; goditja e bazave ushtarake dhe civile; goditja e forcave gjatë përhapjes në formacione luftimi; goditja e objekteve të ndryshme të rëndësishme

[4] AJP-3.2(kreu1) 1-6.

[5] Përkim: tërësia e gabimeve të rastit, vështirësive të paparashikuara, veprimeve të armikut dhe pështjellimit të betejës.

[6] AJP-3.2(kreu1) 2-1.

si ura, nyje komunikacioni etj. Rreziku aksidental mund të përfshijë: Rreziqet si rezultat i gjendjes së gatishmërisë së pajisjeve dhe teknikës luftarake; Rreziqet si rezultat i kushteve të mjedisit; Pasiguritë që lindin si rezultat i përgatitjes së personelit; Rreziqet që lindin si rezultat i gjendjes së personelit, etj.

Në formulimin e çdo modeli të rrezikut, duhet të vendoset një balancë midis specifikimit dhe përgjithësimit, midis kompleksitetit dhe thjeshtësisë. Një theks në modelimin me saktësi aq sa është e mundur e drejton atë për te struktura në të cilën "rezultati botës së modeluar duket po kaq komplekse sa bota konkrete." Struktura e zhvilluar në këtë mënyrë siguron ekzaktësisht një model të "balancuar". Kjo identifikon komponentët kryesorë të rrezikut në operacionet ushtarake, faktorët kyç që influencojnë këto komponentë, mënyrat e përgjithshme në të cilin të gjithë elementët e strukturës lidhen me njëri-tjetrin.

Për shkak të realizimit të operacioneve ushtarake, fushëbeteja moderne është me të vërtetë një sipërmarrje e komplikuar dhe rreziqet me të cilin përballen udhëheqësit politikë dhe ushtarakë janë të vështirë për t'u vlerësuar, qasja e afruar për të është diçka abstrakte dhe lidhet në përgjithësimet për të thjeshtuar natyrën komplekse të luftimit, kjo sidoqoftë përfshin nivel të mjaftueshëm të detajeve për të pranuar një përcaktim metodik të rrezikut në operacionet ushtarake.

Rreziku në operacionet ushtarake

Operacionet ushtarake dhe dështimi

"Lufta nuk është veçse një pjesë e veprimtarisë politike dhe për këtë arsye ajo nuk është aspak një çështje më vete."[7] Siç Klauzeviçi ka theksuar mbi dy shekuj më parë, thelbi i luftës është politik;operacionet në luftë janë thjeshtë një mjet ushtarak për të arritur një fund politik.

Ky këndvështrim është qendror dhe për argumentimin e tij, një operacion ushtarak është përcaktuar si një aplikim taktik i forcës i përdorur nga një shtet në përmbushje të objektivave ushtarakë që kontribuojnë për arritjen e një objektivi politik të përgjithshëm. Një koncept i thjeshtëzuar i "zinxhirit të komandimit" mund të përdoret e strukturuar kështu dhe konsiston në një lidhje të udhëheqësit ushtarak me suksesin e operacionit ushtarak të përgjithshëm dhe njësitë ushtarake të përdorura për të realizuar aplikimin e forcës.

"Qëllimi përfundimtar i luftërave tona, d.m.th. qëllimi politik jo gjithnjë është i thjeshtë. Edhe në se do të ishte i tillë, veprimi do të mbetej gjithmonë aq i varur nga një numër i madh kushtesh dhe vlerësimesh, sa qëllimi nuk do të mund të arrihej më me një veprim të vetëm e të madh, por me një seri veprimesh të mëdha e të vogla, të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin, për të krijuar një të tërë".[8]

Suksesi i çdo operacioni ushtarak (1) arrihet kur: objektivi ushtarak është përcaktuar dhe realizuar në mënyrë të përshtatshme (2) dhe kur objektivi politik është përcaktuar dhe realizuar në mënyrë të përshtatshme.[9] Çdo objektiv është i nevojshëm por jo

[7] Karl Fon Klauzeviç, "Mbi luftën", SHBU, Tiranë,Vëllimi III,fq 559

[8] Karl Fon Klauzeviç, "Mbi luftën", SHBU, Tiranë 1995, Vëllimi II,fq 141

[9] P.Gardner HOWE, "Risk in military operations", NPS, USA, www.dtic.mil/cgi-bin/GetTRDoc…aksesuar me 10.02.2013.

kusht i mjaftueshëm për sukses. Megjithatë, janë dy mundësi nga të cilat operacionet ushtarake mund të dështojnë: ushtarake dhe politike. Një dështim ushtarak ndodh kur objektivi i operacionit ushtarak nuk arrihet për shkak të dështimit të aplikimit të forcës për të arritur objektivin ushtarak. Një dështim politik ndodh kur objektivi politik i operacionit ushtarak nuk arrihet megjithëse aplikimi i forcës arrin në mënyrë të suksesshme objektivin ushtarak.

Rreziku është i lidhur normalisht me mundësinë e humbjes ose shansin e pësimit të disa tipe pengesash. Me fjalë të tjera, kjo është konceptuar në kushte të probabilitetit. Me qëllim për analizuar dhe krahasuar komponentë të veçantë të rrezikut, është thelbësore mos të shikohen vetëm mundësitë relative por edhe kostot përkatëse. Rreziku i çdo ngjarje, si pasojë mund të jetë produkt i (1) probabilitetit të zhvillimit të ngjarjes dhe (2) kostos që shoqëron zhvillimin e ngjarjes. Konceptimi i rrezikut si një probabilitet i peshuar lejon për më shumë krahasime kuptimplota të tipave të ndryshme të riskut.

Rreziku i dështimit ushtarak

Komponentët

Rreziku i dështimit ushtarak është produkt i probabilitetit të dështimit ushtarak dhe kostos së dështimit ushtarak. Probabiliteti i dështimit ushtarak është thjesht mundësi që një aplikim force i operacionit ushtarak do të dështojë për të arritur objektivin ushtarak. Kostot e dështimit ushtarak janë pasoja pësuar nga një shtet si rezultat i një dështimi për të arritur objektiva ushtarakë.

Faktorët që ndikojnë në koston e dështimit ushtarak

Përcaktuesit parësor të kostos të dështimit ushtarak janë të brendshme dhe politikat ndërkombëtare. Influenca e politikave të brendshme është përcaktuar nga shkalla në të cilën audienca e brendshme të shtetit është e ndjeshme për një operacion ushtarak dhe mjetet që ka për tu përgjigjur për një dështim ushtarak. Në të njëjtën mënyrë, shkalla në të cilën politikat ndërkombëtare influencojnë koston e dështimit ushtarak përcaktohet nga ndjeshmëria e audiencës ndërkombëtare për një operacion ushtarak të shtetit dhe mundësitë e tyre për t'iu përgjigjur. Këto variante kanë një marrëdhënie me koston e një dështimi ushtarak në atë që një rritje në ndjeshmërinë për operacionin ushtarak ndikon në aftësinë e audiencës për t'iu përgjigjur kostos.

Faktorët që ndikojnë në probabilitetin e dështimit ushtarak

Faktorët parësorë që ndikojnë probabilitetin e dështimit ushtarak janë (1) sfida/ kundërshtimi i ambientit taktik, (2) gatishmëria e forcës, (3) kompleksiteti i operacionit ushtarak dhe (4) delegimi i kontrollit.[10]

a. Sfida/ kundërshtimi i ambientit taktik

Sfida e ambientit taktik referohet në një shkallë për atë të cilën pjesa e jashtme e faktorëve të kontrollit të drejtuar te pengesat e pozuara të forcës ushtarake për të imponuar në përpjekjen e saj për të arritur objektivin ushtarak. Faktorë të tillë

[10] P.Gardner Howe, "Risk in military operations", NPS, USA, www.dtic.mil/cgi-bin/GetTRDo, aksesuar më 10.02.2013.

përfshijnë gjeografinë, rendin e armikut për betejën, kushtet ambientale dhe dinamikën taktike(vlerën e ndryshimit të konsideratave taktike). Sfida e ambientit taktik ka një marrëdhënie direkt me probabilitetin e dështimit ushtarak.

b. Gatishmëria e forcës

Gatishmëria e forcës referohet për shkallën në të cilën njësitë ushtarake përgatiten për të realizuar detyrat e kërkuara nga operacioni ushtarak. Një vlerësim i gatishmërisë përfshin një vështrim te kompletimi me personel, gjendja e pajisjeve dhe gjendja e trajnimit e forcës për të qenë gati për operacionin. Gatishmëria e forcës ka një marrëdhënie të anasjelltë me probabilitetin e dështimit ushtarak.

c. Kompleksiteti i operacionit ushtarak

"Çdo luftë duhet të vlerësohet para së gjithash në karakterin e saj të mundshëm, në përvijimet e saj thelbësore, të cilat burojnë nga madhësitë dhe raportet politike; nëse, në fund, nuk e largojmë vëmendjen nga fakti që shpesh edhe sot madje do të mund të themi gati gjithmonë, se lufta na duket gjithmonë si një kompleks organik nga i cili nuk mund të ndahen gjymtyrët e tij, kompleks ku për këtë arsye çdo veprimtari e veçantë duhet të ndihmojë në tërësinë dhe të zhvillohet sipas idesë së kësaj tërësie, atëherë do të jetë e sigurt dhe e qartë për ne se këndvështrimi i lartë për drejtimin e luftës, ai prej të cilit ndahen linjat themelore, nuk mund të jetë veçse i politikës."[11]

Lufta është ndeshje e armatosur ndërmjet shtetesh a forcash kundërshtare për të arritur qëllime politike dhe ekonomike. Ajo, zakonisht, zhvillohet me një varg betejash ose përfshin një sërë veprimesh luftarake ndërmjet palëve ndërluftuese.[12] Si një dukuri shoqërore, lufta karakterizohet nga përdorimi i dhunës ushtarake për të arritur objektiva të caktuar politikë, ekonomikë e gjeografikë dhe, si e tillë, është një instrument i vërtetë i politikës për realizimin e synimeve që përcakton ajo; prandaj edhe suksesi i saj matet me arritjen e objektivave politike.

Kompleksiteti i operacionit ushtarak referohet për numrin e detyrave ushtarake që kërkohen për t'u përmbushur njëherësh nga njësi të veçanta në operacion, çdo detyrë është e nevojshme por jo e mjaftueshme për të përmbushur objektivin ushtarak. Kompleksiteti i mjedisit të sotëm operativ dhe ndryshimi i shpejtë i situatës, kërkon kombinimin e njëkohshëm të veprimeve mësymëse, mbrojtëse, si dhe ato të stabilizimit e të mbështetjes civile gjatë realizimit të një operacioni.

d. Delegimi i kontrollit

Delegimi i kontrollit referohet për shkallën në të cilën komandanti ushtarak ka kontroll autonom mbi aplikimin e forcës në operacionin ushtarak. Delegimi i kontrollit ka një marrëdhënie të ndërsjellë me probabilitetin e dështimit ushtarak. Ky autoritet mund të delegohet ose të transferohet pjesërisht ose plotësisht. Ai ushtrohet nëpërmjet analizave dhe mësimeve të nxjerra nga veprimet dhe mosveprimet. Për të qenë i suksesshëm, kontrolli duhet të bazohet në një doktrinë dhe filozofi komandimi të përbashkët, në procedura operative standarde, në varësi me sistemin e pajisjeve, të komunikimit dhe të informacionit në dispozicion.

[11] Karl Fon Klauzeviç, "Mbi luftën", SHBU, Tiranë 1995, Vëllimi III, fq 563.
[12] DPU 10, Tirane 2008 Kreu 2, fq 19.

Përfundim

"Një trimëri e lindur, entuziaste dhe stoike, një ambicie e fortë, ose të qenit për një kohë të gjatë i mësuar me rrezikun; duhen më shumë nga këta elemente, me qëllim që veprimi intelektual, në mes të këtij grupi të vështirë, të mos mbetet nën tipin që duket normal, kur shikohet qetësisht nga qoshja e vatrës. Rreziku në luftë bën pjesë ndër elementet që shkaktojnë dobësimin e forcave"[13].

Në luftë dhe në operacionet ushtarake të çdo niveli rreziku është gjithmonë i pranishëm. Prandaj, zbatimi i parimit të sigurimit nuk nënkupton kujdes të tepruar ose shmangie të rrezikut të llogaritur.[14]Luftimi është një veprimtari e shoqëruar me stres, efektet e rrezikut, frikës, lodhjes së tejskajshme, vetmisë dhe të privimeve të ndryshme ndikojnë në shkallë të ndryshme në vullnetin për të luftuar të atyre që përfshihen në të. Për të mundur ushtarakisht një kundërshtar është e nevojshme të dobësosh vullnetin për të luftuar të komandantit dhe të forcave në vartësi të tij, duke ruajtur njëkohësisht vullnetin dhe vendosmërinë e forcave të veta.

Modeli i rrezikut pretendon se komandanti ushtarak i merr vendimet në një vakum politik dhe këto vendime bazohen vetëm në preferenca ushtarake. Ky supozim është i nevojshëm për të siguruar një strukturë konceptuale për të analizuar rrezikun me të cilin përballet çdo drejtues dhe ato marrëdhënie të rrezikut me njëra tjetrën.[15]

Përdorimi i forcës, apo kërcënimi për përdorimin e saj, është mjeti kryesor nëpërmjet të cilit një komandant e detyron kundërshtarin e vet të bëjë çfarë ai dëshiron. Përdorimi i forcës apo kërcënimi për përdorimin e saj shoqërohet me rritjen e shkallës së rrezikut dhe, së bashku me të, edhe me shkallën e frikës.[16] Në një shkallë më të lartë apo më të vogël, të gjithë njerëzit, burra e gra, e kanë perceptimin e frikës, dhe një komandant ka një rol të rëndësishëm për të ndihmuar ata që janë nën komandën e tij për të tejkaluar frikën e tyre, duke kontribuar në këtë mënyrë në arritjen e suksesit.

Bibliografia:

- Karl Fon Klauzeviç, "Mbi luftën", SHBU, Tiranë, Vëllimi I.
- Karl Fon Klauzeviç , "Mbi luftën", SHBU, Tiranë, Vëllimi II.
- Karl Fon Klauzeviç , "Mbi luftën", SHBU, Tiranë 1995, Vëllimi III.
- DPU 10,Tiranë 2008.
- P.Gardner Howe, "Risk in military operations", NPS, USA, www.dtic.mil/cgi-bin/GetTRDoc.
- AJP 1 (Allied Joint Doctrine), Dhjetor 2010.
- AJP-3.2 (Allied Joint Doctrine).

[13] Karl Fon Klauzeviç ,"Mbi luftën",SHBU,Tiranë 1995,Vëllimi I,fq 140.

[14] P.Gardner HOWE, "Risk in military operations",NPS,USA,www.dtic.mil/cgi-bin/GetTRDoc…aksesuar me 10.02.2013.

[14] AJP 1(Allied Joint Doctrine), Dhjetor 2010.fq 31.

[14] DPU 10,Tirane 2008 Kreu 2,fq 22.

[15] P.Gardner HOWE, "Risk in military operations",NPS,USA,www.dtic.mil/cgi-bin/GetTRDoc…aksesuar me 10.02.2013.

[16] AJP 1 (Allied Joint Doctrine), Dhjetor 2010.fq 31.

Nocioni i pikës kulmore në mbrojtje dhe mësymje

Prof. Dr. Kostaq Karoli
Pedagog i DO

Nënkolonel Edmond Sardi
Kursant i KLO

Trajtesë e shkurtuar. *Karl Filip Gotfrid fon Klauzeviç* (*Carl Philipp Gottfried von Clausewitz) ishte një ushtar dhe teoricien ushtarak gjermano-prusian, i cili vuri në dukje "moralin" (në kuptimin modern, aspekti psikologjik) dhe aspektet politike të luftës. Puna e tij më e shquar, Vom Kriege (Mbi Luftën), mbeti e papërfunduar me vdekjen e tij. Klauzeviç përqafoi një konceptim romantik të luftës, edhe pse ai të paktën një këmbë e kishte të mbështetur fort në idetë më racionaliste të Iluminizmit Evropian. Mendimi i tij është përshkruar shpesh si hegelian për shkak të referencave të tij në të menduarit dialektik, por edhe pse ai ndoshta e njihte Hegelin, dialektika klauzeçiane është mjaft e ndryshme dhe ka pak arsye për ta konsideruar atë një pasues të Hegelit. Ai theksoi ndërveprimin dialektik të faktorëve të ndryshëm, duke vënë në dukje se si zhvillimet e papritura që shpalosen nën "mjegullën e luftës" (p.sh., në kushtet e informacionit të paplotë, të dyshimtë, dhe shpesh krejtësisht të gabuar si dhe nivelet e larta të frikës, dyshimit dhe zemërimit) bëjnë thirrje për vendime të shpejta nga komandantët vigjilentë. Ai e pa historinë si një kontroll me rëndësi jetike për abstraksionet e dijetarëve që nuk përputhen me përvojën.*

Në kontrast me Antoine-Henri Jomini, ai argumentoi se lufta nuk mund të përcaktohet apo reduktohet në punën me harta, gjeometrinë, dhe grafikët. Klauzeviçi kishte aforizma të shumta, nga të cilat më e famshme është se "Lufta është vazhdimi i politikës me mjete të tjera", një përshkrim që ka fituar një pranim të gjerë. Ky punim nuk synon të shqyrtojë cilësitë e burrit Klauzeviç, përkundrazi kjo është një përpjekje për shqyrtimin e ndikimit që "Pika Kulmore" e përshkruar në punimin e tij të shquar "Mbi Luftën", ka pasur në disa nga doktrinat ushtarake të NATO-s dhe Forcave të Armatosura të RSH-së.

Pika Kulmore e Sulmit sipas Klauzeviçit

Përveç teorive të tij themelore të cilat kanë provuar vlefshmërinë e tyre për më shumë se një shekull, Klauzeviçi në veprën "Mbi Luftën" diskuton dhe zhvillon gjithashtu

koncepte praktike se si të zhvillohet lufta. Pika Kulmore e Sulmit dhe Pika Kulmore e Fitores janë koncepte që Klauzeviçi ka zhvilluar me detaje. Të dy konceptet janë të bazuara në të kuptuarit e tij për strategjinë. Megjithatë, siç e shohim sot, ato janë të lidhura me nivele të ndryshme të luftës. Pika Kulmore e Sulmit është një koncept operacional. Pika Kulmore e Fitores është e lidhur me objektivat strategjike të një fushate dhe rezultatin e luftës dhe për pasojë është një koncept strategjik.

Të dy konceptet janë të ndryshme, por ato ndikojnë mbi njëri-tjetrin. Si një deduksion i mendimeve të Klauzeviçit, Pika Kulmore e Mbrojtjes është një koncept i nënkuptuar dhe mund të përdoret nga mbrojtësi sapo sulmuesi ka arritur pikën e tij Kulmore të Sulmit. Nuk është e dobishme të shohim për "receta", për të aplikuar këto koncepte. Klauzeviçi nuk jep asnjë recetë, ai i tregon lexuesit të tij se si të mendojë.

Konceptet janë shqyrtuar në imtësinë më të madhe duke përdorur raste studimore. Lufta në Afrikën e Veriut gjatë viteve 1941 dhe 1942 dhe një shtrirje drejt frontit të Lindjes është marrë për të gjetur kritere të rëndësishme për aplikimin e koncepteve të Klauzeviçit në luftën moderne në nivelin operacional, si dhe në nivelin e strategjisë ushtarake.

Forca e shprehur në numra është e rëndësishme, por jo i vetmi faktor për sukses. Inteligjenca, befasia, mashtrimi, cilësia e pajisjeve, komandimi dhe kontrolli, rezerva strategjike, ekuilibri i forcave, pauza operacionale, logjistika dhe furnizimi kontribuojnë gjithashtu për arritjen e një superioriteti relativ. Drejtuesit ushtarakë duhet të vlerësojnë me kujdes të gjitha kriteret për të përcaktuar Pikën Kulmore të Sulmit, Fitores apo Mbrojtjes në një situatë aktuale.

Në këtë pjesë do të përshkruhet në mënyrë të përmbledhur se si e trajton Klauzeviçi në veprën e tij "Mbi Luftën", vendin dhe rolin e Pikës Kulmore në suksesin apo dështimin e një operacioni, qoftë ky mbrojtës apo mësymës: vetëkuptohet që suksesi në sulm është rezultat i një epërsie të qenësishme, duke llogaritur forcat fizike dhe morale në kompleksin e tyre. Forca materiale e sulmuesit shterohet pak nga pak. Ka mundësi që, pa marrë parasysh këtë, epërsia e tij shtohet për shkak të dobësimit përpjesëtueshmërisht më të madh nga ana e mbrojtësit, por në pjesën më të madhe të rasteve ndodh e kundërta.

Sulmuesi sigurisht i blen pengjet e paqes të paracaktuara për të pasur vlerë të tillë në negociatat e mëpastajme, por i paguan këto pengje në vend, si me thënë "me paré në dorë", me çmimin e një pjese të forcave të veta. Nëse epërsia, qoftë edhe vazhdimisht zbritëse, mbahet nga sulmuesi deri në përfundimin e paqes, qëllimi është arritur. Ekzistojnë edhe rezultate sulmuese strategjike, që kanë sjellë në mënyrë të menjëhershme paqen, por këto janë raste të rralla. Pjesa më e madhe, përkundrazi arrin deri në një pikë në të cilën forcat që disponohen nga sulmuesi nuk i mjaftojnë për të qëndruar mbi mbrojtjen, në pritje të paqes. Matanë kësaj pike fillon përmbysja e situatës, kundërveprimi i mbrojtësit, madje me një fuqi jashtëzakonisht të madhe nga sa ka qenë energjia e goditjes së sulmuesit. Nëse qëllimi i atij që sulmon është zotërimi i territorit armik, atëherë përparimi i tij duhet të vazhdojë derisa epërsia të mos jetë shteruar. Ky kriter e shtyn sulmuesin gjithmonë përpara drejt qëllimit të tij. Nëse vlerësohet larmia e faktorëve që hyjnë në ekuacionin krahasues të forcave, do të kuptohet sa e vështirë do të jetë në shumë raste që të gjykosh se nga cila anë gje-

ndet epërsia. Shpesh gjithçka varet nga filli i mëndafshit të përfytyrimit.

Pika Kulmore e Fitores sipas Klauzeviçit

Jo në të gjitha luftërat ndodh që fitimtari të jetë në gjendje që ta asgjësojë plotësisht kundërshtarin. Nganjëherë, dhe ky është madje rasti më i shpeshtë, ekziston një Pikë Kulmore e Fitores. Dhe këtë përvoja e provon me bollëk. Por ngaqë ky problem ka shumë rëndësi në teorinë e luftës dhe shërben si bazë për të gjitha planet e fushatës, ai paraqet një lojë dritash në kontrast të dukshëm dhe ia vlen të shqyrtohet nga afër e jo në sipërfaqe, duke kërkuar shkaqet e tij.

Në përgjithësi fitorja rezulton nga një epërsi e shumës së të gjitha forcave fizike e morale; ajo e rrit në mënyrë të pakundërshtueshme këtë shumë, ngaqë pa këtë ajo nuk do të kërkohej me më shumë mund dhe nuk do të ishte e domosdoshme të paguhej edhe me çmim të shtrenjtë. Fitorja e krijon në vetvete një rezultat të tillë. Edhe pasojat e saj e krijojnë gjithashtu, veç deri në një farë shkalle. Kjo shkallë mund të jetë mjaft afër, nganjëherë ajo është kaq afër sa të gjitha rezultatet e betejës së fituar mund të kufizohen me rritjen e rënies morale....[1]

Pas gjithë këtyre del domosdoshmërish një çështje, që na bën të pyesim: nëse është kështu, ç'e detyron fitimtarin të ndjekë kursin e fitores së vet, të vazhdojë përparimin sulmues? Dhe a mund të flitet më tej për të shfrytëzuar fitoren? Nuk do të dukej më e mirë të ndalohej atje ku epërsia e fituar ende nuk ka pësuar zvogëlime? Në këtë rast duhet të përgjigjemi: epërsia është një mjet dhe nuk është një qëllim. Qëllimi është ose rrëzimi përtokë i armikut ose së paku pushtimi i një pjese të territorit të tij, për të qenë në gjendje që në veprimin përfundimtar të paqes, të mbahen parasysh përparësitë e fituara.

Edhe kur duam ta rrëzojmë krejtësisht përtokë kundërshtarin duhet të vërejmë me kujdes çdo hap tonin, ku shquhet padyshim një pakësim i epërsisë sonë. Veç nuk del e nevojshme aspak që kjo të bëhet para se të fillojë rënia graduale e armikut. Kjo rënie mund të ndodhë më përpara. Edhe nëse mund ta provokojmë këtë rënie, duke e shtyrë deri në kufirin e skajshëm mbajtjen e ekuilibrit, do të bëhej një gabim i rëndë duke mos e kryer atë. Epërsia që zotërohet ose fitohet në luftë është vetëm një mjet dhe jo një qëllim dhe ajo duhet të sakrifikohet për këtë të fundit. Por lipset të dihet pika që shënon kufirin për të mos e tejkaluar atë, sepse kështu do të mblidhnim dëmet në vend të përparësive të reja.

Nuk kemi nevojë të citojmë shembuj të veçantë të nxjerrë nga përvoja për të treguar që epërsia strategjike në sulm shteron. Në të kundërt, është masa ekzistuese e fakteve që na ka shtyrë për të kërkuar shkaqet e brendshme. Vetëm pas shfaqjes së Bonapartit kemi parë fushata lufte midis kombeve të qytetëruara me të cilat epërsia ka çuar pa ndërprerje drejt rënies së kundërshtarit. Përpara tij të gjitha fushatat përfundonin me kërkimin e një pike, në të cilën do të mund të mbahej një ekuilibër i vërtetë nga ana e ushtrisë fitimtare. Në këtë pikë, vrulli i përparimit të fitimtarit pushonte, nëse nuk bëhej e nevojshme një tërheqje. Kjo pikë kulmore e fitores do të ekzistojë gjithmonë edhe në të gjitha luftërat e ardhshme, në të cilat objektivi luftarak nuk është rrëzimi

[1] *Mbi Luftën Vëllimi III,* Karl Fon Klauzeviç, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1996, faqe 475-476

përtokë i kundërshtarit, një karakteristikë kjo, që do ta kenë, për më tepër, thuajse të gjitha luftërat. Prandaj gjithë planet e fushatës duhet të synojnë natyrisht në këtë pikë kulmore në të cilën sulmi kthehet në mbrojtje...[2]

Pika Kulmore sipas Doktrinës së Përbashkët të Aleancës AJP 01 (D)

Edhe Aleanca e NATO-s duket se zbaton konceptet e Klauzeviçit në nivelin operacional dhe në atë strategjik. Duke qenë se NATO nuk mund të arrijë një epërsi në numër, Aleanca duhet të përdorë të gjithë faktorët e tjerë që kontribuojnë në arritjen e suksesit. Duke aplikuar këto koncepte, do të jetë e mundur tani dhe në të ardhmen për të bindur kundërshtarin që asnjë fitore vendimtare dhe asnjë Pikë Kulmore Fitoreje nuk mund të arrihet dhe kështu mund të ruhet paqja.

Këtë e dëshmon qartë fakti që edhe Doktrina e Përbashkët e kësaj aleance, një vëmendje të veçantë i kushton këtij fenomeni, ku ndër të tjera thuhet: "Pika Kulmore arrihet si në operacionet mësymëse dhe mbrojtëse. Në mësymje, pika kulmore është pika në kohën dhe vendin, kur fuqia luftarake e mësymësit nuk është më e madhe se e mbrojtësit dhe mësymësi duhet të kalojë në mbrojtje ose rrezikon kundërgoditjen dhe të pësojë disfatën. Një forcë në mbrojtje, e arrin pikën e vet kulmore, kur ajo nuk ka më aftësinë për t'u hedhur në kundërmësymje ose për të mbrojtur më gjatë pozicionet e veta dhe është e detyruar që, ose të shkëputë kontaktin, ose të tërhiqet, ose të përballet me disfatën. Identifikimi i Pikës Kulmore lejon shfrytëzimin e plotë të ngjarjes ose planëzimin e pauzave operacionale, në mënyrë që ta shmangë atë. Renditja dhe ndarja në faza duhet të planëzohen për të siguruar që operacionet e forcave të kundërshtarit, të arrijnë pikën kulmore, shumë më parë se ato të arrijnë objektivin e tyre, ndërkohë që operacionet e forcave tona të realizojnë objektivin e tyre, shumë më përpara arritjes së ndonjë pike kulmore."[3]

Pika Kulmore sipas Doktrinës së Përbashkët të Aleancës për planëzimin në nivelin operativ AJP 5

Doktrina e përbashkët e Aleancës për planëzimin në nivelin operativ mban thuajse të njëjtin qëndrim sikurse Klauzeviçi kur trajton pikën kulmore. E veçanta e kësaj doktrine është se ajo vë theksin në masat që duhet të merren qysh në fazën e planëzimit, me qëllim që kundërshtari të arrijë pikën kulmore përpara se të arrijë objektivin ndërkohë që forcat tona duhet të kenë arritur objektivin përpara se të arrijnë pikën kulmore. Ja çfarë thuhet në AJP 5, në lidhje me këtë çështje:

Pika kulmore është një pikë në operacion kur një forcë nuk mund të vazhdojë më operacionin aktual në formën që e ka nisur. Degëzimet në planëzim dhe ndarja në faza skicohen me qëllim që të sigurohemi që operacioni i kundërshtarit arrin pikën kulmore mjaft përpara se të arrijë objektivin, ndërkohë që forcat e veta arrijnë objektivin mjaft përpara se të arrijnë pikën kulmore. Kështu që, skicimi i operacionit duhet të përcaktojë mënyrat për ta përshpejtuar arritjen e pikës kulmore nga kundërshtari dhe përjashtimin e arritjes nga forcat e veta. Pika kulmore ndodh edhe në mësymje, edhe në mbrojtje:

[2] Po aty, faqe 484-486

[3] *AJP-01 (D) Doktrina e Përbashkët e Aleancës*, faqe 98.

- Në mësymje, forca që mësyn arrin pikën kulmore atëherë kur nuk është më në gjendje të vazhdojë mësymjen dhe duhet të kalojë në mbrojtje ose rrezikon pësimin e kundërmësymjes (kundërsulmit) dhe shpartallimin.
- Në mbrojtje, forca që mbrohet arrin pikën e saj kulmore kur nuk ka më mundësi e kapacitete të kundërsulmojë ose të mbrohet me sukses dhe për pasojë, është e detyruar të shkëpusë kontaktin, të tërhiqet ose të përballet me humbjen.[4]

Pika Kulmore e Sulmit gjatë mësymjes së forcave "AXIS" në vitin 1942

Rast studimor

Rommel në fazat e para të betejës aplikoi konceptin e Pikës Kulmore të Sulmit. Duke marrë *Cyreneica*-n perëndimore dhe duke arritur në Gazala, *Rommel* përfundoi sulmin e tij dhe u vu në pozita mbrojtëse. Kjo erdhi me siguri edhe për shkak se ai mbeti pa furnizime. Megjithatë, ne duhet të vlerësojmë faktin se ai, në këtë rast, shfrytëzoi suksesin e tij fillestar në masën maksimale. Me sulmin e tij të vazhdueshëm në Gazala përballë shumë shqetësimeve të Komandës së Lartë Italiane, *Rommel* kishte fituar disa avantazhe. Ai tashmë kishte një pozitë të favorshme për mbrojtje, si dhe për vazhdimin e mëvonshëm të sulmit të tij për në Tobruk. Me *Benghazi*-n, ai kishte një port shtesë për furnizimet e tij. *Rommel* në vlerësimin e tij për konfuzionin e britanikëve, provoi të kishte të drejtë.

Pjesa e dytë e sulmit është e vështirë për t'u gjykuar. Çuditërisht *Rommel* arriti sukses në kapjen e *Tobruk*-ut shumë herët. Kjo duhet të konsiderohet si një gabim që sekuenca e ngjarjeve për të cilën ishte rënë dakord tashmë ishte ndryshuar. Malta nuk u sulmua dhe *Rommel* vazhdoi përparimin e tij. Ai pa një shans të madh për të kapur Egjiptin dhe Hitleri ra dakord për të ndryshuar planin. *Rommel* u përpoq të imponojë vendimin dhe dështoi. Ai mundi të shkatërrojë pjesën më të madhe të forcave të blinduara britanike, por ofensiva e tij në El Alamein përfundimisht u zmbraps. Ndalesa në El Alamein nuk ishte një aplikim i konceptit të Pikës Kulmore të Sulmit, por një ndalim i detyruar nga një mbrojtje të suksesshme, pakësimi dhe lodhja e forcave Axis. El Alamein në të vërtetë ishte përtej Pikës Kulmore të Sulmit, sepse perspektivat për një mbrojtje të suksesshme ishin të dyshimta.

Sir David Hunt krahason situatën e gjermanëve dhe britanikëve në El Alamein: "Ne (forcat britanike) ishim tashmë ekzaktësisht përballë dyerve tona të furnizimit, me burimet e plota të bazës në Lindjen e Mesme, në distancë të përshtatshme mbrapa vijave tona. Ato ishin në shtrirjen e tyre të plotë në të cilat komunikimet ishin shtrirë si kurrë ndonjëherë në gjithë rrjedhën e luftërave të shkretëtirës.... E gjithë gjatësia e këtyre linjave të komunikimit ishte nën goditje të vazhdueshme nga ajri, element në të cilin ne kishim epërsi të plotë. E gjithë kjo ishte rezultat i rrufeshmërisë të *Rommel*-it, në ngutjen e përparimit të tij." [5] Në kërkim të arsyeve të humbjes përfundimtare të forcave Axis në shkretëtirë, ne duhet të shqyrtojmë aspektet strategjike dhe të shohim për Pikën Kulmore të Fitores në luftën e shkretëtirës.

[4] *AJP 5 Doktrina e Përbashkët e Aleancës Për Planëzimin në Nivelin Operativ*, faqe 55
[5] *ADon at War*, Sir David Hunt, London, William Kimber and Co. limited, 1966, p.121,122

Pika Kulmore e Fitores gjatë mësymjes së forcave "AXIS" në vitin 1942

Rast studimor

Në kërkim të Pikës Kulmore të Fitores të secilës palë, ne duhet, së pari, të përcaktojmë objektivat strategjike. Objektivat strategjike britanike ishin të pandryshuara gjatë gjithë fushatës: të godisnin forcat Axis me vendosmëri dhe t'i përzinin ato nga Afrika e Veriut. Teatri i luftës në Afrikën e Veriut, i cili në atë kohë ishte teatri i tyre kryesor, ishte vendi ku ata u ballafaquan direkt me gjermanët dhe këtu ata donin t'i mundnin ata për herë të parë. Suksesi në shkretëtirë ishte supozuar të ishte hapi i parë për një fitore përfundimtare. Edhe në orët e humbjes, objektivat strategjike janë ndjekur me vendosmëri të madhe. Humbjet u zëvendësuan dhe furnizimet ishin garantuar.Një epërsi në numra mund të arrihej, e cila, të paktën, ishte e mjaftueshme për fitoren përfundimtare. Nga ana tjetër, sulmet e suksesshme në linjat e furnizimit të forcave Axis penguan mbërritjen në kohë të forcave dhe furnizimeve për forcat Axis.

Autoritetet Britanike po shihnin mundësinë për një vendim strategjik dhe, më në fund, me ndihmën amerikane, ata arritën qëllimet e tyre strategjike. Vendimi ishte pashmangshmërisht shumë kohë para dorëzimit të forcave Axis në Tunizi. Pika strategjike dhe përfundimtare kulmore e mbrojtjes për forcat britanike në fushatën e shkretëtirës ishte El Alamein. Këtu ishte vendi, ku ata parandaluan një humbje përfundimtare. Këtu ishte vendi, ku ata shfrytëzuan rraskapitjen e forcave Axis. Këtu ishte vendi, ku ata ishin në gjendje të përforcoheshin në një masë të tillë, sa rezultati i fushatës pas El Alamein vetëm mund të vonohej, por jo të parandalohej. Forcat britanike mund të përdornin Pikën (strategjike) Kulmore të Mbrojtjes pasi forcat Axis kishin kapërcyer kufijtë e burimeve të tyre të kufizuara.

Duke vlerësuar palën britanike nga pikëpamja strategjike, duhet të shohim në marrëdhëniet midis *Churchill*-it, liderit politik dhe komandantit në teatrin e luftës, *Auchinleck*, gjatë pjesës më të madhe të kohës. Një pikë kryesore diskutimi ndërmjet tyre në fazat e ndryshme të fushatës ishte kur të nisnin sulmin. Kryeministri ishte nën presion për të nisur një sulm të parakohshëm për arsye politike. Nga ana tjetër, komandanti nuk dëshironte një sulm të parakohshëm me trupat e keqstërvitur dhe pa përvojë. Presioni për një sulm të hershëm provoi të jetë shkatërrues për rezultatin e mësymjes "*Battleaxe*."

Mësimi është i qartë: strategjia duhet të udhëzojë operacionet por instrumenti ushtarak duhet të përdoret me aftësi dhe njohje të thellë të rregullave të tij specifike. Strategjia e forcave Axis ishte e mirëpërcaktuar në fazën e parë të fushatës pas ndërhyrjes gjermane. Objektivi ishte për të parandaluar një humbje dhe për të mbajtur një bazë në Afrikën Veriore. Forcat ishin të mjaftueshme për të arritur këtë qëllim. Suksesi fillestar në nivel operacional, që shpesh fitoi kundër planeve të autoriteteve të Komandës Kombëtare Italiane dhe Gjermane shkaktoi një ndryshimin të objektivave strategjike. U ra dakord për një koncept operacioni me objektivin strategjik për të pushtuar Deltën e Nilit dhe për të dëbuar forcat britanike jashtë Egjiptit.

U vendos për një sekuencë operacionale që përfshinte pushtimin e Maltës, bazë Britanike në Mesdhe, e cila do t'u mundësonte atyre që të ndërprisnin me sukses linjat e furnizimit të forcave Axis. Megjithatë, kjo sekuencë operacionale, u ndryshua

pasi *Rommel* kishte kapur *Tobruk*-un. Ofensiva vazhdoi me qëllim për të arritur në Aleksandri dhe te Delta e Nilit. Mjetet ushtarake nuk u përshtatën me këto objektiva strategjike. Gjermanët, në fillim të 1942, kishin dy mundësi të cilat janë theksuar shumë mirë nga *van Crefeld*: "njëri ishte të pranonin propozimin italian – *Rommeli* duhet të qëndronte aty ku ishte dhe italianët të pushtonin Maltën. Duke supozuar se karburanti për marinën italiane mund të ishte gjetur dhe me disa zgjerime në portin e Bengazit, kjo do të mundësonte *Rommelin* të mbrohej për një kohë të pacaktuar dhe të përgatisë një sulm në shkallë të gjerë në Egjipt në një datë të mëvonshme. Mundësia alternative ishte të silleshin përforcime të mjaftueshme me 2-4 divizione gjermane të blinduara dhe të akumuloheshin rezerva të mjaftueshme në furnizime, për të mundësuar *Rommelin* për të marrë Aleksandrinë me një goditje të vetme."[6] Asnjë prej kurseve të veprimit nuk u zgjodh. Mundësia e tretë për të zgjeruar objektivat strategjike pa përshtatur mjetet ushtarake provoi të ishte e gabuar. Strategjia nuk përcaktoi operacionet, por operacionet përcaktuan strategjinë. Kjo nuk është e gabuar në çdo rast. Çmimi strategjik ishte i lartë. Por, përderisa mjetet ushtarake nuk ishin të mjaftueshme për të arritur objektivat, Pika Kulmore e Fitores u kalua përfundimisht. Mësymja në *El Alamein*, që në të njëjtën kohë ishte një operacion i shkëlqyer, kaloi jo vetëm Pikën Kulmore të Sulmit, por edhe Pikën Kulmore të Fitores, duke i lënë të gjitha avantazhet forcave britanike dhe duke u dhënë atyre mundësinë për të arritur objektivat e tyre strategjike. Është e rrezikshme të kalohet Pika Kulmore e Fitores; në Afrikën e Veriut ky ishte shkaku për humbjen përfundimtare në Tunizi.

Fushata në shkretëtirë ishte si një pasqyrë e gjithë luftës. Ajo përmbante një numër të konsiderueshëm operacionesh të shkëlqyer, të cilët në fund mbingarkuan dhe konsumuan burimet, duke çuar në humbje. Kush duhet të fajësohet për dështimin strategjik? Nuk ka asnjë dyshim se Hitleri ra dakord për të ndryshuar objektivat strategjike dhe sekuencat e operacioneve. Por do të ishte gabim të fajësohet vetëm Hitleri për këtë katastrofë. Ai ndoqi këshillat e *Rommel*-it. Si përfundim, duhet të fajësohen të dy. Të dy mund të kishin kuptuar se ishte e gabuar të përpiqeshin të pushtonin Egjiptin me më pak se tre divizione gjermane. Mësimet janë të dyfishta: strategjia duhet të përcaktojë operacionet, pasi objektivat strategjike janë ndryshuar mjetet ushtarake duhet të përshtaten me kujdes për të arritur këto objektiva.

Pika Kulmore e Mbrojtjes në nivelin operacional të luftës

Pika Kulmore e Mbrojtjes do të jetë një koncept dhe një deduksion nga shkrimet e Klauzeviçit. Nga sa u tha më lart, Pika Kulmore e Sulmit u përcaktua si një si një pikë imagjinare ku superioriteti fillestar i sulmuesit është konsumuar dhe është arritur një ekuilibër i fuqisë luftarake mes kundërshtarëve. Fuqia luftarake e mbetur e sulmuesit është ende e mjaftueshme për një mbrojtje të suksesshme. Kur sulmi vazhdon përtej pikës së tij kulmore, ekuilibri i forcave ndryshon në favor të mbrojtësit. Tani ai ka superioritetin dhe duhet të kundërsulmojë.

Por çuarja e pikës kulmore shumë larg mund të jetë një hap drejt humbjes, vetëm nëse situata shfrytëzohet nga mbrojtësi. Mbrojtësi duhet të kuptojë se sulmuesi ka kaluar pikën e tij kulmore dhe duhet të fillojë një kundërsulm. Për të kapur këtë

[6] *Supplying War*, Martin van Crefeld, Cambridge, University Press, 1977, p.195

moment nuk do të jetë e lehtë. Megjithatë, në qoftë se mbrojtësi është në gjendje për të vlerësuar saktësisht situatën e sulmuesit, nëse ai e shfrytëzon atë me një kundërsulm të kujdesshëm në momentin e duhur, ai do të jetë në gjendje të ndryshojë gjendjen fillestare në favor të tij. Me fjalë të tjera: nuk ekziston vetëm koncepti i "Pikës Kulmore të Sulmit", e cila mund të shfrytëzohet nga sulmuesi, por ka gjithashtu një koncept të "Pikës Kulmore të Mbrojtjes", e cila mund të shfrytëzohet nga mbrojtësi. Klauzeviçi nuk shkroi në lidhje me këtë koncept, por ne jemi ende brenda fushës së konsideratave të tij. Klauzeviçi kërkon nga një mbrojtës të kryejë një kundërsulm në momentin e duhur. Ai merr në konsideratë kalimin nga mbrojtja në një kundërsulm, si një nga tiparet thelbësore të mbrojtjes.

Momenti i përshtatshëm për këtë tranzicion vjen kur armiku ka mbivlerësuar mundësitë e tij dhe sulmi i tij ka kaluar pikën kulmore. Kjo do të thotë se të dy pikat, Pika Kulmore e Sulmit dhe Pika Kulmore e Mbrojtjes nuk mund të jenë të njëjta. Megjithatë, ato mund të jenë shumë afër njëra-tjetrës. Pika Kulmore e një sulmi arrihet dhe koncepti përdoret siç duhet kur një kalimi në një mbrojtje të suksesshme është ende i mundur. Mbrojtësi ka shansin e tij kur kjo pikë është kaluar dhe ai e ka kapur atë. Mbrojtësi duhet të presë për momentin e duhur. Dhe ky moment vjen kur sulmuesi e ka çuar sulmin e tij shumë larg. Prandaj, mbrojtësi nuk mund të përdorë konceptin në mënyrë të pavarur. Përdorimi në mënyrën e duhur varet nga gabimet e sulmuesit.

Bazuar në ekzaminimin e marrëdhënieve midis sulmit dhe mbrojtjes në nivel operacional, ne mund të marrim si të mirëqena tre propozime:

- Në nivelin operacional të luftës ne gjejmë jo vetëm "Pikën Kulmore të Sulmit, por gjithashtu edhe konceptin e "Pikës Kulmore të Mbrojtjes".
- Pika Kulmore e Mbrojtjes arrihet kur sulmi ka kaluar pikën e tij kulmore. Tashmë superioriteti kalon në anën e mbrojtësit dhe ai mund ta shfrytëzojë atë duke kundërsulmuar.
- Mbrojtësi nuk mund ta përdorë këtë koncept në mënyrë të pavarur. Përdorimi i konceptit nga ai, varet nga gabimet e sulmuesit dhe mundësia e tij për t'i kapur ato.

Mbrojtësi mund dhe duhet të inkurajojë sulmuesin të tejkalojë mundësitë e tij. Sapo sulmi të kalojë Pikën Kulmore të Sulmit, shanset për kundërsulm nga ana e mbrojtësit shtohen në mënyrë të konsiderueshme. Për të shqyrtuar këtë temë më tej, ne tani duhet të futim elementin kohë. Ekuilibri pas kalimit nga sulmi në mbrojtje nuk është as i qëndrueshëm dhe, në shumicën e rasteve, as i përhershëm. Të dyja palët do të përpiqen të përdorin pushimin në mënyrë që të rigrupohen e të përforcohen. Nuk ka ndonjë rregull të përgjithshëm se cila anë do të fitojë një avantazh prej pushimit. Megjithatë, shpesh mbrojtësi, me linjat e tij të shkurtra të komunikimit, do të ketë mundësi më të mira për të fituar superioritet.

Pika Kulmore e Mbrojtjes, rast studimor

Para se arrijmë në disa përfundime të përgjithshme, duam të tregojmë, me një shembull, se si koncepti i Pikës Kulmore të Mbrojtjes është aplikuar me vetëdije me

sukses të madh. Do të diskutojmë lidershipin e *Fieldmarshall Manstein* në operacionet kundërgoditëse të grup armatës gjermane Got kundër ofensivës sovjetike ndërmjet *Donetz* dhe *Dnieper*. Beteja e *Kharkov*-it është një nga operacionet më të shkëlqyer të luftës. Kjo është fitorja e fundit e forcave gjermane në Rusi pothuajse e harruar në mes të humbjeve të Stalingradit dhe betejës së Kurskut.

Në muajt e parë të vitit 1943, pasi kishte rënë Stalingradi dhe Armata e 6-të ishte shkatërruar, *Manstein* duhet të parandalonte një disfatë vendimtare të të gjithë grup armatës, një humbje që mund të kishte vendosur fatin e luftës që në fillim të vitit 1943. Pavarësisht disavantazhit në forca dhe sidomos në tanke, duke u përballur me një mësymje ruse prej rreth 100 milje në gjerësi dhe 100 milje në thellësi, *Manstein* fitoi operacionin duke zbatuar konceptin e Pikës Kulmore të Mbrojtjes. Ai u tërhoq prapa për të shkurtuar frontin, manovroi rezervat e tij nga e djathta e tij për në krahun e tij të majtë, ku ai e konsideroi si vendimtare. Qëllimisht dhe qetësisht ai priti për kohën më të mirë për kundërsulm. Kur vijat ruse ishin mbingarkuar dhe forcat e frontit kishin mbetur pa furnizimet thelbësore, *Manstein* kreu kundërgoditjen e tij. Inteligjenca taktike i ofroi informacion për të cilin ai kishte nevojë për të nisur kundërgoditjen e tij në momentin e duhur. Mesazhet e kapura në fillim të shkurtit 1943 nga Inteligjenca Gjermane zbuluan informacionin në lidhje me mungesën e furnizimeve për forcat ruse.

Manstein përcaktoi pikën e kthesës të betejës, Pikën Kulmore të Mbrojtjes. Ai përdori të gjitha rezervat e tij në kulmin e betejës, shkatërroi armatat ruse dhe rimori territorin e humbur. Ai u detyrua të veprojë jashtë një pozicioni të mbrojtjes strategjike, por ai rimori iniciativën. Atij iu desh të luftonte me disavantazh në numër, por ai ishte mjaft i fortë, aty ku beteja ishte vendimtare.

Manstein aplikoi konceptin e Pikës Kulmore të Mbrojtjes qëllimisht. Ai lëshoi territor në mënyrë që të dobësonte armikun dhe të largonte rezervat e tij nga fronti. *Manstein* shkroi për situatën e grup armatës së tij në mes të shkurtit 1943: "Dhe kështu, rreth mesit të shkurtit 1943, kriza akute në zonën e Grup Armatës së Jugut arriti një kulm të ri. Me atë që gjithë krahu jugor do të ishte rrethuar nga një manovër krahëmarrëse e gjerë nga sektori fqinj në veri që kërcënonte të merrte formë herët ose vonë. Dhe përsëri, në mënyrë paradoksale në këtë kulm të krizës u hodh fara e një kundërgoditje"[7]. Duke vlerësuar qëllimet ruse ai shkroi: "Nëse armiku nga çfarëdo shansi do të ishte ambicioz për të arritur në Kiev, ne vetëm do të mund t'i uronim atij një udhëtim të këndshëm." [8]

Manstein arriti sukses në një situatë e cila nuk është shumë e ndryshme nga misioni i NATO-s në rast lufte. Ne do të na duhet të luftojmë në disavantazh përsa i përket numrit, të rimarrim iniciativën jashtë mbrojtjes strategjike dhe të detyrojmë një rezultat të favorshëm. Ai provoi që kjo është e mundur dhe që koncepti i Pikës Kulmore të Mbrojtjes mund të jetë një ndihmë me vlerë.

[7] *Lost Victories*, Erich von Manstein, (Translation of: Verlorene Siege, 1982 edition Bernhard and Graeve Verlag Munich), Novato, Carlifornia, reprinted by Presidio Press, 1982, p.420
[8] Po aty faqe 431

Rekomandime

Që një komandant operacional të ketë një ide funksionale se ku do të jetë pika kulmore e tij, si dhe ajo e armikut gjatë një operacioni të ardhshëm, pjesa më e madhe e punës duhet të bëhet në fazën e planëzimit. Siç edhe dihet, procesi i planëzimit nuk përfshin llogaritjen se ku do të ndodhë pika kulmore. Nëse identifikimi i saktë i vendit të pikës kulmore është një pamundësi para betejës, a mundet që marrja në konsideratë e të gjithë faktorëve që ndikojnë në përcaktimin e vendit të saj të japin një përcaktim të përafërt? Gjatë fazës së planëzimit të një operacioni apo fushate të madhe, pasi është mbledhur dhe sintetizuar gjithë informacioni nga shtabi, së bashku me udhëzimet e komandantit dhe prodhohet një plan operacional ose një urdhër operacional, a ka ndonjë garanci se gjërat do të shkojnë sipas "planit" pasi është shtënë fisheku i parë? Përgjigja për këtë pyetje është e qartë. Një "vlerësim" se ku dhe kur do të ndodhë pika kulmore, mund të realizohet në mënyrë shumë të ngjashme me vlerësimin për logjistikën dhe zbulimin.

Planëzuesit fillimisht mund zhvillojnë një model pune duke i konsideruar "të prekshëm" faktorët që çojnë në kulmim, të ofruara nga Klauzeviçi, doktrinat e NATO-s, Departamentit Amerikan të Mbrojtjes, Forcave të Armatosura të RSH-së si dhe nga autorë të tjerë. Vlerësimet për Logjistikën dhe Zbulimin tashmë trajtojnë shumë nga këta faktorë dhe duhet, në tërësinë e tyre, të përfshihen në modelin e vlerësimit të pikës kulmore. Vështirësia në zhvillimin e një modeli të tillë do të vijë nga përpjekjet për të vlerësuar se si faktorët "e papërcaktuar" do të ndikojnë në përcaktimin e pikës kulmore. Për shembull, si mund të masë një planëzues vullnetin e një armiku, ose gjasat që një aleat i tij do t'i vijë në ndihmë? Si do të matet "mjegulla dhe fërkimet e luftës"? Nuk ka zgjidhje të lehtë për këtë problem kompleks. Kjo mundet shumë mirë të bazohet në intelektin dhe përvojën e planëzuesve, duke përdorur të gjithë informacionin në dispozicion të tyre për të formuluar dhe caktuar "peshën" për këto të panjohura të mëdha.

Nuk ka dyshim se ushqimi i modelit me një sasi të madhe të informacionit do të jetë subjektiv në natyrë. Megjithatë, rezultati i punës së shtabit duhet të sigurojë komandantin me një mjet që do të lejojë atë për të marrë një vendim të informuar, në vend të një hamendësimi, mbi kohën dhe vendin e kulmimit. Nëse një komandant duhet të mbështetet vetëm në gjenialitetin e tij për përcaktimin e pikës kulmore ashtu si sugjeron Klauzeviç, shanset e tij për ta humbur atë do të jenë më të mëdha. Procedurës se si të veprohet duhet të bëhet pjesë e manualeve të planëzimit të përbashkët dhe rezultatet e vlerësimit duhet të përfshihen në planet dhe urdhrat e operacionit.

Edukimi i komandantëve dhe planëzuesve të ardhshëm operacionalë mbi rëndësinë e konceptit të pikës kulmore gjithashtu duhet të rekomandohet me forcë. Lojërat luftarake ofrojnë mundësinë më të mirë për komandantët dhe shtabet e tyre për të qenë të aftë në identifikimin e pikës së tyre kulmore. Stërvitjet e simuluara duhet të përfshijnë modelet që lejojnë komandantin të përfytyrojë se ku ekziston pika kulmore. Kjo padyshim do të jetë një detyrë shumë komplekse dhe e vështirë për t'u arritur, për shumë arsye të njëjta të përmendura më parë që përfshijnë krijimin e një modeli për vlerësimin e pikës kulmore. Aktualisht, lojërat luftarake të simuluara në kompjuter

dhe stërvitjet në terren nuk kanë asnjë mekanizëm që do të llogarisë, me një shkallë të pranueshme saktësie, vendndodhjen e pikës kulmore. Si pasojë, komandanti mëson se ai ka shkuar shumë larg kur kontrolluesi i thotë atij "ju jeni asgjësuar".

Përveç rekomandimit të mësipërm, edhe institucionet e arsimimit ushtarak dhe, veçanërisht Akademia e Forcave të Armatosura, mund të marrin në konsideratë përfshirjen në materialet e kërkuara për studim, edhe të rasteve studimore kryesore historike, që theksojnë rëndësinë e konceptit të pikës kulmore. Këto institucione duhet gjithashtu të përfshijnë leksione dhe seminare që kanë të bëjnë me ndikimin e mundshëm që mentaliteti i një "lufte pa gjak" do të ketë në aftësinë e komandantit për të gjykuar saktë pikën kulmore në fushëbetejat e së ardhmes.

Përfundim

Pika kulmore është një koncept i rëndësishëm që duhet të kuptohet nga komandantët dhe planifikuesit e nivelit operacional të shekullit të 21-të. Kjo është me rëndësi të madhe që pika kulmore e vet dhe ajo e armikut të identifikohet me shkallën më të lartë të mundshme të saktësisë gjatë fazës së planëzimit të një operacioni apo fushate të madhe. Dështimi për të bërë këtë mund të rezultojë në një ndalesë të parakohshme të sulmit, duke përfituar kështu mbrojtësi, ose të çojë në mbishtrirje të forcës së vet, duke i lënë ato të prekshme nga një kundërsulm i armikut.

Ky artikull ka tentuar të tregojë se identifikimi i saktë i pikës kulmore nuk është detyrë e lehtë dhe se dështimi për ta bërë këtë në nivel operacional mund të provojë të jetë katastrofik. Ka faktorë të shumtë, si të prekshëm dhe të paprekshëm, që kontribuojnë në procesin e kulmimit. Planëzuesit duhet të konsiderojnë me kujdes të gjithë këta faktorë, për të lejuar komandantin të marrë një vendim të mirëinformuar në përcaktimin e pikës kulmore. Për të përmbushur këtë detyrë, procesi i planëzimit duhet të përfshijë një vlerësim për pikën kulmore dhe ky vlerësim duhet të përfshihet në planet dhe urdhrat e operacioneve. Edukimi i komandantëve dhe planëzuesve është gjithashtu i rëndësishëm për njohjen e pikës kulmore. Loja luftarake e simuluar duhet të përfshijë një model të projektuar për të lejuar komandantët të përfytyrojnë vendin dhe kohën ku pika kulmore ka më shumë gjasa të ndodhë.

Bibliografia:

- *Mbi Luftën Vëllimi III,* Karl Fon Klauzeviç, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1996
- *Mbi Luftën Vëllimi II,* Karl Fon Klauzeviç, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995
- *AJP-01 (D) Doktrina e Përbashkët e Aleancës*
- *AJP 5 Doktrina e Përbashkët e Aleancës Për Planëzimin në Nivelin Operativ*
- *A Don at War*, Sir David Hunt, London, William Kimber and Co. limited, 1966
- *Supplying War*, Martin van Crefeld, Cambridge, University Press, 1977
- *Lost Victories*, Erich von Manstein, (Translation of: Verlorene Siege, 1982 edition Bernhard and Graeve Verlag Munich), Novato, Carlifornia, reprinted by Presidio Press, 1982

Fuqia luftarake kërkon aftësi drejtimi dhe përgatitje të lartë ushtarake

MSc. Luftim Dema
Shefi i Sektorit të Taktikës, AFA

MSc. Agim Gjini
Specialist në QD, KDS

Nënkolonel Ali Mali
Kursant KLO

Trajtesë e shkurtuar. *Politika ndërkombëtare është në vetvete përpjekja që bëhet nga shtetet kombe për fuqi. Fuqia, në arenën ndërkombëtare, përdoret për mbrojtjen e interesave kombëtare me anë të ndikimit mbi partnerët apo konkurrentët potencial. Instrumenti më i rëndësishëm i fuqisë, që mund të zotërojë një shtet-komb, është fuqia ushtarake. Hans Morgenthau thotë se: "Veçanërisht në politikën ndërkombëtare, fuqia ushtarake, qoftë si kërcënim i drejtpërdrejtë apo si mundësi përdorimi, është faktori më i rëndësishëm material që kontribuon në fuqinë politike të një vendi".*

Elementet e tjerë të fuqisë kombëtare sigurisht që janë të rëndësishëm dhe mund të kontribuojnë për mbështetjen dhe çuarjen përpara të interesave kombëtare; megjithatë, për aq kohë sa shtetet vazhdojnë të jenë në gjendjen e anarkisë, fuqia ushtarake do të vazhdojë të luajë një rol vendimtar në politikën ndërkombëtare. Siç thotë me të drejtë Kenneth Waltz, "Në politikë thuhet që forca do të jetë mjeti i fundit. Në politikën ndërkombëtare, forca shërben jo vetëm si mjet i fundit, por në të vërtetë si forcë e parë dhe e qëndrueshme".

Shtetet e Bashkuara të Amerikës shpenzojnë mbi tetë herë më shumë se buxhetet e përbashkëta të mbrojtjes së Kinës dhe të Rusisë, dhe mbi 25 herë më shumë se shpenzimet e përbashkëta të mbrojtjes së gjashtë "shteteve të papërgjegjshme" të mbetura (Kuba, Irani, Libia, Sudani, Siria dhe Koreja e Veriut).

Këto krahasime nuk pasqyrojnë kontributet e aleatëve më të ngushtë të SHBA-së, dhe as nuk përfshijnë ndikimin e kërkesën prej 400 miliard $ të buxhetit fiskal të

vitit 2005 të Pentagonit, një rritje plotësuese prej 24 % gjatë tre viteve të fundit. Hendeku përfundimtar i aftësive ushtarake në këto kushte është shumë i madh dhe, madje, mund të jetë edhe më i madh nga ai i pasqyruar në krahasimin e buxheteve të mbrojtjes për arsye të udhëheqjes teknologjike dhe cilësisë së lartë profesionale të forcave të armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Operacionet konvencionale të kohëve të fundit në Kosovë, Afganistan dhe Irak vetëm e konfirmojnë në mënyrë më të qartë këtë mbizotërim të tyre. Siç është vënë në dukje kohët e fundit nga Robert Art, fuqia ushtarake aq sa është e rëndësishme për funksionimin e sistemit ndërkombëtar, aq është edhe një instrument shumë i kushtueshëm dhe i rrezikshëm i qeverisjes, që nuk duhet të ushtrohet asnjëherë pa një mençuri dhe efektshmëri të madhe:

Përdorimi korrekt i fuqisë ushtarake nuk jep sigurinë që shteti do të mbrojë të gjitha interesat e tij, por përdorimi jo korrekt do të vendosë një barrë të rëndë në instrumentet e tjerë të fuqisë kombëtare dhe mund ta bëjë të pamundur për një shtet përmbushjen e objektivave të tij. Vendimet nëse duhet përdorur fuqia ushtarake dhe si duhet përdorur ajo, mund të jenë më të rëndësishmit që mund të marrë një shtet.[1]

Fuqia luftarake nënkupton forcën shkatërruese që një njësi ose formacion ushtarak mund të përdorë kundër kundërshtarit, në një kohë të caktuar. Është aftësi e komandantit për të luftuar në operacione të ndryshme, është aftësi për të realizuar misionin. Përcaktimi i FL është një çështje e rëndësishme që merret në konsideratë në planëzimin që bëjnë shtabet ushtarake dhe komandantët, por siç theksohet në të gjitha dokumentet dhe nga përvoja e operacioneve të shumë ushtrive të tjera, është shpesh kritike për suksesin e operacionit analizimi i saktë i elementeve të fuqisë luftarake qoftë i armikut, qoftë i forcave tona.

Analizat që bëhen gjatë planëzimit dhe kryerjes së operacioneve luftarake tregojnë për rëndësinë e madhe të Fuqisë luftarake në kryerjen e misionit. Ajo është një kombinim i efekteve të manovrës, të fuqisë së zjarrit, të mbrojtjes dhe të lidershipit. Ajo është një masë e efektit të përgjithshëm të një force dhe përfshin: numrin, armët, disiplinën, nivelin e stërvitjes, mjeshtërinë taktike, aftësinë luftarake, moralin, vendosmërinë, pajisjet dhe mjetet mbështetëse. Komandantët i kombinojnë elementet e fuqisë luftarake për të plotësuar në mënyrë konstante ndryshimin e kërkesave dhe për të shkatërruar kundërshtarin. Komandantët integrojnë dhe aplikojnë efektet e këtyre elementeve me mbështetjen me shërbime të luftimit, kundër kundërshtarit. Qëllimi i tyre është të kombinojnë në mënyrë të atillë këto elemente që t'i përdorin në pikën vendimtare (qendrën e rëndesës), me qëllim kryerjen e misionit me sa më pak kosto.

Fuqia luftarake

Përvoja e të gjithë luftërave (operacioneve, luftimeve), ka treguar se suksesi është arritur nga ajo palë që ka ditur ose ka shfrytëzuar atë kohë që ka pasur, apo ka krijuar fuqinë luftarake superiore mbi kundërshtarin, në vendin dhe në kohën e duhur.

Me fuqi luftarake duhet të kuptojmë aftësinë për të luftuar.

[1] Guidë për politikën dhe strategjinë e sigurisë kombëtare,Tiranë 209. fq.252.

Shkatërrimi/asgjësimi i forcave të armikut është një nga qëllimet që mund të ndeshet në luftë. Sot mund të ketë raste, që nëpërmjet "kërcënimit të përdorimit të forcës", të arrihen ato synime politike që mund të arriheshin nëpërmjet operacioneve ushtarake. Në luftë/ operacion/ luftim kemi një mjet të vetëm, ndeshjen. Ajo është, në fund të fundit, e vetmja shfaqje, e vetmja veprimtari e efektshme e luftës/ operacionit/ luftimit, pasi asgjësimi i armikut, që është qëllimi i saj, bëhet gjatë ndeshjes dhe nëpërmjet saj.[2]

Po nuk u ndeshe, po nuk u ballafaqove me armikun, nuk mund të arrish asnjë synim apo qëllim.

Të gjitha kombinimet që mund të bëhen në përdorimin e forcave, të armëve dhe zjarrit nuk mund të mos përmbajnë edhe rrezikun, që po me këto kombinime, si kundërpërgjigje, kundërshtari të bëjë të paefektshme kombinimet tona.

Do të ishte e gabuar që, pa një analizë të thellë të kushteve e faktorëve të të dyja palëve, të hidhesh në mësymje apo të kalosh në mbrojtje në mënyrë të verbër. Për shembull, të "aventurosh", të hidhesh në mënyrë të verbër, në vend që të asgjësosh kundërshtarin armik, do të vësh para asgjësimit forcat tona, ose dhe po të fitosh, fitorja do të jetë me humbje shumë të mëdha. Efikasiteti më i lartë i takon jo mjetit (forca të gjalla, armë etj.), por qëllimit.[3] Kjo ka qenë dhe mbetet gjithmonë dukuria kryesore në çdo operacion (luftim). Fitoret "si e Pirros", asnjëherë nuk janë të leverdishme, dhe kjo është kryesore. Prandaj, gjithmonë theksohet që plotësimi i detyrës së operacionit, plotësimi i misionit të bëhet në kohën më të shkurtër, me humbje më të pakta dhe shpenzime më të vogla.

Shpesh herë gjejmë shprehjet: "Përqendrimi i forcave dhe i mjeteve", "Përqendrimi i fuqisë luftarake", "Përqendrimi i përpjekjeve". Dua të theksoj që sido qofshin ato, thelbi i kuptimit dhe përmbajtjes së tyre, në fund të fundit, është dhe ka të bëjë me "fuqinë luftarake".

"Përqendrimi i forcave". Fuqia luftarake duhet të përqendrohet në vendin e përzgjedhur, me synim arritjen e rezultateve vendimtare.

"Përqendrimi i përpjekjeve". Suksesi ushtarak në betejë do të kushtëzohet nga përqendrimi i fuqisë luftarake superiore, në vendin dhe kohën vendimtare.[4]

Me "fuqi luftarake" kuptojmë tërësinë e mundësive të një fuqie dëmtuese dhe asgjësuese që një njësi (veprat, mënyrat) ushtarake mund të realizojë kundër qendrës se rëndesës së armikut, në një kohë të dhënë".[5]

Dihet që çdo njësi (repart) hyn në luftë (operacion, luftim) me një përbërje të caktuar në njerëz dhe armatim. Gjithashtu, për plotësimin e misionit, atyre mund t'u jepen në vartësi apo të mbështeten edhe me njësi apo repartet të tjera. Por në çdo rast, për t'i diktuar armikut vullnetin e vet dhe për të plotësuar detyrën, njerëzit (efektivat) përdorin armët dhe fuqinë e tyre të zjarrit. Pikërisht, fuqia e njësisë (repartit) matet

[2] K.F Klauzeviç "Mbi luftën" Tiranë, 1994.Vol.II.
[3] K.F Klauzeviç, Ibid. Vol.III.
[4] ATP-35 (B), Tiranë, 1999, fq.31.
[5] FM 100-40, Tiranë, 2002, fq. 76.

nëpërmjet asgjësimit (kopjes rob) të kundërshtarit dhe plotësimit të misionit të ngarkuar.

Pra, në fund të fundit, fuqia luftarake përcakton fatin e një beteje apo luftimi. Ajo, siç e theksuam më lart, është aftësia për të luftuar. Në luftë,-ka thënë Klauzeviçi-gjithçka është shumë e thjeshtë, por gjëja më e thjeshtë nuk është e lehtë.[6]

Duke pasur parasysh shprehjen e Klauzeviçit, arrijmë në një përfundim që duhet mbajtur në konsideratë; që fuqia nuk është një shprehje aritmetike. Çdo llogaritje, thjesht mbi bazën e manualeve, nuk është e drejtë dhe nuk duhet bërë. Rastet e shumta të historisë së luftërave dhe operacioneve, kur forca numerikisht më të vogla, më pak të armatosura kanë arritur të fitojnë, e dëshmon më së miri këtë. Edhe formula e "ligjit të epërsisë numerike"[7] e Klauzeviçit që P = N.V.Q , ku N-numri i trupave; V-koeficientët e ndryshueshëm të ndikimit të rrethanave luftarake; Q-vlera e cilësia luftarake e trupave duhet plotësuar e llogaritur me ato elemente e faktorë që përmendëm më lart.

Po kështu duhet të evidentojmë se jo të gjitha ato elemente, në momente apo faza të përgatitjes, zhvillimit e përfundimit të operacionit, kanë vlerë të njëjtë. Vlera e tyre del në pah në momente të caktuara dhe shpesh ndërrojnë rolet me njëra-tjetrën. Në një moment merr vlera më të mëdha nisma; në një tjetër befasia; në një tjetër manovra etj. Përvoja ka treguar që rritja numerike, mbi atë që është e nevojshme për plotësimin e detyrës jo vetëm që nuk ekonomizon forcat, por sjell ndonjë ndryshim cilësor në operacion. Përkundrazi, ajo mund të çojë trupat në pasivitet.

Një karakteristikë e fuqisë luftarake është relativiteti i saj. Me këtë duhet të kuptojmë se ajo, në ecurinë e operacionit, mund të ndryshojë. Prandaj, krijimi i epërsisë për shembull, në të gjitha aspektet, në fillim të operacionit duhet mbajtur gjatë gjithë ecurisë së tij, mbi bazën e përdorimit të rezervave (skalioneve të dyta), në kohën e vendin e duhur, nëpërmjet shfrytëzimit të terrenit, manovrës, shpejtësisë, thyerjes së kundërsulmeve të armikut, nëpërmjet prishjes së planeve të tij, etj.

Sipas AJP-01(D), në përcaktimin e fuqisë luftarake ka pak rëndësi sa të avancuara janë platformat, armatimet apo sensorët e njësive aleate, nëse njerëzit që i drejtojnë ato janë të pamotivuar, janë të patrajnuar apo u mungon lidershipi i duhur. Nga ana tjetër, komponentët nuk janë të pavarur nga njëri-tjetri, secili prej tyre integrohet me të tjerët.

Elementet e fuqisë luftarake

Fuqia luftarake e njësisë, e repartit përbëhet nga këto elemente[8]:

- Komandimi dhe udhëheqja ushtarake.
- Manovra.
- Fuqia e zjarrit.
- Ruajtja.
- Informacioni.

[6] AJP-3.2,Tiranë,2011, fq.1-5.
[7] T.N.Dupoi, "Kuptimi i luftës"Tiranë 1997,fq.52.
[8] DPU-10,Tiranë 2009.fq.163.

- Mbështetja logjistike.

Fuqia luftarake shpreh aftësinë për të luftuar, për të arritur suksesin dhe për të mos lejuar armikun të kundërveprojë. Ajo është relative dhe jo absolute, pasi ajo merr vlerë kur krahasohet me fuqinë luftarake që mund të krijojë armiku. Kombinimi i të gjithë elementeve të fuqisë luftarake: manovrës, fuqisë së zjarrit, mbrojtjes dhe udhëheqjes përbën thelbin dinamik të fuqisë luftarake.

Fuqia luftarake është efekti i krijuar nga kombinimi i këtyre elementeve dinamike në veprimet luftarake. Komandanti siguron fuqinë luftarake nga parashikimi i operacioneve të mëvonshme dhe nga angazhimi dhe zbatimi dinamik i kësaj fuqie. Informacioni për kapacitetet e forcave tona e të armikut është elementi kyç për të siguruar mbështetjen e fuqisë luftarake.

Komandimi dhe udhëheqja ushtarake

Komandimi dhe udhëheqja ushtarake janë elementet më dinamike të fuqisë luftarake. Besimi, guximi dhe kompetenca e udhëheqësit prodhojnë elemente të tjera të fuqisë luftarake dhe shërbejnë si nxitës për të krijuar kushte për sukses. Ata sigurojnë qëllimin, udhëzimet dhe motivojnë të gjitha operacionet. Detyrë e çdo udhëheqësi është kompetenca në profesionin e ushtarakut. Ajo kërkon aftësi komunikuese, konceptuese, teknike dhe taktike. Udhëheqësi ushtarak i krijon këto aftësi nëpërmjet stërvitjeve të vazhdueshme dhe studimit të vazhdueshëm. Është detyrë e komandantëve dhe udhëheqësve ushtarakë që të edukojnë, stërvitin dhe formojnë vartësit e tyre me vullnetin ushtarak, kompetencën profesionale, personalitetin, kurajën, besimin dhe punën në grup.

Manovra

Manovra i vendos forcat në një pozicion të favorshëm nga ku armiku mund të kapet në befasi, të paralizohet ose të sulmohet. Po ashtu, ajo mund ta bëjë atë që të besojë se është mundur. Manovra ka disa qëllime, si:

a. Të kapet një pozicion nga i cili mund të hapet zjarr. Kjo mund të sjellë përqendrime të befasishme të zjarrit, të paracaktuara për të mundësuar lëvizjen e mëtejshme përballë armikut.

b. Të fitohet një pozicion që lejon arritjen e befasisë; ndoshta nëpërmjet sulmit nga një drejtim i papritur a i paruajtur, ose përpara se mësymësi ta presë atë.

c. Të parandalojë një manovër të armikut duke kapur e pushtuar terren, që është kyç për planet e tij.

Manovra mund të jetë e shkallës strategjike, operative dhe taktike

a. Manovra strategjike. Kjo manovër përfshin përhapjen dhe vendosjen e organizuar të forcave e të burimeve në një drejtim strategjik të kërcënuar.

b. Manovra operative përfshin vendosjen e forcave ushtarake dhe të burimeve të tjera, në një kohë dhe vend të caktuar, për të siguruar një përparësi operative. Edhe lëvizjet për dislokim, jashtë rajonit të operacionit, janë manovra operative nëse ato sigurojnë një avantazh pozicional dhe ndikojnë në vijimësinë e operacionit kryesor ose të betejës. Për të arritur rezultate operative, komandantët kërkojnë të arrijnë

përparësi apozicionale, përpara se të fillojë beteja dhe shfrytëzojnë suksesin taktik. Kjo manovër siguron përparësi apozicionale, përpara se të veprojë armiku. Lëvizjet dhe manovra operative u lejojnë komandantëve që të krijojnë kushtet e dëshiruara për betejë dhe të shfrytëzojnë plotësisht suksesin e veprimeve taktike.

c. Manovra taktike ndikon drejtpërdrejt në suksesin e betejës ose të luftimit. Si në mbrojtje dhe në mësymje, nëpërmjet manovrës taktike, forcat dhe mjetet vendosen në pozicione të favorshme për t'u ruajtur nga zjarri i armikut dhe për ta dëmtuar apo shkatërruar atë. Manovra taktike e suksesshme shkakton vazhdimisht probleme për armikun.

Fuqia e zjarrit

Fuqia e zjarrit shkatërron, paaftëson, paralizon, demoralizon dhe dëmton. Fuqia e zjarrit mund të lëshohet nga platforma detare, tokësore e ajrore. Ajo ka efekte fizike, psikologjike dhe fiziologjike. Fuqia e zjarrit i jep mundësi forcës të rritë ose të lehtësojë efektet e ritmit, të njëkohshmërisë dhe të befasisë.

Efektshmëria e saj varet nga vëllimi, saktësia dhe befasia e zjarrit ose paparashikueshmëria e tij.

Efektet psikologjike e fiziologjike të fuqisë së zjarrit janë të përkohshme dhe duhet të shfrytëzohen nëpërmjet manovrës, përpara se të shuhet. Prandaj, operacionet e efektshme kërkojnë bashkërendim të ngushtë ndërmjet fuqisë së zjarrit dhe manovrës.[9]

a. Zjarret operative janë sistemi i organizuar i zjarrit në njësitë e nivelit operativ e lart, gjatë zhvillimit të një fushate apo operacioni kryesor. Ato janë përbërës i rëndësishëm i çdo plani operativ. Komandantët i drejtojnë zjarret operative kundër objektivave, nga shkatërrimi ose paaftësimi i të cilëve priten efekte të rëndësishme. Planëzimi i zjarreve operative përfshin caktimin dhe ndarjen e ndërthurur të sistemeve të armëve të mjeteve ajrore, detare e tokësore.

b. Zjarret taktike shkatërrojnë ose paaftësojnë forcat e armikut, pengojnë zjarret dhe përçajnë lëvizjen e tij. Përqendrimi maksimal i zjarreve taktike kërkon një kuptim të plotë të synimeve të komandantit dhe aftësi për të përdorur njëkohësisht të gjitha mjetet në dispozicion, kundër një numri të madh e të ndryshëm të objektivave. Zbatimi i efektshëm i zjarreve taktike shtron detyrën e përcaktimit të përparësive për zbulimin dhe përzgjedhjen e objektivave, caktimin e mjeteve të fuqisë së zjarrit dhe vlerësimin e efekteve. Zjarret e efektshme kërkojnë përgatitje të lartë, kompetencë në drejtimin e njësisë, repartit dhe shkallë të lartë kuptimi të situatës.

Ruajtja

Ruajtja e aftësisë luftarake të një force ka për qëllim që komandanti të përdorë forcën maksimale, në vendin dhe kohën kritike. Forcat e Armatosura veprojnë në një mjedis ku gjithmonë mund të ndodhin plagosje dhe vrasje. Spektri i operacioneve ushtarake krijon një marrëdhënie karakteristike të brendshme, ndërmjet përmbushjes se misionit dhe humbjeve që mund të pësosh. Prandaj, gjatë përmbushjes së misionit i jepet përparësi shmangies së humbjeve sa më shumë që të jetë e mundur. Ruajtja përfshin

[9] AJP-3-2,Tiranë 2011, fq 2-8.

katër përbërës kryesor: Ruajtja e forcave, disiplina taktike në fushën e luftimit, siguria dhe shmangia e vrasjeve nga pakujdesia.

a. Ruajtja e forcës konsiston në ndërmarrjen e veprimeve për të parandaluar ose pakësuar efektet e veprimtarisë së armikut, kundër personelit, burimeve, pajisjeve dhe informacionit të rëndësishëm. Me këto veprime ruhet fuqia luftarake dhe bashkërendohen e sinkronizohen masat mbrojtëse e mësymëse, për të mundësuar përdorimin e efektshëm të forcave, duke ulur njëkohësisht mundësitë e armikut. Ruajtja e forcave përfshin: mbrojtjen ajrore, detare dhe tokësore; MKK; mbrojtjen atomike dhe bakteriologjike; veprimet terroriste, informacionit dhe ruajtjen e forcave dhe mjeteve.

b. Disiplina taktike në fushën e luftimit është përbërësi i dytë i ruajtjes, sepse të mbron nga efektet fizike dhe psikologjike të mjedisit të luftës, i cili mund të ligështojë trupat dhe dobësojë moralin e tyre më shpejt se veprimet e armikut. Për këtë duhet të sigurohen sisteme të efektshme për mirëmbajtjen, evakuimin dhe zhvendosjen ose riparimin e teknikës e pajisjeve. Komandantët duhet të kujdesen me përparësi për nevojat bazë të ushtarëve të tyre dhe të parandalojnë ekspozimin e panevojshëm në kushte dhe situata të papërshtatshme.

c. Siguria është përbërës i rëndësishëm i ruajtjes. Kushtet e operacionit paraqesin rreziqe të mëdha për shëndetin dhe jetën e personelit, si dhe vështirësojnë përdorimin e teknikës. Gjatë operacionit, komandantët duhet të njohin dhe vlerësojnë kufijtë e durimit njerëzor. Në beteja, lodhja zgjat kohën e reagimit, ul gatishmërinë dhe pakëson fuqinë luftarake e dëshirën për të luftuar. Duke ruajtur një nivel të lartë të disiplinës ushtarake, komandantët duhet t'i pakësojnë këto rreziqe.

d. Shmangia e vrasjeve nga pakujdesia konsiston në marrjen e masave për t'i eliminuar ato nga zjarri i personelit të forcave tona. Kryerja e manovrave të thella dhe në kushtet e terrenit dhe motit të keq, mund të shtojnë këtë rrezik. Prandaj kërkohet zbatimi me korrektësi i zjarreve, forcimi i disiplinës taktike në fushën e luftimit dhe sinkronizimi i veprimeve luftarake për ndryshimet dinamike të situatës dhe vendndodhjen e trupave tona, për të shmangur mundësinë e goditjes se tyre nga zjarri i sistemeve të armëve tona.

Informacioni

Grumbullimi, analiza, shpërndarja dhe shkëmbimi i informacionit të zbulimit do të jetë një faktor vendimtar si për parashikimin, ashtu dhe për parandalimin dhe mbajtjen nën kontroll të konflikteve. Në proceset e përpunimit të informacionit të zbulimit përfshihen shumë agjenci, prandaj është e nevojshme që të formësohet një kuptim i plotë i mjedisit operacional dhe të artikulohet një përqasje proaktive, qysh në fazat e hershme të lindjes së një krize.[10]

"Media, -thoshte Klauzeviçi, -përbën një urë lidhëse midis qeverisë, popullit dhe ushtrisë."[11] Ndërsa Napoleoni, në lidhje me këtë, do të thoshte se: "Katër gazeta kundër janë më të frikshme se 1000 bajoneta".

[10] AJP-01(D),Tiranë 2011, fq.35.
[11] Klauzeviç "Mbi luftën" V.I.Tiranë 1994.

Ne nuk do të mundemi ta fitojmë një betejë, n.q.s stacione të fuqishme mediatike, si, CCN etj., thonë se ne nuk do ta fitojmë atë -do të theksonte K. Pauell**.** Informacioni i lejon komandantët të marrin vendime të drejta për kombinacione operative të suksesshme në fushën e luftës. Ajo u lejon komandantëve të menaxhojnë dhe të shpërndajnë me sukses të dhënat e zbulimit ushtarak e të informacionit. Komunikimi i shpejtë dhe i saktë i vendimeve që merren siguron përqendrimin e fuqisë luftarake më shpejt dhe në mënyrë më të efektshme se armiku.

Mbështetja logjistike

Sistemet e mbështetjes logjistike, në të gjitha veprimtaritë e forcave, janë elemente të rëndësishëm për fuqinë luftarake. Mbështetja logjistike siguron kushte materiale, pajisje, teknike, armatim, kujdesin shëndetësor e veterinar, rezervat, furnizimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme për krijimin dhe ruajtjen e fuqisë luftarake dhe për veprimtarinë e efektshme në të gjitha llojet e operacioneve. Logjistika siguron lëvizjen e njësive, të personelit, të pajisjeve dhe furnizimin e tyre në kohë, për zbatimin e synimeve të komandantëve. Mbështetja logjistike zbatohet në përputhje me situatën, llojet e operacioneve dhe konceptet e vendimmarrjes, me qëllim që të rritet fuqia luftarake. Ajo siguron vend furnizime e vend mjekime të përparuara, për të siguruar sa më mirë vijimësinë e fuqisë luftarake gjatë gjithë fazave të operacionit. Mbështetja logjistike synon: plotësimin me burime nëpërmjet bashkëpunimit civilo-ushtarak; sigurimin e burimeve shtesë nëpërmjet organeve vendore, private, organizatave joqeveritare etj.; pakëson ndikimin e mungesës së tyre në fuqinë luftarake.

Analiza e fuqisë luftarake

Analiza e fuqisë luftarake është e vështirë, ajo kërkon aplikimin e të dyja pjesëve: artit dhe shkencës ushtarake. Analiza e fuqisë luftarake përfshin vlerësimin e faktorëve real, të tillë si: pajisjet, sistemi i armëve, repartet, dhe faktorëve joreal, si: morali dhe nivelet e stërvitjes.

Ajo merr parasysh dhe faktorë si: misioni, kundërshtari, terreni, stërvitja, kohën në dispozicion që direkt ose indirekt ndikojnë në rezultatin e operacionit.

Megjithëse janë përdorur disa marrëdhënie numerike, analiza e fuqisë luftarake nuk është një marrëdhënie matematike e llogaritjes së forcave, e quajtur nga doktrina e mëparshme sovjetike, por është një vlerësim i përzierjes së faktorëve objektiv dhe subjektiv. Krahasimi i rëndësisë së fuqisë dhe dobësisë së secilës forcë në shprehje të fuqisë luftarake, i jep planëzuesve aftësinë për të depërtuar ne:

- Aftësitë e forcës aleate që ka të bëjë me operacionin.
- Në llojet e operacioneve të mundshme nga forcat aleate dhe të kundërshtarit.
- Sa dhe ku kundërshtari mund të jetë i cenueshëm.
- Sa dhe ku forcat aleate janë të cenueshme.
- Burimet shtesë që mund të kërkohen për kryerjen e misionit.
- Si të caktojnë burimet ekzistuese.

Analiza e fuqisë luftarake përfshin përcaktimin e raportit të forcave dhe krahasimin e fuqisë dhe dobësisë për të dy palët. Qëllimi i kësaj analize është për të depërtuar në llojet e operacioneve të mundshme për të dy palët.

Gjatë këtij hapi, stafi studion si ndikojnë faktorët te të dy palët si një pjesë e tërë. Në hapin e tretë, i cili ka të bëjë me llogaritjen e forcave kryesore, ata kryejnë analiza të ngjashme për secilën detyrë kryesore ose rast, në kurset e veprimeve.

Elementet e FL	**Fuqia dhe dobësitë e kundërshtarit**	**Fuqia dhe dobësitë e Forcave tona**	**Avantazhet**	
			Armiku	**Forcat tona**
Manovra	Fuqia: Këmbësoria me numrin e armeve antitank. Dobësi: Pajisje të mirëmbajtura keq. Mungesa e lëvizjes midis pozicioneve të luftimit	Fuqia:3 X M1A2 Pajisje të kombinuar të armeve të task forcës.	x	
Fuqia e Zjarrit	Dobësi:Zjarri i kufizuar i Mortajave.	Fuqia: Supremaci në ajër, sistemi Kundërajror i paorganizuar mirë, zjarri i raketave dhe topave.	**x**	
Mbrojtja	Fuqia: Pozicione mbrojtëse të mbuluara plotësisht.	Fuqia: Aftësi e shikimit natën; Dobësi:Mjete luftarake me trashësi blindi të hollë, këmbësoria jashtë këtyre mjeteve.		**x**
Lidership	Fuqia: Njësitë elite shumë të disiplinuara. Dobësi: Mungesa e iniciativës nga vartësit, pa urdhër nga lart.	Fuqia: Përvoja luftarake e njësive. Klima e komandimit e orientuar drejt agresivitetit dhe sulmit.	**x**	
Informacioni	Fuqia: Mbështetje e plotë nga popullsia dhe nga shtypi lokal. Dobësi: komandim-kontrolli i bllokueshëm dhe i kapshëm.	Fuqi: Sistemi i komandim – kontrollit i sigurt e i besueshëm Dobësi: Shikohet si okupuese nga forcat kundërshtare dhe nga popullsia lokale.		**x**

Model i analizës së elementeve të Fuqisë luftarake

Misioni i F. Tona. Pozicioni. F. Tona: Kundërshtari

Vonim 1: 6

Mbrojtje. Përgatitur ose i fortifikuar 1: 3

Mbrojtje. I zënë me nxitim 1: 2.5

Sulm. Përgatitur ose i fortifikuar 3: 1

Sulm. I zënë me nxitim 2.5: 1

Kundërsulm. Anësor 1: 1

Planëzuesit kombinojnë raportin e forcave me rezultatin e analizës së faktorëve jo të prekshëm për të përcaktuar fuqinë luftarake të të dy palëve. Ato përcaktojnë çfarë lloj operacionesh janë të realizueshme nga krahasimi i raportit të forcave.

Qendra e Rëndesës

Integrimi i të gjithë elementeve të FL orientohet drejt Qendrës së Rëndesës. Qendra e rëndesës është shumë e rëndësishme si koncept për t'u vlerësuar e gjykuar. Doktrina e përbashkët amerikane për planëzimin e operacioneve të bashkuara, qartësisht thekson rolin tepër të rëndësishëm të analizës së QR duke vlerësuar se: "detyra më e rëndësishme që do të përballojnë planëzuesit e betejave ushtarake në këtë proces është aftësia për të gjetur qendrën e rëndesës strategjike të kundërshtarit dhe forcave tona; atë që është burimi i fuqisë, potencialit dhe rezistencës për një forcë. Shkaku pse gjetja e QR është detyra më e rëndësishme për komandantët është sepse, një analizë e gabuar e QR së forcave tona apo kundërshtarit mund të ketë konsekuenca serioze, veçanërisht në pamundësinë e realizimit të objektivave ushtarake, me një kosto të paimagjinueshme dhe harxhim të paarsyeshëm të jetës së njerëzve, kohës dhe që nuk prodhojnë rezultatin e dëshiruar operacional apo strategjik. FA shqiptare, ashtu si të gjitha FA të vendeve të tjera, janë më të predispozuara të përfshihen sot në luftimet jo tradicionale, në operacionet e ndryshme nga lufta, më shumë sesa te një armik i përcaktuar qartë konvencional. Pikërisht për këtë arsye, procesi i identifikimit të QR në operacione të tilla është kritik e i rëndësishëm.

Klauzeviçi përdori i pari konceptin e QR në librin e tij "*Mbi Luftën*",[12] në vitin 1932. Qendra e rëndesës është përcaktuar si themeli (apo baza) i kapaciteteve të cilën ai e quajti: "*qendrën,(boshtin) e të gjithë fuqisë dhe lëvizjes, nga ku varet gjithçka*". Klauzeviçi argumentoi se mungesa e njohjes totale të armikut nuk është domosdoshmërisht e nevojshme për arritjen e qëllimit strategjik të luftës. Për më tepër, komandanti duhet të identifikojë dhe shfrytëzojë "faktorët deciziv" dhe karakteristikat kryesore të armikut të tij në një kohë që kupton edhe forcën e tij. Në AJP-01(D) trajtohet Qendra e Rëndesës. Rëndësi merr gjetja e QR së kundërshtarit dhe pikat e dobëta të saj. Komandantët duhet të jenë vigjilent se mund të shfaqen dobësi të reja ,por edhe se dobësitë e identifikuara më parë mund të jenë shumë të mbrojtura për t'u sulmuar.

Një Qendër e Rëndesës përkufizohet si: "*Karakteristika, aftësi ose infrastruktura nga të cilat buron liria e veprimit, forca fizike ose vullneti për të luftuar i një shteti, i një aleance, i një force ushtarake apo çdo grupimi tjetër*"[13].

Klauzevici perifrazoi se "brenda këtyre karakteristikave zhvillohet një QR e besueshme, boshti (qendra) i të gjithë fuqisë dhe lëvizjes, nga e cila varet gjithçka. Të gjitha energjitë duhet të drejtohen kundër kësaj pike për të arritur në objektivat kryesore ushtarake me më shumë efektivitet.

Sipas Klauzeviwit, rëndësia e pushtimit të qendrave të rëndesës së armikut e bën këtë çështje një faktor vital në procesin e planëzimit dhe kryerjes së betejës. Ai ishte

[12] Klauseviç, Ibid. V.II.Tiranë 1994.
[13] AJP-01(D), fq.92.

i mendimit se detyra e parë në planëzimin e luftimit është analizimi i elementeve të FL, integrimi i të cilëve të çon në identifikimin e QR së armikut dhe nëse është e mundur, ta kthesh atë në një QR të vetme. Detyra e dytë është të sigurohesh se forcat që do të përdorësh kundër kësaj pike janë përqendruar në goditjen kryesore.

Sipas Doktrinës se përbashkët të Forcave tona QR është *"Karakteristika, aftësi, ose vendvendosje nga ku burojnë liria e veprimit, forca fizike, dhe vullneti i një force ushtarake për të vepruar",*[14] QR pra janë burimet e fuqisë. Joseph Strange i U.S. Marine Corps War College e përcakton QR si burimin kryesor të fuqisë fizike apo morale, të pushtetit dhe rezistencës. Një QR është burimi i fuqisë që krijon një forcë apo kapacitet kritik që lejon një entitet(sistem) të kryejë apo plotësojë një detyrë a një qellim.

Nëse duhet ta thjeshtojmë, përcaktimi i thjeshtuar i QR bëhet "burimi i fuqisë së një sistemi për të vepruar". Aktualisht, aplikimi modern i konceptit QR në doktrinën ushtarake këshillon që përdorimi i saj në planëzimin ushtarak ka pësuar ndryshime nga nocioni tradicional i Klauzevicit. Për më tepër, studiuesit dhe pedagogët ushtarakë vazhdojnë të marrin në konsideratë ndryshimet ndërmjet QR në nivel strategjik dhe operacional, dhe nëse shpjegimi i Klauzevicit duhet të aplikohet apo jo në të gjitha nivelet. Një aspekt i këtij debati përqendrohet në diferencimin e QR nga elementet e tjerë, si: pikat kryesore të forta, anët e dobëta apo mangësitë që përcaktojnë karakteristikat e vërteta të fuqisë luftarake të një shteti.

Llojet e Qendrës së Rëndesës

Sipas pjesës më të madhe të literaturës së doktrinave ushtarake ekzistojnë dy nivele të QR: Strategjike dhe Operacionale. Le t'i shpjegojmë shkurtimisht të dyja.

a. Qendrat e Rëndesës strategjike

Në nivel strategjik duken se janë gjerësisht të pranueshme nocionet e Klauzeviçit, që QR është një burim i fuqisë së një shteti. Përzgjedhja e QR strategjike është mjaft e rëndësishme për planëzimin në nivel strategjik. Ky është ai nivel ku zhvillohen synimet në nivel politik, ekonomik e ushtarak dhe përcaktohen objektivat strategjike. Kandidaturat e mundshme për një QR strategjike përfshijnë një kryeqytet, një lider karizmatik apo vullnetin e një populli.

Nëse flasim për qendër rëndese në këtë nivel, mund ta quajmë fuqi apo aftësi për të vepruar apo parandaluar të tjerët nga ndërhyrja. Pra, në nivel strategjik, ekzistojnë vetëm dy elemente të fuqisë kombëtare. Fuqia ushtarake dhe fuqia ekonomike. Ne nuk duhet të ngatërrohemi me elementet e tjerë të fuqisë kombëtare. Diplomacia dhe informacioni shpesh e kanë quajtur "vullneti i popullit".

Në nivel kombëtar, pra strategjik, një QR është edhe një kapacitet ushtarak apo i sigurisë, edhe një kapacitet ekonomiko-industrial. Në luftën totale, një QR strategjike është një kapacitet ekonomiko-industrial. Në luftërat e kufizuara, një QR strategjike është pothuajse gjithmonë një kapacitet ushtarak dhe i sigurisë.

Shembuj: FA amerikane në Vietnam fituan shumë beteja dhe luftëra më të vogla, por ishin të paaftë të rrëzonin qeverinë e Ho Shi Min-it. Fitoret taktike nuk kishin lidhje

[14] DPU-10,Tiranë 2009, fq.14.

me QR strategjike që ishte rrëzimi i Republikës Demokratike të Vietnamit, kështu që fitorja strategjike nuk mund të ishte e arritshme.

Gjatë operacionit Desert Storm, Komandanti i Trupave vlerësoi se QR e Irakut ishte komandimi, kontrolli dhe lidershipi i regjimit të Sadam Hussein. Ky përcaktim u siguroi forcave të koalicionit përqendrimin e saktë të fuqisë luftarake, me qellim imponimin e forcës mbi këtë pikë, gjë që doli me sukses.

Një shembull i përcaktimit jo të saktë të QR strategjike, që mund të çojë në rezultate të pakëndshme, është shembulli historik i sulmit mbi *Pearl Harbor* nga Japonia. Ata dështuan në përcaktimin e saktë të QR strategjike amerikane, që ishte vullneti i popullit amerikan dhe jo Marina Luftarake e vendosur në gjirin amerikan.

b. Qendrat operacionale të rëndesës

Në nivel operacional, QR fokusohet në teatrin e operacioneve. Qendrat akademike akoma debatojnë çështje të tilla si: nëse ekzistojnë një apo më shumë QR në nivel operacional në një teatër dhe nëse përcaktimi i QR shtrihet në nivelin taktik të luftimit. Ndryshe nga niveli strategjik, faktorët që peshohen në përcaktimin e një QR operacionale përfshijnë objektivat, kapacitetet dhe qëllimin për përdorimin e kapaciteteve. Kështu, ekziston rritja e mundshme e konfuzionit për komandantët dhe planëzuesit ushtarak në lidhje me QR operacionale për objektivat, pikat decizive dhe asetet kritike. Siç sugjeron Klauzevici, QR-të operacionale përfaqësojnë një përqendrim të fuqisë luftarake të armikut. Për planëzuesit ushtarak, kjo masë e përqendruar e fuqisë luftarake është më vitale për forcën ushtarake në realizimin e qëllimit operacional të fushatës. Siç e vendosi Klauzeviçi: Një QR është gjithmonë e gjetur, atje ku masa është përqendruar më dendur. Ajo prezanton objektivin më efikas për goditje, për më tepër, goditja më e fuqishme quhet kur është goditur QR[15]. Thyerja e një qendre rëndese strategjike, me një goditje të vetme, është e vështirë, në mos, e pamundur. Kështu si të godisnim çdo problem kompleks, ne mund ta ndajmë QR strategjike në shumë pjesë më të kontrollueshme e më të drejtueshme. Fushatat fokusohen në këto pjesë, që quhen QR operacionale. Një fushatë duhet të jetë pjesë e një procesi gradual (step-by-step process), që në mënyrë direkt apo indirekt, godet këto QR operacionale apo vendos bazat për një fushatë të ardhshme që godet QR operacionale. Goditja e një QR-je operacionale dobëson QR-në strategjike. Një QR operacionale është diçka që mbron një QR strategjike. Zakonisht QR operacionale janë kapacitetet ushtarake apo forcat ushtarake. Përcaktimi i pengesave nxjerr në shesh një kandidaturë të fuqishme për një QR operacionale. Pothuajse gjithnjë një QR e nivelit operacional do të jetë një kapacitet ushtarak apo i sigurisë.

Shembull të një QR operacionale mund të marrim operacionin Desert Storm. FA amerikane përcaktuan si QR operacionale Gardën e Republikës irakiane, dhe në një rast tjetër, kapacitetin irakian për shpërndarjen e armëve të dëmtimit në masë.

Gjetja e një QR kërkon punë. Një komandant ka nevojë të dijë se si kundërshtari dhe i gjithë sistemi i tij vepron, cilat janë anët e dobëta dhe anët e forta të tij. Në përpjekjet për të kuptuar ketë, që është pjesa me e rëndësishme e analizës së FL, ai kërkon aftësi magjike parashikuese të sistemit organizativ të kundërshtarit. Një komandant

[15] Klauseviç Ibid.

duhet të shmangë përpjekjen për të gjetur një sistem magjik analize dhe të hidhet në identifikimin e dobësive, sepse ai mundet që gabimisht t'i identifikoje ato si QR. Identifikimi dhe përcaktimi i një QR fokusohet në përpjekjen ushtarake. Kështu ne duhet të shmangim përkufizimet e shumta. Identifikimi dhe përcaktimi i një QR kërkon një analizë të kujdesshme. P.sh, mund të jetë më e lehtë të identifikohen forcat nukleare strategjike, forcat tokësore apo një lloj specifik njësie apo kapaciteti si një QR më mirë se të themi thjesht, "forca ushtarake". QR është një mjet i fuqishëm në luftim. Kuptimi i përkufizimit dhe metodologjisë për gjetjen e tij do të reduktonte konfuzionin.

Përcaktimi i kapaciteteve kritike të armikut është absolutisht funksioni bazë që shfaq një sistem i armikut. I gjithë sistemi mund të ketë një sërë kapacitetesh, por jo të gjitha janë të rëndësishme në çdo situatë. Identifikimi i burimeve më të rëndësishme të fuqisë e të kapaciteteve vitale të tij janë në fakt QR e tij. Identifikimi i kërkesave kritike apo komponentë që janë më të dobët për t'u sulmuar apo shkatërruar. Këto pika të dobëta kthehen në objekte për t'u sulmuar dhe janë kërkesa për armikun që kërkon t'i mbrojë ato. Më poshtë po japim disa shembuj se çfarë mund të përcaktohen zakonisht si Qendra Rëndese:

- Forcat e bashkuara.
- Forcat bërthamore.
- Forcat tokësore.
- Forcat detare.
- Forcat ajrore.
- Trupat e Operacioneve Speciale.
- Forcat joluftarake, përfshirë edhe terroristët.
- Forcat e sigurisë së shtetit.
- Njësi të veçanta.

Pavarësisht divergjencave të ndryshme në aplikimet moderne të konceptit QR, perceptimet e Klauzevicit janë baza e doktrinës aktuale mbi përdorimin e këtij koncepti në planëzimin e betejave. Botimi amerikan i (Joint Publication 1) deklaron se: "gjetja dhe sulmi i QR së armikut është një koncept i rëndësishëm i pazakontë dhe nënkupton përqendrimin kundër kapaciteteve, shkatërrimi i të cilit apo përmbysja do të na çojë në suksesin e dëshirueshëm ushtarak. Megjithatë, analiza e QR na siguron një fokus të rëndësishëm për të gjitha përpjekjet tona. Manuali fushor amerikan (Manual 100-5, *Operations)* deklaron se "koncepti është i përdorshëm si një mjet analitik, për shkak se komandanti i FB dhe stafi i tij mendojnë rreth fuqisë së tij(pra atë të F.Tona), dhe burimeve të fuqisë së armikut, për të përfytyruar betejën dhe përcaktuar objektivat[16]. Planëzuesit mund të jenë konfuz në përcaktimin e QR në nivel operacional me aspektet e tjera strategjike dhe operacionale të fuqisë ushtarake, të tilla si pikat decisive, anët e forta në nivel strategjik dhe operacional, anët e dobëta dhe mangësitë. Çfarë bëhet me një QR, pasi është përcaktuar? Kujto se qëllimi i një plani beteje është përqendrimi i përpjekjeve kundër QR se armikut, në një kohë që i kushton vëmendje qendrës së vet të rëndesës.

[16] Manual 100-5, Operations.

Përfundime

Nisur nga çfarë trajtuam më lart, në mënyrë të përmbledhur do të fokusohesha në disa përfundime të renditura më poshtë:

- Faktorët, nga të cilët varet fuqia luftarake, kërkojnë nivel të lartë komandimi e drejtimi, nivel të lartë të përgatitjes së efektivave dhe sigurimit të gjithanshëm e të vazhdueshëm material e shëndetësor, shfrytëzim të karakteristikave të terrenit dhe kushteve të motit.
- Analiza e FL është e vështirë, kërkon aplikimin e të dyjave, të artit dhe të shkencës ushtarake.
- Ekzistojnë dy QR, strategjike dhe operacionale.
- QR-të strategjike vlerësojnë zakonisht disa aspekte që kontrollojnë shtetin, aleancën, koalicionin apo grupimin; QR-të operacionale vlerësojnë aspekte të forcës ushtarake. QR strategjike gjendet dhe mbështetet në nivelin kombëtar strategjik, ndërsa ajo operacionale gjendet dhe mbështetet në nivelin strategjik të një teatri veprimesh.
- Në nivelin strategjik gjendet vetëm një QR dhe jo më shumë. Nuk duhet të ngatërrohet ky koncept me objektivin strategjik, pikat decizive, kapacitetet kritike apo anët e dobëta.
- Ndërsa në nivelin operacional QR është shumë e varur nga objektivat, QR strategjike është e fiksuar dhe e pandryshuar.
- Doktrinat tona në të ardhmen duhet të analizojnë më gjerë elementet e FL, të përcaktojnë më saktë QR si koncept dhe të përshkruajnë përdorimin e tyre në lloje të ndryshme të operacioneve ushtarake. Po ashtu, e rëndësishme do të ishte edhe përcaktimi i një metodologjie më të saktë për përcaktimin dhe aplikimin e QR në të gjitha llojet e operacioneve.

Bibliografia:

- U.S.Joint Chiefs of Staff, Joint Publication (JP) 5-0, Doctrine for Planning Joint Operations.
- Manual 100-5, *Operations.*
- K.F Klauzeviç “Mbi luftën” Tiranë, 1994 Vol.I,II,III.
- ATP-35 (B), Tiranë, 1999.
- Guidë për politikën dhe strategjinë e sigurisë kombëtare,Vol.I. Tiranë 2009.
- Doktrina e përbashkët e FA te RSH, DPU-10.
- Taktika FM 100-40.
- T.N. Dupoi, Kuptimi i luftës,Tiranë 1997.
- AJP-01(D),AJP-3(B),AJP-3.2,AJP-5.

Informacioni dhe zbulimi, faktor i rëndësishëm në vendimmarrje

MSc. Vladimir Imeraj
Pedagog i DO

Nënkolonel Besnik Cukali
Kursant KLO

Trajtesë e shkurtuar. *Sa i rëndësishëm është zbulimi në kohë lufte? A do të kishte ndonjë komandant që të fillonte operacionin, pa u përpjekur të zbulojë më parë synimet dhe aftësitë e kundërshtarit e cila do ta ndihmonte për fushën e betejës?*

"Historia ka treguar në mënyrë të përsëritur se forcat më të pakta mund të fitojnë kur komandantët kanë zbulim të saktë.[1]"

Gjithmonë janë përdorur të dhënat e zbulimit para fillimit të luftimeve. Nëse studiohet se si është përdorur zbulimi në fushata të ndryshme, duke përfshirë, sidomos kohën e Napoleonit, Luftën e Parë Botërore, Luftën e Dytë Botërore, Luftërat e Gjirit deri dhe Lufta e fundit kundër Al Qaedës, do të arrinim në konkluzionin, se: zbulimi ka luajtur një rol të rëndësishëm dhe disa herë dhe rol vendimtar për të fituar betejën.

Fillimet e zbulimit ishin të vështira, mbasi nuk kishte mënyra të shumta të transmetimit të informacioneve deri në daljen e telefonit. Shekulli i 20-të është dhe shekulli i informacionit, mbasi mund të sigurosh informacion në kohë reale mbi fuqinë dhe planet e kundërshtarit.

Në shumicën e rasteve, zbulimi ishte një nga faktorët që vendoste fatin e një fushate. Ndonëse sot u arrit një sukses në luftën kundër Al Qaedës, duhet përsëri mënyra të reja për t'iu përshtatur luftës asimetrike.

Duhet të pranojmë faktin se zbulimi është i rëndësishëm në luftë, por nuk është në vetvete vendimtar. Zbulimi është një përparësi e madhe, por nuk mund të garantojë fitoren. Luftërat i fiton forca dhe mjetet dhe për të fituar, këto forca dhe mjete duhen të jenë të mjaftueshme, të përdoren me shkathtësi dhe guxim. Zbuluesit kanë informacion mbi armikun, por zgjuarsia e tyre është që ky informacion të shfrytëzohet në të mirë të operacionit. Për shembull, "anglezët kishin informacion se gjermanët

[1] Marrë nga interneti dhe përshtatur.

do të pushtonin Kretën, por nuk e shfrytëzuan këtë informacion, kështu që gjermanët e morën ishullin me lehtësi[2]".

Në të gjithë manualet shkruhet për mbështetjen me zbulim, por Klauzeviç donte të pasuronte më tej parimet e luftës. Klauzeviç plotësoi boshllëkun se "çfarë është lufta?", duke përcaktuar më mirë natyrën e luftës dhe sjelljet e saj, arsyet që të çojnë në luftë dhe parimet e saj. Një nga parimet e luftës, theksoi ai, është se zbulimi në luftë është njohja e mirë e kundërshtarit.

Zbulimi sipas Klauzeviçit

Me fjalën zbulim, Klauzeviç, në veprën e tij "Mbi luftën", vëllimi i parë, (libri i parë dhe i dytë), kreu VI, "zbulim në luftë", kupton njohuritë që mund të merren mbi armikun dhe vendin e tij, pra mbi bazën ku do të mbështeten idetë dhe veprimet tona. N.q.s nuk kemi njohuri mbi armikun, kjo -thekson ai,- ngjason me një gërmadhë që shpejt do të shembet dhe do të na mbulojë. Kjo thënie e tij është e bazuar në manualet e asaj kohe, të cilat këshillojnë që të besojmë informacione të sigurta dhe të shikojmë gjithçka me mosbesim. Klauzeviç i cili në atë kohë pranon, që edhe në kohë lufte vijnë informacione në shumë drejtime, që shumë prej tyre janë në kundërshtim me njëra-tjetrën, ku disa mund të jepen të pasakta me qëllim nga armiku apo nuk janë nga burime të sigurta. Prandaj, ai thekson se oficeri i zbulimit i të gjithë niveleve duhet që të bëjë seleksionimin e tyre. Oficeri i zbulimit duhet të ketë përvojë në këtë fushë dhe aftësi të veçanta profesionale dhe psikologjike për të bërë një gjykim të saktë. Me këtë rast ai flet për ligjin e probabilitetit. Prandaj duhet të parashikohen kurset e veprimit të kundërshtarit, të cilat janë të vështira për t'u përcaktuar si gjatë planëzimit, ashtu edhe gjatë kryerjes së operacioneve, ku shpejtësia e informacioneve rritet. Nëse dy informacione janë në kundërshtim me njëra-tjetrën atëherë analiza e tyre të çon në produkte zbulimi. Mungesa e përvojës për një analizë të këtyre informacioneve, të cilat nuk janë të bazuar në fakte dhe që nuk mbështesin informacionet e mëparshme në mënyrë që të rifreskojë kurset e veprimit që mund të ketë kundërshtari, do të bëjë që të propozohen kurse të gabuara veprimi dhe si pasojë, armiku ka arritur të të ushqejë me informacion të rremë. Mashtrimi nëpërmjet informacioneve të rreme është një parim që kundërshtari e ka si pjesë të planëzimit dhe zbatimit gjatë gjithë fazës së operacionit. Klauzeviç vë në dukje se njeriu është i prirur që të besojë më shumë lajmin e keq se sa lajmin e mirë. Jo vetëm që besohet lajmi i keq, por edhe keqinformohet dhe ngjason me valën e detit që të godet. Prandaj, komandanti duhet të jetë i vendosur dhe i palëkundur si shkëmb ku mund të kthehen këto valë. Ruajtja e gjakftohtësisë nga komandantët do të bëhet në sajë të trajnimeve dhe përvojës për të shmangur frikën, kaosin dhe pasigurinë dhe në kundërshtim me të, të rritë besimin në fitore në mënyrë që të bëjë një ekuilibër të këtyre fenomeneve.

Vështirësitë e përcaktimit të kurseve të mundshme të kundërshtarit do të jenë një fërkim gjatë gjithë operacionit, mbasi jo gjithmonë gjërat do të shkojnë ashtu siç janë planëzuar. Kështu, informacioni me zbulim me trupa është më i besueshëm sesa ngritja e kurseve të veprimit të bazuar në doktrinën e armikut dhe gjithmonë duhet të dyshosh tek informacioni i cili të reflektohet gjatë zbatimit të operacionit.

[2] Po aty.

Zbulimi dhe reflektimi në AJP 2.0/STANAG 2190

Në Doktrinën e Përbashkët të Aleancës për Zbulim, Kundërzbulim dhe Siguri, Stanag 2190/ AJP 2.0, e vitit 2003, e ratifikuar nga vendi ynë në tetor 2010 dhe në përdorim në FARSH, që nga shtatori 2011, theksohet se: "zbulimi nuk është thjesht një dallavere, një trillim pa bazë apo një hamendje e rastit, e bazuar në gjykime subjektive të një informacioni jo të plotë. Për të bërë zbulim, informacioni duhet të grumbullohet në bazë të një modeli të bazuar në pyetjet e shtruara për përgjigje nga komanduesi[3]". Ashtu siç e përcakton Klauzeviç se "informacioni do një analizë"[4], edhe AJP 2.0 parashikon se: "pasi është grumbulluar, informacioni i nënshtrohet një procesi analize të bazuar mbi njohuri dhe eksperiencë. Së fundi, produkti i këtij procesi, pra zbulimi i përgatitur, shpërndahet në kohën e duhur dhe në formën e një formati të asimilueshëm për ata që kanë nevojë për të, për të hartuar urdhra luftarake apo për të ndërmarrë operacione[5]''.

Një rast i sinkronizimit të informacionit të marrë me planëzimin dhe me zbatimin e tij është "Beteja e Tannenberg", 23-30 gusht 1914, ndonëse pak e njohur si betejë, por ishte një fitore strategjike mbasi zbulimi gjerman u përdor në mënyrë të suksesshme kundër rusëve. Gjermanët arritën të deshifrojnë kodet e rusëve, duke kapur oraret e lëvizjes, urdhrat, mesazhe të rëndësishme për koordinim të dy armatave ruse. Këto të dhëna të zbulimit gjermanët i futen në planëzimin e operacionit duke krijuar një pamje të qartë të fushëbetejës. Gjermanët kishin informacion të bollshëm, mbasi kishin zbuluar një distancë të madhe midis dy armatave dhe se ndihma e armatës së dytë për armatën e parë ruse mund të vinte mbas tre ditësh. Zbulimi luajti një rol vendimtar, sepse ndihmoi që gjermanët me një forcë të vogël të kryenin veprime përballë një forcë më të madhe ruse në numër"[6].

Thënia e Klauzeviç se "informacioni vjen në shumë drejtime"[7] tek AJP 2.0 pasqyrohet se "Informacioni mund të përbëhet nga një e dhënë e vetme ose nga një seri apo grup

	Besueshmëria e Burimit		*Besueshmëria e Informacionit*
A	Plotësisht i besueshëm	1	E konfirmuar nga burime te tjera
B	Zakonisht i besueshëm	2	Ndoshta i vërtetë
C	Mjaftueshmërisht i besueshëm	3	Mundësisht i vërtetë
D	Zakonisht jo i besueshëm	4	I dyshueshëm
E	I pabesueshëm	5	Jo i mundshëm
F	Nuk mund të gjykohet besueshmëria	6	Nuk mund të gjykohet vërtetësia.

[3] Doktrina e Përbashkët e Aleancës për Zbulim, Kundërzbulim dhe Siguri, STANAG 2190/ AJP 2.0, faqe 10.
[4] Klauzeviç në veprën e tij "Mbi luftën" vëllimi i parë, (libri i parë dhe i dytë), kreu VI, "zbulim në luftë", faqe 144-146.
[5] Doktrinën e Përbashkët të Aleancës për Zbulim, Kundërzbulim dhe Siguri, Stanag 2190/ AJP 2.0 faqe 10.
[6] Marrë nga interneti dhe përshtatur.
[7] Klauzeviç. Po aty, faqe 144-146.

të dhënash, që janë marrë nga një mjet zbulues dhe janë grumbulluar në një mënyrë apo në një tjetër, për një kohë të vazhdueshme[8]".

Klauzeviç thekson se është e domosdoshme besueshmëria e informacionit nëpërmjet dyshimeve, për këtë qëllim AJP 2.0, ka parashikuar se "Vlerat e standardizuara të pranuara për renditjen në bazë të shkallës së besueshmërisë së burimeve dhe kredibilitetit të informacionit, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme[9]".

Mashtrimi nëpërmjet informacioneve të rreme është një parim që kundërshtari e planëzon thotë Klauzeviç, kështu që AJP 2.0 sqaron se: "Vlerësimi ka të bëjë me atë se sa i besueshëm është burimi dhe se sa probabilitet ka që informacionin që vjen nga ai, të jetë i vërtetë. Informacionet e ardhura nuk mund të konsiderohen menjëherë si të vlefshme. Ka shumë arsye, duke përfshirë këtu dhe mashtrimin, që mund ta bëjnë informacionin të pabesueshëm ose jo plotësisht të vërtetë[10]".

"Gjatë luftës civile në SHBA, në betejën e Run Bullit me 21 korrik 1861, vetëm në sajë të mashtrimit, ushtria federale fitoi në minutën e fundit kundër ushtrisë së bashkuar, duke shfrytëzuar spiunazhin e ngritur me kujdes në Uashington DC. Aftësia për të fituar në kohë të dhënat e sakta dhe të besueshme të zbulimit, ndihmoi në goditjen e saktë. Fakti që u dërgua një informacion i rremë, se lëvizja e ushtrisë federale do të bëhet në jug, bëri që ushtria e bashkimit të përqendronte forcat në këtë drejtim"[11].

Klauzeviç shton se zbulimi duhet të mbështetet te faktet dhe se analisti duhet të ketë përvojë, prandaj AJP 2.0 vlerëson se:"Gjatë analizës, informacioni i grumbulluar dhe i vlerësuar ekzaminohet në bazë të fakteve të rëndësishme. Lidhen më pas me fakte të tjera, të cilat janë bërë të ditura më parë dhe arrihet në përfundime, duke bërë krahasimet e duhura. Integrimi konsiston në bashkimin e përfundimeve dhe identifikimin e një modeli zbulimi, një sekuence ngjarjesh ose e një fotografie të një individi. Ky aspekt i përpunimit është mendor dhe përbën pikën kritike në të dhënat e zbulimit, pasi nuk ka akoma, të paktën tani për tani, një proces që të zëvendësojë eksperiencën dhe gjykimin e analistit"[12].

Klauzeviç tregon se analisti duhet të ketë arsyetim, eksperiencë dhe aftësi për gjykim, ndërsa AJP 2.0 sqaron se "Arsyetimi i njeriut për të arritur në gjykime dhe vlerësime dhe kapaciteti i tij intuitiv janë kritike për një sukses të procesit analitik, gjë e cila konsiderohet edhe zemra e përpunimit. Këto aftësi janë më tepër të fituara se të mësuara, ato janë një produkt i praktikës dhe eksperiencës së analizës, për një periudhe të gjatë kohe, e ndërthurur kjo me njohuri të gjëra profesionale. Ato përbëjnë çelësin e tipareve parashikuese të zbulimit"[13].

[8] Doktrina e Përbashkët e Aleancës për Zbulim, Kundërzbulim dhe Siguri, STANAG 2190/ AJP 2.0 faqe 25.
[9] Po aty, faqe 24.
[10] Po aty, faqe 24.
[11]Marrë nga interneti dhe përshtatur.
[12] Po aty, faqe 25.
[13] Po aty, faqe 25.

Zbulimi dhe reflektimi në AJP 01(D)

Klauzeviç kupton se me zbulim kemi të bëjmë me njohuritë mbi armikun dhe AJP 01 (D), sqaron se: "Informacioni është një instrument tjetër i fuqisë. Përveç rolit mbështetës, informacioni i Aleancës duhet... për t'i mohuar kundërshtarit informacionin jetësor që i duhet atij për zbatimin e strategjisë së tij... Instrumenti i informacionit tonë ka si synim kryesor t'i kundërvihet informacionit të kundërshtarit dhe sistemeve të tij të informimit, duke mbrojtur njëkohësisht sistemet tona dhe të Aleancës..."[14]

Ndërsa kur Klauzeviç flet për mashtrimin, në AJP 01 (D) reflektohet si "Siguria jonë rrit lirinë e veprimit duke kufizuar njëkohësisht brishtësinë ndaj veprimeve dhe kërcënimeve të kundërshtarit. Masat e sigurisë aktive dhe pasive ndihmojnë që kundërshtarit t'i mohohet marrja e informacionit kritik. Këto masa mbështesin mashtrimin dhe ndihmojnë në veprimet kundërmësymëse"[15]

Mungesën e informacionit Klauzeviç e krahason me gërmadhën, e cila reflektohet në AJP 01 (D), se "Informacioni jo i plotë, i pasaktë ose kontradiktor krijon një "*mjegull të luftës*", e cila ndikon në kufizimin e perceptimit dhe në shkaktimin e konfuzionit. Një komandant, i secilës palë, duhet ta shfrytëzojë kaosin duke ia imponuar atë kundërshtarit të vet dhe duke prodhuar më shumë rregullsi në interes të synimeve të planeve të tij. Kuptimi i natyrës së mjedisit të veprimeve luftarake, njohja e kundërshtarit, çfarë dhe si ai mendon apo si ai mund të veprojë dhe kundërveprojë etj., përbën një kërkesë paraprake për arritjen e këtij avantazhi...[16]''

Për marrjen e informacioneve gjithmonë ka vështirësi ose siç i quan Klauzeviç, fërkime, ku në AJP 01 (D) gjen zbatim si më poshtë, "Grumbullimi, analiza, shpërndarja dhe shkëmbimi i informacionit të zbulimit do të jetë një faktor vendimtar si për parashikimin, ashtu dhe për parandalimin dhe mbajtjen në kontroll të konflikteve...".[17] Ndërsa për njohjen e saktë të armikut AJP 01 (D) thekson se: "Është e nevojshme që të formësohet një kuptim i plotë i mjedisit operacional dhe të artikulohet një përqasje proaktive, qysh në fazat e hershme të lindjes së një krize. Ky vlerësim do të ndihmojë në njohjen në rritje progresive të situatës, në shkëmbimin në kohë reale të informacionit dhe në rritjen e koordinimit gjatë situatave që zhvillohen me shpejtësi. Po ashtu, rëndësi të veçantë merr përmirësimi i të gjitha aspekteve të ciklit të vendimmarrjes, në mënyrë që koha midis parashikimit të një rreziku apo kërcënimi, nga njëra anë dhe vendimmarrjes dhe zbatimit të operacionit përkatës, nga ana tjetër, të jetë sa më e shkurtër që të jetë e mundur"[18].

Njohja e saktë e armikut i çoi izraelitët drejt një vendimmarrje strategjike, e cila i dha fitoren në ditën e gjashtë të luftimit me Egjiptin, në qershor 1967. "Zbulimi izraelit ishte në nivel të lartë, mbasi kishte një sinkronizim të zbulimit strategjik me atë operacional, u zbulua vendndodhja e saktë e çdo skuadroni egjiptian, u zbulua

[14] AJP 01 (D), faqe 41.
[15] Po aty, faqe 20.
[16] Po aty, faqe 33.
[17] Po aty, faqe 34.
[18] AJP 01 (D), faqe 34.

çdo bazë ajrore dhe kishin çdo detaj të procedurës operacionale egjiptiane të forcave ajrore. Gjatë mëngjesit, izraelitët goditen 18 baza të forcave ajrore egjiptiane. Egjiptianët humbën mbi 300 nga 420 avionë të tyre luftarakë, dhe 100 prej 350 pilotëve të kualifikuar. Sulmi izraelit uli superioritetin numerik të kundërshtarit, mbasi raportet fillimisht ishin në favorin egjiptian, konkretisht ishin 2 me 1 në raport forcash; 2 me 1 në tanke; 7 me 1 në artileri; 3 me 1 në avion dhe 4 me 1 në luftanije. Teknologjia e armatimit egjiptian ishte më e mirë, sepse "MIG" në atë kohë kishin aftësi më të mirë se aeroplanët "Mirazh" izraelit. Zbulimi i dobët i Egjiptit i hapi derën humbjes së tyre.[19]

Zbulimi dhe reflektimi në AJP 5.0

Klauzeviç e pranon se informacioni vjen në shumë drejtime, kështu që edhe në AJP 5.0, thotë se: "Suksesi i misionit varet nga shumëllojshmëria e perceptimeve si në teatër, ashtu edhe në mënyrë globale. Është e rëndësishme të kuptohet se nuk ka kufij ose ndarje në fushën e informacionit. Ka vetëm një mjedis informimi. Kështu që, çdo veprim ushtarak potencialisht mund të vëzhgohet kudo që të jetë, në çdo cep të botës"[20].

Klauzeviç thotë se informacioni duhet të jetë i saktë, ai ndihmon komandantin në operacion, kështu që edhe në AJP 5.0 reflektohet se "... Informacioni në kohë dhe i saktë bën të mundur që komandanti i forcës së bashkuar të marrë vendime të drejta rreth forcave që kërkohen për t'i përfshirë në operacion. Kapacitetet e përmirësuara të informacionit rritin aftësinë e komandantit të forcës së bashkuar për të gjetur vendndodhjen e kundërshtarit dhe lëvizjet e tij. Në veçanti, një informim më i mirë e lejon komandantin e shtabin e tij të planëzojë, përgatitë e zbatojë ndarjen në faza për forcat e tij në teatër, më mirë e më efektshëm se në të kaluarën"[21].

"Njohja e armikut nëpërmjet një informacion të saktë bëri të mundur që ushtria amerikane të mos binte në kurthin japonez në betejën Midway, më 4-7 qershor 1942. Kjo betejë ishte vendimtare, mbasi u kapën kodet sekrete japoneze ku u kuptuan qartë qëllimet japoneze. Zbulimi i operacioneve detare të japonezëve bëri të mundur që marina japoneze të humbte disa anije dhe qindra avionë. Marrja e informacioneve të sakta mbi planet japoneze ishte jetike për amerikanët, mbasi humbjet në Pear Harbor bën që raporti i forcave të ishte në favor të japonezëve. Nga kriptimi i mesazheve u arrit të kuptohej përbërja e forcave japoneze, përhapja e tyre, planet operacionale, drejtimet e sakta të sulmit, që në këtë rast u vërtetua se objekti japonez ishte ishulli Midway. Nëse japonezët do të kishin fituar në kurthin që u kishin përgatitur amerikanëve, mund të kishin ndryshuar rrjedhën e Luftës së Dytë Botërore. Por ishte zbulimi taktik dhe operacional që bëri të mundur të gjenin vend tre parime të Klauzevicit, që ishin: vendimi, përqendrimi dhe sulmi. Njohja e armikut ishte faktori më vendimtar në Midway"[22].

[19] Marrë nga interneti dhe përshtatur.
[20] AJP 5.0, faqe 41.
[21] Po aty, faqe 41.
[22] Marrë nga interneti dhe përshtatur.

Informacioni duhet të jetë i vazhdueshëm sipas Klauzevicit, kështu edhe doktrina AJP 5.0, shkruan se: "Qëllimi i marrjes së vazhdueshme të informacionit është mbajtja e SACEUR-it të informuar dhe në gatishmëri për zonën e tij të interesit, të cilat u jepen pastaj komandave të forcave të bashkuara, përfshirë komandën e forcës së bashkuar të krijuar për teatrin e krizës ose konfliktit. Ato grumbullojnë informacion dhe analizojnë krizën e konfliktet në zonën e caktuar të interesit. Për më tepër, ato do të përcaktojnë dhe koordinojnë më tej me SHAPE informacionin e kërkuar dhe kërkesat kryesore për të dhëna zbulimi për zonën e interesit"[23].

Zbulimi dhe reflektimi në AJP 3.2

Pasigurinë e konfliktit Klauzeviçi e përshkruan në këtë mënyrë: *"Lufta lëviz në një atmosferë të përbërë nga rreziku, tendosja fizike, pasiguria dhe rasti. Çdo gjë në luftë është e thjeshtë, por edhe gjëja më e thjeshtë është e vështirë, dhe këto vështirësi, në pjesën më të madhe të papritura e të paparashikuara, grumbullohen e prodhojnë fërkim, një frenë ngadalësuese mbi shtrirjen dhe shkarkimin e plotë të dhunës. Këto vështirësi përbëhen nga "rreziku", "tendosja trupore", "informacioni" ose mungesa e tij dhe rrethana e pasiguri të tjera të panumërta të vogla e të pallogaritshme, që burojnë nga rasti. Këto janë disa nga gjërat e pashmangshme që e pengojnë gjithmonë luftën në realitet, qoftë edhe t'i përafrohet luftës në letër e në plane[24]".*

Ndërsa në doktrinën AJP 3.2, ky fenomen shpjegohet: "Zbulimi mund ta pakësojë pasigurinë dhe operacionet mund të planifikohen për ta mënjanuar këtë pasiguri. Sidoqoftë, pavarësisht se sa shumë përpjekje bëhen për zbulim, përsëri komandantëve do t'u duhet të marrin vendime duke u bazuar në informacion të paplotë, të pasaktë ose kontradiktor. Kjo është e ashtuquajtura "mjegull e luftës". Rreziku pakësohet me shtimin e informacionit për armikun, por rëndohet nga efektet e kundërta të rastit. Mundësi krijohen nga efektet e dobishme të rastit. Këto mundësi duhet të shfrytëzohen me këmbëngulje për përmbushjen e misionit. Vendimmarrja e efektshme dhe në kohë, nisma dhe liria e veprimit janë çelësat për të shfrytëzuar pasigurinë, që është veçanërisht tipike për mjedisin tokësor"[25].

"Zbulimi me imazhe në Kubë, në vitin 1962 dhe analizat përkatëse paralajmëruan për lëvizjen e rrezikshme nukleare të Moskës. Komuniteti i zbulimit siguroi një tablo të qartë të situatës dhe të vlerësimeve për reagime të mundshme të Sovjetikëve, duke e ndihmuar presidentin amerikan në arritjen e një rezultati të suksesshëm dhe evitimin e një konflikti të mundshëm katastrofik"[26].

Klauzevic flet për fërkimin dhe se informacioni duhet të jetë i besueshëm e të analizohet, ndërsa AJP 3.2 thotë se, "...Cilido qoftë burimi i tij, informacioni rrallë është tërësisht i besueshëm. Ai mund të ketë nevojë të kontrollohet a të verifikohet me burime të tjera. Informacioni i tepërt është një formë fërkimi që mund të pengojë vendimmarrjen"[27].

---

[23] po aty, faqe 66.
[24] Carl von Clauseëitz, 'Mbi luftën', (London: Routledge & Kegan Paul, 1962), Libri 1, faqe 53.
[25] AJP 3.2
[26] Marrë nga interneti, përshtatur nga ana ime.
[27] AJP 3.2

Klauzeviç e shtron me të madhe se zbuluesi duhet të ketë përvojë, gjë e cila gjen zbatim edhe në AJP 3.2. "Që të jetë i suksesshëm, zbulimi i armikut kërkon shumë më tepër përpjekje fizike e intelektuale sesa përcaktimi i vendndodhjes së tij. Një komandant ka më shumë gjasa të arrijë sukses nëse e njeh organizimin dhe efektivin e një force të armikut, cilat janë synimet e tij, si lufton dhe si mund të reagojë ai ndaj veprimeve tona, sesa nëse është thjesht në dijeni të pozicionit të armikut. Po aq e rëndësishme është të përcaktohet se ku nuk ndodhet armiku, si dhe të vlerësohet se çfarë nuk mund të bëjë ai brenda një kohe të dhënë, pasi kjo mund të sigurojë mundësi për befasi dhe shfrytëzim... Marrja e informacionit nga një larmi e gjerë burimesh kontribuon në cilësinë e tablosë së zbulimit që e ndihmon komandantin të formulojë planin e tij. Për ta ndihmuar komandantin në përfytyrimin e kërcënimit sikurse përshkruhet në burimet e zbulimit, duhet të krijohet një tablo e përbashkët operative. Tabloja e përbashkët operative është një tablo e fushëbetejës që përditësohet vazhdimisht. Ajo pasqyron informacionin për forcat e veta, për forcat kundërshtare, për forcat asnjanëse, për mjedisin dhe për statusin e mjeteve të grumbullimit të të dhënave."[28]

Klauzevic përcakton saktë rolin e mashtrimit në luftë, kështu që edhe në AJP 3.2 gjen zbatim ky fenomen. "Një forcë mund të fitojë liri veprimi duke e parandaluar armikun e vet nga arritja e synimeve të tij dhe duke e vënë atë në një gjendje mendore kundërvepruese. Synimi është të prishet baraspesha e armikut. Mënyrat kryesore janë: kapja në befasi dhe mashtrimi. Kur armiku mashtrohet, ai mund të jetë i sigurt si të veprojë, por vendimi i tij do të jetë i gabuar. Përdorimi i befasisë dhe i mashtrimit mund ta tundojnë armikun për të ndërmarrë një kurs veprimi që e bëjnë atë të cenueshëm. Një shembull është nxitja e tij për të ndriçuar një objektiv me radar, i cili pastaj shkatërrohet me raketa kundër rrezatimit"[29].

Zbulimi me njerëz thotë Klauzevic është mënyra më e mirë, ndërsa në AJP 3.2, kjo nënkupton zbulimin me forca. "Qëllimi i zbulimit me forca është ta nxitë një armik që të zbulojë vendndodhjen, madhësinë, efektivin, vendosjen ose ndoshta, edhe synimin e forcës së tij, duke e detyruar të përgjigjet ndaj veprimit mësymës"[30] dhe AJP 3.2 vijon se "Veprimtari zbulimi janë ato misione që ndërmerren për të shtënë në dorë, me vëzhgim pamor a metoda të tjera zbulimi, informacion për veprimtaritë dhe burimet e një armiku të mundshëm, ose për të siguruar të dhëna rreth karakteristikave meteorologjike, hidrografike a gjeo-grafike të një rajoni të veçantë. Zbulimi i rajonit dhe i rrugëkalimeve janë detyra të zakonshme"[31].

"Rast vendimtar ka luajtur zbulimi me njerëz në kapjen në befasi të kundërshtarit, në zbarkimin amerikan në portin korean në Inchon, më 15 shtator 1950. Zbulimi ndihmoi planëzuesit për njohjen e kundërshtarit. Zbuluesit amerikanë u munduan të zbulojnë se si mund të gjejnë zbatim dy pyetje të tyre: (1) Ku duhet të bëhet pika e zbarkimit amfib? dhe (2) çfarë forcash mund të ketë armiku për kundërpërgjigje në këtë pikë? Zbulimi i saktë dhe vendimi i gjeneralit Douglas Mac Arthur për zbarkim detar në

[28] AJP 3.2
[29] Po aty.
[30] Po aty.
[31] Po aty.

Inchon, një port i madh në bregdetin e detit të Verdhë të Koresë, ndryshoi në mënyrë dramatike rrjedhën e luftës, sepse do të kapej edhe baza ajrore dhe më pas do të fillonte një sulm tokësor në drejtim të Seulit, për asgjësimin e ushtrisë së Koresë së Veriut që kishte pushtuar Korenë e Jugut. Për të marrë informacion u rekrutuan peshkatarë që u vendosen në ishujt e vegjël, përballë Inchon. Në këtë rast kemi sinkronizimin e zbulimit me trupa dhe me imazhe ajrore, që do të ndihmonin planëzimin amerikan për operacionin amfib. Nga ky zbulim u mor informacion mbi dobësitë e komandim-kontrollit dhe zbuloi se koreanët kishin forca të pakta reaguese në pikën e zbarkimit. Roli mjeshtëror i zbulimit ishte i rëndësishëm, sepse ndihmoi në planëzimin e një fushate e cila doli me sukses mbasi humbjet amerikane ishin të pakta. Konkretisht, ky zbulim bëri të mundur që të kapet armiku në befasi, një sulm që çoi në rënien e Koresë së Veriut."[32]

Përfundime

Fakti se njohja e armikut është një faktor i suksesit në luftë është aq mirë i vërtetuar, sa askush nuk e mohon atë. Ndonëse kjo njohje bëhet vetëm me supozime dhe në bazë të informacioneve të marra të cilat do t'i nënshtrohet një analize që do të dalë me produkt zbulimi për të ndihmuar liderët civilë dhe ushtarakë në vendimmarrje.

Napoleoni ka thënë se: "*Çdo ushtri ka nevojë për zbulim*". Edhe në të ardhmen zbulimi është i argumentuar se do të diktojë dukshëm në fitore, sepse gjithmonë do të kemi nevojë për informacion paraprak dhe të vazhdueshëm dhe se informacioni vjetërsohet shpejt. Zhvillimet teknologjike do të ndikojnë në zbulim duke e bërë të vështirë dallimin në tre nivele të zbulimit: strategjik, operativ dhe atë taktik.

Historia vazhdimisht ka treguar se forcat numerikisht inferiore, të armatosura me teknologjitë më të afta, mund të fitojnë kur komandantët kanë informacion të saktë dhe që rritin besimin e zbatimit të planit operacional. Zbulimi i saktë bën të mundur shumëzimin e forcës.

Rol të rëndësishëm ka pasur zbulimi në nivel taktik dhe operacional dhe rol vendimtar në nivelin strategjik. Në çdo rast, zbulimi dhe komandantët me një zbulim që kupton mirë fushëbetejën, bëjnë të mundur që të krijojnë një pamje të fushëbetejës se ku kundërshtari ka përqendruar forcat e tyre, në mënyrë që të godasim në vendin e duhur dhe në kohen e duhur, për ta mposhtur atë.

Luftimi i sotëm, i shpejtë, kompleks, me lëvizshmëri dhe manovrueshmëri të lartë, me forma të larmishme të përdorimit të gjithë llojeve të forcave dhe mjeteve në hapësirë dhe në kohë, kërkon njohje, analizë të vazhdueshme të situatave dhe gjykim sa më real për vendimmarrje nga hartuesit e politikave, drejtuesit ushtarak, njerëzit që merren me sigurinë kombëtare dhe në të njëjtën kohë duhet t'u mohohen kundërshtarëve tanë të njëjtat avantazhe.

Zbulimi po përdoret në të gjitha fushat e jetës. Zbulimi ka të bëjë me trajnimin e personelit të këtyre organizatave shtetërore apo private. P.sh., në sport, sinkronizimi i përgatitje fizike me atë mendore bën atë që pse të mos jesh më i miri.

[32] Marrë nga interneti, përshtatur nga ana ime.

Në të ardhmen mendohet se zbulimi do të jetë një instrument i fuqisë kombëtare. Shkrimtari, Attali, krahas të tjerash në librin e tij, "Një histori e shkurtër e së ardhmes", bën një bilanc të botës në 100 vitet e ardhshme. Sipas tij, "Zbulimi në pesëdhjetë vjetët e ardhshëm, do të jetë pjesë e zhvillimit teknologjik. FA do të interesohen për hipervëzhgimin dhe vetëvëzhgimin.

Armët e ardhshme do të bazohen kryesisht mbi konceptin e vëzhgimit, sisteme të vëzhgimit të lëvizjeve të dyshimta, mjete mbrojtëse instalimesh strategjike, rrjete të zbulimit ekonomik.

Robotë fluturues do të transmetojnë të dhëna, do të gjurmojnë agjentë kimikë ose biologjikë, do të shërbejnë si zbulues të avancuar të reparteve të këmbësorisë, që ballafaqohen me zona të minuara ose në kënde të vdekura.''[33]

Bibliografia:

- Klauzeviç, 'Mbi luftën' vëllimi i parë, (libri i parë dhe i dytë).
- Doktrinën e Përbashkët të Aleancës për Zbulim, Kundërzbulim dhe Siguri, Stanag 2190/ AJP 2.0.
- Doktrina e Përbashkët e Aleancës AJP-01(D).
- Doktrina e Përbashkët e Aleancës për Planëzimin në Nivel Operativ, AJP 5, Stanag 2526).
- Doktrina e Përbashkët e Aleancës për Operacionet Tokësore, AJP-3.2 .
- Jacques Attali, "Një histori e shkurtër e së ardhmes", Botimet Dita, Tiranë, 2008. Internet.

[33] Jacques Attali, Një histori e shkurtër e së ardhmes, Botimet Dita, Tiranë, 2008.

Refleksione të veprës së Sun Tzu
në Artin Ushtarak të Forcave të Armatosura

Nënkolonel Arjan Rroshi
Pedagog në Akademinë e Forcave të Armatosura

Trajtesë e shkurtuar. *Akademia e Forcave të Armatosura, si institucioni më i lartë arsimor ushtarak i Forcave të Armatosura, trajton një gamë të gjerë tematikash me kurset institucionale e funksionale që zhvillohen në të. Në morinë e tematikave që kanë gjetur vend dhe diskutohen shpesh është edhe ajo lidhur me mendimet e strategëve dhe teoricienëve të shquar ushtarakë, mendime të cilat jo vetëm që i kanë qëndruar kohës, por bëhen akoma më aktuale sa herë që në sfond shfaqet ndonjë konflikt i brendshëm shtetëror apo rajonal. Për këtë arsye, në këtë prag fillimi të vitit të ri akademik, menduam të sjellim nëpërmjet këtij materiali disa refleksione të strategut të madh kinez Sun Tzu, në Artin Ushtarak të FA-së, të shprehura në doktrinat dhe manualet e saj. Kësisoj mendojmë se kursantët e kurseve institucionale do të gjejnë në këtë material një bazë teorike modeste gjatë trajtimit të temave që lidhen me teoritë e luftës.*

"*Lufta është një çështje me rëndësi të veçantë për një shtet. Çështja e jetës apo vdekjes; e mbijetesës apo shkatërrimit, kjo është e detyrueshme të studiohet thellësisht*"

Sun Tzu "*Arti i Luftës*"

Cilën teori të strategjisë dhe cilët teoricienë ushtarakë duhet të adaptojë FA e RSH-së, gjatë kryerjes së misionit të saj, brenda vendit dhe në kuadër të Aleancës, në shekullin e njëzetenjëtë? Lidershipi dhe teoricienët ushtarakë duhet të kenë në qendër të vëmendjes këtë pyetje. Në realitetin e sotëm gjeostrategjik, ku rreziqet dhe kërcënimet janë të shumta dhe natyra e luftës ka marrë karakter të pabalancuar dhe asimetrik, pyetja e mësipërme kërkon përgjigje, për t'u përballur me këto sfida. Studimi i teorisë së Sun Tzu-së, ekzaminimi me kujdes i çështjeve që ai trajton në veprën e tij "Arti i Luftës", por edhe operacionet e kryera nga ushtritë e mëdha botërore, sidomos nga SHBA, kanë treguar se teoria e Sun Tzu-së për luftën është ndër më aktualet në shekullin që jetojmë.

Afërsisht 2500 vjet më parë, Gjenerali dhe Strategu kinez i quajtur Sun Tzu filloi të shkruajë atë që mund të konsiderohet i pari dokument i shkruar për kuptimin e teorisë së luftës, duke hedhur principet bazë në lidhje me zhvillimin e luftës. Ky dokument, është mjaft i vlefshëm dhe aktual edhe në ditët e sotme, si dhe i aplikueshëm në shumë konflikte apo beteja luftarake.

Të kuptosh Sun Tzu në librin e tij "Arti i Luftës", është njëkohësisht interpretim dhe burim i Artit të Luftës së Sun Tzu-së, që shpjegon filozofinë e luftës, pa kompromentuar finesën e mendimit të nevojshëm për ta zotëruar atë. Ta bësh këtë, duke e studiuar Artin e Luftës së Sun Tzu-së, dhe aq më tepër ta aplikosh atë në praktikë, do të thotë t'i bësh të përdorshme idetë e strategut kinez të luftës, në doktrinën dhe artin tonë ushtarak.

Sun Tzu e konsideronte luftën si një "të keqe të domosdoshme" që duhet të shmanget kur është e mundur. Ai nënvizonte se: "lufta është si zjarri; popujt që nuk ulin armët do të vdesin nga armët e tyre"[1]. Lufta duhet të zhvillohet me shpejtësi për të evituar humbjet ekonomike. "Asnjë luftë e gjatë nuk i ka shërbyer ndonjë kombi"[2]. Këto thënie të strategut të madh kinez Sun Tzu, megjithëse shumë kohë më parë, janë aktuale edhe në artin ushtarak të luftës së shteteve të ndryshme, dhe padyshim, edhe në artin tonë ushtarak.

Por, subjekt i esesë sonë janë edhe të tjera thënie të të madhit Sun Tzu, siç është koncepti i mësymjes strategjike. Çfarë thotë Sun Tzu për këtë? Në cilat rrethana dhe ku është mbështetur ai për këtë parim? Ku aplikohet ky parim në artin tonë ushtarak? Këto janë disa nga pikëpyetjet, të cilave do të përpiqemi t'u përgjigjemi duke iu referuar librit të Sun Tzu-së "Arti i Luftës" dhe reflektimin e tij në doktrinën dhe Artin Ushtarak të Forcave tona të Armatosura.

Fillimisht të ndalemi në konceptin e mësymjes strategjike sipas Sun Tzu. Në librin e tij "Arti i luftës", Sun Tzu thekson: "Në luftë, rruga më e mirë është të ruash shtetin tënd të paprekur, ta shkatërrosh atë, është e kundërta. Të zësh rob të gjithë ushtrinë e armikut është më mirë sesa ta shkatërrosh atë; të kapësh një regjiment, një batalion, një kompani apo një skuadër të armikut është më mirë sesa t'i asgjësosh ato. Të mundësh armikun pa luftuar, kjo është zgjuarsia më e madhe"[3].

Duke analizuar këto thënie të Sun Tzu-së, ne kuptojmë se është tepër e rëndësishme të studiosh, të kuptosh dhe aplikosh taktikat dhe strategjinë tonë kundër asaj të armikut, pra t'i kundërvihesh strategjisë së armikut. Faktor tjetër i rëndësishëm është të përdorësh zgjuarsinë dhe diplomacinë për ta mposhtur kundërshtarin.

Në artin tonë ushtarak, duke reflektuar jo vetëm parimet e Sun Tzu-së, por edhe të dijetarëve të tjerë ushtarakë, mësymja është përcaktuar si lloj kryesor luftimi. Konkretisht në Doktrinën e Përbashkët të Forcave të Armatosura theksohet: "Operacionet mësymëse janë lloji kryesor i operacioneve luftarake. Ato ndërmerren për të kapur objektiva kyçe vendimtare të terrenit. Qëllimi i operacionit mësymës është: asgjësimi ose nxjerrja jashtë luftimit e forcave të armikut, thyerja e vullnetit

[1] Sun Tzu, "Art i Luftës".
[2] Po aty.
[3] Po aty.

të tij për qëndresë, rifitimi i territoreve të humbura dhe rivendosja e gjendjes atje ku është e nevojshme”[4].

Megjithëse në Doktrinën e Përbashkët të FA-së theksohet, se qëllimi kryesor i operacionit mësymës është asgjësimi i kundërshtarit, në të përcaktohet qartë se armiku fillimisht duhet të gozhdohet, neutralizohet, t’i imponohet vullneti ynë, që do të thotë se asgjësimi përfundimtar është alternativa e fundit kur situata dhe terreni nuk të lejojnë alternativa të tjera dhe kur nuk arrihet dorëzimi i tij, ose kur forcat tona dështojnë në imponimin e vullnetit tonë ndaj tij.

Aksioma e dytë e Sun Tzu-së në librin e tij “Arti i Luftës” është: “Prandaj më e mira luftë është të shkatërrosh qëllimet e kundërshtarit, në rend tjetër vjen shkatërrimi i aleatëve të tij, e në tjetër rend shkatërrimi i ushtrisë së tij. Më e mira është jo të rrethosh kështjella dhe të lëshosh ushtarët si miza e në fund të mos e marrësh kështjellën, pasi kjo kërkon kosto dhe humbje të mëdha”.[5] Aplikimi i kësaj thënieje në Artin Ushtarak të FA dhe në doktrinën e saj gjen plotësisht zbatim.

Në manualin MP 3-0 “Operacionet e përbashkëta luftarake dhe joluftarake” bëhet fjalë për nivelet e luftës. Duke u ndalur në nivelin strategjik, ajo është e shprehur qartë në strategjinë ushtarake, e cila është arti dhe shkenca e përdorimit të forcave të armatosura për realizimin e qëllimeve të politikës së mbrojtjes nëpërmjet përdorimit të FA-së, ose kërcënimit të përdorimit të tyre. Kjo do të thotë, që strategjia ushtarake parashikon format, mënyrat, planet për përdorimin e FA–së, që është në sinkron me thëniet e Sun Tzu-së, kur thekson se duhet llogaritur dhe planifikuar çdo gjë përpara se të sulmohet një kështjellë apo një kundërshtar, pasi pa planifikuar mund të pësosh humbje të konsiderueshme dhe qëllimi nuk arrihet. Po këtu gjen vend edhe parimi i ekonomizimit të forcës, kur theksohet përdorimi i resurseve dhe kërcënimi me anë të forcës, ashtu siç Sun Tzu thekson fitimin e betejës pa u ndeshur. Referuar manualit FM 100- 40 “Taktika”, një ndër konceptet taktike kryesore është ekonomizimi i forcës që e përmendëm më lart. Në këtë manual theksohet se: “forcat dhe mjetet duhet të ekonomizohen në mënyrë të tillë që në drejtimin kryesor të përdoret sasia më e madhe e tyre, ndërsa në drejtimet ndihmuese sasi më e pakët dhe gjithashtu, në bazë të parashikimit të rreziqeve dhe kërcënimeve, është e nevojshme edhe mbajtja e një rezerve për ta përdorur në momentin e volitshëm[6].

Prandaj sipas thënieve të Sun Tzu-së, të perifrazuara më lart, gjen zbatim në artin tonë ushtarak “Vlerësimi i kundërshtarit” që nxjerr në pah se sa vital është arti ushtarak i FA për një shtet. Këtu gjejnë zbatim pesë parime dhe faktorë të rëndësishëm të luftës, që duhen vlerësuar, si: influenca e forcës morale, koha, terreni, komandim-kontrolli dhe doktrina e kundërshtarit. Sun Tzu në librin e tij thekson se, “lufta duhet të zhvillohet në një kohë sa më të shkurtër që të jetë e mundur”[7]. Duke iu referuar Manualit MP 3-0, në faqen 153, bëhet fjalë për planëzimin e operacioneve të FA në nivel strategjik, ku ndër të tjera edhe për parashikimin e burimeve të nevojshme dhe

[4] Doktrina e Përbashkët e FA të RSH-së, faqe 199.
[5] Sun Tzu. “Art i Luftës”.
[6] FM 100-40 “Taktika” faqe 80, perifrazim.
[7] Sun Tzu “Art i luftës”.

përcaktimin e saktë të objektivave, çka janë në sinkron me aksiomën a Sun Tzu-së, për një luftë sa më të shkurtër dhe me humbje sa më të vogla[8].

Aksioma e katërt e Sun Tzu-së, objekt i materialit tonë është: "Nëse forcat e tua janë dhjetë herë më të mëdha se të armikut, rrethoje atë nga të gjitha anët, n.q.s janë pesë herë më të mëdha, sulmoje atë, n.q.s janë dy herë më të mëdha ndaje atë në pjesë, n.q.s janë të barabarta mund të ndeshesh me të, n.q.s forcat i ke më të pakta, ke mundësi të mbrohesh prej tij. Prandaj ata që këmbëngulin me forca më të pakta, bëhen robër të kundërshtarit të fortë."[9]

Për të parë reflektimin e kësaj aksiome të Sun Tzu-së në Artin Ushtarak të FA-së, ne iu referuam Doktrinës së Përbashkët të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në këtë manual, duke e perifrazuar atë, theksohet konkretisht se, për të asgjësuar armikun duhet ta njohësh atë në detaje, të njohësh anët e forta dhe të dobëta të tij. Por një element i rëndësishëm që duhet të kihet në konsideratë është edhe përcaktimi drejt, i qendrës së rëndesës së armikut, çka nuk është një gjë e lehtë. Përcaktimi i qendrës së rëndesës nuk do të thotë të përcaktosh vetëm ku i ka përqendruar armiku forcat dhe mjetet kryesore, por me mjaft rëndësi është edhe përcaktimi i atij që është një abstraksion, pra mbështetja e armikut nga publiku ose qëllimi i tij politik. Ky fakt është mjaft i rëndësishëm në nivelin strategjik të luftës.

Po kështu, duke iu referuar manualeve të tjera të FA-së, në mjaft prej tyre si, MP 3-0, DPU-10 etj., theksohet se që të ndeshesh me kundërshtarin duhet së pari të njohësh veten, të njohësh aftësitë e forcave të tua, burimet dhe teknikën luftarake që disponon, por njëkohësisht, duhet të njohësh edhe kundërshtarin. Ky fakt reflektohet në doktrinën dhe Artin Ushtarak të FA të RSH, dhe konkretisht në procesin e marrjes së vendimit, ku një ndër fazat e tij është analiza e faktorëve. Në këtë fazë, komandanti duhet të krijojë një ide të qartë për aftësitë e forcave tona dhe të marrë informacionin e nevojshëm për armikun, ku ndodhet ai, ku i ka dislokuar forcat dhe mjetet kryesore, cilat janë pikat e tij të forta dhe të dobëta. A nuk reflekton kjo pikëpamjet e Sun Tzu-së të theksuara në librin e tij "Arti Luftës"?

"Strategu është për shtetin njësoj si boshti i rrotës së qerres, nëse është i fortë, shteti patjetër është i fortë, n.q.s. ai është dobësuar, shteti patjetër është i dobët". Ky krahasim mjaft i goditur i Sun Tzu-së, nxjerr në pah, rolin e liderit në fitoren e luftës. Le të shikojmë reflektimin e këtij parimi në doktrinën tonë ushtarake. Referuar manualit MP 3-0, "Operacionet e përbashkëta luftarake dhe joluftarake" në faqen 41, përmenden elementet e komandim-kontrollit, ku një ndër më të rëndësishmit është edhe lidershipi (udhëheqja). Eksperienca luftarake, theksohet ndër të tjera në këtë manual, ka treguar se për shkak të kaosit dhe frenimit që ndodh gjatë veprimeve luftarake, vendimet merren më mirë dhe më saktë nga niveli i drejtimit të përfshirë drejtpërdrejt në zbatim.

Udhëheqja është procesi i ndikimit në mënyrë të ndërgjegjshme në sjelljen e të tjerëve dhe i përpjekjeve vetjake me qëllim që të arrihet objektivi i përcaktuar bashkërisht. Çdo komandant e motivon veprimtarinë e personelit të tij vartës në mënyrë të ndryshme. Zotërimi i aftësive udhëheqëse është një nga cilësitë më të rëndësishme

[8] MP 3-0 " Operacionet e përbashkëta luftarake dhe joluftarake".
[9] Sun Tzu "Art i luftës".

që një lider duhet të ketë për të ushtruar komandimin; te njësitë ushtarake ky është një parakusht për suksesin e veprimit.[10]

Në nivel strategjik, ky faktor merr një rëndësi më të madhe. Në nivelin strategjik lidershipi ushtrohet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së. Është ai ushtaraku më i lartë që i drejton Forcat e Armatosura në rrugën e duhur, që në sinkron me politikën e shtetit, i orienton Forcat e Armatosura në drejtimin e duhur, dhe realizon qëllimet e Politikës në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e vendit. Sa më i mirëorientuar, sa më njohës i mirë i misionit kushtetues të FA-së dhe sa më në përputhje me politikën e shtetin të jetë lidershipi vendimmarrës ushtarak, aq më mirë FA do të realizojë misionin e saj kushtetues dhe detyrimet në operacionet e përbashkëta në kuadër të Aleancës.

Ndër të tjera, në librin e tij "Arti i Luftës", Sun Tzu thekson: Prandaj është e njohur të fitohet në pesë raste: "Fitojnë ata që dinë kur të ndeshesh dhe kur jo, fitohet atëherë kur të lartët dhe të ulët kanë të njëjtën dëshirë, fitohet atëherë kur je i kujdesshëm dhe rri në pritje të pakujdesisë së kundërshtarit"[11].

Kjo do të thotë që, para se të ndeshesh me një kundërshtar, duhet t'i bësh llogaritë mirë, duhet të krahasosh forcat dhe mjetet, anët e forta dhe të dobëta, pra të bësh atë që ne e theksuam edhe më lart, të analizosh të gjithë faktorët. "Mos e sulmo armikun kur është i organizuar dhe kur po avancon, -thotë Sun Tzu -por prit kur ai të humbasë fuqinë luftarako". Kjo aplikohet mjaft mirë në doktrinën tonë ushtarake.

Ata që janë të aftë në luftë, vlerësojnë aftësitë e armikut, e fitojnë luftën pa u ndeshur. Kapja e qyteteve të armikut pa luftuar, fitimi i luftës pa humbje, kjo është zgjuarsia, -thekson Sun Tzu, -ky është arti i mësymjes strategjike.

Prandaj, -thekson Sun Tzu, -njih veten dhe kundërshtarin, kur ju jeni injorant në njohjen e armikut por njihni vetveten, shanset për fitore janë të barabarta, por, kur ju nuk njihni veten dhe as armikun, humbja është e garantuar.

Në këto refleksione të librit të Sun Tzu-së "Arti i Luftës", padyshim që ne e gjejmë veten dhe e praktikojmë në artin tonë ushtarak të luftës. Aksiomat e Sun Tzu-së që përmendëm në këtë material të shkurtër, si: njohja e vetes dhe e kundërshtarit, përdorimi me efektivitet i forcave dhe mjeteve, roli i faktorit moral në luftë, roli i lidershipit etj, të gjithë këto parime zbatohen më së miri në doktrinën e Forcave të Armatosura dhe në manualet që përmendëm. Prandaj, Sun Tzu është aktual edhe në ditët e sotme dhe referimi i këtyre parimeve, në konfliktet dhe betejat si më vete, ashtu edhe në kuadër të operacioneve të përbashkëta në kuadër të Aleancës, është një domosdoshmëri e komandantëve që drejtojnë formacionet ushtarake.

Komandantët e të gjitha niveleve në Forcat e Armatosura të RSH-së duhet të studiojnë me baza mësimet e nxjerra, që nga kohët më të lashta e deri në ditët e sotme. Është detyrë e ushtarakëve nëpër shtabe dhe nivele komandimi, që në operacionet ushtarake të studiojnë dhe t'u referohen strategëve ushtarakë, si: Sun Tzu, Karl fon Klauzeviç, Napoleoni, por edhe atyre të kohëve moderne, për të nxjerrë mësime e për të

[10] MP 3-0 "Operacionet e përbashkëta luftarake dhe joluftarake", faqe 41-42.
[11] Sun Tzu, "Art i Luftës", faqe 287-290.

përmirësuar aktivitetin tyre luftarak. Vetëm kështu do të arrihet realizimi me sukses i misionit të tyre, mbrojtja e tërësisë territoriale të RSH-së dhe plotësimi i detyrimeve, si dhe integrimi i plotë i Forcave tona të Armatosura sipas standardeve të NATO-s.

Ndër të tjera duhen mbajtur në konsideratë thëniet e të madhit Sun Tzu se: Çdo shtet duhet të ketë doktrinën e tij ushtarake për t'u mbrojtur nga rreziqet e jashtme, për të qenë gjithmonë i përgatitur duke menduar gjithnjë se armiku është në sulm e agresion. Kur armiku përqendrohet, -thekson Sun Tzu, -përgatitu kundër tij, sulmoje atë kur ai është i papërgatitur. Fitorja është objektivi kryesor i luftës. Ai që e kupton kur duhet luftuar dhe kur jo, ai që di kur të përdorë forca të shumta dhe kur të pakta, ai që është gjithmonë i përgatitur, është i destinuar të fitojë dhe realizojë qëllimin e luftës. Theksuam gjithashtu edhe rolin e liderit, që sipas Sun Tzu-së "kurrë nuk duhet luftuar kur je i papërgatitur, kurrë mos lufto kur nuk je i sigurt në fitore". Aq aktuale është teoria dhe përvoja e Sun Tzu-së dhe aq e aplikuar në artin tonë ushtarak, sa kurrë nuk duhet harruar çka ai thekson: "Ashtu si uji nuk ka një formë konstante, edhe në luftë nuk ka kushte konstante, përdore strategjinë në luftë bazuar gjithmonë në manovrën dhe mashtrimin". Jo më kot Amerikanët, duke iu referuar doktrinës së Sun Tzu-së, në operacionin "Liria e Irakut", shmangën planet fikse të luftimit, përdorën mjetet e teknologjisë së lartë dhe sistemet e inteligjencës. Forcat e rregullta sulmuan kundërshtarin, ndërsa ato speciale shfrytëzuan pikat e tij të dobëta. Një shembull tjetër tipik, referuar në strategjinë e Sun Tzu-së, është edhe beteja në Pearl harbour, më 7 dhjetor të vitit 1941, ku u aplikua më së miri ideja se kur njihet armiku dhe vetja, fitorja është më se e sigurt.

Në luftën e Koresë gjeti zbatim edhe thënia tjetër e Sun Tzu-së, "Për të qenë i sigurt se çfarë po sulmoni, gjeni pikat e dobëta të armikut". "Tezat e Sun Tzu-së janë aplikuar në të gjithë akademitë ushtarake të botës", -thekson Gjeneral Montgomeri.

Duke e krahasuar Strategun kinez me Karl fon Klauzeviç dhe Zhomini, del në pah edhe vizioni i secilit prej këtyre tre dijetarëve ushtarakë. Klauzeviçi theksonte se: "format e luftimit janë mbrojtja dhe mësymja", Zhomini e konsideronte mbrojtjen, si "forma më e rëndësishme e luftimit", ndërsa Sun Tzu theksonte se: "kur duhet të mbrohesh dhe kur të sulmosh, varet gjithmonë nga rrethanat". Gjithashtu:-mos bini pre dhe mos përdorni gjithmonë të njëjtën strategji mësymëse, edhe pse mund të keni fituar më parë, pasi armiku mund të ndryshojë dhe të përshtatet për formën e mësymjes që ju keni pasur sukses, prandaj ndryshoni gjithmonë strategjinë dhe taktikën e luftimit, në përputhje me terrenin dhe rrethanat. Gjenerali që nuk di të përdorë si duhet terrenin, është i papërshtatshëm për të luftuar-thotë Sun Tzu.

Si konkluzion mund të thuhet se: Teoria e Sun Tzusë për luftën është aq aktuale dhe e zbatueshme, sa çka qenë mijëra vjet më parë. Teoritë moderne të luftës bazohen në shumë faktorë, si: kultura, teknologjia, terreni, mësimet e nxjerra nga zhvillimet e operacioneve luftarake. Ndërsa historia përparon, konceptet bazë të teorisë së zhvillimit të luftës vazhdojnë të mbështeten në dimensionet njerëzore të konfliktit të armatosur. Lufta bëhet nga njerëzit dhe jo nga teknologjia. Pas mijëra vjetësh, natyra njerëzore e luftës mbetet thelbësore dhe e pandryshueshme.

Arti i Luftës i Sun Tzu ka influencuar shumë liderë ushtarakë dhe ushtri profesioniste, siç ka influencuar dhe aplikohet edhe nga Forcat tona të Armatosura. Operacionet e

kryera nga ushtri të mëdha, si ajo e SHBA dhe konkretisht lufta e Gjirit e viteve 1990, ka aplikuar një sërë parimesh të të madhit Sun Tzu. Gjenerali Norman Schwartzkopf Jr praktikoi me mjaft sukses parimet e mashtrimit, shpejtësisë, goditjes së armikut në pikën më të dobët etj, të analizuara me kujdes nga Sun Tzu. Në librin e tij biografik, Gjeneral Tommy Franks theksonte "Unë kam lexuar si për luftën, ashtu edhe për paqen: teoritë e Sun Tzu, Clausevic, Bertram Russell dhe Gandhi."[12] Teoritë e Sun Tzu kanë influencuar planëzuesit ushtarakë të Operacionit "Stuhia e Shkretëtirës" e vitit 1991 dhe të Operacionit "Liria e Irakut" e vitit 2003. Liddell Hart, strategjisti i madh britanik e përshkruan Sun Tzu-në si "mendjen më të koncentruar në zhvillimin e luftës"[13]

Sun Tzu përpiloi teorinë e tij të luftës mijëra vjet më parë, por strategët dhe lidershipi ushtarak i sotëm vazhdojnë t'i referohen atij. Ai analizoi të gjithë nivelet e luftës dhe hartoi udhëzime dhe metoda për fitimin e çdo lloj lufte. Ai hartoi metodat e studimit të luftës, duke i mundësuar strategëve ushtarakë të mendojnë thellë dhe në mënyrë krijuese. Ai u ka ofruar liderëve ushtarakë dhe më gjerë, një perspektivë unike për luftën, strategjinë, lidershipin dhe inteligjencën. Këta që përmendëm janë vetëm katër elemente nga të shumtat që ka analizuar Sun Tzu. Teoria e tij është aq aktuale sot, sa ç'ishte mijëra vjet më parë. Teoria e tij është e provuar nga koha dhe e zbatueshme në kushtet e sotme të konflikteve të armatosura, në artin ushtarak të Forcave tona të Armatosura, por sidomos, të ushtrive të mëdha, operacionet e të cilave kanë qenë më të shpeshta në historitë e luftës. Liderët ushtarakë dhe strategët e shekullit të njëzetenjëtë, Forcat tona të Armatosura duhet t'i referohen Sun Tzu-së, si teoricieni më i mirë i luftës.

Bibliografia:

- Sun Tzu, "Arti i Luftës".
- DPU-10, "Doktrina e Përbashkët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë"
- MP 3-0 "Operacionet e Përbashkëta Luftarake dhe jo luftarake"
- FM 100-40, "Taktika"
- Robert L.Cantrell, "Understanding Sun Tzu on the Art of War" (Arlington, VA, Center for Advantage, 2003), 4.
- Sun Tzu: "Theorist for the twenty-first century" by Colonel Gregory l. Wilcoxon United States Army National Guard

[12] Mark McNelly, Sun Tzu and the Art of Modern Warfare (New York, Oxford University Press, Inc., 2001).

[13] Griffith, Sun Tzu: "The Art of War"

Drejt harmonisë apo përplasjes së qytetërimeve? Huntingtoni i gabuar?

MSc. Lindita Mukaj
Programi i Doktoraturës 2010-2013
Akademia e Forcave të Armatosura

Trajtesë e shkurtuar. *Trajektorja globale e nisur nga gjeopolitika drejt gjeokulturës është një temë që ka tërhequr shumë studiues të mëdhenj, analistë, vëzhgues e liderë politikë. Immanuel Valershtajn ka shkruar ese të mrekullueshme rreth kësaj teme. Terence Hokins e shumë të tjerë janë marrë gjithashtu me këtë trajektore. Natyrisht që dimensionet e tyre janë globale, ashtu sikurse është vetë karakteri i kësaj teme.*

Në këtë shkrim dua të paraqes një studim modest për paradigmën e Huntingtonit tek analiza sfiduese drejt harmonisë apo përplasjes së qytetërimeve? Huntingtoni i gabuar apo…?Për ta bërë më të qartë atë që dua të shpreh, do të përqendrohem në një këndvështrim më domethënës të globalizmit si fenomen dhe si proces, në funksion të trajtave konkrete që merr në aspektin kulturor.

Teza që mbroj përmes këtij artikulli është se trajektorja globale po rreh gjithnjë e më shumë për nga kultura dhe se, në këto kushte, është e domosdoshme të krijohet një kulturë strategjike drejtimi e menaxhimi, e cila, nga ana e saj, duhet të formësohet jo vetëm si nevojë parimore, por edhe si detyrim institucionesh shtetërore e shoqërore, për të gjetur e zbatuar përzgjedhjet dhe zgjidhjet më frutdhënëse në tregun global të politikave, ekonomisë dhe kulturës.

Përplasja e qytetërimeve

Përplasja e qytetërimeve është një teori e propozuar nga studiuesi i politikës *Samuel Huntington*. Teoria shpreh se identitetet kulturore dhe fetare do të jenë burimi kryesor i konflikteve në botën e Pasluftës së Ftohtë. Fillimisht, kjo teori u formulua në një leksion të vitit 1992, në *American Enterprise Institute*. Më pas, ideja u zhvillua në një artikull të "*Foreign Affairs*" me titull "Përplasja e qytetërimeve" si një reagim ndaj librit të *Francis Fukuyama*, "Fundi i historisë dhe njeriu i fundit"[1]. Më vonë, *Huntington* shtjellon më gjerë tezën e tij në librin e botuar në vitin 1996 "Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit të ri botëror".

Huntington e nis shtjellimin e tij pasi ka vëzhguar një sërë teorish rreth politikave globale të Pasluftës së Ftohtë. Ai beson se, teksa ideologjisë i ka ardhur fundi, bota po i kthehet një gjendjeje normale të karakterizuar nga konflikti kulturor. Kështu, në tezën e tij, ai përpiqet të argumentojë se, në të ardhmen, trajtat kulturore dhe fetare do të përbëjnë boshtin e konflikteve. [2]

Huntington argumenton se trendet e konfliktit global pas përfundimit të Luftës së Ftohtë janë shfaqur gjithnjë e më shumë në këto ndarje të qytetërimeve. Luftëra të tilla si ato pas shpërbërjes së Jugosllavisë, në Çeçeni dhe në mes Indisë dhe Pakistanit janë dëshmi të konfliktit të ndër-qytetërimeve. Gjithashtu, *Huntington* argumenton se besimi i përhapur perëndimor mbi universalitetin e vlerave të perëndimit dhe sistemeve politike është naiv dhe se këmbëngulja e vazhdueshme për demokratizim dhe norma të tilla "universale" vetëm do të armiqësojnë më tej qytetërimet e tjera. *Huntington* identifikon një zhvendosje të madhe të fuqisë ekonomike, ushtarake, politike dhe nga perëndimi në qytetërimet e tjera të botës, më dukshëm dhe në mënyrë shumë domethënëse, në atë që ai e identifikon si dy "kandidatët-sfidantë të qytetërimeve"-qytetërimet sinike[3] dhe islamike.

Sipas mendimit të *Huntingtonit*, qytetërimi aziatiko-lindor sinik është në proces të vlerësimit të vlerave të tij kulturore në lidhje me perëndimin, për shkak të rritjes së shpejtë ekonomike të këtyre vendeve që aderojnë në këtë qytetërim. Në mënyrë të

[1] "Fundi i historisë dhe njeriu i fundit" i Francis Fukuyama ishte një shtjellim më i gjerë i esesë së autorit "Fundi i Historisë?" i botuar në revistën mbi çështjet ndërkombëtare "*The National Interest*". Në këtë libër, *Fukuyama* argumenton se shfaqja e liberal-demokracisë perëndimore mund të sinjalizojë pikën fundore të zhvillimit socio-kulturor të njerëzimit dhe formën fundore të qeverisjes njerëzore. Ai shprehet:"Çfarë do të dëshmojmë nuk është vetëm fundi i Luftës së Ftohtë ose kalimi në një periudhë tjetër të veçantë të historisë, por fundi i historisë: kjo do të thotë pika e fundit e zhvillimit ideologjik të njerëzimit dhe universalizimi i liberal-demokracisë perëndimore si forma përfundimtare e qeverisjes njerëzore

[2] Në vitin 1993, në artikullin e "Foreign Affairs", *Huntington* shkruan:*"Është hipoteza ime se burimi kryesor i konflikteve në botën e re nuk do të jetë as ideologjik dhe as ekonomik. Kjo ndarje e madhe ndërmjet njerëzimit dhe burimi mbizotërues i konflikteve do të jetë kulturor. Shtet-kombet do të mbeten aktorë të fuqishëm në çështjet botërore, por konfliktet më të mëdha të politikës globale do të ndodhin ndërmjet kombeve dhe grupeve të qytetërimeve të ndryshme. Përplasja e qytetërimeve do të dominojë politikën botërore."*

[3] Qytetërimi sinik përfshin Kinën, Koretë, Singaporin, Tajvanin dhe Vietnamin, siç janë përshkruar edhe në hartë.

veçantë, ai beson se Kina po shfaqet gradualisht si fuqi hegjemone rajonale dhe se vendet e tjera në rajon do t'i bashkëngjiten Kinës, për shkak të historisë e strukturave komanduese hierarkike të nënkuptuara në qytetërimin sinik konfucian[4] në krahasim me individualizmin dhe pluralizmin që e karakterizon perëndimin.

Huntington e konsideron qytetërimin islamik si një aleat potencial të Kinës. Të dy qytetërimet kanë qëllime të njëjta në raport me qytetërimet e tjera, veçanërisht ndaj perëndimit. Në mënyrë të veçantë, ai identifikon interesat e përbashkëta kineze dhe islamike në zonat e përhapjes së armëve, të të drejtave të njeriut, të demokracisë, të cilat bien ndesh me ato të perëndimit dhe mendon se këto janë fushat në të cilat dy qytetërimet do të bashkëpunojnë.

Për Rusinë, Japoninë dhe Indinë, *Huntington* përdor termin "qytetërime të lëkundura", të cilat mund të favorizojnë edhe perëndimin, edhe një aleancë kineze-islamike. Gjithashtu, *Huntington* argumenton se konfliktet e qytetërimeve janë "veçanërisht të përhapura midis myslimanëve dhe jo myslimanëve", duke identifikuar "kufijtë e përgjakur" midis qytetërimeve jo islamike dhe islamike. Ky konflikt shkon aq larg deri në pushtimin e Evropës nga Islami, vendosjen e tyre madje edhe në gadishullin Iberik, sulmet e turqve osmanë mbi Evropën Lindore, deri në Vjenë.

Të gjithë këta faktorë historikë dhe modernë të kombinuar mes tyre që *Huntington* i ka përshkruar në librin e tij, mund të shkaktojnë, në të ardhmen, përplasje të përgjakshme mes qytetërimeve islamike dhe perëndimore. Së bashku me konfliktin perëndimor-sinik, ai beson se përplasjet islamike-perëndimore do të paraqesin konfliktet e fillimit të shekullit të 21-të. Kështu, sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001 dhe ngjarjet e mëvonshme, duke përfshirë luftërat në Afganistan janë parë gjerësisht si një provë e teorisë së përplasjes së qytetërimeve.

Harmoni apo përplasje? Huntingtoni i gabuar?

Bota që kërkon identitete është në një farë ankthi: Globalizimi do të sjellë një qytetërim universal, unik në llojin e tij, apo do të kemi një pluralitet qytetërimesh të cilat do të kërkojnë të rivalizojnë dhe madje të përplasen midis tyre?

Prononcimin më të hapur për këtë tezë e ka *Huntington*, i cili në thelb, i sheh qytetërimet e ndryshme si shkak përplasjeje. Sipas *Huntington*, konfliktet kulturore më të rrezikshme do të jenë midis vijave të shkëputjes së qytetërimeve. Ai mbron idenë se në botën e Pasluftës së Ftohtë, kultura është njëkohësisht forcë ndarëse si dhe fuqi bashkuese. Njerëzit janë të përçarë nga ideologjia, por të bashkuar prej kulturës. *Huntington* mendon se "perdja e hekurt" që ishte vendosur për shkaqe ideologjike në qendër të Evropës në Luftën e Ftohtë, pas kësaj lufte është zhvendosur disa qindra kilometra më në lindje, duke zëvendësuar ndarjen e djeshme ideologjike me ndarjen midis perëndimit dhe botës islame. Edhe *Vaclav Havel* ka vënë në dukje se: "Konfliktet kulturore janë duke u shtuar dhe sot janë më të rrezikshme më shumë se në ndonjë periudhë

[4] Konfucianizëm është një sistem filozofik i zhvilluar nga filozofi kinez Konfuci (551–479 BC). Është një sistem kompleks i mendimit moral, shoqëror, politik, filozofik dhe pothuajse fetar që ka patur ndikim të gjerë në Azinë Lindore, për shkak të promovimit të ideve të Konfucit në qeverisje.

tjetër të historisë," ndërsa *Jaques Delors* ishte i një mendjeje kur thoshte se "Konfliktet e ardhshme do të ndizen nga faktorë kulturorë dhe jo nga ideologjia dhe ekonomia."[5]

Nëse i marrim si të mirëqena tezat e mësipërme, atëherë dalin një varg pikëpyetjesh: A janë qytetërimet qendra fuqie për të zëvendësuar, si të tilla, fuqitë, kur dimë që fuqi janë, si rregull, shtetet kombe? A mund të kenë organizim qytetërimet që të kryejnë përplasjen? Në çfarë raportesh do të jenë qytetërimet me monopolin global? Do të ketë më shumë prirje drejt identitetit etnik apo drejt identitetit kulturor? Qytetërimet dhe polet përkatëse do të jenë mburojë apo kërcënim për sovranitetin kombëtar dhe identitetet etnike në kuadrin e globalizimit? Cila do të jetë natyra e vërtetë e globalizimit në të ardhmen nëse këto qytetërime përplasen, nëse konkurrojnë apo nëse afrohen midis tyre?

Për hir të së vërtetës, hipotezat e *Huntingtonit*, të ngritura në librin e tij "Përplasja e Qytetërimeve" janë bërë objekt diskutimesh dhe analizash në nivelet akademike universitare, por edhe në rrethet e politikëbërësve. Ka edhe autorë të cilët e konsiderojnë këtë libër si të kompromentuar dhe autorin si zëdhënës të qëllimshëm të qarqeve të caktuara politike në SHBA, të cilat kërkojnë të shpikin një armik të ri në vendet e botës myslimane dhe të përligjin ose të justifikojnë ndërhyrjen për të luftuar terrorizmin. Sidoqoftë, jehona e këtij libri ka përfshirë të gjitha nivelet dhe skenarët që projektohen në libër, nuk mund të mos merren në konsideratë.

Në një shkrim të tij, studiuesi *Amartya Sen* (1999) argumenton se "diversiteti është një tipar i shumicës së kulturave të botës. Qytetërimi perëndimor nuk është përjashtim. Praktika e demokracisë që ka fituar në perëndimin modern është, në një masë të madhe, rezultat i konsensusit që u shfaq qysh nga Rilindja dhe Revolucioni Industrial, sidomos në shekullin e fundit. *Paul Berman*, shkrimtar i shquar në letërsinë politike, argumenton se nuk ka kufij të dallueshëm kulturorë në ditët e sotme. Ai thotë se nuk ka "Qytetërim Islamik", as "Qytetërim Perëndimor" dhe se nuk ka prova bindëse për përplasje qytetërimesh. Sipas *Berman*, konfliktet lindin për shkak të besimeve që ndajnë (ose nuk ndajnë) me njeri tjetrin grupe të ndryshme besimesh filozofike, pavarësisht nga identiteti i tyre kulturor apo fetar.[6]

Një studiues tjetër, *Said*, profesor në Universitetin *Columbia* në SHBA, me origjinë palestineze, e ka vlerësuar konceptin e *Huntington* "Përplasja e Qytetërimeve" si "Përplasje Injorance," sepse kategorizimi i *Huntington* për qytetërimet, duke i marrë si objekte "të ngurta," mohon ndërvarësinë dhe ndërveprimin dinamik të kulturave. Ai vlerëson se konceptet e *Huntingtonit* janë "racizëm i pastër, një lloj parodie e shkencës hitleriane që sot drejtohet kundër arabëve dhe myslimanëve."[7] *Noam Chomsky* e ka kritikuar konceptin e përplasjes së qytetërimeve duke thënë se është thjeshtë një justifikim i ri për

[5] Huntington, Samuel P, "*The Clash of Civilizations and the Remaking of World Order*", 2003, pg.28.
[6] Berman, Paul, "Terror and Liberalism", 2003.
[7] Said, Edward "The Clash of Ignorance", 2001, pg.293.

SHBA-të për çfarëdo kasaphane njerëzore që duan të zbatojnë dhe që iu kërkohet pas Luftës së Ftohtë kur Bashkimi Sovjetik nuk është më një kërcënim jetësor.[8]

Një nismë e kundërt me konceptet e *Huntingtonit* është ideuar nga presidenti i Spanjës, *José Luis Rodríguez Zapatero* i bashkësponzorizuar nga kryeministri turk *Recep Tayyip Erdoðan*. Nisma është shpallur në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, në 2005 dhe quhet "Aleanca e Qytetërimeve." Ajo synon të rrisë veprimin kolektiv përmes shoqërive të ndryshme për të luftuar ekstremizmin, për të kapërcyer barrierat shoqërore e kulturore midis botës perëndimore dhe asaj me shumicë myslimane dhe për të pakësuar tensionet dhe polarizimin midis shoqërive që ndryshojnë në vlerat kulturore e fetare.

David Brooks, studiues, gazetar amerikan mendon se "*Huntington* ka një gabim themelor në trajtesat e veta kur thotë se popujt në hapësirën arabe nuk janë në thelb së brendshmi nacionalistë. Ai argumentonte se ata nuk kanë "uri" për pluralizëm dhe demokraci në mënyrën se si këto gjëra kuptohen në perëndim. Por tani, me lëvizjen 'Pranvera Arabe', duket se ata thjesht po jetojnë rrethanat që nuk e lejuan atë patriotizëm të dilte në sipërfaqe."[9] Ai shprehet më tej se edhe arabët, si të gjithë popujt kanë "veten" e tyre. Kur rrethanat ndryshojnë, edhe arabët, si të gjithë kombet e tjera, aktivizojnë identitetet e tyre. Kanë jetuar me frikë për shkak të regjimeve tiranike, por kur kanë ndryshuar rrethanat atëherë iu janë energjizuar si aspiratat, edhe identitetet kombëtare. Ne kemi parë popuj arabë që jetojnë në pluralizëm dhe demokraci. *Huntington* e përcaktoi në mënyrë të gabuar kulturën apo qytetërimin arab. Edhe arabët e duan lirinë. Edhe arabët e kanë kulturën, ndoshta me diferenca, por kanë edhe ata brenda tyre "aspiratën universale për dinjitet, për sisteme politike që i dëgjojnë, që u përgjigjen dhe që respektojnë vullnetin e njerëzve."[10]

E vërteta është se në kohën e perandorive të mëdha, qytetërimet pothuajse përputheshin me kufijtë (nëse do mund t'i quanim kështu, pasi në atë kohë nuk bëhej fjala për kufij të mirëfilltë) administrativë të tyre. Sot, në kohën e pluralitetit të shteteve kombe dhe madje të shumimit të tyre, qytetërimet nuk kanë më ato forma politike të përhapjes. Qytetërimet e sotme janë përhapur në zona klasike por jo me strukturën klasike të perandorive. Përkundrazi, në secilën prej tyre gëlojnë shtete nga më të ndryshmet në sistemin politik, në orientimet fetare, etj. Madje, brendapërbrenda një hapësire qytetërimi që dikur ishte unik, sot kemi shtete që janë deri edhe të armiqësuara me njëri-tjetrin sikurse janë shtetet arabe me përbërje fetare *shiit* me ata *sunit*, etj.

Atëherë del pyetja: Do të kemi në të ardhmen përplasje apo harmoni qytetërimesh, apo një gjendje të mesme, të pjesshme? Globalizimi kërkon si rregull një ndërvarësi dhe bashkërendim të gjithanshëm. Për të arritur këtë duhet që të ndërhyjnë kulturat. Në pikëpamjen e *Huntington* përjashtohen kategorikisht iluzionet e atyre që mendojnë se globalizimi postmodern do të mbështetet në një qytetërim unik, universal, ku sistemi

[8] Chomsky, Naom, "Clash of Civilizations?", leksion i mbajtur në Shkollën Ekonomike Delhi, 5 Nëntor 2001, publikuar nga Oxford University Press.
[9] Brooks, David, "Huntington's Clash Revisited", New York Times, March 3, 2011.
[10] Po aty.

ndërkombëtar do të merrte formën e bazuar në një ideologji të vetme. Faktikisht globalizimi ekonomik është më i lehtë të arrihet, sepse është një nevojë e ngutshme ekonomike.

Modernizimi, evropianizimi dhe "vendet në ndryshim"

Janë të shumtë kritikët që parashtrojnë argumente ndaj qëndrimeve të atyre që besojnë se kulturat tradicionale mund të modernizohen vetëm duke u bazuar mbi qasjen perëndimore. Këta reformatorë dëshirojnë të modernizojnë qytetërimet e tyre, duke u bazuar në vlerat e kulturës perëndimore. Ata e kuptojnë modernizimin të bashkëngjitur me kulturën perëndimore.

Ata që e konsiderojnë të saktë tezën e "Përplasjes së Qytetërimeve" mbështeten te shembulli i Japonisë dhe argumentojnë se Japonia nuk është në thelb të saj një shtet perëndimor, se Japonia ka adoptuar teknologji perëndimore (si edhe ka zhvilluar teknologjinë e saj në vitet e fundit), demokraci parlamentare dhe treg të lirë, por ka mbetur shumë e ndryshme dhe e dallueshme nga perëndimi në anën kulturore Edhe Kina është cituar si një ekonomi jo perëndimore në rritje. Janë të shumtë studiuesit që argumentojnë se *Tigrat e Azisë Lindore* kanë adoptuar ekonominë perëndimore duke ruajtur dhe mirëmbajtur qeveri shoqërore tradicionale dhe autoritare.

Ndoshta, shembulli i fundit i modernizimit joperëndimor është Rusia, një shtet lider i qytetërimit ortodoks. Variant i këtij argumenti (ku Rusia përdoret si shembull) mbështetet në pranimin jo tërësor të qytetërimit perëndimor. Mirëpo, zhvillimet e fundit tregojnë një përafrim gjithnjë e më të madh të kulturës ortodokse ruse dhe të vendeve të tjera ortodokse me perëndimin. Kjo gjë ka ndodhur edhe me vende fqinje të Rusisë, të cilat kanë zgjedhur përfshirje në aleanca politike dhe ushtarake si NATO dhe BE dhe me vendet që janë katërcipërisht perëndimore.

Sipas *Huntington*, perëndimi dallohet nga vendet e krishtera ortodokse nga përvojat e Rilindjes, reformimit, ilumimizmit, kolonializmit. Vërehen edhe ndryshime ndërmjet vetë shteteve sllave brenda këtij qytetërimi të quajtur nga *Hutington* si ortodoks. Megjithatë, për shtete të caktuara ka ambiguitete në lidhje me faktin se kujt qytetërimi i përkasin në të vërtetë. *Huntington* i referohet atyre vendeve që përpiqen të bashkohen apo anëtarësohen në një qytetërim tjetër si "vende në ndryshim". Një shembull i goditur është Turqia, lidershipi politik i së cilës është përpjekur sistematikisht të evropianizohet që prej viteve 1920.

Sipas *Huntington*, një vend "në ndryshim" duhet të përmbushë tre kushte për të ripërcaktuar identitetin e tij të qytetërimit. *Së pari*, elita e tij politike dhe ekonomike duhet të mbështesë këtë kalim apo zhvendosje. *Së dyti*, shoqëria e këtyre vendeve duhet të jetë e gatshme dhe e përgatitur që të pranojnë këtë ripërcaktim. *Së treti*, elitat e qytetërimit që vendi "në ndryshim" është duke u përpjekur t'i bashkohet, duhet të pranojnë vendimet e popullatës së tij.

Përfundime

Në procesin e globalizimit, feja ka shumë rëndësi. Gjithashtu, edhe vlerat që rrjedhin prej saj. Mënyrat se si do të kombinohen ato, do të përcaktojnë suksesin e së ardhmes dhe bashkëekzistencën paqësore të shoqërisë globale. Në të kundërt, bota do të për-

ballet me konflikte dhe dhunë**.**

"Fuqia e butë" është tashmë në vijën e parë. Ajo do të bëjë luftën, ajo do të bëjë edhe paqen. Koha e përplasjes së ushtrive të mëdha dhe e betejave mes tyre, duket se ka perënduar. Ndoshta qytetërimet mund të mos përplasen sikurse parashikonte *Huntington*. Sot, ato përfaqësohen më së shumti me kultura, të cilat janë të ndryshme përpara se të jenë të njëjta. Nuk është lloji i qytetërimit që të jep fuqi, por shkalla e kulturës për të lundruar në detin plot dallgë të globalizmit.

Bibliografi:

- Samuel Hutington, "Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit të ri botëror".
- Francis Fukuyama, "Fundi i historisë dhe njeriu i fundit"**.**
- Sen A, "Democracy as a Universal Value", Journal of Democracy 10 (3): 3–17. doi:10.1353/jod.1999.0055.
- Berman, Paul, "Terror and Liberalism", 2003.
- Said, Edward "The Clash of Ignorance", 2001,
- Brooks, David, "Huntington's Clash Revisited", New York Times, March 3, 2011.
- Redner, Harry, "Conserving Cultures: Technology, Globalization, and the Future of Local Cultures", 2004.
- "The International Herald Tribune," 24 December 2008.
- George Ritzer dhe Douglas Goodman, "Teoria Sociologjike".
- "The International Herald Tribune", 24 December 2008.
- Mohammad Khatami, "Dialogu ndërmjet qytetërimeve".
- http://en.wikipedia.org/wiki/Clash_of_civilizations
- Concise Routledge, Encycklopedia of Philosophy.

Siguria mjedisore në dokumentet strategjike të Shqipërisë

MSc. Enkeleida Sallaku

Trajtesë e shkurtuar. *Koncepti i sigurisë mjedisore rrjedh nga kuptimi i sektorializimit të termit siguri që mbulohet brenda fushës së marrëdhënieve ndërkombëtare. Koncepti i sigurisë mjedisore ka lindur nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare duke bërë një përditësim të urgjencës politike dhe duke sjellë vëmendjen e politikës në zgjidhjen e problemeve që lidhen me: sigurinë energjitike, sigurisë ushqimore, sigurisë së ujit dhe sigurisë së shëndetit.*

Studimi është bazuar mbi një meta-analizë të nocionit siguri mjedisore duke shqyrtuar më pas dokumentet bazë të shtetit shqiptar siç janë: Strategjia e Sigurisë Kombëtare (SSK), Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit, Strategjia e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI). Megjithëse siguria mjedisore është një nga dimensionet që po merr peshë kryesore në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, trajtimi i saj në dokumentet bazë strategjike mungon duke krijuar një vakuum në njohjen dhe më pas trajtimin e saj më prioritet.

Hyrje

Viti 1960 shënoi fillimin e shqetësimit të gjerë publik, mbi degradimin e mjedisit në vendet e zhvilluara të Perëndimit. Megjithatë, u desh pothuajse një dekadë, me propaganda të vazhdueshme politike mbi çështje të tilla si: pesticidet, centralet bërthamore, grumbullime të mbeturinave toksike, zhvillimet industriale në shkallë të madhe etj. Ndotja, para së ashtuquajturës "krizë mjedisore", u njoh zyrtarisht si një shqetësim lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Festimet para Ditës së Tokës, në vitin 1970, shfaqja dhe jehona e ligjeve të reja mjedisore në vendet perëndimore në fund të viteve 1960 dhe fillim të viteve 1970, zhvillimi i programeve ndërdisiplinore mjedisore, studimeve në institucionet e arsimit të lartë, si dhe Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin Njerëzor në Stokholm në vitin 1972, të gjitha këto u paraqitën si fillesa mjaft të rëndësishme të njohjes kombëtare dhe ndërkombëtare për problemet mjedisore.[1]

[1] Eckersley,1992

Problemi kompleks i ngrohjes globale jep një ilustrim krejt të ndryshëm të mënyrave sesi problemet mjedisore "reale" lidhen me njëra-tjetrën përmes lenteve të ndryshme teorike në disiplinën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare (MN). Në teorinë kryesore të MN, realistët heqin dorë nga trajtimi periferik i problemeve mjedisore, në lojën kryesore të politikës ndërkombëtare. Pasojat e problemeve mjedisore ato i mendojnë të lidhura drejtpërsëdrejti si kërcënime të sigurisë kombëtare të vendeve. Krejt ndryshe nga realistët, neoliberalet në epiqendër të teorive të tyre kanë metodat këshilluese për të krijuar struktura nxitëse në zgjidhjen e problemeve globale mjedisore, duke synuar në të njëjtën kohë dhe stimulimin e bashkëpunimit ndërshtetëror.[2]

Rritja në numër dhe madhësi e veprimeve dëmtuese të njeriut ndaj mjedisit, si dhe ndërgjegjësimi ndaj këtyre dëmtimeve, kanë gjeneruar shumë nga teoritë se përse problemet ndërkombëtare mjedisore janë të përhapura kudo dhe në rritje. [3] Shfrytëzimin e burimeve natyrore të Tokës e kemi shumë shekuj më parë, por ishte revolucioni industrial, ai që qe si një pikë kthese vendimtare, që çoi në ndryshime themelore në aktivitetet prodhuese dhe rezultoi në streset shumë më të mëdha në mjedisin natyror. Zgjerimet industriale kanë shkaktuar investime të shpejta, risi teknologjike, rritje të paparë të popullsisë dhe në shkallë të gjerë, kanë nxitur lëvizjen e njerëzve nga zonat rurale në ato urbane dhe nga qytetet e vogla në ato të mëdha.[4]

Viti 1960 është marrë si pikënisje për të shënuar lindjen e lëvizjes "moderne" të mjedisit, si një lëvizje e gjerë dhe e vazhdueshme sociale, e cila ka publikuar dhe kritikuar "efekte anësore" mjedisore, nga bumi i gjatë ekonomik i pas Luftës së Dytë Botërore. Rritja e shpejtë ekonomike, përhapja e teknologjive të reja, dhe popullsia në rritje në këtë periudhë, prodhuan energji në rritje dhe burime konsumi, burime të reja dhe rritje të nivelit të ndotjes dhe prodhimin e mbetjeve, si dhe një erozion të shpejtë të biodiversitetit të tokës[5]. Vlerësimi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin konsistoi se në mars 2005, rreth 60 për qind e shërbimeve të ekosistemit për jetesën në tokë janë duke u degraduar ose po përdoren në mënyrë të paqëndrueshme.[6]

Ndryshe nga kërcënimet ushtarake, të cilat janë të qëllimshme, diskrete, specifike dhe kërkojnë një përgjigje të menjëhershme, problemet mjedisore janë zakonisht të paqëllimshme, të përhapura, ndërkufitare, veprojnë në një hark kohor mjaft të gjatë, implikojnë një gamë të gjerë të aktorëve dhe kërkojnë negocim të përpiktë dhe bashkëpunim midis shumë aktorëve. Megjithatë, problemet e mjedisit nganjëherë përshkruhen si "probleme të këqija", për arsye të kompleksitetit të tyre, të ndryshueshmërisë, dhe karakterit të rastësishëm.[7]

Siguria mjedisore në dokumentet strategjikë të Shqipërisë

Nëse do të kryenim një analizë teorike mbi dokumentet bazë të shtetit shqiptar siç janë: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), Strategjia

[2] (Eckersley, Green Theory, 2006).
[3] Mitchell, 2002).
[4] Garner, 1996).
[5] (Eckersley, Green Theory, 2006).
[6] (UNEP, 2005).
[7] (Eckersley, Green Theory, 2006).

Ndërsektoriale e Mjedisit të Shqipërisë, Strategjia e Mbrojtjes së Shqipërisë për të nxjerrë trajtimin e konceptit të sigurisë mjedisore në Shqipëri, ajo që do të vërenim është mungesa jo vetëm e trajtimit të konceptit siguri mjedisore por edhe fakti që "siguria mjedisore" trajtohet vetëm në rastet e faktorëve të jashtëm kur kemi fatkeqësi natyrore. Në fakt, siguria mjedisore duhet të shikohet si element ose faktor i brendshëm pasi armiku nuk janë ata përtej kufijve por jemi vetë ne që e shkaktojmë këtë. Si rezultat, siguria mjedisore nuk është trajtuar saktë në dokumentet kryesorë shtetërorë, megjithëse siguria mjedisore është një komponent shumë i rëndësishëm për Shqipërinë dhe sigurinë e saj kombëtare. Strategjia energjitike e vendit është 90% e bazuar mbi burime natyrore dhe si e tillë, çdo kërcënim ndaj sigurisë mjedisore është kërcënim ndaj sigurisë energjitike dhe rrjedhimisht asaj kombëtare.

Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2007-2013

Gjatë rishikimit në dokumentet strategjikë të Shqipërisë është e rëndësishme të kuptojmë se edhe pse këto dokumente janë përditësuar dhe hartuar në funksion të integrimit të Shqipërisë drejt Bashkimit Europian, koncepti mbi sigurinë mjedisore është vështirë të kuptohet në rastin më të mirë dhe nuk është i përmendur fare, në rastin më të keq. Në rastin më të mirë flitet për një siguri të qëndrueshme ekonomike që përfshin dhe mjedisin por natyrisht kjo është jashtë natyrës së sigurisë mjedisore si përbërës i sigurisë kombëtare. Dokumenti kryesor i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave është Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2007-2013 dhe planet përkatëse për zbatimin e kësaj strategjie. Megjithëse SNM u hartua në vitin 2007 dhe është e integruar me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, trajtimi ndaj sigurisë mjedisore shikohet vetëm në kontekstin e "Dëmit Mjedisor". Pra, dëm mjedisor në fushën e nxjerrjes së mineraleve, ndotjes së kores së tokës, krijimi i pikave të nxehta mjedisore si pasojë e mbetjeve nga minierat dhe dampat e ndryshme.[8] Megjithëse, dokumenti është përgjithësisht pozitiv dhe mbulon një tematikë të gjerë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, në vend të parë të strategjisë qëndron prioriteti i qeverisë që është Integrimi në Bashkimin Evropian dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm në kontekstin ekonomik. Megjithëse strategjia parashikon dëmin nga erozioni, përmbytjet, prerja e pyjeve, shkatërrimi i faunës dhe biodiveristetit apo mbetjeve të rrezikshme ose jo, ndikimi i këtyre pasojave është siguria e individit ose pasiguria që i krijohet individit si pasojë e problematikës mjedisore. Askund në dokument nuk është trajtuar siguria mjedisore në këtë koncept të sigurisë.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2007-2013

Dokumenti bazë i qeverisë sonë që lidhet me vizionin dhe prioritetin e saj kundrejt së ardhmes është Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), i hartuar si nevojë e përshtatjes së objektivave dhe prioriteteve tona kundrejt zhvillimit ekonomik dhe integrimit euroatlantik mund të themi që, SKZHI është kolona kryesore pas kushtetutës së vendit. Në gjithë dokumentin mungon trajtimi i konceptit të sigurisë mjedisore, por trajtohet veçse në kontekstin e dëmit mjedisor dhe elementëve të lidhura me mjedisin si, mbetjet, cilësia e ajrit, pyjet, biodiversiteti, kanalizimet dhe erozioni. Askund nuk trajtohet se kush janë implikimet për sigurinë si pasojë e

[8] Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2007-2013, fq.31.

problematikës së mjedisit dhe kush janë planet dhe strategjitë e adresimit të impakteve të sigurisë mjedisore.

Strategjia e Sigurisë Kombëtare 2004

Analiza e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (2004) është në fakt një pikë referimi jo e dëshiruar duke qenë së Shqipëria fatkeqësisht operon me Strategjinë e vitit 2004. Tentativat për ripërditësimin e saj u iniciuan në 2008 dhe arritën deri në fazën e një draft strategjie por që nuk arriti të shkonte në Parlament dhe të miratohej. Në këtë kontekst po i referohemi shkurtimisht SSK (2004) në faqen 6 ku thuhet shprehimisht: "Vlerësimi i faktorit mjedisor në sigurinë e vendit. Mbrojtja dhe rigjenerimi i natyrës shqiptare do të sigurojnë një mjedis ekologjik e kushte të favorshme për jetesë për qytetarët dhe shoqërinë. Interesat kombëtare kërkojnë marrjen e masave për shfrytëzimin racional të burimeve të natyrës nëpërmjet zhvillimit të një strategjie të balancuar sektoriale për mbrojtjen e mjedisit natyror në interes të zhvillimit të qëndrueshëm të Shqipërisë."[9]

Për më tepër në kapitullin 16.4 thuhet se: "Mjedisi dhe burimet natyrore janë elemente të pashtershme të gjenerimit të instrumenteve të sigurisë".[10] Megjithëse SSK përcakton se burimet natyrore dhe mjedisi janë elementë të pashtershme të sigurisë në përbërjen e Këshillit të lartë të Sigurisë Kombëtare, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nuk bën pjesë. Paradoksalisht, në SKK e vendit tonë mungon komponenti kryesor që ka të bëjë më mirëqenien dhe sigurinë njerëzore siç është siguria mjedisore, kur kjo e fundit është një nga sfidat dhe dimensionet kryesore të sigurisë.

Domosdoshmëria e trajtimit të sigurisë mjedisore

Nëse njerëzimi neglizhon me sjelljen dhe menaxhimin e tij gjithë ekosistemin natyror që i nevojitet për të siguruar ujin e mjaftueshëm, ushqimin e mjaftueshëm ajrin e pastër dhe ilaçet e duhura brezat e sotëm dhe të ardhshëm do të ballafaqohen gjithnjë e më shumë me rastet e rënda të ndryshimeve mjedisore. Këto ngjarje dhe ndryshime do të testojnë konceptet tona tradicionale të sigurisë kombëtare, të kufijve dhe të kuptuarit të politikës dhe aleancave tona të tanishme. Këto do të çojnë në konflikte duke përfshirë konfliktet e dhunshme përtej rrafshit lokal rajonal apo kombëtar dhe ndërkombëtare derisa mund të shkojnë në rrafshin njerëzor dhe individual. Prandaj, siguria mjedisore ndikon në jetën tonë dhe jetën e institucioneve tona në çdo kohë dhe kurdo.

Pikërisht për këtë arsye, Siguria Mjedisore shtrihet jashtë çdo qëllimi të diplomacisë apo marrëdhënieve ndërkombëtare. Ajo paraqitet si një ndryshim i madh i konceptit tradicional të shtetit-komb që është themeluar 400 vite më parë. Dukë qenë se të gjithë janë të prekur nga kërcënimet mjedisore dhe përgjigja është globale, prandaj kur flitet për siguri mjedisore kemi të bëjmë me siguri kolektive[11] dhe jo me siguri shtetërore apo individuale të shteteve.

[9] Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë 2004, fq.6.
[10] Po aty.
[11] Ribaj.P. Siguria bashkëpunuese,sistem modern drejt përsosjes, Akademia e Mbrojtjes, Tiranë,2004,f.8-11.

Nëse do të citonim ish-Ambasadorin Britanik *Sir Crispin Tickell* në Organizatën e Kombeve e Bashkuara kur tha: "Asnjë burrë nuk është një ishull, asnjë ishull nuk është një ishull, asnjë kontinent nuk është një ishull", do të vëmë re se shtetet mendojnë në kontekstin e gjeopolitikës ose më saktë në kontekstin e ishullit- ishullit ekonomik, politik dhe mjedisor.

Natyrshëm lind pyetja për qeveritë se çfarë rruge duhet të ndjekin për ta plotësuar këtë sfidë. Si fillim është njohja dhe pranimi i problemit si një kategori e veçantë nga ajo që njihet deri tani. Këto shkojnë përtej diplomacisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Deri tani, shtetet individuale janë imune ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve strategjike ushtarake siç mund të jenë silurët apo raketat, por ajo që është e sigurt ngelet fakti se nuk mund të lëshosh një raketë për të zgjidhur problemin e klimës, ngrohjes globale, rritjes së nivelit të deteve, përmbytjeve, erozionit dhe shpyllëzimit.

Edukimi mjedisor, metodë e re, efektivitet dhe kënaqësi

Edukimi mjedisor ka një histori 30-vjeçare dhe objektivi i tij fillestar ka qenë kontributi për mbajtjen e një mjedisi të shëndetshëm, duke u mësuar njerëzve, se si t'i përdorin njohuritë e tyre për mbrojtjen dhe përmirësimin e natyrës me sa më pak pengesa të niveleve të ndryshme, si dhe duke drejtuar shkencërisht shkaqet sociale, ekonomike dhe kulturore të degradimit mjedisor. Për shkak të përdorimit të teknologjive e praktikave të vjetruara dhe ndotëse në prodhimin e ushqimeve, energjisë dhe të mirave të tjera materiale, ne kemi nevojë të ndryshojmë rrugët, që shkaktojnë degradimin e mjedisit. Për të bërë këtë në mënyrë efektive, nevojitet më tepër se kurrë pjesëmarrja dhe vullneti i mirë i shoqërisë dhe individëve, të cilët nga ana e tyre kanë nevojë për ndërgjegjësim dhe edukimin, që në vitet e para të jetës. Pra, është nevoja për mekanizma, mjete dhe mënyra për të edukuar njerëzit. Sa më i madh të jetë angazhimi, aq më i shumtë është edhe informacioni, që ruhet dhe përçohet brenda komunitetit. Edukimi mjedisor, si pjesë e edukimit të përgjithshëm, duhet të jetë stimulues dhe dëfrye.

Më shumë vlerësim për sigurinë njerëzore

Elementë të sigurisë njerëzore, përbërës kryesor i së cilës është dhe siguria mjedisore, ndeshen dhe në dokumentet ekzistuese. Por çështja është se si mund të orientohen dhe të theksohen më mirë këto elementë, duke i dhënë dhe frymën vetëpërmbajtjes së dokumentit, apo si mund të "operacionalizohet" në mënyrë konkrete axhenda për sigurinë njerëzore (ndryshe nga siguria shtetërore që perceptohet shumë më thjesht, të paktën në variantin tradicional).

Pavarësisht, nga rezultati i vështirë i këtij operacionalizimi, siguria njerëzore mbetet të sfidojë në një mënyrë apo tjetrën konceptin tradicional të sigurisë kombëtare, duke u bërë paralelisht dhe pjesë përbërëse e sigurisë ndërkombëtare. Dhe në këtë kuptim krahas mekanizmave institucionalë kombëtarë e ndërkombëtarë, ku përfaqësimet janë shtetërore, një rol në rritje duhet të marrin aktorë të tjerë, si NGO-të, media, etj., sidomos ata me shtrirje tejshtetërore e tejkombëtare. Po ashtu, ky koncept i sigurisë njerëzore, i shtrirë në një nivel rajonal e ndërkombëtar, duhet të përmbajë kontributin tonë modest dhe në fusha të tjera si në ndërhyrjet humanitare,

kontrollin e armëve, eliminimin e minave kundër njeriut, reagimin ndaj abuzimit nga jashtë të mjedisit, shfrytëzimit të padrejtë të fuqisë punëtore, abuzimit me fëmijët, reduktimin e ndarjes teknologjike, që ka zëvendësuar atë ideologjike, etj. Nuk mund të mohohet se nëpërmjet një përpunimi të drejtë në nivel vendor, rajonal e global të sigurisë njerëzore mund të bëhet më e suksesshme lufta kundër trafiqeve të ndryshme, krimit ekonomik e terrorizmit, por dhe të rriten kontributet vendore kundër ngrohjes globale, për shfrytëzimin me nikoqirllëk të rezervave energjetike, ujore, etj.

Prandaj, krahas problematikës mbi theksimin e aspiratave njerëzore për liritë dhe të drejtat e njeriut[12], konsolidimin e infrastrukturës institucionale demokratike, kontrollin dhe kufizimin demokratik të pushtetit ekzekutiv, zgjerimin e peshës specifike të shoqërisë civile dhe të pjesëmarrjes qytetare, rritjen e rolit të konsumatorit dhe të përkujdesjes ndaj tij, etj., mendojmë se po aq thelbësor është për dokumentin e strategjisë dhe ridimensionimi i vetë konceptit të sovranitetit, "dobësimi" apo reduktimi, nga pikëpamja teorike e praktike, i mjaft përbërëseve të tij, në favor të rritjes së përbërëseve të ndërvarësisë[13].

Krijimi i një konsensusi për rreziqet ekologjike

Kur autorë elitarë si *Charl Kegley* [14] shtrojnë pyetjen se cili është kërcënimi më i madh botëror, përgjigjet e mundshme janë të shumta [15].

Sfidat botërore të mjedisit dhe studimi i reagimeve për to është quajtur ekopolitikë, bashkimi i rastësishëm mes ekologjisë dhe politikave. Ekologjia ka të bëjë me lidhjen mes njerëzve dhe organizmave të tjera të gjalla dhe kushteve të mjedisit. Politika ka lidhje me ushtrimin e pushtetit. Ekopolitika, si pasojë, heton se si aktorët politikë bëjnë zgjidhje për të menaxhuar impaktin e dëmshëm të sjelljes njerëzore në mjedisin në të cilin të gjithë njerëzit e Tokës jetojnë [16].

Përfshirja e çështjeve ekologjike botërore

Siguria mjedisore është një koncept i dobishëm që zgjeron përkufizimin kombëtar të sigurisë duke shtyrë vizionet përtej kufijve dhe mbrojtjes së tyre. Ajo fokusohet në

[12] Mejdani, Rexhep, cituar nga Konferenca Ndërkombëtare mbi Zhvillimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, mbajtur më 21 shtator 2007, organizuar nga Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, BOTIMET TOENA Tiranë, 2007

[13] Për më tepër, në këtë rishikim, krahas kësaj ndërvarësie të kuptueshme, në rritje në të gjitha fushat, duhen analizuar e përfshirë, të paktën si "frymë", edhe disa koncepte të tjera. Ndoshta duhen mishëruar në tekstin e dokumentit të strategjisë koncepte të tillë janë si p. sh.: koncepti i sistemit të hapur, relativiteti i hapësirë-kohës, binomi ndërvarësi-sovranitet, pakthyeshmëria e proceseve makroskopike,etj. Përfshirja e tyre veçse e pasuron përmbajtjen e këtyre dokumenteve, duke krijuar terrenin e duhur për rishikime më cilësore në një të ardhme të afërt.

[14] Charl. W, Kugley,JR(World Politics Trend and Transormation) Politikat Botërore Tendencat dhe Transformimi, UFO University Press, Tiranë, 2009, f.346-349.

[15] Ju,-shkruan Kegley,- mund t'i përgjigjeshit ndryshe nëse do të ishit banues në Bagdad e ndryshe nëse do të banonit në Pekin, në Bombei, Boston apo Buenos Aires, nëse ju jini mashkull apo femër etj.

[16] Toka siguron mjaftueshëm për të kënaqur nevojat e çdo njeriu, por jo lakminë e çdo njeriu,- thotë Mohandar Gandhi, aktivist indian i paqes.

karakterin ndërkufitar të sfidave për ruajtjen e mjedisit botëror, duke pranuar se kërcënimet nga fenomene të tilla si ngrohja globale, shterimi i ozonit dhe humbja e pyjeve tropikale dhe habitateve ujore, mund të kërcënojnë të ardhmen e njerëzimit po aq sa kërcënimi për luftë me armë të shkatërrimit në masë. Mbi të gjitha burimet e kërcënimeve ekologjike janë të pranishme për bashkësinë globale. Keni vënë re ndonjëherë se njerëzit kudo, janë shumë të ngjashëm? E vërteta është se njerëzit dhe grupet sillen shumë ndryshëm. Megjithëse, duket se janë disa vlera që çdokush ushqen dhe që e bëjnë atë esencialisht të ngjashëm. Këto vlera janë universale, të mbrojtura në hapësirë dhe kohë. Nuk ka rëndësi se cila është feja, nacionaliteti, gjuha, vendi apo ngjyra e lëkurës, kush dëshiron të thithë ajër të pastër? Kush dëshiron të jetojë me të drejtën për ujë të freskët dhe të pastër? Kush dëshiron të ketë furnizim me ushqime të përshtatshme? Kush dëshiron të jetojë aty ku natyra ka siguruar një peizazh të bukur? Kush dëshiron të provojë gëzimin e një klime të përshtatshme për një habitat njerëzor? Çdokush!

Në të njëjtën linjë për kërcënimet mjedisore vijon analizën dhe autori i njohur *Rebert Kapllan* në veprën e tij "Anarkia që po na troket"[17]. Ka ardhur koha të kuptojmë mjedisin për atë që është në të vërtetë: çështje e sigurisë kombëtare e fillim shekullit XXI. Pasojat politike dhe strategjike të popullsive në rritje, përhapjes së sëmundjeve, shpyllëzimit dhe erozionit të dheut, mungesës së ujit, ndotjes së ajrit etj do të jenë sfida kryesore e politikës së jashtme prej së cilës do të rrjedhin shumë sfida të tjera. Këto do të rrëmbejnë interesin publik dhe do të bashkojnë grupe interesi të shpërndara dhe të lëna pas dore që nga mbarimi i Luftës së Ftohtë.

Homer-Dikson [18] ka integruar me më shumë sukses se analistët e tjerë dy fusha që paramendoheshin të ndara: studimet e konfliktit ushtarak me studimet e mjedisit fizik. Për një kohë tepër të gjatë ne kemi qenë të burgosurit e një teorie 'social-sociale', -shkruan autori,- e cila presupozon se ka vetëm shkaqe sociale për ndryshimet sociale e politike dhe nuk ka shkaqe natyrore. Kjo mendësi "social-sociale" lindi së bashku me Revolucionin Industrial, i cili na ndau nga natyra. Por natyra po kthehet hakmarrëse dhe e lidhur me rritjen e popullsisë. Kjo do të ketë pasoja të pabesueshme të lidhura me sigurinë.

Po hyjmë në një botë të dyzuar [19]. Një pjesë e rruzullit është e banuar nga *Njeriu i Fundit i Hegelit* dhe i *Fukuyamas*, i shëndetshëm, i mirëushqyer dhe i llastuar nga teknologjia. Pjesa tjetër, që është më e madhe, është e banuar nga *Njeriu i Parë i Hobbes*-it, i dënuar të jetojë një jetë që është "e varfër, e poshtër, e pistë dhe e

[17] Kaplan, Robert, (The Coming Anarchy) Anarkia që po na troket, Biblioteka e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Historia, Tiranë, 2008 f. 38-39.

[18] Artikulli i publikuar në vjeshtë të vitit 1991 nga Thomas Fraser Homer-Dikson, Drejtor i Programit të Studimeve të Paqes dhe të Konfliktit të Universitetit të Torontos, titullohej " Në prag: Ndryshimet e mjedisit si shkaqe të një konflikti të mprehtë**",** marrë nga Kaplan, Robert, vep. e cituar.

[19] Mendoni për një limuzinë të madhe në rrugët me gropa të New York City, ku jetojnë të pastrehët dhe lypsarët. Brenda në limuzinë me ajër të kondicionuar, vijon ai, janë rajonet post-industriale të Amerikës së Veriut, Evropës, Bregut të Paqësorit në rritje dhe disa vende të tjera të izoluara, së bashku me samitet e tyre të tregtisë dhe autostradat e informacionit kompjuterik. Jashtë saj është pjesa tjetër e njerëzimit që ecën në një drejtim të kundërt**.** Marrë nga Kaplan, Robert, vep. e cituar, f. 40

shkurtër". Megjithëse të dyja pjesët do të kërcënohen nga trysnia mjedisore, Njeriu i Fundit do ta ketë atë nën kontroll, ndërsa Njeriu i Parë jo. [20]

Përfundime

Fillimisht, termi "siguri" në marrëdhëniet ndërkombëtare barazohej shpesh me aspektin ushtarak. Në këtë kohë marrin vlerë skemat dhe strategjitë ushtarake, të cilat duhet të mbrojnë shtetin nga një rrezik i jashtëm. Por me ndryshimin e realitetit ndërkombëtar pas Luftës së Ftohtë, nëpërmjet zhvillimeve të tilla si globalizmi dhe regjionalizimi, objekti "shtet" e humb kuptimin e mëparshëm ku përgjegjësia e tij kryesore ishte siguria e jashtme. Termi "siguri" bëhet më i përgjithshëm dhe zgjerohet në fusha të ndryshme të jetës.

Koncepti i sigurisë mjedisore ka evoluar dhe është maturuar në shumë hapa dhe periudha me prakticienët dhe kritikët e saj. Duke filluar nga frika për militarizimin e konflikteve mjedisore si pasojë e pamjaftueshmërisë së burimeve të përcjella nga Homer Dixon dhe rritja e popullsisë dhe migracioni mjedisor si pasojë e problemeve të hasura në vendet e Afrikës të paraqitura nga Norman Myers, koncepti i sigurisë mjedisore ka përfituar tashmë nga shumë vite punë kërkimore. Si rezultat frika e "një luftë apo konflikti në shkallë të gjerë për burimet e rinovueshme është eliminuar tashmë.

Studimi i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe mjedisit është sjellja për të përmirësuar menaxhimin global mjedisor. Studiuesit kanë gjeneruar teoritë dhe rastet që demonstronin pse problemet globale mjedisore janë aq të zakonshme, të tilla si, se si ata bëjnë pjesë në axhendën ndërkombëtare, pse shtetet formojnë regjime për disa, e për të tjerët jo, çfarë faktorë lehtësojnë efikasitetin e regjimit, etj[21].

Disa dijetarë të sigurisë ekologjike thonë se problemet mjedisore (të tilla si, ngrohja globale) duhet të konsiderohen si një burim në rritje i pasigurisë. Madje, disa të tjerë argumentojnë gjithashtu se rritja e mungesës së burimeve natyrore për shkak të problemeve mjedisore të tilla si, veçanërisht ujit, degradimi i mjedisit, dhe numrat në rritje të refugjatëve ekologjike, mund të gjenerojnë konflikt dhe dhunë në rritje me dy dhe mes shteteve, dhe se shtetet duhet të përfshijnë një strategji ekologjike në strategjitë e tyre të sigurisë kombëtare[22].

Së fundi, teoria e gjelbër nëpërmjet zhvillimit të rëndësishëm që ka marrë gjatë dekadave të fundit, ka krijuar një dimension të ri, një dimension global. Kjo teori ka ndryshuar rolet e aktorëve shtetërorë, ekonomikë, duke përcaktuar nivelet e përgjegjësive mjedisore. Ky rimodelim ka implikime të rëndësishme për evoluimin e sovranitetit shtetëror, duke i karakterizuar shtetet si shtete transnacionale, në vend të thjesht komb-shteteve apo qytetarët kombëtare. Por, natyrisht, shoqëria e shteteve është një rrugë e gjatë për të arritur këtë ideal. Megjithatë, teoricienët e gjelbër e

[20] Gjithsesi këto rreziqe, bile dhe terrorizmi, sipas Bjorm Lomberg, Drejtor i Qendrës së Konsesusit, qendër që analizon sfidat më të mëdha botërore dhe identifikon zgjidhjet efektive, nuk janë rreziqet e kërcënimet kryesore.
[21] (Mitchell, 2002).
[22] (Eckersley, Green Theory, 2006).

kanë sjellë tashmë këtë ideal, duke e bërë atë të mendueshme. Këto e problematika të tjera mjedisore kërkojnë vlerësimin e hapësirën e duhur në dokumentet kryesore strategjike, që si dokumente kombëtare orientojnë e formësojnë zhvillimin e sigurinë.

Bibliografia:

- Eckersley, Green Theory, 2006.
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë 2004.
- Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2007-2013.
- Charl. W, Kugley,JR (Wurd Politics Trend and Transormation) Politikat Botërore Tendencat dhe Transformimi, UFO University Press, Tiranë, 2009.
- Paterson, 1996; "Theories of International Relations, Third Edition.
- Detlef Sprinz & Urs Luterbacher, 1996; "International Relations and Global Climate".
- Kaplan, Robert, (The Coming Anarchy) Anarkia që po na troket, Biblioteka e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Historia, Tiranë, 2008.
- Mejdani, Rexhep, cituar nga Konferenca Ndërkombëtare mbi Zhvillimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, mbajtur më 21 shtator 2007.
- Timoteut Doyle & Doug McEachern, 2008; "Environment and Politics".
- Wapner, Etika e Mjedisit dhe Qeverisja Globale: Angazhimi i Traditës Internacionaliste Liberale, 1997.
- Eckersley, Environemtalizmi dhe Teoria Politike : Drejt një qasje Ekocentrike, 1992.
- Ribaj. P. Siguria bashkëpunuese, sistem modern drejt përsosjes, Akademia e Mbrojtjes, Tiranë, 2004.
- Eckersley, 1992; "Green political theory".
- Robert Garner, 1996; "Introduction to Politics".
- UNEP, 2005; "United Nation Economic Programme".

RUBRIKA E TRETË

Studime Historike

Në shkrimet e kësaj rubrike, një rëndësi e veçantë i është kushtuar historikut të Forcave tona të Armatosura, kryesisht pas Luftës së Dyte Botërore e deri në hyrjen e saj në NATO.

Kolonel Ahmet Leka, në shkrimin e tij "Strategjia dhe mendimi ushtarak shqiptar në periudhën e Luftës së Ftohtë", bën një analizë të elementeve kryesore të FA-së, duke nxjerrë në pah arritjet në organizimin, modernizimin e zhvillimin e konceptit doktrinar të FA të Shqipërisë, pas Luftës II Botërore deri në vitet 1990. Përshkrimi që ai iu bën këtyre elementeve, jep një tablo të qartë të etapave të zhvillimit të konceptit ushtarak të Forcave tona të Armatosura.

Nënkolonel Leonard Çoku, sjell në këtë rubrikë një pasqyrë të transformimit të Forcave tona të Armatosura në rrugën e anëtarësimit në NATO. Duke na dhënë një rrjedhë historike të zhvillimit të ushtrisë sonë, nga antikiteti e deri sot, ai trajton traditën e ushtrisë sonë, transformimin, përparësitë dhe problemet e angazhimit në NATO, veçanërisht sfidat e angazhimet deri në anëtarësimin e plotë në Aleancën Euroatlantike.

Në këtë rubrikë, Kolonel (R) Mikado Shakohoxha tek "Operacioni Gjerman i Dimrit në Luginën e Shushicës" trajton zhvillimin e operacionit në zonën e Shushicës, duke vlerësuar rolin heroik të banorëve të kësaj zone gjatë operacionit. Ai përshkruan guximin e trimëritë që e kanë karakterizuar popullin e Luginës së Shushicës në këtë luftë.

Në shkrimin "Roli i Kinës dhe Iranit në zhvillimin e Afganistanit" që trajtohet në këtë rubrikë, Kolonel Dritan Demiraj jep të dhëna e detaje për rolin e interesat e Kinës dhe Iranit në Afganistan. Këtu autori na njeh me projektet e vazhdimësisë së Iranit në Afganistan dhe ato të Kinës në Pakistan e anasjelltas, duke vënë theksin tek interesat ekonomike të tyre si më kryesore.

Strategjia dhe Mendimi Ushtarak Shqiptar në periudhën e Luftës së Ftohtë

Kolonel Ahmet Leka
Shef i Qendrës së Doktrinës, KDS

MSc. Evis Sadikaj

Trajtesë e shkurtuar. *Shkrimi i mëposhtëm trajton çështje të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin dhe modernizimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura Shqiptare si dhe strategjinë dhe doktrinën e tyre ushtarake, pas Luftës së 2-të Botërore, kryesisht në periudhën e Luftës së Ftohtë. Me anën e këtij shkrimi synohet që, nëpërmjet analizës përgjithësuese të elementëve kryesorë përbërës të FA, të argumentohen arritjet në organizimin, modernizimin dhe sidomos në zhvillimin e konceptit doktrinar e strategjik të Forcave te Armatosura Shqiptare, gjatë viteve 1945-1990.*

Vitet 1961-1975 shënuan fazën e zhvillimit dhe përsosjes të ndërtimit të FA dhe strategjisë ushtarake të tyre. Në këtë periudhë, detyra themelore ishte zhvillimi e modernizimi i mëtejshëm i Forcave të Armatosura, nëpërmjet organizimit dhe formësimit të tyre me "karakterin popullor", dhe sidomos thellimit e zhvillimit të mendimit teorik doktrinar shqiptar. Prishja me Bashkimin Sovjetik, dalja nga Traktati i Varshavës detyroi udhëheqjen komuniste të kohës të përdorë parullën e famshme që do të shërbente si parimi themelor në ekonomi dhe si rrjedhojë edhe në ushtri "mbështetjen tërësisht në forcat e veta". Tipar dallues i kësaj periudhe ishte jo vetëm shtrirja dhe plotësimi i të gjitha strukturave të Forcave të Armatosura me forca rezerviste, por veçanërisht stërvitja e kompaktësimi i efektivave, duke mundësuar rritjen e dukshme numerike të tyre.

Gjendja e re e krijuar pas daljes nga Traktati i Varshavës, shtroi si detyrë themelore, domosdoshmërinë e një mbrojtjeje të fuqishme e më të sigurtë të drejtimeve kryesore operative e operativo-strategjike, sidomos në zonat veriore, verilindore e bregdetare. Për këtë qëllim, u forcua ndërtimi organizativ ekzistues, u bë rishikimi dhe ristrukturimi tërësor i FA, sidomos në zona të mundshme desantimi ajror që bazoheshin kryesisht në forca efektive, në vitet 1960, 1966, 1972 deri 1975. Në Konceptin Strategjik u bë riorganizimi, u ngritën repartet të gatshme, u bë afrimi i njësive pranë

detyrave luftarake, u krijua brezi i sigurimit i cili deri në vitin 1981 varej nga Korpusi dhe më vonë do të shërbente si Skalion i Parë i BrK.

Zhvillimi i FA dhe strategjisë ushtarake të tyre në vitet 1961-1975

Divergjencat politike midis PPSH dhe PKBS që u shprehën në Konferencën e 81 partive në nëntor të vitit 1960 në Moskë, sollën krisjen e parë dhe të madhe midis vendit tonë dhe BS dhe rrjedhimisht dhe me Traktatin e Varshavës. Në këtë periudhë kohore, ideologët e partisë-shtet filluan të përpunojnë një strategji të re ideologjike, politike dhe ushtarake, e cila përfshiu të gjitha nivelet partiake dhe shtetërore, për t'u përshtatur me situatën e re të krijuar, gjë e cila përfshiu fuqishëm Forcat e Armatosura Shqiptare si çdo qelizë tjetër të vendit tonë.

Forcat e Armatosura filluan të mendojnë për një koncept të ri të mbrojtjes së tërësisë territoriale të vendit me ato burime që aktualisht dispononinin. Pra, mund të themi se këtu e ka fillesën ose origjinën edhe platforma strategjike e mëvonshme për ushtrinë.

Ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike me Bashkimin Sovjetik dhe më vonë, shkëputja nga Traktati i Varshavës (1963), sipas analizave të udhëheqjes politike, do të sillte edhe rritjen e kërcënimeve e rreziqeve në aspektin e brendshëm por, me shumë gjasa, edhe të atyre që vinin nga armiqtë e jashtëm.

Situata tepër e ndërlikuar në aspektin gjeopolitik, e ndërthurur me ndarjen në blloqe për problemet e brendshme të rajonit të Ballkanit, por edhe me konsideratat për pozicionin gjeostrategjik të vendit, ishte shumë komplekse. Në këtë rajon kishim dy shtete (Greqia dhe Turqia) anëtare të NATO-s, Bullgarinë dhe Rumaninë, por edhe Hungarinë më në veri, anëtare të Traktatit të Varshavës, ndërsa Jugosllavia megjithë udhëheqjen komuniste valëviste flamurin e vendit të paangazhuar, ndërkohë që Shqipëria ishte fanari i vetëm ndriçues i "Marksizëm-Leninizmit".

"Rreziku" mund të vinte nga shtetet fqinjë, edhe pa marrë pëlqimin e "blloqeve", duke filluar agresionin me forcat e gatshme të dislokuara në afërsi të kufijve shtetërorë, me forca më të mëdha të sjella nga thellësia, me pretekstin e stërvitjeve, ose me sulmin masiv të forcave desantuese. Preteksti për fillimin e sulmit të armatosur apo agresionit, sipas udhëheqjes, mund të ishte i ndryshëm, p.sh., Blloku i lindjes mund të pretendonte të mënjanonte rrezikun "perëndimor" ndaj Shqipërisë, apo për të përballuar rrezikun që e kërcënonte atë nga Flota e gjashtë Amerikane apo NATO-ja. Në të kundërt, NATO, ashtu sikurse dhe shtetet e saj si Italia e Greqia mund të shfrytëzonin pretekstin për "mundësinë" e daljes së "lindorëve" në brigjet e Adriatikut dhe në kufi të tyre, ashtu sikurse Greqia mund të shfrytëzonte si pretekst edhe të ashtuquajturën çështje të Vorio Epirit, etj.[1]

Sipas shumë deklarimeve të bëra nga "udhëheqja", të dy blloqet kryesore ushtarake, dëshironin pushtimin e menjëhershëm të Republikës Popullore të Shqipërisë, sepse eliminimi i saj, pra "kështjellës shqiptare", do të sillte daljen në Adriatik e Mesdhe ose e kundërta daljen në zemër të Ballkanit, duke e përdorur kështu vendin tonë si një bazë të rëndësishme strategjike. Mënyrat kryesore të fillimit të agresionit mund

[1] AQU, F. 100/5, D.21, viti 1974.

të ishin të befasishme dhe, në rastin më të mirë, pas një periudhe të shkurtër kërcënuese apo "propagande anti shqiptare" ose më vonë "anti Marksiste-Leniniste".

Qenia e vendit, anëtar i Traktatit të Varshavës, nënkuptonte që në këtë periudhë

mbrojtja e vendit të ishte e lidhur edhe me detyrimet që ishin në kuadër të këtij anëtarësimi, por me daljen e njëanshme dhe, lidhur me situatën e re, kushtet gjeopolitike të rajonit shtronin detyrën e përpunimit dhe zbatimit të një koncepti dhe mendimi strategjik për mbrojtjen e vendit. Përpunimi i këtij koncepti do të mbështetej kryesisht në përvojën e vendit të fituar edhe në stërvitjet e mëdha ushtarake, të realizuara deri në atë kohë. Në vitin 1967, u hodhën "tezat" e Artit Ushtarak Popullor të RPSH, çka përbënin dhe bazën e veprimtarive operacionale të këtyre forcave ushtarake. Këto teza, me kalimin e viteve, u ripunuan dhe u përsosën më tej, deri në publikimin e Artit Ushtarak të Luftës Popullore në vitin 1975.

Për të përballuar me sukses dhe për të thyer agresionin e befasishëm të armiqve si dhe për të siguruar hapjen e strukturave me organikat e kohës së luftës, rol të veçantë do të luante brezi i sigurimit, i cili do të hapte për luftë jo vetëm skalionin e parë por edhe skalionin e dytë të Divizionit të Këmbësorisë së kundërshtarit, si edhe repartet e gatshme të Artilerisë Tokësore, Artilerisë Kundërajrore, etj. Mbrojtja e vendit konceptohej mbi baza të pozicionalitetit dhe aktivitetit të saj me zjarrin e të gjitha llojeve të armëve, të kombinuara me pengesat e ndryshme xheniere, me kundërsulme e kundërgoditje vendimtare.

Mbrojtja e vendit, sikurse theksohej në "Artin Ushtarak", planëzohej dhe kryhej duke u mbështetur "plotësisht në forcat tona"; ajo do të realizohej në kushtet e izolimit të plotë, po kështu "fitorja përfundimtare në fushë-betejë, mund të arrihej edhe nga një ushtri e vogël, cila luftonte kundër një ushtrie të madhe, mbështetur në luftën popullore nën udhëheqjen e partisë", etj[2]. Mbështetur në këto teza u bënë shumë ndryshime në aspektin organizativ dhe strukturor, duke rikrijuar korpuset, duke fuqizuar forcat në brezin e sigurimit dhe realizuar përhapjen strategjike të njësive dhe reparteve kryesore sa më afër detyrave luftarake, duke shtuar në numër dhe fuqizuar së tepërmi strukturat rezerviste, krijimi, organizimi dhe rritja në numër e strukturave të Forcave Vullnetare të Vetëmbrojtjes Popullore (FVVP), Rinisë Shkollore e Studentore. Në të gjitha shkollat e mesme dhe të larta të vendit u vendos si lëndë e detyrueshme në programe Përgatitja Ushtarake.

Në krahasim me vitet '60, masat e marra dhe organizimi i forcave në këtë format bën që të ndryshojnë e të rriten tej mase të gjitha strukturat, si dhe të ndryshohen të gjitha raportet. Kështu në fund të viteve'70 numri i ushtrisë ishte rritur gati 3.8-4.3 herë. Forcat e kohës së luftës ishin rritur 8.5-9.5 herë më shumë se forcat e kohës së paqes. Njësitë e nivelit operativ u rritën me më shumë se 6 herë; njësitë e nivelit taktik gjitharmëshe u rritën me mbi 5 herë; njësitë tankiste u rritën me më shumë se 7 herë; njësitë e artilerisë tokësore u rritën me gati 8 herë; repartet e AKA u rritën me 4 herë; aviacioni dhe helikopterët u shtuan më shumë se 3 herë; repartet xheniere u shtuan

[2] AQU, F. 100/1, D.86, viti 1968.
[3] AQU, F.100/4, D.29, viti 1970.

së tepërmi, deri në 10 herë; repartet të vijës së parë ato artmitraliere u shtuan gati 3 herë, FVVP u rritën me më shumë se dyfishin, etj[3].

Mbrojtja e vendit u realizua duke i dhënë thellësi asaj, duke bërë fortifikimin masiv të të gjithë rajoneve, sidomos drejtimeve strategjike dhe operative, ndërtimit të brezave të mbrojtjes, si dhe pozicioneve dhe QZ për këmbësorinë e artilerinë, rreth 200.000 të tilla, tunelizimin e bazave të Flotës, Aviacionit, vendkomandave, depove, industrisë ushtarake, ndërlidhjes telefonike nëntokësore, strehimeve për popullsinë etj., masa të cilat do të sillnin rritjen e qëndrueshmërisë së saj që si rrjedhojë logjike do të kishin marrjen e nismës dhe kalimin në kundërmësymjen e përgjithshme. Kundërmësymja në nivel strategjik, sikurse u theksua më sipër, u konceptua si rrjedhojë e marrjes së nismës në shkallë operative, nëpërmjet arritjes së ekuilibrit të forcave në shkallë operative-strategjike, sipas drejtimeve të përcaktuara. Kundërmësymja parashikohej të realizohej përsëri sipas këtyre drejtimeve strategjike, duke u nisur nga brezi i dytë ose në hapësirën midis brezit të dytë ose të tretë, në një thellësi 30-40 km, brenda territorit.

Rëndësi e madhe në konceptimin e mbrojtjes së vendit, sidomos për realizimin me sukses të operacioneve kundër desantit ajror dhe për realizimin e operacioneve të mbrojtjes dhe kundërmësymjes (mësymjes), iu dha mbajtjes dhe fuqizimit të rezervave të Komandës së Përgjithshme, si dhe krijimit e skalionimit të rezervave të prapavijës ku përfshiheshin rezervat në ushqime, karburant, pjesë këmbimi, armatim e municione, etj, të cilat do të ishin më vete dhe do të mbaheshim krahas rezervave shtetërore. Trajtimi i luftës së gjatë gjeti pasqyrim si *Koncept Strategjik*, e lidhur me sigurimin e prapavijave dhe të qëndrueshmërisë politike dhe ekonomike, me krijimin e rezervave si për popullsinë, ashtu edhe për repartet e skalionimin e tyre.

Krijimi i Rezervës së Komandës së Përgjithshme, në pikëpamje strategjike, përbën një element shumë të rëndësishëm. RKP përbëhej kryesisht nga brigadat e këmbësorisë, tanket, artileria tokësore, AKA, njësitë sulmuese, etj. Nëse do të përmendim disa shifra, në rezervat e Komandës së Përgjithshme do të kishim mbi 50% të njësive tankiste, mbi 67% të njësive të artilerisë tokësore, rreth 70% të reparteve xheniere, ndërkohë që këmbësoria ishte në një masë më të vogël, rreth 18%, etj.[4] Skalionimi i rezervave ishte parashikuar në nivele të ndryshme dhe për forca të ndryshme, kështu do të kishim, për njësitë e skalionit të parë, rezerva të cilat ishin parashikuar për 15 ditë luftime, në nivelet e divizioneve për 25 ditë, kurse sipas drejtimeve dhe rajoneve, parashikohej që forcat të kryenin veprime luftarake edhe në rrethim, për një periudhë 3-6 muaj. Planëzimi kryhej që në kohë paqeje, në një mënyrë tepër të hollësishme, duke u shtrirë në të gjitha nivelet. Ai kryhej në disa kurse veprimi, apo disa drejtime të goditjes kryesore si dhe me pjesëmarrjen dhe përdorimin edhe të Aviacionit e të FVVP.

Të gjitha strukturat shtetërore duhej të merrnin masa për mbrojtjen e "atdheut socialist" e cila konsiderohej "detyrë mbi detyrat". Organet e pushtetit popullor, në nivel vendor dhe qendror, kishin të përcaktuara organikat e kohës së luftës, si dhe kishin planifikuar me hollësi masat për mobilizimin e përgjithshëm të popullsisë.

[4] AQU, F.100/4, D.29, viti 1980.

Teoria e *Konceptit Strategjik të Mbrojtjes* i nënshtrohej, në një masë të madhe, konceptit themelor që ekzistonte në atë kohë pothuajse në të gjithë vendin dhe që shprehej në të ashtuquajturën *"Periudhë fillestare e Luftës"*. Në një pikëpamje të përgjithshme, ky koncept tregonte apo më mirë të themi i nënshtrohej mendimit se si vendi do të futej në luftë në aspektin organizativ, në aspektin e funksionimit të aparatit shtetëror dhe partiak, të funksionimit të ekonomisë (prodhimit), të krijimit dhe shpërndarjes së rezervave të të gjitha llojeve për një luftë eventuale.

Kohëzgjatja e "*Periudhës fillestare të luftës"* ishte (perceptohej) nga fillimi i agresionit të armikut dhe deri në kalimin tërësor të vendit në situatën e luftës, si hapja, kompletimi, vendosja e burimeve ekonomike, etj.

Të gjitha burimet njerëzore, ekonomike e materiale, nën administrimin e strukturave shtetërore vendoseshin në dispozicion të mbrojtjes, në rast nevoje, për të përballuar një gjendje lufte, nën moton "Çdo gjë për fitoren"[5].

Njësitë luftarake u vendosën sipas drejtimeve dhe kompletimi i tyre u parashikua edhe në bazë të mundësive që kishin strukturat e pushtetit popullor për mbështetjen e tyre në njerëz, por mbi të gjitha në materiale, për të siguruar përballimin me sukses të kushteve të një lufte të gjatë ndaj një armiku të pabarabartë, mbështetur në parimin e përgatitjes për të përballuar situatat më të vështira e më komplekse të luftës.

Kushtet politike në arenën ndërkombëtare, të ndërthurura me vetëizolimin politik e ekonomik të vendit për përballimin me sukses të problematikave të mbrojtjes së vendit, kërkonin ndërmarrjen e masave të reja për përballimin e detyrave të shtruara nga udhëheqja politike. Industria e mbrojtjes ishte e para që duhej t'i përgjigjej këtyre ndryshimeve, duke bërë të domosdoshme krijimin dhe funksionimin e linjave të projektimit, prodhimit, e riparimit të armatimit, municionit dhe teknikës luftarake, brenda vendit. Në këtë periudhë, para kësaj industrie u shtrua direktiva "…prodhimi i armatimit të këmbësorisë dhe municionit të saj në vend, por edhe i artilerisë së lehtë kryesisht atij të mortajave"[6], sikurse dhe një sërë detyrash të këtij karakteri çuan në ristrukturimin dhe fuqizimin e këtij sektori në vend, u ngritën apo dhe u ristrukturuan institutet studimore e projektuese në nivel qendror, por edhe në strukturat prodhuese ku në këtë periudhë funksiononin me kapacitete të plota rreth 12 uzina ushtarake. Sipas statistikave të kohës në industrinë ushtarake të vendit punonin mbi 14600 njerëz, prodhimi i saj vjetor, në vlerë leku, ishte afërsisht i barabartë me prodhimin e industrisë mekanike të vendit. Krahas saj u fuqizuan edhe ofiçinat e riparimit në çdo divizion (korpus) këmbësorie, për të siguruar riparim e mirëmbajtje të niveleve dhe vështirësive tepër të larta.

Këto kushte politike të vendit, sikurse u theksua më sipër, por në veçanti ato të vetëizolimit, sollën edhe mungesën në informacion sikurse ishin edhe ato të funksionimit të plotë të një shërbimi agjenturor, ç'ka shtroi nevojën e rritjes dhe përmirësimit të sistemit të vrojtimit, vëzhgimit dhe zbulimit të hapësirës shtetërore në tokë, det dhe ajër. Kjo do të çonte në përhapjen në një shkallë të gjerë të tyre në të

[5] AQU, F. 14, D.6, viti 1968.
[6] AQU, F.100/1, D.48, viti 1962.

gjithë territorin duke filluar që nga vija e parë. Duke konsideruar si një nga drejtimet kryesore të sigurisë lajmërimin në kohë për rrezikun apo kërcënimin, gjatë kësaj periudhe, u ngrit një sistem i plotë radiolokator për vëzhgimin e hapësirës ajrore: rreth 18 posta radioteknike, rreth 8 posta radiozbulimi, shumë posta vrojtimi në kufirin tokësor e detar, etj.

Rritja tepër e madhe e numrit të strukturave dhe numrit të forcave kërkonte në mënyrë të padiskutueshme rritjen e numrit të përgjithshëm të oficerëve dhe të nivelit të tyre, për të patur oficerë me formim të plotë ushtarake për të gjitha llojet e shërbimeve. Gjatë këtyre viteve u krijuan shkollat për të tre shërbimet sikurse ishin Shkolla e Lartë e Bashkuar e Oficerëve (SHLBO) në Tiranë dhe shkollat e Aviacionit dhe Marinës në Vlorë, të cilat siguronin studime në nivel universitar. Për strukturat rezerviste u ngritën shkollat e përgatitjes së oficerëve rezervistë në Tiranë dhe Vlorë, si dhe funksiononin të ashtuquajturat shkolla instruksioni në të gjitha korpuset (divizionet), në mbarë vendin.

Kjo periudhë do të shënonte edhe përshtatjen dhe përmirësimin e të gjitha programeve të përgatitjes luftarake të trupës, me përparësi stërvitjen e përgatitjes së zjarrit, qitjen me lloje të ndryshme të armëve dhe në kombinim ndërmjet tyre, stërvitjen taktike në nivel nënreparti e reparti të ndërthurur me qitje luftarake, luftën kundërtankeve dhe mjeteve të blinduara, masat e mbrojtjes xheniere dhe të mbrojtjes nga ADM, stërvitjen në kushtet e pamjes së kufizuar dhe natën, stërvitjet në kushte ekstreme të motit dimër apo verë, desantit ajror dhe goditjen e objektivave ajrore, luftën kundër grupeve zbuluese diversioniste, etj.

Sigurisht, të gjitha këto masa, të marra në situatën politike të shpjeguar më lart, kishin edhe një kosto tepër të lartë ekonomike, e cila edhe në kushtet e mëpasshme, ishte tepër e rëndë, duke rënduar së tepërmi gjendjen ekonomike të popullsisë. Rënia e vazhdueshme ekonomike, masat e tejskajshme dhe të pakuptimta si tufëzimi, të ndërthurura me mungesën e plotë të shkëmbimeve me jashtë, me masat shtrënguese dhe luftën e klasave, etj., kishin ndikim edhe në fushën e mbrojtjes. Ato e goditën atë në radhë të parë në moralin e saj, por edhe në nivelin e gatishmërisë dhe aftësive luftarake në tërësi.

Mendimi teorik shqiptar për konceptin strategjik ushtarak të viteve 1960-’70 do të karakterizohet më pas nga ndryshime thelbësore dhe të menjëhershme në të gjitha fushat e jetës së vendit në përgjithësi dhe, në atë të mbrojtjes në veçanti. Shkaku themelor i këtij ndryshimi të madh erdhi si pasojë e daljes nga Traktati i Varshavës *“de facto”* në vitin1961 dhe *“de jure”* në vitin 1968.

Në këtë kohë, lindi dhe u zbatua koncepti i ri: “Mbështetja tërësisht në forcat e veta”, një gjë unike për nga lloji dhe vendi, që u projektua nga ideologët e “partisë-shtet”.

Si koncept në vetvete ai përfshinte: “Zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë, duke u mbështetur tërësisht në forcat tona, mbi bazën e thellimit të industrializimit socialist të vendit, të fuqizimit dhe të intensifikimit të bujqësisë, të rritjes së efektivitetit të ekonomisë, të zhvillimit të revolucionit tekniko-shkencor dhe të përsosjes së marrëdhënieve socialiste në prodhim, me qëllim që të garantohej dhe të ngrihej gradualisht mirëqenia materiale dhe niveli kulturor i masave punonjëse, të forcohej me tej rendi socialist dhe fuqia mbrojtëse e atdheut”.

Bazuar në konceptin e mësipërm, të gjitha strukturat ushtarake, nga Shtabi i Përgjithshëm dhe deri në bazë, u vunë në lëvizje për t'iu përshtatur realitetit të ri. Kjo ishte edhe periudha kur teoricienët ushtarakë hartuan *Konceptin e Përgjithshëm Strategjik të Mbrojtjes* së vendit, i cili në vetvete përfshinte hartimin e planit të përgjithshëm të mbrojtjes së vendit, në rast agresioni nga fqinjët, nga ndonjë vend anëtar, ose koalicion vendesh anëtare të Traktatit të Varshavës dhe më gjerë, duke përfshirë dhe NATO-n.

Filloi të përpunohet mendimi teorik ushtarak operativ dhe strategjik shqiptar, ku taktika e përgjithshme vlerësohej si çelësi i suksesit (suksesi taktik çon në suksesin operativ dhe më tej në suksesin strategjik, e në përfundimin e luftës) që u materializuan në *Tezat e Këshillit të Mbrojtjes*[7] (1967)). Ushtria Shqiptare, për herë të parë, kishte mendimin e vet origjinal ushtarak, të shprehur në formë tezash të cilat u eksperimentuan gjerësisht në shkallën taktike deri në atë operativo-strategjike.

Po merreshin masa të rëndësishme për organizimin e tërë strukturave ushtarake në një forme të re, e cila do të bënte "të mundur" që ato të ishin të afta për "të përballuar" një agresion apo edhe koalicion agresorësh që do të sulmonin vendin tonë.

Ndryshimet në zhvillimin e konceptit strategjik pas daljes nga Traktati i Varshavës

Me daljen e Shqipërisë nga Traktati i Varshavës, situata politiko-ushtarake (viti 1961) ndryshoi shumë dhe në mënyrë të menjëhershme. Partia-shtet e asaj kohe u vu në kërkim të krijimit të një sistemi dogmash dhe parimesh të reja, të cilat do të përbënin edhe shinat mbi të cilat do të ecte vendi ynë në të ardhmen. Meqenëse, Shqipëria mbeti pa aleatë dhe e kërcënuar nga dy blloqe të fuqishme ushtarake, u kërkua zgjidhja nga brenda vendit, pa mohuar dëshirën e madhe të drejtuesve të lartë partiakë për aleanca të reja. Zgjidhja në këtë kohë u gjend shumë shpejt; *parimi i mbështetjes totalisht në forcat dhe burimet e brendshme*.

I menjëhershëm ishte dhe reagimi i ekspertëve ushtarakë në fushën krijimit dhe zhvillimit të koncepteve të reja strategjike, të cilat do të përbënin bazën për direktivën e mbrojtjes së vendit nga çdo agresion i mundshëm, qoftë nga toka, ajri apo deti. Baza e mendimit teorik, në këtë kohë, ishte zhvillimi i koncepteve të përgjithshme dhe i taktikave që do të përdoreshin në fushën e luftimit, për të arritur suksese ndaj çdo kundërshtari sado i fuqishëm dhe i përgatitur qoftë ai. Në kushtet e epërsisë së armikut në forca e mjete, si dhe të rritjes së fuqisë asgjësuese e shkatërruese të armëve në fushën e luftimit, mendimi taktik shqiptar kërkonte rrugë më efektive për minimizimin e humbjeve, duke siguruar mbrojtje sa më të madhe të efektivave, pajisjeve, armatimit dhe rezervave materiale. Në këtë kontekst, zbulimi në pikëpamjen strategjike përbënte dhe luante një rol shumë të rëndësishëm, duke u përcaktuar si pikënisje e çdo veprimi luftarak. Ai luante një rol shumë të rëndësishëm në sistemin e drejtim-komandimit. Gjithashtu sistemi i ndërlidhjes, si element tepër i domo-

[7] *Tezat e Këshillit të Mbrojtjes*, të përmbledhura në "Teza mbi Artin Ushtarak Popullor të Ushtrisë Popullore të Republikës Popullore të Shqipërisë" janë aprovuar me Vendimin Nr. 9, datë 25.11.1967 të Këshillit të Mbrojtjes të RPSH. Ato janë mbajtur sekret dhe e drejta e përdorimit të tyre ishte vetëm për kuadrot kryesore të ushtrisë të cilët kishin të drejtën e hartimit të materialeve studimore, në zbërthim të këtyre tezave (AQFA).

sdoshëm i drejtim-komandimit, në kuadrin e fortifikimit të përgjithshëm, u bë pothuajse plotësisht nëntokësor.

Në këto kushte, në fushën taktike u punua shumë sikurse ishte fortifikimi si dhe për përpunimin teorik e zbatimin në praktikë të veprimeve luftarake taktike të nënreparteve, reparteve e njësive taktike në fushëbetejë. Nga ky këndvështrim, duke u mbështetur edhe në përvojën e disa vendeve aziatike, fillimisht vëmendja u përqendrua në krijimin e një sistemi mbrojtës të trupave të tipit tunel të pikëmbështetjeve e rajoneve të mbrojtjes. Ai u konceptua dhe u vu në rrugën e zgjidhjes në formën e pikëmbështetjeve dhe e rajoneve të mbrojtjes me sistemin tip tunel në formë ylli (Y), me tre qendra zjarri, në fillim të çdo hyrjeje tuneli dhe të lidhura me transhe e me hendeklidhje. Sistemi i pajisjeve fortifikuese çoi në përpunimin e zbatimin në praktike të koncepteve taktike në kushtet e sistemit të mbrojtjes tip tunel. Kjo ruante, në shkallë të lartë, forcat dhe mjetet nga asgjësimi i armikut.

Taktika e përgjithshme u trajtua si një nga tri pjesët përbërëse të *Tezave të Këshillit të Mbrojtjes*, e cila u zhvillua dhe u trajtua gjerësisht në atë periudhë dhe, ka pasur vend dhe rol të posaçëm në të gjitha planet luftarake apo stërvitjet e zhvilluara, me apo pa trupa. Ajo ndahej në dy pjesë kryesore: në taktikën e luftës me front të rregullt dhe taktikën partizane, si dy shtylla ku mbështetet mendimi teorik e praktik shqiptar në shkallë taktike. *"Suksesi taktik çonte në suksese operative e strategjike" apo "shuma e sukseseve taktike çojnë në suksese operative"* në kushtet e një lufte të gjatë popullore që realisht përgatitej nga i gjithë vendi; pra, përbënin thelbin e konceptimit taktik, por me ndikime edhe në sferat më të larta, në atë operative e strategjike.

Taktika për mbrojtjen kundër desantit ajror e detar dhe asgjësimi i tyre në fushën e luftës, sipas parimeve të taktikës së përgjithshme, ishin dukuri të reja taktike në mendimin teorik shqiptar. Taktika kundër desantit ajror përbënte një dukuri të re për vendin tonë. Për vetë kushtet e terrenit, veçanërisht në bregdet, ajo u gërshetua ngushtë me taktikën kundër desantit detar.

Në situatën e re të krijuar, theksi u vu në riorganizimin e tërë strukturave ushtarake nga lart-poshtë, gjë e cila përbën dhe atë që quhet faza e dytë e organizimit të FA. Shtabi i Përgjithshëm u shndërrua në një institucion që vepronte me harmoni, operativitet e dinamizëm, duke ndikuar dukshëm në rritjen e aftësive drejtuese të komandave dhe shtabeve të të gjitha rangjeve dhe në nivelin e stërvitjes e të gatishmërisë luftarake të trupave. Në riorganizimin ushtrisë në vitin 1966, Shtabi i Përgjithshëm u riorganizua dhe vlerësohej si organ i Ministrisë se Mbrojtjes Popullore (MMP), që organizon, bashkërendon dhe harmonizon veprimtarinë e aparatit të Ministrisë, kontrollon e ndihmon për zbatimin e vendimeve të qeverisë dhe të urdhrave e udhëzimeve të MMP në ushtri, si dhe ndjek punën me organet shtetërore për çështjet e mbrojtjes. Kryerja e këtyre funksioneve kushtëzoi edhe zhvillimin strukturor të këtij institucioni e plotësimin me të gjithë elementët e nevojshëm, për drejtimin, stërvitjen e veprimtaritë e tjera të domosdoshme për ushtrinë.

Me riorganizimin e vitit 1966, Shtabi i Përgjithshëm përbëhej nga 4 drejtori: Operative, e Zbulimit, e Organizim-Mobilizimit dhe e Ndërlidhjes dhe nga 7 degë autonome: e

Mbrojtjes Kundërkimike, e Shifrës, e Topografisë, e Administratës, Ekonomike, e Stërvitjes Luftarake dhe e Shërbimit. Kjo strukturë nuk ndryshoi deri në vitet ’80. Nga Shtabi i Përgjithshëm nuk vareshin komandat e korpuseve, Drejtoria Politike, Drejtoria e Xhenios, Komanda e MBL, Komanda e Artilerisë, Prapavija dhe Forcat e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Pas vitit 1970, me krijimin e korpuseve, u lehtësua edhe puna e detyrat e Shtabit të Përgjithshëm për zgjidhjen e problemeve të njësive. Tani Shtabi i Përgjithshëm merrej me drejtimin dhe udhëheqjen e përgjithshme të veprimtarisë luftarake dhe organizimin e kontrolleve të FA.

Në këtë periudhë, në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura u ideuan dhe u vunë shumë shpejt në zbatim *“Pikat e hapjes”* në funksion të artit taktik si dhe parimi bazë: *“Pranë kazmës edhe pushkën”*, duke shtuar në tabelën e organizimit, trupat rezerviste. Ushtria Shqiptare dhe udhëheqja e saj e panë zbatimin e këtij koncepti të ri në funksion të artit taktik, që për kohën vlerësohej si çelësi i suksesit.

Për këtë arsye, pikëpamja: “Arma pranë popullit ushtar” [8] shpejt do të kthehej në një praktikë të plotë zbatuese. Në të gjithë territorin e republikës do të përhapeshin me mijëra pika hapjeje për armatosjen dhe përgatitjen e të gjithë popullit ushtar, të kontingjenteve rezerviste të “mbjella” në çdo fshat, lagje e ndërmarrje shtetërore. Tashmë, mbrojtja e vendit “pëllëmbë për pëllëmbë”,[9] ishte një realitet i madh e i prekshëm.

Në këtë fazë të lulëzimit të plotë të pikave të hapjes, karakteristike ishte sistemi i pikave të hapjes, i plotësimit dhe i stërvitjes, që u realizuan mbi bazën e pikave të hapjes, duke përmbushur kërkesën e udhëheqjes politike të kohës: *“Pranë kazmës edhe pushkën”*. Kjo ishte një masë politiko-ushtarake e cila rriti sasinë numerike të FA, por nxori si të metë të madhe pamundësinë e aftësimit të këtyre trupave për të plotësuar në mënyrë sa më të plotë gatishmërinë luftarake të FA. Populli gjendej vazhdimisht nën trysninë psikologjike të mundësisë së luftës në çdo moment dhe të nevojës për t’u përgatitur dhe përballuar me sukses një agresion të mundshëm.

Mbështetur në konceptin e mbrojtjes së terrenit, “pëllëmbë për pëllëmbë” që nga kufiri shtetëror deri në thellësi të mbrojtjes, në zonat e mundshme të desantimit ajror. Përgjatë kufijve shtetërorë dhe në rajonet e mundshme të desantimit u vendosën një kordon formacionesh të njësive luftarake, që përbënin një zinxhir statik, në një kordon linear përgjatë gjithë kufirit shtetëror, si dhe grupime në thellësi. Pas viteve 60’, rezervisti u atashua pranë njësive. Në *Konceptin Strategjik* u bë riorganizimi, u ngritën repartet te gatshme, u bë afrimi i njësive pranë detyrave luftarake, u krijua brezi i sigurimit i cili deri në vitin 1981 varej nga korpusi dhe më vonë do të shërbente si Skalion i Parë i BrK.

Shpërndarja e ushtrisë aktive në mbi 1500 garnizone e 2800 pika hapjeje formonte atë që quhej ushtri popullore, larg kazermës dhe pranë popullit. E gjithë kjo ishte pjesë e origjinalitetit shqiptar, ku *problemet e ushtrisë dhe të mbrojtjes ishin pjesë përbërëse të çdo qytetari*. Kjo ishte edhe pikënisja e parullës së famshme “çdo ushtar

[8] AQ i FA të RSH. Fondi i Drejtorisë së Përgatitjes Luftarake, Dosja Nr 2, viti l961, faqe 2.
[9] AQ i FA të RSH. Po aty, Dosja Nr 4, viti l961, faqe 9.

qytetar dhe çdo qytetar ushtar". Pikat e hapjes shkurtuan në maksimum kohën e gatishmërisë së formacioneve që bazoheshin në të si dhe eliminonin mundësinë e goditjeve të befasishme të kundërshtarit në grumbullime të mëdha, veçanërisht kjo në periudhën fillestare të luftës.

Pikat e hapjes kishin një lidhje të ngushtë midis ushtrisë dhe terrenit. Dallimi midis tyre po shkonte drejt zhdukjes. Në shpërndarjen e pikave të hapjes, që në fillimet e ndërtimit të tyre, u mbajtën parasysh zhvillimet demografike shqiptare, mbyllja sa më e mirë e drejtimeve taktike dhe taktiko-operative, mbledhja e kontingjenteve në një kohë sa më të shkurtër. Kjo shpërndarje bënte që armatimi dhe pajisjet organike të mbaheshin krejtësisht të decentralizuara Për këtë u morën parasysh edhe përvojat e sistemeve të mobilizimit të disa vendeve të vogla europiane.

Kjo mund të quhet periudha: "Shqipëria mes viteve të izolimit dhe parimit të mëvetësisë" dhe u bë një realitet i prekshëm i kohës. Pas viteve '60-të, divergjencat e drejtuesve politiko-ushtarakë të shtetit shqiptar me Bllokun Lindor morën përmasa të mëdha e një shtrirje të gjerë. Mëvetësia synonte që, në organizimin luftarak, çdo formacion luftarak, sipas përbërjes së tij organike, duke u mbështetur në forcat dhe në mjetet e veta, të ishte në gjendje të plotësonte me sukses detyrën luftarake. Kjo për kohën është arritur duke përsosur më shumë armatimin e teknikën e re luftarake në përdorim, duke përmirësuar raportet përbërëse të llojeve të armëve brenda formacioneve dhe strukturave të caktuara, në kuadrin e të gjitha Forcave të Armatosura, në varësi të mundësive tona dhe të ndryshimit të koncepteve e pajisjeve të kundërshtarëve tanë. Pajisja e nënreparteve dhe e reparteve me armatim këmbësor e me fuqi më të madhe zjarri nga njëra anë dhe nivel mesatar të pranueshëm të përgatitjes luftarake të të gjithë popullit ushtar, nga ana tjetër, rriste në mënyrë të dukshme rendimentin luftarak në fushën e luftimit.

Provat e vazhdueshme të gatishmërisë së efektivave dhe sidomos stërvitjet me trupa të shkallëve të ndryshme, kanë qenë praktikë e vijueshme pune e komandave të të gjitha shkallëve për kontrollin e verifikimin e aftësive dhe të mundësive të formacioneve, strukturave, apo llojeve të ndryshme të armëve në përmbushjen e parimit të mëvetësisë.

Sipas kushteve konkrete ku vepronin repartet e njësitë taktike, pra sipas rajoneve a drejtimeve taktike që ato mbronin, në funksion të zbatimit të këtij parimi në pikëpamje organizative, nga ana numerike dhe sasia e efektivit, brenda e ndërmjet formacioneve, qoftë edhe të një shkalle e të një arme, kishte ndryshime, nga njëri formacion, rajon a drejtim te tjetri. Këtë e ndeshim më shumë në organizimin tipik të reparteve artmitraliere, me përbërje vetëm nga formacione e forca të këmbësorisë, por me efektiv të moshave të reja, me një armatim të lehtë, të fuqishëm e të manovrueshëm të njësive sulmuese, të ndjekjes, të njësive gjitharmëshe të skalioneve të dyta, sidomos të njësive Rezervë e Komandës së Përgjithshme (RKP).

Mëvetësia, si një koncept ushtarak, e ka pasur bazën e vet në parimin që iu mëshua fort për kohën. Ky parim ka gjetur shprehjen e vet dhe është konceptuar e zbatuar që nga ushtaraku i vetmuar deri në formacionin apo strukturën më të lartë ushtarake. Edhe pse deri në vitet "60-të, ne ishim anëtarë të Traktatit të Varshavës, në kuadrin e të cilit ushtritë pjesëmarrëse parashikonin detyrime të ndërsjellta për mbrojtjen,

anëtarësia jonë kushtëzonte kryesisht furnizimet ushtarake, standardizimin e armatimeve, njësimet konceptuale të artit taktik, operativ e strategjik. Me ndërprerjen e marrëdhënieve me vendet e Bllokut Lindor, çështja e mbrojtjes u pa nën një këndvështrim të ri për kohën, duke u mbështetur tërësisht në forcat e veta. Materializimi i këtij parimi ishte masivizimi tepër i madh që mori organizimi ushtarak, stërvitja taktike dhe e zjarrit, deri tek ngritja e strukturave të reja në Forcat e Armatosura. Parë në tërësi, këto ndryshime sollën edhe pasurimin dhe përsosjen e anës konceptuale të artit ushtarak të kohës si dhe konceptet doktrinore taktike.

Disa analiza, vlerësime dhe përfundime për konceptet strategjike

***Së pari*:** Kjo periudhë kohore përkon me zhvillimet politiko-ushtarake dhe veçanërisht me prishjen zyrtare të marrëdhënieve të vendit tonë me aleatët e vet lindorë dhe me strukturën që i bashkonte ushtarakisht, Traktatin e Varshavës. Këto zhvillime, për vetë pasojat që mbartnin, kërkonin jo thjeshtë ridimensionimin e vizioneve e të praktikave ushtarake taktike shqiptare që mbisundonin në atë kohë, por edhe të atyre operative strategjike. Madje ato shtruan zgjidhje themelore të reja për mbrojtjen e vendit që çuan edhe në përmbysje të të vjetrave. Politikisht dhe ideologjikisht, shteti shqiptar e vlerësonte veten të rrethuar nga shtete armiq dhe me synime ndaj trojeve shqiptare. Në këto kushte, udhëheqja politike dhe ushtarake, në vetminë e vet, kërkonte rrugë dhe mundësi të brendshme për të përballuar sfidat e angazhimit politik të mëvetësisë.

Në kushtet e Luftës së Ftohtë, pas periudhës fillestare, prishja me BS, bëri që Shqipëria të mos kishte më aleatë politikë. Ndërkohë, disa nga shtetet kufitare kishin pretendime të përhershme territoriale, për vise të caktuara të Shqipërisë. Po kështu, marrëdhëniet mes dy blloqeve më të mëdha ushtarake të kohës (NATO- Traktati i Varshavës), u ashpërsuan së tepërmi. Të dy blloqet, jo vetëm që po armatoseshin dhe po plotësoheshin me njësi elite, me teknikë dhe armatim modern, por ishin futur në një garë të ethshme rivaliteti. Në këto kushte, lidershipi politiko-ushtarak shqiptar e vlerësonte realisht të mundshëm kthimin e territorit të vendit tonë në një arenë të veprimeve luftarake mes tyre. Ky përfundim vinte edhe nga fakti se pozicioni gjeografiko-strategjik i vendit tonë ishte shumë i favorshëm, i lakmueshëm dhe përbënte një teatër me përparësi në rivalitetin e dy blloqeve. Vlen të theksohet fakti se territori ynë materializohej edhe në ide të stërvitjeve të tyre të mëdha, sidomos nga Traktati i Varshavës.

Në këto zhvillime, si rrugë më e përshtatshme u vlerësua angazhimi i gjithë popullit në luftën e pritshme sipas parullës "çdo qytetar ushtar dhe çdo ushtar qytetar". Pra, ajo, për nga ridimensionimi, përmasat dhe rrjedhojat që solli në fushën ushtarake në tërësi dhe në atë konceptuale e praktike të taktikës në veçanti, përbënte një reformë të thellë dhe tërësore në fushën e koncepteve strategjike dhe taktike; pra një reformë të plotë të mendimit teorik dhe praktik ushtarak edhe pse nuk u emërtua asnjëherë si e tillë. Këtij synimi dhe angazhimi të përgatitjes të të gjithë vendit për luftën e mundshme, iu nënshtruan jo vetëm formacionet ushtarake, rezerviste, vullnetare, rinia shkollore, por të gjitha strukturat partiake, shtetërore, ekonomike, etj. që pritej të kryenin detyra luftarake në situata kërcënuese dhe lufte. Kjo përbënte një rrugë të gjatë, të shtrirë në kohë si dhe me shumë privacione ekonomike, fizike, morale, por

edhe me kosto të madhe ushtarake. Duhet theksuar se udhëheqja politiko-ushtarake e vendit ishte e vendosur ta vinte në jetë parullën "I gjithë populli ushtar".

Kuadrot ushtarakë, me ndjenjën e detyrës për atdheun, vunë gjithçka në funksion të organizimit dhe të përgatitjes së "popullit ushtar". Në funksion të këtyre zhvillimeve e pozicionimeve politiko-ushtarake të udhëheqjes së lartë të vendit, FA shqiptare, veçanërisht forcat tokësore, po shkonin drejt konsolidimit të plotë dhe po merrnin fizionomi dhe karakter mjaft të gjerë popullor, me tipare të spikatura shqiptare.

Së dyti: Zhvillimet e vrullshme dhe pavarësia e Ushtrisë Shqiptare pas shkëputjes nga BS dhe Traktati i Varshavës, bënë që udhëheqja ushtarake e vendit, deri tek komandat më të vogla, të ndjente peshën e përgjegjësisë së misionit të mbrojtjes, tashmë pa ombrellën e mbrojtjes kolektive. Kjo peshë u ndje në të gjitha strukturat ushtarake, prandaj dhe përkushtimi i të gjithëve për rritjen e gatishmërisë luftarake ishte relativisht i lartë. Pas viteve '60-të, ritmi i ngritjes së njësive e reparteve taktike u përshpejtua shumë. Krahas punës riorganizuese e ristrukturuese të ushtrisë, iu dha përparësi ngritjes së nivelit të gatishmërisë së tyre, duke vënë në themel përgatitjen intensive luftarake. Dy lëndë mbisundonin në programin e të gjithë strukturave ushtarake: stërvitja taktike nga ushtari (vullnetari, nxënësi, studenti) e deri tek nënrepartet taktike (kompani, batalion) dhe kompaktësimi i veprimeve të tyre për të vepruar si një trupë unike, në përputhje me detyrën luftarake.

Përvetësimi dhe përdorimi luftarak i armëve, në kuadrin e përgatitjes për qitje, si dhe zhvillimi i tyre u kushtëzua nga vizione taktike, duke synuar gërshetimin e veprimeve vetmore taktike të zjarrit, në kuadrin e stërvitjes së vogël taktike, për t'i marrë armës rendimentin maksimal të mundshëm. Por në stërvitjet taktike, bëhej kujdes për ndërthurjen e të gjitha disiplinave të tjera (përgatitjes fizike, luftimit të afërt dhe deri të ndeshjes trup me trup, mbrojtjes nga ADM, goditjet nga aviacioni dhe artileria). Ky gërshetim e afronte stërvitjen taktike dhe fushën e stërvitjes më pranë realiteteve të luftës, apo sikurse punohej e thuhej në atë kohë nën parullën "Ta kthejmë fushën e stërvitjes në fushë lufte, apo" "…sa më shumë djersë në kohë paqeje, aq më pak gjak në kohë lufte". Pa nënvlerësuar stërvitjen e vogël taktike, në këtë periudhë, përparësi morën stërvitjet e mëdha taktike me brigada e më pas në shkallë korpusi.

Krijimi i formacioneve të reja ushtarake, u shoqërua veçanërisht me njohjen e hollësishme të terrenit, të drejtimeve të vogla taktike dhe taktiko-operative, me shfrytëzimin maksimal të vlerave të tij, me përgatitjen e tij nga ana xheniere, që do të pasohej më pas me tunelizimin dhe fortifikimin masiv të vendit. Krijimi i reparteve të reja sipas shtrirjes territoriale të popullsisë, kufizoi manovrimet e mëdha taktike të reparteve e njësive, pasi detyrat luftarake ishin më të përcaktuara dhe në sektorë më të ngushtë, kryesisht në zonat ku plotësoheshin me kontingjentin njerëzor, rezervist apo vullnetar. Këtu bënin përjashtim vetëm njësitë e repartet RKP si dhe skalionet e dyta të korpuseve. Parimi i organizimit territorial u kushtëzua nga nevoja që nënrepartet dhe repartet taktike të zinin, në kohën më të shkurtër, rajonet e mbrojtjes, ndërsa njësitë taktike të mos gjendeshin shpesh nën goditjen e aviacionit të armikut, i cili vlerësohej se kishte epërsi në ajër, qoftë edhe nga një shtet i vetëm.

Së treti: Armatosja e të gjithë popullit sipas parimit "mbrojtja e atdheut të bëhet pëllëmbë për pëllëmbë, që në vijën e kufirit" përbën rrugën kryesore të ndjekur,

sipas një platforme të qartë mbrojtëse, në përmbushje të misionit kushtetues. Sipas konceptit të udhëheqjes ushtarake të vendit, problemi themelor i përcaktuar qartas, ishte fakti se ushtria jonë, si një ushtri e një vendi me sipërfaqe dhe popullsi të vogël, duhej të aftësohej ushtarakisht e kryesisht në veprime taktike që të përballonte një armik më të madh në tokë, ajër dhe det.

Së katërti: Në themel të Ushtrisë Shqiptare, sipas konceptit "populli ushtar", për përballimin e një agresioni të mundshëm u vendos "ushtria rezerviste" e organizuar mbi bazë territori. Njësitë dhe repartet hapeshin dhe kompletoheshin pranë rajoneve ku banonin, pranë brezave të mbrojtjes së tyre. Kjo shkurtonte kohën e zënies së rajoneve e brezave taktikë të mbrojtjes, për përballimin e një sulmi të befasishëm dhe nuk kërkonte lëvizje dhe manovër të gjerë të forcave dhe mjeteve kryesore. Sipas idesë së udhëheqjes politike dhe ushtarake të vendit, në fillim të viteve '70-të, tërësia e sistemit të përgatitjes luftarake të "popullit ushtar" u përfshi në sistemin e *Shkollave të Lira Ushtarake*. Në funksion të kësaj ideje u krijuan SHLU, kryesisht në qendrat urbane. U kthyen në komanda të shkollave të lira edhe komandat e batalioneve këmbësore, mitraliere, sulmuese, etj. SHLU-*të* kishin varësi të dyfishtë: nga njëra anë vareshin nga komandat e brigadave ku ishin të sistemuara në organikë dhe, nga ana tjetër, vareshin edhe nga komitetet e partisë të rretheve. Kjo e fundit tregonte zgjerimin dhe forcimin e kontrollit të partisë mbi ushtrinë.

Së pesti: Vitet '60-'75 shënuan kohën e shtrirjes dhe ndërtimit të FA me konceptin "I gjithë populli ushtar"dhe "gjetjes së vetvetes", duke çuar, krahas krijimit të organikave dhe pajisjeve me armatim të fuqishëm të këmbësorisë edhe në formimin e koncepteve të pavarura doktrinore origjinale taktike. Kjo u konkretizua me daljen e *Tezave të Këshillit të Mbrojtjes* dhe përpjekjeve për zbatimin e tyre në praktikë. Kjo periudhë, me përmbajtje të gjerë konceptuale e praktike në shkallë strategjike, ushtronte ndikim të fuqishëm edhe në fushën taktike, madje një ndikim thelbësor. Tashmë, mendimi i përpunuar doktrinor shqiptar, i përshkallëzuar që nga ushtari apo taktika e vogël deri tek konceptet themelore operative dhe strategjike, morën formë, si dhe iu hap rruga mendimit shkencor ushtarak të institucionalizuar. Në funksion të këtij mendimi të ri ushtarak, për herë të parë në historinë e FA, u krijua Instituti i Studimeve Kërkimore Ushtarake Shkencore (ISKUSH), në fillim të viteve '70.

Së gjashti: *Tezat e Këshillit të Mbrojtjes* si një mendim e përgjithësim i përvojës shqiptare, por edhe i asaj botërore, të përshtatura me kushtet dhe mundësitë e vendit, filluan menjëherë të eksperimentoheshin në praktikë, në stërvitjet me formacione të vogla taktike në poligone dhe më pas, në stërvitje të mëdha në shkallë korpusi dhe më gjerë. Kështu u zhvilluan stërvitjet me trupa si "Tomori '68", "Shpiragu" (prill '69), "Drini '71", "Peza '72", "Kaptina '73", "Semani '74", etj. Në këto stërvitje u përpunuan çështje të shumta e të ndërlikuara që lidheshin drejtpërdrejt me problemet taktike, pavarësisht se këto stërvitje ishin të niveleve taktiko-operative. Për vëzhgimin e problemeve taktike, në këto stërvitje organizoheshin grupe studimore, mendimet e të cilëve gjenin trajtesa të posaçme në përfundimet mbi stërvitjet.

Gjithë kjo ecuri stërvitore, eksperimentuese e përgjithësuese lidhur me tezat, krijoi terrenin e favorshëm për të kaluar nga mesi i viteve '70-të, jo vetëm në kthimin e tyre

nga teza në art ushtarak popullor, por edhe në zbërthimin gjerësisht të tyre në të gjitha fushat dhe në të gjitha strukturat dhe shkallët. U arrit kështu të përpunohej plotësisht *Koncepti Doktrinor mbi Strategjinë dhe Taktikën* e FA, siç e quajmë ne sot, për të gjitha strukturat, llojet e armëve, shërbimeve, duke filluar nga ushtari (vullnetari) deri tek njësia më e madhe taktike. Pra, të gjithë këto elementë krijuan bazën për formulimin e doktrinave dhe rregulloreve përkatëse. U përpunuan , u miratuan dhe u vunë në përdorim, në vitet '70-'75, rreth 212 rregullore, tekste dhe instruksione të ndryshme.

Në rregulloret dhe materialet taktike, krahas kodifikimit të veprimeve konkrete taktike në fushën e luftimit, sipas hierarkisë ushtarake, duke filluar nga ushtari i thjeshtë, gjejnë pasqyrim parimet, rregullat e elementët e taktikës së përgjithshme, si pjesë e artit ushtarak dhe ato të llojeve të armëve dhe shërbimeve, llojet përkatëse të luftimit taktik dhe mënyra e përdorimit të reparteve dhe nënreparteve për arritjen e qëllimit taktik në luftimin gjitharmësh, si dhe taktika speciale për forcat e tjera si Artileria Kundërajrore, Artileria Tokësore, Artileria Bregdetare, etj. Në këtë mënyrë, *Koncepti mbi Strategjinë dhe Taktikën*, në tërësi, mori formë dhe, për kushtet konkrete të asaj periudhe, duhet vlerësuar.

Së shtati: Ndërtimi dhe perfeksionimi i FA u konceptua dhe u zbatua në mënyrë të tillë që të përfshinte mbarë popullin. Kulmi u arrit me çuarjen e armatimit për armatosjen e përgatitjen luftarake të të gjithë popullit ushtar, sa më pranë kontingjenteve, sipas parimit të mobilizimit në bazë territori. Kjo masë përfshiu, në të gjithë vendin, ngritjen e Pikave të Hapjes, kryesisht në bazë batalioni (grupi), sa më pranë kontingjenteve dhe rajoneve të mbrojtjes. Pranë tyre u ngritën edhe poligone të shumëllojshme për përgatitjen luftarake të efektivave. Madje, për repartet mitraliere, në brezin e kufirit, ato u ngritën edhe në bazë kompanie, pa folur për kompani dhe bateri të AKA. U krijuan kështu kushtet e përshtatshme për kalimin nga ushtri e kazermës në ushtri të madhe popullore. U shkri ushtria aktive me popullin ushtar. Ky sistem siguroi një rritje të nivelit taktik të të gjithë kontingjenteve të gjera rezerviste, apo të të gjithë popullit ushtar, si një garanci për mbrojtjen e vendit që nga kufiri shtetëror, duke mos lënë i hapësira boshe armikut të mundshëm. Duke vlerësuar përparësitë e kësaj mase, mund të themi se kjo pati edhe pasoja negative, pasi kuadrot që shërbenin në këto reparte dhe nënreparte u kthyen thjesht në prakticienë të thjeshtë, duke hequr dorë nga përgatitja teorike.

Së teti: Në këtë periudhë kohore, duke njohur realisht epërsitë e armiqve tanë, në koalicion ose të marrë veçmas, në teknikë, armatim si dhe në fuqinë asgjësuese të zjarrit, komanda politike dhe ushtarake e vendit, e përqendroi vëmendjen tek fortifikimi i teatrit të veprimeve luftarake, përfshi edhe fushën e luftimit. Fillimisht, mbi bazën e përvojës së luftës së Koresë dhe të Vietnamit, u hapën tunele jo vetëm për objekte të rëndësishme, por edhe pikëmbështetje e rajone mbrojtjeje tip tunel e më pas, u programua dhe u realizua pajisja e rajoneve dhe e pikëmbështetjeve me qendra zjarri të përhershme, si Rajone të Fortifikuar (RF) dhe Rajone Tepër të Fortifikuar (RTF), me ndikim të fuqishëm në fushën e luftimit taktik, me front të rregullt.

Së nënti: Në këtë etapë të zhvillimit të mendimit teorik dhe praktik ushtarak shqiptar, ajo që vlen të theksohet ishte se si vlerësohej luftimi mbrojtës dhe ai mësymës. Si

lloj kryesor luftimi vlerësohej ai mësymës, ndërsa ai mbrojtës, si një nga kategoritë kryesore të luftimit. Bëhej kujdes për të vendosur ekuilibra në mes tyre, në funksion të qëllimit thelbësor; mbrojtjes me çdo kusht të rajoneve e brezave të mbrojtjes. Por, për vetë vizionin ushtarak shqiptar si dhe mundësitë, luftimi mësymës lind nga ai mbrojtës, sepse veprimet luftarake, në kushtet kur ushtria jonë kishte karakter mbrojtës dhe priste agresionin e armikut, mësymja do të fillonte pas kryerjes së veprimeve mbrojtëse dhe pykëzimit të armikut. Luftimi taktik mbrojtës përfshinte luftimin në mbrojtje, rrethim dhe tërheqje, të shprehura qartas në rregulloret e luftimit. Duhet theksuar se luftimi në tërheqje pati trajtesa të ndryshme. Ky lloj luftimi ishte tepër i kushtëzuar në rregulloret përkatëse dhe bëhej vetëm me urdhër të veçantë. Madje në *Rregulloren e Luftimit të Këmbësorisë* nuk trajtohej si lloj i veçantë luftimi, por thjesht si "formë e manovrës taktike", i përkohshëm dhe vetëm brenda kuadrit taktik të mbrojtjes. Me luftimin në tërheqje në atë kohë u abuzua shumë dhe dihet fati i ushtarakëve shqiptarë të cilët u "burgosën dhe u gjymtuan" totalisht nga partia-shtet.

Së dhjeti: Teoricienët ushtarakë e shikonin luftimin taktik në kompleksitet, jo vetëm në funksion të organizimit ushtarak, të pajisjes me teknikë dhe armatim të llojshmërisë së taktikave që përdoren, por edhe të llojeve të luftimit. Në rregulloret e luftimit trajtoheshin gjerësisht luftimi në mbrojtje, mësymje, në marshim, në tërheqje, ndjekje, në kushte të veçanta, luftimi në qendrat e banuara, në pyll, kalimi në mësymje në ecje etj, si dhe lufta kundër desantit ajror, detar e dukuri të reja të taktikës shqiptare.

Së fundi: Mund të themi se mendimi doktrinar ushtarak shqiptar mbajti në vëmendje dhe në konsideratë, me shumë kujdes, taktikën e luftës partizane, si pjesë përbërëse e taktikës së përgjithshme, si mjeshtëri e të luftuarit me mënyrat dhe metodat partizane në prapavijat e armikut. Ndryshe nga luftimi taktik me front të rregullt, taktika e luftës partizane karakterizohej nga sulmet, goditjet e pritat si mënyrë kryesore të veprimeve luftarake, për shkatërrimin e objektivave të armikut, goditjet e befasishme në kohën dhe vendin që armiku nuk e pret.

Bibliografia:

- Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, Neni 94, Tiranë, 1946.
- *Tezat e Këshillit të Mbrojtjes,* të përmbledhura në "Teza mbi Artin Ushtarak Popullor të Ushtrisë Popullore të Republikës Popullore të Shqipërisë".
- AQU, F. 100/5, D.21, viti 1974.
- AQU, F. 100/1, D.86, viti 1968.
- AQU, F.100/4, D.29, viti 1970 dhe 1980.
- AQU, F. 14, D.6, viti 1968.
- AQU, F.100/1, D.48, viti 1962.
- AQ i FA të RSH. Fondi i Drejtorisë së Përgatitjes Luftarake, Dosja Nr 2, Dosja Nr 4 viti l961.
- F. Engels , "Vepra të zgjedhura ushtarake", V. 1, Tiranë 1975.
- Karl Fon Klauzeviç, Mbi luftën, V. 1, libri i parë dhe i dytë,Tiranë,1994.
- AUP i RSH, viti 1975 dhe 1985.
- Historia e Artit Ushtarak Botëror, Tiranë, viti 1987.

Reformimi i Ushtrisë Shqiptare deri në anëtarësimin e saj në NATO

Nënkolonel Leonard Çoku
Shef i Degës së Personelit në KDS

Trajtesë e shkurtuar. *Ky punim kërkon të shpjegojë procesin mjaft kompleks të transformimit të Forcave tona të Armatosura (FA), reformimin e ushtrisë shqiptare, mekanizmat thelbësorë dhe përpjekjet maksimale të gjithë institucioneve të vendit në rrugën më të vështirë, atë të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Ajo do të përqendrohet në etapat kyçe të veprimtarisë: dialogu për sigurinë dhe bashkëpunimin; anëtarësimi në Këshillin e Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut; iniciativa e Partneritetit për Paqe; pjesëmarrja në Operacionet për Mbështetjen e Paqes; reformën e mbrojtjes; gatishmërinë ndaj katastrofave dhe bashkëpunimin në kuadër të aleancave të tjera rajonale, gjithnjë në funksion të rritjes së sigurisë dhe bashkëpunimit me NATO-n.*

Përpjekje dhe arritje të jashtëzakonshme janë bërë në transformimin e FARSH, nga një forcë e bazuar n¸ konceptin e mbrojtjes individuale, n¸ një forcë të bazuar mbi konceptin e mbrojtjes kolektive. FA kanë qenë dhe janë një nga institucionet më të përkushtuara dhe të konsoliduara të Republikës së Shqipërisë. Sot ato janë faktor i fuqishëm pozitiv që ndikon në arritjen e objektivave strategjike të vendit tonë dhe japin mesazhin se i shërbejnë një vendi demokratik që do të jetojë në paqe me fqinjët e tij, por dhe i aftë për integrimin dhe mbrojtjen e vet.

Qëllimi i këtij punimi është të parashtrojë një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me anëtarësimin e FA në NATO, integrimin e plotë në strukturat e saj. Në kreun e parë trajtohet tradita ushtarake shqiptare, organizimet ushtarake nga kohët antike deri në ditët e sotme. Në kreun e dytë janë trajtuar çështje të transformimit të ushtrisë shqiptare si pjesë e orientimit politik të shoqërisë, angazhimi i FA për anëtarësimin në NATO, aktivitetet në kuadrin e Partneritetit për Paqe etj. Në kreun e tretë i kushtohet vëmendje përparësive që mbart në vetvete anëtarësimi i Shqipërinë në NATO, parashtron problemet e angazhimit të FA për integrimin në ***NATO,*** *ku theksi vihet mbi sfidat që hasen për realizimin e këtij procesi, angazhimi i Forcave të Armatosura në kuadrin e integrimit të plotë të tyre në Aleancën Euroatlantike.*

Tradita Ushtarake Shqiptare

Organizimet ushtarake nga kohët antike deri në vitet 1990

Shqipëria ka një traditë të pasur ushtarake e cila shënon fillimet e saj që në kohët antike. Ushtritë ilire ishin disa nga ushtritë më të shquara të kohës, me këndvështrimet e tyre të veçanta. Tradita ushtarake u pasurua më tej në shekujt që pasuan, për të shënuar zhvillime të rëndësishme në periudhën e pushtimit të vendit nga Perandoria Osmane. Në vitet 1443-1468, në krye të luftëtarëve shqiptarë ishte Gjergj Kastrioti (Skënderbeu). Më 2 Mars 1944, Skënderbeu thirri Lidhjen e Lezhës, me pjesëmarrjen e të gjithë princave shqiptarë, ku një nga arritjet e saj ishte krijimi i një ushtrie të përbashkët, e cila ishte e vogël, por cilësore. Për 25 vjet rresht, kjo ushtri u bë pengesa kryesore për ushtritë e panumërta të perandorisë më të fuqishme të kohës.

Gjatë viteve 1771-1832, që është periudha e organizimit të vendit mbi bazën e pashallëqeve, edhe ushtritë u organizuan e u përdorën nga udhëheqësit e këtyre pashallëqeve. Në përpjekjet e tyre për t'u ndarë me Portën e Lartë dhe krijimin e vendeve të pavarura, ata arritën nivelet e një pozite të rregullt të Forcave të Armatosura (FA), duke pasur pothuajse të njëjtin organizim ushtarak (Divizion, Regjiment, Batalion) me ushtritë moderne të kohës.

Lidhja e Prizrenit (1878-1881) është një pikë kulmore e historisë së Shqipërisë, për pasojë është e tillë edhe për FA të saj. Duke qenë se në rrezik ishte ekzistenca e vendit, Lidhja krijoi një ushtri vullnetare, bazuar në parimin një burrë për shtëpi. Ajo u drejtua nga Komiteti Ushtarak Qendror, nën vartësinë e të cilit ishin Komisionet e Mbrojtjes Rajonale, si edhe Korpuset.

Në 30 vjetët që pasuan pas rënies së Lidhjes së Prizrenit dhe shpërbërjes së forcave të saj ushtarake, gjithçka do të zbehej për t'u ringjallur në vigjilje të shpalljes së pavarësisë së vendit në vitin 1912. Më 4 dhjetor 1912, vetëm 6 ditë pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, u krijua Ushtria Kombëtare. Për herë të parë në historinë shekullore të vendit u krijua Ministria e Mbrojtjes Kombëtare, (Ministria e Luftës) e drejtuar nga Mehmet Dralla (Tetova) dhe Shtabi i Përgjithshëm i drejtuar nga Major Ali Shefqet Shkupi. Strukturat kryesore përbërëse të saj ishin forcat aktive, forcat rezervë e ato vullnetare, si edhe Xhandarmëria me 12000 personel gjithsej[1]. Në tetor 1913, me Vendim të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, një grup ushtarakësh holandez (oficerët holandezë *De Weer* dhe *Thomson*, si dhe 15 oficerë të tjerë) ndihmuan në ristrukturimin dhe përgatitjen e xhandarmërisë. Vitet që pasuan shënuan zhvillime të tjera të rëndësishme. Kështu, për herë të parë, Forcat e Armatosura u ndanë në Forca Tokësore, Forca Detare dhe Forca Ajrore. Gjatë periudhës së sundimit monarkik, kjo ndarje ekzistoi, por vetë forcat kaluan ndryshime të brendshme, të vlerësuara pozitive për kohën. Gjithçka që shteti shqiptar dhe Forcat e tij të Armatosura kishin arritur deri në fillimin e Luftës së Dytë Botërore do të shuhej në ditën e agresionit fashist ndaj vendit tonë, më 7 prill 1939. Shteti u bë inekzistent dhe për pasojë, edhe Forcat e tij të Armatosura.

Në këto rrethana lindën forca të reja të armatosura, që u përkisnin grupimeve të ndryshme politike të kohës dhe që u përballën me pushtuesit. Forca më e madhe, me

[1] Historiku i FA Shqiptare "Faqja zyrtare e FA të Republikës së Shqipërisë".

një skemë organizative të qëndrueshme, me formacione sulmuese të disiplinuara, me një ngritje numerike progresive dhe me një Shtab të Përgjithshëm, ishte Ushtria Antifashiste Vullnetare Nacionalçlirimtare.

Pas çlirimit të vendit, ajo iu nënshtrua një procesi reduktimi e riorganizimi, gjithashtu filloi transformimin në një ushtri të rregullt të kohës së paqes. Struktura organizative e saj përbëhej nga Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm, FT, FD, FA, FR dhe ato Territoriale. Në vitin 1951, Ushtria krijoi për herë të parë aviacionin ushtarak, në vitin 1953 armën e Kimisë, shërbimin e Komunikimit, Zbulimin etj., FD, tanket, artileria, transporti, logjistika dhe disa shërbime të tjera u riorganizuan. Shqipëria ishte anëtare e Traktatit të Varshavës, nga vitet 1950 deri 1968. Ushtria shqiptare u pajis me armatim dhe teknikë nga Bashkimi Sovjetik. Kjo periudhë shënoi fillimet e stërvitjeve të mëdha, siç ishte ajo e vitit 1950. Në vitin 1966, sipas udhëzimeve të udhëheqjes politike të asaj kohe, me qëllimin e bërjes së ushtrisë më pak të kushtueshme dhe të lidhur me popullin, për mos lejimin e krijimit të Kastës Ushtarake, u realizua nxjerrja e ushtrisë nga kazermat, heqja e sistemit të gradave, shpërndarja e saj në çdo pjesë të territorit të vendit, si dhe u vendos komisari politik. Gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, në vitet 70 dhe 80, FA patën një rritje të madhe numerike duke arritur shifrën 61 000 forca aktive e 260 000 rezervistë dhe një numër të madh të Forcave Vullnetare. Bazuar në konceptin e mbrojtjes pëllëmbë për pëllëmbë, Ushtria u shpërnda në 2200 pika në të gjithë vendin dhe fortifikimi u kthye në qëllim më vete.

Ushtria, pjesë e ndryshimeve pas viteve '90

Në vitet '90, me ndryshimin e sistemit politik, edhe Ushtria u bë pjesë e këtyre ndryshimeve. Reforma në FA filloi me vendosjen e kontrollit civil në to, heqjen e simboleve komuniste nga uniformat ushtarake dhe zëvendësimin e tyre me simbolet kombëtare, vendosjen e gradave dhe depolitizimin e departizimin. Në bazë të koncepteve të reja për përdorimin e FA u bë ristrukturimi e riorganizimi i tyre, me tendencë kryesore zvogëlimin e sasisë dhe rritjen e cilësisë. Hapja ndaj botës ishte një aspekt tjetër që i shërbeu modernizimit të FA dhe rritjes së shkallës së ndërveprueshmërisë së tyre me partnerët ndërkombëtarë. Në vitin 1992, Shqipëria shpalli publikisht dëshirën e saj për t`u bërë anëtare e NATO-s, dëshirë e cila u pasua me ndërmarrjen e hapave konkret në këtë drejtim. Kështu, në vitin 1994 firmoset Dokumenti në kuadrin e PfP dhe në Qershor 1995, Shqipëria është zyrtarisht pjesë e nismës PfP. Në vitin 1999 u përgatit për herë të parë Plani i Veprimit për Anëtarësim (MAP). Megjithëse në vitin 1997, si pasojë e krizës, FA rezultuan më të dëmtuarat, në një kohë relativisht të shkurtër ato u ringritën dhe u bënë kontribuuese të denja për sigurinë e paqen në rajon e më gjerë. Gjeografia e kontributeve të FA, në mbështetje të paqes e sigurisë, i kaloi kufijtë e rajonit të Ballkanit, për t`u shtrirë edhe përtej kontinentit. Proceset integruese të FA të nisura në vitin 1992 u ridimensionuan pas vitit 1997 në përputhje me realitetet e krijuara dhe arritën pikën e tyre kulmore me ftesën për anëtarësim në NATO që vendi ynë mori në Samitin e Bukureshtit, në Prill 2008.[2]

[2] Revista Mbrojtja Nr.3/2008 "Koha për anëtarësimin e Shqipërisë tashmë ka ardhur"

Transformimi i Ushtrisë Shqiptare dhe përpjekjet për Anëtarësimin në NATO, 1990-2008

Origjina e Aleancës[3]

Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) mishëron lidhjen transatlantike që lidh Evropën dhe Amerikën e Veriut në një aleancë mbrojtjeje dhe sigurimi unik. Qëllimi thelbësor dhe jetëgjatë i NATO-s, i përcaktuar në Traktatin e Uashingtonit, është që të mbrojë sigurinë dhe lirinë e të gjithë anëtarëve të vet me mjete politike dhe ushtarake. Për këtë qëllim, NATO ka kontribuar për mbrojtjen kolektive të anëtarëve të vet qysh nga themelimi i saj, në 1949. Ajo ka vepruar gjithashtu si një forum thelbësor për konsultime mbi çështje të sigurisë me interes për anëtarët e vet, dhe si një shtyllë thelbësore për paqen dhe stabilitetin në zonën Euroatlantike.

Me përfundimin e Luftës së Ftohtë, Aleanca mori përsipër detyra të tjera themelore, që përfshijnë ndërtimin e partneriteteve për sigurinë me demokracitë përmes Evropës, Kaukazit e deri në Azinë Qendrore. Në përgjigje të ndryshimeve, në situatën e përgjithshme të sigurisë, Aleanca ka marrë përgjegjësi shtesë. Këto përfshijnë përgatitjet për t'iu përgjigjur sfidave të destabilitetit, shkaktuar nga konflikte rajonale e etnike brenda Evropës dhe kërcënimeve që vijnë nga jashtë zonës Euroatlantike. Sot Aleanca angazhohet në një shkallë gjithnjë e më të gjerë aktivitetesh që synojnë të nxisin bashkëpunimin me Rusinë, Ukrainën dhe vende të tjera jashtë NATO-s dhe të përballojnë me sukses sfidat e reja të sigurimit të shekullit të XXI, si ato që vijnë nga terrorizmi ndërkombëtar, ashtu dhe nga përhapja e armëve të shkatërrimit në masë.

Qëllimi i themelimit të Organizatës së Atlantikut të Veriut është dhënë qartë në parathënien e traktatit, ku riafirmohet besimi në qëllimet dhe principet e Kartës së OKB dhe dëshira e anëtarëve të Aleancës për të jetuar në paqe me të gjithë popujt dhe qeveritë. Palët e traktatit riafirmojnë dëshirën dhe vullnetin për ruajtjen e lirisë, pasurisë së përbashkët dhe civilizimin e popujve të tyre, të bazuara në parimet e demokracisë, lirinë individuale dhe qeverisjen e ligjit. Traktati nuk synon të ngrejë një organizatë paralele të OKB-së, por veprimtarinë e tij e mbështet në Kartën e OKB.

Zhvillimi i Partneritetit dhe angazhimi i Shqipërisë

Nëntori i vitit 1989 me rrëzimin e Murit të Berlinit, shënoi fundin e Luftës së Ftohtë. Brenda një periudhe të shkurtër, ritmi i jashtëzakonshëm i ndryshimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore e bëri NATO-n që të ballafaqohet me një grup të ri dhe shumë të ndryshëm të sfidave të sigurisë, si: Çfarë mund të bëhet për të zotëruar mundësinë për të stabilizuar çështjet e sigurisë evropiane, në një trajektore të re, më pozitive, pas përplasjeve të Luftës së Ftohtë? Çfarë masash duhet të merren për të rivendosur gjendjen normale në marrëdhëniet ndërmjet gjithë vendeve të Evropës, të Lindjes dhe të Perëndimit? Çfarë ndihme u duhet dhënë shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore për të përforcuar pavarësinë e tyre të fituar kohët e fundit dhe për të realizuar aspiratat e tyre, për të marrë pjesë plotësisht si vende demokratike, si rajonale ashtu

[3] NATO Public Diplomacy Division /NATO Library "NATO në Shekullin e XXI", faqe 3-15.

edhe më gjerë në botë, duke iu drejtuar interesit të sigurisë shumëkombëshe? Udhëheqësit aleatë iu përgjigjën takimit të tyre të lartë në Londër, në Qershor 1990, duke shtrirë një "dorë miqësie" përmes ndarjes Lindje-Perëndim, duke propozuar një marrëdhënie të re bashkëpunimi me të gjitha vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Në dhjetor 1991 u përgatit skena për themelimin e Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut (North Atlantic Cooperation Council - NACC), një forum i cili do të bashkonte NATO-n dhe vendet e saj partnere të reja, për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët[4].

Për Shqipërinë dëshira apo aspirata për t'u anëtarësuar në NATO ka qenë një proces i gjatë, i nisur menjëherë pas fitores së Demokracisë. Çdo vend që bën kërkesë për t'u anëtarësuar në NATO, duhet të miratohet prej Parlamentit të secilit nga vendet aktualisht anëtare. Këtë rrugë e këtë proces kaloi edhe kandidatura e Shqipërisë. Secili vend që dëshiron të jetë anëtar i ri i NATO-s duhet t'i bindë me vepra të gjithë anëtarët e Aleancës, se i ka plotësuar standardet politike dhe ushtarake për të qenë një partner i barabartë në mes të barabartëve.

Etapat kyçe të transformimit dhe thellimi i bashkëpunimit me Aleancën[5]

1992 Shqipëria i bashkohet Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut Verior të sapokrijuar, i emërtuar në vitin 1997 si Këshilli i Partneritetit Euroatlantik.

1994 Shqipëria i bashkohet Partneritetit për Paqe (PfP).

1996 Forcat shqiptare bashkohen me forcën paqeruajtëse të udhëhequr nga NATO, SFOR, në Bosnjë dhe Hercegovinë.

1999 NATO-ja ngre një bazë logjistike në Tiranë për të mbështetur operacionet e Aleatëve në Kosovë. 2000 Shqipëria zhvillon stërvitjen e PfP-së "Adventure Express", në prill dhe "Cooperative Dragon", në qershor.

2001 Shqipëria zhvillon etapën e parë të stërvitjes së PfP-së "Adventure Express 01", në prill dhe në maj.

2002 Ngrihet NATO HQ Tirana për ta ndihmuar Shqipërinë në zbatimin e reformave të saj për kapacitetin e mbrojtjes, si dhe për të kontribuar në komandën dhe kontrollin e KFOR-it.

2003 Trupat shqiptare dislokohen në mbështetje të ISAF në Afganistan të drejtuar nga NATO.

2005 Shqipëria i bashkohet Konceptit të Kapaciteteve Operative. Një skuadër e përbashkët mjekësore nga të tre vendet e MAP-it i bashkohet në gusht trupave të drejtuara nga NATO-ja në Afganistan. Shqipëria zhvillon stërvitjen e PfP-së "Cooperative Engagement 05" në shtator.

2007 Shqipëria zhvillon në maj një takim të Grupit Këshillues për Politikat Euroatlantike të EAPC-së. Shqipëria zhvillon stërvitjet e PfP-së "Cooperative Longbow 07" dhe "Cooperative Lancer 07".

[4] NATO Library "Security through Partnership" faqe 24.
[5] "Objektivat e Partneritetit me NATO-n", Shtëpia Botuese e Ushtrisë, 2001.

2008 Në prill 2008, Shqipëria ftohet të nisë bisedimet për anëtarësim me Aleancën.

Vendet Aleate të NATO-s nënshkruan protokollet e Anëtarësimit me Shqipërinë, më datë. 09 Korrik 2008.

Partneriteti për Paqe dhe Planet Individuale të Veprimit për Partneritetin

I bazuar në bashkëpunimin praktik dhe angazhimin ndaj parimeve demokratike që janë baza e vetë Aleancës, qëllimi i Partneritetit për Paqe është që të rritë stabilitetin, të zvogëlojë kërcënimet ndaj paqes dhe të ndërtojë marrëdhënie të sigurta të fuqizuara, ndërmjet vendeve partnere dhe NATO-s, si dhe ndërmjet vetë vendeve partnere.[6]

Në fillimet e vitit 1994, me përpunimin e konceptit të Partneritetit për Paqe (PfP) të NATO-s, Shqipëria ishte nga shtetet e para, që e përkrahu këtë nismë, si rrugën më të natyrshme të aderimit si anëtar i plotë në Aleancë.[7] Shqipëria u orientua thellësisht drejt përmbushjes së parimeve dhe objektivave të shprehur në dokumentin kuadër të PfP-së. Kjo pjesëmarrje aktive u konkretizua nëpër vite, ndërmjet të tjerash, në stërvitje të ndryshme shumëpalëshe e dypalëshe, ku FA Shqiptare kanë treguar të gjitha mundësitë e tyre për t'u transformuar në një forcë ushtarake moderne të tipit perëndimor. Këto arritje na forcojnë bindjen se aftësitë tona në evolucion e sipër në fushën e mbrojtjes dhe pozicioni strategjik i vendit tonë, kanë kontribuar në rritjen e efektivitetit të Aleancës, duke e bërë atë njëherësh edhe më elastik për kryerjen e misionit të saj tradicional të mbrojtjes kolektive dhe misionit të ri të menaxhimit të krizave rajonale. FA Shqiptare, të përfshira në veprimtaritë e PfP-së, kanë pasur një rol mjaft aktiv në këtë nismë. Ato, vetëm gjatë vitit 1995 u angazhuan në më shumë se 12 stërvitje, ku për herë të parë në histori ushtarakët shqiptarë morën pjesë në stërvitje jashtë shtetit, në SHBA, Greqi dhe Itali. Organizimi dhe zhvillimi me sukses në vendin tonë i stërvitjes "Shqiponja Paqësore '96" dhe ajo e vitit 1998 ku morën pjesë forca nga shumë shtete, deri tek ajo "Cooperative Longbow and Lancer", që dëshmojnë ecurinë politike dhe ushtarake të strukturave shqiptare mbrojtëse dhe afirmimin në praktikë të politikës së Sigurimit dhe të Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë. Përse u kërkua me aq ngulm dhe u bënë aq përpjekje të mëdha për t'u anëtarësuar në NATO? Përgjigjja e pyetjes mund të jepet në mënyra të ndryshme, por me thelbësorja gjendet te parathënia e NATO-s, ku thuhet se ajo është mbrojtëse e vlerave njerëzore. Kjo ka qenë dhe është deviza e saj që nga krijimi e deri më sot. Ky është edhe vlerësimi dhe për këtë janë bërë edhe përpjekjet maksimale për anëtarësimin. Si rezultat i përgjigjes së pyetjes së parë, bëhet pyetja tjetër: "Si i ka mbrojtur këto vlera njerëzore NATO?" Përgjigjja do të jetë: "Gjithnjë, por Kosova është rasti më unikal. Nëse Partneriteti për Paqe (PfP-ja) kontribuoi për stabilitetin në vendet e Evropës Qendrore e Lindore, rasti i marrjes në Mbrojtje të popullsisë në Kosovë e çlirimi i saj, tregoi qartë se NATO është mbrojtëse e vlerave më të larta njerëzore, vetë jetës së lirë. Ja cila është domethënia, ja ç'vlera universale të mbrojtjes së të drejtave të njeriut manifeston e mbron NATO[8].

---

[6] "Siguri Nëpërmjet Partneritetit" "Security through Partnership".

[7] Revista Mbrojtja Nr.6/2008 " Paketa e objektivave të partneritetit 2008 dhe detyrimet e FA".

[8] NATO / OTAN 2005 STPART_ALB0405 "Broshure"; NATO Book " NATO Trans formed"

Programi i Partneritetit Individual (IPP) dhe Plani i Veprimit për Anëtarësim (MAP)

Ky program është zhvilluar që të përkrahë programet kryesore që burojnë nga rishikimi i mbrojtjes. Ai përforcon vazhdimësinë e procesit të ristrukturimit, duke synuar rritjen e aftësive operacionale të FA. Ai synonte tre çështje kryesore bashkëpunimi:[9]

- Të ndihmojë Shqipërinë në ristrukturimin e FA të saj, nën kontrollin demokratik të autoritetit civil sipas planit afatgjatë të implementimit.
- Të sigurojë përkrahjen në fusha të interesit të NATO-s dhe Shqipërisë.
- T'i japë më shumë përmbajtje marrëdhënieve me PfP në një afat kohor më të gjatë.

Qëllimi kryesor për NATO-n dhe Shqipërinë në këtë fazë është që të arriheshin rezultate konkrete, me qëllim që të demonstrohen efektet pozitive të PfP. Shqipëria ka marrë pjesë dhe në Procesin e Planifikim -Rishikimit, që nga viti 1996 e në vazhdim. Për vitin 2000 ajo pranoi 53 Objektiva Partneriteti. Në Shkurt 2002 u diskutua për Paketën e tyre të Re

Plani i Veprimit për Anëtarësim (MAP), është aprovuar në Samitin e Uashingtonit të vitit 1999 si një procedurë për vendet që aspirojnë anëtarësim në NATO. Pjesëmarrja e një vendi në MAP monitoron progresin e tij në pesë fusha të ndryshme:

- Gatishmëri për zgjidhjen në mënyrë paqësore të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, etnike ose territoriale, vendosmëri në rregullin e ligjit dhe të drejtat e njeriut, dhe kontrolli demokratik i forcave të armatosura.
- Aftësi për të kontribuuar në mbrojtjen dhe misionet e organizatës.
- Përkushtim i mjaftueshëm burimesh për FA, për të plotësuar angazhimet e anëtarësimit.
- Siguri e informacioneve të ndjeshëm dhe ruajtja e tij.
- Përshtatshmëri e legjislacionit të shtetit me bashkëpunim të NATO-s.
- Nëpërmjet MAP-it Shqipëria është e angazhuar të arrijë objektivat e mëposhtëm:
- Të vazhdojë të përmirësojë rendin dhe ekonominë e tregut duke i kushtuar vëmendje të veçantë përmirësimit të rendit dhe luftës kundër korrupsionit.
- Të inkurajojë dhe zhvillojë respektin për të drejtat e njeriut, duke përfshirë të drejtat e minoriteteve.
- Të forcojë institucionet demokratike dhe si pasojë rolin e tyre në shoqëri. Të vendosë një administratë publike efektive.
- Të forcojë kontrollin civil demokratik mbi FA.
- Të ruajë rezultatet e arritura vitet e fundit në rritjen ekonomike dhe të vazhdojë reformat e saj ekonomike, veçanërisht në fushën e privatizimit.

[9] Revista Mbrojtja Nr.7/2007 "Vlerësimi maksimal për planin special të veprimit për anëtarësim"

- Të vazhdojë politikën e fqinjësisë së mirë, veçanërisht në kontekstin e situatës pas ngjarjeve në Kosovë, duke përdorur plotësisht rrjedhojat rajonale të programeve të Paktit të Stabilitetit.
- Të modifikojë legjislacionin përkatës me qëllim që ta harmonizojë atë me sistemet standarde të Aleancës.
- Të jetë plotësisht e angazhuar që të garantojë kontrollin e brendshëm të armëve dhe çarmatimit.[10]

Pjesëmarrja në Operacione për Mbështetjen e Paqes

Vendet partnere kanë luajtur një rol kritik në operacionet e udhëhequra prej NATO-s për mbështetjen e paqes në Ballkan dhe tani janë duke dhënë gjithashtu një kontribut thelbësor për misionin e NATO-s në Afganistan. Pjesëmarrja e vendeve partnere në këto operacione intensifikon sigurinë në zonën Euroatlantike dhe më gjerë. Përveç kësaj, pjesëmarrja e partnerëve në një operacion të udhëhequr prej NATO-s, vë në dukje një mirëkuptim ndërkombëtar për të ndihmuar administrimin e krizave dhe parandalon përhapjen e pasigurisë. Ushtarë nga një numër i madh vendesh partnere janë mësuar të veprojnë krah për krah me homologët e NATO-s, duke mësuar se si Aleanca vepron në rrethana komplekse dhe të vështira.[11]

Shqipëria është një ndër vendet e para të ish-bllokut komunist që shprehu vullnetin për t'iu bashkuar Aleancës së Atlantikut të Veriut e bashkë me të edhe për të kontribuar me trupa paqeruajtëse në misione të ndryshme. Për herë të parë forcat ushtarake shqiptare u angazhuan në misionet ndërkombëtare të NATO-s, në shtator 1996.

Ky mision ka filluar më 09.09.1996, me dërgimin e Kontingjentit të parë paqeruajtës, bazuar në Ligjin Nr. 8139, datë 05.09.1996, "Për dërgimin e kompanisë paqeruajtëse shqiptare për të marrë pjesë në operacionin e NATO-s, "Përpjekjet e përbashkëta në ish-Jugosllavi".

Angazhimi në misionin e ALTHEA të drejtuar nga Bashkimi Evropian, ka filluar më 2 dhjetor 2004, në bazë të Ligjit me Nr. 9015, datë 11.11.2004, "Për dërgimin e kompanisë paqeruajtëse shqiptare për të marrë pjesë në operacionin e Bashkimit Evropian, ALTHEA, në Bosnjë-Hercegovinë. Ky mision i kontingjenteve tona përfundoi në dhjetor të 2007 duke i lënë vendin një kontributi tjetër të forcave tona në këtë mision, atij të EOD.

Në prill 2008, Forcat e Armatosura (FA) rifilluan angazhimin e tyre në misionin "ALTHEA", duke mbështetur shtabin e EUFOR me një grup EOD.[12]

Angazhimi i FA të Republikës së Shqipërisë në misionin ISAF filloi në muajin Gusht të vitit 2002, me dërgimin e Kontingjentit të Parë Paqeruajtës, bazuar në Ligjin Nr. 8932 datë, 25.07.2002 "Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar, kundër terrorizmit". Kontingjentet nga i pari deri tek i katërti kanë qenë personel i batalionit të Operacioneve Speciale, kontingjenti

[10]NATO Library "NATO After Riga".
[11] Revista Mbrojtja Nr.8/2010 "Shqipëria për herë të parë në operacione luftarake paqeruajtëse".
[12] Revista Mbrojtja Nr.11/2010 "Shqipëria e përfshirë me dinjitet në çështjet e sigurisë ndërkombëtare".

i pestë e në vijim nga repartet e tjera të Forcës Tokësore. Kontingjentet ndërrohen me sistem rotacioni 6-mujor. Në të njëjtën kohë, FA në misionin e ISAF-it, të drejtuar nga NATO në Herat, që nga 23 korriku 2007 marrin pjesë bazuar në Ligjin Nr. 9752, date 07.06.2007, "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 8932, datë 26.07.2002, Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit".

Ekipi mjekësor u dërgua në Afganistan në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë, Ministrisë së Mbrojtjes së Kroacisë dhe Maqedonisë (Nenit 8 të), lidhur me krijimin e ekipit të përbashkët mjekësor për pjesëmarrjen në operacionin e drejtuar nga NATO, ISAF në Afganistan. Ekipi mjekësor shqiptar, i përbërë nga një mjek dhe 3 infermierë, veproi në përbërje të personelit mjekësor të vendeve pjesëtare të Kartës së Adriatikut (A-3) Shqipëri, Kroaci, Maqedoni. Misioni i ekipit ishte, që në bashkëveprim me personelin mjekësor të vendeve pjesëtare të Kartës së Adriatikut dhe me personelin mjekësor të vendeve të tjera, të jepte mbështetje mjekësore për operacionet paqeruajtëse dhe humanitare, mision që u mbyll me sukses në gusht të 2009-ës.

"Liria e Irakut" ishte angazhimi i FA të Republikës së Shqipërisë, i cili ka filluar në muajin prill të vitit 2003 me dërgimin e kontingjentit të parë paqeruajtës, bazuar në Ligjin Nr. 9025, datë 13.03.2003 "Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit Nr. 01, datë 09.03.2003, të Këshillit të Ministrave, Për vënien në dispozicion të hapësirës tokësore, detare e ajrore dhe dërgimin e një force ushtarake shqiptare në rajonin e Gjirit Persik, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar të luftës kundër terrorizmit".

Në korrik të vitit 2008, FA shqiptare kanë angazhuar edhe një kontingjent në operacionin e EUFOR TCHAD - RCA të drejtuar nga Bashkimi Evropian në Çad të Afrikës. Vendi ynë ka marrë pjesë edhe në misione të tjera si në rastin e misionit të vëzhguesve në Gjeorgji, etj.

Mbas anëtarësimit në NATO në prill 2009 e në vazhdim pjesëmarrja e FA me kontingjentet ushtarake në misionet ku ishim angazhuar më parë, nuk është pakësuar por përkundrazi, këto kontribute janë shtuar në sasi dhe cilësi. Këtu mund të përmendim misionin në Kandahar dhe Herat, pjesëmarrjen në NTL në Irak apo edhe dërgimin e OMLT të forcave ushtarake në korrik 2011 dhe atyre policore në kuadër të ISAF-it.[13] Misioni i kontingjenteve Shqiptare të Forcave Speciale "Eagle", përbën një mision të ri dhe shumë kompleks për FARSH.

Aktualisht, FA Shqiptare kanë të angazhuara në operacione jashtë vendit një sasi të konsiderueshme personeli ushtarak si në Afganistan me misionin ISAF, në Bosnjë misioni ALTHEA, EUFOR, përfaqësues në Shtabin Amerikan në Tampa, në Irak NTM-I, në Kosovë në përbërje të KFOR-it dhe të NATO-s (NAT).

Kurorëzimi i përpjekjeve

Shqipëria merr ftesën zyrtare për në NATO

"Shqipëria merr zyrtarisht ftesën për në NATO. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Shefer i uroi mirëseardhjen Shqipërisë në familjen e madhe euroatlantike. Marrja e

[13] Gazeta Ushtria 15 Shkurt 2008 "Anëtarësimi në NATO, Stabilitet në Ballkan"

ftesës shënon një datë historike për Shqipërinë, pasi hapet një kapitull i ri për integrimin dhe prosperitetin e vendit"[14].

Thuajse në harkun e një muaji nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, për shqiptarët u shënua ngjarja e dytë më e rëndësishme që nga rënia e komunizmit. Pas një nate të tensionuar diplomatikisht, në të ashtuquajturin Paris të Lindjes, pra në Bukuresht, Samiti më i madh në historinë e NATO-s vendosi që Kroacia edhe Shqipëria të marrin ftesën për anëtarësim. Nga struktura e krijuar vite të shkuara me iniciativën shqiptaro-amerikane dhe e quajtur A3 (Adriatik 3), mbeti thuajse jashtë vetëm Maqedonia, për shkak të së ashtuquajturës veto greke.

Shqipëria ka marrë ftesën për anëtarësim në NATO. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jap de Hop Shefer bëri zyrtare 2 ftesa: një për Shqipërinë e një për Kroacinë, duke lënë jashtë Maqedoninë. Sipas Shefer, këto dy vende do anëtarësohen në NATO, kurse "FYROM", siç theksoi ai, nuk mundi të fitojë ftesë në këtë anëtarësim.

Faktorët që kanë ndikuar për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO[15]

Anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në NATO, e lehtësuan shumë faktorë permanentë, strategjikë e politikë, të kohës e të kaluar, por edhe të perspektivës. Shqipëria plotësoi standardet, çka u shpreh në të gjitha vendimet e parlamenteve të vendeve anëtare të NATO-s që ratifikuan dhe u shprehën njëzëri për pranimin e Shqipërisë në familjen e madhe euroatlantike. Anëtarësimi në NATO për Shqipërinë mbart në vetvete disa përparësi. Dihet se sot Ballkani është një nga pikat më nevralgjike të Evropës. Në këtë kuadër, anëtarësimi i Shqipërisë në këtë Aleancë, përbën një faktor të qëndrueshëm dhe garancie, duke ekuilibruar edhe raportin e forcave në gadishull. Nga ana tjetër, do të krijohen edhe shumë mundësi që kanë të bëjnë me ristrukturimin politik, ekonomik, pse jo, edhe ushtarak në rajon. FA kanë qenë në pararojë të plotësimit të standardeve për anëtarësim në NATO. Ky është një vlerësim jo vetëm i yni, por dhe i partnerëve. Kjo tregon për një punë e përpjekje vitale, e cila nisi që në dhjetor 1992, kohë kur realizohet për herë të parë kontakti në nivelin më të lartë midis Shqipërisë dhe Aleancës. Shkëmbimet dhe bashkëpunimi midis Aleancës dhe Shqipërisë në këto vite janë zhvilluar progresivisht. Forcat e Armatosura kanë qenë dhe janë një nga institucionet më të përkushtuara dhe të konsoliduara të Shqipërisë. Reforma i transformoi ato në forca plotësisht profesioniste, moderne dhe të mirëtrajnuara. Pas marrjes së ftesës për anëtarësim në NATO në vitin 2008 nga Samiti i Bukureshtit, Shqipëria për asnjë çast nuk i ndali reformat. Periudha pothuajse njëvjeçare ishte një periudhë e ngjeshur aktivitetesh për Shqipërinë, vlerësimesh e rivlerësimesh nga shumë personalitete të NATO-s e partnere, ratifikimesh parlament pas parlamenti të vendeve anëtarë të NATO-s, proces që nisi për Shqipërinë që më 18 tetor 2008 dhe përfundoi me konsensus e sukses të plotë më 17 shkurt të vitit 2009 me ratifikimin e Holandës e të Greqisë. Të gjithë personalitetet më në zë të botës euroatlantike janë shprehur gjatë periudhës së provës, nga Samiti i Bukureshtit deri në këtë të Strasburgut, me vlerësimet më pozitive për Shqipërinë e reformat e saj

[14] NATO Library "Samiti i Bukureshtit, Deklarata e Përbashkët e Samitit.
[15] Gazeta "Ushtria", Revista "Mbrojtja".

euroatlantike.[16] Samiti i 3-4 prillit 2009 në Strasburg/Këln, është përfundimi i suksesshëm i rrugëtimit 17-vjeçar të Shqipërisë për anëtarësimin në NATO.

Obama "Krenarë që jemi aleatë". STRASBURG (04/04/2009) - Ka qenë presidenti amerikan Barak Obama, që u ka dorëzuar Kryetarëve të shteteve, Shqipërisë dhe Kroacisë, dokumentin e anëtarësimit në NATO, në një ceremoni simbolike që ka zgjatur vetëm pak minuta. Ai ka uruar krerët e anëtareve të reja për progresin në reformat e vështira, duke shprehur kënaqësinë për anëtarësimin në aleancë.[17]

Angazhimi i Forcave të Armatosura për integrimin në NATO

Për çdo komb, Ushtria përbën jo vetëm krenarinë, por edhe sigurinë e tij. Në këtë kuadër, **Forcat e Armatosura** janë të angazhuara për integrimin e plotë të të gjithë strukturave të saj. Kjo shtron nevojën për një angazhim maksimal tërësor në të gjitha nivelet vendimmarrëse dhe ato të ekspertizës. Fokusi i këtyre përpjekjeve, në të gjitha format dhe në të gjitha nivelet e përfaqësimit, duhet të jetë në qendër të vëmendjes së lidershipit tonë nëpërmjet realizimit të disa treguesve kryesorë. Rishikimi i dokumenteve strategjike, të cilat janë: SSK, SU dhe Plani Afatgjatë i Zhvillimit të FA "Vizion Strategjik 2020". Në këto dokumente materializohet e gjithë politika zyrtare e Tiranës për çështjet e Sigurisë dhe të Integrimit.

Sistemi i planifikimit. Transformimi i gjithë sistemit aktual të planifikimit të mbrojtjes drejt sistemit kolektiv të planifikimit, duke konsideruar prioritar integrimin e plotë të Shqipërisë në NATO.

Motivimi i personelit dhe ndërtimi i një force profesioniste, e cila që tani po jep rezultatet e veta qoftë në angazhimet brenda vendit, ashtu edhe në Operacionet e Mbështetjes së Paqes. Rritja e kapaciteteve operacionale, të ndërveprueshme dhe të përdorshme. Përmirësimi i performancës dhe nivelit të ekspertizës së personelit civil. Personeli që rekrutohet/përzgjidhet për të shërbyer në institucionin e mbrojtjes, përfshirja e tyre në sistemin e menaxhimit të personelit, nëpërmjet vendosjes dhe zbatimit të rregullave transparente, përfshin gjithë spektrin e këtij komponenti nga rekrutimi, edukimi, promovimi deri te dalja në pension. Përmirësimi i kulturës së punës në të gjitha hallkat dhe nivelet e institucionit të mbrojtjes. Marrja dhe shkëmbimi i informacionit, puna në grup, mirëbesimi dhe moralizimi i përpjekjeve dhe arritjeve, mbetet një sfidë që nuk është e fundit për nga rëndësia.[18]

Një nga sfidat e reja të Shqipërisë, si anëtare e re e NATO-s, do të jetë rritja dhe përshtatja e aftësive të saj për të dhënë ndihmesë ushtarake sistematike për sigurinë ndërkombëtare, sipas nevojave që do të paraqiten dhe kërkesave që do të shtrohen për t'u përmbushur. Përvoja e deritanishme e trupave tona ushtarake në misione paqeruajtëse jashtë Shqipërisë, së bashku me reformimin e vazhdueshëm të Forcave tona të Armatosura, janë dy shtylla mbështetëse në hapat tona të marrëdhënieve me NATO-n në këtë sfidë.

[16] Gazeta "Ushtria" 18 Prill 2008 "FASH, Angazhimet nga Bukureshti në Samitin e Ardhshëm"
[17] Marre nga shtypi shqiptar i ditës që i bënte jehonë Anëtarësimit te Shqipërisë në NATO
[18] Gazeta "Ushtria" 15 Prill 2011 "Forcat e Armatosura dy vjet pas anëtarësimit në NATO"

Përfundime

Nga analiza e materialeve të përdorura për trajtimin e kësaj teme studimore mund të shprehim pa rezerva se Shqipëria ka një traditë të pasur ushtarake, e cila shënon fillimet e saj që në kohët antike. Kjo traditë është pasuruar më tej në shekujt që pasuan. Në vitet 90 me ndryshimin e sistemit politik, edhe Ushtria u bë pjesë e këtyre ndryshimeve. Reforma në FA filloi me vendosjen e kontrollit civil në to, heqjen e simboleve komuniste nga uniformat ushtarake dhe zëvendësimi e tyre me simbolet kombëtare, vendosjen e gradave dhe depolitizimin e departizimin. Në vitin 1992 Shqipëria shpalli publikisht dëshirën e saj për t'u bërë anëtare e NATO-s, dëshirë e cila u pasua me ndërmarrjen e hapave konkrete në këtë drejtim.

Një nga përfundimet më të spikatura të kësaj teme kërkimore është analiza e plotë e lidhjeve që ekzistojnë midis rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe vullnetit politik, të cilët përbëjnë faktorë esencialë për realizimin e interesave kombëtare dhe për integrimin në NATO. Mbështetja reciproke e këtyre dy faktorëve do të bëhet e mundur duke njohur e zbatuar konceptet bashkëkohore të menaxhimit në luftë, me dukuri të tilla si: korrupsioni, paaftësia si dhe vendimmarrja subjektive.

Një aspekt i veçantë që duhet vlerësuar për të siguruar performancën aktive të Shqipërisë në fazën integruese, është rritja e kapaciteteve dhe e efektivitetit të strukturave koordinuese të integrimit. Në këtë drejtim, rritja e numrit të aktorëve që marrin pjesë në realizimin e procesit të integrimit, përfaqësimi i tyre në strukturat që koordinojnë këtë proces, përmirësimi i agjendës së veprimtarisë së këtyre strukturave dhe roli i tyre më i zhdërvjellët mund të kontribuojnë shumë për zhvillimin e interesave kombëtare në procesin e integrimit.

Orientimi gjatë punës për hartimin e kësaj teme kërkimore ka fokusuar në arritjen e përfundimeve që shkojnë vetëm në dobi të çuarjes përpara të interesave kombëtare dhe të integrimit të plotë te Forcave të Armatosura në NATO. Mbështetja e plotë e FA për të arritur standardet e vendeve të NATO-s, i shërben drejtpërdrejt zhvillimit të fuqisë sonë kombëtare dhe të interesave kombëtare. Kjo kërkon rritjen e kapaciteteve të kualifikuara njerëzore dhe financiare në dispozicion të Forcave të Armatosura.

Bibliografia:

- "NATO, 1949 -1999, OTAN"; "NATO në 50 - vjetorin e krijimit", Shtëpia Botuese e Ushtrisë 1999.
- Nënkolonel Hysen Goçi, "Partnership Goals (PG-s)", Qendra e Shtypit, Botimeve dhe Përkthimeve Ushtarake, 2005.
- NATO Library "Security through Partnership" NATO Public Diplomacy Division Web site: www.nato.int
- Libri i Zyrës së Shtypit dhe Informacionit të NATO-s, (Office of Information and Press) NATO – 1110 Brussels – Belgium, "Doracak i NATO-s".
- Prof. As. Dr.Elmas Leci, "Integrimi Euroaltantik", ShB IS&M.
- NATO Library "NATO After Riga", broshurë.
- NATO Public Diplomacy Division /NATO Library "NATO në Shekullin e XXI", faqe,3-15
- "Objektivat e Partneritetit me NATO-n", ShBU, 2001.
- "Kontributi i Shqipërisë për një rajon dhe Evropë të sigurtë", Revista "Mbrojtja" Nr.12/2005.

- “Integrimi në NATO pasaporta e shkëlqyer e sigurisë dhe progresit”, Revista “Mbrojtja” Nr.3/2006.
- “Samiti i Rigës: Ftesë për anëtarësim në 2008”, Revista “Mbrojtja” Nr.12/2006
- “Anëtarësimi në NATO: Sfida dhe prioritetet e Forcave të Armatosura”, Revista “Mbrojtja” Nr.3/2007.
- “Paketa e objektivave të partneritetit 2008 dhe detyrimet e Forcave tona të Armatosura”, Revista “Mbrojtja” Nr.6/2008.
- “Hyrja në NATO është fillimi i punës dhe jo mbarimi i saj”, Revista “Mbrojtja” Nr.2/2009.
- “NATO dhe realitetet e reja që burojnë prej saj”, Revista “Mbrojtja” Nr.8/2009.
- “Rasmussen: Çmojmë shumë angazhimin e Shqipërise në NATO”, Revista “Mbrojtja” Nr.5/2010.
- “Shqipëria për herë të parë në operacione luftarake paqeruajtëse”, Revista “Mbrojtja” Nr.8/2010.
- “Tempulli i paqes dhe i sigurisë”, Revista “Mbrojtja” Nr.1/2011.
- “Sfida Jonë, Një Forcë e Armatosur Profesioniste”, Gazeta “Ushtria” 4 Janar 2008.
- “Anëtarësimi në NATO, Stabilitet në Ballkan”, Gazeta “Ushtria” 15 Shkurt 2008.
- “FASH, Angazhimet nga Bukureshti në Samitin e Ardhshëm”, Gazeta “Ushtria” 18 Prill 2008.
- “Shqipëria do të gjejë vlerat e merituara brenda NATO-s”, Gazeta “Ushtria” 13 Mars 2009.
- “SHBA e vendosur të bashkëpunojë me Shqipërinë në Fushën ushtarake”, Gazeta “Ushtria” 24 Prill 2009.
- “Drejt integrimit të plotë në NATO”, Gazeta “Ushtria” 2 Tetor 2009.
- “Modernizimi në FA”, Gazeta “Ushtria” 9 Tetor 2009.

Operacioni Gjerman i Dimrit në Luginën e Shushicës (dhjetor 1943-shkurt 1944)

Kolonel (R) Mikado Shakohoxha

Trajtesë e shkurtuar. *Kur pushtuan territorin shqiptar, qëllimi i nazistëve gjermanë ishte likuidimi i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Forcave të Armatosura Popullore dhe të bazave të luftës së saj. Për të plotësuar këto objektiva, që në fillim, gjermanët shpërthyen shumë operacione lokale, por gjithnjë dështuan, duke pësuar humbje të ndjeshme në efektiva dhe teknikë luftarake. Për të pasur një fitore të garantuar, gjermanët planëzuan dhe zhvilluan një operacion të shkallës së gjerë, të përbërë prej disa operacionesh më të vogla, me një ide të vetme dhe me detyra të përbashkëta, i cili u quajt Operacioni i Dimrit 1943-1944.*

Në fshatin Vranisht, gjermanët zbarkuan në tetor 1943, ku morën në dorëzim 2000-3000 italianë, të cilët i çuan në Kuç. Pas kësaj, janë kthyer përsëri në Vranisht, duke luftuar nga tetori në dhjetor, e në vazhdim, janar, shkurt, mars, prill e qershor 1944.

Dalja në plan të parë e veprimeve luftarake të kryera në Vranisht, ku gjetën vdekjen 60 vetë në një operacion, nuk do të thotë se Vranishti ka dhënë më shumë kontribut se fshatrat e Kurveleshit apo të lumit të Shushicës.

Operacioni nazist në Luginën e Shushicës me emrin"Berkessel", 15-19 dhjetor 1943

Divizioni i 100-të i ushtrisë gjermane filloi, më 15 dhjetor, operacionin në tre drejtime: Vajzë-Ramicë-Vranisht; Qafa e Dushkut-Gjorm-Vranisht dhe Dukat-Tërbaç-Vranisht. Më vonë, forcat gjermane kaluan në mësymje edhe nga drejtimi i Borshit, i cili mbyllte unazën e goditjeve bashkëqendrore. Pikërisht, për shkak të goditjeve koncentrike, nga periferia në qendër, gjermanët ia kishin vënë emrin operacioni "Bergssel".

Duke u mbështetur në armatimet e rënda, në luftimet e përgjakshme dhe te bashkëpunëtorët, më 17.12.1943, gjermanët iu afruan Horës së Vranishtit nga shumë drejtime. Pushtimi i Vranishtit ishte i lidhur me arritjen e njërit prej objektivave të pushtuesit.

Skema nr. 1

Forcat territoriale dhe ato të Brigadës V Sulmuese vendosën t'i bëjnë një pritë të përbashkët pararojës gjermane, në periferi të fshatit Vranisht. Qëllimi i kësaj prite ishte që të plotësohej unaza e rrethimit, me qëllim që t'iu merrte krahët nazistëve dhe t'iu mbyllte rrugët e tërheqjes.

Të organizoje pritë kundër bishës naziste në këtë kohë, të hapje zjarr me njësitin e fshatit në qendër të banuar nga gra, fëmijë e pleq, rreth 2-3 muaj pas pushtimit të vendit, ishte shumë e vështirë. Egërsia e pushtuesit ishte e madhe, fuqia e tij dukej e pamposhtur, lufta kundër tij dukej e pashpresë. Por, pavarësisht nga këto, vendasit e thyen këtë mit duke gëzuar një respekt të merituar.

Pararoja gjermane mori goditje befasuese prej zjarrit të organizuar , toka i digjej nën këmbë duke lënë në fushën e veprimeve luftarake 11 të vrarë, 14 të plagosur(1 oficer) dhe 1 të zhdukur. Më 18 dhjetor pasdite erdhën forcat kryesore gjermane dhe në shenjë hakmarrjeje vranë e masakruan 10 vetë, gra, fëmijë e pleq, si dhe plagosën,

dogjën e plaçkitën. Prita prodhoi një moral të lartë, por gjermanët nuk mund ta pranonin këtë. Të 11 arkivolet e ngarkuar në Vranisht u shndërruan në thirrje për hakmarrje, e cila nuk vonoi.



Skema nr. 2

Operacioni nazist i mbiquajtur "horridoh" (thirrje për të çuar gjahun), në Luginën e Shushicës

Operacionet kundër partizanëve që u ndërmorën në Shqipëri i pagëzuan me emra gjuetie, si: "Gjuetia e thëllënxave", "Gjuetia e dhelprave", "Çuarja e gjahut", "Cjapi i egër", etj., ndërsa disa trupa të vogla kundërpartizane i quanin "Jagdkomandos" (komanda gjuetarësh).

Duke mos u kënaqur me fazën e parë të operacionit dhe nga dështimi i bisedimeve e kompromiseve me 6 batalione(6000 ushtarë) të Divizionit I Malor, të Divizionit "Shtajrer" të korpusit" XXII dhe të Divizionit të 100-të të K XXI , planëzuan operacionin "Horridoh", me 4 faza, në rajonet: Pogon, Lunxhëri, Kurvelesh-Lumi i Vlorës dhe në fund, në veri të Delvinës. Mbasi e quajti të papërfunduar fazën e parë e të dytë (ku në Pogon, Lunxhëri, Zagori e Përmet u rivendos menjëherë pushteti Këshillave Nacional- çlirimtare), filloi fazën e tretë të operacionit Tepelenë-Vlorë-

Bregdet. Objekt i goditjeve kryesore ishin: Nivica, Brati, Vranishti, Progonati, Golemi dhe rrethinat e tyre. Në këtë zonë veprimi përfshiheshin Brigada V, Grupi III dhe IV dhe batalioni "Perlat Rexhepi" i Zonës së Parë Operative, me rreth 2000 luftëtarë. Baza kryesore ishte Brigada V dhe kjo vlerësohet nga situatat më të vështira për të, ku me 31 janar ra heroikisht në Brataj, Lazer Seferi, komandant kompanie.

Lugina e sipërme e Shushicës, ku afërsisht në qendër ndodhet Vranishti, u bë rajon i veprimeve luftarake nga më të përgjakshmet edhe për faktin se ai rrugëkalim, në çdo situatë, garanton lidhje të sigurta me Vlorën, Kurveleshin, Dukatin dhe Bregun e Detit. Depërtimi i kolonave gjermane në të dy krahët e derdhjes së lumit dhe në 6-drejtime, nëpërmjet metodës së "mbytjes", kërkonte të ngushtonte rrethimin Progonat-Kuç-Vranisht, deri në asgjësim.

Vendosja e të gjithë elementëve të formacionit të luftimit të forcave gjermane, më 3 shkurt në Vranisht, për të sulmuar në drejtim të Kuçit, ishte një shkatërrim i plotë i fshatit. Në rrethana kontradiktore, gjermanët më 5 shkurt e shpallën të përfunduar këtë fazë operacionale dhe duke mos qenë të kënaqur, komanda e K.XXI e quante këtë zonë rajon"komunist" dhe kërkonte autorizime që me forcat e Divizionit të 100-të, të bënte një operacion vendimtar.

Qëndresën në fshat vranishtiotët e kaluan me vështirësi të paparashikuar dhe dolën fitimtarë, por me kosto të lartë. Edhe gjermanët po përgatiteshin për hakmarrje e mizori dhe pikërisht, 4 ditë më vonë e realizuan atë.

Operacioni Gjerman i mbiquajturi "UNDDENNOCH" (09-11 dhjetor 1944)

Vërtet që më 5 shkurt operacioni "Horridoh" ishte shpallur i përfunduar me një jehonë të madhe e të gjatë, por populli nuk u besonte "sinqeriteteve" të ushtarakëve gjermanë.

Armiqtë, në befasi e pabesi, planëzuan operacionin në tre drejtime kryesore: Fterrë-Vranisht-Bolenë; Brataj-Vranisht; Nivicë-Kuç-Vranisht dhe nga dy drejtime ndihmuese: Dukat-Tërbaç-Vranisht. Nëpërmjet manovrës krahëmarrëse dyanëshe dhe goditjeve koncentrike, ata synonin të ngjisnin forcat partizane në vargmalet me dëborë, t'i copëtonin e asgjësonin pjesë-pjesë, ndërsa me anë të terrorit, masakrave, arrestimeve e pushkatimeve, të krijonin panik në masat e popullit.

Në agimin e 9 shkurtit, ku vëmendja ishte përqendruar nga veriu, forcat gjermane u gjendën në shtëpinë e Shakohoxhëve e të Limajve në periferi të fshatit ku vranë e masakruan 11 vetë.

Në pasditen e 9 shkurtit, gati në të errur, Vranishti u gjet plotësisht i rrethuar nga të gjitha anët. Njerëzit u ballafaquan me mori ushtarësh armiq, me helmeta gjermane, me armë në pozicion luftimi në avlli, koshtera, rrugë e rrugica. 5 kolona vetëm nga jugu për të zaptuar një fshat në një ditë?. Shtëpitë u ndezën nga flaka atë ditë, fshati po shkrihej në flakë. Burra të të gjithë moshave, të detyruar, i mbyllnin në një dhomë izolimi me rreth 60 vetë brenda. Nata 9-10 shkurtit ka qenë nga më të rëndat për fshatin, të masakruarit në Bolenë nuk i linin t'i merrnin të afërmit, të vrarët në Gjistrat nuk guxonin t'i varrosnin, të izoluarve në atë dhomë të vogël u bëhej presion se kush i vrau 11 gjermanët dhe ku ishin partizanët. Kishte filluar një operacion barbar e

hakmarrës. Mbasi për gjithë natën u rezistuan presioneve të kërkesave të gjermanëve, në agimin e 10 shkurtit, të ngarkuar me materiale ushtarake, i nisën në rrugëkalimin Vranisht-Tërbaç-Brataj. Ndërkohë, praparoja u kthye e filloi djegie të gjithçkaje, grabitje masive nëpër rrugët e shtëpitë e fshatit dhe vrau 10 vetë, ndërsa dy pleq të pamundur i dogji në zjarr përvëlues. Veprime të tilla çdo gjakësor do t'i kishte zili

Marshimi u krye në kushte shumë të rënda. Me mbërritjen në Brataj, oficerët gjermanë u bënë edhe një herë thirrje për pendim robërve dhe mbas qëndrimit heroik e kundërvënës, ata masakruan 30 vetë, ndërsa disa të plagosur në dyluftim u kthyen në fshat. Ata nuk humbën në luftë, por u mposhtën nga hordhitë naziste, nuk u mungonte trimëria, por përkrahja dhe mbështetja. Gjetja e të vrarëve në fshatin e Bratit zgjati 2-3 ditë, kolonat e grave Brataj-Tërbaç-Vranisht hiqej zvarrë me mundim. Kolona me të vdekur ngarkuar mbi të gjallë.

Vrasja e 11 gjermanëve, rezistenca aktive në mbrojtjen e qendrës së banuar, qëndrimi krenar në Brataj, dinjiteti kolektiv në çdo rrethanë i detyruan gjermanët të realizonin operacione hakmarrëse. Për këto e kontribute të tjera, Vranishti me të drejtë është titulluar fshat "Martir". Në Kuç, në këtë operacion, u kapen 28 vetë dhe u pushkatuan në vend, midis tyre, 3 gra.

Nga ky operacion nazist Vranishti dhe i gjithë populli i lumit të Vlorës doli më i fortë dhe më i mobilizuar se kurrë

Roli i Kinës dhe Iranit në zhvillimin e Afganistanit

Kol. Dritan Demiraj
Komandant i Batalionit të Forcave Speciale

Trajtesë e shkurtuar. *Në vazhdimësinë e shkrimeve mbi Afganistanin po mundohemi t'i japim një shpjegim të shkurtër të ambientit të sigurisë në Afganistan, pasi nuk janë vetëm talebanët dhe Al Kaeda të cilët ndikojnë negativisht në problematikën e përditshme të Afganistanit, por dhe shtetet kufitare me të, që kanë interesa të drejtpërdrejta ekonomike, politike dhe ushtarake. Prej vitesh Afganistani po destabilizohet nga ndërhyrja e drejtpërdrejtë e Pakistanit, Iranit dhe ndërhyrja e tërthorte e Kinës. Të tria këto shtete pa dyshim kanë interesa ekonomike dhe mundohen, nëpërmjet burimeve njerëzore të tyre, të mundësojnë shfrytëzimin e burimeve energjetike të këtij shteti duke përdorur të gjitha llojet e formave dhe metodave. Sado pak që ky shkrim të na njohë me projektin e vazhdimësisë iraniane për Afganistanin, i cili që prej fushatës së ish-BS 1979-1989, vazhdon të ndërhyjë drejtpërdrejt në destabilizimin e Afganistanit, na njeh gjithashtu edhe me rolin e Kinës atje.*

Projekti i vazhdimësisë iraniane mbi Afganistanin

Për një kohë të gjatë, mes Iranit dhe Pakistanit ka patur mosmarrëveshje në lidhje me Afganistanin dhe pika e këtyre marrëveshjeve ka qenë preferenca e tyre teokratike.

Kohët e fundit, iranianët *shiitë* janë vënë re në territoret talebane *sunni*. Kjo krijon një shqetësim te planifikuesit amerikanë të luftës, pasi dihet që Garda Revolucionare Iraniane (*Sepah*) i ka ofruar armë, trajnim dhe vullnetarë, gueriljeve *sunni* në Irak[1]. Pikërisht dhe *Hamas*-i *sunni* është një degëzim i *Hezbollah*-ëve *shiitë* për të gjitha qëllimet praktike, përfshirë këtu edhe përpjekjet e Sepahu-t për rekrutimin e talebanëve. Ajo e ka kthyer kontrabandën në një punë të përkryer të IED-ve në Afganistan për të ndihmuar ata. Deri tani qëllimi i *Sepah-ut* nuk është i qartë, pasi ishte Aleanca Veriore pro-Iraniane që inicioi qeverinë e re Afgane. Për më tepër, elementet pro-iraniane ende kanë ndikim të konsiderueshëm mbi atë qeveri. Kur

[1] Louis Meixler, AP,"Exstermists Sends Recruits into Iraq via Iranian Border", Jacksonville Daily News, 8 nëntor 2004, fq 4A.

Ahmadinexhad vizitoi Kabulin në mars të vitit 2010, Presidenti *Karzai* e quajti Presidentin iranian "vëlla" dhe u shpreh se "afganët ishin me fat që ai erdhi për vizitë." Dy muaj më parë, Parlamenti Afgan kundërshtoi kur Presidenti *Karzai* u përpoq të mbante në kabinetin e tij kryekomandantin e Heratit, *Ismail Khan*, i cili prej një kohe të gjatë kishte lidhje me *Sepahun*[2].

Lind pyetja, përse do t'i ndihmonte Irani talebanët për të luftuar aleatin e tij politik? Përgjigja ka vetëm dy shpjegime: *së pari*, *Sepahu*, për ta bërë sa më të lehtë kontrabandën e drogës, ka përfaqësues përgjatë gjithë Korridorit Pashtun; dhe *së dyti*, *Sepahu* po e zgjat luftën me qëllim që Kongresi Amerikan të lodhet prej saj. Ka prova se agjentët e zbulimit iranian kanë ndihmuar në lëvizjen e drogës jashtë Afganistanit dhe disa prej tyre kanë ndihmuar gjithashtu në koordinimin e sulmeve të talebanëve ndaj forcave të NATO-s[3]. Sulmet mund të jenë përdorur për të tërhequr vëmendjen nga karvanët e drogës afgane, ose për të ulur interesin në një tjetër arenë lufte (si Iraku, Libani ose Jemeni). Sipas institutit të madh kërkimor, parashikues dhe planifikues të zhvillimeve të së ardhmes në Shtetet e Bashkuara, rezulton të jetë kjo e fundit:

Irani favorizon ruajtjen e rebelimit në nivel të ulët për aq kohë sa trupat amerikane mbeten në rajon. Një intensitet i tillë i ulët i konfliktit do ta mbante lidhur ushtrinë amerikane dhe do të lehtësonte presionin amerikan dhe ndërkombëtar mbi Teheranin në lidhje me programin e tij bërthamor dhe me polemikat e tjera të tij[4].

Instituti për Studimin e Luftës (Uashington, D.C.)

Megjithatë, alternativa e drogës është e mundshme. Përfshirja e Iranit me tregtimin e opiumit afgan nuk është çështje e re. Rreth përfundimit të luftës Sovjeto-Afgane, kryekomandanti *Akhundzada* në Hemand kishte një zyrë në Zaidan, Iran. Ajo zyrë ishte e dedikuar haptas për veprimet e tij kontrabandiste[5]. Sipas zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, rreth një e treta apo gjysma e heroinës afgane kontrabandohej nëpërmjet Iranit deri në fund të vitit 2008[6].

Demaskimi i qershorit të 2007-s

Më 7 qershor 2007, ish-cari i Antiterrorizmit (ish drejtori i shërbimit sekret) të Amerikës pohoi se lufta e Iranit ishte zhvendosur me autorizim nga Iraku në

[2] "Afghanistan's President Partner or Obstacle", by Soraya Sarhaddi Nelson, NPRs"Morning Edition" News, 24 mars 2010, Rahimullah Samander and Rahim Gul Sarwan "Concerns That Jihad Chieftains Will Set Political Agenda", Inst for Waqr and Peace Reporting, ARR Nr. 88, 18 dhjetor 2003.

[3] Peters, Seed of Terror, fq. 138.

[4] "The Presence of U.S. Troops and Alleged Support for the Insurgency", Afghanistan Project Themes, Iran and Afghanistan, Inst. for the study of War (Washington D.C.), n.d.

[5] Rubin, "The Fragmentation of Afghanistan", p. 263, in Seeds of Terror, by Peters, p. 34.

[6] "Afghanistan Opium Winter Assessment" and "Responding to drug use and HIV in Iran", United Nations Office on Drugs and Crime, January 2009 and November 2008, respectively in "The presence of U.S. Troops and Alleged Support for the Insurgency".

Afganistan. Ai është shprehur se EFP të sofistikuara (raketat e krijuara shpërthyese), të gjetura së fundmi në Afganistan,[7] kishin lidhje me karvanët e armëve nga Irani. Pas kapjes së dy karvanëve nga forcat e NATO-s, u konfirmua se ato ishin nga Garda Revolucionare Iraniane. Karvanët mbanin eksplozivë dhe qarqe për drejtimin e Granatave të Raketës (RPG).

Ky raport nuk ishte ndonjë surprizë për gardën revolucionare iraniane. Edhe në mungesë të një pushtuesi të huaj, Irani dhe Pakistani janë grindur-nëpërmjet përfaqësuesve-në lidhje me Afganistanin. Zëvendësi më i dukshëm në Iran ishte Aleanca e Veriut (më parë Fronti i Bashkuar), ndërkohë që lojtarët pakistanezë ishin talebanët. Edhe gjatë luftës Sovjeto-Afgane kishte vetëm bashkëpunim të kufizuar ndërmjet fraksioneve *muxhahedine* të dy vendeve respektive. Tashmë, provat se Irani është duke mbështetur talebanët janë duke u bërë çdo ditë edhe më bindëse. Ndërkohë që kundër-intuitës Perëndimore, kjo sindromë nuk është e re në Azinë Jugore. Pavarësisht nga ndihma e dhënë Presidentit *al-Maliki* për t'u zgjedhur (me falsifikimin e votave dhe votuesve) në Irak[8], Irani ka vazhduar të shkaktojë telashe në atë vend. Duhet të kuptohet se edhe një regjim pro-iranian nuk ka për të qenë i lirë të bëjë çfarë të dojë deri në momentin kur Kongresi Amerikan të japë mendimin për kaosin në atë vend dhe për kthimin e trupave në shtëpi. Cilido qoftë niveli i përfshirjes të *Sepahut* në Afganistan, amerikanët mund të fajësojnë vetëm veten e tyre. Kjo për arsye se *Sepah-u* u lejua të merrte pjesë në pushtimin e vitit 2001.

Prania e mëparshme e mirëpritur e Iranit në Afganistan

Bashkimi i Iranit me Aleancën e Veriut, të përbërë nga minoritete jo Pashtune, është i mirë dokumentuar. Aleanca e Veriut pajisej me armë iraniane dhe afganët e zënë rob, i dërgonte për burgim në Teheran, ku merreshin dhe në pyetje[9]. Sipas Qendrës për Studime Ndërkombëtare Strategjike, Forcat Quds të *Sepah*-ut vazhdojnë të drejtojnë kampe në Iran, të cilat janë të dedikuara në mënyrë specifike për trajnimin e ekstremistëve dhe terroristëve ndërkombëtarë. Kampi që ndodhet pranë *Mashhadit* është dhe vazhdon të përdoret për stërvitjen e revolucionarëve afganë dhe taxhikë[10].

Lideri i dikurshëm i *Sepahut* dhe kandidati iranian për president, *Mohsen Rezaie*, ppretendonte se pjesëtarët e *Sepahut* kanë luftuar së bashku dhe kanë kështilluar të njëjtat trupa të Aleancës së Veriut të cilat ndihmuan Shtetet e Bashkuara të përmbysin talebanët. Sipas "*USA Today"* të qershorit të vitit 2005, CIA e dinte se gjatë pushtimit kishte kështilltarë dhe agjentë të *Sepah-ut* të atashuar në Aleancën e Veriut. Komandantët e ushtrisë amerikane u përplasën me agjentët e zbulimit iranian në Kunduz dhe Herat. Lidhur me këtë ngjarje, Sekretari i Mbrojtjes, *Donald Rumsfeld*, gjatë një emisioni në *Columbia Broadcasting System* (CBS*)* në 11 nëntor të vitit

[7] Jason Straziuso, AP, "Afghan Bomber Deadlier", Jacksonville Daily News (NC), 3 June 2007, fq. 1A, 8A.

[8] ABC Monitor News, 14 December 2005.

[9] Jason Burke, "Waiting for a Last Battle with the Taliban", the Observer (UK), 27 June 1999, Mir, The True Face of Jihadis, p. 29.

[10] Anthony H.Cordesman, "Irans Developing Military Capabilities", working draft, Washington D.C., Center for Strategic Internal Studies, 14 December 2004, p. 35-38.

2001 është shprehur se: *"në Afganistan kishte vende ku ndodheshin disa ndërlidhës iranianë dhe disa të tjerë amerikanë", të cilët punonin me të njëjtët elementë afganë."* Një ish-zyrtar i Departamentit të Shtetit Amerikan shkoi më tej duke thënë se: "*Iranianët ishin duke pajisur dhe duke paguar Aleancën e Veriut.*[11]" Një ekstrakt i *Radios Europa e Lirë* e konfirmon këtë pohim.

Një ndihmës i Guvernatorit të Provincës së Kandaharit, *Gul Agha Shirazi*, ka pohuar se: "oficerë të vjetër ushtarakë të Iranit kanë vepruar në provincat e Farahut, Nimruzit dhe Helmandit. Ndërsa gjeneralët iranianë, të cilët përdornin emrat "*Baqbani*" dhe "*Dehqan*", ofronin para në dorë dhe stimuj të tjerë me synimin për të tërhequr kryekomandantët lokalë nga detyrimet e tyre ndaj administratës në Kabul, në përputhje me raportimin e botuar në 24 janar në "The New York Times" dhe "The Los Angeles Times."

"....Irani ka dërguar afërsisht 20 kamionë të ngarkuar me para për Ismail Khanin (kryekomandant në Herat) për të paguar trupat e tij..... Përafërsisht 12 kamionët që vinin në ditë nga Irani transportonin armë, uniforma dhe materiale të tjera luftimi..... Shefi i zbulimit të Kandaharit, Haji Gulali, tha se Ismail Khani ishte duke punuar me Trupat e Rojës së Revolucionit Islamik (IRGC) dhe aleatët e Gulbuddin Hekmatyarit, komandant muxhahedin, i cili e ka pasur bazën në Iran gjatë viteve të fundit, armatosin dhe financojnë kundërshtarët e administratës së përkohshme.[12]*"*

Radio Free Europe/Radio Liberty, janar 2002

Së fundi janë gjetur depo të tëra me mina, raketa dhe EFP Iraniane në provincat e Farahut dhe Heratit.[13] Kështu që Irani ka demonstruar më shumë se mjaftueshëm projektin e tij në vazhdim në lidhje me Afganistanin. Për fat të keq, udhëheqësit e NATO-s duket se ose nuk kanë vullnet ose janë të paaftë për të kundërshtuar këtë ndërhyrje të Iranit. Për shembull, përse përpjekjet e tyre përqendrohen thuajse plotësisht në pjesët Lindore dhe Jugore të vendit?

Nëse Irani po përpiqet të zotëronte plotësisht shoqërinë afgane, ai nuk do të kufizonte aktivitetin zbulues dhe këshillues në provincat e Heratit, Farahut, Nimrozit dhe Helmandit. Tre të parat gjenden në kufirin e tij me Afganistanin, por i katërti është në thellësi të vendit dhe burim parësor i heroinës. Iranianët ose janë duke u përpjekur ta ndalojnë atë heroinë ose po përpiqen të lehtësojnë kalimin e saj ose e përdorin atë për nevojat e tyre.

Detaje shtesë mbi mbështetjen iraniane

Shpjegimi më logjik është se armët iraniane janë duke shkuar në *Hekmatyar*. Dhe pse *Sunni* është i lidhur me talebanët[14], ai ka lidhje të forta dhe me Iranin. Ai është dhe përfaqësuesi më i fshehtë i tyre. Megjithatë, burime të larta të SHBA-së insistojnë se ndihma po shkon drejt talebanëve. Më shumë se armë, kjo ndihmë përfshin më shumë luftëtarë të huaj.

"Forcat Quds iraniane raportohet se trajnojnë luftëtarë për grupe të caktuara talebane dhe iu ofrojnë atyre forma të asistencës ushtarake për rebelime," tha Gjeneral McChrystal në raport[15].

Los Angeles Times Online, 22 shtator 2009

Gjeneral *McChrystal* rikonfirmoi, më 31 maj të vitit 2010, se disa nga talebanët afganë me të cilët po ndesheshin trupat e tij, kanë qenë të trajnuar në Iran[16]. Disa veteranë të Luftës Afgane thonë me gatishmëri se ndërmjet armiqve të tyre *sunni* ka dhe iranianë. Komandantët amerikanë duhet të vënë në dukje se si janë duke u përpjekur të ndikojnë aksionin ata iranianë dhe pastaj të bëjnë të njëjtën gjë vetë.

Në datën 2 tetor 2006, *The Guardian* (UK) botoi një artikull ku thuhej se *"burimet ushtarake dhe diplomatike deklarojnë se kanë marrë raporte të shumta për iranianë që takojnë të moshuarit tribialë në zonat e ndikuara nga talebanët, duke iu bërë oferta për mbështetje ushtarake ose, më shpesh, oferta financiare për të luftuar kundër forcave të huaja.*[17]**"**

Fondacioni Jamestown, 21 shkurt 2007

Një guvernator i mëparshëm i provincës perëndimore të Farahut, deklaroi se Irani po trajnon "një numër të madh kundërshtarësh politikë të qeverisë afgane" në një kamp refugjatësh në Iran, të quajtur Shamsabad.

Radio Free Europe/Radio Liverty, 17 mars 2007

Shpjegime të tjera të asistencës iraniane për talebanët

Përveç vijueshmërisë së drogës dhe destabilizimit qeveritar, ka vetëm dy arsye të tjera se përse një regjim radikal shiit dëshiron të rifurnizojë dhe riforcojë guerilet radikale *sunni*: (1) Të dy fraksionet kanë përcaktuar një përparësi të re në bashkëpunimin Salafist; ose (2) Një superfuqi aspiruese ka drejtuar pasuesit që vështirë se pajtohen për të bashkëpunuar. Në shtator të vitit 2009, pati një të dhënë për këtë të panjohur. Irani ka qenë duke dërguar armatim kinez në Afganistan[18].

Përzierja politike kineze në Pakistan

Në lidhje me manipulimin politik, dikush mund të mendojë për intriga diplomatike apo për marrëveshje qeveritare. Me kinezët nuk është domosdoshmërisht ky rasti.

---

[11] Barbara Slavin, "Iran Helped Overthrow Taliban, Candidate Says", USA Today, 10 June 2005, p. 14A.

[12] Iran Report.

[13] Ahmad Qurishi, "Landmine Depot Smuggled from Iran Discovered", Pajhwok News Agency, 26 January 2008, and "Iran, Iranian Weapons Cache Found in Afghanistan", U.S. AFP, 10 D
ecember 2009, both in "The presence of U.S. Troops and Alleged Support for the Insurgency".

[14] Stephen Graham, AP, "Latest Assault Leaves 2 Brits, Afghan Interpreter Dead", Jcksonville Daily News (NC), 6
maj 2004, fq. 8A.

[15] Greg Miller, "U.S. Says Pakistan, Iran helping Taliban", Los Angeles Times online, 22 shtator 2009.

[16] Heidi Vogt and Rahim Faiez, AP, "NATO General in Afghanistan, Taliban Train, Get weapons in Iran", Jacksonville Daily News (NC), 31 maj 2010, p11. Muhammad Tahir, "Iranian involvement in Afghanistan",Jamestown Faundation, Terrorism Monitor, vol 5, Issue 1, 21 shkurt 2007.

[17] Amin Tarzi, "Afghanistan, Kabuls Mulls relations with Iran"Radio Free Europe,Radio Liberty, 17 mars 2007, in "The presence of U.S. Troops and Alleged support for the Insurgency ".

[18] "Pakistani Islamists Sign Deal with China" by Farhan Bokhari, CBS News World Watch, 18 shkurt 2009.

Pikërisht pse Kina ka pasur marrëdhënie të veçanta me Autoritetin Palestinez brenda Izraelit, tashmë ka bërë një marrëveshje me krahun më radikal të partive fetare pakistaneze. Në shkurt të vitit 2009, kishte një shkrim shumë interesant të CBS nga njëri prej reporterëve të tij në Pakistan. Ai fillonte si më poshtë vijon:

Jamaat-i-Islami (JI) i Pakistanit, partia kryesore islamike e vendit dhe partia komuniste e Kinës kanë nënshkruar një marrëveshje zyrtare për të respektuar interesat e përbashkëta[19].

CBS News "World Watch", shkurt 2009

Thuhet sikur ky raportim është konfirmuar nga një lider i vjetër i *JI* nga Mansoora, selia e partisë në provincën Punjab në Pakistan. Artikulli vijonte më tej duke thënë se kinezët po përpiqeshin për të patur negociatat e tyre me bashkëpunëtorët e talebanëve. Ai gjithashtu vinte në dukje, se që prej 9/11, zyrtarët e zbulimit pakistanez "kanë raportuar pjesëmarrjen e separatisteve myslimanë kinezë në operacionet e ndërmarra nga *Al Kaeda* dhe talebanët në rajonin pakistano-afgan." Kjo nuk ishte aspak e panjohur për ata që kishin dijeni për mbështetjen zhurmëmadhe kineze për talebanët drejtues të Afganistanit, para pushtimit të vitit 2001[20]. Tashmë është më se e qartë se *JI* dhe militantët e tij bashkëpunues kanë zëvendësuar *JUI/F. JI* është partia nga radhët e së cilës dolën *HIG, Hezb* dhe *TNSM.* Kjo e vë kuadratin kinez në kampin e atyre që u përpoqën të pushtonin Islamabadin përmes Luginës *Swat* dhe aspak për t'iu kundërvënë *Al Kaeda*-s, siç do të donte të besonte perëndimi.

Me gjithë provat e mjaftueshme të armëve kineze në duart e ushtarëve talebanë, pjesa më e madhe e liderëve amerikanë ende e konsiderojnë Kinën si një aleat në Afganistan. Kina, nga ana e saj, mirëpret mundësinë për të marrë bakrin afgan dhe për ta çuar më me lehtësi naftën iraniane në shtëpinë e saj. Vetëm vëzhguesit e regjur të RPK dyshojnë ndonjë gjë të gabuar. Të gjithë ata janë tepër të vetëdijshëm për aftësinë e Kinës për zhvendosjen e burimeve natyrore prej vendeve tepër të pa stabilizuara për të mbështetur konkurrencën perëndimore. Vetëm në Afrikë, RPK ka bërë tashmë të njëjtën gjë në Sudan, në Republikën Demokratike të Kongos (DRC), Nigeri dhe së fundmi, në Guine. Ndërkohë që nuk ka prova direkte që ajo të destabilizojë këto vende, për të marrë më me lehtësi burimet e tyre, kjo është një mundësi tepër reale për një qeveri revolucionarizuese. Kur NPR raportoi, në tetor të vitit 2009, se SHBA do të ndihmonte Kinën për të hapur një kufi të ngushtë me Afganistanin, këto dyshime u thelluan.

Duke ndërtuar një lidhje hekurudhore me njërën nga minierat më të mëdha të bakrit në botë, nëpërmjet korridorit *Wahkan*[21], Kina do të ketë përmbushur "hilenë e kapelës". Më parë ajo rregulloi një lidhje hekurudhore Manta-Manaus në Andet ekuadoriane,

[19] Po aty.

[20] H. John Poole, Homeland Siege, Tactics for Police and Military (Emerald Isle, NC, Posterity Press, viti 2009), introduction "Guinea Confirms Huge China deal", BBC News Online, 13 tetor 2009., BBC News, 8 tetor 2009, ABCs Nightly News, 7 janar 2007.

[21] "Ecuador offers concession of Manta Air Base to China, Declines to renew contract with U.S. "by Vittorio Hernandez, AHN News (Ecuador), 26 nëntor 2007.

në vitin 2007 dhe një shtrirje hekurudhore Benguela në verilindje të DRC, në vitin 2008[22]. I njëjti korridor *Wahkan* u raportua të ishte përdorur nga Osama bin Ladeni, nga dy periodikë tepër të respektuar, menjëherë pas 9/11. Ai përmban një rrugë të tërthortë të *Rrugës së Mëndafshit*, të pushtuar nga *Marco Polo*. Sa për tetorin e vitit 2009, trupat amerikane kanë ofruar siguri për një kompani të RPK, e cila po shfrytëzon rezervat e bakrit të *Aynak*. Këto rezerva raportohet të vlejnë dhjetëra miliardë dollarë dhe ndodhen në provincën Logar në jug të Kabulit[23].

Më tej, në veri, kinezët kanë ndihmuar në ndërtimin jo vetëm të rrugës Herat-Bamianit, por edhe të rrugës Bamian-Peshawarit. Shpesh rrugët e ndërtuara nga RPK janë pararendëset e linjave paralele hekurudhore. Kur shinat e korridorit *Wahkan* të priten me ato të shinave të Bamianit, ato do të lejojnë importimin direkt të naftës iraniane, pa qenë e nevojshme të kalojnë në Pakistanin në rritje properëndimor.

Çfarë do të thotë e gjithë kjo për të ardhmen e rajonit?

Që Irani antiperëndimor ka kapur 71 herë më shumë opiate se Pakistani properëndimor, është pak për të zbutur shqetësimin që ky i fundit të bëhet një narko-shtet. Për më tepër, ndonjë shtet, organizatë ose lëvizje është duke u përpjekur haptazi për të destabilizuar Pakistanin sa të përmbysë qeverinë aktuale.

Në ngritjen e katër sulmeve të mirëorkestruara në stilin komando, nga grupe të ndryshme terroriste, kundër vendosjes së sigurisë në 15 tetor të vitit 2009, Rehman Mallick, ministri i brendshëm pakistanez, raportohet të ketë përshkruar me zgjuarsi situatën e pakontrollueshme në rritje që haset nga Pakistani në zonën e fisit pashtun dhe në Punjab, ndërkohë që u lëshua një sulm gueril ndaj shtetit të Pakistanit[24].

South Asia Analusis Group, 15 tetor 2009

Fajtori i fshehur mund të jetë *Al Kaeda*, pjesë e burokracisë pakistaneze (Zia dhe Musharraf të dy erdhën në fuqi nëpërmjet goditjeve të befasishme ushtarake), ose vetëm e një partie politike. Një kërkues i respektuar lokal mendon se është *JI*. Ai pretendon se programi i deklaruar i *JI* është të marrë shtetin nga brenda. Duke u përpjekur vazhdimisht të infiltrojë strukturat e pushtetit të Pakistanit, ai ka tashmë ndikim të konsiderueshëm brenda ushtrisë së Pakistanit. (Thuajse 70% e oficerëve dhe njerëzve në Ushtrinë e Pakistanit janë punjabi dhe pjesa më e madhe kanë ndjekur shkollën në Lahore). Me ofensivën *Swat* nga bashkëpunëtorët e *JI* dhe Kinën dhe me aleancën e saj me *JI*, kjo logjikë duket se është e drejtë. Megjithatë, është e mundur që një vend fqinj ekspansionist të ketë përdorur *JI-n*ë si një instrument që nuk e bën të dyshuar. Ndërkohë që Irani dhe Kina janë të dy të aftë për një gjë të tillë, kjo e fundit ka më shumë të ngjarë të ndërhyjë në punët e brendshme të Pakistanit. Përfundimisht, Nepali u dorëzua në vitin 2008, pas 20 vjet aktivitetesh subversive kundër atij vendi. Tani duket se India dhe Pakistani janë nën të njëjtin burgim. Për herë të dytë, në pesë vjet, qeveria e Indisë njoftoi më 18 shkurt të vitit 2010, se

[22] Escabar "The Roving Eye", "Osamas Secret Citadel", DEBKA-Net-Weekly, 28 shtator 2001.

[23] Amiuzadeh (Dep minister of…..Iran), Special Address to the Federation of Indian Chambers of Commerce and Industry (New Dehli, 22 korrik 2003) .

[24] . "Pakistani Reels Under A Jihadi Guerilla War", by B. Raman, South Asia analyst group, Paper nr.3462, 15 Tetor 2009.

rebelimi i saj maoist përbënte "kërcënimin e vetëm më të madh të sigurisë së brendshme" të saj. Në mes të prillit 2010, 76 policë indianë u vranë nga rebelët maoistë, në një incident të vetëm. Ndërsa 55 rajone në nëntë shtete janë sulmuar nga maoistët, në vitin 2004, një e treta e plotë e 636 rajoneve në 20 nga 28 shtetet e Indisë u mësynë në maj të vitit 2010[25].

A nuk u përpoq një tjetër fqinj komunist t'ia shtojë Afganistanin zonës së tij të influencës në vitin 1980? Duke qenë se forcat e tij të armatosura kryen operacione kundërsulmuese në thuajse të njëjtën mënyrë si Amerika, duhet mbajtur mend arsyeja e dështimit të tij.

Lidhjet e aleancës së *Quetta*-s me Pakistanin

Në maj të vitit 2009, *Associated Press* dhe korrespodenti i lajmeve *Greçen Peters* i *Kompanisë Amerikane të Transmetimeve* (ABC), dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm në transmetimin në përgjithësi të Luftës Afgane. Një pjesë e mirë e këtij kapitulli ka rrjedhur nga libri i saj "Fara e Terrorit". Ndërmjet shumë të tjerash, ky libër tregon se pjesa më e madhe e ngjarjeve në Afganistan është shumë më tepër se narkotikë dhe rebelim. Nëse nuk i jepet fund shpejt, narkotikët do të çojnë në dështimin e qeverisë së Pakistanit dhe sistemi i drejtësisë penale të SHBA-ve do të jetë i mbingarkuar në mënyrë shkatërruese.

Në fillimet e vitit 2008, Aleanca e Kuetas kishte ende kontroll të fortë të kalimit të narkotikëve, jashtë Afganistanit jugor[26]. Është vështirë të identifikohen anëtarët e saj aktualë. Haji Kuma Khani ishte ose një anëtar i spikatur, ose sfidues i suksesshëm përpara se të futej në burg kohët e fundit. Autoriteti i tij rivalizoi atë të Noorzait nga fundi i regjimit taleban. Ai mund të ketë qenë anëtari i tretë në radhë në atë hierarki. Deri në kapjen e tij në tetor të vitit 2008, Khani mbajti njërën nga rezidencat e tij të shumta të Kueta-s dhe drejtoi një perandori droge e cila qarkullonte opium dhe heroinë që kapte vlerën deri në 1 miliard dollarë në vit, për të mbështetur talebanët. Sipas një zyrtari të lartë të policisë afgane, ai nuk punonte as për talebanët e as për Al Kaedën. Në fakt, ata punonin për të.[27]

Khani ishte me origjinë nga popullata brahuni, e cila popullon zonën e shkretëtirës së tre kufijve (ku takohen Pakistani, Afganistani dhe Irani). Kontrabandimi i drogës në këtë zonë, është mjet i zakonshëm jetese. Khani qëndronte pas autokolonave me automjete nga Nimrozi për në Iran dhe pas ngarkesave të anijeve nga Karaçi për në EBA (Emiratet e Bashkuara Arabe).

Khani drejtonte gjithashtu një rafineri masive të opiumit dhe mbante depo të mëdha të nëndheshme për ruajtje në Baramaça, qyteti i pluhurosur i kontrabandistëve që shtrihet në kufirin midis Hekmandit dhe Baluçistanit. Kur Baramaça, u sulmua nga forcat pakistaneze, ai krijoi rafineri dhe vende fshehjeje në zonën e vetmuar të rajonit Chahar Borjak në jug të Nimrozit dhe përgjatë kufirit malor me Iranin. Pastaj ai krijoi laboratorë të lëvizshëm të cilët mund të përdoreshin në kamionët *Toyota* ose

[25] "Are Indian Maoist Rebels Winning the War", BBC News Online, 28 Maj 2010.

[26] Bob Clarke, former DEA agant in Islamabad, 2 Shkurt 2008, as quoted in Seeds of Terror, by Peters, fq. 86.

[27] General Ali Shah Paktiawal, as quoted in Peters, Seeds of Terror, fq. 145.

nëpër shtëpi. Thuhet se ai ka më shumë bunkerë nëntokësorë për ruajtjen e opiumit në kampin e refugjatëve të xhunglës Girdi në kufirin e Baluçistanit.[28] (Referoju te harta 2.6) Ai mbajti një forcë personale prej 1500 burrash që njiheshin në zonë si talebanë. Ai financoi gjithashtu një medrese të madhe në Pakistan nga e cila tërhiqte zëvendës për milicinë. Luftëtarët e tij nuk ishin aty vetëm për t'u dukur. Një komandant britanik i Forcave Speciale Angleze (SAS) tha se sa herë që sulmohej një laborator në zonën Deshu të Baramça, sulmi që pasonte kishte nevojë për goditje ajrore nga NATO[29].

Sidoqoftë, fuqia e vërtetë e Khan duket se ka ardhur prej aftësisë së tij për të ngritur rrjete dhe për të korruptuar zyrtarë. Në Afganistan, rrjetet e tij të shumta shtriheshin deri tek guvernatorët e provincave, agjentët e sigurisë, komandantët rajonalë të ushtrisë, anëtarët e lartë të policisë së Autostradës numër 4 dhe madje edhe deri tek rrethet e brendshme të presidentit Karzai. Khani luajti gjithashtu një rol kyç në furnizimin e talebanëve me Pajisje Eksplozive të Improvizuara (IED) të prodhimit iranian dhe kallëpe mbushjeje në vitin 2007. [30]

Bibliografia:

- Louis Meixler, AP,"Exstermists Sends Recruits into Iraq via Iranian Border", Jacksonville Daily News, 8 nëntor 2004.
- "Afghanistan's President Partner or Obstacle", by Soraya Sarhaddi Nelson, NPRs"Morning Edition" News, 24 mars 2010, Rahimullah Samander and Rahim Gul Sarwan "Concerns That Jihad Chieftains Will Set Political Agenda", Inst for Waqr and Peace Reporting, ARR Nr. 88, 18 dhjetor 2003.
- Peters, Seed of Terror.
- "The Presence of U.S. Troops and Alleged Support for the Insurgency", Afghanistan Project Themes, Iran and Afghanistan, Inst. for the study of War (Washington D.C.), n.d.
- Rubin, "The Fragmentation of Afghanistan",in Seeds of Terror, by Peters.
- "Afghanistan Opium Winter Assessment" and "Responding to drug use and HIV in Iran", United Nations Office on Drugs and Crime, January 2009 and November 2008, respectively in "The presence of U.S. Troops and Alleged Support for the Insurgency".
- Jason Straziuso, AP, "Afghan Bomber Deadlier", Jacksonville Daily News (NC), 3 June 2007, fq. 1A, 8A.
- ABC Monitor News, 14 December 2005.
- Jason Burke, "Waiting for a Last Battle with the Taliban", the Observer (UK), 27 June 1999, Mir, The True Face of Jihadis.
- Anthony H.Cordesman, "Irans Developing Military Capabilities", working draft, Washington D.C., Center for Strategic Internal Studies, 14 December 2004.
- Barbara Slavin, "Iran Helped Overthrow Taliban, Candidate Says", USA Today, 10 June 2005.

[28] Po aty.

[29] Former SAS Commander, as quoted in Seeds of Terror, by Peters, fq. 115.

[30] Po aty, fq. 159.

- Ahmad Qurishi, “Landmine Depot Smuggled from Iran Discovered”, Pajhwok News Agency, 26 January 2008, and “Iran, Iranian Weapons Cache Found in Afghanistan”, U.S. AFP, 10 December 2009, both in “The presence of U.S. Troops and Alleged Support for the Insurgency”.
- Stephen Graham, AP, “Latest Assault Leaves 2 Brits, Afghan Interpreter Dead”, Jcksonville Daily News (NC), 6 maj 2004.
- Greg Miller, “U.S. Says Pakistan, Iran helping Taliban”, Los Angeles Times online, 22 shtator 2009.
- Heidi Vogt and Rahim Faiez, AP, “NATO General in Afghanistan, Taliban Train, Get weapons in Iran”, Jacksonville Daily News (NC), 31 Maj 2010, p11. Muhammad Tahir, “Iranian involvement in Afghanistan”, Jamestown Faundation, Terrorism Monitor, vol 5, Issue 1, 21 shkurt 2007.
- Amin Tarzi, “Afghanistan, Kabuls Mulls relations with Iran “Radio Free Europe, Radio Liberty, 17 mars 2007, in “The presence of U.S. Troops and Alleged support for the Insurgency “.

The role of "Soft Security" in the frame of traditional security

Brigadier General Bardhyl Hoxha,
TRADOC Commander

Short commentary. *International environment at the dawn of the century is characterized by uncertainty, instability, and rapid change of situations, from the fading of the old rules to their replacement with new rules, which require increased evaluation skills of decision makers to respond effectively and at the appropriate time. According to some analysts, today's world is chaotic and future developments are more unpredictable than in any other period in history.*

In general terms security can be defined as security or freedom from fear and danger. Traditionally, security studies have been focused primarily on threat, use and control of military forces. However, since the end of the Cold War, the concept of security has expanded, including State, social and human security[1]

The way security policies, "hard" or "soft", implemented in peacetime, crisis and conflict are still issues under discussion. There is a great and essential discussion among key researchers and experts on the best use of these policies. The common denominator in such discussions, is that the elements of "soft security" are preventive in nature and if used well, they influence to recreate stability and extend normality in hot areas.
Nowadays there is a kind of argumentation that through dialogue and cooperation intensification and increase of financial aid and development programs, the current goal is to neutralize the potentially violent nature of "soft" threats and prevent them become "hard", in the long term.

This discussion intends to articulate the overall policy and planning "negotiations" and suggests possible strategies of mitigation and regulation. The final goal is to

[1] ***State Security*** is more related to the measures taken for the traditional security and defence of the country and is primary concerned with the sovereignty preservation, territorial integrity and independence protection.
Social Security is related to the safety and protection of the civilian population and social groups against the emergencies caused by the nature, industrial incidents or human mistakes, such as terrorism, etc.
Human Security aims the human rights protection, according to the UN Resolution 1674, under "the responsibility to protect" the population from genocide, crimes against humanity, ethnic cleansing, war crimes, etc.

create a stable system in the region/state on objective, such as the assistance from abroad is no longer needed and all forms of threats "soft" and "hard" become irrelevant.

Model of military lidership and the 21st century

Colonel Dr. Idriz Haxhiaj,
Head of Simulations Centre, TRADOC

Short commentary. *If the wide spectrum of the main operations of the Armed Forces, on the past 20 years, will be studied, then we will better understand their vitality, sacrifice and their spent energies and their willingness to be transformed, regardless the pains caused by the last deep reforms. In all this history, AF have been grown and adapted, on the most exemplary way, and are ready to assume new responsibilities In this framework, the need for qualified personnel, visionary lidership with a professional courage and integrity, as in all the other countries, is one of their main development challenges.*

The supremacy of the AF values and traditions, the creation of a positive and organisational climate, the drafting and adoption of the support policies for the solder, officer and NCO personnel and their families, will enable the recruitment of young, capable and honest citizens. The key to the success, in this regard, is the role of the political and military leadership to enable development conditions to the AF, to change their culture and to improve the military personnel structure. For this, it is needed the adjusting of many processes and systems, creative and hard work, as well as ingenuity to adopt the effective and successful forms and methods. Individuals and quality groups exist already in the majority of all the levels and organisations areas of the AF, but it is needed their synergy to common goal in order to accomplish the mission towards the country and to all our allies.

Definition and development of the security concept

Bedri Bytyçi,
MSc. Program "National Security",
Academy of the Armed Forces

Short commentary. *Security in international relations is seen by different currents in different ways. The way in which these currents view the world in terms of security, gives the individual a certain impression of the security setting around. Based on this perception are then made specific security policies and strategies.*

The article, after placing apart the complexity of security, focuses on the historical light of development, various forms and spaces which the concept of security includes. This paper treats periods that have shaped in different ways the perceptions and dimensions of security, such as the period prior to, during, and after the Cold War.

In treating the role and importance of security, as well as efforts to perceive and interpret it, it is essential to also study the importance an actor has, including the impact on the infinite stream of change.

As a conclusion, this article pays special importance to globalization and security, as one of the most debated issues, especially recently and particularly following the events of September 11 in the US. This issue has hd a profound effect on changing and determining new dimensions for the concept of security by enhancing the debate about this. It takes a central place in the field of studies on security and constitutes one of the most serious threats to it.

NATO enlargement with new members

Colonel (R) Kristaq Birbo,
Executive Director of North Atlantic Council

Short commentary. *This paper treats in summary the issue of Atlantic Alliance enlargement since its creation. Given that the next NATO Summit, which will is likely to be held in 2014, is expected to make decisions on accepting new members. The author gives an accurate and factual analysis on who might be the new members to receive the invitation for membership.*

The author is limited to the analysis of the Western Balkan countries, such as: Montenegro, Bosnia and Herzegovina, Macedonia, Serbia, Kosova, as well as two ex-Soviet Union countries, Ukraine and Georgia, which have intensified the dialog with NATO. The paper shows the path taken by these countries towards membership, achievements, non achievements in this process, and possibilities that these countries have to receive the invitation in the next summit.

There also countries, members of Partnership for Peace, that currently have not gone above this degree of membership process.

Lastly, based also on the current developments, and the tradition of NATO as regards enlargement, one comes to the conclusion (these represent only the author's opinions), that two neighbouring countries of Albania, Macedonia and Montenegro, are the only countries meeting the criteria to become NATO members.

Security culture increases awareness in the implementation of tasks

LtC. (R) Dr. Ulsi Meta

Short commentary. *Security culture is a relatively new field of information security. In recent years, security researchers and scholars began to recognize and accept*

that the security culture of an organization, public or private structure is an important factor in achieving an appropriate level of information security and of information and communication systems where the information of a structure is processed, stored and transmitted.

The implementation of information security technologies may not always result in improved security. Human factors play an important role in information security. Those who prepare information and process, preserve, transmit and apply the procedural and technical protection of information, are people. People are characterized by differences in culture, attitudes and individual behaviour, cognitive skills, personality traits, individual perception of risk etc.

Also, all these elements are influenced by the culture and structure of the security environment in which they occur. These factors interact with each other and may result in actions and attitudes that are often harmful to the security of information.

Public Diplomacy and Communication Case study: "Italian Institute of Culture"

Bonin Toptani,
MSc. Program "National Security",
Academy of the Armed Forces

Short commentary. *Nowadays the communication with the public space is very important. So in this sense, states or international actors tend to address more directly to the broad mass of the public, not only to ensure the support of the public opinion, but also to explain more clearly and directly all the necessary issues that need to be understood correctly and in a right way, by people, but also by other political communities, states, organizations, etc.*

In public communication with others, especially with the international public opinion, the organized forms by which a state addresses to another are important; when an official diplomacy addresses to another people, it shows above all its higher and well known values. In this context it is very interesting to note how large and average size countries, which are able to organize and manage strong policies towards others, appear in public.

Intelligence: important element of political decision making

Ismail Skënderaj,
MSc. Program "National Security",
Academy of the Armed Forces

Short commentary. *The effects of globalization, the great development of technology,*

means of communication, transportation, information, etc, have brought about changes in the conceptualization of international security environment. Threats of nowadays, regardless of where they appear, have a direct impact on national security, something that has led to a new concept of intelligence services, role, mission and their authorities and the need for a much more rapid response to the emergence of these threats. Intensity, variety, the unpredicted nature of current security threats as well as the dimensions of their damages are increasing and, therefore, the timelines phases of political decision making process are significantly reduced. In this reality, the fundamental feature of the importance of intelligence is their direct aid to political decision-making, through assessments, recommendations, advice and provision of the best options for political decision-making in the successful addressing of the current threats.

Challenges of intelligence services in service of policy makers associated with a new positioning of these relations, transforming from static to dynamic relations. Their importance depends not just on their legal status as state intelligence institutions, but also by their ability to successfully fulfil its mission towards threats to information security and to assure that political decision making has all the necessary information for a successful decision making in addressing issues of national security and interests of the country.

Language, vital factor of national geopolitics

MSc. Granit Zela
PhD Program, 2011-2014

Silvana Markgjonaj,
MSc. Program "National Security",
Academy of the Armed Forces

Short commentary. *Language is an essential identity component of nations and ethnicities. It is one of their distinctive features and may be as well their main character of establishing identity. When it comes to language, one is referring to a dimension of internal geopolitics of states. Language can also be a dimension of foreign geopolitics, since it is a factor of power and influence to nations, by becoming as such also a factor of hegemony.*

A nation that loses its language, in fact it loses not only the spirit but also its distinction as one people. But what is the way from ethnicity to the nation and the nation state? It is a long road that passes through using one common language by the population living within the state borders. Hence, language is also a means of building national projects.

The role of leadership in terms of gender process implementation at AF

Colonel (R) MSc. Suzana Jahollari,
Lecturer at Lidership & Social Sciences Department, AAF

MSc. Mentor Isufaj,
PhD Program, 2011-2014

Short commentary. *Given the opinion expressed by the NATO Chairman of the Military Committee, Admiral Giampaolo di Paola, that gender process is an asset to improve the operational effectiveness and it is as well a multiple force that helps to earn hearts and minds naturally one feels the obligation towards a better understanding of this process. He adds that "Gender is an expanded concept which helps the local structures to understand it, wherever NATO forces operate. In such a context, the gender perspective should be achieved as a key component of the NATO Strategic Concept.*[2] *"Together, these approaches emphasize the importance of recognizing gender perspective, especially 10 years after the adoption of Resolution 1325 of the UN Security Council "On Women, Peace and Security".*

On the occasion of International Women's Day, March 2013, The Special Representative of the Secretary- General on Women, Peace and Security, Mary Skaare, answered questions on the implementation of UNSCR 1325 in the Alliance and its missions, specifically in Afghanistan. Mary Skaare talks about the role of military women, the presence of women in decision-making and NATO long-term commitment to gender issues in Afghanistan. Thirty questions were asked by representatives of ten world countries. The Special Representative Skaare, chose five questions that dealt extensively on the issue and presented its responses on the International Women's Day. She also presented a video to answer each question; it is of interest to know the question posed by me on behalf of AAF to change the mentality of the role of men but also of women, especially through the leadership role in this process.

Concept of using AAF in national and international operations

Colonel David Rroku,
Head of Operations Department, AAF

LtC. Beqir Tafili,
Senior Officer's Course

Short commentary. *Geopolitical developments, Albania NATO membership, the diversity of military operations, the presence of the civilian factor, the rapid development of technology and information and other factors have directly*

[2] NATO, *The NCGP Conference*, May 2010.

contributed to the using redesigning of the AF structures, in various operational environments, within and outside the Republic of Albania (RoA).

Based on the recent years developments, especially on NATO membership of the RoA, the dynamic changes of the security environment, in order to harmonize the defence costs, creating operational capacities to perform the full spectrum of the operations, the RoA has conducted the Strategic Defence Review (SDR), which was based on the RoA Constitution, the National Security Strategy, the Military Strategy of the RoA, as well as on the Alliance Strategic Review 2010. The Strategic Defence Review provides the operational capabilities building for the performance of certain roles, using the concept of a single set of forces for many purposes and the identification and development of those operational capacities that can meet the national and NATO obligations.

Soldier, a modern demanding profession of high standards

Col. Prof. Asc. Dr. Kristaq Xharo.
Head of Lidership & Social Sciences Department, AFA

Short commentary. *It is not surprising that the trend of military professionalism has been increasingly growing at a steady rate since World War II. The ongoing threats of the Cold War, including the wars in Korea, Vietnam, Iraq and Afghanistan, but the subsequent growth of regional crises and global terrorism, have paved the way for a permanent attention to security issues and the protection of national psychology.*

We are trying to view the military profession, in the perspective. It is already known that trust and prestige of the military profession is strongly influenced by the behaviour of the general public towards the Armed Forces. This is related to the perception of threat by the public and in this case the prestige that each army enjoys in its state. Thus, let's consider it as an opportunity to address this experience on the basis of some knowledge elements on aspects of a more general interest, before we move to a more focused observation of the military profession in a more specific sense.

Scientific Research Methodology, not only a teaching program curricula

Dr. Simon Gega,
Lecturer at AAF

Short commentary. *Research methodology, as a separate module of the high education institutions gives meaning to the content of teaching activities, scientific research and to the institution itself. Fortunately, in the context of the entire education in RoA, research has taken a more tangible and perceptible dimension, putting*

institutions on their rightful role in the field. In this framework, the connection of the education process with the practice of State and social activity, especially for the second and third cycle of the study, present irreplaceable values to avoid the routine processes that repeat themselves.

The education institutions and their academic staffs have all the needed space to include the developing process of all the life areas into research, discussion, analysis objects, creating new and modern theories and practices of management and development. To this aim, it serves not only the diplomas and dissertations works, but also the education process itself. It is particularly important to understand that: "It is extremely ugly to talk as in books and programs, but it is as ugly if one does not discuss and leads as he has taught in the books"[3].

This is more than necessary for the security and defence field. Management practices, starting from the planning, programming, budgeting, execution to continue with the other aspects related to the personality role and lidership authority, are easily perceived as parts of an unique process in which practice and education cannot be separated. Therefore, the research methodology cannot be seen simply as a module of a subject, but also as an important part of each module of the daily activity.

The danger in war according to Clausewitz and reflection in military doctrine

Prof. Dr. Pajtim Ribaj,
Lecturer at AAF

LtC. Armir Çani,
Senior Officer's Course

Short commentary. *The war moves in an atmosphere consisting of danger, physical tension, uncertainty and chance. Everything in war is simple, but the simplest thing is difficult, and the difficulty in most cases is unexpected and unforeseen, producing a friction, being this a slowing brake on expansion and in complete dismissal of violence.*

When fighting, ground forces create a unique environment, which is extremely complex, dynamic and hostile. Military action occurs between human organisms, is complex and difficult to predict its outcome with certainty. Basically, it is unpredictable. Combating land is entirely human, human behaviour explains the nature of warfare more than numbers and technology interaction, although both can

[3] Oskar Blumenthal Wisenschaftlich schreiben leicht gemacht 4..Auflage. p.5.

be critical. In addition, war tends to be evolutionary, armed-forces learn from previous experience and the losers tend to learn more.

The intelligence may reduce uncertainty and operations can be planned to avoid this uncertainty. However, no matter how many attempts are made to identify, commanders will still have to make decisions based on incomplete information, inaccurate or inconsistent. This is called "war uncertainty". The risk decreases with the addition of information to the enemy, but aggravated by occasional adverse effects. Opportunities created by the beneficial effects of the case. These options should be used persistently to fulfil the mission. Effective and timely decision, initiative and freedom of action are the keys to exploit uncertainty, which is especially typical for the terrestrial environment.

Notion of culminating point in defence and offensive

Prof. Dr. Kostaq Karoli,
Lecturer at AAF

LtC. Edmond Sardi,
Senior Officer's Course

Short commentary. *Carl Phillip Gottfried von Clausewitz was a German soldier and military Prussian- theorist, which noted "morality" (in the modern sense, psychological) and political aspects of war. His most remarkable, Vom Krieg (On War), was unfinished at his death. Clausewitz embraced a romantic conception of war, even though he had at least one foot firmly supported the ideas of the European Enlightenment rationalist. His opinion is often described as Hegelian because of its references to dialectical thinking, but even though he probably knew Hegel, Clausewitz's dialectics is quite different and there is little reason to consider it a successor of Hegel. He stressed that the dialectical interaction of various factors, noting how unexpected developments that unfolded under the "war uncertainty" (i.e, under conditions of incomplete information, suspicious, and often completely wrong and higher levels of fear, doubt and anger) call for quick decisions by alert commanders. He saw history as a vital check on abstractions of scholars that are not in accordance with the experience.*

In contrast, Antoine-Henry Jomin, he argued that it could not be determined or reduced work with maps, geometry, and graphs. Clausewitz had many aphorisms, of which the most famous is that "War is the continuation of politics by other means", a description that has gained a wide acceptance. This paper is not intended to examine the qualities of Clausewitz man, more than an attempt to examine the impact of "culmination" described in his remarkable paper "On War", has been in some of the military NATO doctrines and Armed Forces of the RoA.

Military Power requires management capabilities and high military preparation

MSc. Luftim Dema,
Head of the Tactic Section, AFA

MSc. Agim Gjini,
Specialist in DC, TRADOC

Lieutenant Colonel Ali Mali,
Senior Officer's Course

Short commentary. *The international policy is, in itself, the effort of the nation-states to be powerful. In the international area, the power is used to defend the national interests, by influencing the partners or the potential competitors. The most important power instrument, that a nation-state may possess, is the military power. Hans Morgenthau says: "Especially, in the international policy, the military power, being a direct threat or an use access, is the most important material factor that contributes to the political power of a country."*

The other elements of the national military power are certainly important and can contribute to support and advance the national interests; however, as long as the states continue to be under an anarchy situation, the military power will continue to play a crucial role to the international policy. As Kenneth Walz rightly says, "In the policy, the force would be the last resort. In the international policy, the power serves not only as the last resort, but rather as the first and stable resort".

Information and intelligence, an important factor in decision making

MSc. Vladimir Imeraj
Lecturer at AAF

LtC Besnik Cukali,
Senior Officer's Course

Short commentary. *How important is intelligence in war? Would any commander begin an operation without first trying to detect the enemy's intentions and skills which will help him in the battlefield? "History has shown repeatedly that fewer forces can win when commanders have accurate intelligence service."*

The data of intelligence service are always used before the start of the fighting. If you look at how intelligence is used in various campaigns , including , in particular period of time of Napoleon , World War I , World War II , the Gulf Wars up to the last War against Al Qaeda , would come to the conclusion that : intelligence has played an important role and sometimes a decisive role in winning the battle .The beginnings

of intelligence were hard because there were not many ways of transmitting information until the invention of the telephone. The 20th century is the century of information, because you can get real-time information on the power and plans of the enemy.

In most case, the intelligence was one of the factors that decided the fate of a campaign. Although today it was achieved a success in the fight against Al Qaeda, again new ways are needed to be adapted to the asymmetric war.

We have to accept the fact that intelligence is important in the fight, but it is not in itself decisive. Intelligence is a great advantage, but cannot guarantee victory. Wars are won by the strength and means to win and tools to make these forces and means should be sufficient to be used skilfully and courageously. Intelligence officers have information on the enemy, but their wisdom is that this information be used for the benefit of the operation. For example, "English had information that the Germans would invade Crete, but did not make use of this information, so the Germans invaded the island easily."

In all manuals it is written about the support by the intelligence, but Clauzeviç wanted to enrich further the principles of war. Clauzeviç filled the gap "what is war? " , better defining the nature of war and its behaviour, the reasons that lead to war and its principles. One of the principles of war, he stressed, is that intelligence in war is recognizing well the opponent.

Reflections of Sun Tzu's work on Military Art of Armed Forces

LtC Arjan Rroshi,
Lecturer at AAF

Short commentary. *Academy of the Armed Forces, as the highest military education of the Armed Forces, addresses a wide range of topics in its institutional and functional courses. In the multitude of topics that have found their place and it is frequently discussed is the one related to the views of prominent strategists and military theorists, opinions which have not only persisted, but are still present whenever an inner state or regional conflict occurs. For this reason, at the beginning of this new academic year, we thought to bring this material through some reflections of the great Chinese strategist Sun Tzu on the Military Art of Armed Forces, expressed in its doctrines and manuals. Thus we believe that the institutional courses participants will find in this material a modest theoretical in dealing with topics related to theories of war.*

Strategy and Albanian Thought during the Cold War

Colonel Ahmet Leka,
Head of Doctrine Centre, TRADOC

Short commentary. *The paper addresses issues related to the development and*

modernization of the capacities of the Albanian Armed Forces, their strategy and military doctrine, after the Second War World, mainly during the period of the Cold War. Through the generalizing analysis of the main constituting elements of the FA, this paper aims at arguing the achievements regarding organisation, modernization and especially the development of the strategic and doctrinal concept of the Albanian Armed Forces, during 1945-1990.

The years 1961-1975, marked the stage of development and perfection of the establishment of the Armed Forces and their military strategy. In this period, the basic task was the further development and modernization of the Armed Forces, by organizing and shaping their "popular character" and especially the deepening of doctrinal development of the Albanian theoretical thought. Breaking with the Soviet Union, the abandonment of the Warsaw Pact obliged the communist leadership of the time to use the famous slogan that will serve as a fundamental principle in the economy and therefore in the army "complete self-support in our forces". The distinguishing feature of this period was not only the extension and completion of all structures Armed Forces reserve force, but especially the training of the personnel, enabling noticeable increase in numbers.

The new situation created after getting out of Warsaw Pact, raised as fundamental task, the necessity of a strong and safer protection of the main operational and operational-strategic directions, especially in the north, northeast and coast areas. To this purpose, the existing organizational establishment was strengthened, a thorough review and restructuring of the Armed Forces was carried out, especially in potential air deployment areas which were based primarily on the effective force in 1960, 1966, 1972 to 1975. In the Strategic Concept it made the was reorganization, ready units were established, units became closer to combat duties , and it was created the security company which up to 1981 was subordinate to Corps, and later as the first line of the Infantry Brigade.

Reformation of the Albanian Army up to its NATO membership

LtC. Leonard Çoku,
Chief of Personnel Branch in TRADOC

Short commentary. *This paper aims at explaining the complex process of the transformation of the Armed Forces (AF), the Albanian army reform, the fundamental mechanisms and best efforts of all institutions of the country towards the most difficult way, that of membership in NATO. It will focus on the key stages of activity: the dialogue on security and cooperation , membership in the Council of the North Atlantic Cooperation, Partnership for Peace Initiative, participation in Peace Support Operations; defence reform, disaster preparedness and cooperation within other regional alliances, always serving to increase security and cooperation with NATO.*

Extraordinary efforts and achievements have been made in the transformation of the

Armed Forces of RoA, from a force based on the concept of individual protection to force based on the concept of collective defence . AF have been and are one of the most dedicated and consolidated force of the Republic of Albania. Today they are powerful positive factor that affects the achievement of the strategic objectives of our country and give the message that they serve a democratic country that wants to live in peace with its neighbours, but also capable of its integration and his defence

The purpose of this paper is to present a range of issues relating to the Armed Forces membership in NATO, its full integration into NATO structures. The first chapter deals with the Albanian military traditions, military organizations from ancient times until today. The second chapter addresses issues of transformation of the Albanian army as part of society's political orientation, involvement of the Armed Forces for NATO membership, activities under the Partnership for Peace, etc. The third chapter attention is paid to the advantages of Albania 's NATO membership carries with itself, poses issues that the Armed Forces face during their integration in NATO, with emphasis on the challenges encountered in carrying out this process, the involvement of the Armed Forces under their full integration into Euro-Atlantic Alliance .

German Winter Operation in the Shushica Valley (December 1943-February 1944)

Colonel (R) Mikado Shakohoxha

Short commentary. *When occupied the Albanian territory, the purpose of Nazi-Germans was the liquidation of the National Liberation War of the Armed Forces as well as its bases. To meet these objectives, since the beginning, the Germans started many local operations, but always failed suffering significant losses in combat and effective techniques. To have a guaranteed victory , Germans planned and conducted a large-scale operation, consisting of several smaller operations, with a single idea and common tasks , called the Winter Operation of 1943-1944 .*

In Vranisht village, the Germans embarked in October 1943, where they took over 2000-3000 Italians, which were sent to Kuç. After that, they returned to Vranisht, fighting from October to December and on from January, February, March, April and June 1944.

Placing at the forefront the military operations conducted in Vranisht , where 60 people were killed in an operation, does not mean that Vranisht has given more contribution than Kurvelesh villages or those of Shushica river .

China and Iran's role in the development of Afghanistan

Col. Dritan Demiraj,
Commander of Special Forces Battalion

Short commentary. *In the series of papers on Afghanistan this is an effort to give a*

brief explanation of the security environment in Afghanistan for it is not only the Taliban and Al Qaeda that negatively affect the daily problems of Afghanistan but also the neighbouring countries, which have direct economic, political and military interests. For years Afghanistan has been destabilized by the direct intervention of Pakistan, Iran and China's indirect intervention. All three countries have undoubtedly economic interests and try through human resources to enable their use of energy resources in this state using all sorts of forms and methods. This paper is a modest effort to make us known about the Iranian continuity project for Afghanistan, which since the Soviet Union campaign from 1979-1989 continues to intervene directly in the destabilization of Afghanistan, at the same time, it focuses on China's intervention in Pakistan and vice versa.

KUJTESË

PËR BASHKËPUNËTORËT E REVISTËS USHTARAKE

Të nderuar bashkëpunëtorë të Revistës Ushtarake!

"Revista Ushtarake" është një Revistë kërkimore me fokus teoriko-shkencor. Ajo është revistë e elitës ushtarake të FA dhe e analistëve të spikatur civilë që, nëpërmjet shkrimeve të tyre, synojnë jo vetëm të informojnë, por në radhë të parë të ofrojnë zgjidhje për çështjet më të rëndësishme të reformës së Sigurisë dhe të Mbrojtjes në nivel strategjik, operacional dhe taktik. Pra, përparësia numër një e RU janë vlerat zbatuese të krijimtarisë origjinale të autorit.

Edhe njëherë ftojmë studentët e talentuar ushtarakë, akademistët e sistemit të kurseve të larta të AM, instruktorët, pedagogët, punonjësit kërkimorë, analistët, komandantët, shefat dhe trajnuesit e të gjithë institucioneve e njësive të FA të RSH, analistët e pavarur civilë apo ushtarakë në fushën e Sigurisë e të Mbrojtjes. Në vijim, Redaksia e RU jep disa udhëzime e të dhëna teknike për strukturën e artikujve të Revistës Ushtarake, të cilat duhet të respektohen prej autorëve.

Struktura e artikullit

Titulli. Emërtimi i artikullit, me tre deri në katër fjalë.

Autori, Bashkautori: Shkruhet emri i autorit ose bashkautorëve të artikullit.

Trajtesa e shkurtuar: Është pjesa që paraprin një artikull. Tek trajtesa autori shkurtimisht, duhet të paraqesë karakteristikat e artikullit (thelbin apo çështjet themelore të trajtesës, synimet e autorit, këndvështrimin, përfundimet ose rekomandimet, etj). Trajtesa nuk zëvendëson parathënien e vetë artikullit. Ajo zë rreth 1/2 e faqes dhe nuk duhet t'i kalojë të 400 fjalët.

Paraqitja, gjatësia: Pjesa kryesore e shkrimit (përfshirë parathënien dhe përfundimet) shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të jetë maksimumi 6-8 faqe kompjuterike (15 000-25 000 shkronja e shenja, duke përfshirë edhe hapësirat përfshi edhe *"endnotes"* dhe informacionin shtesë.

Formati: Faqja duhet të jetë e formatit A4; Lloji i shkrimit: "Times New Roman"; Madhësia e shkrimit 11. Kryeradha (Paragrafi i ri) përcaktohet me një rresht bosh. Paraqitja e tekstit të jetë e thjeshtë dhe në minimum të alternativave të stileve dhe formatimit. Kapitujt nuk duhet të jenë të numërzuar; teksti duhet të ketë një strukturë me maksimumin 3 nivele. Duhet të shmangen tekstet e theksuara me bold apo shkronjat me ngjyra. Shkrimi i pjerrët dhe thonjëzat duhet të përdoren vetëm për citimet e burimeve të përdorura dhe literaturës.

Grafikët, tabelat dhe imazhe të tjera duhet të bëhen të formatuara në grup, duke shmangur shpërbërjen e tyre. Ato duhet të vendosen sa më qartë në një pozicion të përshtatshëm pranë tekstit që i shpjegon ato. Të gjitha imazhet duhet të pasqyrohen në mënyrë të tillë që lexueshmëria të mos ndikohet nga reduktimi i madhësisë dhe printerat bardhë e zi. Nëse një imazh është marrë nga një burim tjetër, është e domosdoshme që të citohet burimi përkatës i tij.

Artikujt duhet të dërgohen të printuar dhe në mënyrë elektronike dhe me CD në Redaksinë e Revistës Ushtarake. Për ata artikuj që nuk i plotësojnë kërkesat e mësipërme të formatit dhe të gjuhës, Redaksia vendos nëse do t'i rikthehen autorëve për përmirësim, apo do të përjashtohen nga procesi i paraqitjes në Këshillin Botues.

Dokumentacioni: Redaksia e RU vlerëson me rëndësi të veçantë paraqitjen, nga çdo autor, të artikujve e trajtesave me referenca dhe *"footnote"* si dhe në fund të materialit të vendosë literaturën e shfrytëzuar. *"Footnote"* duhet të respektojnë në mënyrë korrekte rregullat kombëtare e ndërkombëtare ku të përfshihen; Mbiemri, emri (i autorit që i referohet), titulli i materialit të referimit, emri i entit botues, vendi i botimit, viti i botimit, numri i faqeve ku referohet, numri ISBN, *website*-in ku ndodhet artikulli. *(p.sh. Smith, James, Siguria në Shekullin e 21-të: Histori e panjohur. 2nd edition. New York, London: Oxford University Press, 2006. p..235, ISBN 0071448209,* http:/www. iir.cz/display.asp?lng=uk&ida=*)*.

Biografia: Së bashku me shkrimin, autori të dërgojë edhe një përshkrim të shkurtër biografik me rreth 100 fjalë ku të përfshijë: emrin, mbiemrin, gradën, pozicionin e punës, arsimimin, angazhimet kërkimore, fotografinë, numrin e telefonit dhe adresën elektronike.

Stili: Shkrimi duhet të paraqesë një strukturë të thjeshtë, duke përdorur tituj dhe nëntituj. Është e rëndësishme që në fund të shkrimit, autori ta mbyllë me disa përfundime dhe rekomandime të cilat duhet të jenë zgjidhje të propozuara në realitetin tonë.

Artikulli nuk duhet të përmbajë material të klasifikuar dhe duhet të zbatojë rregullat e klasifikimit të informacionit.

Artikulli nuk duhet të përmbajë ngjyrime e as qëndrime politike apo partiake.

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni me:

Dega e Botimeve (Redaksia e RU), Qendra e Doktrinës, KDS

Mail: Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, QD, Dega e Botimeve
Kutia Postare 24 23, Rruga e Dibrës, Tiranë, Shqipëri

Nr. Tel: 00355(4)23 63 465 ext. 516 /1195, 516/ 1159

Mobile: 0664050100/0664050220

Nr. Fax: 00355(4)23 69 179

Email: revistaushtarake@aaf.mil.al qdm@aaf.mil.al
ahmet.leka@aaf.mil.al silvana.markgjonaj@aaf.mil.al

Redaksia e Revistës Ushtarake

Shtypur në shtypshkronjën
“KRISTALINA-KH”
Rr. “Lord Bajron”
Tel. + 355 4 2447100
E-mail: kristalina-kh@hotmail.co.uk
Tirana/Albania